

**XHEVAT HASANI**

**S'KA DHE S'MUND TË  
KETË KOMB KOSOVAR**

**(KUNDËR IDEVE KOMB-NDARËSE TË N. SPAHIUT)**

 **PROINTEGRA**

CYRIH, 2025







**XHEVAT HASANI**

**S'KA DHE S'MUND TË KETË KOMB KOSOVAR  
(KUNDËR IDEVE KOMB-NDARËSE TË N. SPAHIUT)**

**XHEVAT HASANI**

**S'KA DHE S'MUND TË KETË KOMB KOSOVAR  
(KUNDËR IDEVE KOMB-NDARËSE TË N. SPAHIUT)**

**Redaktor:** Autori

**Redaktore gjuhësore:** Sevi Lami Agolli

**Përgatiti për shtyp:** Skënder Hajdari

**Administrues:** Bedri Halimi

**Shtëpia Botuese**

Prointegra.ch, Cyrih 2025

ISBN 978-3-9525622-6-0

Të gjitha të drejtat i përkasin autorit

**XHEVAT HASANI**

**S'KA DHE S'MUND TË KETË  
KOMB KOSOVAR**

**(KUNDËR IDEVE KOMB-NDARËSE TË N. SPAHIUT)**

**≡ PROINTEGRA**

CYRIH, 2025



# PARATHËNIE

---

Të nderuar lexues,

Shkak i drejtpërdrejtë për ta shkruar këtë libër ka qenë propagandimi i ideve komb-tjetërsuese dhe komb-ndarëse të Nexhmedin Spahiut dhe të Halil Matoshit dhe, në njëfarë mase, edhe të Migjen Kelmendit e të Bardhyl Metës.

Këta katër gazetarë pas çlirimit të Kosovës në vitin 1999 dhe sidomos pas pavarësimit të saj në vitin 2008 e këtej, kush më shumë e kush më pak, kanë propaganduar pa asnjë fakt krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”<sup>1</sup>.

Idet e tilla të këtyre publicistëve dhe gazetarëve i kam perceptuar si **ide komb-tjetërsuese**, sepse nëpërmjet tyre është tentuar dhe tentohet që kombi shqiptar në Kosovë të tjetërsohet në “komb kosovar”. Por këto ide të tyre i kam perceptuar edhe si **ide komb-ndarëse**, sepse nëpërmjet tyre është synuar dhe synohet ndarja e kombit shqiptar në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”. Dhe këto ide të tyre i kam perceptuar edhe si **ide komb-vrasëse**, sepse pasojat e ideve të tilla, nëse do të gjenin zbatim, do të çonin drejt shthurjes totale të kombit shqiptar.

Por ky libër paraqet edhe zërin tim të protestës ndaj një pjese të medieeve të Kosovës dhe të Shqipërisë, të cilat fatkeqësisht kanë shërbyer si trampolina tragjike të propagandimit nga ana e N. Saphiut, M. Matoshit, M. Kelmendit dhe të B. Metës, të gjoja krijimit nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, gjë nuk ka

---

<sup>1</sup> Shprehja “komb kosovar” në tërë tekstin e këtij libri është dhënë në thonjëza, në kuptimin se ky komb nuk ekziston realisht.

ndodhur dhe, sipas të gjitha gjasave, as s'ka për të ndodhur.

Ndërsa në televizionet e vendeve të Ballkanit dhe të Europës, propagandimi i ideve komb-ndarëse me ligje të shkruara e të pashkruara nuk lejohet, në disa televizione të Kosovës dhe të Shqipërisë, tanimë për 25 vite me radhë, katër individëve të lartpërmendur u është lejuar, pa pengesën më të vogël, propagandimi i ideve komb-tjetërsuese, komb-ndarëse dhe komb-vrasëse në adresë të kombit shqiptar, duke i neveritur dhe shqetësuar kësisoj jo vetëm rreth dy milionë shqiptarët e Kosovës, por edhe miliona shqiptarë të tjerë jashtë Kosovës.

Më tej ky libër paraqet edhe protestën time ndaj asaj pjese jo fort të vogël të medieive audiovizuale të Kosovës dhe pjesërisht edhe ato të Shqipërisë, të cilat menjëherë pas çlirimit të Kosovës në vitin 1999 dhe sidomos pas pavarësisimit të Kosovës në vitin 2008 e këtej, tanimë për 25 vite me radhë “kanë kosovarizuar” gjithçka në Kosovë: njerëzit, institucionet, objektet dhe fenomenet, duke “deshqiptarizuar” kësisoj gjithçka në Kosovë.

Që kur është çliruar Kosova në vitin 1999 e deri më tani kur po shkruhet ky libër, kanë kaluar 25 vjet, që nga shumica e medieive audiovizuale dhe të shkruara të Kosovës, emri **shqiptar** është dëgjuar e lexuar rrallë e më rrallë. Kështu që, na ka marrë malli, që nga një pjesë jo e vogël e televizioneve tona, të dëgjojmë fjalën dhe emrin **shqiptar**.

Edhe pse shumica e medieive të Kosovës shqiptarët e Kosovës i quajnë **kosovarë**, në kuptimin e përkatësisë vendore-gjeografike, sepse vendi i tyre quhet Kosovë, dhe në kuptimin e përkatësisë shtetërore, sepse shteti i tyre quhet Kosovë, dhe nuk i quajnë shqiptarët e Kosovës **kosovarë**, në kuptimin e përkatësisë “kombëtare kosovare”, megjithatë, emërtimi i shqiptarëve të Kosovës si “kosovarë” për kohë të gjatë, i kontribuon padukshëm krijimit nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

Por ky libër imi paraqet edhe protestën time ndaj dy Akademive të Shkencave dhe të Arteve: njëra e Kosovës dhe tjetra e Shqipërisë; ndaj shumicës së intelektualëve në tërë hapësirën etnike shqiptare; ndaj shumicës së politikanëve shqiptarë; ndaj shumicës së ish-të burgosurve politikë të Kosovës, kategori këto, të cilat mbase për

shkak të neglizhencës, qoftë edhe një herë të vetme, nuk janë prononcuar kundër fenomenit të propagandimit të ndarjes së kombit shqiptar në dy kombe: njëri shqiptar në Shqipëri dhe tjetri “kosovar” në Kosovë.

Kështu, nëse në të ardhmen në Kosovë do të krijohet “kombi kosovar”, për mendimin tim ai më shumë se produkt i ideve komb-ndarëse të Spahiut, të Matoshit e të ndonjë tjetri, do të jetë produkt i oportunitizmit dhe i indiferentizmit masiv të kategorive të përmendura më lart, në raport me propagandimin e ndarjes së kombit shqiptar në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

Por unë këtë libër nuk e kam shkruar thjesht për t’iu kundërvënë N. Spahiut si individ, siç mund të duket në pamje të parë, por e kam shkruar për hir të shqiptarëve të Kosovës, që ata të mos bien pre e ideve destruktive, anakronike dhe antihistorike të N. Spahiut, për ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe: njëri shqiptar në Shqipëri dhe tjetri “kosovar” në Kosovë.

Këtë libër e kam shkruar për t’iu kundërvënë ideve komb-ndarëse të Spahiut, sepse ndonëse shanset për krijimin e “kombit kosovar” janë shumë të vogla, megjithatë, nëse krijimi i “kombit kosovar” në të ardhmen do të bëhej i mundur, ai do të çonte drejt shturjes totale të kombit shqiptar në viset e tij në Ballkan.

Ajo që më ka detyruar ta shkruaj këtë libër është rrezikshmëria e tillë e krijimit të mundshëm në të ardhmen e “kombit kosovar”, sepse sa për Spahiun, nuk do të shkruaja as edhe dy fjalë, jo më një libër voluminoz, si ky që kam shkruar.

Duke qenë një njeri i rritur dhe i edukuar me ide komb-dashëse, komb-bashkuese dhe atdhe-dashëse, e kam ndier për detyrë dhe për nder që, për aq sa di e mundem, t’u kundërvihem me argumente të qëndrueshme ideve komb-tjetërsuese, komb-ndarëse dhe komb-vrasëse të N. Spahiut, të H. Matoshit, të M. Kelmendit dhe të B. Metës. Kjo, sepse për mua nuk ka nder e detyrë më të madhe, sesa ta mbrosh kombin tënd shqiptar (edhe ashtu të ndarë e të copëtuar territorialisht), nga tendencat e kujtdo qoftë për ndarjen e tij në dy kombe të ndryshme: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

Në këtë libër u jam kundërvënë kryesisht dhe drejtpërdrejt ideve komb-ndarëse të Spahiut, por duke iu kundërvënë ideve

komb-ndarëse tij, u jam kundërvënë shkarazi edhe ideve të njëjta e të ngjashme të H. Matoshit, të M. Kelmendit<sup>2</sup> dhe të B. Metës.

Gjatë gjithë jetës sime kam bërë aq sa kam ditur e mundur, për ta mbrojtur kombin shqiptar nga armiqtë e tij të relacionit Serbi-Greqi-Rusi, por nuk kam menduar se do të vijë një kohë, kur mua do të më duhet që ta mbroj kombin shqiptar nga idetë komb-ndarëse të katër shqiptarëve të përmendur më lart.

Lufta me armiqtë e kombit shqiptar nga radhët e kombeve të tjera është luftë që të bën krenar. Por lufta politike me disa shqiptarë për ta mbrojtur kombin shqiptar prej tyre, së paku mua më bën që të ndihem sa i dëshpëruar, aq edhe i trishtuar.

Dua të theksoj se nuk kam asgjë kundër Spahiut as si njeri, as si gazetar, as si publicist dhe as si politolog dhe uroj që ai të rrojë 100 vjet! Por unë kam shumëçka kundër ideve të tij komb-tjetërsuese, komb-ndarëse dhe komb-vrasëse në adresë të kombit shqiptar, të cilat ai përpiqet t'i jetësojë duke propaganduar pa asnjë fakt, krijimin nga shqiptarët e Kosovës të "kombit kosovar".

Të gjitha ato që kam shkruar në kapitujt e këtij libri, provojnë të kundërtën e atyre që ka thënë e shkruar Spahiu, Matoshi e ndonjë tjetër. Ato që ka thënë e shkruar Spahiu dhe Matoshi janë thirrje për ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri "kosovar". Ato që kam shkruar unë janë thirrje për marrëveshje, harmoni dhe integrim të brendshëm të kombit shqiptar në viset e tij në Ballkan.

Duke pasur parasysh se idetë për ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe (në komb shqiptar dhe në "komb kosovar"), bartin rreziqe të pallogaritshme për të ardhmen e tërë kombit shqiptar në viset e tij në Ballkan, qëllimi i parë dhe i fundit i këtij libri është parandalimi i krijimit nga shqiptarët e Kosovës të "kombit kosovar".

**Ndarja në pjesë dhe kapituj:** Ky libër, për shkaqe didaktike, është ndarë në 13 pjesë dhe 59 kapituj. Kriter për ndarjen e tij në 13 pjesë kanë qenë temat e veçanta, të cilat janë trajtuar në këtë libër. Kriter për ndarjen e librit në 59 kapituj kanë qenë nëntemat e ndryshme të trajtuara brenda 13 pjeseve të librit.

---

<sup>2</sup> Migjen Kelmendi ka dalë me idenë e krijimit nga shqiptarët e Kosovës të "identitetit kosovar", gjë që për mua dhe për shumkënd nënkupton idenë e krijimit nga shqiptarët e Kosovës të "kombit kosovar".

**Analiza dhe sinteza:** Metodologjia e punës e përdoruar për hartimin e këtij libri ka qenë qasja ime ndaj ideve - thënieve - me përmbajtje komb-ndarëse të Spahiu në dy drejtime të kundërta: në drejtimin e zbrërthimit të tyre nëpërmjet të analizës, duke nxjerrë të veçantat e ideve - thënieve - me karakter komb-ndarës të Spahiut, dhe në drejtimin e kundërt: atë të bashkimit të të veçantave të ideve komb-ndarëse të Spahiut nëpërmjet të sintezës, për ta nxjerrë kështu të keqen tërësore të ideve - thënieve - të tij me karakter komb-ndarës.

**Vështirësitë me deshifrimin:** Me rastin e përzgjidhjes së thënieve të Spahiut me karakter komb-ndarës, për t`i cituar ato në këtë libër dhe për t`iu kundërvënë atyre nga ana ime, kam pasur vështirësi me deshifrimin e thënieve të tij të shprehura nëpër debate televizive. Kjo sepse Spahu për gjykimin tim nxjerr nga goja fjali shumë keq të strukturuar, të ngjajshme me fjalitë e strukturura keq në gjuhën gjermane, nga ana e migrantëve të vendeve të ndryshme të vendosur në vendet gjermano-folëse, siç janë: Gjermania, Zvicra dhe Austria.

**Ide dhe njohuri shtesë:** Por ky libër nuk përbëhet vetëm nga thëniet e Spahiut dhe kundërthëniet e mia, ashtu një më një, por brenda tij duke marr shkas nga thëniet e Spahut, jam përpjekur që lexuesve t`iu jap edhe ide dhe njohuri shtesë me karakter etnik, historik, politik, teorik dhe etnopsikologjik, të cilat edhe pse dalin jashtë konizave të polemikës sime të drejtpërdrejt me Spahiu, megjithatë, janë në funksion të vërtetimit të ides bazë të këtij libri, sipas të cilës: **Në Kosovë as nuk ka pasur dhe as nuk mund të ketë “komb kosovar”, sepse në Kosovë ka pasur, ka dhe do të ketë komb shqiptar.**

**Argumentet e përdorura:** Për demaskimin dhe kundërshtimin e ideve komb-tjetërsuese, komb-ndarëse dhe komb-vrasëse të Spahiut kam përdoruar argumente të natyrshme: argumentin etnik, historik, demografik, gjeopolitik, teorik (teoritë për kombin), gjuhësor, psikologjik dhe kulturor. Në çdo kapitull të këtij libri janë cituar thëniet me karakter komb-ndarës të Spahiut, të cilave u jam kundërpërgjigjur me argumentet e përmendura më lart.

Për t'iu kundërvënë ideve komb-ndarëse të Spahiut u jam referuar: Planit/Dokumentit të Ahtisarit, në saje të të cilit Kosova është pavarësuar; Kushtetutës së Kosovës, si dhe përcaktimeve të dala nga neni 4, kapitullit i II i Kartës së Kombeve të Bashkuara, që kanë të bëjnë me anëtarësimin e shteteve në OKB.

Por, për t'iu kundërvënë ideve komb-ndarëse të Spahiut, u jam referuar edhe teorive gjermane dhe franceze për kombin, duke sqaruar përkufizime dhe veti të ndryshme për kombin, qoftë sipas teorive gjermane, qoftë sipas teorive franceze.

Do të isha i lumtur nëse këtë libër kam arritur ta bëj të kuptueshëm dhe të vlefshëm jo vetëm për intelektualët me arsim të lartë, por edhe për njerëzit me arsim të mesëm dhe fillor.

Lexuesve u dëshiroj lexim të mbarë!

Autori: Xhevat Hasani

Cyrih, nëntor 2025

PS: Ata që duan ta kenë këtë libër duhet ta bëjnë kërkesen në këtë mail-adresë: **sharri2001al@yahoo.com**

# **PJESA E PARË**

# 1

---

## **PSE NË KOSOVË NUK DUHET TË KRIJOHET “KOMBI KOSOVAR”? PSE SPAHIU, MATOSHI DHE NDOJË TJETËR KANË DALË ME IDE KOMB-NDARËSE? CILAT JANË TEMAT BOSHT TË KËTIJ LIBRI?**

### **Pse nga shqiptarët e Kosovës nuk duhet të krijohet “kombi kosovar”?**

Mendoj se një nga pyetjet që do të më parashtronin lexuesit e këtij libri do të ishte: *Pse nga shqiptarët e Kosovës nuk duhet të krijohet “kombi kosovar”?*

### **Në Kosovë ka pasur e ka komb shqiptar**

● Arsyeja kryesore pse nga shqiptarët e Kosovës nuk duhet të krijohet “kombi kosovar”, ka të bëjë me faktin se ata i takojnë kombit shqiptar, dhe për rrjedhojë nuk kanë asnjë arsye logjike të tjetërsohen në një një komb tjetër joshqiptar, të emërtuar si “komb kosovar”. Asimilimi dhe tjetërsimi i kombeve ka ndodhur kur kombet më të fuqishme kanë ushtruar shtypje etnike ndaj kombeve më pak të fuqishme. Serbia përreth një shekull ka ushtruar ndaj shqiptarëve dhunë të eger etnike, me qëllim të asimilimit dhe tjetërsimit të tyre në një komb tjetër joshqiptar, por shqiptarët as nuk janë asimiluar e as nuk janë tjetërsuar në ndonjë komb tjetër joshqiptar. Dhe shqiptarët aq më pak asimiohen e tjetërsohen në ndonjë komb tjetër joshqiptar, pas

çlirimit dhe pas pavarësimit të Kosovës, kur më ndaj tye nuk ushtrohet shtypje etnike.

### **Efekti zinxhiror negativ i “kombit kosovar”**

● Arsyeja tjetër pse nga shqiptarë e Kosovës nuk duhet të krijohet “kombi kosovar”, ka të bëjë me efektin zigjiror negativ që ai do të kishte për tërë kombin shqiptar. Krijimi i tij (“i kombit kosovar”) nuk do ta ndante kombin shqiptar në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”, vetëm brenda relacionit Kosovë-Shqipëri, por do ta ndante kombin shqiptar në dy kombe (shqiptar - “kosovar”) edhe brendapërbrenda Kosovës, brendapërbrenda viseve shqiptare në Maqedoninë e Veriut, brendapërbrenda shqiptarëve në Mal të Zi dhe brendapërbrenda shqiptarëve të Luginës së Preshevës në jug të Serbisë.

● Dhe jo vetëm kaq, por “kombi kosovar” nuk duhet të krijohet, sepse ideja e krijimit të tij edhe në sajë të veprimtarisë agjenturore të Serbisë, do të mund të bartej edhe në mesin e shqiptarëve të tri krahinave veriore të Shqipërisë, siç janë krahina e Lumës, e Hasit dhe e Tropojës, duke u ndarë kështu edhe pjesa e kombit shqiptar në Shqipëri në dy kombe: në komb shumicë shqiptar dhe në komb me pakicë “kosovar”.

### **“Kombi kosovar” do të mund të çonte deri në konfliktin Shqipëri-Kosovë**

● Dhe nëse shqiptarët e krahinave të lartpërmendura të Shqipërisë, duke u ndier pjesëtarë të “kombit kosovar”, do të kërkonin në të ardhmen që krahinat e tyre t’ia bashkonin shtetit të Kosovës, kjo në rastin më të keq do të mund të çonte deri te konflikti Shqipëri-Kosovë. Kështu, nëse ndonjëherë mes Shqipërisë dhe Kosovës do të ketë konflikt të armatosur, ajo për mendimin tim do të mund të ndodhte, vetëm nëse nga shqiptarët e Kosovës do të krijohet “kombi kosovar”.

● E di se shumëkush nuk beson që ideja e krijimit të “kombit kosovar”, mund të depërtojë edhe në tri krahinat veriore të Shqipërisë, dhe se shumëkush nuk beson se krijimi i “kombit kosovar”, do të mund të çonte deri te konflikti Shqipëri-Kosovë! Më

vjen keq të them, por ata që nuk i besojnë këto pohime, mendoj se ende nuk kanë arritur ta kuptojnë plotësisht, se kush është Serbia dhe shovinizmi i saj tejet specifik dhe efektiv, sidomos në raport me shqiptarët.

### **Kombi i ndarë në gjashtë njësi territoriale nuk duhet të ndahet më tej në dy kombe**

● Arsyeya tjetër pse nga shqiptarët e Kosovës nuk duhet të krijohet “kombi kosovar”, ka të bëjë me faktin se, nëse një komb, që përveçse është i **ndarë gjeografikisht-territorialisht** në gjashtë njësi shtetërore të ndryshme, siç është rasti me kombin shqiptar, pranon që të ndahet edhe në dy kombe (në komb shqiptar dhe “kosovar”), ai komb kështu nuk bën gjë tjetër, përveçse vret veten me dashje! Unë jam i sigurt se shqiptarët nuk do ta vrasin veten dashje duke u ndarë në dy kombe. Përkundrazi, ata do ta fuqizojnë vetën duke e kultivuar unitetin dhe bashkimin kombëtar.

### **Kombi më i rrezikuar i Ballkanit dhe i Europës nuk do të duhej të ndahet në dy kombe**

● Dhe arsyeya tjetër pse nga shqiptarët e Kosovës nuk duhet të krijohet “kombi kosovar”, ka të bëjë me faktin se kombi shqiptar **paraqet kombin më të rrezikuar të Ballkanit dhe të Europës**. Dhe nëse kombi më i rrezikuar i Ballkanit dhe i Europës pranon të ndahet në dy kombe (njëri shqiptar dhe tjetri “kosovar”), ai komb (në rastin konkret kombi shqiptar) kështu nuk bën gjë tjetër, përveçse e firmos vetë zhbërjen e tij në planin afatmesëm dhe afatgjatë.

● **Në njërin anë është Greqia**, ajo e cila pasi i ka aneksuar vetes 2/3 e Krahinës Shqiptare të Çamërisë të banuar deri vonë dëndur me shqiptarë, tanimë ka më shumë se 70-të vjet që ka synuar dhe synon edhe aneksimin e viseve jugore të Shqipërisë. Ajo dëshiron ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe, sepse në përpjekje e sipër për aneksimin e viseve jugore të Shqipërisë, nuk dëshiron të ketë punë me 5 milionë shqiptarë, por dëshiron të ketë punë vetëm me 3 milionë shqiptarë të Shqipërisë.

● **Në anën tjetër është Serbia**, ajo që edhe pse në të kaluarën

ia ka aneksuar vetes Kosovën e sotme, Sanxhakun e Pazarit të Ri dhe Sanxhakun e Nishit, të gjitha këto pjesë të Vilajetit të Kosovës, megjithatë ende nuk i ndal përpjekjet që ta ripushtojë Kosovën e sotme të lirë dhe të pavarur. Edhe Serbia e dëshiron ndarjen e kombi shqiptar në dy kombe, sepse në përpjekje e sipër për ta ripushtuar Kosovën, nuk dëshiron të ketë punë me 5 milionë shqiptarë, por dëshiron të ketë punë vetëm me 2 milionë “kosovarë”.

● **Edhe Bullgaria** brenda një konflikti të gjerë rajonal do të përpiquej që ta pushtonte dhe aneksonte Maqedoninë e Veriut, bashkë me Maqedoninë Perëndimore të banuar dendur me shqiptarë, gjë që tregon se edhe Bullgaria brenda rrethanave të caktuara do të ishte një armike e kombit shqiptar, të cilës po ashtu i leverdis ndarja e kombit shqiptar në dy kombe.

● Dhe në një konflikt të gjerë rajonal edhe ajo **pjesë e malazezve**, e cila edhe pse si tërë kombi malazez ka origjinë iliro-arbërore, megjithatë ndihet të jetë e përkatësisë kombëtare serbe, po ashtu do t'i kapte armët kundër shqiptarëve, për ta pushtuar qytetin e Shkodrës si dikur në vitin 1913, gjë që flet se edhe kjo pjesë e malazezve të asimiluar në serbë, brenda rrethanave të caktuara, do të ishte armike shtesë e kombit shqiptar, të cilës po ashtu i leverdis ndarja e kombit shqiptar në dy kombe.

● Kështu, ndërsa kombi kroat rrezikohet vetëm nga Serbia, ndërsa edhe kombi boshnjak-mysliman rrezikohet vetëm nga Serbia dhe ndërsa edhe kombi malazez rrezikohet po ashtu vetëm nga Serbia, kombi shqiptar rrezikohet nga Serbia, Greqia dhe Bullgaria, si dhe nga malazezët e tjetërsuar në serbë. Kjo është arsyeja pse unë them se kombi shqiptar paraqet kombin më të rrezikuar në Ballkan dhe në Europë.

● Duke qenë se kombi shqiptar është kombi më i rrezikuar i Ballkanit dhe i Europës, kjo është një arsye e fuqishme që ai të qëndrojë i bashkuar si komb dhe jo të ndahet në dy kombe, thjesht sepse një ndarje e tillë po i duhet Spahiut, Matoshit e ndonjë tjetri.

● Shqiptarët edhe sikur të mos ishin kombi më i rrezikuar i Ballkanit dhe i Europës, ata sërish nuk kanë asnjë arsye logjike për t'u ndarë në dy kombe. Përkundrazi, ata kanë një mijë e një arsye (etnike, historike, politike, strategjike, kulturore dhe ekonomike),

për të qenë një komb unik shqiptar, që synon bashkimin e tij kombëtar, kuptohet me rrugë demokratike dhe në marrëveshje me vendet aleate euroatlantike.

● Edhe nëse Kosova dhe Shqipëria nuk do të bashkohen ndonjëherë, shqiptarët sërisht nuk kanë asnjë arsye të ndahen në dy kombe: në komb shqiptar dhe në “komb kosovar”. Kjo sepse shqiptarët si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, mund të jetojnë shumë mirë si komb shqiptar. Ndarja e shqiptarëve në dy kombe është një mijë herë më tragjike se mosbashkimi Kosovë-Shqipëri.

● Duke pasur parasysh se kombi shqiptar paraqet kombin më të ndarë e më të copëtuar territorialisht, si dhe paraqet edhe kombin më të rrezikuar në Ballkan dhe në Europë, secila mendje që gjykon realisht, do t’i këshillonte shqiptarët që të unifikoheshin sa më shumë kombëtarisht, shoqërisht, politikisht, ekonomikisht, gjuhësisht dhe kulturalisht. Por në këtë botë ka mendje e mendje...! Kështu, në këtë botë ka edhe mendje si ajo e Spahiut dhe e Matoshit, të cilat i këshillojnë shqiptarët që të ndahen më dysh kombëtarisht, gjuhësisht dhe kulturalisht.

### **Kosovës askush nuk ia ka kërkuar krijimin e “kombit kosovar”**

● Shqiptarët e Kosovës nuk kanë pse të tjetërsohen në “komb kosovar”, edhe për vetë faktin se SHBA-ja dhe vendet e fuqishme të Europës, ndihmën e tyre madhore për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës, fatmirësisht, nuk e kanë kushtëzuar me krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”. Sikur këto vende ndihmën e tyre madhore për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës do ta kishin kushtëzuar me krijimin e “kombit kosovar”, ato deri më tani Kosovës do t’ia kërkonin shumë herë krijimin e “kombit kosovar”.

● Por ne jemi dëshmitarë, se vendet perëndimore që kanë dhënë ndihmën e tyre madhore për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës, as edhe një herë të vetme nuk kanë kërkuar nga Kosova që të krijojë “kombin kosovar”. Këto vende nuk e kanë kërkuar krijimin e “kombit kosovar” nga se kanë pasur frikë apo turp, por nuk e kanë kërkuar, sepse krijimi i “kombit kosovar”, si komb politik

dhe artificial, nuk ka qenë e nuk është pjesë e agjendës së tyre për Kosovën. Kështu, Spahiu kot është përpjekur dhe përpiqet që t'i bindë (mashtrojë) shqiptarët, sikur gjoja krijimi nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, ka qenë dhe është kërkesë e faktorit ndërkombëtar.

### **Ideja e “kombit kosovar” paraqet idenë më të rrezikshme të mundshme**

● Duke pasur parasysh tërë ato që u thanë më lart, rezulton se idetë e Spahiut, të Matoshit e të ndonjë tjetri për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, paraqesin idetë më të rrezikshme dhe më tragjike të mundshme, të bëra ndonjëherë në adresë të kombit shqiptar. Mendoj kështu, sepse hapi i parë i shkatërrimit të një kombi të ndarë në gjashtë pjesë, shumë i rrezikuar nga fqinjët e vetë dhe relativisht i vogël, siç është kombi shqiptar, është ndarja e tij në dy a më shumë kombe.

● Duke pasur parasysh rrezikshmërinë e krijimit të “kombit kosovar” për tërë kombin shqiptar në viset e tij Ballkan, këtë libër ndër të tjera e kam shkruar edhe me qëllim, që t'u tërheqë vëmendjen intelektualëve, publicistëve, gazetarëve, ish-të burgosurve politikë, shoqatave të veteranëve të luftës së UÇK-së, kryetarëve të partive dhe sidomos dy Akademive të Shkencave dhe të Arteve, njëra e Kosovës dhe tjetra e Shqipërisë, që t'u kundërvihen ideve që e synojnë ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe: njëri shqiptar dhe tjetri “kosovar”.

### **1. Pse Spahiu, Matoshi e ndonjë tjetër kanë dalë me idenë e krijimit të “kombit kosovar”?**

Mendoj se pyetja tjetër që do të më shtrohej nga lexuesit e këtij libri do të ishte: ***Pse Spahiu, Matoshi e ndonjë tjetër, menjëherë pas çlirimit të Kosovës nga Serbia okupatore në vitin 1999 dhe sidomos pas pavarësisht të Kosovës në vitin 2008, kanë dalë me idenë e ndarjes së kombit shqiptar në dy kombe, nëpërmjet propagandimit të krijim-ekzistimit të “kombit kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues?***

● Meqë shkaku e vërtetë pse Spahiu, Matoshi e ndonjë tjetër,

menjëherë pas çlirimit dhe pavarësimit të Kosovës, kanë dalë me ide të tilla komb-ndarëse nuk e di, unë mundem vetëm të supozoj pse ata kanë dalë me ide të tilla komb-ndarëse.

● Ndoshta Spahiu, Matoshi e ndonjë tjetër kanë dalë me ide komb-ndarëse, thjesht sepse ata besojnë që krijimi nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, paraqet diçka të mirë për konsolidimin e shtetit të Kosovës. Por ky supozim nuk qëndron, sepse konsolidimi i shtetit të Kosovës nuk varet aspak nga krijimi apo moskrijimi i “kombit kosovar”, por varet kryekëput nga zbatimi i reformave demokratike, ekonomike dhe politike, nga shkalla e përndjekjes dhe e ndëshkimit të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe nga shkalla e respektimit të të drejtave dhe të lirive të njeriut etj.

● Duke pasur parasysh se faktori ndërkombëtar, i cili ka dhënë ndihmën madhore për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës, nuk e ka kritikuar asnjëherë Kosovën pse ajo nuk e ka krijuar “kombin kosovar”, por e ka kritikuar Kosovën për zbatimin e ngadalshëm të reformave demokratike dhe politike dhe, për ndjekjen e ndëshkimit e pakët të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, kjo tregon qartë se konsolidimi i shtetit të Kosovës nuk ka të bëjë aspak me krijimin apo moskrijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

● Ndoshta Spahiu, Matoshi e ndonjë tjetër kanë dalë me ide komb-ndarëse, sepse duke komunikuar me pjesën e kombit shqiptar në Shqipëri, janë ndier inferiorë ndaj shqiptarëve të Shqipërisë (ndaj intelektualëve, politikanëve, artistëve, publicistëve dhe gazetarëve të Shqipërisë). Dhe mbase kjo ndjenjë inferioriteti ka bërë që ata të angazhohen për distancimin e vetes dhe të shqiptarëve të Kosovës nga shqiptarët e Shqipërisë, duke propaganduar krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

● Ose ndoshta Spahiu, Matoshi e ndonjë tjetër kanë dalë me ide komb-ndarëse thjesht për protagonizëm: për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve ndaj tyre sikur janë dikush. Herostati në kohët antike e ka djegur Athinën thjesht për të tërhequr vëmendjen të tjerëve ndaj tij dhe kësaj për t’u bërë i famshëm.

● Është fakt i njohur në psikologji, se njerëzit, të cilëve u mungon inteligjenca pozitive dhe resurset shpirtërore pozitive, përpiqen

që të bëhen të famshëm duke vënë në veprim inteligjencën dhe resurset e tyre shpirtërore negative: përpiqen të bëhen të rëndësishëm duke dalë me ide dhe veprime të mbrapshta.

● Ose ndoshta Spahi, Matoshi e ndonjë tjetër kanë dalë me ide komb-ndarëse, thjesht sepse krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, për arsye që ne nuk i dimë, e kanë mision jetësor. Por, nëse ata krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” e kanë mision jetësor për veten e tyre, apo e kanë mision jetësor të sponsorizuar nga ndonjë komb e vend antishqiptar, siç është p.sh., Serbia, kjo është çështje që mund të diskutohet.

● Sa më përket mua, jam i prirë të mendoj se Spahi, Matoshi dhe ndonjë tjetër, krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” e kanë mision të vetin, por as variantin që ata krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” ta kenë mision të sponsorizuar nga ndonjë komb e vend antishqiptar, siç është Serbia, nuk mund ta përjashtoj deri në fund.

## 2. Cilat janë temat bosht të këtij libri?

Mendoj se pyetja e radhës që do të më shtrohej nga lexuesit e këtij libri do të ishte: ***Cilat janë temat bosht të këtij libri?***

● Në këtë libër trajtohen disa tema bosht, të cilat përfshijnë aspekte të ndryshme të kundërvënies sime ndaj ideve komb-ndarëse të Spahiut, të propaganduara nëpërmjet të idesë së krijimit nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

● **Brenda temës së parë bosht** - asaj që kombi shqiptar është një komb unik dhe i pandarë, jam përpjekur që t'i sqaroj lexuesit me argumente etnike, historike, politike, gjuhësore dhe etno-psikologjike, pse kombi shqiptar në tërë hapësirën e tij ballkanike ka qenë, është dhe, sipas të gjitha gjasave, edhe do të jetë një komb monoetnik i pandarë, prej të cilit brenda rrethanave normale as nuk ka mundur dhe as nuk do të mund të krijohet një komb tjetër “kosovar”.

● **Brenda temës së dytë bosht** - jam përpjekur që t'i sqaroj lexuesit lidhur me paqëndrueshmërinë, destruktivitetin, falsitetin dhe fiktivitetin e ideve të tilla komb-ndarëse të Spahiut e të ndonjë tjetri. Brenda kësaj teme bosht, ideve komb-ndarëse të Spahiut u

jam kundërvënë me ide komb-konsoliduese dhe komb-bashkuese, kurse kuaziargumenteve, manipulimeve dhe spekulimeve të tij u jam kundërvënë me argumente të mirëfillta.

● **Brenda temës së tretë bosht** - asaj të teorive të ndryshme për kombin të dhëna nga filozofë, sociologë, historianë dhe studiues të ndryshëm, jam përpjekur t'i sqaroj lexuesit se, ndërsa kombet multietnike (të përbëra nga etni të ndryshme), janë krijuar në përputhje me teoritë franceze për kombin, të përfaqësuara nga Ernest Renan, kombet monoetnike (të krijuara nga etni të vetme, siç është rasti edhe me kombin shqiptar), janë krijuar në përputhje me teoritë e filozofëve gjermanë për kombin, të përfaqësuara nga Johann Gottlieb Fichte. Dhe brenda kësaj teme bosht jam përpjekur që t'i sqaroj lexuesit lidhur me spekulimet e Spahiut me teoritë franceze për kombin (të vlefshme për kombet multietnike), për t'i bindur shqiptarët e Kosovës se ata, pas çlirimit të Kosovës në vitin 1999 dhe pas pavarësismit të Kosovës në vitin 2008, veç janë tjetërsuar nga kombi shqiptar në "komb kosovar". Spekulimeve të tilla të Spahiut me teoritë franceze për kombin u jam kundërvënë me teoritë gjermane për kombin, të vlefshme për kombet monoetnike, siç është edhe kombi shqiptar në tërë hapësirën e tij etnike.

● **Brenda temës së katërt bosht** - jam përpjekur që t'i sqaroj lexuesit lidhur me kuaziargumentet e Spahiut, sipas të cilave pas çlirimit dhe pas pavarësismit të Kosovës, flamuri kombëtar shqiptar në Kosovë jo vetëm që nuk do të duhej të përdorej, por do të duhej të hiqej edhe nga varrezat e Dëshmorëve të Kombit, në Prekaz, në Glogjan e vende të tjera ku janë varrezat e dëshmorëve. Natyrisht që kuaziargumenteve të Spahiut për mospërdorimin e flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë, u jam kundërvënë me argumente të mirëfillta etnike, historike dhe politike, të cilat flasin se flamuri kombëtar shqiptar në Kosovë do të përdoret gjithnjë, derisa do të ketë shqiptarë mbi tokë.

● **Brenda temës së pestë bosht** - asaj të bashkimit kombëtar në përgjithësi dhe asaj të bashkimit Kosovë-Shqipëri në veçanti, jam përpjekur t'i sqaroj lexuesit lidhur me idetë e Spahiut për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri, ose për bashkimin Kosovë-

Shqipëri, pasi në Kosovë do të jetë krijuar “kombi kosovar” dhe pasi Kosova të jetë bërë vend anëtar i OKB-së, ndërkohë që dihet se po u krijua nga shqiptarët e Kosovës “kombi kosovar”, nuk mund të ketë bashkim Kosovë-Shqipëri. Kështu, ideve kundër-komb-bashkuese të Spahiut u jam kundërvënë me idetë komb-bashkuese të shqiptarëve në përgjithësi, dhe me idetë komb-bashkuese të rilindësve kombëtarë shqiptarë në veçanti.

● **Brenda temës së gjashtë bosht** - asaj që ka të bëjë me jetën dhe veprën e rilindësve kombëtarë shqiptarë, jam përpjekur t’i sqaroj lexuesit se nuk qëndrojnë thëniet e Spahiut, sipas të cilave rilindësit duke e ditur se etnia dhe kombi janë dy gjëra të ndryshme (sipas teorive franceze për kombin), paskan lënë hapësirë teorike, që nga etnia shqiptare të krijohet një komb tjetër, ta zëmë “kosovar”. Por duke qenë se kombi shqiptar është një komb monoetnik, rilindësit kombëtarë e kanë ditur se te kombet monoetnike etnia dhe kombi paraqesin të njëjtën gjë, ndaj jo vetëm që nuk kanë lënë hapësirë për ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe, por përkundrazi edhe janë tretur si qirinj për bashkimin e kombit shqiptar në një Shqipëri të vetme.

● **Brenda temës së shtatë bosht** - asaj të krijimit të kombit austriak nga kombi gjerman dhe asaj të krijimi i kombit moldav nga kombi rumun, jam përpjekur t’i sqaroj lexuesit, se krijimi i këtyre dy kombeve nuk paraqet shembullin e duhur për ta përligjur krijimin e “kombit kosovar” nga kombi shqiptar, siç mundohet të na bindë Spahiu.

● Kjo, sepse ndërsa kombi austriak është krijuar për shkak të përzierjes etnike të ish-gjermanëve të Austrisë me pakicat e mëdha çeke, sllovaqe, kroate dhe sllovene në Austri, shqiptarët e Kosovës nuk janë përzier etnikisht (nëpërmjet martesave të përzieria) me pakicën serbe ose me pakica të tjetra në Kosovë, për t’u krijuar prej tyre një komb tjetër “kosovar”.

● Ose ndërsa kombi moldav është krijuar përmes përzierjes etnike (nëpërmjet martesave të përzieria) të ish-rumunëve të Moldavisë me pakicat e mëdha ruse dhe ukrainase në Moldavi, shqiptarët e Kosovës nuk kanë pasur përzierje etnike me pakica joshqiptare, për t’u krijuar prej tyre një komb tjetër “kosovar”.

● Dhe siç do të shohim më poshtë në tekstin e këtij libri, as shembulli i krijimit të kombit maqedon (sipas Spahiut nga kombi bullgar, gjë që nuk qëndron) dhe as shembulli i krijimit të kombit malazez (sipas Spahiut nga kombi serb, gjë që nuk qëndron), nuk paraqesin shembuj të duhur për ta përligjur krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

● **Brenda temës së tetë bosht** - saj që ka të bëjë me Planin/ Dokumentin e Ahtisarit dhe me Kushtetutën e Kosovës, jam përpjekur që t'i sqaroj lexuesit se thëniet e Spahiut, sipas të cilave Plani i Ahtisarit dhe Kushtetuta e Kosovës e njohin “kombin kosovar”, nuk qëndrojnë aspak. Përkatesisht jam përpjekur që t'i sqaroj lexuesit, se Plani i Ahtisarit dhe Kushtetuta e Kosovës, përkundrazi, e njohin ekzistencën e kombit shqiptar në Kosovë.

● **Brenda temës së nëntë bosht** - asaj të anëtarësimit të Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), jam përpjekur që t'i sqaroj lexuesit se nuk qëndrojnë thëniet e Spahiut, sipas të cilave për t'u bërë Kosova vend anëtar i OKB-së, nga shqiptarët e Kosovës duhet të krijohet “kombi kosovar”, përkatesisht jam përpjekur që t'i sqaroj lexuesit se Kosova mund të anëtarësohet në OKB, duke qenë shqiptarët e Kosovës pjesëtarë të kombit shqiptar, ashtu siç kanë qenë e janë për shekuj me radhë.

● Se Kosova mund të anëtarësohet në radhët e OKB-së pa pasur nevojë që shqiptarët e Kosovës të tjetërsohen në “komb kosovar”, përkatesisht se Kosova mund të anëtarësohet në radhët e OKB-së duke pasur komb shqiptar, siç ka pasur e ka shekuj me radhë, për këtë falsin përcaktimet e Kartës së OKB-së për anëtarësimin e shteve në radhet e saj. Brenda përcaktimeve të Kartës së OKB-së për anëtarësimin e shteve brenda saj, nuk ekziston ndonjë përcaktim i cili e kushtëzon pranimin e ndonjë shteti me krijimin e ndonjë kombi të caktuar nga ai shtet. OKB-ja i anëtarëson shtetet me ato përbërje etnike të popullatave që ato kanë pasur dhe kanë, gjë që vjen në kundërshtim me pohimin (për mua fals) e Spahiut, sipas të cilit për t'u anëtrësuar Kosova në OKB duhet ta ketë kombin e saj “kosovar”

● Se Kosova mund të anëtarësohet në radhët e OKB-së si një shtet i dytë i të njëjtit komb shqiptar, krahas shtetit të Shqipërisë, për

këtë flet fakti se OKB-ja e ka bërë anëtarësimin e dy e më shumë shteteve të të njëjtit komb, gjë që vjen në kundërshtim me pohimet (për mua false) e Spahiut, sipas të cilave Kosova nuk mund të anëtarësohet në OKB si shtet i kombit shqiptar, sepse vendin e shtetit të kombit shqiptar në OKB e ka zënë Shqipëria.

● **Brenda temës së dhjetë bosht** - jam përpjekur t'i sqaroj lexuesit, se fjala **komb** ("nation") në gjuhën angleze nuk e ka vetëm kuptimin e fjalës **komb**, siç pohon Spahiut pa të drejtë, por e ka edhe kuptimin e fjalës **shtet** dhe **vend**, dhe se fjala "nation" në varësi të kontestit të fjalisë, herë ka kuptimin e kombit e herë ka kuptimin e shtetit. Kështu, nuk qëndrojnë thëniet e Spahiut, sipas të cilave presidentët amerikanë sa herë e kanë quajtur Kosovën "Komb i Kosovës" ("Kosovo-Nation"), ata kështu kanë pohuar ekzistimin e "kombit kosovar" në Kosovë.

● Përkundrazi, presidentët amerikanë duke e quajtur Kosovën "Komb i Kosovës" ("Kosovo-Nation"), e kanë quajtur atë "Shteti i Kosovës", kjo edhe për vetë faktin, sepse në Kosovë ka ndodhur shtetbërja e Kosovës dhe nuk ka ndodhur krijimi nga shqiptarët e Kosovës të "kombit kosovar". Se fjala "nation" në gjuhën angleze ka edhe kuptimin e kombit, edhe kuptimin e shtetit, për këtë flasin edhe shumë fjalorë, në të cilët fjala "nation" e gjuhës angleze është përkthyer jo vetëm si **komb**, por edhe si **shtet**, edhe si **vend**.

● Këto dhjetë tema bosht të marra së bashku, paraqesin tërë spektrin e kundërvënies sime ndaj ideve komb-tjetërsuese, komb-ndarëse dhe komb-vrasëse të Spahiut në adresë të kombit shqiptar.

## 2

---

### **IDEVE KOMB-NDARËSE TË SPAHIUT U ËSHTË KUNDËRVËNË NJË PJSË E INTELKTUALËVE DHE SHUMË QYTETARË TË THJESHTË**

Në këtë kapitull dua t`i njotoj lexuesit se fatmirësisht, unë nuk jam as i pari dhe as i vetmi që po u kundërvihem ideve komb-ndarëse të Nexhemedin Spahiut, sepse ideve të tij u janë kundërvënë edhe të tjerë para meje dhe do t`u kundërvihen edhe të tjerë pas meje.

● Ata që u janë kundërvënë ideve komb-ndarëse të Spahiut, nëpërmjet propagandimit nga ana e tij të krijim-ekzistimit të “kombit kosovar”, janë një pjesë e politikanëve, e intelektualëve, e ish të burgosurve politik, e ish-ushtarëve të UÇK-së dhe një pjesë e publicistëve dhe e gazetarëve shqiptarë.

● Por edhe pse numri i atyre që u janë kundërvënë ideve komb-ndarëse të Spahiut dhe të tjerëve nuk është shumë i madh, megjithatë, ato që ata kanë shkruar nëpër gazeta elektronike dhe portale të ndryshme, marrë së bashku bëjnë mijëra faqe shkrime, në të cilat janë hedhur poshtë, në disa raste deri edhe me sharje e ofendime të rënda, idetë komb-ndarëse të Spahiut, të Matoshit e të ndonjë tjetri.

● Janë dhjetëra intelektualë: kryesisht historianë, sociologë, publicistë e gazetarë nga Kosova, Shqipëria dhe pjesërisht nga Maqedonia, të cilët ideve komb-ndarëse të Spahiut, të Matoshit e të ndonjë tjetri, u janë kundërvënë edhe nëpër debate televizive, duke

i hedhur poshtë idetë e tyre destruktive me fakte dhe argumente të padiskutueshme.

● Por, pjesa e madhe e mijëra intelektualëve, e akademikëve të Akademive Shkencore dhe të Arteve të Kosovës dhe të Shqipërisë, e ish-të burgosurve politikë të Kosovës, e publicistëve, e gazetarëve dhe e analistëve politikë, edhe pse nuk pajtohen me idetë kombndarëse të Spahiut e të Matoshit, megjithatë, ende nuk janë prononcuar kundër ideve të tilla për arsyet që përmendën më poshtë.

● Supozoj se një pjesë intelektualëve nuk është prononcuar kundër ideve të tilla kombndarëse të Spahiut, sepse nuk e ka kuptuar rrezikshmërinë e ideve të tilla për tërë kombin shqiptar dhe, për rrjedhojë, edhe i kanë neglizhuar dhe i neglizhojnë ato. Një pjesë tjetër e tyre nuk është prononcuar kundër ideve të tilla kombndarëse, sepse mendon që, propaganduesit e ideve të tilla (Spahiu, Matoshi, Kelmendi e Meta) duke qenë disa askushë, idetë e tyre nuk kanë asnjë efekt ndikues në mesin e shqiptarëve. Një pjesë tjetër e intelektualëve nuk është prononcuar kundër ideve të tilla, sepse thjesht ka rrëshqitur në komoditet, mediokritet dhe meskitet. Një pjesë tjetër e intelektualëve nuk është prononcuar, sepse mendon që prononcimi i tyre kundër ideve kombndarëse të Spahiut dhe të Matoshit, do t'i faktorizonte këta të fundit dhe do t'i bënte dikushë dhe, së fundi, mendoj se një pjesë tjetër jo shumë e vogël e intelektualëve nuk është prononcuar kundër ideve kombndarëse të Spahiut, sepse ka frikë që, nëse në të ardhmen do të krijohet “kombi kosovar”, ata do të mbeten tradhtarë!

● Unë nga ana ime edhe sikur ta dija se që nesër do të krijohej në Kosovë “kombi kosovar”, sot, një ditë përpara krijimit të tij, do të prononcohesha kundër, sepse e di sigurt (si vdekjen), se kurdo që të krijohet “kombi kosovar”, krijimi i tij do të ishte një gabim tragjik politik dhe historik, me pasoja të pallogaritshme për tërë kombin shqiptar në viset e tij në Ballkan.

● Për mendimin tim, të gjitha arsyet e përmendura më lart, për shkak të të cilave shumica e intelektualëve nuk është prononcuar kundër ideve kombndarëse të Spahiut dhe të të tjerëve, nuk janë vetëm të paqëndrueshme, por edhe shumë të dëmshme e të

gabueshme. Kjo, sepse mendoj se mosprononcimi i tyre kundër ideve komb-ndarëse të Spahiut dhe të Matoshit, në popull ka lënë përshtypjen sikur ata po pajtohen me ide të tilla komb-ndarëse, dhe sikur edhe ata janë në favor të krijimit nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

● Mendoj se kjo pjesë e madhe e intelektualëve shqiptarë, jodomosdoshmërisht është dashur të polemizojë drejtpërdrejt me Spahiun, siç bëj unë, por është dashur që ideve komb-ndarëse të tij t’u kundërviheshin në parim, sepse kësaj njerëzve të thjeshtë do t’u jepnin të kuptonin, se ata nuk janë për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

● Por, më shumë se kushdo tjetër, ideve komb-ndarëse të Spahiut, të Matoshit e të ndonjë tjetri, u janë kundërvënë dhe po u kundërvihen qytetarët e thjeshtë shqiptarë. Më ka rënë rasti që të lexoj në portale të ndryshme, por edhe të dëgjoj në përditshmëri (në mjedise familjare dhe publike), se si qytetarët e thjeshtë idetë komb-ndarëse të Spahiut, të Matoshit e të ndonjë tjetri jo vetëm që i refuzojnë me neveri, por nga mllefi lëshojnë edhe shumë sharje e fyerje në adresë të Spahiut, të Matoshit e të ndonjë tjetri.

● Popullsia shqiptare e Kosovës duke i bërë dasmat me flamurin kombëtar shqiptar, Spahiut dhe të Matoshit u kanë dhënë dhe u japin të kuptojnë, se ajo nuk e ka ndër mend të tjetërsohet nga komb shqiptar në “komb kosovar”, sepse ky komb thjeshtë po i duhet Spahiut, Matoshit e ndonjë tjetri.

### **Lista e intelektualëve dhe e të tjerëve që u janë kundërvënë ideve komb-ndarëse të Spahiut**

Më poshtë janë renditur sipas rendit alfabetik emrat, mbiemrat dhe biografitë e shkurtra të një pjese intelektualëve, politikanëve, historianëve, sociologëve, analistëve politikë, publicistëve dhe gazetarëve, të cilët në një mënyrë apo një tjetër u janë kundërvënë me argumente të ndryshme ideve komb-ndarëse të Spahiut, sipas të cilave nga shqiptarët e Kosovës veç është krijuar “kombi kosovar”, gjë që nuk qendron aspak .

**Adrian Gaxherri**, gazetar

**Agim Zogaj**, publicist, gazetar, historian, autor i disa librave, profesor i historisë në Universitetin e Prishtinës

**Albin Kurti**, kryetar i Lëvizjes *Vetëvendosje*, aktualisht Kryeministër i Kosovës

**Arben Çejku**, filolog, historian, diplomat, autor i disa librave, ish-ambasador i Shqipërisë në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut

**Arbër Rexhaj**, deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes *Vetëvendosje*

**Arbër Zeka**, gazetar

**Ardi Nurellari**, gazetar, publicist, analist, profesor në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin e Tetovës, ish-këshilltar i Presidentit Hashim Thaçi

**Artur Zheji**, publicist, gazetar, analist politik nga Shqipëria, drejton emisione televizive në televizionin ABC

**Avni Klinaku**, veprimtar politik, ish-i burgosur politik, ish-kryetar i organizatës ilegale të Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK-së)

**Azdran Shala**, magjistër i historisë, analist politik, mësimdhënës i historisë dhe i edukatës qytetare, bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit Arkeologjik të Kosovës dhe i Muzeut të Kosovës

**Basri Beka**, politolog, ish-ushtar i UÇK-së, sekretar i shoqatës *Shqiptaria*

**Baton Haxhiu**, gazetar, publicist, opinionist, analist politik; për një kohë drejtor i përgjithshëm i televizionit “Klan Kosova”, ku ka moderuar dy emisione: “Zona B” dhe “Zona e debatit”

**Bekim Baliqi**, profesor i shkencave politike në Universitetin e Prishtinës

**Bekim Jashari**, teolog, hoxhë nga Besiana (ish-Podujeva)

**Blerim Latifi**, profesor i filozofisë dhe i sociologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, analist politik, ish-anëtar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së)

**Bylbyl Sokoli**, profesor/trajner i futbollit, profesor i lëndës së futbollit në Fakultetin e Shkencave Sportive të Universitetit të Prishtinës

**Dritëro Arifi**, doktor i shkencës, profesor në Departamentin e

Shkencave Politike në Universitetin UBT në Prishtinë

**Elena Kocaqi**, ka studiuar historinë dhe drejtësinë në Universitetin e Tiranës, ka bërë edhe master në shkencat politike, ka shkruar disa libra lidhur me origjinën e shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe

**Engjëll Xhuxha**, filozof

**Enida Bozheku**, profesoreshë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Tiranë

**Enver Hasani**, profesor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

**Erald Selca**, ushtar i UÇK-së

**Ervis Iljazaj**, doktor i shkencave politike, profesor i asocuar, autor i shumë punimeve shkencore, dekan i Fakultetit Juridik në Tiranë

**Fadil Maloku**, profesor i sociologjisë së globalizimit në Universitetin e Prishtinës

**Fahri Xharra**, inxhinier i teknologjisë, publicist, analist, hulumtues i historisë së shqiptarëve, autor i disa librave

**Fatmir Bardhoci**, sportist

**Fehmi Ajvazi**, politolog, publicist, analist, shkrimtar

**Fitim Zekthi**, politolog, analist politik nga Tirana

**Florian Zhega**, gazetar

**Fuad Ngucati**, biznesmen

**Glauk Konjufca**, politikan, deputet i Lëvizjes *Vetëvendosje* në Kuvendin e Kosovës, ish-ministër i Punëve të Jashtme të Kosovës, ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës

**Hakif Bajrami**, profesor, doktor i shkencave historike, autor i disa librave me karakter historik

**Hashim Thaçi**, historian, politikan, kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, drejtor i Drejtorisë Politike të UÇK-së, ish-Kryeministër dhe ish-President i Kosovës

**Hysamedin Feraj**, ish-pjesëmarrës i lëvizjes studentore të vitit 1981 në Kosovë; për shkak të përndjekjes politike është arratisur në Shqipëri; publicist, analist politik, ka studiuar shkencat juridike dhe politike në Universitetin e Tiranës, mbështetës i Lëvizjes *Vetëvendosje*

**Imer Selmani**, mjek, politikan dhe biznesmen, ish-ministër i Shëndetësisë në Maqedoninë e Veriut, themelues i Partisë

*Demokracia e re* në Maqedoni

**Islam Lauka**, gjuhëtar, politolog, diplomat; vepra kryesore e tij është “Kosova, rast universal apo *sui generis*”, ish-ambasador i Shqipërisë në Kosovë

**Ismail Tasholli**, filozof, publicist, analist politik, ka publikuar shumë artikuj me karakter filozofiko-sociologjik

**Ismet Munishi**, futbollist i njohur në Kosovë dhe jashtë Kosovës në Shqipëri, Slloveni dhe Turqi, aktualisht trajner profesional i futbollit

**Isuf Thaçi**, psikolog, publicist, merret aktivisht me çështjet e arsimit në Kosovë

**Kim Mehmeti**, gazetar, publicist, analist politik, romancier, nga Maqedonia

**Lirak Çelaj**, aktivist politik, artist i artit dramatik, ish-deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, ish-ushtar i UÇK-së

**Lis Bukuroca**, profesor i gjuhës dhe letërsisë frënge, publicist, gazetar, autor i disa romanëve, me origjinë nga Presheva, jeton e punon në Gjermani

**Lulzim Veliu**, opinionist, analist politik, kryetar i Shoqatës Integrative - Identitet, në Gjermani

**Mark Krasniqi** (tani më i ndjerë), akademik, gjeograf, etnolog, shkrimtar, kryetar i Partisë Demokristiane të Kosovës, autor i disa librave me karakter letrar, tanimë i ndjerë.

**Mehdi Hyseni**, doktor i marrëdhënieve politike ndërkombëtare, publicist, analist politik; libri më i njohur i tij është “Shqipëria e ribashkuar e qetëson Ballkanin”; jeton në SHBA

**Mehmet Kraja**, publicist, gjuhëtar, shkrimtar, autor i disa librave, aktualisht kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

**Mentor Nazarko**, politolog, publicist, gazetar, analist politik, autor i librit “Lufta e fundit”, drejtor i Qendrës së Studimeve Rajonale “Marin Barleti” në Tiranë

**Mesila Doda**, ekonomiste, politikane, ish-deputete e Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë

**Milazim Krasniqi**, akademik, gjuhëtar, gazetar, publicist, studiues, autor i disa librave, profesor i asociuar i gazetarisë në Universitetin

e Prishtinës, një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës  
**Musa Llamallari**, teolog, jeton në Londër, por kthehet shpesh në qytetin e Shkupit ku ka lindur; është i njohur për vlerësimet kritike ndaj hoxhallarëve

**Naim Rustemi**, profesor, ish-deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së; ka doktoruar në Londër në Universitetin *Phonix*

**Nak Lushta**, emigrant, humorist

**Nazmi Rrahmani**, shkrimtar i njohur, autor i disa romaneve, mësimdhënës i gjuhës shqipe në shkollat e mesme të Prishtinës

**Nevila Nika**, historiane, pjesë e stafit akademik të Universitetit Europian në Tiranë; ka qenë drejtoreshë e Arkivit Shtetëror të Shqipërisë

**Nexhmi Muçiqi**, kryetar i Shoqatës “Çamëria” në Prishtinë.

**Paskal Milo**, profesor, doktor i shkencave historike, autor i disa librave me karakter historik, ish-ministër i Jashtëm i Shqipërisë

**Pëllumb Xhufi**, profesor, historian, autor i disa librave, ish-zëvendësministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë

**Ramiz Shala**, analist

**Rexhep Qosja**, akademik, profesor, gjuhëtar, shkrimtar, publicist, autor i tridhjetë librave, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

**Sabit Geci**, ish-komandant i UÇK-së nga Drenica

**Sadik Elshani**, doktor i shkencave, aktivist politik, publicist nga Kosova që jeton në SHBA

**Sadik Zeqiri**, gazetar

**Seladin Novosella**, aktivist i çështjes kombëtare, organizator i demonstratave studentore të vitit 1981; ish-i burgosur politik, autor i disa librave për Adem Demaçin

**Shkëlzen Maliqi**, filozof, publicist, analist politik, kritik i artit, drejtues i Qendrës për Studime Historike “Gani Bobi” në Prishtinë

**Shpend Gashi**, publicist, analist politik, profesor i gjeopolitikës në Fakultetin e Shkencave Sociale në Tiranë

**Spartak Ngjela**, avokat, politikan, prokuror, ish-ministër i Drejtësisë në Qeverinë e Pajtimit Kombëtar

**Valon Murati**, aktivist politik, ekonomist, kryetar i Partisë *Lëvizja për Bashkim*, ish-ministër i Diasporës në Qeverinë e Kosovës

**Veton Surroi**, politikan, publicist, analist politik, shkrimtar, themelues i Partisë *Ora* dhe i gazetës *Koha*

**Xhensil Shkëmbi**, gazetar, Tiranë

**Zgjim Hyseni**, jurist, nënkryetar i Partisë Social-Demokratike të Kosovës.

### **Kundërvënia e Spahiut deri edhe me të shara nëne!**

● Spahiu kundërshtarëve të ideve të tij komb-ndarëse nëpër debate televizive u është kundërvënë e u kundërvihet me të gjitha arsyetimet e tij sa të paqëndrueshme, aq edhe absurde, sipas të cilave pas çlirimit dhe pavarësisimit të Kosovës, në Kosovë veç është krijuar “kombi kosovar”, edhe pse realisht dhe objektivisht në Kosovë nuk ka “komb kosovar”.

● Por Spahiu kundërshtarëve të tij nëpër debate televizive të tij u është kundërvënë edhe me gjuhë fyese dhe banale, duke i quajtur ata akademikë, intelektualë dhe politikanë injorantë, që nuk i njohin teoritë për kombin: që nuk e dinë dallimin mes etnisë dhe kombit etj.

● Spahiu në një debat televiziv kundërshtarin e tij, i cili ka thënë se në Kosovë nuk ka “komb kosovar”, e ka kërcënuar duke thënë se *atyre që shprehen se s’ka “komb kosovar”, është i gatshëm t’u shajë madje edhe nënën, kurse një kundërshtar tjetër, që po ashtu ka thënë se në “Kosovë nuk ka “komb kosovar”, Spahiu e ka quajtur gomar! Kështu, Spahiu vret e pret për “kombin kosovar”, edhe pse “kombi kosovar” nuk shihet as në horizont.*

● Mendoj se ato që Spahiun e bëjnë sa të pabesueshëm, po aq dhe qesharak, janë dijet e pamjaftueshme, mendjemadhësia, banalitetet që nxjerr nga goja dhe arroganca, veti këto që e karakterizojnë.



# **PJESA E DYTË**

# 3

---

## PROPAGANDIMI I “KOMBIT KOSOVAR” NË KATËR LIBRA METAFORIKË DHE QESHARAKË

Në këtë kapitull dua ti sqaroj lexuesit lidhur publikimin nga Nexhmedin Spahiu të katër librave të tij, nëpërmjet të cilëve ka propaganduar si një akt të kryer krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”. Në këta libra ai nuk thotë se **mendon** që, pas çlirimit dhe pavarësisë të Kosovës, nga shqiptarët e Kosovës ka filluar të krijohet “kombi kosovar”, me ç’rast kjo thënie do të mund të kuptohej si një mendim i lirë i tij, por ai pa asnjë fakt relevant **konkludon** se pas çlirimit dhe pavarësisë të Kosovës, veç na genka krijuar nga shqiptarët e Kosovës “kombi kosovar”.

### Libra që shqiptarëve të Kosovës ua mohojnë përkatësin kombëtare shqiptare

- Spahiu duke publikuar katër libra në të cilët deklarohet pa asnjë fakt, se nga shqiptarët e Kosovës veç është krijuar “kombi kosovar”, ai kështu në njërin anë ua ka mohuar përkatësinë kombëtare shqiptare rreth dy milionë shqiptarëve të Kosovës, kurse në anën tjetër ua ke veshur atyre një përkatësi tjetër kombëtare “kosovare”, e cila objektivisht e realisht nuk ekziston.
- Në Kushtetutën e Kosovës mohimi i përkatësisë kombëtare të kujtqo qoftë që jeton në Kosovë, paraqet diskriminim kombëtar dhe shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Në **nenin 24, pika 2** e Kushtetutës së Kosovës thuhet:

■ **Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal<sup>3</sup>.**

● Kështu, çdo shqiptar i Kosovës sipas nenit 24, pika 2 e Kushtetutës së Kosovës, ka të drejtë ta padisë Spahiun për tjetërsimin kombëtar që ai u bën atyre, duke i deklaruar ata pa asnjë fakt, se nuk i përkasin kombit shqiptar, por i përkasin një kombi tjetër joshqiptar, të cilin Spahiu e quan “komb kosovar”.

### **Katër libra me tituj metaforikë**

● Më poshtë dua t’u interpretoj lexuesve vetëm domethëniet e titujve metaforikë dhe simbolikë të katër librave të Spahiut, në të cilët ai ka propaganduar krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, pa pasur asnjë fakt.

### **Libri “Drejt kombit kosovar”**

● Titulli i këtij libri të botuar në qytetin e Mitrovicë në vitin 2004, flet se Spahiut i është dukur sikur gjoja pas çlirimit të Kosovës nga Serbia në vitin 1999, shqiptarët e Kosovës kanë marrë rrugë drejt tjetërsimit të tyre nga komb shqiptar në “komb kosovar”.

● Por shqiptarët e Kosovës pikërisht pas çlirimit të Kosovës në vitin 1999, jo vetëm që s’kanë rrugëtuar drejt tjetërsimit të tyre në “komb kosovar”, por janë ndier më shumë se kurrë krenarë që kanë qenë shqiptarë, që me Luftën Çlirimtare të bërë nga UÇK-ja, kanë ngritur gjithë botën në këmbë, duke realizuar kështu çlirimin e Kosovës nga Serbia okupatore në qershorin e vitit 1999.

● Ajo që Spahiu nuk dëshiron ta kuptojë, është se, ashtu siç nga një arë e mbjell me grurë nuk mund të rriten kallinj të tjerë, përveç kallinjve të grurit, edhe nga Kosova e banuar dendur me pjesëtarë të kombit shqiptar, nuk ka mundur të krijohet një komb tjetër (“kosovar”), përveç kombit shqiptar.

<sup>3</sup> Kushtetuta e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

● Të thuash se shqiptarët e Kosovës në aspektin gjeografik janë kosovarë kjo qëndron, sepse vendi i tyre quhet Kosovë. Edhe të thuash se shqiptarët e Kosovës në aspektin e shtetësisë janë kosovarë edhe kjo qëndron, sepse shteti i tyre quhet Kosovë. Por të thuash se shqiptarët e Kosovës pas çlirimit dhe pavarësisë të Kosovës, nuk i përkasin më kombit shqiptar, por i përkasin një kombi tjetër realisht joekzistues “kosovar”, kjo jo vetëm që nuk qëndron aspak, por paraqet edhe një absurd dhe një gabim logjik elementar.

### **Libri “Kombi në inkubator”**

● Titulli metaforik i këtij libri të botuar në Prishtinë në vitin 2010, të lë përshtypjen sikur z. Spahiu rreth dy milionë shqiptarë të Kosovës, brenda fantazisë së tij metaforike, i ka kthyer në vezë pulash, të cilat i ka futur në inkubatorin e tij metaforik, me shpresë që kur të çelin vezët prej tyre, të mos dalin “zogj shqiptarë”, por të dalin “zogj kosovarë”! Dhe sipas tij, zogjtë vërtet i kanë dalë “zogj kosovarë”, prandaj edhe nuk ndalet duke thënë pa asnjë fakt, se në Kosovë veç është krijuar “kombi kosovar”!

● Por fantazitë metaforike dhe figurative janë falas. Askush nuk e ndalon Spahiun të bëjë fantazi të tilla imagjinare, të dala jashtë çdo logjike elementare. Por realiteti objektiv në terren e tradhton shumë. Shqiptarët gjithandej Kosovës ndihen pjesëtarë të kombit shqiptar dhe nuk ndihen pjesëtarë të “kombit kosovar”, duke iu dhënë kësisoj fantazive metaforike të Spahiut një grusht të fortë!

### **Libri “Foshnjëria e kombit kosovar”**

● Edhe titulli metaforik i këtij libri të botuar në Prishtinë në vitin 2014, flet se z. Spahiu brenda fantazisë së tij metaforike, rreth dy milionë shqiptarët e Kosovës nuk i sheh ndryshe, veçse si “foshnja të kombit kosovar”! Krejt kjo në kuptimin se “zogjtë kosovarë” që kishin çelur në librin “Kombi në inkubator”, tani kishin arritur moshën e foshnjërisë, që në mjekësi përfshin periudhën jetësore të fëmijës brenda vitit të parë të jetës.

● Sa herë që njeriu nuk mund t’i realizojë konkretisht dëshirat e tij, ai fillon “t’i realizojë” ato me fantazi. Çdo njeri ka të drejtë, që me fantazi figurative “t’i realizojë” dëshirat e tij. Por askush nuk

ka të drejtë, që fantazitë e tij figurative t'ua imponojë të tjerëve si fakte të kryera dhe si realitete, siç bën z. Spahiu, duke e paraqitur krijimin e “kombit kosovar” si fakt të kryer. Mendoj e besoj thellë, se rreth dy milionë shqiptarë të Kosovës nuk do të lejojnë asnjëherë që të bëhen “foshnja kosovare” të “kombit kosovar” të Nexhmedin Spahiut apo të kujtdo qoftë tjetër.

### **Libri “Ngritja e kombit kosovar”**

● Edhe titulli i këtij libri të botuar në Prishtinë në vitin 2017 flet për idetë joreale të Nexhmedin Spahiut. Sipas këtij libri, del se “zogjtë kosovarë” që z. Spahiu i kishin çelur në librin “Kombi në inkubator” dhe të cilët në librin “Foshnjëria e kombit kosovar” kishin arritur moshën e foshnjërisë, tani në librin e tretë të tij me titull “Ngritja e kombit kosovar” ishin rritur dhe ngritur, duke bërë hapat e parë mbi këmbët e tyre prej qelqi.

● Nëse z. Spahiu do të vazhdojë të botojë libra të tillë, duke iu referuar fantazive vetjake metaforike dhe figurative, kjo tregon se ai edhe në ardhmen do të botojë libra të tjerë me tituj po ashtu metaforikë, si p.sh.: “Adoleshenca e kombit kosovar”, “Pjekuria e kombit kosovar”, “Pleqëria e kombit kosovar”, sepse çdo gjë lind, zhvillohet dhe vjetrohet.

● Nexhmedin Spahiu nuk kupton ose nuk dëshiron të kuptojë, se për të thënë që në Kosovë veç është krijuar “kombi kosovar”, kushti i parë dhe i fundit është ekzistimi real i “kombit kosovar” në terren. Kështu, mungesa e “kombit kosovar” në terren e bën këtë komb, bashkë me fantazitë figurative të Spahiut, joekzistues.

### **Shqiptarët e Kosovës kanë qenë e janë kundër krijimit të “kombit kosovar” nga vetja e tyre**

Se shqiptarët e Kosovës nuk i kanë akseptuar idetë e Spahiut për gjoja krijimin e “kombit kosovar”, për këtë flasin, ndër të tjera, edhe dy thënie të vetë Spahiut, të cituara më poshtë:

■ **Në vitin 2004, kur u promovua libri “Drejt kombit kosovar”, kopjet e librit iu morën me dhunë autorit dhe u dogjën para kamerave televizive.**<sup>4</sup>

<sup>4</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit* <https://telegafi.com/koncepti-i-kombit/>

## ■ Kur më 2005 kam promovuar librin “Drejt kombit kosovar” jashtë u dogj libri.<sup>5</sup>

### **Librin nuk e djeg vetëm djegësi, por edhe vetë autori!**

● Nuk e di nëse libri i Spahiut me titull “Drejt kombit kosovar” është djegur ose jo në vitin 2004 dhe në vitin 2005, sepse mua nuk më ka rënë as të lexoj e as të dëgjoj se ai libër, me rastin e promovimit, të jetë djegur nga dikush. Por mund të them se, në parim, jam kundër djegies edhe të librit më të keq të mundshëm, sepse edhe nga libri më i keq i mundshëm njeriu mëson si nuk duhet të bëhet i keq, si autori i librit të keq.

● Por, nëse libri i Spahiut me titull “Drejt kombit kosovar” vërtet është djegur, mendoj se atë libër më shumë se ata që e kanë djegur fizikisht, e ka djegur vetë ideja absurde e Spahiut e shprehur në atë libër, sipas të cilës nga shqiptarët e Kosovës është krijuar një komb tjetër “kosovar”, edhe pse diçka e tillë nuk ka ndodhur as atëherë e as sot. Spahiu nuk dëshiron të kuptojë se, sa herë që thotë se në Kosovë veç është krijuar “kombi kosovar”, ai kësisoj u mohon rreth dy milionë shqiptarëve të Kosovës përkatësinë kombëtare shqiptare. Dhe Spahiu nuk dëshiron të kuptojë se prej shqiptarit të Kosovës, të cilit ia ka tjetërsuar përkatësinë kombëtare shqiptare në përkatësi kombëtare “kosovare”, më e vogla që do të duhej të priste, do të ishte djegia e librit të tij me titull “Drejt kombit kosovar”.

● Edhe librin e Adolf Hitlerit, “Mein Kampf” (“Lufta Ime”), nuk e kanë djegur vetëm antifashistët gjermanë dhe antifashistët e kombeve të tjera, por bashkë me ta e ka djegur edhe vetë autori: Adolf Hitleri me idetë e tij raciste të prezantuara në atë libër. Ne mund të themi se Kisha Katolike i ka ndaluar ose djegur pa të drejtë shkrimet e Xhordano Brunos, të Kopernikut dhe të Galileit, sepse idetë e tyre kanë të qëndrueshme dhe të drejta, por nuk mund të themi se edhe antifashistët e kanë djegur pa të drejtë librin “Lufta

---

<sup>5</sup> Nexhmedin Spahiu: *Shqipëria dhe Kosova - dy kombe të ndryshme me gjuhë të njëjtë* 16/03/2021 *syri.net*:

[https://www.syri.net/syri\\_kosova/lajme/228586/nexhmedin-spahiu-shqipëria-dhe-kosova-dy-kombe-te-ndryshme-me-gjuhe-te-njejte/](https://www.syri.net/syri_kosova/lajme/228586/nexhmedin-spahiu-shqipëria-dhe-kosova-dy-kombe-te-ndryshme-me-gjuhe-te-njejte/)

Ime” të Hitlerit, sepse idetë e Hitlerit jo vetëm që s’kanë qenë të drejta, por kanë qenë raciste.

● Me fjalë të tjera, djegia e librit “Drejt kombit kosovar” nga pjesëmarrësit në promovimin e tij tregon qartë se pjesëmarrësit në atë promovim, duke pasur përkatësi kombëtare shqiptare, janë ndier të diskriminuar kombëtarisht, sepse ata nuk ishin drejtuar drejt krijimit të “kombit kosovar” nga vetja e tyre, siç ishte shprehur Spahiu në atë libër, për mua të çoroditur, ndaj ata kanë reaguar me djegien e atij libri. Në popull nuk thuhet kot se “Dashni me zor nuk ka”!

### **Libri “Foshnjëria e kombit kosovar” është pritur me kundërshtime të mëdha**

● Nga ana tjetër, ka të dhëna të cilat tregojnë se edhe libri “Foshnjëria e kombit kosovar” i Spahiut, i publikuar në vitin 2014, jo vetëm që nuk është pritur “në mënyrë afirmative”, siç na thotë Spahiu, por është pritur me kundërshtime të mëdha në qytezën e Malishevës dhe në Prizren. Kështu, në një portal është shkruar si në vijim:

■ **Publicisti Nexhmedin Spahiu, sot në Malishevë, ka promovuar librin e tij “Foshnjëria e kombit kosovar”, ku para audiencës malishevase autori u mundua ta arsyetojë çështjen e krijimit të kombit kosovar dhe dallimin mes etnisë dhe kombit. Kjo pavarësisht shpjegimit në versionin e autorit, të pranishmit, shumica prej tyre, nuk u pajtuan me mendimin e autorit<sup>6</sup>.**

■ **Megjithëse autori e arsyetoi në versionin e tij këtë temë, shumica e pjesëmarrësve nuk u pajtuan me teorinë e krijimit të kombit kosovar, pasi sipas tyre, “kanë shtetësinë kosovare, por si komb jemi shqiptarë”<sup>7</sup>.**

● Dy shkrimet e “Prizrenpress”-it të cituara më lart, flasin se Spahiu

<sup>6</sup> Nexhmedin Spahiu promovon librin “Foshnjëria e kombit kosovar” në Malishevë 04/08/2015: <https://prizrenpress.com/nexhmedin-spahiu-promovon-librin-foshnjeria-e-kombit-kosovar-ne-malisheve/>

<sup>7</sup> Nexhmedin Spahiu promovon librin “Foshnjëria e kombit kosovar” në Malishevë 04/08/2015: <https://prizrenpress.com/nexhmedin-spahiu-promovon-librin-foshnjeria-e-kombit-kosovar-ne-malisheve/>

me rastin e promovimit të librit të tij “Foshnjëria e kombit kosovar” në qytezën e Malishevës jo vetëm që nuk ka bindur askënd për gjoja ekzistimin e “kombit kosovar”, por ai me atë rast ka përjetuar një dështim të madh. Pjesëmarrësit në atë provim libri i kanë thënë atij shkurt e qartë: se me shtetësi janë kosovarë, sepse shteti i tyre quhet Kosovë, por me kombësi janë shqiptarë dhe nuk janë “komb kosovar”.

### **Promovimi që është pritur me kundërshti e pakënaqësi**

● Por Spahiu promovimin e librit të tij “Foshnjëria e kombit kosovar” në vitin 2014 e ka paraqitur të suksesshëm si më poshtë:

■ **Kurse në vitin 2014, kur botova librin “Foshnjëria e kombit kosovar”, kishte të pranishëm ambasadorë të huaj, kishin 200 të ftuar dhe dolën në mënyrë afirmative<sup>8</sup>.**

● Spahiu librin “Foshnjëria e kombit kosovar” e ka promovuar në shumë qytete: në Prishtinë, Fushë-Kosovë, Obiliq, Prizren, Deçan, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë etj. Por ky libër nuk është pritur në mënyrë afirmative as nga publiku i brendshëm shqiptar, dhe as nga zyrtarët e ambasadave të vendosura në Prishtinë, siç na thotë Spahiu.

● Përkundrazi, ky libër i Spahiut nga publiku shqiptar është pritur me kundërshti, me heshtje e pakënaqësi. Edhe ata pak përfaqësues të ambasadave të vendosura në Prishtinë, që kanë marrë pjesë në promovimin e atij libri, nuk kanë thënë asnjë fjalë për atë libër të Spahiut. Dhe të gjitha këto tregojnë, se të gjithë ata që kanë marrë pjesë në promovimin e këtij libri, nuk kanë dalë nga ai promovim në mënyrë afirmative, siç na thotë Spahiu, por mbase kanë dalë duke vënë duart në kokë, nga absurditeti i ideve komb-ndarëse të Spahiut.

### **Promovimi refuzues i librit “Ngritja e kombit kosovar”**

● Në një video që kam gjetur në “Google” në internet, kam parë promovimin e librit “Ngritja e kombit kosovar” në Prishtinë nga

---

<sup>8</sup> Nexhmedin Spahiu: Shqipëria dhe Kosova dy kombe të ndryshme me gjuhë të njëjtë 16/03/2021 *syri.net*: [https://www.syri.net/syri\\_kosova/lajme/228586/nexhmedin-spahiu-shqipëria-dhe-kosova-dy-kombe-te-ndryshme-me-gjuhe-te-njejte/](https://www.syri.net/syri_kosova/lajme/228586/nexhmedin-spahiu-shqipëria-dhe-kosova-dy-kombe-te-ndryshme-me-gjuhe-te-njejte/)

ana e Spahiut<sup>9</sup>. Në atë promovim libri, z. Spahiu, duke dashur ta bindë faktorin ndërkombëtar se gjoja tanimë në Kosovë ishte krijuar “kombi kosovar”, kishte ftuar për të marrë pjesë të gjithë ambasadorët e të gjithave vendeve, që i kanë ambasadat e tyre në Prishtinë.

**Tri goditje të njëpasnjëshme:** Por Spahiu në promovimin e librit “Ngritja e kombit kosovar” ka marr tri goditje të njëpasnjëshme.

● **Goditja e parë** ka të bëjë me faktin, se në promovimin e atij libri, përveç ambasadorit të Italisë dhe zëvendësambasadorit të Francës, nuk kanë marrë pjesë ambasadorët e vendeve të tjera të kuintit: ambasadori amerikan, britanik dhe ai gjerman. Mospjesëmarrja e ambasadorëve të këtyre tri vendeve të mëdha të kuintit dhe heshtja e ambasadorit italian dhe e zëvendës-ambasadorit francez në atë promovim libri, linin të kuptohej se vendet e kuintit jo vetëm se nuk i merrnin në konsideratë idetë joreale të Spahiut për gjoja krijim-ekzistimin e “kombit kosovar”, por edhe linin të kuptohej se prapa ideve të tilla të Spahiut nuk qëndronin vendet e kuintit.

● **Goditja e dytë** kishte të bënte me faktin, se asnjëri nga të pranishmit (shqiptarë dhe të huaj), nuk e mori fjalën për t’u dhënë qoftë edhe mbështetjen më të vogël ideve të Spahiut, për gjoja krijim-ekzistimin e “kombit kosovar”. Kështu, ai provim libri më shumë ngjante me një mbledhje memoriale për përkujtimin e një të vdekuri, sesa me një promovim libri.

● **Dhe goditja e tretë** kishte të bënte me fjalën e një shoku të ngushtë të Spahiut, të prof. Naim Rustemit, i cili ishte i pranishëm në atë promovim libri. Ai i kundërshtoi në mënyrë intelektuale idetë e Spahiut, duke thënë se *Spahiu ka aftësi për të hapur debate për tema të ndryshme, por debati për ngritjen e një kombi mbi bazën e emrit territorial të Kosovës (“Territorial Nation”)<sup>10</sup>, mendoj se do të mbetet vetëm në suaza diskutimesh akademike, por nuk do të gjejë vend në këto hapësira*. Shprehja “se debati për krijimin e kombit

<sup>9</sup> Nexhmedin Spahiu: Promovimi i librit “Ngritja e kombit kosovar”; <https://www.youtube.com/watch?v=usdIs0EmQ8o>

<sup>10</sup> Me *komb territorial* kuptohet kombi i krijuar mbi bazën e territorit, ku banorët e një territori të caktuar, pavarësisht nga dallimet e tyre etnike, gjuhësore, fetare, kulturore dhe të tjera, besojnë se i përkasin të njëjtit identitet kombëtar.

kosovar nuk do të gjejë vend në këto hapësira”, tregonte se ideja e Spahiut për krijimin e “kombit kosovar” nuk do të gjejë vend në mesin e shqiptarëve gjithandej Kosovës.

### **Me fantazi metaforike mund të krijohen përralla e tregime, por jo kombe**

Lidhur me promovimin e librit “Ngritja e kombit kosovar” në vitin 2017 në Prishtinë, Spahiu ndër të tjera është shprehur si më poshtë:

■ **Libri “Ngritja e kombit kosovar”... u botue në vitin 2017... edhe e bojm ni kërcim, një paralele me trupin e njeriut, atëherë kjo fazë kur u shkruie ky libri ka qenë... kur kombi osht ngrit n’kom, nga foshnje ja ka nisë mi marr hapat e me ecë. Ky këtu osht libri “Foshnjëria e kombit kosovar”, do me thon se kombi ka qenë foshnje, ...edhe “kombi n’inkubator” domethon kombi ka lind por... Mendoj se na kemi kalue prej ikubatorit në foshnjëri dhe tash osht ni fëmijë i vogël që ecën, por që sigurisht mbas një kohe ka me qenë ni komb normal<sup>11</sup> (min. 1:25:54 - 1:27:51)**

● Spahiu edhe brenda thënies së tij të cituar më lart na e tregon përrallën e tij të njëjtë gjoja për krijim-ekzistimin e “kombit kosovar” në tri faza: atë të inkubatorit, të foshnjërisë dhe atë të fëmijërisë së hershme, kur ai (“kombi kosovar”) ka filluar të ecë me këmbët e veta. Por në terren (në tokën e Kosovës) nuk ka ndodhur diçka e tillë! Këtë e dinë të gjithë, përveç Spahiut.

● Shtrohet pyetja: ku na qenka fshehur ai “komb kosovar”, rritjen e të cilit prej tri fazash e paska parë vetëm Spahiu, por nuk e kemi parë ne të tjerët?! Jo, “kombi kosovar” i Spahiut nuk shihet askund nga askush, thjesht e qartë, sepse ai realisht dhe objektivisht as nuk ka ekzistuar dhe as nuk ekziston. Atë e sheh vetëm Spahiu brenda fantazive të tij metaforike, nëpërmjet të cilave mund të krijohen përralla e tregime, por nuk mund të krijohen kombe.

---

<sup>11</sup> Nexhmedin Spahiu në “Oksigjen”, pjesa e parë, 13.11.21:  
<https://www.youtube.com/watch?v=gmCJhoFX-Ps>

## **Kombi është një frymë e një shpirt, që nuk shkëmbehet me një frymë e një shpirt tjetër**

Spahiu duke shkruar më tej për krijimin, sipas tij, të “kombit kosovar” përmend Ernest Renanin, që ka qenë përfaqësues i teorive franceze për kombin.

■ **Libri “Ngritja e kombit kosovar”... u botue në vitin 2017... Shiko, Ernest Renani e përshkruan kombin si një frymë, si një shpirt. Edhe na nëse kombin e bojm ai një paralele me trupin e njeriut, atëherë kjo fazë kur u shkruie ky libri ka qenë kur kombi osht ngrit n’komb nga foshnje, ja ka nisë mi marr hapat e me ecë. Ky këtu për shembull osht libri paraparak “Foshnjëria e kombit kosovar”, domethonë se kombi ka qenë foshnje edhe “Kombi në inkubator”, do me thon kombi lind por... Sepse gathërë ka lind kombi, ka lind akoma i pashëndetshëm, akoma i pavetëdijshëm<sup>12</sup>. (min. 1:25:54-1:27:51)**

● Spahiu edhe në këtë thënie të tij të cituar më lart na e tregon të njëjtën tregim: atë të krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” në tri faza: atë të inkubatorit, të foshnjërisë dhe të fëmijërisë së hershme, kur “kombi kosovar”, sipas tij, paska filluar të ecë me këmbët e veta. Por, për fatin e keq të Spahiut, në terren (në tokën e Kosovës) diçka e tillë nuk ka ndodhur!

● Spahiu në tregimin e tij të krijim-ekzistimit sipas tij të “kombit kosovar” përmend dietarin francez Ernest Renan, i cili kombin, ndër të tjera, e ka përkufizuar edhe si një frymë dhe shpirt. Por, nëse kombi është frymë dhe shpirt, kjo flet se edhe kombi shqiptar në Kosovë është një frymë e një shpirt, që nuk mund ta ndërrosh e ta zëvendësosh me një frymë e me një shpirt të një kombi tjetër, në rastin konkret të “kombit kosovar”.

● Kombi, sidomos kur ai është monoetnik (i krijuar nga një etni e vetme, siç rasti edhe me kombin shqiptar), nuk është vetëm një frymë apo një shpirt, siç ka thënë Ernest Renani, por është edhe etni, histori, gjuhë dhe kulturë e një komuniteti të veçantë kombëtar, e të gjitha këto të krijuara jo brenda natës, por shekuj me radhë. Shqiptarëve të Kosovës nuk mund t’ua shkulësh aq lehtë

---

<sup>12</sup> Nexhmedin Spahiu: “Oksigjen”, pjesa 1, 13.11.21:<https://www.youtube.com/watch?v=gm>

përkatësinë kombëtare shqiptare, si të ishte ajo një puhizë ere dhe as nuk mund t'ua implantosh një përkatësi kombëtare tjetër "kosovare", si të ishte ajo, po ashtu, një puhizë tjetër ere.

### **Katër libra - katër pamflete propagandistike**

● Duke pasur parasysh se idetë e Spahiut të propaganduara në katër libra, për gjoja krijimin nga shqiptarët e Kosovës pas pavarësisimit të Kosovës të "kombi kosovar", nuk kanë asgjë të përbashkët me realitetin objektiv në Kosovë, ku ka komb shqiptar, por nuk ka "komb kosovar", ato libra si të tilla nuk janë tjetër, veçse katër pamflete propagandistike politike, në shërbim të ndarjes dhe të çoroditjes së kombit shqiptar.

● Këto katër pamflete të Spahiut, për mendimin tim, ngërthejnë brenda vetes idetë më të errëta të mundshme që ka pasur ndonjëherë ndonjë shqiptar ndaj kombit shqiptar. Në të kaluarën ka pasur shqiptarë që i kanë shitur interesat e Shqipërisë dhe të Kosovës te Serbia apo te Greqia, por nuk ka pasur asnjë shqiptar që e ka kërkuar ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri "kosovar

---

## KEQINTERPRETIMI I PLANIT/DOKUMENTIT TË AHTISARIT NË FUNKSION TË PROPAGANDIMIT TË GJOJA KRIJIM- EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”

Nexhmedin Spahiu për t’i bindur shqiptarët se ata, pas çlirimit dhe pavarësisimit të Kosovës, janë tjetërsuar ose duhet të tjetërsohen nga komb shqiptar në “komb kosovar”, nuk ka zgjedhur e nuk zgjedh mjete. Kështu, për këtë qëllim ai i ka keqinterpretuar deri edhe dokumentet themelore të shtetit të Kosovës: Planin/Dokumentin e Ahtisarit<sup>13</sup>, në saje të të cilit Kosova është shpallur shtet i pavarur në vitin 2008 dhe, Kushtetutën e Kosovës të miratuar në Kuvendin e Kosovës më 8 prill të vitit 2008.

### **Plani/Dokumenti i Ahtisarit nuk e njeh “kombin kosovar”, por njeh kombin shqiptar**

Lidhur me Planin/Dokumentin e Ahtisarit, Spahiu ka shkruar si më poshtë:

**■ Kombi kosovar nuk përmendet as në Kushtetutën e Kosovës. Por kombi kosovar përmendet shprehimisht në**

---

<sup>13</sup> Marti Ahtisari, ish-presidenti i Finlandës, gjatë viteve 2006-2008 ka qenë i autorizuar nga OKB-ja që të udhëhiqte bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë, për gjetjen e statusit politik përfundimtar të Kosovës. Pas bisedimeve dyvjeçare për gjetjen e statusit përfundimtar të Kosovës, Marti Ahtisari ka dalë me planin/dokumentin e tij për gjetjen e statusit përfundimtar të Kosovës, në saje të të cilit Kosova në vitin 2008 është shpallur shtet i pavarur dhe demokratik: [https://en.wikipedia.org/wiki/Marti\\_Ahtisari](https://en.wikipedia.org/wiki/Marti_Ahtisari)

**Planin e Ahtisaarit në nenin 1.7, ku shkruan se Kosova duhet të ketë simbolet e veta kombëtare. Politikanët kosovarë dhe shumica e medieve kosovare këto i quajnë simbole shtetërore, kurse simbole kombëtare quajnë vetëm simbolet kombëtare shqiptare<sup>14</sup>.**

● **Por në pikën 1.7 të Dokumenti e Ahtisarit** (në saje të të cilit Kosova është pavarësuar), nuk thuhet plotësisht ashtu siç thotë Spahiu, por thuhet pak më ndryshe, përkatësisht thhet:

■ **Kosova duhet të ketë simbolet e veta kombëtare, përfshirë flamurin, stemën dhe himnin, të cilat paraqesin karakterin multietnik të saj.**

● Për vetë faktin se në pikën 1.7 të Planit/Dokumentit të Ahtisarit thuhet se simbolet e Kosovës **paraqesin karakterin multietnik të Kosovës**, kjo flet qartë se këto simbole nuk janë simbole të asnjë komuniteti kombëtar të veçantë që jeton në Kosovë, por janë thjesht simbole të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, të cilat së bashku paraqesin karakterin multietnik të shtetit të Kosovës, gjë tregon se flamuri, stema dhe himni i Kosovës janë simbole shtetërore të Kosovës, dhe jo simbole të ndonjë kombi të veçantë “kosovar”, siç do të donte Spahiu.

● Duke qenë Dokumenti i Ahtisarit i hartuar në gjuhën angleze, në të cilën fjala *komb* (anglisht “nation”) nuk ka vetëm kuptimin e kombit, por ka edhe kuptimin e shtetit, shtrohet pyetja: në çfarë kuptimi është shkruar shprehja “simbole kombëtare” në Dokumentin e Ahtisarit?

● Duke pasur parasysh se në shkurtin e vitit 2008 realisht dhe objektivisht ka ndodhur shtetbërja e Kosovës, por nuk ka ndodhur krijimi i “kombit kosovar”, kjo flet se shprehja “simbole kombëtare” në Dokumentin e Ahtisarit është shkruar në kuptimin e simboleve shtetërore të Kosovës, dhe jo në kuptimin e “simboleve kombëtare” të kombit joekzistues “kosovar”, siç mund t’i duket Spahiut.

● Por Spahiu do që fjalën “nation” në gjuhën angleze të na e servojë vetëm kuptimin e kombit e jo edhe të shtetit. Kjo, sepse po të na e servonte fjalën *komb* (“nation”) edhe në kuptimin e shtetit, del se

---

<sup>14</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit*: <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

në Kosovë ka shtet të Kosovës, por nuk ka “komb kosovar” dhe, rrjedhimisht në Kosovë nuk ka as simbole të “kombit kosovar”, por ka simbole të shtetit të Kosovës.

● Se fjala “komb” në gjuhën angleze “nation” ka edhe kuptimin e kombit, edhe kuptimin e shtetit, për këtë flasin qartë edhe shumë fjalorë anglisht - gjuhë tjera, në të cilët fjala “nation” e gjuhës angleze është përkthyer jo vetëm si *komb*, por edhe si *shtet* dhe *vend*.

● Kështu, dihet mirëfilli se fjala *komb* (“nation”) në gjuhën angleze është dykuptimshme dhe në varësi të kontekstit të çështjes që trajtohet, herë merr kuptimin e kombit, herë merr kuptimin e shtetit, dhe herë edhe kuptimin e vendit.

● Edhe Migjen Kelmendi e propagandon krijimin e kombit kosovar, duke e quajtur atë “identitet kosovar”, por ai në dallim nga Spahiu, e pranon se fjala *komb* në gjuhën angleze “nation” ka dy kuptime: atë të kombit dhe atë të shtetit.

● Se pika 1.7 e Planit/Dokumentit të Ahtisarit në të cilën thuhet se “**Kosova duhet të ketë simbolet e veta kombëtare, përfshirë flamurin, stemën dhe himnin, të cilat paraqesin karakterin multietnik të saj**”, nuk ka të bëjë me simbolet kombëtare të Kosovës, përkatësisht me simbolet e “kombit kosovar” të paqenë, por ka të bëjë me simbolet shtetërore të Kosovës, për këtë flasin neni 2.1 dhe neni 2.2 i ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës, në të cilat thuhet qartë se flamuri, stema dhe himni i Kosovës janë simbole shtetërore të Republikës së Kosovës.

● Në **nenin 2.1** të ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës thuhet:

■ **Simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës janë: flamuri, stema dhe himni<sup>15</sup>. Ky nen vërteton se flamuri, stema dhe himni i Kosovës janë simbole të shtetit të Kosovës, dhe nuk janë simbole kombëtare të Kosovës apo të “kombit kosovar”, siç përpiqet t’i paraqesë ato Spahiu, Matoshi e ndonjë tjetër.**

● Në **nenin 2.2** të ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës thuhet:

---

<sup>15</sup> Ligji për përdorimin e simboleve shtetërore:  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2517>

■ **Me flamurin, stemën dhe himnin përfaqësohet Republika e Kosovës dhe identiteti shtetëror i saj**<sup>16</sup>. Edhe ky nen tregon qartë se me flamurin, stemën dhe himnin e Kosovës përfaqësohet Republika e Kosovës dhe identiteti shtetëror i saj, dhe nuk përfaqësohet identiteti i “kombit kosovar”, edhe ashtu joekzistues, siç përpiqet të na bindë Spahiu, Matoshi dhe ndonjë tjetër.

● Nëse fjala *komb* (në gjuhën angleze “nation”) në Dokumentin e Ahtisarit do të kishte kuptimin e “kombit kosovar”, siç na thotë Spahiu, atëherë Bashkësia Ndërkombëtare deri më tani do t’ia kishte kërkuar Kosovës shumë herë krijimin e “kombit kosovar”. Fakti se askush në botë nuk i ka kërkuar Kosovës krijimin e “kombit kosovar” dhe fakti se askush në botë nuk e ka kushtëzuar shtetbërjen e Kosovës me krijimin e “kombit kosovar”, këto flasin qartë se fjala “kombëtare” (në gjuhën angleze “national”) në pikën 1.7 të Dokumentit të Ahtisarit, nuk ka të bëjë aspak me “kombin kosovar”, por ka të bëjë kryekëput me shtetin e Kosovës.

● Ose nëse pika 1.7 në Dokumentin e Ahtisarit, në të cilën thuhet se “*Kosova do të ketë simbolet e veta të veçanta kombëtare, përfshirë flamurin, stemën dhe himnin...*”, do të nënkuptonte simbolet kombëtare të “kombit kosovar”, atëherë shtrohet pyetja: pse të njëjtat simbole në **nenin 6, pika 1 të Kushtetutës së Kosovës** nuk përcaktohen si simbole kombëtare të Kosovës, por përcaktohen si simbole shtetërore të Republikës së Kosovës.

● Në nenin 6, pika 1 të Kushtetutës së Kosovës thuhet si në vijim:

■ **Flamuri, stema dhe himni janë simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës, të cilat pasqyrojnë karakterin shumetnik të saj**<sup>17</sup>.

● Definimi i simboleve të Kosovës në nenin 6, pika 1 të Kushtetutës së Kosovës si simbole shtetërore të saj, tregon qartë se edhe pika 1.7 e Dokumentit të Ahtisarit nuk ka të bëjë aspak me simbole kombëtare të “kombit kosovar”, por ka të bëjë me simbolet e shtetit shumetnik të Kosovës.

---

<sup>16</sup> Kushtetuta e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2517>

<sup>17</sup> Kushtetuta e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

● Faktet që u përmendën më lart tregojnë qartë se Plani/Dokumenti i Ahtisarit, në kundërshtim me ato që thotë Spahiut, nuk e njih aspak ekzistimin e “kombit fiktiv kosovar”, por njih ekzistimin e shtetit të Kosovës dhe e njih edhe kombin shqiptar objektiv dhe real.

### **Në Kosovë festohet “Dita Kombëtare e Shqiptarëve”**

● Por ka edhe fakte të tjetra, të cilat flasin qartë se Dokumenti/Plani i Ahtisarit e njih kombin ekzistues shqiptar, dhe nuk e njih kombin fiktiv “kosovar” të Spahiut. Një nga këto fakte është edhe festimi i caktuar me ligj i **“Ditës Kombëtare të Shqiptarëve”**, që është dita e 28 Nëntorit, kur në vitin 1912 është ngritur Flamuri Kombëtar Shqiptar në Vlorë nga Ismail Qemali.

● Nëse Dokumenti i Ahtisarit do ta kishte njohur ekzistimin e “kombit kosovar”, siç na thotë Spahiut, atëherë në Kosovë nuk do të festohej “Dita Kombëtare e Shqiptarëve”, por do të festohej “Dita Kombëtare e Kosovarëve”. Fakti se në Kosovë festohet “Dita Kombëtare e Shqiptarëve”, me ç’rast në vendet publike ngrihet Flamuri Kombëtar Shqiptar, kjo flet qartë se Dokumenti i Ahtisarit e njih kombin shqiptar, por nuk e njih “kombin kosovar”.

### **Në Kosovë festohen edhe “Ditët kombëtare të komuniteteve pakicë”**

● Fakti se në Kosovë është vendosur me ligj që të festohen edhe “Ditët kombëtare të komuniteteve pakicë”, kjo po ashtu flet se Dokumenti i Ahtisarit si shumicës shqiptare, ashtu edhe komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë, ua njih përkatësitë e tyre kombëtare përkatëse dhe nuk u vesh atyre ndonjë përkatësi kombëtare të përbashkët “kosovare”.

● Janë këto arsye pse pohimi i Spahiut, se Plani/Dokumenti i Ahtisarit e njih “kombin kosovar”, nuk është tjetër, veçse një keqinterpretim i qëllimshëm i Spahiut në adresë të Dokumentit Ndërkombëtar të Ahtisarit, me qëllim që t’i bindë (për mendimin tim t’i mashttoj) shqiptarët e Kosovës, që ata të tjetërsohen nga komb shqiptar në “komb kosovar”, sepse gjoja këtë e paska parashikuar edhe Ahtisari në dokumentin e tij, në saje të të cilit Kosova është shpallur shtet i pavarur.

## **Në planin e Ahtisarit komuniteti shqiptar nuk njihet si “komb kosovar”**

Spahiu duke u marrë me Planin/Dokumentin e Ahtisarit ka thënë më tej:

■ U gjenden edhe ca idiotë që të thoshin nëpër televizione, për t’u mburrur se dinë diçka, se me demek, 6 yjet paraqesin komunitetet etnike në Kosovë. Por këta idiotë harronin se me Planin e Ahtisaarit dhe Kushtetutën e Kosovës njihen 8 komunitete. Komuniteti shqiptar si komb kosovar, dhe 7 komunitete të tjera si minoritete: serbët, boshnjakët, goranët, turqit, ashkalinjtë, romët dhe egjiptasit. Në fund të fundit, estetika e simboleve kombëtare nuk luan aspak rol, është vetë kombi që i bën ato të vlefshme apo të pavlefshme. Një komb mund t’i ndryshojë kur të dojë simbolet e veta kombëtare. Mjafton që ideja të përkrahët nga 2/3-at e deputetëve në Parlament<sup>18</sup>.

● Duke thënë në pohimet e tij të cituara më lart, se Plani i Ahtisarit komunitetin shqiptar e paska njohur si “komb kosovar”, Spahiu nuk thotë tjetër, përveç një të pavërtetë të madhe sa bjeshka, sepse në asnjë rresht të Planit të Ahtisarit nuk thuhet se komuniteti shqiptar e paraqet “kombin kosovar”. Dhe për më tepër në Planin e Ahtisarit nuk përmendet as edhe një herë të vetme “kombi kosovar”. Prandaj pohimi i Spahiut se në Planin e Ahtisarit komuniteti shqiptar njihet si “komb kosovar”, nuk është tjetër, veçse një trillim dhe sajim i tij i bluar shumë i trashë i tij.

## **Plani/ Dokumenti i Ahtisarit nuk e ka formuluar kombin fiktiv “kosovar”**

Spahiu duke dashur të na bindë se Plani/Dokumenti i Ahtisarit e ka formuluar krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, ka shkruar si më poshtë:

■ **Plani i Ahtisaarit në mënyrë implicite formulon kombin Kosovar**<sup>19</sup>

---

<sup>18</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi. 26 gusht, 2016. *Dritare net*: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

<sup>19</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit*, gazeta “Dielli”, DEZENBER 4, 2015: <https://>

● Lidhur me thënien e Spahiut të cituar më lart dua t'i sqaroj lexuesit, se në Planin/Dokumentin e Ahtisarit “kombi kosovar” nuk është formuluar as në mënyrë implicite e as në mënyrë eksplicite. Kjo, sepse në asnjë rresht të Dokumentit të Ahtisarit nuk flitet as në mënyrë implicite, as në mënyrë eksplicite për “komb kosovar”. Kjo është arsyeja pse pohimi i Spahiut, se në Dokumentin e Ahtisarit na qenka formuluar, sipas tij, në mënyrë implicite “kombi kosovar”, nuk është tjetër, veçse një keqinterpretim tjetër i tij i qëllimshëm në adresë të Dokumentit të Ahtisarit.

### **Ahtisari e nënkupton kombin ekzistues shqiptar dhe jo kombin joekzistues “kosovar”**

Spahiu në vazhden e propagandimit të ekzistimit të “kombit kosovar”, për Dokumentin e Ahtisarit ka shkruar edhe si më poshtë: **■ Edhe Ahtisaari edhe pse nuk e përmend në mënyrë decitive, eksplicite, por në mënyrë implicite, Ahtisaari e nënkupton kombin kosovar, e kupton si ni komb monoetnik, sepse minoriteteve në parlamentin e Kosovës janë lan vende të rezervume, domethon i dallon me diçka. Kur ta diskriminojsh dikend, qoftë pozitivisht, qoftë negativisht, doemthon ti veç po ndan ato pi atij komuniteti<sup>20</sup>. (min. 25:27-26:04)**

● Lidhur me thënien e Spahiut të cituar më lart, dua t'i sqaroj lexuesit, se Ahtisari në dokumentin e tij as nuk e përmend e as nuk e nënkupton ekzistimin e “kombit kosovar”, siç përpiqet të na hedhë hi syve Spahiu, por e nënkupton kombin shumicë ekzistues shqiptar dhe komunitetet pakicë që jetojnë ne Kosovë. Po ashtu dua t'i sqaroj lexuesit, se sigurimi i dhjetë vendeve rezervë në Kuvendin e Kosovës për deputetë serbë, nuk ka pasur asgjë të përbashkët me krijim-ekzistimin e “kombit kosovar” si komb monoetnik, siç mund t'i duket Spahiut, por ka pasur të bëjë me diskriminimin pozitiv të pakicës serbe, me qëllim që ajo të integrohet brenda shtetit të Kosovës me identitetin e vet të veçantë serb.

---

[gazetadielli.com/koncepti-i-kombit/](http://gazetadielli.com/koncepti-i-kombit/)

<sup>20</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun “Valamala Show”, 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

## **Në Kosovë ka komb shqiptar monoetnik dhe bireligjioz, por nuk ka “komb kosovar” monoetnik dhe bireligjioz**

Për të na bindur se në Kosovë ka komb kosovar monoetnik dhe bireligjioz, Spahiu ka shkruar si më poshtë:

■ **Plani i Ahtisaarit në mënyrë implicite formulon kombin kosovar. Sipas Pakos së Ahtisaarit del se kombi kosovar është komb monoetnik dhe bireligjioz (mysliman-katolik)**<sup>21</sup>.

● Lidhur me thënien e Spahiut të cituar më lart dua të sqaroj se, në Planin/Dokumentin e Ahtisarit “kombi kosovar” jo vetëm që nuk formulohet si komb monoetnik dhe bireligjioz (mysliman-katolik), siç përpiket të na bindë Spahiu, por siç është thënë edhe më lart, “kombi kosovar” në Dokumentin e Ahtisarit nuk përmendet as edhe një herë të vetme. Një gabim të tillë logjik nuk e ka bërë Ahtisari në dokumentin e tij, sepse ai e ka ditur paraprakisht se në Kosovë ka pasur komb shqiptar monoetnik dhe bireligjioz (mysliman-katolik), dhe nuk ka pasur “komb kosovar” monoetnik dhe bireligjioz. Spahiu përpiket që kombit të tij joekzistues “kosovar”, t`ia vesh karakteristikat e kombit ekzistues shqiptar.

## **Për të pasur “komb kosovar” në Kosovë, do të ishte dashur që shqiptarët të ishin përzier paraprakisht me martesë të përziera me pjesëtarë të kombit serb**

● Për të pasur “komb kosovar” në Kosovë, kusht i domosdoshëm do të ishte që kombi shqiptar në Kosovë, paraprakisht, në masë të konsiderueshme dhe për një kohë relativisht të gjatë, të përzihej etnikisht me martesë të përziera me pjesëtarët e komunitetit serb, ose me pjesëtarët e ndonjë komuniteti tjetër, me ç`rast ish-kombi shqiptar nuk do të ishte më plotësisht monoetnik, por në njëfarë mase do të ishte një komb bietnik. Dhe ky komb bietnik, për shkak të këtij bietniciteti nuk do të quhej më komb shqiptar, por do të merrte emrin e vendit, duke u quajtur “komb kosovar”.

● Por, megjë kombi shumicë shqiptar në Kosovë nuk është përzier etnikisht me martesë të përziera me pjesëtarë të kombit serb ose

---

<sup>21</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit*, gazeta *Dielli*, DEZENBER 4, 2015  
<https://gazetadielli.com/koncepti-i-kombit/>

me pjesëtarë të ndonjë kombi tjetër, kjo në kundërshtim me ato që thotë Spahiu, tregon qartë se në Kosovë nuk ka “komb kosovar” monoetnik bireligjioz, por ka komb shqiptar monoetnik dhe bireligjioz, siç ka pasur gjithmonë.

● Kështu, nëse në Kosovë do të kishte vërtet “komb kosovar”, siç na thotë Spahiu, ai “komb kosovar” patjetër do të duhej të ishte një komb bietnik, përkatësisht një komb i përzier shqiptaro-serb. Por duke mos pasur në Kosovë një komb të përzier shqiptaro-serb, i cili do të quhej “komb kosovar”, kjo tregon se në Kosovë ka komb monoetnik shqiptar dhe ka edhe komunitete pakicë, por nuk ka komb monetnik “kosovar”.

● Spahiu duke pohuar se në Kosovë ka “komb monoetnik kosovar”, ai kështu nuk bën gjë tjetër, veçse kombin monoetnik shqiptar e quan “komb monoetnik kosovar”. Ai e bën këtë, sepse mendon që kështu vërtet e ndihmon krijimin e “kombit kosovar”, aq shumë të dëshiruar prej tij. Por ja që njerëzit nuk janë aq të paditur, saqë thëniet mashtruese të Spahiut, për gjoja ekzistimin e “kombit kosovar”, t’i “gëlltitin” symbyllur.

### **Vija mes komunitetit shumicë shqiptar dhe komuniteteve pakicë në Kosovë**

Spahiu për të na bindur se në Kosovë kombin shumicë e paraqet, sipas tij, “kombi kosovar” i krijuar nga etnia shqiptare, ka shkruar si në vijim:

**Me Planin e Ahtisaarit në mënyrë eksplicite definohej se cilat janë minoritetet në Kosovë dhe të drejtat e tyre pozitivisht të diskriminuara. Kjo do të thotë që kombin në Kosovë e përbën komuniteti shqiptar, për vetë faktin se komunitetet e tjera janë të definuara si minoritete<sup>22</sup>.**

● Pajtohem me thënien e Spahiut të cituar më lart sipas të cilës Plani/ Dokumenti i Ahtisarit ka vënë vijën e demarkacionit mes kombit shumicë që përbëhet nga komuniteti shqiptar dhe komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë.

● Por nuk pajtohem me aludimin e Spahiut të bërë në thënin e

---

<sup>22</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit*: <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

tij të cituar më lart, sipas të cilit komuniteti shumicë shqiptar e paraqet “kombin kosovar” realisht dhe objektivisht joekzistues. Komuniteti shqiptar shumicë e ka paraqitur dhe e paraqet kombin shqiptar objektivisht dhe realisht ekzistues.

● Në fakt, Ahtisari duke bërë dallimin mes komunitetit shumicë shqiptar dhe komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë, e ka projektuar Kosovën si shtet multietnik: me një etni/komb shumicë shqiptar dhe me disa etni/kombe pakicë, siç janë serbët, turqit, boshnjakët, goranët, romët etj., dhe nuk e ka projektuar Kosovën si komb të vetëm multietnik “kosovar” brenda të cilit do të duhej të integroheshin (asimiloheshin) komunitetet pakicë të përmendura më lart.

### **Nga kombi monoetnik shqiptar nuk ka mundur të krijohet një komb tjetër, përveç kombit shqiptar**

● Ideja e Spahiut dhe e Matoshit, sipas së cilës në Kosovë nga etnia shqiptare është krijuar “kombi kosovar”, nuk qëndron aspak. Kjo, sepse duke qenë kombi shqiptar një komb i ngritur mbi konstruktin e tij etnik, historik, gjuhësor e kulturor të veçantë, kjo tregon se prej etnisë shqiptare as para dhe as pas pavarësimit të Kosovës, nuk ka mundur të krijohet një komb tjetër “kosovar”.

● Nga etnia shqiptare (në fakt nga etnia pellazgo-iliro-arbërore) është krijuar kombi shqiptar, por nga ky i fundit nuk ka mundur të krijohet një komb tjetër me emrin “komb kosovar”. Ky konkluzion i drejtë përputhet me teoritë e filozofëve gjermanë për kombin, sipas të cilave etnia dhe kombi paraqesin të njëjtën gjë sipas formulës:

***Etnia shqiptare = Kombi shqiptar dhe anasjelltas:***

***Kombi shqiptar = Etnia shqiptare.***

### **Fyerje ndaj mençurisë politike të Ahtisarit**

E kam lexuar disa herë Dokumentin e Ahtisarit, por brenda tij askund nuk formulohet, as në mënyrë implicite dhe as në mënyrë eksplicite, “kombi kosovar”. Ahtisari nuk ka qenë aq i paditur dhe aq i palogjikshëm, saqë brenda Dokumentit/Planit të tij për Kosovën të formulonte një komb joekzistues “kosovar”. Ahtisari ka qenë një politikan i rangut botëror. Ai nuk është përzgjedhur

rastësisht nga OKB-ja, që të udhëhiqte bisedimet gjatë viteve 2005-2007, mes delegacionit të Kosovës dhe të Serbisë, për gjetjen e një zgjidhjeje përfundimtare për statusin e Kosovës. Prandaj të thuash se Ahtisari brenda Planit/Dokum-entit të tij për Kosovën ka formuluar një komb joekzistues “kosovar”, siç thotë Spahiu, kjo nuk është tjetër, veçse një fyerje banale e Spahiut ndaj mençurisë politike të Marti Ahtisarit.

# 5

---

## DOKUMENTI I AHTISARIT NËPËRMJET TË DISKRIMINIMIT POZITIV TË PAKICËS SERBE, E PAMUNDËSON KRIJIMIN E KOMBIT KOSOVAR, SI DHE E BËN KOSOVËN SHTET SUI GENERIS

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se Planit/Dokumenti i Ahtisarit jo vetëm që nuk e njeh dhe nuk e synon krijimin e “kombit kosovar”, siç mundohet të na bindë Spahiu pa asnjë fakt, por përkundrazi, ai (dokumenti i Ahtisarit) duke e diskriminuar aq shumë pozitivisht pakicën serbe, edhe e pamundëson krijimin e “kombit kosovar”.

● Edhe Spahiu e përmend diskriminimin pozitiv të pakicës serbe nga ana e Planit/Dokumentit të Ahtisarit, por ai nuk e pranon faktin se diskriminimi pozitiv i pakicës serbe e pamundëson krijimin e “kombit kosovar”. Kështu, Spahiu ka shkruar si më poshtë:

■ Sipas Planit të Ahtisaarit, serbët mbeten pjesë integrale e kombit serb, sepse çdo serb i Kosovës mund ta mbajë shtetësinë serbe. Po ashtu ata janë njëkohësisht edhe minoritet në Kosovë, por për dallim nga minoriteti boshnjak apo ai turk që vijojnë mësimet në shkolla kosovare, në gjuhën boshnjake përkatësisht turke, shkollat në gjuhën serbe në Kosovë janë praktikisht shkolla të Republikës së Serbisë në territorin e Kosovës<sup>23</sup>.

---

<sup>23</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit*: <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

● Plani/Dokumenti i Ahtisarit komunitetin pakicë serb në Kosovë nuk e ka diskriminuar pozitivisht, ngase çdo serb i Kosovës mund ta mbajë shtetësinë e Serbisë. Kjo, sepse edhe çdo shqiptarë i Luginës së Preshevës brenda Serbisë mund ta mbajë shtetësinë e shtetit të Kosovës. Mbajta e shtetësisë së Kosovës nga pjesëtarët e pakicës kombëtare shqiptare në Serbi (në Luginën e Preshevës) jo vetëm që nuk i diskriminon ata pozitivisht, por edhe do të keqpërdorej nga regjimi serb, për shpërnguljen e tyre nga Lugina e Preshevës në Kosovë.

● Mbajtja e shtetësisë së një shteti tjetër A nga qytetarët e shtetit B, në kohët e sotme nuk paraqet diskriminim pozitiv, por paraqet një të drejtë të njeriut kudo në botë. Shqiptarët e Kosovës që punojnë dhe jetojnë në Zvicër, Gjermani dhe Austri, krahas shtetësisë së këtyre vendeve, zotërojnë edhe shtetësinë e Kosovës, dhe kjo nuk paraqet ndonjë diskriminim pozitiv për ta, por thjesht paraqet një të drejtë të njeriut për të pasur dy shtetësi.

● Plani/Dokumenti i Ahtisarit për Kosovën e ka parashikuar zhvillimin e mësimi për serbët në gjuhën serbe në shkollat që në Kosovë funksionojnë në gjuhën serbe, dhe as kjo nuk paraqet ndonjë diskriminim pozitiv për pakicën serbe. Por Plani/Dokumenti i Ahtisarit nuk e ka parashikuar zhvillimin e mësimi në shkollat në gjuhën serbe me plan-programet e Serbisë. Kështu, zhvillimi i mësimi në shkollat në gjuhën serbe në Kosovë sipas plan-programeve të Serbisë, nuk ka të bëjë aspak me ndonjë diskriminim pozitiv të serbëve nëpërmjet të Planit/Dokumentit të Ahtisarit, por ka të bëjë me lëshimet e UNMIK-ut dhe të institucioneve shtetërore të Kosovës të bëra bdaj pakicës setbe, në emër të mosacarimit të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë.

### **Diskriminimi pozitiv i pakicës serbe në Kosovë është bërë me qëllim që pakica serbe ta pranojë shtetin e Kosovës**

Duke shkruar për diskriminimin pozitiv të pakicës serbe në Kosovë, Spahiu është shprehur si më poshtë:

■ **Serbët e Kosovës janë komuniteti i vetëm në Kosovë, që ka bërë jetën e kombit për gati një shekull. Për këtë arsye, rasti i Kosovës është *Sui Generis*. Për Ahtisaarin ka qenë e**

panatyrshme që një komunitet, pas gati një shekull jete si komb, të mos vazhdojë të ketë kualitet jetese<sup>24</sup>.

■ **Duke qenë se serbët ishin i vetmi komunitet në Kosovë që ka bërë paraprakisht jetën e kombit, me Planin e Ahtisaarit atyre iu mundësua të mbesin pjesë integrale e kombit serb<sup>25</sup>.**

● Lidhur me dy thënie të Spahiut të cituara më lart, dua të sqaroj lexuesit se Ahtisari në Planin/Dokumentimin e tij për Kosovën nuk e ka diskriminuar pozitivisht pakicën serbe, për shkak se ajo në Kosovë përreth një shekull ka bërë pa të drejtë jetën e kombit, edhe pse kanë qenë minoritet, por e ka diskriminuar pozitivisht, me qëllim që pakica serbe ta pranojë realitetin e ri të shtetbërjes së Kosovës, si dhe për t'i amortizuar kundër-shtimet e Serbisë dhe të Rusisë ndaj aktit të pavarësisht të Kosovës.

● Ahtisari duke qenë i vetëdijshëm për diskriminimin ekstrem pozitiv të pakicës serbe, në dokumentin e tij ka shkruar se konkluzionet e dhëna në atë dokument nuk janë domosdoshmërisht të përjetshme dhe se ato me kalimin e kohëve edhe mund të ndryshohen.

### **Dokumenti i Ahtisarit duke shmangur integrimin e serbëve brenda shumicës shqiptare, pamundëson krijimin e “kombit kosovar”**

Spahiu duke shkruar më tej lidhur me pozitën e pakicës serbe në Kosovë, është shprehur edhe si më poshtë:

■ **Vetë dokumenti i Ahtisaarit bën shmangie nga synimi për integrim në një komb kosovar kur është fjala për serbët. Duke qenë se serbët ishin i vetmi komunitet në Kosovë që ka bërë paraprakisht jetën e kombit, me planin e Ahtisaarit, atyre iu mundësua të mbesin pjesë integrale e kombit serb. Serbëve të Kosovës u mundësohet të mbajnë shtetësinë e Serbisë, të kenë shkollat publike që i përgjigjen programeve të Ministrisë në Beograd etj<sup>26</sup>.**

<sup>24</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit* <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

<sup>25</sup> Nexhmedin Spahiu: Kombi kosovar nuk është multi-etnik (Arkiv, 13.01.2012): <https://rtvmitrovica.com/opinione-kombi-kosovar-nuk-eshte-multi-etnik/By>

<sup>26</sup> Nexhmedin Spahiu: Kombi kosovar nuk është multi-etnik (Arkiv, 13.01.2012):

● Lidhur me thënien e Spahiut të cituar më lart, pajtohem se **Dokumenti i Ahtisarit bën shmangie nga synimi për integrim në një komb kosovar kur është fjala për serbët**, por Dokumenti i Ahtisarit këtë shmangie nuk e bën ngase serbët paraprakisht kanë bërë jetën e kombit në Kosovë, siç mund t'i duket Spahiut, por e ka bërë këtë për t'i siguruar serbët, se ata në Kosovën e pavarur do të jenë një subjekt kombëtar i mëvetësishëm dhe i barabartë me shqiptarët, dhe kjo me qëllim që serbët ta pranojnë shtetin e Kosovës si shtetin e tyre.

● Për vetë faktin se Dokumenti i Ahtisarit e shmang integrimin e pakicës serbe brenda komunitetit shumicë shqiptar, të cilin Spahiu gabimisht e quan “komb kosovar”, kjo tregon qartë se në Kosovë as nuk ka pasur dhe anuk mund të ketë “komb kosovar”. Kjo, sepse kusht i domosdoshëm për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” është integrimi i komuniteteve pakicë (përfshi edhe pakicën serbe) brenda kombit shumicë shqiptar, i cili pas përzjerjes me komunitetet pakicë do të ndryshohej dhe, për rrjedhojë, do të quhej “komb kosovar”.

● Është interesant fakti, që Spahiu edhe në kundërshtim me vetë Dokumentin e Ahtisarit, i cili jo vetëm që nuk e synon, por dhe e pamundëson krijimin e “kombit kosovar”, ai (Spahiu) me kryeneçësi thotë se Dokumenti i Ahtisarit në mënyrë implicite e njeh “kombin kosovar”, si dhe po me kryeneçësi dhe pa asnjë fakt pohon, sikur gjoja nga shqiptarët e Kosovës veç është krijuar “kombi kosovar”. Por, të kërkosh nga shqiptarët e Kosovës krijim të “kombit kosovar”, është si t'i thuash ujit: ec përpjetë!

### **Dokumenti i Ahtisarit paraqet pengesën kryesore për krijimin e “kombit kosovar”**

● Lidhur me Dokumentin e Ahtisarit, Spahiu ka shkruar edhe si në vijim:

■ **Plani i Ahtisarit nuk është pengesë që kombi kosovar në të ardhmen të zhvillohet në një komb multi-etnik. Përkundrazi, Plani i Ahtisarit e synon pikërisht këtë perspektivë. Prej**

**të gjitha komuniteteve në Kosovë, më së paku pritet që komuniteti serb të bëhet pjesë integrale e kombit Kosovar<sup>27</sup>.**

● Kjo thënie e Spahiut, sipas së cilës dokumenti i Ahtisarit nuk është pengesë për krijimin e kombit kosovar si komb multi-etnik, është në kundërshtim me thënien paraprake të tij të cituar më lart, sipas së cilës: **Dokumenti i Ahtisarit bën shmangie nga synimi për integrim në një komb kosovar kur është fjala për serbët**, gjë që nënkupton se ky dokument jo vetëm që nuk synon krijimin e “kombit kosovar multi-etnik”, por përkundrazi, paraqet pengesën kryesore të krijimit të tij.

● Dhe tjetra që mund t’i sqaroj lexuesit, është se Plani/ Dokumenti i Ahtisarit nuk e pamundëson krijimin e “kombit kosovar” vetëm me diskriminimin ekstrem pozitiv të serbëve dhe vetëm me shmangien e serbëve për t’u integruar brenda komunitetit shumicë shqiptar, por e pamundëson edhe duke e projektuar Kosovën si shoqëri shumë-etnike (multi-etnike), pra si një shtet me shumë etni të ndryshme dhe jo si një shtet me një “komb të vetëm multi-etnik kosovar”, brenda të cilit do të integroheshin dhe, me kalimin e kohëve, edhe do të asimiloheshin komunitetet pakicë.

● Se Plani/Dokumenti i Ahtisarit e projektonte Kosovën si shoqëri multi-etnike (shoqëri me komunitete të ndryshme etnike) dhe jo si një shoqëri me një komb të vetëm multi-etnik kosovar“, brenda të cilit do të integroheshin (asimiloheshin) të gjitha komunitet pakicë, për këtë flet sidomos **pika 1.1 e Dokumentit të Ahtisarit** në të cilën thuhet:

**■ Kosova do të jetë një shoqëri shumë-etnike që, nëpërmjet institucioneve të saj legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, dhe me respekt të plotë për sundimin e ligjit, do të ushtrojë pushtetin e saj demokratik.**

● Sikur Spahiu ta pranonte faktin se Dokumenti i Ahtisarit Kosovën e ka projektuar si shtet shumë-etnik dhe jo si “komb kosovar multi-etnik”, ai nuk do të merrej më me propagandimin e krijim-ekzistimit të kombit të tij fiktiv “kosovar”, duke e lënë kësajsoj të qetë edhe veten, edhe shqiptarët.

---

<sup>27</sup> Nexhmedin Spahiu: Koncepti i kombit: <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

## **Kosova - një shtet i veçantë *sui generis*<sup>28</sup>!**

Lidhur me diskriminimin pozitiv të pakicës serbe, Spahiu ka shkruar si në vijim:

■ Kur flitet për atë se Kosova është “*sui generis*” mendohet pikërisht në këtë fakt: Dokumenti i Ahtisaarit ua mundëson serbëve të integrohen në shoqërinë kosovare, pra të bëhen pjesë integrale e kombit kosovar po qe se ata duan, por me asnjë mekanizëm nuk i cyt në këtë drejtim. Ky nuk është rasti me serbët në Kroaci e Maqedoni, ku serbët nga të qenët komb për gati një shekull, tani bëjnë jetën e një minoriteti etnik<sup>29</sup>.

● Pajtohem me thëniet e Spahiut të cituara më lart, sipas të cilave: Plani/Dokumenti i Ahtisarit duke i diskriminuar aq shumë pozitivisht serbët e Kosovës, ai e ka bërë shtetin e Kosovës një rast *sui generis*. Por, pikërisht *sui generiteti* i tillë i Kosovës nuk e lejon krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, si një komb i përbashkët për të gjitha komunitetet etnike që jetojnë në Kosovë. Kjo, sepse pakica serbe pikërisht duke qenë e diskriminuar kaq shumë pozitivisht, nuk ka nevojë për integrimin e saj brenda kombit shumicë shqiptar, për t’u krijuar pastaj prej tij “kombi multietnik kosovar”.

● Pajtohem me Spahiun, se Dokumenti i Ahtisarit nuk e nxit me asnjë mekanizëm integrimin e serbëve brenda “kombit kosovar”. Por, shtohet pyetja: *si do ta nxiste Dokumenti i Ahtisarit integrimin e serbëve brenda “kombit kosovar”, kur në Kosovë realisht dhe objektivisht nuk ka pasur e nuk ka “komb kosovar”?* Spahiu duke thënë se Dokumenti i Ahtisarit nuk e cyt pakicën serbe që të integrohet brenda “kombit kosovar”, ai krijimin e “kombit kosovar” përpiqet të na e paraqesë si një akt të kryer. Por aktet e kryera nuk realizohen me fjalë.

### **Gjashtë diskriminimet pozitive të pakicës serbe, të cilat e kanë bërë Kosovën shtet *sui generis*!**

#### **I. Dokumenti i Ahtisarit e ka bërë Kosovën shtet *sui generis*, duke**

<sup>28</sup> *Sui generis*: diçka e llojit, gjinisë, rendit të vet, unike në karakteristikat e tij

<sup>29</sup> Nexhmedin Spahiu: Kombi kosovar nuk është multietnik (Arkiv, 13.01.2012) <https://rtvmitrovica.com/opinione-kombi-kosovar-nuk-eshte-multietnik/By>

**shpallur në Kosovë gjuhë zyrtare edhe gjuhën e pakicës serbe, krahas gjuhës shqipe.** Në asnjë vend të botës nuk ka ndodhur që gjuhë zyrtare të jetë edhe gjuha e një pakice kombëtare, e cila nuk përbën më shumë se 3% të popullatës së përgjithshme të atij vendi, siç është rasti me pakicën serbe në Kosovë.

**2. Dokumenti i Ahtisarit e ka bërë Kosovën shtet *sui generis*, nëpërmjet të procesit të decentralizimit,** proces ky që ka rezultuar me formimin e 10-të komunave me popullatë serbe me nga 3000 e 5000 banorë, kuptohet me qëllim që numri i komunave me popullatë serbe të ishte sa më i madh në Kosovë. Por fakti se Prishtina e banuar me rreth 250 mijë banorë shqiptarë, është një komunë e vetme dhe fakti se edhe të gjitha qytetet dhe qytezat e tjera të Kosovës të banuara me nga 20 mijë, 50 mijë e 100 mijë banorë shqiptarë, po ashtu janë nga një komunë e vetme, kjo tregon qartë se decentralizimi i Kosovës i parashikuar me Dokumentin e Ahtisarit, komunitetin pakicë serb e ka diskriminuar pozitivisht, kurse komunitetin shumicë shqiptar e ka diskriminuar negativisht

**3. Dokumenti i Ahtisarit e ka bërë Kosovën shtet *sui generis*, edhe duke ia rezervuar pakicës serbe dhjetë deputetë serbë në Kuvendin e Kosovës,** pa marrë parasysh rezultatin e zgjedhjeve. Kështu, ndërsa shqiptarëve për t'u bërë deputetë iu duhet një numër i madh i votave të popullit, dhjetë serbë bëhen deputetë të kuvendit të Kosovës edhe nëse nuk e kanë asnjë votë të popullit.

**4. Dokumenti i Ahtisarit e ka bërë Kosovën shtet *sui generis*, edhe duke iu njohur kishave ortodokse serbe territore të mëdha tokësore,** të cilat kishat serbe nuk i kanë pasur as në kohën e Mbretërisë së Jugosllavisë gjatë viteve 1918-1941, kur të drejtat e shqiptarëve nga ana e regjimit mbretëror të Jugosllavisë janë shkelur si në kohët e skllavërisë. Kështu, mund të thuhet lirisht se në Kosovë 100 xhami së bashku, nuk kanë pronësi tokësore sa ka vetëm Manastiri Ortodoks Serb në Deçan. Edhe në Serbi asnjë kishë dhe as asnjë manastir nuk ka pronësi tokësore sa ka Manastiri Ortodoks Serb i Deçanit.

**5. Kosovën e ka bërë shtet *sui generis* edhe aplikimi i plan-programeve shkollore të Serbisë** në shkollat në gjuhën serbe në Kosovë, por kjo nuk ka të bëjë me Dokumentin e Ahtisarit, sepse në

atë dokument nuk thuhet se shkollat në gjuhën serbe në Kosovë, duhet të punojnë sipas plan-programeve shkollore të Serbisë. Kështu, derisa nxënësit shqiptarë në librat e historisë të botuar në Prishtinë lexojnë se Adem Jashari është hero legjendar i Kosovës, nxënësit serbë të Kosovës në librat e historisë të botuar në Beograd lexojnë se Adem Jashari ka qenë terrorist.

**6.** Dokumenti i Ahtisarit e ka bërë Kosovën shtet *sui generis*, edhe duke e detyruar Kosovën që ajo të themelojë **“Asociacionin Komunave me Shumicë Serbe”** në Kosovë. Por ky asociacion edhe nëse nuk do të kishte kompetenca ekzekutive, ai për vetë faktin se duhet të jetë asociacion monoetnik, do të mund të keqpërdorej si nga pakica serbe në Kosovë, ashtu dhe nga Serbia, në të dy rastet për ta destabilizuar Kosovën nga brenda.

● Këto janë gjashtë diskriminimet kryesore pozitive që Plani/Dokumenti i Ahtisarit i ka bërë pakicës serbe, duke bërë kështu Kosovën një shtet *sui generis*. Bërja e Kosovës shtet *sui generis* nëpërmjet këtyre diskriminimeve pozitive bërë ndaj pakicës serbe, në fakt e lëndon funksionalitetin e shtetit të Kosovës deri në invaliditet. Nëse Kosova do të mund të mbijetojë si shtet i tillë *sui generis*, këtë nuk mund ta parashikoj.

### **Nuk ka e nuk mund të ketë “komb kosovar” vetëm për shqiptarët**

● Nëse në Kosovë do të krijohet “kombi kosovar” logjika thotë se ai komb do të duhej të ishte një komb i përbashkët për të gjitha etnitë/kombet e Kosovës: si për shumicën kombëtare shqiptare, ashtu edhe për komunitetet pakicë, përfshi këtu edhe pakicën serbe. Por nëse pakica serbe, për shkak të rrethanave favorizuese në formën e diskriminimit pozitiv, nuk do të integrohej brenda “kombit kosovar”, atëherë shtrohet pyetja: Pse u dashka që vetëm për shqiptarët të krijohet “komb kosovar”?!

● Në Kosovë asnjë komunitet nuk ka nevojë të tjetërsohet në “komb kosovar”: as shqiptarët, as serbët dhe as të tjerët. Kjo edhe për vetë faktin, se Bashkësia Ndërkombëtare e ka njohur shtetin e Kosovës, ashtu siç ka qenë e siç është: me shumicën kombëtare shqiptare dhe me komunitetet pakicë. Bashkësia ndërkombëtare

nuk e do krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, sepse ai komb politik dhe artificial nëpër-mjet të integritimit (asimilimit) brenda vetes të komuniteteve pakicë, do të ishte varri i komuniteteve pakicë që kanë jetuar dhe jetojnë në Kosovë.

### **Vetë përbërja etnike e Kosovës nuk e lejon krijimin e “kombit kosovar”**

- Në të vërtetë është vetë përbërja etnike e Kosovës, ajo që e pamundëson krijimin e “kombit kosovar” në Kosovë. Duke qenë se përqindja e popullatës shumicë shqiptare në Kosovë është shumë e madhe (rreth 94% e popullatës së gjithmbarshme të Kosovës), kurse përqindja e pakicave kombëtare shumë e vogël (rreth 6% e popullatës së gjithmbarshme të Kosovës), kjo tregon se edhe integrimi i të gjitha pakicave kombëtare brenda kombit shumicë shqiptar, këtë të fundit nuk do ta ndryshonte në atë shkallë, sa për t’u konsideruar ai një komb tjetër multi-etnik “kosovar”.
- Mendoj se Ahtisari pikërisht duke pasur parasysh një përbërje të tillë etnike të komuniteteve që jetojnë në Kosovë, nuk e ka synuar krijimin e kombit multi-etnik “kosovar”, sepse e ka ditur që edhe integrimi tërësor i komuniteteve pakicë brenda popullatës shumicë shqiptare, nuk do të rezultonte me krijimin e një kombi multi-etnik “kosovar”.

### **Për t’u bërë Kosova shtet, shqiptarët kanë bërë tri kompromise të mëdha**

- Për t’u bërë Kosova shtet, shqiptarët e Kosovës kanë pranuar Planin/Dokumentin e Ahtisarit, duke bërë tri kompromise të mëdha: **1)** Ndalimin e së drejtës që Kosova t’i bashkohet një shteti tjetër, gjë që ka pasur të bëjë me ndalimin e së drejtës që Kosova t’i bashkohet Shqipërisë; **2)** Kompromisin e diskriminimit pozitiv të komunitetit pakicë serb dhe **3)** Kompromisin e themelimit të Asociacionit të Komunave të Banuara me Shumicë Serbe në Kosovë, krijimi i të cilit, sipas të gjitha gjasave, do të keqpërdorej nga serbët e Kosovës dhe nga regjimet e Beogradit për destabilizimin e shtetit të Kosovës.
- Të tri këto kompromise, sado që ia ka vlejtur të bëhen për t’u bërë Kosova shtet, megjithatë janë kompromise sa të mëdha, aq

edhe të dhimbshme jo vetëm për shqiptarët e Kosovës, por edhe për të gjithë kombin shqiptar në viset e tij në Ballkan. Por Spahiu duke mos u ngopur me tri kompromiset e mëdha të përmendura më lart, shqiptarëve të Kosovës u kërkon edhe kompromisin katërt të madh, i cili atyre nuk u është kërkuar as nga Dokumenti i Ahtisarit e as nga Bashkësia Ndërkombëtare. Ky kompromis i katërt me radhë ka të bëjë me kërkesën e Spahiut, që shqiptarët e Kosovës identitetin të tyre kombëtar shqiptar ta zëvendësojnë me një identitet tjetër kombëtar “kosovar”, realisht joekzistues.

● Për t’i bindur shqiptarët e Kosovës që ata të tjetërsohen nga komb shqiptar në “komb kosovar”, Spahiu edhe pse nuk e thotë drejtpërdrejt, megjithatë aludon se këtë tjetërsim kombëtar shqiptarëve ua ka kërkuar dhe po ua kërkon Bashkësia Ndërkombëtare. Por kjo nuk qëndron aspak, sepse Bashkësia Ndërkombëtare nuk ua ka kërkuar shqiptarëve të Kosovës asnjëherë tjetërsimin e tyre nga komb shqiptar në “komb kosovar”.

● Besoj shumë se shqiptarët e Kosovës një kërkesë të tillë të Spahiut, për tjetërsimin e tyre nga komb shqiptar në “komb kosovar” jo vetëm që do ta refuzojnë, por edhe do ta groposin njëherë e përgjithmonë.

# 6

---

## KEQINTERPRETIMI I KUSHTETUTËS SË KOSOVËS NË FUNKSION TË PROPAGANDIMIT TË GJOJA KRIJIM-EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se Nexhmedin Spahiu për t'i bindur (sipas meje për t'i mashtruar) shqiptarët, se ata pas çlirimit dhe pavarësimit të Kosovës janë tjetërsuar ose duhet të tjetërsohen nga komb shqiptar në “komb kosovar”, nuk ka keqinterpretuar vetëm Dokumentin e Ahtisarit, por ka keqinterpretuar edhe Kushtetutën e Kosovës, duke thënë pa asnjë fakt, se ajo (Kushtetuta) e njih “kombin kosovar”. Por, siç do të shohim më poshtë, Kushtetuta e Kosovës, si dhe Dokumenti i Ahtisarit e njih kombin shumicë shqiptar dhe pakicat kombëtare që jetojnë në Kosovë, por nuk e njih ekzistimin e “kombit kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues.

### **FSK-ja është forcë kombëtare e shtetit të Kosovës dhe jo forcë kombëtare e “kombit kosovar”**

Spahiu për të na bindur se në Kosovë ekziston “kombi kosovar”, përmend **nenin 126, pika 1** të Kushtetutës së Kosovës, në të cilin thuhet:

■ **Forca e Sigurisë e Kosovës është forcë kombëtare e sigurisë për Republikën e Kosovës, dhe mund të dërgojë pjesëtarët e saj jashtë vendit në përputhje të plotë me përgjegjësitë e**

### saj ndërkombëtare<sup>30</sup>.

Duke komentuar këtë nen të Kushtetutës së Kosovës, Spahiu ka shkruar edhe si më poshtë:

■ **“Në Kushtetutën e Kosovës kur flitet për Forcën e Sigurisë së Kosovës përmendet termi “forcë kombëtare e sigurisë”. Kjo nënkupton që edhe Kushtetuta e Kosovës e definon kombin kosovar definitivisht<sup>31</sup>.**

● Me pohimin e mësipërm të Spahiut, sipas të cilit Kushtetuta e Kosovës e njeh “kombin kosovar”, nuk pajtohem aspak. Kjo, sepse Kushtetuta e Kosovës në nenin 126, pika 1, Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK-në) e definon si “forcë kombëtare e sigurisë së Republikës së Kosovës” e kjo flet qartë, se kushtetuta FSK-në e ka definuar si forcë kombëtare të shtetit-republikës së Kosovës, dhe nuk e ka definuar si forcë kombëtare të sigurisë së “kombit kosovar”. Kjo tregon qartë, se Kushtetuta e njeh shtetin e Kosovës, por nuk e njeh “kombin kosovar”, realisht joekzistues.

● Meqë Kushtetuta e Kosovës është shkruar në frymën e gjuhës angleze, në të cilën fjala *komb* (anglisht “nation”), siç kemi sqaruar edhe më lart, ka edhe kuptimin e *kombit* dhe kuptimin e *shtetit*, shtrohet pyetja: në cilin kuptim është thënë në **nenin 126, pika 1** të Kushtetutës së Kosovës se: **“Forca e Sigurisë e Kosovës është forcë kombëtare e sigurisë për Republikën e Kosovës...”?**

● Duke pasur parasysh se në Kosovë në vitin 2008 ka ndodhur shtetbërja e Kosovës, por nuk ka ndodhur krijimi i “kombit kosovar”, kjo tregon qartë se në nenin 126, pika 1, të Kushtetutës së Kosovës, shprehja se **“Forca e Sigurisë e Kosovës është forcë kombëtare e sigurisë për Republikën e Kosovës...”**, nuk ka të bëjë me “kombin kosovar” joekzistues, por ka të bëjë me shtetin e Kosovës, realisht ekzistues.

● Vet fakti se Forcat e Sigurisë (ushtria dhe policia) në gjithë botën konsiderohen attribute të shteteve dhe jo të kombeve në kuptimin e ngushtë të fjalës komb, po ashtu flet se edhe Forca

<sup>30</sup> Kushtetuta e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

<sup>31</sup> Nexhmedin Spahiu: Kushtetuta e definon kombin kosovar - të tillë e njohu Kosovën edhe SHBA-ja; *Balkan. Info*, 20 nëntor 2019, ora 22:35: <https://klankosova.tv/nexhmedin-spahiu-kushtetuta-e-definon-kombin-kosovar-te-tille-e-njohu-kosoven-edhe-shba/>

e Sigurisë së Kosovë (FSK-ja), është po ashtu atribut i shtetit të Kosovës dhe jo atribut i “kombit kosovar”, kuptimin e ngushtë të fjalës komb.

### **Kushtetuta e Kosovës e nuk e njeh “kombin kosovar”**

Se Kushtetuta e Kosovës nuk e njeh “kombin kosovar”, për këtë tregon qartë edhe **neni 3, pika 1** (Barazia para ligjit) e Kushtetutës së Kosovës ku thuhet:

■ **Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore<sup>32</sup>.**

● Togfjalëshi sipas të cilit “Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera”, flet qartë se Kushtetuta e Kosovës e njeh ekzistimin e kombit shumicë shqiptar, si dhe njeh edhe ekzistimin e komuniteteve të tjera pakicë, por nuk e njeh “kombin kosovar”, të cilin e kanë shpikur N. Spahiu, H. Matoshi e ndonjë tjetër si këta.

● Fakti se Kushtetuta e Kosovës në nenin 3, pika 1, e njeh kombin shqiptar, por nuk e njeh “kombin kosovar”, tregon qartë se Kushtetuta e Kosovës edhe në nenin 126, pika 1 të saj, nuk e ka definuar FSK-në si forcë kombëtare të sigurisë së “kombit kosovar”, siç do të donte Spahiu, por e ka definuar FSK-në si forcë kombëtare të sigurisë të Republikës së Kosovës, përkatësisht e ka definuar FSK-në forcë të shtetit të Kosovës.

### **Spahiu i ofendon dhe diskriminon shqiptarët e Kosovës në bazën kombëtare shqiptare**

Se Kushtetuta e Kosovës me nene të caktuara e ndalon dhe e ndëshkon diskriminimin etnik dhe kombëtar, për këtë flet edhe **neni 40, pika 2** (Liria e shprehjes) e tij, në të cilin thuhet:

■ **Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes**

<sup>32</sup> Kushtetuta e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

## **dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare<sup>33</sup>.**

● Shtrohet pyetja: propagandimi i “kombit joekzistues kosovar” nga ana e Spahiut, çon apo nuk çon në nxitjen dhe provokimin e dhunës dhe të armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare?

● Për vetë faktin se, sa herë që Spahiu thotë se në Kosovë ka “komb kosovar”, gjë që nënkupton tjetërsimin e pjesëtarëve të kombit shqiptar në “komb kosovar”, kjo tregon qartë se Spahiu duke u shprehur kësisoj nuk bën tjetër, përveçse i ofendon dhe i diskriminon shqiptarët e Kosovës mbi bazën etnike dhe kombëtare shqiptare të tyre.

● Ushtrimi i këtij ofendimi dhe diskriminimi i Spahiut në emër të shprehjes së lirë, ndaj rreth 1,5 milionë shqiptarëve që jetojnë në Kosovë dhe ndaj rreth 1,5 milionë shqiptarëve të Kosovës që jetojnë në diasporë, sipas nenit 40, pika 2 të Kushtetutës së Kosovës duhej të ndalohej.

### **Spahiu shqiptarëve të Kosovës ua shkel të drejtat njerëzore më elementare**

Duke pasur parasysh se pohimi i Spahiut për ekzistimin e “kombit kosovar”, shqiptarëve të Kosovës tërthorazi ua mohon përkatësinë kombëtare shqiptare, kësisoj ai u shkel atyre (shqiptarëve të Kosovës) të drejtat njerëzore më elementare, të garantuara në Kushtetutën e Kosovës, nëpërmjet **nenit 21, pika 1, 2 dhe 3** (Parimet e përgjithshme) të Kushtetutës, në të cilin thuhet:

■ **Neni 21, pika 1: Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës<sup>34</sup>.**

■ **Neni 21, pika 2: Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë<sup>35</sup>.**

<sup>33</sup> Kushtetuta e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

<sup>34</sup> Kushtetuta e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

<sup>35</sup> Kushtetuta e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

■ **Neni 21, pika 3: Çdokush ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve**<sup>36</sup>.

● Spahiu duke ua mohuar shqiptareve të Kosovës përkatësin kombëtare shqiptare, ai ishte dashur të përgjigjej për shkeljen e të drejtave të tyre elementare, të përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 dhe 3 të Kushtetutës së Kosovës të cituar më lart.

### **Kushtetuta e Kosovës e ka ndaluar dhe penalizuar diskriminimin etnik, kombëtar, racor etj.**

Kushtetuta e Kosovës nëpërmjet **nenit** të saj **24, pika 2**, e ka ndaluar dhe penalizuar diskriminimin etnik, kombëtar, racor dhe të gjitha diskriminimet e tjera, që mund t'i bëhen njeriut. **Në nenin 24, pika 2**, të cituar edhe në një kapitull tjetër më lart thuhet:

■ **Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal**<sup>37</sup>.

● Bazuar në nenin 24, pika 2 të Kushtetutës së Kosovës, të cituar më lart, Spahiu duke propaganduar ekzistimin e “kombit kosovar”, gjë që nënkupton mohimin e përkatësisë etnike dhe kombëtare të shqiptarëve, kësajsoj ka diskriminuar shqiptarët e Kosovës në bazën etnike dhe kombëtare, gjë që Kushtetuta e Kosovës e ka ndaluar.

● Por Spahiu në vend që të ketë frikë se mund të akuzohet dhe të dënohet për diskriminim etnik dhe kombëtar të ushtruar ndaj rreth 3 milionë shqiptarëve brenda e jashtë Kosovës, duke e paraqitur krijim-ekzistimin e “kombit kosovar” si një fakt të kryer, gjë që nuk qëndron aspak, kërkon që të dënohen ato media të Kosovës, të cilat, sipas tij, e vënë në pikëpyetje ekzistimin e “kombit kosovar”, realisht joekzistues. Kësaj i thonë ironi përtej ironisë!

<sup>36</sup> Kushtetuta e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

<sup>37</sup> Kushtetuta e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

## **Spahiu kërkon dënimin e atyre medieve, që e vënë në pikëpyetje ekzistimin e “kombit kosovar”**

Spahiu duke kërcënuar me dënime mediet që vënë në pikëpyetje ekzistimin e “kombit kosovar”, ka shkruar si më poshtë:

■ **Ish dashur të dënohej një media, e cila e vë në pikëpyetje ekzistencën e kombit<sup>38</sup> .....**

● Nga thënia e Spahiut e cituar më lart, del se ai kërkon të dënohen ato medie që e kontestojnë ekzistencën e “kombit kosovar”. Por për t’u dënuar një medie që vë në pikëpyetje ekzistimin e “kombit kosovar”, kusht i domosdoshëm është që “kombi kosovar” realisht dhe objektivisht të ekzistojë. Por, meqë “kombi kosovar” realisht e objektivisht nuk ekziston, kërkesa e Spahiu për dënimin e atyre medieve që e vënë në pikëpyetje ekzistencën e “kombit kosovar”, aq sa është e pakuptimtë, po aq është edhe e kotë.

---

<sup>38</sup> Nexhmedin Spahiu: Kushtetuta e definon kombin kosovar - të tillë e njohu Kosovën edhe SHBA-ja, Balkan. Info, 20 nëntor 2019. <https://klankosova.tv/nexhmedin-spahiu-kushtetuta-e-definon-kombin-kosovar-te-tille-e-njohu-kosoven-edhe-shba/>

---

## KEQINTERPRETIMI I ANËTARËSIMIT TË SHTETEVE NË OKB, NË FUNKSION TË PROPAGANDIMIT TË GJOJA KRIJIM-EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se si Nexhmedin Spahiu, për t'i bindur (sipas meje për t'i mashtruar) shqiptarët e Kosovës, që ata nga vetja e tyre të krijojnë “kombin kosovar”, nëpër debate televizive dhe në shkrimet e tij të publikuara në mediet elektronike, nuk ka keqinterpretuar vetëm Dokumentin e Ahtisarit dhe Kushtetutën e Kosovës, por ka keqinterpretuar edhe kriteret e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB-së), për anëtarësimin e shteteve në këtë organizatë.

**OKB-ja bën anëtarësimin e shteteve dhe jo të kombeve**  
Spahiu lidhur me Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB-në), në një intervistë të tij në një televizion është shprehur si më poshtë:  
■ **Ajo osht Organizata e Kombeve të Bashkuara, osht Organizatë e Kombeve të Bashkuara dhe jo Organizatë e Shteteve të Bashkuara**<sup>39</sup>. (min. 8:00-8:06)  
● Është vërtet se Organizata e Kombeve të Bashkuara quhet organizatë e kombeve dhe jo e shteteve, por po ashtu është e vërtetë

---

<sup>39</sup> Nexhmedin Spahiu: “Oksigjen”, pjesa e tretë, 23.09.2011: <https://www.youtube.com/watch?v=D673tLZUdIE>

se ajo, edhe pse quhet Organizatë e Kombeve, megjithatë nuk bën anëtarësimin kombeve, por bën anëtarësimin e shteteve, dhe këtë me ato përbërje etnike dhe kombëtare që ato kanë.

● OKB-ja edhe pse nuk bën anëtarësimin e kombeve por të shteteve, megjithatë quhet Organizatë e Kombeve për dy arsye: ***e para***, për hir të traditës emërore të **“Lidhjes së Kombeve”**, të themeluar në Gjenevë në vitin 1920, e cila i ka paraprirë themelimit të “Organizatës së Kombeve të Bashkuara” në vitin 1945, dhe ***e dyta***, për të mos u përplasur emërtimi i saj si “Organizatë e Shteteve të Bashkuara” me emërtimin **“Shtete të Bashkuara të Amerikës (SHBA)”**.

### **Rreth 108 shtete dhe jo kombe e kanë njohur shtetin e Kosovës dhe jo “kombin kosovar”**

Spahiu në vazhden e propagandimit të “kombit kosovar” ka shkruar edhe më tej si në vijim:

■ **... Kombi kosovar nuk ekziston edhe për liderët politikë të 84 shteteve të tjera, por ky komb tashmë ekziston për 108 kombe anëtare të OKB-së<sup>40</sup>.**

● Spahiu brenda thënies së tij të cituar më lart na thotë se “kombi kosovar” ekziston, sepse atë e kanë njohur 108 kombe anëtare të OKB-së, por, duke pasuar parasysh se OKB-ja anëtarëson shtetet dhe jo kombet, kjo tregon qartë se 108 shtete të botës e kanë njohur shtetin e Kosovës dhe jo “kombin e kosovar”, i cili nuk ekziston.

### **Një vend për të qenë subjekt ndërkombëtar, ai vend duhet të jetë shtet**

Spahiu për ta ma bindur se në radhet e OKB-së anëtarësohen kombet (duke e nënkuptuar “kombin kosovar”), ai lidhur me anëtarësimin e shteteve në OKB është shprehur si në vijim:

■ **Për t’u anëtarësuar në Kombet e Bashkuara duhet të jesh komb. Prandaj George W. Bush kur e ka njohur Kosovën e ka njohur si komb... e jo vetëm si një shtet, si Colorado apo shtetet e tjera që kanë simbolet, por s’është komb<sup>41</sup>.**

<sup>40</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit*: <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

<sup>41</sup> Nexhmedin Spahiu: Kushtetuta e definon kombin kosovar - të tillë e njohu Kosovën edhe SHBA-ja, *Balkan. Info*, 20 nëntor 2019: <https://klankosova.tv/nexhmedin-spahiu->

\* Por Spahiu lidhur me anëtarësimin e shteteve në OKB është shprehur si më poshtë:

■ **...vetë fakti se kur ti bohesh anëtar i Kombeve t'Bashkuara duhet me qenë komb, ...për me qenë anëtar i shoqatës së peshkatarëve duhesh me qenë peshkatar<sup>42</sup>. (min. 9:15 - 9:24)**

● Spahiu brenda dy thënieve të tij të cituara më lart, shprehet se për t'u anëtarësuar në Kombet e Bashkuara duhet të jesh komb, por duke pasur parasysh se në OKB anëtarësohen shtetet dhe jo kombet, kjo tregon se për t'u anëtarësuar në OKB duhet të jesh një shtet i njohur nga 2/3 e shteteve anëtare të OKB-së, sepse duke qenë shtet i njohur nga 2/3 e shteteve anëtare të OKB-së, kombi është aty brenda shtetit.

● Spahiu duke thënë se se për t'u anëtarësuar në OKB duhet të jesh komb, ai dëshiron të thotë se edhe Kosova për t'u anëtarësuar në OKB, do të duhej të ketë patjetër komb, por sipas tij duhet të ketë "komb kosovar" e jo komb shqiptar. Por, anëtarësimi i Kosovës në OKB nuk kushtëzohet me ekzistimin e "kombit kosovar", edhe për vetë faktin se OKB-ja nuk i anëtarëson kombet por i anëtarëson shtetet dhe atë me atë përbërje etnike dhe kombëtare që ato kanë.

● Kështu, edhe Kosova do të anëtarësohet në OKB me atë përbërje etnike dhe kombëtare që ka: me kombin shumicë shqiptar dhe me komunitetet pakicë që jetojnë brenda saj. Dhe kjo tregon se OKB-ja anëtarësimin e Kosovës në radhët e saj nuk e lidh aspak me krijim-ekzistimin e "kombit kosovar", siç thotë Spahiu, për t'i bindur (alias për t'i mashtruar) shqiptarët e Kosovës, që ata, pa pasur as nevojën më të vogël, të konvertohen në "komb kosovar".

### **Subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës nuk varet nga kombi joekzistues "kosovar"**

Spahiu duke teorizuar lidhur me anëtarësimin e Kosovës në OKB, është shprehur si më poshtë:

■ **Na po thojmë çdo ditë dojmë me forcue subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës. Por çka domethonë subjekt ndërkombëtar? Subjektivitet ndërkombëtar domethonë**

---

kushtetuta-e-definon-kombin-kosovar-te-tille-e-njohu-kosoven-edhe-shba/

<sup>42</sup> Debat i nxehtë "Kombi kosovar" me Nexhmedin Spahiun "Valamala Show", më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

**s'mundesh me kon subjekt ndërkombëtar pa kenë komb, subjekt ndërmmjet kombeve, në mesin e kombeve. Domethonë po thu due me konë subjet në mesin e kombeve, a po thue nuk jem komb...<sup>43</sup>. (min. 28:49 - 29:14)**

**■ Jo ekziston. Në qoftë se ekziston shteti i Kosovës ekziston kombi kosovar<sup>44</sup>. (min. 7:32 -7:34)**

● Spahiu brenda thënies së tij të parë të cituar më lart, thotë se shqiptarët e Kosovës e duan forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës (anëtarësimin e Kosovës në OKB), por po thonë se nuk janë komb kurse pa qenë komb në mesin e kombeve, nuk ka subjektivitet ndërkombëtar të Kosovës. Me këtë thënie të Spahiu nuk pajtohem aspak, sepse shqiptarët e Kosovës nuk kanë thënë e nuk e thonë se nuk janë komb, por kanë thënë e thonë se janë komb shqiptar.

● Për më tepër shqiptarët e Kosovës që nga viti 1878 i Kongresit të Berlinit e deri në vitet 1998-1999 të Luftës Çlirimtare të Kosovës, kanë bërë shumë luftëra të përgjakshme me armiq të shumtë, për ta çliruar veten prej tyre si komb shqiptar dhe jo për ta çliruar veten prej tyre si “komb kosovar”.

● Kështu, duke pasur parasysh se shqiptarët thonë/pohojnë, deri edhe nëpërmjet këngëve të tyre popullore, se janë komb shqiptar, shtrohet pyetja: ku e ka hallin Spahiu, kur thotë se shqiptarët e duan forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, por thonë se nuk janë komb, kurse pa komb nuk ka subjektivitet ndërkombëtar të Kosovës?

● Unë e di mirë se ku e ka hallin Spahiu! Ai hallin e ka tek ai kombi i tij “kosovar”, sepse sipas tij, OKB-ja do ta anëtarësonte Kosovën brenda radhëve të veta vetëm nëse shqiptarët e Kosovës do të tjetërsohen nga komb shqiptar në “komb kosovar”. Kjo tregon se Spahiu e do Kosovën shtet anëtar të OKB-së me “komb kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues, dhe nuk e do Kosovën shtet anëtar të OKB-së me komb shqiptar, realisht dhe objektivisht ekzistues.

---

<sup>43</sup> Nexhmedin Spahiu; *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri” (Aktualitete - 30.03.2021) <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>.

<sup>44</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiu në “Valamala Show”, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

● Spahiu brenda thënies së tij të dytë të cituar më lart thotë se:  
- **Në qoftë se ekziston shteti i Kosovës, ekziston kombi kosovar.**  
Por kjo thënie e tij nuk qëndron aspak, sepse duke mos pasur në Kosovë “komb kosovar”, edhe ekzistenca e shtetit të Kosovës nuk ka si të varet nga një “komb kosovar”, që realisht nuk ekziston. Ekzistenca e shtetit të Kosovës varet nga ekzistenca e kombit shqiptar, realisht dhe objektivisht ekzistues.

### **Shqipëria dhe Kosova do të jenë anëtare të OKB-së si dy shtete të të njëjtit komb shqiptar**

Duke u marrë me anëtarësimin e Kosovës në OKB, Spahiu është shprehur edhe si në vijim:

■ **Kombi shqiptar osht anëtar i Kombeve t’ Bashkume, flamuri kombëtar oshtë në Kombet e Bashkume** <sup>45</sup>. (min. 29:18 - 29:25)

● Spahiu duke thënë brenda pohimit të tij të cituar më lart, se Shqipëria duke qenë vend anëtar i OKB-së, kombi shqiptar dhe flamuri kombëtar shqiptar veç është në Kombet Bashkuara, dëshiron të thotë se Shqipëria dhe Kosova nuk mund të jenë anëtare të OKB-së si dy shtete të të njëjtit komb shqiptar. Prandaj, sipas tij, për t’u bërë Kosova vend anëtar i OKB-së, shqiptarët e Kosovës duhet të tjetërsohen nga komb shqiptar në “komb kosovar”, realisht joekzistues.

● Por ky përkufizim i Spahiut nuk qëndron aspak, sepse OKB-ja nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore, që të mos e bëjë anëtarësimin e dy a më shumë shteteve të ndryshme të të njëjtit komb. Kështu, OKB-ja në të kaluarën ka anëtarësuar brenda saj dy shtetet gjermane të të njëjtit komb gjerman, dy shtetet vietnameze të të njëjtit komb vietnamez, si dhe ka anëtarësuar më shumë se dhjetë shtete të ndryshme të Ligës Arabe të të njëjtit komb arab.

● Shembujt e mësipërm flasin se OKB-ja nuk ka asnjë problem, që brenda gjirit të saj të ketë edhe dy shtete shqiptare (Shqipërinë dhe Kosovën) të të njëjtit komb shqiptar. OKB-ja nuk ka asnjë ligj në

---

<sup>45</sup> Nexhmedin Spahiu: *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri” (Aktualitete - 30.03.2021): <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd70Q>

fuqi, i cili ia ndalon anëtarësimin e dy ose të më shumë shteteve të të njëjtit komb.

● Duke pasur parasysh se në OKB anëtarësohen shtetet dhe jo kombet, Kosova në OKB do të përfaqësohet me flamurin e shtetit të Kosovës, dhe jo me flamurin kombëtar shqiptar. Shqipëria në OKB përfaqësohet me flamurin kombëtar shqiptar, sepse në Shqipëri flamuri kombëtar shqiptar paraqet edhe flamurin shtetëror të Shqipërisë.

● Por përfaqësimi i Kosovës në OKB me flamurin e shtetit të Kosovës nuk do të thotë aspak se shqiptarët e Kosovës, nga komb shqiptar janë kthyer në “komb kosovar”, siç mund t’i duket Spahiut apo ndonjë tjetri. T’u thuash shqiptarëve të Kosovës se OKB-ja nuk i anëtarëson brenda radhëve të saj dy shtete të të njëjtit komb shqiptar (Shqipërinë dhe Kosovën), kjo nuk është vetëm dezinformim, por është edhe një shpifje e kulluar në adresë të OKB-së.

● S’ka dyshim se Spahiut këtë dezinformim të shqiptarëve të Kosovës dhe këtë shpifje në adresë të OKB-së e bën për t’i bindur (mashtruar) shqiptarët e Kosovës se, nëse ata duan që Kosova të jetë shtet anëtar i OKB-së, duhet patjetër të tjetërsohen në “komb kosovar”.

**Dy radio nuk mund të regjistrohen me të njëjtin emër, por dy shtete të të njëjtit komb mund të anëtarësohen në OKB**  
Spahiut një intervistë të tij të dhënë në radion “Sharri” në komunën e Dragashit, ndër të tjera ka thënë edhe si në vijim:

**■ Kombi kosovar përbohet prej shqiptarëve t’Kosovës, por nuk quhet sot komb shqiptar, sepse komb shqiptar janë shqiptarët e Shqipërisë, tani ata e kanë zonën e emenit, nuk mundish m’i regjistruar dy radio me emrin radio “Sharri”<sup>46</sup>. (min. 24:29 - 24:46)**

● Lidhur thënien e Spahiut cituar më lart, dua t’i sqaroj lexuesit si në vijim: thënia e kujtdo qoftë, se “kombi kosovar” përbëhet prej shqiptarëve të Kosovës, por shqiptarët e Kosovës nuk mund

---

<sup>46</sup> Nexhmedin Spahiut: *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri” (Aktualitete - 30.03.2021); <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

të quhen komb shqiptar, sepse emërtimin “komb shqiptar” e kanë zënë shqiptarët e Shqipërisë, jo vetëm që nuk qëndron aspak, por edhe paraqet një absurd të llojit të vet. Kjo, sepse vetë nocioni “komb shqiptar” nuk është një nocion i rezervuar vetëm për pjesën e kombit shqiptar që jeton në Shqipëri, por është një nocion kombëtar që u përket të gjithë shqiptarëve: edhe atyre të Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi, të Luginës së Preshevës dhe të Çamërisë.

● Me fjalë të tjera, ashtu siç nocioni “komb gjerman”, që ka paraqitur identitetin kombëtar gjerman edhe për gjermanët e Gjermanisë Perëndimore, edhe për gjermanët e Gjermanisë Lindore, ashtu siç edhe nocioni “komb vietnamez”, që ka paraqitur identitetin kombëtar vietnamez si të vietnamezëve të Vietnamit Verior, ashtu edhe të vietnamezëve të Vietnamit Jugor, edhe nocioni “komb shqiptar” paraqet identitetin kombëtar shqiptar edhe të shqiptarëve të Shqipërisë dhe të shqiptarëve të Kosovës.

● Spahiu duke thënë se dy radio nuk mund të regjistrohen me të njëjtin emër, si radio “Sharri”, dëshiron të na thotë se edhe dy shtete shqiptare (Shqipëria dhe Kosova) nuk mund të anëtarësohen (regjistrohen) në OKB si dy shtete të të njëjtit komb shqiptar, prandaj sipas tij, për t’u bërë Kosova vend anëtar i OKB-së, në Kosovë nga shqiptarët duhet të krijohet “kombi kosovar”.

● Por kjo mendësi e Spahiut, që krahason dy shtete të të njëjtit komb me dy radio me të njëjtin emër nuk qëndron. Kjo, sepse ndërsa dy radio nuk mund të regjistrohen me të njëjtin emër si radio “Sharri”, dy shtete të të njëjtit komb mund të anëtarësohen në OKB. Kështu, Shqipëria dhe Kosova do të jenë anëtare të OKB-së si dy shtete të të njëjtit komb shqiptar.

● Duke pasur parasysh sa u tha më lart, del e qartë se Spahiu, duke pohuar pa asnjë argument se në OKB nuk mund të anëtarësohen dy shtete të të njëjtit komb, ai nuk bën gjë tjetër, veçse dezinformon në adresë të kriteve të OKB-së lidhur me anëtarësimin e shteteve brenda saj.

● Kam menduar se mjerimi është vetëm zhele dhe kafshatë që s’kapërdihet, siç ka shkruar Migjeni, por jo, mjerimi qenka edhe manipulim, spekulim dhe gënjeshtëri!

● Mendësi të tilla keqpërdoruese, keqinterpretuese dhe dezinformuese të Spahiut më bëjnë që, edhe një herë, t'u drejtohem shqiptarëve të Kosovës dhe t'u them: Kosova mund të bëhet subjekt ndërkombëtar (vend anëtar i OKB-së) pa pasur nevojë që shqiptarët e Kosovës të kthehen në "komb kosovar". Kjo, sepse OKB-ja nuk ka asnjë kompetencë, që popujve të shteteve që anëtarëson, t'u ndryshojë përkatësitë kombëtare.

● Shqiptarët e Kosovës duan që Kosova të bëhet shtet anëtar i OKB-së, duke qenë me përkatësi kombëtare shqiptare, siç kanë qenë shekuj me radhë, dhe jo duke u tjetërsuar në një "komb fiktiv kosovar", thjesht sepse krijimi i "kombit kosovar" iu dashka Spahiut, Matoshit, Kelmendit, Metës dhe disa shokëve të tyre të verbër.

# 8

---

## **ÇFARË THOTË KARTA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ANËTARËSIMIN E SHTETEVE NË OKB? CILAT JANË KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR ANËTARËSIMIN E SHTETEVE NË OKB**

Në këtë kapitull dua t'i informoj lexuesit lidhur me përcaktimet e artikullit 4, të kapitullit të II, të Kartës së Kombeve të Bashkuara<sup>47</sup>, lidhur me anëtarësimin e shteteve brenda radhëve të OKB-së.

### **OKB-ja bën anëtarësimin e shteteve dhe jo të kombeve**

Në artikullin 4, kapitulli II, të Kartës së Kombeve të Bashkuara, për anëtarësimin e shteteve në OKB thuhet:

**1. Anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të jenë të gjitha shtetet paqedashëse, që i pranojnë detyrimet e përfshira në këtë Kartë dhe të cilat, sipas gjykimit të Organizatës, janë të afta dhe të gatshme t'i përmbushin këto detyrime<sup>48</sup>**

---

<sup>47</sup> Karta e Kombeve të Bashkuara paraqet traktatin themelues të OKB-së dhe përbën bazën ligjore për punën e saj. Ajo u nënshkrua në San Francisko më 26 qershor 1945 dhe hyri në fuqi më 24 tetor 1945. Karta përcakton qëllimet, parimet, organet dhe procedurat e organizatës.

<sup>48</sup> United Nations Charter, Chapter II: Membership <https://www.un.org/en/about-us/un-charter/chapter-2>

## **2. Pranimi i çdo shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara bëhet me rekomandim të Këshillit të Sigurimit bërë Asamblesë së Përgjithshme<sup>49</sup>**

● Ajo që në pikën 1 dhe 2 të artikullit 4, të kapitullit II, të Kartës së OKB-së, të bie menjëherë në sy, është se OKB-ja e bënë anëtarësimin në radhet e saj të shteteve dhe jo kombeve, gjë që e demanton keqas pohimin e pavërtetë të Spahiut, sipas të cilit në OKB-ja e bënë anëtarësimin e kombeve dhe jo të shteteve, sepse sipas tij OKB-ja është organizatë e kombeve dhe jo e shteteve.

● Nga ana tjetër, sipas pikës 1 dhe 2 të artikullit 4, të kapitullit të II, të Kartës së OKB-së, del se shtetet që anëtarësohen në OKB duhet të jenë paqësore dhe të afta për të realizuar detyrimet që dalin nga Karta e OKB-së, dhe se është Këshilli i Sigurimit, ai që ia rekomandon Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së procedurën e pranimit të një shteti në OKB.

### **Karakteristikat e shtetit sipas Konventës së Monetevideos**

● Konventa e Montevideos ka dalur nga Konferencën e Shtatë Internacionale e Shteteve të Amerikës, e mbajtur 26 mars të vitit 1933 në qytetin Montevideo. Kjo konventë i ka përcaktuar katër karakteristikat themelore të kombit, polotësimi i të cilave është kusht për anëtarësimin e kombeve në OKB<sup>50</sup>

● Karakteristikat e kombit sipas Konventës së Monetevideos janë: **“Shteti si subjekt i së drejtës ndërkombëtare duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme: (a) një popullsi të përhershme; (b) një territor të përcaktuar; (c) një qeveri dhe (d) aftësinë për të hyrë në marrëdhënie me shtete të tjera.”**<sup>51</sup>

**Kriteret dhe procedurat e anëtarësimit të shteteve në OKB**  
Shtetet për anëtarësimin e tyre në radhet e OKB-së përveç kriterëve

<sup>49</sup> United Nations Charter, Chapter II: Membership <https://www.un.org/en/about-us/un-charter/chapter-2>

<sup>50</sup> [https://www.google.com/search?q=konvention+von+montevideo&sca\\_esv=65b8675cb353c26d&source=hp&ei=mzG0aI\\_5Aseui-gP57Oz-](https://www.google.com/search?q=konvention+von+montevideo&sca_esv=65b8675cb353c26d&source=hp&ei=mzG0aI_5Aseui-gP57Oz-)

<sup>51</sup> [https://www.google.com/search?q=konvention+von+montevideo&sca\\_esv=65b8675cb353c26d&source=hp&ei=mzG0aI\\_5Aseui-gP57Oz-](https://www.google.com/search?q=konvention+von+montevideo&sca_esv=65b8675cb353c26d&source=hp&ei=mzG0aI_5Aseui-gP57Oz-)

të Konventës së Montevideos, duhet t'i përmbushin edhe disa kritere tjera të dhëna më poshtë:

**1. Të jenë shtete:** shtetet aplikuese duhet të janë subjekte me status shtetëror (sovrانيتet, territor të përcaktuar, popullsi të qëndrueshme dhe qeveri funksionale)<sup>52</sup>

**2. Shtetet aplikuese duhet të janë në gjendje t'i përmbushin detyrimet e Kartës së OKB-së:** kjo përfshin respektimin e paqes ndërkombëtare, të drejtave të njeriut, zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve dhe mos-përdorimin e forcës.<sup>53</sup>

**3. Pranimi i shteteve aplikuese bëhet me rekomandimin e Këshillit të Sigurimit:** aplikimi i një shteti të ri shqyrtohet fillimisht nga Këshilli i Sigurimit, i cili duhet të japë rekomandim pozitiv. Ky rekomandim kërkon 9 vota pro nga 15 anëtarë dhe asnjë veto kundër nga 5 anëtarët e përhershëm (SHBA, Britania e Madhe, Franca, Rusia dhe Kina).<sup>54</sup>

**4. Vendimi përfundimtar merret nga Asambleja e Përgjithshme:** pas rekomandimit të Këshillit të Sigurimit, Asambleja e Përgjithshme e miraton anëtarësimin me shumicë prej dy të tresh të anëtarëve të pranishëm dhe votues.<sup>55</sup>

● Kështu, anëtarësimi i shteteve në OKB është një proces **juridik dhe politik**, ku përveç kushteve formale, një rol vendimtar luan **balanca e interesave të fuqive të mëdha** përmes të drejtës së vetos.<sup>56</sup>

### Në OKB pranohen shtetet dhe jo kombet

● Argumentet e dhëna më lart flasin qartë se në radhet e OKB-së, anëtarësohen shtetet dhe nuk anëtarësohen kombet në kuptimin etno-kulturor. Kështu, Spahiu saherë që në debatët televizive ka thënë se në OKB anëtarësohen kombet, ai kësisoj ka bërë një dezinformim të trashë dhe asgjë më shumë.

---

<sup>52</sup> Montevideo Convention on the Rights and Duties of States (1933), art. 1.

<sup>53</sup> Charter of the United Nations (San Francisco: United Nations, 1945), art. 4(1). <https://treaties.un.org/doc/publication/ctc/uncharter.pdf>

<sup>54</sup> Charter of the United Nations, art. 27; see also Thomas M. Franck, *The United Nations as a Normative Power* (New York: Oxford University Press, 1990), 42–44.

<sup>55</sup> Charter of the United Nations, art. 18(2).

<sup>56</sup> Edward C. Luck, *UN Security Council: Practice and Promise* (New York: Routledge, 2006), 23–27.

- Edhe pse emri i organizatës iu referohet kombeve (“Organizata e Kombeve të Bashkuara”), ajo praktikisht e bënë anëtrësimin e shteteve sepse ato paraqesin subjekte juridike ndërkombëtare.
- Shtetet sipas rasteve përfaqësojnë një komb unik, disa kombe, apo vetëm një pjesë të një kombi.<sup>57</sup>

### **Pranimi i shteteve në OKB nuk kushtëzohet me krijimin e ndonjë kombi të caktuar nga shtetet aplikuese**

- Lexuesit duke u njohur me kriteret dhe procedurat e pranimit të shteteve në radhet e OKB, të cituara më lart, shohin se OKB-ja nuk e ka kritër të anëtarësimit të shteteve në radhet e saj, krijimin nga ato shtete të kombeve të caktuara, por i pranon shtetet në radhët e saj me ato përbërje etnike/kombëtare që ato kanë pasur e kanë.
- Fakti se OKB-ja nuk e kushtëzon anëtarësimin e shteteve në radhët e saj me krijimin nga ana e tyre të kombeve të caktuara, kjo flet qartë se thëniet e Spahiut sipas të cilave - për t`u anëtarësuar Kosova në OKB, në Kosovë duhet të krijohet “kombi kosovar”, aq sa kanë qenë thënie dezinformuese po aq kanë qenë edhe thënie pa vlerë.
- Këshu, ska dyshim se OKB-ja edhe Kosovën do ta anëtarësoj në radhet e saj pa e kushtëzuar atë me krijimin e “kombit ksoovar”, përkatësisht OKB-ja do ta anëtarësoj Kosovën në radhet e saj me atë përbërje etnike/kombëtare që ka: me shumicën kombëtare shqiptare dhe me komunitetet pakicë që kanë jetuar dhe jetojnë në Kosovë
- Spahi u duke thënë se për t`u anëtarësuar Kosova në radhet e OKB-së, duhet që nga shqiptarët e Kosovës të krijohet një komb tjetër “kosovar”, ai kësisoji është përpjekur për t`i bindur (për mua për t`i mashtruar) shqiptarët e Kosovës, që ata për hir të antarësimit të Kosovës në OKB të tjetërsohen nga komb shqiptar në “komb kosovar”.

---

<sup>57</sup> Rosalyn Higgins, *The Development of International Law through the Political Organs of the United Nations* (London: Oxford University Press, 1963), 25–28.

## **Pesë pengesat kryesore për anëtarësimin e shteteve në OKB**

Në literaturë përmenden **pesë** pengesa të cilat e pamundësojnë anëtarësimin e shteteve në radhët e OKB-së. Ato janë:

- **Mosnjohja e shtetit aplikues si shtet nga shtetet tjera** (p.sh. rasti i mosnjohjes si shtet i Tajvanit).
- **Vetoja e Këshillit të Sigurimit kundër pranimit të shtetit aplikues në radhët e OKB-së** (p.sh. Vetoja e KS kundër pranimit të Palestinës në radhët e OKB-së):
- **Vetoja kundër pranimit të një shteti në OKB qoftë edhe vetëm nga njëri prej pesë shteteve anëtare të përsheshme të Këshillit të Sigurimit siç janë: Amerika, Rusia, Kina, Anglia dhe Franca.**
- **Konfliktet e shtetit aplikues me shtetet tjera dhe shkelja e sistematike të të drejtave të njeriut nga shteti aplikues.**
- **Papajftueshmëria e shtetit aplikues me Kartën e OKB-së ose kundërshtimi politik i Kartës së OKB-së nga shteti aplikues.**
- Lexuesi duke u njohur me pengesat e lartpërmenduar për anëtarësimin e shteteve në radhët e OKB-së, kupton se pengesë për anëtarësimin e një shteti në OKB nuk paraqet moskrijimi nga ai shtet aplikues i ndonjë kombi të caktuar.
- Dhe kjo flet se për OKB-në moskrijimi i “kombit kosovar” në Kosovë, nuk paraqet pengesë për anëtarësimin e shtetit të Kosovës në radhët e saj. Ose thënë shkurt e qartë: mosekzistimi i “kombit kosovar” nuk paraqet pengesë që Kosova të jetë vend anëtar i OKB-së.

### **Karta e OKB-së nuk e pengon anëtarësimin në OKB të dy a më shumë shteteve të të njëjtit komb**

- **Duke pasur parasysh se një komb etnik ose monoetnik ose kulturor - jo me patjetër krijon një shtet të vetëm unik, por sipas rastit mund të krijojë edhe dy a më shumë shtete<sup>58</sup>, kjo flet qartë se se OKB-ja e bënë edhe anëtarësimin e dy e më shumë shteteve të të njëjtit komb në radhët e saj.**
- Kështu, OKB-ja brenda viteve 1945-1990 e ka bërë anëtarësimin

---

<sup>58</sup> Nation: <https://de.wikipedia.org/wiki/Nation>

e dy shteteve gjermane (të Gjermanisë Perëndimore dhe të Gjermanisë Lindore) të të njëjtit komb gjerman. Dhe OKB-ja edhe aktualisht i ka të anëtrësuar në radhët e saj më shumë se dhjetë shtet arabe të të njëjtit komb arab, sepse i njëjti komb arab ka krijuar më shumë se dhjetë shtete të Ligës Arabe<sup>59</sup>

● Edhe fakti se OKB-ja e bën edhe anëtarësimin e dy e më shumë shteteve të të njëjtit komb, e demanton keqas falsitetin e thënieve të Spahiut, sipas së cilave, meqë Shqipëria është shtet anëtar i OKB-së si shtet i kombit shqiptar, Kosova nuk mund të bëhet vend anëtar i OKB-së si shtet i dytë i kombit shqiptar, sepse gjoja OKB-ja nuk bën anëtarësimin në radhët e saj të dy shteteve të të njëjtit komb shqiptar.

### **OKB-ja ka bërë edhe anëtarësimin e shteteve monarkike dhe diktoriale**

● Edhe pse përcaktimet e artikullit 4, kapitulli II të Kartës së OKB-së, thonë se në OKB pranohen shtetet paqedashëse dhe demokratike, në të cilat respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut, megjithatë, brenda radhëve të OKB-së janë pranuar edhe shtete që nuk i kanë plotësuar këto kritere.

● Kështu, OKB-ja e ka anëtarësuar Korenë Veriore të sotme, ku shteti ushtron dhunë diktoriale ndaj pjesëtarëve të tij, duke mos i re spektuar aspak të drejtat dhe liritë e njeriut. Dhe OKB-ja ka anëtarësuar edhe shtete të tjera, të cilat duke qenë sulltanate, nuk respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut.

### **OKB-ja ka qenë e gatshme ta anëtarësonte edhe Monarkinë Absolute të Vatikanit**

Spahiu lidhur me shtetin e Vatikanit është shprehur si në vijim:

■ **Shteti i Vatikanit osht një shtet fetar pronar i të cilit osht Papa<sup>60</sup>. (min. 7:34 - 7:43)**

■ **Në Mesjetë, pronarë të shteteve kanë qenë mbretërit, perandorët, sulltanët, kanët, shahët, raxhët etj., ndërsa në**

<sup>59</sup> Nation: <https://de.wikipedia.org/wiki/Nation>

<sup>60</sup> Debat i nxehtë "Kombi kosovar" me Nexhmedin Spahiun "Valamala Show", më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

**kohën moderne, pronarë të shteteve janë kombet. Përjashtim bën shteti i Vatikanit, i cili nuk është anëtar i OKB-së, për shkak se pronar i këtij shteti është Papa dhe jo ndonjë komb<sup>61</sup>.**

● Lidhur me dy thëniet e Spahiut të cituara më lart dua t'i sqaroj lexuesit se, edhe pse Vatikani është një shtet fetar dhe një Monarki Absolute, pronar i të cilit nuk është kombi-populli, por është Papa, OKB-ja ka qenë e gatshme që ta bëjë anëtarësimin e shtetit të Vatikanit brenda saj. Por Vatikani nuk e ka pranuar anëtarësimin e tij në OKB për dy arsye:

**E para**, sepse Vatikani duke njohur të drejtën e Zotit, e ka refuzuar nënshkrimin e Kartës së të Drejtave të Njeriut të OKB-së, dhe **e dyta**, sepse Vatikani duke mos u bërë shtet anëtar i OKB-së, ka dashur që ta ruajë në mënyrë strikte neutralitetin e tij politik<sup>62</sup>. Por Vatikani ka pranuar që Selia e Shenjtë të ketë statusin e vrojtuesit të përhershëm në OKB<sup>63</sup>.

---

<sup>61</sup> Nexhmedin Spahiu, *Koncepti i kombit*: <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

<sup>62</sup> Vatikan Stadt <https://www.google.ch/search?q=warum+vatican+ist+kein+mitglied+der+Vereinten+Nationen+>

<sup>63</sup> Vatikan Stadt: <https://www.google.ch/search?q=warum+vatican+ist+kein+mitglied+der+Vereinten+Nationen+>

# **PJESA E TRETË**

# 9

---

## TEORITË GJERMANE PËR KOMBIN (Përfaqësuesi tipik: Johann Gottlieb Fichte)

Meqë për ta kuptuar përmbajtjen e këtij libri duhet pasur njohuri elementare lidhur me teoritë kryesore për kombin, siç janë ato gjermane dhe ato franceze, jam përpjekur që lexuesve në dy kapitujt vijues të këtij libri, t'u ofroj njohuri elementare lidhur me këto teori. Krejt kjo, me qëllim që t'i sqaroj lexuesit pse nga kombi monoetnik shqiptar nuk ka mundur e nuk mund të krijohet një komb tjetër “kosovar”, ekzistimin e të cilit N. Spahiu dhe H. Matoshi e kanë propaganduar që nga viti 2000 e këtej, tanimë për 25 vite me radhë pa pasur asnjë fakt.

● Në thelb të krijimit të teorive gjermane për kombin kanë qëndruar idetë e filozofëve idealistë gjermanë, në radhë të parë idetë e filozofit Johan Gotlib Fihte (**Johann Gottlieb Fichte** (1762-1814), por edhe të filozofit Friedrich Hegel (**Fridrich Hegel** (1770-1831) dhe pjesërisht edhe ato të filozofit Imanuel Kant (**Immanuel Kant** (1724-1804), por edhe të dijetarit dhe shkrimtarit botëror, Johan Wolfgang Gëte (**Johann Wolfgang Göthe**), të dramaturgut të madh gjerman Fridrih Shiller (**Friedrich Schiller**) dhe të shumë dijetarëve të tjerë gjermanë.

● Këta filozofë dhe dijetarë të fushave të ndryshme duke plasuar idetë e tyre për bashkimin e kombit gjerman dhe për themelimin e shtetit të bashkuar gjerman, si dhe duke u pozicionuar (sidomos Fihte dhe Hegel) edhe kundër pushtimit të Prusisë nga Franca e

Napolon Bonapartit në vitin 1806, me shkrimet e tyre u kanë dhënë bazën teorive gjermane për kombin, sipas modelit të së cilave janë krijuar shumica e kombeve monoetnike, përfshi këtu edhe kombin shqiptar.

● Fihte dhe Hegel, që kanë marrë edhe epitetin “filozofë kombëtarë gjermanë”, por edhe filozofi Kant kanë paraqitur përfaqësuesit e filozofisë së “idealizmit gjerman”. E përbashkëta e tyre ka qenë kërkesa për të kapërcyer egoizmin dhe kërkesa për sakrifikimin e interesave individualë për interesin e kombit dhe të shtetit. Fihte në mësimet e tij të mëvonshme morale flet gjithnjë e më radikalisht për “shkatërrimin” e egos individuale<sup>64</sup>.

● Filozofi Gotlib Fihte duke qenë i indinjuar nga pushtimi i Prusisë (qendrës së Gjermanisë së ardhshme të bashkuar) nga ana e ushtrive franceze të Napolon Bonapartit në vitin 1806, ai gjatë viteve 1807-1808 ka mbajtur 14 fjalimet e tij të famshme para kombit gjerman. Në ato fjalime ai ka mbrojtur idenë e bashkimit të kombit gjerman dhe idenë e themelimit të shtetit të bashkuar të Gjermanisë, duke luftuar kundër pushtuesve francezë të Prusisë<sup>65</sup>. Brenda atyre 14 fjalimeve që Fihte ka mbajtur në ato vite, kanë qenë të skicuara parimet kryesore të teorive gjermane për kombin.

● Fjalimet e Gotlib Fihte drejtuar kombit gjerman kanë qenë një thirrje e zjarrtë për rezistencë kundër pushtimit të Prusisë nga ushtritë franceze të Napolonit. Fihte më vonë ka marrë pjesë edhe vetë në luftën çlirimtare kundër forcave pushtuese të Napolon Bonapartit. Fihte është shprehur se ajo që u kërkohet gjermanëve si komb nuk është dominimi i tyre në botë, por është bashkimi i kombit gjerman dhe rivendosja e unitetit të Europës së krishterë, në të cilën kombet individuale janë “shfaqje hyjnore”<sup>66</sup>.

● Sipas Fihtes, gjermanët për të qenë në gjendje të mbrohen nga ndikimet e huaja (nga francezët etj.), duhet të kujtojnë veçoritë e tyre të veçanta dhe rolin e tyre të madh historik. Thirrja e tij

---

<sup>64</sup> Lexikon der Philosophen: Johann Gottlieb Fichte: <https://shs.cairn.info/revue-de-metaphysique-et-de-morale-2014-1-page-40?lang=fr>

<sup>65</sup> <https://www.philomag.de/philosophen/johann-gottlieb-fichte#:~:text=%20Es%20ist%20nicht%20die%20Pflicht,werden%20ist%20eine%20himmlische%20Sache.>

<sup>66</sup> <https://shs.cairn.info/revue-de-metaphysique-et-de-morale-2014-1-page-40?lang=fr>

pasionante drejtuar bashkatdhetarëve të tij që të rebelohen kundër forcave franceze pushtuese, në mënyrë që ta shpëtojnë veten dhe të gjithë njerëzimin nga shkatërrimi, edhe në kohët e sotme paraqet një thirrje mbresëlënëse<sup>67</sup>.

● Dhe Fihte ka besuar se brenda kombit gjerman ka ekzistuar njëfarë qenësie/ndjesie gjermane, e cila sipas tij e ka ndihmuar konsolidimin e kombit gjerman përgjatë shekujve<sup>68</sup>. Edhe unë (autori i këtij libri) besoj se brenda kombeve ka ekzistuar dhe ekziston njëfarë intuitede e *lindur* komb-ndijesuese, që kombet e ndryshme kanë pasur brenda vetes gjatë krijimit dhe zhvillimit të tyre shumëshekullor.

● Fihte gjuhën gjermane e ka identifikuar me kombin gjerman dhe kombin gjerman e ka identifikuar me gjuhën gjermane. Kjo, sepse asokohe gjuha gjermane është folur vetëm nga pjesëtarët e kombit gjerman dhe nuk është folur nga asnjë komb tjetër<sup>69</sup>, kjo edhe duke pasur parasysh se asokohe ende nuk ekzistonte kombi austriak, pjesëtarët e të cilit po ashtu e kanë folur dhe e flasin edhe sot gjuhën gjermane. Sipas Fihtes, gjuha e krijon identitetin kombëtar dhe kulturor të një populli, ide kjo që është përputhur me rrymimin filozofik të ekzistencializmit<sup>70</sup>.

● Më tej, sipas Fihtes, gjermanët ndryshojnë nga popujt e tjerë me prejardhje gjermanike, nëpërmjet përdorimit të gjuhës gjermane<sup>71</sup>. Ai ka shkruar se, ndërsa gjermanët nuk e kanë shtetin e tyre të pavarur, kombin gjerman e ka mbajtur dhe e mba të bashkuar

---

<sup>67</sup> Reden an die deutsche Nation <https://www.getabstract.com/de/zusammenfassung/reden-an-die-deutsche-nation/10046#:~:text=Laut%20Fichte%20stiftet%20die%20Sprache,zeitgeschichtlichen%20Auspr%C3%A4gung%20der%20Nation%20existiert>

<sup>68</sup> Lexikon der Philosophen: Johann Gottlieb Fichte <https://www.philomag.de/philosophen/johann-gottlieb-fichte#:~:text=%20Es%20ist%20nicht%20die%20Pflicht,werden%20ist%20eine%20himmlische%20Sache>

<sup>69</sup> Lexikon der Philosophen: Johann Gottlieb Fichte <https://www.philomag.de/philosophen/johann-gottlieb-fichte#:~:text=%20Es%20ist%20nicht%20die%20Pflicht,werden%20ist%20eine%20himmlische%20Sache>

<sup>70</sup> Reden an die deutsche Nation <https://www.getabstract.com/de/zusammenfassung/reden-an-die-deutsche-nation/10046#:~:text=Laut%20Fichte%20stiftet%20die%20Sprache,zeitgeschichtlichen%20Auspr%C3%A4gung%20der%20Nation%20existiert>

<sup>71</sup> Reden an die deutsche Nation <https://www.getabstract.com/de/zusammenfassung/reden-an-die-deutsche-nation/10046#:~:text=Laut%20Fichte%20stiftet%20die%20Sprache,zeitgeschichtlichen%20Auspr%C3%A4gung%20der%20Nation%20existiert>

vetëm gjuha gjermane. Dhe sipas Fihtes është uniteti i gjermanëve, ai që përcakton vazhdimin e ekzistencës së kombit gjerman<sup>72</sup>.

● Gjermanët sipas Fihtes duhet të përballen me situatën e tyre të vërtetë, dhe për zgjidhjen e problemeve të veta nuk duhet të mbështeten te vendet e tjera, por duhet që, në radhë të parë, të mbështeten në forcat e tyre<sup>73</sup>. Fihte është shprehur se vetëm përmes një edukimi të ri kombëtar për të gjithë gjermanët, pavarësisht nga statusi i tyre, mund të ndalet rrënimi i kombit gjerman. Sipas tij, edukimi i ri kombëtar duhet ta kufizojë vullnetin e lirë të rinjtë, në mënyrë që ata të mos mund të bëjnë asgjë tjetër, përveçse ta duan të mirën<sup>74</sup>.

● Dhe Fihte është shprehur se është besimi në vazhdimësinë e përtjetshme të kombit, ai që i shtyn individët të marrin pjesë aktive në formësimin e kësaj bote dhe të sakrifikojnë veten për atdheun. Nga ana tjetër, kushdo që është i bindur për kalueshmërinë e jetës tokësore, nuk mund ta dojë veten dhe atdheun e tij: në të vërtetë ai nuk ka atdhe. Më tej, sipas tij, çdo gjerman për ta konsoliduar kombin gjerman duhet të fillojë menjëherë nga vetja: t'i tejkalojë marrëzitë, dobësitë dhe gabimet e tij, për të shmangur kësisoj rrënimin e kombit gjerman<sup>75</sup>.

● Në kundërpërgjigje ndaj politikës nënshtruese të Napolon Bonapartit, në Gjermani nuk është shfaqur vetëm mendimi i Fihtes për kombin, por është shfaqur edhe “Lëvizja Politike Kombëtare Gjermane”. Sipas kësaj lëvizjeje, duhej që çdo gjerman të largohej nga “e huaja” (*e huaja* ka nënkuptuar largimin nga Franca e Napolonit), sepse e huaja ka mund të çojë në tjetërsimin e gjermanëve dhe çdo gjerman është dashur të kalonte në të

---

<sup>72</sup> Reden an die deutsche Nation <https://www.philomag.de/philosophen/johann-gottliebfihte#:~:text=%20Es%20ist%20nicht%20die%20Pflicht,werden%20ist%20eine%20himmlische%20Sache.>

<sup>73</sup> Reden an die deutsche Nation <https://www.getabstract.com/de/zusammenfassung/reden-an-die-deutsche-nation/10046#:~:text=Laut%20Fichte%20stiftet%20die%20Sprache,zeitgeschichtlichen%20Auspr%C3%A4gung%20der%20Nation%20existiert.>

<sup>74</sup> Reden an die deutsche Nation <https://www.getabstract.com/de/zusammenfassung/reden-an-die-deutsche-nation/10046#:~:text=Laut%20Fichte%20stiftet%20die%20Sprache,zeitgeschichtlichen%20Auspr%C3%A4gung%20der%20Nation%20existiert.>

<sup>75</sup> Reden an die deutsche Nation: <https://www.getabstract.com/de/zusammenfassung/reden-an-die-deutsche-nation/10046#:~:text=Laut%20Fichte%20stiftet%20die%20Sprache,zeitgeschichtlichen%20Auspr%C3%A4gung%20der%20Nation%20existiert.>

vetën (te kombi i tij), që për Fihten ka paraqitur burimin hyjnor të vullnetit të njeriut dhe të të gjithë kombit gjerman<sup>76</sup>.

● Për Fihten “egoizmi” ka qenë shkak i vërtetë i humbjes së pavarësisë së të gjitha shteteve (principatave) gjermane. Por sipas Fihtes, humbja e pavarësisë së shteteve (principatave) gjermane, ka ndodhur edhe për shkak të ndikimit të kulturës franceze të shekullit të 18-të në mesin e principatave gjermane që para Revolucionit<sup>77</sup>.

● Fihte i fton kombet e tjera që të ndjekin modelin gjerman. Por pikërisht ky mendim i Fihtes është keqpërdoruar (abuzuar) nga nacional-socialistët gjermanë, sipas të cilëve kombi gjerman dhe kultura gjermane ka qëndruar mbi të gjitha kombet dhe gjuhët e tjera në botë<sup>78</sup>.

● Për Fihten, ashtu si edhe për Hegelin, Reformimi Kishtar i shekullit të 16-të, të cilit i ka prirë prifti gjerman Martin Luteri, që ndër të tjera edhe e ka përkthyer Biblën nga gjuha latine në gjuhën gjermane, ka pasur rëndësi të madhe në zhvillimin e kombit gjerman. Nga ana tjetër, kritika e Fihtes për besimin në jetën e përtejme si një ngushëllim për “skllëvërit” e kësaj bote, i ka paraprirë kritikës së Marksit për fenë si “opium për njerëzit”<sup>79</sup>.

### **Teoritë gjermane për kombin janë të vlefshme për përshkrimin e kombeve monoetnike**

● Ndonëse filozofët idealistë gjermanë kanë menduar se teoritë e tyre për kombin janë të vlefshme për të gjitha kombet e botës, jeta dhe praktika kanë treguar se ato teori kanë qenë dhe janë të vlefshme për kombet monoetnike, siç janë shumica e kombeve të botës, përfshirë këtu edhe kombin shqiptar, por nuk janë të vlefshme për kombet multietnike, siç janë kombi amerikan, australian, kanadez, neozelandez e të tjerë.

---

<sup>76</sup> Vom mystischen Körper zur Erfahrungsgeschichte. Nation ...<https://shs.cairn.info/revue-de-metaphysique-et-de-morale-2014-1-page-40?lang=fr>

<sup>77</sup> Vom mystischen Körper zur Erfahrungsgeschichte. Nation ...<https://shs.cairn.info/revue-de-metaphysique-et-de-morale-2014-1-page-40?lang=fr>

<sup>78</sup> Reden an die deutsche Nation: <https://www.getabstract.com/de/zusammenfassung/reden-an-die-deutsche-nation/10046#:~:text=Laut%20Fichte%20stiftet%20die%20Sprache,zeitgeschichtlichen%20Auspr%C3%A4gung%20der%20Nation%20existiert.>

<sup>79</sup> Vom mystischen Körper zur Erfahrungsgeschichte. Nation <https://shs.cairn.info/revue-de-metaphysique-et-de-morale-2014-1-page-40?lang=fr>

## **Parimet themelore të teorive gjermane për kombin**

Filozofët idealistë gjermanë (Fihte, Hegel, Kant e të tjerë), teoritë e tyre për kombin, siç u shpreha edhe më lart, i kanë hartuar në përputhje me Lëvizjen Nacionaliste Gjermane, për bashkimin e kombit gjerman në një Gjermani të Bashkuar. Parimet themelore të teorive gjermane për kombin janë:

- Etnia dhe kombi janë dy gjëra të njëjta, sinonime, dhe nuk janë dy gjëra të ndryshme, siç thonë teoritë franceze për kombin;

- Edhe etnia, edhe kombi janë të pandryshueshme dhe të përhershme (konstante), gjë vjen në kundërshtim me teoritë franceze për kombin, sipas të cilave etnia është e përhershme dhe e pandryshueshme (konstante), kurse kombi është i ndryshueshëm (variabël).

- Etnitë dhe kombet janë etni dhe kombe edhe kur ende nuk i kanë krijuar shtetet e tyre, dhe jo vetëm pasi i kanë krijuar shtetet e tyre, siç thonë teoritë franceze për kombin;

- Gjuhët identifikohen me kombet dhe kombet identifikohen me gjuhët, duke paraqitur ato (gjuhët) një element shumë të rëndësishëm për krijimin e kombeve, gjë që vjen në kundërshtim me përkufizimin e teorive franceze për kombin, sipas të cilave gjuhët nuk identifikohen me kombet dhe nuk paraqesin element të komb-ndërtimit.

- Kombet janë konstrakte etnike, gjuhësore, historike dhe kulturore specifike, gjë që bie në kundërshtim me përkufizimin e teorive franceze për kombin, sipas të cilit kombet janë konstrakte politike dhe artificiale, të krijuara me vullnetin e lirë politik të bashkësive njerëzore të përbëra nga etni të ndryshme.

## **Kombi shqiptar është krijuar në përputhje me teoritë gjermane për kombin**

- Kombi shqiptar duke qenë komb monoetnik në tërë hapësirën e tij etnike, është krijuar në përputhje me teoritë gjermane për kombin: si konstrukt etnik, historik, gjuhësor e kulturor specifik, dhe nuk është krijuar në përputhje me teoritë franceze për kombin: si konstrukt politik dhe artificial.

- Rilindësit Kombëtarë Shqiptarë duke luftuar me penë e me

pushkë për bashkimin e kombit shqiptar dhe për themelimin e shtetit kombëtar shqiptar, kanë vepruar në frymën e teorive të filozofëve gjermanë për kombin, të formuluar nga ideologët e Rilindjes Kombëtare Gjermane.

● Meqë teoritë gjermane për kombin flasin qartë se nga pjesa e kombit monoetnik shqiptar në Kosovë nuk ka mundur të krijohet një komb tjetër “kosovar” politik dhe artificial, kjo ka bërë që Spahiu teorive gjermane për kombin t’u referohet shumë pak.

### **Sipas modelit të teorive gjermane janë krijuar rreth 2/3 e kombeve të botës**

Rrethanat historike kanë bërë që shumica e kombeve të botës (rreth 2/3 e tyre), duke qenë të përbëra nga një etni e vetme dhe duke pasur histori, gjuhë dhe kultura specifike, janë krijuar si kombe monoetnike në përputhje me teoritë gjermane për kombin. Por kjo nuk ka ndodhur, sepse shumica e kombeve të botës i kanë preferuar teoritë gjermane për kombin, por kjo ka ndodhur thjesht për shkak të rrethanave etnike, historike, ekonomike, gjuhësore dhe kulturore specifike, brenda së cilave kanë jetuar ato kombe. Brenda rrethanave të tilla këto kombe as që kanë mundur të krijohen ndryshe, veçse si kombe monoetnike, në përputhje me teoritë gjermane për kombin.

### **Spahiu i zhvlerëson teoritë gjermane për kombin, sepse ato falsin qartë që në Kosovë nuk ka “komb kosovar”**

Spahiu në përpjekje e sipër për paraqitjen e teorive gjermane për kombin si teori joefikase, është shprehur si në vijim:

■ **Sa i përket kësaj filozofisë gjermane që përfaqësohej nga Fichte, ai në kohën kur lind ideja e kombit, Fichte mendonte se çdo etni, çdo popull që flet një gjuhë të veçantë, duhet të krijohej si një komb të veçantë, duhet ta ketë një shtet të veçantë<sup>80</sup>. Kjo osht filozofia e Fichtes<sup>81</sup>. (min. 20:08 – 20:31)**

<sup>80</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“ - Nexhmendin Spahiu dhe Ervis Iljazaj;| *ABC News Albania*, 06.11.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

<sup>81</sup> Fjala është për Johann Gottlieb Fichte (1762-1814), filozofin gjerman, që ka themeluar teoritë e filozofëve gjermanë të shekujve 18-të e 19-të për kombin.

■ ...Por të shohim se ku jemi sot n'shekullin 21, 200 e kusur vite ma vonë. A e dini se sa gjuhë flitën në botë? Janë përafërsisht 8000 etni, domethon 8 mijë njerzë t'originave t'ndryshme, dimethon që e ndajnë vetën nga të tjerët, janë 7 mijë gjuhë në botë që fliten, nja 1 mijë gjuhë domethon janë etni që e kanë humb gjuhën. Për shembull skocezët nuk e flasin gjuhën skoceze... Dua të tham se në botën bashkohore ajo që ka mendue Fihte nuk osht realizue. Në botë tani ekzistojnë vetëm rreth 200 kombe: 193 kombe janë anëtare të Kombeve të Bashkuara<sup>82</sup>. (min. 20:29 -21:47)

■ ...Por në botën bashkohore ajo që ka menduar Fihte e nuk është realizuar. Në botë janë përafërsisht 8000 etni... Por, në botë tani ekzistojnë vetëm rreth 200 kombe: 193 kombe janë anëtare të Kombeve të Bashkuara<sup>83</sup>. (45:00 - 45:13)

● Është e vërtetë se nga 8000 etni që ka pasur ose ka bota, vetëm 200 sosh janë bërë kombe me shtete përkatëse, por kjo nuk flet aspak se idetë e filozofëve gjermanë për kombin, të përfaqësuar nga Gotlib Fihte, janë joefikase apo të gabuara.

● Se nga 8000 etni sa ka pasur ose ka edhe sot bota vetëm 200 janë zhvilluar si kombe që kanë shtetet e tyre, për këtë nuk janë përgjegjëse as teoritë gjermane për kombin dhe as teoritë franceze për kombin. Për këtë janë përgjegjëse rrethanat negative historiko-politike, të cilave u janë nënshtruar dhe u nënshtrohen edhe sot shumica e etnive ekzistuese në botë. Kanë qenë rrethanat e tilla negative, ato që nuk kanë lejuar e nuk lejojnë, që mijëra etni ekzistuese të kthehen në kombe me shtete vetjake.

● Mendoj se Spahiu duke folur me nota zhvlerësuese për teoritë gjermane për kombin, nuk e ka hallin tek ato 8000 etni të ndryshme që ka bota, të cilat nuk kanë arritur të bëhen kombe dhe shtete, por e ka hallin se teoritë gjermane për kombin tregojnë qartë, se nga pjesa e kombit monoetnik shqiptar në Kosovë nuk ka mundur të krijohet një komb tjetër “kosovar”.

---

<sup>82</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“ - Nexhmendin Spahiu dhe Ervis Iljazaj; *ABC News Albania*, 06.11.2021, <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

<sup>83</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“ - Nexhmendin Spahiu dhe Ervis Iljazaj; *ABC News Albania*, 06.11.2021, <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

## **Autorë të tjerë që kanë shkruar për kombin në frymën e teorisë gjermane për kombin**

Përveç filozofit Gotlib Fihte, në frymën e teorisë gjermane për kombin kanë folur e shkruar edhe shumë autorë të tjerë, por ne do të trajtojmë këtu vetëm pikëpamjet teorike të Max Weber, të Erick Hobsbawm dhe Urs Altermatt.

### **Maks Veber (Max Weber)**

Max Weber (1864-1920) ka qenë një sociolog dhe ekonomist nacional gjerman. Ka qenë profesor në disa universitete të Gjermanisë. Ka dhënë kontribute shkencore në sociologjinë ekonomike dhe në sociologjinë e religjionit. Në vitin 1893, si nacionalist gjerman me premisa liberale, i është bashkuar “Lidhjes Pangjermane”, e cila ka mbështetur politikat nacionaliste gjermane.<sup>84</sup> Pikëpamjet e tij për kombin kanë qenë të ngjashme me ato të filozofëve gjermanë të shekujve XVIII e XIX, sipas të cilave kombet janë konstruktet etnike, gjuhësore, historike dhe kulturore. Max Weber i ka dhënë rëndësi të madhe gjuhës amtare me rastin e formimit të kombeve<sup>85</sup>.

### **Erik Hobsbawm (Erick Hobsbawm)**

Erick Hobsbawm ka lindur në Aleksandri të Egjiptit në vitin 1917 dhe ka vdekur në Londër në vitin 2012. Ka qenë një teoricien me orientim marksist, që ka dhënë kontribute shkencore në shkencat sociale, ekonomike dhe për historinë e kombeve e të nacionalizmit. Sipas tij, kombet janë bashkësi njerëzore, që kanë gjuhët, historinë, traditat, zakonet, artin dhe literaturën e tyre. Për të kombet kanë qenë bashkësi natyrore të bazuara në “tradita të shpikura”. Ai ka thënë se njeriu lind brenda kombit si në shtëpinë ose në fshatin e vet. Vetë fjala “komb” (“nation”) në gjuhën latine do të thotë *lindje, gjini, fis*. Sipas tij, simbolet e kombit janë flamuri, himni dhe monumentet kombëtare<sup>86</sup>. Hobsbawm duke qenë historiani më i

---

<sup>84</sup> Max Weber: [https://de.wikipedia.org/wiki/Max\\_Weber](https://de.wikipedia.org/wiki/Max_Weber)

<sup>85</sup> Max Weber <https://www.jstor.org/stable/43639288>

<sup>86</sup> h Benedickt Anderson und Eric Hobsbawm über Nation <https://www.jstor.org/stable/23983892>

rëndësishëm i shekullit XX, analiza e tij e mprehtë e historisë së kombeve dhe e nacionalizmit, deri më tani nuk ka humbur asgjë nga aktualiteti. Sipas tij, nacionalizmi modern është krijuar në vitin 1870, dhe që nga ajo kohë botës së sotme i ka dhënë fytyrën politike<sup>87</sup>.

### **Urs Altermat (Urs Altermatt)**

Urs Altermatt ka lindur në vitin 1942 në Soloturn të Zvicrës. Që nga viti 1980 deri në vitin 2010 ka qenë profesor i rregullt i historisë në Universitetin e Freiburgut. Ka studiuar historinë, sociologjinë dhe shkencat politike. Kontributet e tij shkencore i përkasin kulturës, religjionit, shoqërisë, pakicave kombëtare, nacionalizmit dhe antisemitizmit. Në vitin 2002 ka botuar librin “Kombi dhe nacionalizmi në Europë: Konstrukcioni kulturor i identiteteve”, në të cilin ai ka shkruar për konstruktin kulturor të identiteteve kombëtare<sup>88</sup>. Pikëpamjet e tij për kombin kanë qenë të ngjashme me ato të filozofëve gjermanë, sipas të cilave *kombi është bashkësi njerëzore që ka etni, gjuhë, histori dhe kulturë të përbashkët*.

---

<sup>87</sup> Nationen und Nationalismus, ein Buch von Eric J. Hobsbawm  
[https://www.campus.de/buecher-campus-verlag/wissenschaft/geschichte/nationen\\_und\\_nationalismus-2433.html](https://www.campus.de/buecher-campus-verlag/wissenschaft/geschichte/nationen_und_nationalismus-2433.html)

<sup>88</sup> Nation und Nationalismus in Europa. Kulturelle Konstruktion von Identitäten. Festschrift für Urs Altermatt. Huber, Frauenfeld u. a. 2002, ISBN 3-7193-1299-2 (mit Bibliographie Altermatt).

# 10

---

## TEORITË FRANCEZE PËR KOMBIN (Përfaqësuesi tipik: Ernest Renan)

Meqë në kapitullin e mësipërm u përshkruan teoritë gjermane për kombin, brenda këtij kapitulli do të përshkruhen teoritë franceze për kombin. Në thelb të teorive franceze për kombin kanë qëndruar idetë e filozofit, historianit dhe shkrimtarit francez, Ernest Renan (1823-1892), por edhe idetë e disa e dijetarëve të tjerë francezë.

- Teoritë e dijetarëve francezë për kombin kanë qenë të motivuara nga Revolucioni Francez (1789-1799), i cili është bërë në frymën e sloganit: *Liri-Barazi-Vëllazëri (Liberte-Egalite-Fraternite)*.
- Fryma e Revolucionit Francez ka çuar tek idetë e krijimit të kombeve, jo më duke pasur në qendër të komb-krijimit etninë, gjuhën, historinë apo kulturën e caktuar të kombit të veçantë monoetnik, por duke pasur në qendër të komb-krijimit lirinë, vëllazërinë dhe barazinë mes pjesëtareve të etnive të ndryshme të kombit multi-etnik.
- Slogani i Revolucionit Francez: *Liri-Vëllazëri-Barazi*, ka lindur si kundërshtim i qytetarëve të Francës ndaj sistemit feudalist të Mbretërisë Absolute të Francës, në krye të së cilës ka qëndruar Mbretit i Francës, Luigji XVI, që ka ushtruar dhunë diktatoriale dhe pabarazi ekstreme mes qytetarëve dhe të shtresës pushtet-mbajtëse.
- Qytetarët francezë nëpërmjet të Revolucionit kanë arritur që

të largojnë nga skena politike e Francës sistemin feudalist absolut të Francës, duke e zëvendësuar atë me sistemin republikan-demokratik, me ç'rast vendimet nuk janë marrë më nga Mbreti, por janë marrë nga deputetët e zgjedhur nga populli në parlament, duke u kthyer kësisoj Franca nga një Mbretëri Absolute, në një Republikë Demokratike.

● Brenda rrethanave të tilla të motivuara dhe të diktura nga Revolucioni Francez kanë lindur idetë franceze për kombin, të cilat në qendër të komb-krijimit kanë vënë lirinë, barazinë dhe vëllazërinë, në mesin e qytetarëve të etnive, të gjuhëve dhe të kulturave të ndryshme, duke u krijuar kësisoj kombet shumetnike kozmopolite.

● Kështu, Ernest Renani i frymëzuar nga parimet e Revolucionit Francez, kombin ndër të tjetra e ka përkufizuar edhe si një komunitet të madh solidariteti, i mbështetur mbi ndjenjën e sakrificave që dikush ka bërë për të, si dhe i mbështetur mbi ndjenjën e sakrificave që dikush ende do të bënte për të<sup>89</sup>.

● Ernest Renani në marsin e vitit 1882 ka mbajtur ligjëratën e tij të famshme në Paris, me ç'rast është shprehur se kombet e krijuara nga dinastitë feudale duhet të shkëputen nga dinasti të tilla, për të ekzistuar më tej jashtë tyre si kombe të lira<sup>90</sup>.

● Ernest Renani është shprehur se bazën e krijimit të kombeve nuk e bën raca, grupi etnik apo gjuha, por është liria-vëllazëria dhe barazia mes qytetarëve dhe pushtetarëve. Për më tepër, ai ka thënë se “është mirë që të gjithë ta harrojnë etninë. Unë e dua etnografinë, që është një shkencë me vlerë të rrallë, por dua që të ajo mbetet pa aplikim politik”<sup>91</sup>.

● Ernest Renani qysh në vitin 1882 e ka parashikuar krijimin e “Konfederatës Europiane”<sup>92</sup>, në kuptimin e bashkimit të shteteve europiane në një strukturë shtetërore konfederative të përbashkët.

---

<sup>89</sup> Ernest Reanan: [https://de.wikipedia.org/wiki/Ernest\\_Renan](https://de.wikipedia.org/wiki/Ernest_Renan)

<sup>90</sup> Was eigentlich ist eine Nation? Die Antwort: <https://www.infosperber.ch/politik/schweiz/was-eigentlich-ist-eine-nation-die-antwort/>

<sup>91</sup> Was eigentlich ist eine Nation? Die Antwort: <https://www.infosperber.ch/politik/schweiz/was-eigentlich-ist-eine-nation-die-antwort/>

<sup>92</sup> Ernest Reanan: [https://de.wikipedia.org/wiki/Ernest\\_Renan](https://de.wikipedia.org/wiki/Ernest_Renan)

● Sipas Ernest Renanit, gjuha nuk paraqet element të komb-ndërtimit, sepse ajo, ndonëse i fton njerëzit të bashkohen, megjithatë nuk i detyron ata që të bashkohen dhe sepse ka gjuhë që fliten nga disa kombe të ndryshme. Kështu, gjuha angleze duke u folur nga kombe të ndryshme në Angli, Amerikë, Kanada, Australi, Zelandë të Re e në vende tjera, ajo nuk identifikohet me ndonjë komb të caktuar dhe, për rrjedhojë, edhe nuk është element komb-ndërtues ose komb-identifikues<sup>93</sup>.

● Ernest Renani lidhur me religjionin është shprehur se nuk ka religjion kombëtar ose shtetëror, sepse i njëjti religjion mund të jetë edhe religjionin i shumë kombeve të ndryshme. Kështu, ka francezë, anglezë, gjermanë dhe të tjerë, që janë të të njëjti besim të krishterë. Prandaj, sipas tij, feja nuk është çështje kombëtare apo shtetërore, por është çështje individuale e secilit dhe ka të bëjë me ndërgjegjen e çdo njeriu veç e veç<sup>94</sup>.

● Më tej Renani është shprehur se “kombet nuk janë të përjetshme. Ato ashtu siç e kanë një fillim, kanë edhe një mbarim”. Ai është shprehur se ndoshta Konfederata Europiane (La confédération européenne, probablement, les remplacera)” do t’i zëvendësojë kombet<sup>95</sup>.

● Ernest Renani duke mos e konsideruar kombin krijesë të përhershme, ka thënë se ekzistenca e tij (e kombit) duhet të jetë një plebishit i përditshëm, ashtu si ekzistenca e individit, që është një afirmim i vazhdueshëm i jetës<sup>96</sup>.

● Ernest Renani nuk e lidh kombin me etninë apo gjuhën, por e lidh me elementin shpirtëror duke thënë: “Një komb është një shpirt, një parim shpirtëror (une me, un principe spirituel)”<sup>97</sup>

● Më tej, sipas tij, kombi është një bashkësi e madhe njerëzore, me

---

<sup>93</sup> Was eigentlich ist eine Nation? Die Antwort:

<https://www.infosperber.ch/politik/schweiz/was-eigentlich-ist-eine-nation-die-antwort/>

<sup>94</sup> Was eigentlich ist eine Nation? Die Antwort: <https://www.infosperber.ch/politik/schweiz/was-eigentlich-ist-eine-nation-die-antwort/>

<sup>95</sup> Was eigentlich ist eine Nation? Die Antwort: <https://www.infosperber.ch/politik/schweiz/was-eigentlich-ist-eine-nation-die-antwort/>

<sup>96</sup> Was eigentlich ist eine Nation? Die Antwort: <https://www.infosperber.ch/politik/schweiz/was-eigentlich-ist-eine-nation-die-antwort/>

<sup>97</sup> Was eigentlich ist eine Nation? Die Antwort: <https://www.infosperber.ch/politik/schweiz/was-eigentlich-ist-eine-nation-die-antwort/>

mendje të shëndoshë dhe me zemër të ngrohtë, që krijon brenda vetes një ndërgjegje morale<sup>98</sup>.

### **Teoritë franceze për kombin - adekuate për përshkrimin e kombeve multietnike**

● Ndonëse Ernest Renani dhe filozofë e dijetarë të tjerë francezë kanë menduar se teoritë e tyre për kombin janë të vlefshme për të gjitha kombet e botës, megjithatë, jeta dhe praktika ka treguar se ato kanë qenë dhe janë të vlefshme për përshkrimin e kombeve multietnike, siç janë kombi amerikan, australian, kanadez, neozelandez, turk e të tjerë, por nuk janë të vlefshme për përshkrimin e kombve monoetnike, siç janë shumica e kombeve të botës dhe siç është edhe kombi shqiptar.

● Meqë teoritë franceze për kombin lënë hapësirë që të mendohet gabimisht, sikur gjoja pas çlirimit dhe pavarësimit të Kosovës, nga etnia shqiptare është krijuar një komb tjetër “kosovar” politik dhe artificial, gjë që nuk qëndron, Spahiu u është referuar dhe u referohet atyre vazhdimisht, kurse teorive gjermane u është referuar pak ose hiç, sepse sipas tyre del e qartë, se nga pjesa e kombit monoetnik shqiptar në Kosovë nuk ka mundur të krijohet një komb tjetër “kosovar” politik dhe artificial.

### **Parimet kryesore të teorive franceze për kombin**

● Brenda rrethanave të shqyrtuara më, filozofi dhe shkrimtari francez Ernest Renani, i frymëzuar nga Revolucioni Francez i viteve 1789-1799, ka vënë parimet kryesore të teorive franceze për kombin, të vlefshme kryesisht për kombet multietnike, por jo për kombet monoetnike. Parimet kryesore të teorive franceze për kombin janë si më poshtë:

- \* **Etnia dhe kombi janë dy gjëra të ndryshme dhe jo dy gjëra të njëjta, siç thonë teoritë gjermane për kombin.**
- \* **Etnitë bëhen kombe vetëm kur i krijojnë shtetet e tyre, përkatësisht, ato derisa nuk kanë shtetet e tyre janë etni,**

---

<sup>98</sup> Was eigentlich ist eine Nation? Die Antwort: <https://www.infosperber.ch/politik/schweiz/was-eigentlich-ist-eine-nation-die-antwort/>

por nuk janë kombe, gjë që vjen në kundërshtim me teoritë gjermane për kombin, sipas të cilave etnitë janë etni dhe kombe si para, ashtu edhe pas krijimit të shteteve të tyre.

- \* Etnia është e pandryshueshme (konstante), kurse kombi është i ndryshueshëm (variabël), gjë që vjen në kundërshtim me teoritë gjermane për kombin, sipas të cilave edhe etnia, edhe kombi janë të pandryshueshme (konstante).
- \* Gjuhët nuk identifikohen me kombet dhe kombet nuk identifikohen me gjuhët, dhe gjuhët si të tilla nuk paraqesin element të komb-formimit, gjë që vjen në kundërshtim me përkufizimin e teorive gjermane për kombin, sipas të cilit gjuhët identifikohen me kombet dhe kombet identifikohen me gjuhët, duke paraqitur një element të rëndësishëm të komb-formimit.
- \* Kombi është thjesht një konstrukt politik i vullnetit të lirë të pjesëtarëve të tij dhe, për rrjedhojë, është edhe një konstrukt artificial, dhe nuk është një konstrukt etnik, gjuhësor dhe kulturor specifik, siç thonë teoritë gjermane për kombin.
- \* Kombi sipas teorive franceze nuk është vetëm bashkësi e interesave të njëjtë të pjesëtarëve të bashkësisë së madhe njerëzore, por është edhe një bashkësi emocionale dhe shpirtërore e pjesëtarëve të tij.

### **Sipas modelit të teorive franceze janë krijuar rreth tridhjetë kombe multietnike të botës**

- Në frymën e Revolucionit Francez, përveç kombit multietnik francez, janë krijuar edhe kombe të tjera multietnike, që marrë së bashku bëjnë rreth 30 kombe të botës.
- Kështu, sipas modelit të teorive franceze për kombin, janë krijuar: kombi multietnik amerikan, kombi multietnik brazilian, kombi multietnik kanadez, kombi multietnik australian, kombi multietnik neozelandez, kombi multietnik turk dhe kombe të tjera multietnike.
- Kombet multietnike të përmendura më lart nuk janë krijuar si kombe multietnike, thjesht sepse ato kombe i kanë preferuar teoritë franceze për kombin, por janë krijuar si kombe multietnike

për shkak të përbërjes shumetnike, shumëgjuhësore dhe shumëkulturore të tyre. Brenda rrethanave të tilla këto kombe as që kanë mundur të krijohen ndryshe, veçse si kombe dhe shtete multietnike, në përputhje me teoritë franceze për kombin.

● Kombi shqiptar duke qenë një komb monoetnik në tërë hapësirën e tij etnike, ai nuk është krijuar në përputhje me teoritë franceze për kombin, si një konstrukt politik dhe artificial, por është krijuar në përputhje me teoritë gjermane për kombin, si një konstrukt i natyrshëm etnik, gjuhësor, historik e kulturor.

### **Teoritë franceze për kombin janë kritikuar si teori raciste dhe asimiluese**

● Nga ana tjetër, teoritë franceze për kombin, të lindura gjatë Revolucionit Francez të viteve 1789-1799 dhe të përfaqësuara nga Ernest Renani (1823-1892), janë kritikuar si teori raciste dhe asimiluese. Kjo, sepse këto teori duke e konsideruar kombin një bashkësi të madhe solidarë<sup>99</sup>, të krijuar me vullnetin e qytetarëve të etnive të ndryshme, kanë çuar në asimilimin e shumë etnive të vogla brenda etnive të mëdha<sup>100</sup>.

● Nuk kam asgjë kundër teorive franceze për kombin, adekuate për përshkrimin dhe sqarimin e krijimit të kombeve multietnike, por unë jam kundër keqpërdorimit dhe keqinterpretimit të tyre nga Spahiu, për t'i hutuar e mashtruar ai nëpërmjet tyre shqiptarët e Kosovës, që ata nga komb shqiptar të konvertohen në “komb kosovar”.

● Në fakt, Spahiu gjithë propagandën e tij për gjoja krijim-ekzistimin e “kombit kosovar”, e ka të ndërtuar mbi strategjinë e keqpërdorimit dhe të keqinterpretimit të teorive franceze për kombin. Spahiu edhe pse teoritë franceze për kombin janë adekuate për përshkrim-sqarimin e krijimit të kombeve multietnike, ai pjesës së kombit shqiptar monoetnik në Kosovë i është qasur vazhdimisht nëpërmjet teorive franceze, sepse ato lënë hapësirë fiktive teorike për gjoja krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

<sup>99</sup> Ernest Renan: [https://de.wikipedia.org/wiki/Ernest\\_Renan](https://de.wikipedia.org/wiki/Ernest_Renan)

<sup>100</sup> Maximilian Opitz: *Die Minderheitenpolitik der Europäischen Union*. LIT Verlag, Münster 2007, ISBN 978-3-8258-0524-1.

## Autorët e tjerë që kanë shkruar për kombin në frymën e teorive franceze për kombin

● Përveç filozofit Ernest Renan, në frymën e teorive franceze për kombin, kanë shkruar edhe autorë të tjerë, por ne do të trajtojmë vetëm pikëpamjet teorike të Benedikt Anderson (**Benedickt Anderson**), Dominik Shneper (**Dominique Schnapper**) dhe Ernest Gellner.

### Benedikt Anderson (Benedickt Anderson)

● Benedickt Anderson ka lindur në vitin 1936 në Kinë dhe ka vdekur në vitin 2015 në Indonezi. Ka qenë një amerikano-irlandez që ka punuar si profesor i shkencave politike dhe i studimeve internacionale në Universitetin e Kornelit (Cornell University) në Amerikë.

● Benedickt Anderson në vitin 1983 ka publikuar librin mbi kombin dhe nacionalizmin, me titull: “Komunitete të imagjinuara” (*Imagined Communities*). Anderson i ka konsideruar kombet “komunitete imagjinare”, sepse duke qenë kombet shumë të mëdha pjesëtarët e tyre nuk e njohin njëri-tjetrin dhe, kjo ka bërë që pjesëtarët e kombeve raportet në mes tyre vetëm t’i përfytyrojnë (magjinojnë)<sup>101</sup>.

● Anderson për përkufizimin e kombit e ka përdorur qasjen konstruktiviste të sociologjisë, sipas së cilës perceptimi i realitetit është rezultat i konstruksionit shoqëror të realitetit, në interpretimin historik të fenomenit të “kombit”<sup>102</sup>.

● Anderson pikënisjen e krijimit të kombeve e ka parë të lidhur me pozicionimin e fuqishëm të religjioneve, me shkrimin e gjuhëve të mëdha, me shtypin dhe publikimin e teksteve, me përkthimin e Bibles nga gjuha latine në gjuhën gjermane, me bërjen e gjuhëve gjuhë administrative, duke u krijuar kesisoj “bashkësitë lokale të imagjinuara” prej të cilave janë krijuar kombet<sup>103</sup>.

● Sips Andersoni rol të rëndësishëm për imagjinimin e komuni-

---

<sup>101</sup> Benedickt Anderson: [https://de.wikipedia.org/wiki/Benedickt\\_Anderson](https://de.wikipedia.org/wiki/Benedickt_Anderson)

<sup>102</sup> Benedickt Anderson: [https://de.wikipedia.org/wiki/Benedickt\\_Anderson](https://de.wikipedia.org/wiki/Benedickt_Anderson)

<sup>103</sup> Fatmir Lekaj, Kombformimimi dhe Përpjekjet e Shqiptarëve për liri dhe barazi, faqe 19.

teteve kombëtare, kanë përvojat e përbashkëta kulturore të bashkësive njerëzore dhe mediet<sup>104</sup>.

● Tezat tij për kombin janë bërë kryesisht në frymën e teorive franceze për kombin, sipas të cilave kombet janë komunitete imagjinare politikisht të konstruara, përkatësisht janë konstrukte politike dhe artificiale, gjë që bie në kundërshtim me teoritë gjermane për kombin, sipas të cilave kombet janë konstrukte etnike, gjuhësore, historike dhe kulturore.

### **Dominik Shneper (Dominique Schnapper)**

● Dominique Schnapper ka lindur në Paris në vitin 1934 . Ka studiuar historinë dhe shkencat politike. Është marrë me sociologji, me komunitetet pakicë, me teorinë e kombit dhe të shtetit. Ka punuar për vite këshilltare në komisionet qeveritare franceze<sup>105</sup>.

● Sipas saj, kombi është i pandashëm historikisht nga demokracia dhe në thelb i kundërvihet nacionalizmit, si dhe nuk i përfill fare veçoritë etnike, krahinore, gjuhësore dhe fetare...<sup>106</sup>.

● Pikëpamjet e saj për kombin janë të ngjashme me ato të teorive franceze për kombin, sipas të cilave kombet janë konstrukte politike dhe artificiale variable, që mund të ndryshohen sipas rrethanave politike dhe historike.

### **Ernest Gellner**

● Ernest Gellner ka lindur në Paris në vitin 1952 dhe ka vdekur në Pragë më 1995. Ka qenë një sociolog, filozof dhe antropolog çekoslovak dhe britanik me origjinë hebreje. Ka dhënë kontribute të shumta shkencore në lëmin e filozofisë, sociologjisë, antropologjisë sociale dhe historisë. Ka qenë shumë i ndikuar nga sociologu gjerman Max Weber dhe nga filozofi anglez, Karl Popper.

● Gellner kombin e ka kuptuar si fenomen modern. Ai është bërë i njohur me teorinë e tij për nacionalizmin. Ai e ka paraqitur nacionalizmin si një parim politik, i cili e dakordëson politikën me

---

<sup>104</sup> Benedickt Anderson: [https://de.wikipedia.org/wiki/Benedict\\_Anderson](https://de.wikipedia.org/wiki/Benedict_Anderson)

<sup>105</sup> Dominique Schnapper: [https://de.wikipedia.org/wiki/Dominique\\_Schnapper](https://de.wikipedia.org/wiki/Dominique_Schnapper)

<sup>106</sup> Dominique Schnapper: [https://de.wikipedia.org/wiki/Dominique\\_Schnapper](https://de.wikipedia.org/wiki/Dominique_Schnapper)

unitetin kombëtar<sup>107</sup>. Sipas tij kombet janë krijuar nga nacionalizmi që ka qenë konsekuencë e industrializimit dhe e formimit të shtetit të centralizuar<sup>108</sup>.

● Por sipas Gellner rol të rëndësishem për krijimin e komunteteve kombëtare, kanë pasur edhe faktorët socioekonomik të cilët kanë shpënë në krijimin e kulturave të standardizuara dhe homogjene...<sup>109</sup>

---

<sup>107</sup> Ernest Gellner: [https://de.wikipedia.org/wiki/Ernest\\_Gellner](https://de.wikipedia.org/wiki/Ernest_Gellner)

<sup>108</sup> Fatmir Lekaj, Kombformimi dhe Përpyqjet e Shqiptarëve për liri dhe barazi, faq 14.

<sup>109</sup> Ernest Gellner: [https://de.wikipedia.org/wiki/Ernest\\_Gellner](https://de.wikipedia.org/wiki/Ernest_Gellner)

---

## KOMBET DHE LLOJET E KOMBEVE

Ndërsa në kapitujt pararendës u sqaruan karakteristikat kryesore të teorive gjermane dhe franceze për kombin, në këtë kapitull lexuesit sqarohen lidhur me kombet dhe llojet e tyre, sepse secili komb ose grup i kombeve ka karakteristikat e tij të veçanta, të cilat i bëjnë ato të ndryshme.

Shumë filozofë, sociologë, historianë, politikanë dhe dijetarë të fushave të ndryshme, duke pasur parasysh karakteristikat e ndryshme të kombeve të ndryshme, përveçse kanë dhënë dhjetëra përkufizime të ndryshme për kombin, edhe i kanë ndarë kombet në lloje të ndryshme.

### **Nuk ka teori për kombin të vlefshme për të gjitha kombet**

● Por, edhe pse janë dhënë dhjetëra teori dhe përkufizime të ndryshme për kombin, praktika e krijimit të kombeve ka treguar se asnjëra nga teoritë dhe asnjëri nga përkufizimet e dhëna për kombin, nuk ka rezultuar aq gjithëpërfshirës, sa të mund të përshkruhen me ndonjëren prej tyre të gjitha kombet e botës.

● Kështu, p.sh., ndërsa me teoritë gjermane për kombin mund të përshkruhen dhe të përkufizohen kryesisht kombet monoetnike, me to nuk mund të përshkruhen dhe përkufizohen kombet multietnike. Ose ndërsa me teoritë franceze për kombin mund të përshkruhen dhe përkufizohen kombet multietnike, me to nuk mund të përshkruhen dhe përkufizohen kombet monoetnike.

● Duke pasur parasysh se çdo komb ka disa karakteristika të veçanta, të cilat nuk përputhen me karakteristikat e veçanta të secilit komb tjetër, kjo tregon se për secilin komb të botës duhet të jepet një teori dhe një përkufizim i veçantë, që përputhet me karakteristikat e veçanta të krijimit të çdo kombi.

● Meqë nuk ekziston asnjë teori dhe asnjë përkufizim me të cilin mund të përkufizohen të gjitha kombet e botës, kjo tregon se përkufizimi më i mirë për secilin komb të botës është ai që secili komb e harton për veten e tij, në përputhje me rrethanat historiko-politike specifike të krijimit të tij.

### Prejardhja e nocionit “komb” (“nation”)

● **Nocioni “komb”** rrjedh nga gjuha latine “nation”, që do të thotë “lindje”<sup>110</sup>. “klan”, “origjinë”. Kuptimësia e kombit si “lindje” rrjedh nga folja “nasci”, që do të thotë “të lindësh”<sup>111</sup>, gjë që nënkupton lindjen e grupeve ose të kolektivave të mëdha njerëzore, të cilëve u atribuohen karakteristika të përbashkëta, si: gjuha, tradita, sjelljet, zakonet ose prejardhja.

● Por me fjalën “komb” (“nation”) në kuptimin më të gjerë, është kuptuar një komunitet njerëzor me origjinë, gjuhë, tradita dhe zakone të njëjta, i cili si i tillë është dalluar nga popullatat e huaja emigruese që kanë jetuar brenda një popullsie të madhe vendëse. Kështu, e drejta romake e njohur si *Ius gentium*, ka krijuar një bazë ligjore të veçantë për trajtimin e personave, që nuk e kanë pasur shtetësinë romake<sup>112</sup>.

### Llojet e kombeve

● Ajo që duhet ta kuptojnë lexuesit, është se në botë, në varësi nga rrjedhat historike dhe politike brenda së cilave janë krijuar kombet e ndryshme, ekzistojnë disa lloje kombesh, të cilat ashtu siç kanë të përbashkëtat e tyre, kanë edhe të veçantat e tyre.

<sup>110</sup> Hans-Jürgen Lüsebrink: L'Etat-Nation/Staatsnation. Zur frühmodernen Genese und postmodernen Infragestellung des Nationalen. In: Rainer Hudemann, Manfred Schmeling (Hrsg.): Die “Nation” auf dem Prüfstand/La “Nation” en question / Questioning the „Nation“. Akademie Verlag, Berlin 2009, S. 3.

<sup>111</sup> Nation. In: Digitales Wörterbuch der deutschen Sprache. Abgerufen am 11. Februar 2020

<sup>112</sup> Nation: <https://de.wikipedia.org/wiki/Nation>

## **Ndarja e kombeve në kombe monoetnike dhe multietnike**

● Nga ato që kam lexuar, studiuar dhe krahasuar lidhur me kombet dhe llojet e tyre, kam ardhur në përfundim se ndarja kryesore dhe njëkohësisht edhe më racionale e kombeve, është ndarja e tyre në kombe monoetnike dhe në kombe multietnike. Kjo, sepse të gjitha kombet e botës ose janë monoetnike (të prejardhura dhe të përbëra nga një etni e vetme), ose janë multietnike (të prejardhura dhe të përbëra nga etni të ndryshme).

● Të gjitha ndarjet dhe emërtimet e tjera të kombeve ose paraqiten si variacione të kombeve monoetnike, ose paraqiten si variacione të kombeve multietnike.

### **Llojet dhe karakteristikat e kombeve monoetnike**

● **Kombi monoetnik/kulturor:** Duke pasuar parasysh se kombet monoetnike janë krijuar nga një etni e vetme, ato quhen edhe **kombe monoetnike**. Me që këto kombe (monoetnike), përveçse mbi bazën e konstrukteve të tyre etnike, janë krijuar edhe mbi bazën e historive, gjuhëve dhe kulturave të tyre specifike, ato quhen edhe *kombe etno-kulturore (organike)*<sup>113</sup>

● **Një komb etnik ose monoetnik ose kulturor** - jo me patjetër krijon një shtet të vetëm unik, por sipas rastit mund të krijojë edhe dy a më shumë shtete<sup>114</sup>. Kombi gjerman brenda viteve 1945-1990 ka zotëruar dy shtete: Gjermaninë Perëndimore dhe Gjermaninë Lindore, ose i njëjti komb arab zotëron më shumë se dhjetë shtete të Ligës Arabe.

● **Kombi etnik ose monoetnik ose kulturor** - është një koncept shumë i qëndrueshëm i kombit, sepse ai, përveç elementit të përbashkët etnik, përfshin brenda vetes edhe elementin e përbashkët gjuhësor, historik, të traditës dhe të kulturës së kombit etnik. Kështu, kombi etnik ose kulturor si i tillë, identifikohet edhe nga heronjtë kombëtarë, monumentet kombëtare, me himnin dhe flamurin kombëtar, elemente këto të pashmangshme të kombeve etnike ose kulturore<sup>115</sup>.

---

<sup>113</sup> Anthony D. Smith, *Nationalism and Modernism* (London: Routledge, 1998), 57–63.

<sup>114</sup> Nation: <https://de.wikipedia.org/wiki/Nation>

<sup>115</sup> Nation: <https://de.wikipedia.org/wiki/Nation#Kulturnation>

● **Kombi etnik ose kulturor është komb homogjen** - sepse pjesëtarët e tij kanë prejardhje të përbashkët etnike, historike gjuhësore dhe kulturore. Por përpjekjet e këtyre kombeve për krijimin e shteteve etnikisht të pastra gjatë shekullit XX kanë çuar shpesh në spastrime të etnive të vogla nga etnitë/kombet e mëdha shtet-krijuese<sup>116</sup>.

● **Kombi popullor** - paraqet një variant të kombit monoetnik, i krijuar nga një etni e madhe dhe disa etni të vogla, ku etnia e madhe synon integrim-asimilimin e etnive të vogla brenda vetes. Sipas historianit **Vito Gironda**, kombi popullor, të shumtën e herëve, synon integrimin dhe asimilimin e pakicave kombëtare brenda një bashkësie kulturore të përcaktuar<sup>117</sup>.

● **Krijimi i kombit monoetnik gjerman:** Kombi gjerman është krijuar si komb tipik monoetnik, sepse është krijuar nga etnia e vetme gjermane e shpërndarë në shumë principata gjermane. Kombi gjerman monoetnik në vitin 1871 ka krijuar shtetin e bashkuar gjerman në formën e Monarkisë Kushtetuese të Gjermanisë.

● **Krijimi i kombit monoetnik italian:** Edhe kombi italian është krijuar si komb tipik monoetnik, sepse është krijuar nga etnia e vetme italiane e shpërndarë në shumë principata italiane. Edhe kombi italian monoetnik në vitin 1871 ka krijuar shtetin e bashkuar italian në formën e Monarkisë Kushtetuese të Italisë.

● **Kombet monoetnike** i kanë krijuar shtetet një-nacionale. Meqë shumica e kombeve të botës janë kombe monoetnike edhe shumica e shteteve të botës janë kombe një-nacionale.

### **Llojet dhe karakteristikat e kombeve multietnike**

● **Kombet multietnike** - janë kombe të prejardhura dhe të përbëra nga etni të ndryshme.

● **Kombet multietnike** - për vetë faktin se janë krijuar me marrëveshje politike mes etnive të ndryshme, quhen edhe **kombe politike dhe artificiale**.

---

<sup>116</sup> Nation: <https://de.wikipedia.org/wiki/Nation#KulturNation>

<sup>117</sup> Nation: <https://de.wikipedia.org/wiki/Nation#KulturNation>

● **Kombet multietnike** - për vetë faktin se janë krijuar me vullnetin e lirë të pjesëtarëve të etnive të ndryshme, quhen edhe **kombe të vullnetit të lirë**.

● **Kombet multietnike** - meqë janë krijuar mbi bazën e vlerave të përbashkëta politike të qytetarëve të etnive të ndryshme, quhen edhe **kombe qytetare**. Në qendër të kombeve qytetare nuk qëndron etnia, por qëndron qytetaria, kushtetuta, shteti, ligji. Shembull tipik i kombit qytetar është kombi francez i përshkruar nga Ernest Renan<sup>118</sup>

● **Kombet multietnike** - kur janë të krijuara nga banorë të etnive të ndryshme që jetojnë brenda një territori të caktuar, ato si të tilla quhen edhe **kombe territoriale**<sup>119</sup>.

● **Kombet-shtete** - janë të krijuara nga etni të ndryshme të cilat krijohen (legalizohen) si kombe me rastin e krijimit të shteteve të tyre po ashtu multietnike. Në literaturë thuhet se me rastin e krijimit të kombeve-shtete, ndodh shpërfillja e lidhjeve territoriale dhe e lidhjeve etnike të grupeve njerëzore. Edhe pse krijimi i kombeve-shtete është arsyetuar me emancipimin e etnive të vogla, krijimi i tyre ka rezultuar me asimilimin e etnive të vogla brenda etnive të mëdha<sup>120</sup>.

● **Krijimi i kombit-shtet francez** - ka qenë produkt i Revolucionit Francez (1789-1799). Parlamenti Kombëtar i Francës e ka krijuar kombin francez si komb-shtet, pjesëtarët e të cilit ndonëse të etnive të ndryshme, megjithatë kanë përqafuar rendin e përbashkët kushtetues dhe rendin demokratik të shtetit në formën e Republikës së Francës. Me rastin e krijimit të kombit-shtet francez, kombi francez dhe shteti francez kanë qenë sinonime mes tyre. Bazë për krijimin e kombit-shtet francez nuk kanë qenë konstruktet etnike të etnive të ndryshme, por kanë qenë idealet e përbashkëta të pjesëtarëve të etnive të ndryshme, të përmbledhura brenda sloganit: **Liri-Vëllazëri-Barazi**<sup>121</sup>.

● **Krijimi i kombit-shtet zviceran** - ka ndodhur për një kohë

---

<sup>118</sup> Ernest Renan, *Qu'est-ce qu'une nation?* (Paris: Calmann-Lévy, 1882), 27-29.

<sup>119</sup> Nation: <https://de.wikipedia.org/wiki/Nation>

<sup>120</sup> Nation: <https://de.wikipedia.org/wiki/Nation>.

<sup>121</sup> Nation: <https://de.wikipedia.org/wiki/Nation>.

të gjatë, duke iu bashkuar Konfederatës Zvicerane kanton pas kantoni, derisa janë bërë bashkë 26 kantone të ndryshme. Kombi-shtet zviceran është krijuar me vullnetin e lirë dhe jo me kartën e emancipimit dhe të asimilimit të etnive të katër grupeve popullore: gjermane, franceze, italiane dhe retro-romane, të cilat jehojnë së bashku në shtetin e përbashkët, të njohur si Konfederatë Zvicerane<sup>122</sup>.

● **Kombet multietnike** i kanë krijuar shtetet shumë-nacionale, Meqë meqë pakica e kombeve të botës janë kombe multietnie kjo ka bërë që pakica e shteteve të botës janë shtete shumë-nacionale.

### **Katër llojet e kombeve të tipizuara nga sociologu M. Rainer Lepsius**

Sociologu M. Rainer Lepsius në tipologjinë e tij të publikuar në vitin 1982, lidhur me vetitë strukturore dhe funksionale të kombeve, ka dalluar katër lloje kombesh:

- 1. Kombi etnik**, i cili e sheh veten si një bashkësi me prejardhje të njëjtë etnike;
- 2. Kombi kulturor**, që e sheh veten si bashkësi kulturore;
- 3. Kombi qytetar**, i cili bazohet në të drejtat individuale të njeriut dhe në procedurat demokratike të shtetit, siç është, p.sh., rasti me kombin amerikan, francez etj;
- 4. Kombi klasor** (i bazuar në idetë marksiste), të cilin përveç përkatësisë etnike, e karakterizon edhe përkatësia klasore e komunitetit kombëtar. Si i tillë, si komb klasor është konsideruar kombi gjerman në Gjermaninë Lindore<sup>123</sup>.

### **Kombet fetare/religjioze**

● **Kombet fetare/religjioze** - janë ato kombe të cilat më shumë se në elementin etnik apo qytetar, bazohen në elementin e tyre religjioz, përkatësisht bazohen në religjionin e pjesës pothuajse absolute të pjesëtarëve të tyre. Si kombe të tilla fetare konsiderohen, p.sh., populli i Iranit, i cili jeton si komb religjioz islamik brenda

<sup>122</sup> Nation: <https://de.wikipedia.org/wiki/Nation>.

<sup>123</sup> Zitiert nach Dieter Langewiesche: Nation, Nationalismus, Nationalstaat in Deutschland und Europa. C.H. Beck, München 2000, S. 39 f.

Republikës Islamike të Iranit<sup>124</sup>. Por si komb religjioz konsiderohet edhe popullsia e Tibetit, që jeton si popullatë budiste në Kinë. Dhe si komb religjioz konsiderohet edhe popullsia e Vatikanit, që jeton si komb katolik brenda shtetit katolik të Vatikanit.

### Kombet pa shtete

● **Është e njohur edhe kategoria e kombeve pa shtete. Komb pa shtet konsiderohet një grup etnik ose komb që nuk zotëron shtetin e vet sovran<sup>125</sup>. Grupi etnik ose kombi pa shtet e ka të drejtën për vetëvendosje: për ta krijuar shtetin e vet kombëtar të pavarur dhe qeverin e shtetit të vet<sup>126</sup>. Kombet pa shtete nuk përfaqësohen në organizatat ndërkombëtare<sup>127</sup>. Nocioni „kombe pa shtet“ është përdoruar për herë të parë në vitin 1983 nga politologu Jacques Leruez në librin e tij „L' Ecosse, une nation sans Etat“, në të cilin ka shkruar lidhur me pozicionin e Skocisë brenda Mbretërisë së Bashkuar. Më vonë nocioni „kombe pa shtete“ është përpunuar nga disa studiues Skocezë si David McCrone, Michael Keating dhe T. M. Devine<sup>128</sup>.**

● **Kombet pa shtet<sup>129</sup> -janë ato kombe të cilat kanë identitete etnike, gjuhësore dhe kulturore të veçanta por të cilat ende nuk i kanë krijuar shtetet e tyre kombëtare.**

● **Kombe pa shtete kondiderohen kurdët, palestinezët, baskët dhe katalanët në Spanjë, skocezët në Angli, tibetanët dhe ujgurët në Kinë, kashmirasit në Indi dhe Pakistan. Kombi më i madh pa shtet është kombi kurd me rreth 30 milionë banorë<sup>130</sup> i shpërndarë në disa shtete: Turqi, Irak, Siri dhe Iran.**

---

<sup>124</sup> Peter Alter: Nationalismus. Ein Essay über Europa. Alfred Kröner, Stuttgart 2016, S. f. 37.

<sup>125</sup> Dictionary Of Public Administration, U.C. Mandal, Sarup & Sons 2007, 505 p

<sup>126</sup> Stattlosen Nationen: Chouinard, Stéphanie (2016), „Stateless nations“, in Karl Cordell; Stefan Wolff (eds.), The Routledge Handbook of 3. Ethnic Conflict, Routledge, pp. 54–66, ISBN 9781317518921

<sup>127</sup> Ethnic Minority Media: An International Perspective, Stephen Harold Riggins, 217p.

<sup>128</sup> National Identity: Verdugo, Richard R.; Milne, Andrew (1 June 2016). National Identity: Theory and Research. IAP. p. 85. ISBN 9781681235257. Archived from the original on 4 April

<sup>129</sup> Stattlosen Nationen:

[https://www.google.com/search?q=Stattlosen+Nationen%C2%A0&scala\\_esv=217b1722850278e3&source=hp&ei=NYS0aM3zL\\_u5i-](https://www.google.com/search?q=Stattlosen+Nationen%C2%A0&scala_esv=217b1722850278e3&source=hp&ei=NYS0aM3zL_u5i-)

<sup>130</sup> Stattlosen Nationen: „Who are the Kurds?“. TRT World. Archived from the original on 8 July 2019. Retrieved 23 June 2018.

- Spahiu në kundërshtim me nocionin e kombeve pa shtet ka vite që nëpër debate televizive ka deklaruar se kombet bëhen kombe vetëm kur krijojnë shtetet e tyre. Në të kundërtën kombet derisa nuk kanë shtetet e tyre, ato nuk paraqesin komb, por paraqesin etni.
- Spahiu duke pasur parasysh se kurdët nuk kanë shtet të vetin kombëtar, është shprehur se ata nuk paraqesin komb kurd por etni kurde. Por kurdet kanë gene e janë thjesht një komb pa shtet i cili në të ardhmën do të bëhet një komb me shtet.
- Spahiu thotë se shqiptarët derisa Kosova ka qenë pjesë e Jugosllavisë, nuk kanë qenë komb shqiptar, por kanë qenë etni shqiptare, për të thënë se nga etnia shqiptare e Kosovës me rastin e pavarësimit të Kosovës, është krijuar “kombi kosovar”.
- Por shqiptarët derisa Kosova ka qenë pjesë e Jugosllavisë relaisht kanë paraqitur një komb pa shtet, i cili me rastin e pavarësimit të Kosovës, është bërë një komb shqiptar me shtet të Kosovës.

# 12

---

## **DALLIMET MES KOMBIT DHE SHTETIT DHE LLOJET E SHTETEVE**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit lidhur me dallimet mes kombit dhe shtetit dhe lidhur me llojet e shteteve. Spahiu duke mos përmendur dallimet mes shtetit dhe kombit, përpiket që shtetin e Kosovës ta identifikojë me kombin joekzistues “kosovar”, dhe jo me kombin ekzistues shqiptar.

Duke qenë kombi dhe shteti dy nocione më vete, ato nuk përputhen gjithnjë mes tyre. Kështu, Kosova paraqet shembullin e shtetit, ku emri i shtetit Kosovë nuk përputhet me emrin e kombit shumicë shqiptar, që ka jetuar dhe jeton në Kosovë shekuj me radhë.

Por duke qenë mospërputhja e emrit të kombit shqiptar dhe e emrit të shtetit të Kosovës, një mospërputhje formale dhe përmbajtësore, ajo si e tillë nuk paraqet pengesë as për shtetin e Kosovës dhe as për kombin shqiptar që jeton në Kosovë.

### **Dallimet kryesore mes shtetit dhe kombit**

- Edhe pse në pamje të parë duket sikur shteti dhe kombi janë dy gjera identike, megjithatë, ato dallohen në mes tyre.

### **Çka është shteti?**

- **Shteti** është një organizatë e madhe administrative dhe politike e institucionalizuar, që ushtron pushtet sovran mbi një territor

të caktuar dhe mbi popullsinë që jeton në atë territor, nëpërmjet aparatit ligjor, administrativ dhe ushtarak.<sup>131</sup>

● Karakteristikat e shtetit sipas Konventës së Monetvideos janë: **“Shteti si subjekt i së drejtës ndërkombëtare duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme: (a) një popullsi të përhershme; (b) një territor të përcaktuar; (c) një qeveri dhe (d) aftësinë për të hyrë në marrëdhënie me shtete të tjera.”**<sup>132</sup>

● Shteti duke qenë subjekt i të drejtës ndërkombëtare e ka të drejten e anëtarizimit në OKB<sup>133</sup>, merret me vendosjen e marrëdhënieve politike, ekonomike dhe kulturore me shtete tjera dhe ka për detyrë të i repektoj dhe zbatoj përcaktimet e Kartës së OKB-së.

● Mëtej shteti duke qenë koncept juridiko-politik ai merret me rregullimin e rendit politik dhe kushtetues të vendit: me judikativin, legjislativin dhe ekzekutivin e pavarur të shtetit<sup>134</sup>.

### **Çka është kombi?**

● **Kombi** është një bashkësi e madhe historike e njerëzve e lidhur ngushtë me elemente të përbashkëta siç janë: gjuha, kultura, traditat, kujtesa historike dhe ndjenja e identitetit kolektiv.

● Kombi duke mos qenë subjekt i të drejtës ndërkombëtare, ai nuk e ka të drejtën e anëtarësimit në OKB; nuk vendos marrëdhënie politike, ekonomike, tregtare dhe kulturore me shtete tjera, si dhe nuk është pjesë e organizatave ndërkombëtare politike, ekonomike, tregëtare etj.

● Kombi duke mos qenë koncept juridiko-politik ai nuk merret drejtpërdrejt me rregullimin e rendit politik dhe kushtetues të shtetit, por e ndihmon rendin politik dhe kushtetues të shtetit, duke iu nënshtruar rendit politik dhe kushtetues të shtetit

● Dhe kombi duke mos qenë koncept juridiko-politik nuk i referohet rendit juridik-politik, por i referohet bashkësisë identitare dhe kulturore.

---

<sup>131</sup> Max Weber, *Politics as a Vocation* (Munich: Duncker & Humblot, 1919), 78–79.

<sup>132</sup> Charter of the United Nations (San Francisco: United Nations, 1945), art. 4.

<sup>133</sup> Ernest Gellner, *Nations and Nationalism* (Oxford: Blackwell, 1983), 6–7.

<sup>134</sup> Anthony D. Smith, *Nationalism and Modernism* (London: Routledge, 1998), 57–63.

## **Identiteti i kombit nuk është domosdoshmërisht i njëjtë me identiten e shtetit**

● Të dhënat nga literatura flasin se në të shumtën e rasteve identiteti i kombit përrputhet me identitetin e shtetit, por ka edhe raste kur identiteti i kombit nuk përrputhet me identitetin e shtetit.

● Siç sqarova edhe më lart identiteti emërtor i kombit shqiptar që ka jetuar dhe jeton në Kosovë (për shkak të rrjedhave specifike historiko-politike nëpër të cilat ka kaluar Kosova) nuk përrputhet me identitetin emërtor shtetit të Kosovës: kombi quhet shqiptar, shteti quhet Kosovë. Por kjo mospërrputhje, siç kam sqaruar edhe më lart, duke qenë formale dhe jo përmbajtësore, nuk i sjell asgjë të keqe as shtetit të Kosovës dhe as kombit të saj shumicë shqiptar.

● Spahiu, duke mos e bërë dallimin komb-shtet është shprehur si më poshtë:

■ **Në qoftë se ekziston shteti i Kosovës ekziston kombi kosovar<sup>135</sup>. (min. 7:32 -7:34)**

● Lidhur me këtë thënie të Spahiut duhet sqaruar lexuesit se shteti i Kosovës ekziston, por “kombi kosovar” në Kosovë nuk ekziston, sepse thejshhtë në Kosovë ka pasur dhe ka komb shqiptar. Dhe me që në Kosovë ka pasur dhe ka komb shqiptar, nuk ka pasur e nuk ka nevojë që në Kosovë të ket një komb tjetër të paqenë dhe joshqiptar “kosovar”.

● Spahiu për ta përligjiur krijim-ekzistimin sipas tij të “kombit kosovar” ai thotë: meqë ekziston shteti i Kosovës ekziston edhe “kombi kosovar”, por ai me ekzistimin e shtetit të Kosovës nuk mund ta përligjë krijim ekzistimin e “kombit kosovar”, sepse ky komb as nuk ka ekzistuar dhe as nuk ekziston.

● Problematike është kur me shtetin identifikohet kombi i vogël sepse e ka pushtetin në duart e veta (identifikimi në të kaluarën i pakicës së bardhë me shtetin e Afrikës së Jugut) dhe mosidentifikimi me shtetin i kombi i madh (mosidentifikimi në të kaluarën i shumicës së zezë me shtetin e Afrikës së Jugut).

---

<sup>135</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiu  
“Valamala Show”, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

## **Kombi mundet me qenë më i madh se shteti**

● Nga ana tjetër, kombi mundet me qenë më i madh se shteti: derisa shteti ndodhet brenda kufijve të tij caktuar, kombi duke qenë më i madh se shteti, shtrihet edhe jashtë kufijve të shtetit. Kështu, kombi shqiptar duke qenë më i madh se shteti shqiptar i vitit 1913, më shumë se gjysma e tij është shtrirë jashtë Shqipërisë në Jugosllavi dhe Greqi.

● Nga pjesa e kombit shqiptar e mbetur jashtë Shqipërisë në vitin 2008 është krijuar shteti i Kosovës. Por meqë kombi shqiptar është më i madhe se Shqipëria dhe Kosova bashkë, ai sërish shtrihet edhe jashtë Kosovës dhe jashtë Shqipërisë: në Serbi, Maqedoni, Mal të Zi dhe në Greqi (krahina e Çamërisë).

## **Llojet e shteteve**

Në varësi nga kriteret e ndryshme në botë ekzistojnë shtete të ndryshme si më poshtë:

### **I.Llojet e shteteve sipas sovranitetit dhe sistemit politik**

**Shtetet unitare:** janë shtete me pushtet qendror të përqendruar (p.sh. Koreja Veriore etj.).

**Shtetet Federale:** janë shtete me ndarje pushtetit mes qendrës dhe njësive federale (p.sh. 16 Landet e Gjermanisë Federale).

**Shtetet Konfederale:** janë shtete me ndarje të pushtetit në mes të qendrës dhe njësive konfederative të shteti konfederal. Të tilla janë 51 shtetet e Shteteve të Bashkuara të Amerkës.

### **II. Llojet e shteteve sipas formës së regjimit**

**Shtetet Demokratike:** janë shtete në të cilat pushteti buron nga populli dhe në të cilat ekziston ndarja pushteteve (shumica e shteteve të Europës).

**Shtetet Autoritare:** janë shtete me përqendrim pushteti dhe kufizim të lirive politike (p.sh. disa shtete në Azi e Afrikë).

**Shtetet Totalitare:** janë shtete me kontroll të plotë mbi jetën shoqërore, politike dhe ekonomike (në të kaluarën Gjermania naziste, Bashkimi Sovjetik stalinist).

### **III. Llojet e shtetve sipas marrëdhënies me kombin**

**Shtetet-komb** – janë shtete në të cilat kufijtë e shtetit përkojnë përafërsisht me kufijtë e një kombi (p.sh. Portugalia, Japonia).

**Shtetet shumkombëshe:** janë shtete në të cilat bashkëjetojnë disa kombe ose etni të ndryshme (p.sh. Belgjika, Zvicra etj).

**Shtetet koloniale:** janë shtete të krijuara përmes vendimeve koloniale (p.sh. në të kaluarën shumë shtete afrikane).

#### **Lloje tjera të shteteve**

● Sipas një kalsifikimi tjetër ekzistojnë edhe llojr tjera të shteteve si më poshtë:

**Shtetet një-nacionale: Japonia, Polonia, Portugalia**

**Shtetet multinacionale: Zvicra, Belgjika, Kanada**

**Shtetet pa kombe unike: Ish-Jugosllavia, Bashkimi Sovjetik, Iraku, Nigeria**

● **Shtetet qytetare:** Në literaturë përmendet edhe shteti qytetar, që nënkupton shtetin e krijuar mbi bazën e qytetarëve të etnive të ndryshme, të unifikuar rreth shtetit të përbashkët sovran, nëpërmjet rregullave dhe ligjeve të caktuara kushtetuese, të vlefshme brenda një hapësire jetësore socio-psikologjike të caktuar<sup>136</sup>.

#### **Shtetet njënacionale**

● **Shteti nacional** - nënkupton shtetin brenda të cilit jeton vetëm një komb shumicë (monoetnik) dhe disa komunitete pakicë. Të tilla shtete njënacionale nuk janë vetëm Japonia, Polonia, Portugalia, por të tilla janë edhe shumica e shteteve të botës. Edhe Kosova dhe Shqipëria duke qenë të banuara nga i njëjti komb shumicë shqiptar dhe nga disa komunitete pakicë, janë shtete njënacionale.

#### **Shtetet shumnacionale**

● **Shteti multinacional** - nënkupton shtetin brenda të cilit jetojnë dy a më shumë kombe etnike shumicë të ndryshme. Të tilla shtete multinacionale nuk janë vetëm Zvicra, Belgjika dhe Kanadaja, por

---

<sup>136</sup> Benedickt Anderson: Wissenschaftliche Artikel - Anderson 1991, S. 6.

janë edhe disa shtete të tjera, që po ashtu përbëhen nga kombe shumicë të ndryshme dhe nga komunitete pakicë..

### Çka janë shtetet pa kombe unike?

● **Shtetet pa kombe unike** të cituara më lart, janë ato shtete që nuk kanë një komb të vetëm unik, por kanë disa kombe të ndryshme. Të tilla shtete kanë qenë Jugosllavia Federative, ish-Bashkimi Sovjetik, kurse aktualisht shtete të tilla janë Iraku dhe Nigeria.

**Jugosllavia Federative** - nuk ka pasur një komb unik jugosllav, por ka pasur gjashtë kombe të ndryshme dhe disa kombësi (pakica etnike).

**Ish-Bashkimi Sovjetik** - po ashtu nuk ka pasur një komb të vetëm unik sovjetik, por ka pasur shumë kombe të ndryshme.

**Iraku** - po ashtu nuk ka një komb unik irakian, por ka disa kombe shumicë: kombin arab që përbën rreth 70% të popullatës; kombin kurd që përbën rreth 20% të popullatës; kombin turkmen që përbën rreth 5% të popullatës etj.

**Nigeria** - po ashtu nuk ka një komb unik nigerian, por ka kombe të ndryshme: kombin **Hausa** që përbën rreth 55% të popullatës, kombet **Zarma** dhe **Songhai** që përbëjnë rreth 20% të popullatës, kombin **Taureg-Berber** që përbën rreth 9% të popullatës e kështu me radhë. Nigeria ka probleme të brendshme, sepse shteti është kryesisht në duart e kombeve Zarma dhe Songhai, që përbëjnë rreth 20% të popullatës, dhe fare pak është në duart e kombit më të madh Hausa, që përbën rreth 55% të popullatës së vendit.

### Pse ka dështuar krijimi i kombit jugosllav

Në Jugosllavinë Federative gjatë viteve '70-të të shekullit XX ka pasur përpjekje për krijimin e kombit jugosllav, në cilësinë e një kombi unik të Jugosllavisë. Por krijimi i kombit unik jugosllav ka dështuar, sepse gjashtë kombet e ndryshme të Jugosllavisë nuk kanë pranuar të tjetërsohen në një komb të përbashkët jugosllav.

## **Edhe përjekjet për krijimin e “kombi kosovar” janë të dështuara**

Edhe Spahiu, Matoshi e ndonjë tjetër përpiqen që nga shqiptarët e Kosovës dhe nga komunitetet pakicë që jetojnë në Kosovë të krijojnë një “komb kosovar” të vetëm dhe unik për shtetin e Kosovës. Por edhe krijimi i “kombit kosovar” është apriori e dështuar, siç ka qenë apriori i dështuar edhe krijimi i kombit jugosllav. Kjo sepse edhe me këtë rast as kombi shumicë shqiptar dhe as pakica kombëtare serbe, nuk do të pranojnë t’i sakrifikojnë identitetet e tyre kombëtare, për krijimin e një kombi të përbashkët “kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues.

# 13

---

## **NJË KOMB MUND TË JETË PRONAR I DY A MË SHUMË SHTETEVE TË BANUARA PREJ TIJ: KOMBI SHQIPTAR ËSHTË PRONAR LEGJITIM I DY SHTETEVE SHQIPTARE**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se pohimi i Spahiut, sipas të cilit një komb nuk mund të jetë pronar i dy a më shumë shteteve, nuk qëndron aspak. Kjo, sepse në botë ka pasur dhe ka edhe sot kombe, që kane qenë dhe janë pronare të dy a më shumë shteteve të pavarura, të banuara prej tyre.

### **Kombi shqiptar ka të drejtë të jetë pronar i dy shteteve shqiptare: Shqipëri - Kosovë**

Lidhur me pamundësinë që një komb të jetë pronar i dy a më shumë shteteve, Spahiu është shprehur si më poshtë:

■ **Nëqoftëse i kemi dy shtete kemi dy kombe, nëqoftëse e kemi ni shtet e kemi ni komb<sup>137</sup>. (min. 23:28-23:30)**

■ **Për mua osht e qartë se nuk mund të ket një komb që mund të jetë oshtë pronar i dy shteteve, sepse atëherë ato dy shtete nuk janë sovrane<sup>138</sup>. (min. 30:00 - 30:26)**

■ **Ni komb mundet me jetue domethon vetëm brenda ni**

---

<sup>137</sup> Debat i nxehtë "Kombi kosovar" me Nexhmedin Spahiun "Valamala Show", 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

<sup>138</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“ - Nexhmedin Spahiu dhe Ervis Iljazaj | ABC News Albania, 06.11.2021, <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

### **shteti<sup>139</sup>. (min. 22:45 -22:47)**

● Thënia e Spahiut e cituar më lart, sipas të cilës në qoftë se kemi dy shtete, kemi dy kombe, paraqet një përpjekje tjetër të tij, për t'i bindur (mashtruar) shqiptarët se, meqë Shqipëria dhe Kosova janë dy shtete, ato paraqesin edhe dy kombe të ndryshme: Shqipëria kombin shqiptar e Kosova “kombin kosovar”.

● Por edhe fëmijët e dinë se dy shtete paraqesin dy kombe të ndryshme, vetëm kur ato banojnë nga dy kombe të ndryshme, kurse Shqipëria dhe Kosova duke qenë të banuara nga i njëjti komb shumicë shqiptar, ato nuk paraqesin dy shtete të dy kombeve të ndryshme, por paraqesin dy shtete të të njëjtit komb shqiptar.

● Edhe dy pohimet tjera ë Spahiut të cituara më lart, sipas të cilave një komb nuk mund të ketë në pronësi dy a më shumë shtete dhe se një komb mundet të jetojë vetëm brenda një shteti, nuk qëndrojnë aspak. Kjo, sepse siç kemi sqaruar edhe më lart, si në të kaluarën, ashtu edhe tani, ka pasur e ka kombe që kanë qenë dhe janë pronare të dy a më shumë shteteve sovraane të banuara nga i njëjti komb.

● Kur Gjermania gjatë viteve 1945-1990 ka qenë e ndarë në dy shtete: në Gjermaninë Perëndimore dhe në Gjermaninë Lindore, pronar legjitim i të dy shteteve gjermane ka qenë kombi asokohe monoetnik gjerman, sepse ai ka paraqitur kombin shumicë në të dyja Gjermanitë. Kombi gjerman pikërisht sepse ka qenë pronar legjitim i dy Gjermanive, edhe i ka bashkuar ato dy Gjermani në vitin 1990 në një Gjermani të vetme Federale.

● Kur Vietnami gjatë viteve 1965-1975 ka qenë i ndarë në dy shtete: në Vietnam Verior dhe Vietnam Jugor, pronar legjitim i dy shteteve vietnameze ka qenë kombi monoetnik vietnamez, sepse ai ka paraqitur kombin shumicë në të dy Vietnamet. Kombi vietnamez pikërisht pse ka qenë pronar legjitim i të dy shteteve vietnameze, edhe i ka bashkuar ato në vitin 1975 në një Vietnam të vetëm.

● Koreja edhe pse që nga viti 1953 e këtej është e ndarë në dy shtete: në Kore Veriore dhe në Kore Jugore, megjithatë, pronar legjitim i këtyre dy shteteve koreane ka qenë dhe është kombi

---

<sup>139</sup> Nexhmedin Spahi; *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri” (Aktualitete - 30.03.2021) <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

korean, sepse ai paraqet kombin shumicë në të dy Koretë. Kombi korean pikërisht pse është pronar legjitim i të dy Koreve, ai një ditë edhe ka për t'i bashkuar dy Koretë në një Kore të vetme.

● Kombi arab duke jetuar në dhjetë e më shumë shtete arabe, është pronar legjitim i dhjetë e më shumë shteteve arabe, sepse ai në të gjitha këto shtete paraqet kombin shumicë. Kombi arab pikërisht pse është pronar legjitim i dhjetë e më shumë shteteve arabe, ai edhe mund t'i bashkojë ato në një shtet të vetëm federal ose konfederal arab.

● Edhe kombi shqiptar i ndarë në dy shtete: në Shqipëri dhe në Kosovë, është pronar legjitim i dy shteteve shqiptare: Shqipërisë dhe Kosovës, sepse ai paraqet kombin shumicë edhe në Shqipëri, edhe në Kosovë, dhe si i tillë e ka edhe të drejtën e patjetërsueshme, që në të ardhmen Shqipërinë dhe Kosovën t'i bashkojë në një shtet të vetëm kombëtar shqiptar.

● Spahiu duke thënë se një komb nuk mund të jetë pronar i dy shteteve, ai nuk e ka aspak hallin nëse një komb ka apo nuk ka të drejtë të jetë pronar i dy a më shumë shteteve, por hallin e ka gjatë: te “kombi kosovar”, ekzistencën e të cilit e propagandon pa asnjë fakt. Spahiut i duhet të thotë se një komb nuk mund të jetë pronar i dy shteteve, thjesht sa për të thënë se edhe kombi shqiptar nuk mund të jetë pronar i dy shteteve (Shqipëri dhe Kosovë), prandaj sipas tij kombi shqiptar duhet të ndahet në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”

### **Shtetet që janë pjesë e shteteve federale apo konfederale kanë sovranitet të kufizuar**

Spahiu për të na bindur se, nëse një komb bëhet pronar i dy shteteve, ato dy shtete nuk janë më sovrane, ai është shprehur si në vijim:

■ **Mund t'ketë një komb që është pronar i 50 shteteve, siç është kombi amerikan, ose kombi gjerman, por ato nuk janë shtete sovrane<sup>140</sup>. (min. 30:27 -30:35)**

---

<sup>140</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?” - Nexhmenin Spahiu dhe Ervis Iljazaj | ABC News Albania, 06.11.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

● Është e vërtetë se pronar i 50-të shteteve të Amerikës është kombi multietnik amerikan, por ato shtete nuk kanë sovranitet të plotë, por kanë sovranitet të kufizuar, sepse duke qenë të lidhura me njëra-tjetrën në një federatë shtetesh, një pjesë të sovranitetit të tyre e kanë të deleguar brenda sovranitetit të përbashkët federal të SHBA-së. Kështu, asnjëri nga 50 shtetet e Amerikës nuk mund të ndahet nga SHBA-ja, për të ekzistuar si shtet në vete, apo për t'iu bashkuar një shteti tjetër, pa pajtimin e të gjitha shteteve përbërëse të Amerikës.

### **Shtetet që nuk janë pjesë e shteteve federale apo konfederale kanë sovranitet të plotë**

● Por, ndërsa shtetet që janë në përbërje të shteteve federale apo konfederale kanë sovranitet të kufizuar, shtetet që nuk janë pjesë e shteteve federale ose konfederale kanë sovranitet të plotë. Këto shtete duke pasur sovranitet të plotë, ato nëpërmjet të vullnetit të lirë të shprehur me referendume popullore, mund t'i bashkohen shtetit tjetër të të njëjtit komb, duke realizuar kështu ëndrrën e bashkimit kombëtar.

● Kështu, edhe Shqipëria, edhe Kosova duke mos qenë në lidhje federale ose konfederale me shtete të tjera, si dhe duke qenë dy shtete të të njëjtit komb shqiptar, ato si të tilla me marrëveshje politike mund të bashkohen në një shtet të vetëm shqiptar, kuptohet jo aktualisht e për një kohë, por kur të krijohen rrethana të favorshme për bashkimin e tyre.

### **Pronar i shtetit të Kosovës është kombi shqiptar që ka krijuar shtetin e Kosovës**

Spahiu në vazhden të propagandimit të “kombit kosovar”, ndër të tjera ka thënë:

■ **Çdo shtet e ka pronarin e vet. Pronari i shtetit është kombi. Edhe nëqoftëse ne e kemi shpallë pavarësinë e Kosovës, shtetin e Kosovës, atëherë ne ekzistojmë si komb ... Derisa ekziston shteti i Kosovës ekziston kombi kosovar....në radhë të parë në kombin kosovar hyn ata që kanë luftue për me krijuar shtetin e Kosovës<sup>141</sup>. (min. 0:58-1:43)**

---

<sup>141</sup> Nexhmedin Spahiu në “Oksigjen”, pjesa e tretë, 23.09.2011:

● Është e vërtetë se çdo shtet ka pronarin e vet. Edhe shteti i Kosovës e ka pronarin e vet. Por pronar i shtetit të Kosovës nuk mund të jetë “kombi kosovar” joekzistues, por ka qenë dhe është kombi shqiptar ekzistues, i cili ka jetuar dhe jeton në Kosovë shekuj me radhë, dhe i cili e ka çliruar Kosovën në vitin 1999 dhe e ka bërë atë shtet në vitin 2008. Këtë e di shumë mirë Spahiu.

● Shqiptarët nuk e kanë krijuar shtetin e Kosovës për t’u tjetërsuar më pas në “komb kosovar”, por e kanë krijuar për të qenë ata që janë: komb shqiptar. Kombi shqiptar dhe shteti i Kosovës janë vlera ekuivalente të njëra-tjetrës. Ka shtet të Kosovës, sepse ka komb shqiptar, i cili Kosovën e ka bërë shtet. Dhe ka komb shqiptar, sepse ka shtet të Kosovës.

### **Kombi shqiptar është pronar i dy shteteve shqiptare: Shqipërisë dhe Kosovës**

● Spahiu po për të na bindur se shqiptarët e Kosovës i përkasin “kombit kosovar” dhe jo kombit shqiptar, ai është shprehur edhe si në vijim:

■ **Çdo shtet e ka pronarin e vetë. Kombi shqiptar osht pronar i Republikës Shqipërisë...kombi polak oshtë pronar i Republikës së Polonisë, kombi serb o pronar i Republikës Serbisë, pronar i Kosovës osht kombi kosovar<sup>142</sup>. (min. 47:07- 47:28)**

● Kombi shqiptar për vetë faktin se ekziston realisht dhe objektivisht dhe për vet faktin se e ka çliruar dhe pavarësuar Kosovën, ai e paraqet pronarin legal dhe legjitim të shtetit të Kosovës. Kështu, shqiptarët si komb janë pronarë të dy shteteve shqiptare: të shtetit të Shqipërisë dhe të shtetit të Kosovës. “Kombi kosovar” për vetë faktin se realisht dhe objektivisht nuk ekziston dhe për rrjedhojë edhe nuk e ka çliruar dhe pavarësuar Kosovën, ai edhe s’ka si të jetë pronar i shtetit të Kosovës.

● Nuk ekziston asnjë ligj ndërkombëtar, i cili ia ndalon një kombi, për të qenë ai pronar i dy ose më shumë shteteve. Kombi arab është pronar i më shumë se dhjetë shteteve të banuara me shumicë

---

<https://www.youtube.com/watch?v=D673tLZUdIE>

<sup>142</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri” (Aktualitete - 30.03.2021)  
<https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

kombëtare arabe. Këtë të drejtë kombit arab nuk ia ka kontestuar askush në botë.

\*\*\*

### **Ndarja territoriale e një kombi në disa shtete nuk është ndarje e tij në dy a më shumë kombe**

Një aspekt tjetër të cilin Spahiu e ka keqpërdorur për t'i bindur (për mua për t'i mashtruar) shqiptarët, sikur gjoja kombi shqiptar është i ndarë në dy kombe, ka të bëjë me fatkeqësinë historike ndarjes së kombit shqiptar në disa njësi territoriale të disa shteteve të ndryshme aneksuese ndaj tij. Kështu, ai ka shkruar si më poshtë.

■ **....shpesh e përdorim termin “komb i ndarë”. Harrojnë se komb i ndarë do të thotë dy kombe, sepse kombi është INTEGRUM, pra është i pandashëm. Nëse ndahet, më nuk është një komb<sup>143</sup>.**

● Sipas thënies së Spahiut të cituar më lart, del se kur ne shqiptarët themi **“Se jemi një komb i ndarë në dy pjesë”** (në Shqipëri dhe në Kosovë), ne harrojmë se nuk jemi më një komb, por jemi dy kombe: njëri komb shqiptar e tjetri “komb kosovar”, sepse kombi është një integrim i pandashëm.

● Por thënia e mësipërme e Spahiut nuk qëndron aspak, sepse ndarja territoriale e një kombi në dy a më shumë pjesë (në dy a më shumë territore shtetërore), nuk paraqet njëkohësisht edhe ndarjen e atij kombi në dy a më shumë kombe. Kështu, ndarja e kombit shqiptar në dy shtete shqiptare (Kosovë dhe Shqipëri), kombin shqiptar nuk e bën komb të ndarë në dy kombe: në komb shqiptar dhe “komb kosovar”, siç do të donte Spahiu.

● Nga ana tjetër, duke pasur parasysh se kombi shqiptar është i ndarë në gjashtë njësi territoriale (Shqipëri, Kosovë, vise shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi, në Serbi dhe Greqi), kjo sipas mendësisë së Spahiut do të thotë se kombi shqiptar është i ndarë në gjashtë kombe, gjë që nuk pajtohet as me logjikën më elementare.

● Se ndarja një kombit në dy a më shumë territore të shteteve të

---

<sup>143</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi 26 gusht, 2016. *Dritare net*: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

ndryshme, nuk do të thotë edhe ndarje e atij kombi në dy a më shumë kombe, flet sidomos rasti i kombit gjerman dhe vietnamez. Kombi gjerman në të kaluarën ka qenë i ndarë në dy territore të dy shteteve gjermane, por ai nuk ka qenë i ndarë në dy kombe dhe sot jeton si komb unik në Gjermaninë e bashkuar. Edhe kombi vietnamez në të kaluarën ka qenë i ndarë në dy territore të dy shteteve vietnameze, por ai nuk ka qenë i ndarë në dy kombe dhe sot jeton si komb unik në Vietnamin e bashkuar.

● Spahiu thotë se kur një komb jeton i ndarë në dy pjesë, p.sh., në dy territore të dy shteteve, ai nuk është më një komb, por është dy kombe, për të thënë se edhe kombi shqiptar meqë jeton i ndarë në dy territore të dy shteteve shqiptare (në Shqipëri dhe në Kosovë), ai nuk është më një komb i vetëm shqiptar, por është dy kombe: njëri shqiptar në Shqipëri dhe tjetri “kosovar” në Kosovë.

● Për mua është sa e tmerrshme, aq edhe e trishtueshme që Spahiu, fatkeqësinë historike të kombit shqiptar (atë të ndarjes së tij në gjashtë njësi territoriale të gjashtë shteteve të ndryshme), e shfrytëzon për shkaktuar një fatkeqësi tjetër edhe më të madhe të kombit shqiptar: atë të ndarjes së tij në dy kombe: njëri shqiptar në Shqipëri dhe tjetri “kosovar” në Kosovë.

● Por bota nuk është kurdisur sipas mendësive të Spahiut, por është kurdisur sipas mendësive, të cilat thonë se, edhe pse kombi arab jeton në dhjetë a më shumë shtete të Ligës Arabe, ai nuk paraqet dhjetë kombe të ndryshme, por paraqet të njëjtin komb arab.

● Kështu edhe kombi shqiptar, edhe pse është i ndarë territorialisht në gjashtë njësi të ndryshme shtetërore, paraqet të njëjtin komb shqiptar të ndarë në gjashtë njësi shtetërore të ndryshme.

## SHQIPTARËT E KOSOVËS JANË PJESËTARË TË KOMBIT SHQIPTAR, PA MARRË PARASYSH NËSE KANË APO NUK KANË PASAPORTË TË SHQIPËRISË

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se në kohët e kaluara, kur njerëzit kanë zotëruar vetëm pasaportën e shtetit ku kanë lindur dhe jetuar, pasaporta e ka pasur rolin e vet në përcaktimin kombëtar të individit apo të grupit. Por në kohët e sotme, kur njerëzit kanë dy a më shumë pasaporta të dy a më shumë shteteve, pasaporta e ka humbur rolin e saj në përcaktimin kombëtar të individit ose grupit.

● Spahiu lidhur me rëndësinë e pasaportës për përcaktimin e përkatësisë kombëtare të një individi, është shprehur si më poshtë:

■ **Me qenë pjesëtar i një kombi duhet mi pas tri kushtet të cilat kërkohen: me pas etninë që kërkohet, fenë që kërkohet edhe pasaportin që kërkohet. Për shembull: serbi n'Serbi e ka pasaportin serb, e ka fenë ortodokse, e ka etninë serbe, domethon ai i takon kombit serb. Por shqiptari e ka pasaportën serbe, për shembull ai i Preshevës, por as nuk e ka fenë ortodokse dhe nuk e ka as etninë serbe<sup>144</sup>. (min. 31: 30 -31:59)**

● Pajtohem me Spahiun se, për të qenë pjesëtar i një kombi, duhet

<sup>144</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio "Sharri" (Aktualitete - 30.03.2021)  
<https://www.youtube.com/watch?v=kzli8RjD70Q>

të kesh etninë përkatëse të atij kombi dhe fenë përkatëse të atij kombi, por jo domosdoshmërisht edhe pasaportën e shtetit të atij kombi. Kjo, sepse njerëzit në kohët e sotme duke pasur dy a tri pasaporta të dy a tri shteteve të ndryshme, pasaporta ka humbur rolin që ka pasur në të kaluarën, si element për përcaktimin kombëtar të individit apo të grupit.

● Pasaporta në kohët e sotme nuk e përcakton përkatësinë kombëtare të individit apo të grupit, por përcakton vetëm përkatësinë shtetërore të individit apo të grupit. Për shqiptarët në Luginën e Preshevës në jug të Serbisë, pasaporta e shtetit serb nuk përcakton përkatësinë kombëtare serbe të tyre, sepse ata etnikisht e kombëtarisht janë shqiptarë, por përcakton vetëm përkatësinë shtetërore të Serbisë që ata kanë.

● E njëjta gjë vlen edhe për shqiptarët në viset e tyre në Maqedoni: pasja e pasaportës të shtetit maqedonas nuk përcakton përkatësinë e tyre kombëtare maqedonase, sepse ata etnikisht dhe kombëtarisht janë shqiptarë, por përcakton vetëm përkatësinë shtetërore të Maqedonisë që ata kanë.

● Dhe e njëjta gjë vlen edhe për shqiptarët në viset e tyre në Mal të Zi: zotërimi i pasaportës të shtetit të Malit të Zi nuk përcakton përkatësinë e tyre kombëtare malaziase, sepse ata etnikisht dhe kombëtarisht janë shqiptarë, por përcakton vetëm përkatësinë shtetërore të Malit të Zi që ata kanë.

### **Shqiptari i Kosovës nuk i përket “kombit kosovar” joekzistues, por i përket kombit shqiptar ekzistues**

Spahiu duke teorizuar më tej lidhur me rolin e pasaportës në përcaktimin kombëtar, është shprehur edhe si më poshtë:

■ **Për me qenë komb kosovar ti duhet mi pas tri kushte: me qenë me etni shqiptar, me fe me qenë mysliman apo katolik, edhe e treta me pas pasaportën e Kosovës. Nëse nuk e ke pasaportën e Kosovës ti nuk mujsh me qenë komb kosovar<sup>145</sup>. (min. 49:41 – 50:09)**

---

<sup>145</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri” (Aktualitete - 30.03.2021)  
<https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd70Q>

● Lidhur me thënien Spahiut të cituar më lart, dua të sqaroj lexuesit se shqiptari i Kosovës që e ka etninë shqiptare, që ka njëren nga fetë e shqiptarëve dhe që ka edhe pasaportën e Kosovës, ai nuk i përket “kombit kosovar”, sepse ky komb realisht dhe objektivisht nuk ekziston në Kosovë, por i përket kombit shqiptar, sepse ky komb realisht dhe objektivisht ka ekzistuar dhe ekziston në Kosovë.

### **Fetë nuk paraqesin element të komb-ndërtimit**

● Feja ose fetë nuk paraqesin element të kombit, sepse feja/fetë dhe kombi/kombet janë dy gjëra te ndryshme: feja është fe e kombi është komb. Feja nuk identifikohet me kombin dhe as kombi nuk identifikohet me fenë.

● Kështu të qenët e shqiptarit me fe myslimane ose katolike, atë nuk e identifikon as me kombin ekzistues shqiptar dhe as me kombin fiktiv “kosovar”. Kjo, sepse të besimit mysliman dhe të besimit katolik nuk janë vetëm shqiptarët e Kosovës dhe të Shqipërisë, por janë edhe pjesëtarët e shumë kombeve të tjera në botë.

● Fetë paraqesin element komb-ndërtues vetëm për tri kombe fetare që ka bota: për kombin islamik të Iranit, për kombin katolik të Vatikanit, për kombin budist të Tibetit në Kinë. Për të gjitha kombet tjera fetë nuk paraqesin element komb-formues.

● Dhe Spahiu duke teorizuar edhe më tej lidhur me rolin e pasaportës në përcaktimin kombëtar, është shprehur edhe si në vijim:

■ **Kur shqiptari i Kosovës e ka etninë shqiptare, e ka njonën prej feve të shqiptarëve, mysliman apo katolik apo tjetër, por nëse nuk e ka pasportën e Shqipërisë, atij i mungon ni element me qenë komb shqiptar<sup>146</sup>. (49:20 - 49:37)**

● Lidhur me thënien Spahiut të cituar më lart, dua t’i sqaroj lexuesit, se shqiptari i Kosovës që ka etninë shqiptare dhe që ka njëren nga fetë e shqiptarëve, ai edhe nëse nuk ka pasaportën e Shqipërisë, i takon kombit shqiptar. Kjo, sepse kombit shqiptar nuk i përkasin vetëm shqiptarët e Shqipërisë që kanë pasaporta

---

<sup>146</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri” (Aktualitete - 30.03.2021)  
<https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

të shtetit të Shqipërisë, por i përkasin të gjithë shqiptarët kudo që janë: edhe ata që kanë pasaporta të shtetit të Kosovës, të Serbisë dhe të Malit të Zi.

● Sphiu nuk don të kuptoj se pasaporta nuk është element i kombit, por është kryekëput element i shtetit. Dhe Spahiu nuk don të kuptoj se feja, po ashtu (përveç në tri rste) nuk është element i kombit, por është kryekëput element i kulturës së një kombi.

● Meqë shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Luginës së Preshevës në jug të Serbisë nuk kanë pasaporta të Shqipërisë ata nuk janë shtetas të Shqipërisë, por ata edhe pse nuk kanë pasaporta të Shqipërisë, i përkasin kombit shqiptar njësoj si shqiptarët e Shqipërisë. Kjo, sepse shqiptarët, edhe pse jetojnë në disa shtete të ndryshme, kombin shqiptar e kanë komb të përbashkët.

● Nëse njëri nga tri kushtet për t'i takuar kombit shqiptar do të ishte vërtetë, edhe zotërimi i pasaportës të Shqipërisë, siç na thotë Spahiu, atëherë kombit shqiptar do t'i takonin vetëm shqiptarët Shqipërisë, sepse ata zotërojnë pasaporta të Shqipërisë, kurse shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Luginës së Preshevës në jug të Serbisë, meqë nuk zotërojnë pasaporta të Shqipërisë, nuk do t'i takonin kombit shqiptar.

● Dhe nëse shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe ata të Luginës së Preshevës në jug të Serbisë, që marrë së bashku paraqesin rreth gjysmën e kombit shqiptar nuk do t'i takonin kombit shqiptar, sepse nuk kanë pasaporta të Shqipërisë, atëherë shtrohet pyetja: *Cilit komb do t'i takonin ata?! Por, këta shqiptarë nuk duhet të brengosen se mund të mbeten pa komb, sepse duke qenë Spahiu e Matoshi specialistë për krijimin e kombeve të reja, ata ua gjejnë atyre ndonjë komb...!*

● Se pasaporta nuk paraqet element për përcaktimin kombëtar të individit ose të grupit, flet historia e dy shteteve gjermane dhe historia e dy shteteve vietnameze. Kështu, ndonëse gjermanët ndërsa kanë qenë të ndarë në dy shtete, kanë pasur pasaporta të ndryshme të dy shteteve të tyre, kjo nuk i ka bërë ata pjesëtarë të dy kombeve të ndryshme. Gjermanët edhe pse kanë pasur pasaporta të ndryshme të dy shteteve të tyre, megjithatë, i kanë takuar të njëjtit komb gjerman.

● E njëjta gjë vlen edhe për vietnamezët, të cilët ndërsa Vietnami ka qenë i ndarë në dy shtete, kanë pasur pasaporta të ndryshme të dy shteteve të tyre, por kjo nuk i ka bërë ata pjesëtarë të dy kombeve të ndryshme. Vietnamezët edhe pse kanë pasur pasaporta të ndryshme të dy shteteve të tyre, megjithatë i kanë takuar të njëjtit komb vietnamez.

● E njëjta gjë vlen edhe pjesëtarët e kombit shqiptar në Shqipëri dhe në Kosovë. Edhe ata, ndonëse kanë pasaporta të ndryshme të dy shteteve të tyre (Shqipëri-Kosovë), kjo nuk i bën ata pjesëtarë të dy kombeve të ndryshme, siç mund t'i duket Spahiut.

● Spahiu duke e bërë posedimin/mosposedimin e pasaportës njërin nga tri elementet vendimtare për përcaktimin e përkatësisë kombëtare të individit ose të grupit, dëshiron të na thotë tri gjëra: **E para**, dëshiron të na thotë se shqiptarët e Kosovës edhe pse kanë prejardhje etnike shqiptare, edhe pse e kanë njërin nga tri fetë e shqiptarëve, ata për vetë faktin se nuk posedojnë pasaporta të shtetit të Shqipërisë, nuk i përkasin kombit shqiptar, por i përkasin “kombit kosovar”.

**E dyta**, dëshiron të na thotë se, meqë shqiptarët e Kosovës zotërojnë pasaporta të Kosovës, ata i përkasin “kombit kosovar” dhe jo kombit shqiptar. Spahiu dëshiron që pasaportën e Kosovës ta bëjë element vendimtar të përkatësisë “kombëtare kosovare”, gjë që nuk shkon.

**Dhe e treta**, Spahiu dëshiron të na thotë se, meqë shqiptarët e Shqipërisë, përveç etnisë shqiptare dhe njëres nga tri fetë e shqiptarëve, zotërojnë edhe pasaportat e shtetit të Shqipërisë, ata janë të vetmit që i përkasin kombit shqiptar, gjë që nuk qëndron aspak.

● Kësisoj, Spahiu shqiptarët i ndan në dy kombe të ndryshme në varësi të pasaportës. Nëse kanë pasaportën e Shqipërisë, ata sipas tij i përkasin kombit shqiptar, kurse nëse kanë pasaportën e Kosovës, ata, sipas tij, i përkasin “kombit kosovar”. Kështu, del se në përcaktimin e përkatësisë kombëtare të një individit ose të një grupi, më e rëndësishme është pasaporta sesa prejardhja etnike, gjuha, historia dhe kultura, gjë që nuk pajtohet as me logjikën më elementare.

- Duke pasur parasysh sa u tha më lart, dua të konkludoj se shqiptarët janë pjesëtarë të të njëjtit kombi shqiptar, pa marrë parasysh se çfarë pasaporte kanë: të Kosovës, të Shqipërisë, të Maqedonisë, të Malit të Zi, apo të Serbisë.
- Ajo që duhet ta kuptojnë lexuesit, është se pasaporta nuk paraqet element të kombit, por paraqet element të shtetit. Pasaporta përcakton përkatësinë shtetërore të individit apo të grupit, por nuk përcakton përkatësinë kombëtare të individit apo të grupit.
- Është interesante se jo vetëm te Spahiu, por edhe në literaturë kam hasur autorë, të cilët duke qenë konfuzë, herë kanë shkruar se pasaporta përcakton përkatësinë shtetërore të individit e herë kanë shkruar se pasaporta përcakton përkatësinë kombëtare të individit.
- Spahiu, për t'i bindur shqiptarët e Kosovës se nuk i përkasin kombit shqiptar, por i përkasin “kombit kosovar”, ka bërë e bën lojëra të ndryshme. Loja me pasaportën paraqet njëren nga lojërat e shumta që ka bërë.

# **PJESA E KATËRT**

## **KEQPËRDORIMI I PARIMEVE TË REVOLUCIONIT FRANCEZ PËR KOMBIN, NË FUNKSION TË PROPAGANDIMIT TË GJOJA KRIJIM-EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se si Nexhmedin Spahiu, edhe duke keqpërdoruar parimet e Revolucionit Francez (1789-1799), është përpjekur që t'i bindë (për mendimin tim që t'i mashtrojë) shqiptarët e Kosovës, se ata pas çlirimit dhe pavarësisht të Kosovës veç janë tjetërsuar në “komb kosovar”, ose duhet të tjetërsohen patjetër në “kombit kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues. Por, ndërsa Revolucioni Francez i viteve 1789-1799 dhe Revolucioni Shqiptar i viteve 1998-1999 në pamje të jashtme mund të duken si dy gjëra të njëjta, në pamje të brendshme (në brendi) paraqesin dy gjëra të ndryshme.

### **Dallimet mes Revolucionit Francez dhe të Revolucionit Kombëtar në Kosovë**

Ndërsa në kapitullin pararendës kam renditur pesë dallime kryesore mes teorive franceze dhe gjermane për kombin, në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit lidhur me dallimet mes Revolucionit Francez të viteve 1789-1799, dhe të Revolucionit Shqiptar të Kosovës të viteve 1998-1999, që nënkupton Luftën Çlirimtare të Kosovës gjatë viteve 1998-1999.

### **Dallimi i parë:**

- Revolucioni Francez duke qenë një revolucion shoqëror, ka pasur për qëllim ndërrimin e sistemit shoqëror të Francës nga monarki absolute në sistem republikan demokratik.
- Revolucioni shqiptar në Kosovë i viteve 1998-1999 duke qenë një revolucion kombëtar, ka pasur për qëllim çlirimin e pjesës së kombit shqiptar në Kosovë, pavarësimin e Kosovës dhe, sipas mundësive, edhe bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.

### **Dallimi i dytë:**

Qëllimet e Revolucionit Francez për vendosjen e drejtësisë politike dhe sociale brenda shtresave të ndryshme të kombit francez dhe për zëvendësimin e sistemit monarkik me sistemin republikan demokratik, janë arritur duke luftuar masat popullore revolucionare franceze kundër “armikut të brendshëm”, përkatësisht kundër forcave monarkiste të Luigjit XVI.

- Qëllimet e Revolucionit Shqiptar të Kosovës për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës, janë arritur duke luftuar shqiptarët e Kosovës kundër armikut të jashtëm: kundër forcave okupatore serbe.

### **Dallimi i tretë:**

- Duke qenë Revolucioni Francez një revolucion shoqëror, ai nuk ka rezultuar me çlirimin e kombit francez dhe të Francës nga ndonjë armik i jashtëm, por ka rezultuar me konsolidimin e kombit francez si komb multi-etnik, dhe me konsolidimin e Francës si shtet Republikan Demokratik.
- Revolucioni shqiptar në Kosovë duke qenë Revolucion Kombëtar, ka rezultuar me çlirimin dhe konsolidimin e pjesës së kombit shqiptar në Kosovë si komb mono-etnik shqiptar, dhe me krijimin e shtetit të Kosovës për herë të parë në histori.

### **Dallime që tregojnë se me parimet e Revolucionit Francez nuk mund të përligjet krijimi i “kombit kosovar”**

- Këto tri dallime të këtyre dy revolucioneve tregojnë se ato në brendi kanë qenë të ndryshme dhe se mes tyre nuk mund të vihet shenja e barazimit. Këto tri dallime tregojnë se rrjedhat dhe rezultatet e njërit revolucion nuk janë të njëjta me rrjedhat dhe rezultatet e revolucionit tjetër.

● Spahiu në debate televizive përpiqet që t'i bindë shqiptarët e Kosovës, se ashtu siç Revolucioni Francez që ka rezultuar me konsolidimin e kombit multietnik francez si komb politik dhe artificial, edhe revolucioni shqiptar në Kosovë ka rezultuar me krijimin dhe konsolidimin e një "kombi kosovar" si komb politik dhe artificial.

● Por duke qenë revolucioni shqiptar Revolucion Kombëtar, dhe duke qenë se shqiptarët e Kosovës janë pjesë e kombit monoetnik shqiptar, në Kosovë ka ndodhur konsolidimi i mëtejshëm i kombit ekzistues shqiptar, dhe nuk ka ndodhur krijimi i një kombi tjetër joshqiptar, të cilin Spahiu e quan "komb kosovar".

● Prandaj Spahiu kot përpiqet që, nëpërmjet të manipulimeve me Revolucionin Francez dhe teoritë franceze për kombin, shqiptarët e Kosovë t'i bindë që ata, pas çlirimit dhe pavarësisht Kosovës, të tjetërsohen nga komb etnik shqiptar në "komb kosovar" politik dhe artificial.

\*\*\*

### **Periudha e krijimit të kombeve në radhë të parë ka pasur të bëjë me Revolucionin Industrial**

Spahiu për të na bindur se periudha e krijimit të kombeve ka filluar me Revolucionon Francez, është shprehur edhe si në vijim.

■ **Periudha e krijimit të kombeve ka fillue me Revolucionin Francez dhe ajo oshtë akoma, quhet periudha e kombeve, akoma osht periudha e modernitetit. A ndodh ndonjë revolucion tjetër n'botë, kjo mbetet me u pa..... Prej revolucionit francez e këndeje numri i kombeve në botë shtohet. Para 50 viteve jonë kon vetëm 50 kombe, tash janë...**<sup>147</sup>. (min. 59:05 - 100:10)

● Thënia e mësipërme e Spahiut, se periudha e formimit të kombeve ka filluar me Revolucionin Francez, ka kohë që është bërë pjesë e vlerësimit të Revolucionit Francez nga historianë të shumtë. Por, në të vërtetë, fillimi i krijimit të kombeve më shumë

---

<sup>147</sup> Debati i nxehtë "Kombi kosovar" me Nexhmedin Spahiun, *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

se produkt i Revolucionit Francez, ka qenë produkt i **Revolucionit Industrial** të ndodhur në shtetet e Europës dhe në Amerikë gjatë shekujve XVII, XVIII dhe XIX, revolucion ky që është shoqëruar me fuqizimin e ideve shoqërore dhe kombëtare.

● Se krijimi i kombeve dhe i shteteve në radhë të parë ka pasur të bëjë me Revolucionin Industrial, për këtë flet edhe fakti, se edhe vetë Revolucioni Francez ka qenë produkt i Revolucionit Industrial dhe jo e kundërta. Pa Revolucion Industrial nuk do të kishte Revolucion Francez, dhe pa këtë të fundit nuk do të kishte krijim të kombeve të reja dhe krijim të shteteve të tyre me sisteme republikane demokratike.

### **Kombet nuk janë krijuar vetëm sipas sloganit të Revolucionit Francez: *Liri-Vëllazëri-Barazi***

Spahiu për të na bindur se kombet janë krijuar vetëm sipas sloganit të Revolucionit Francez: *Liri-Vëllazëri-Barazi (Liberte-Fraternite-Egalite)*, ka shkruar edhe si në vijim:

■ **Sllogani “ Liberte-Fraternite- Egalite “ (Liri- Vëllazëri - Barazi), në të vërtetë paraqet formulën e kombit. Pjesëtarët e një kombi janë ata të cilët mes vete konsiderohen vëllezër, të lirë dhe të barabartë<sup>148</sup>.**

■ **Konceptin e kombit e ka paraqitur sllogani i Revolucionit Francez: Liberte - Egalite - Fraternite, që do të thotë Liri-Barazi-Vëllazëri<sup>149</sup>. (min. 6:08 - 6:13)**

### **Slogani i Revolucionit Francez ka dhënë vetëm konceptimin e krijimit të kombeve multietnike**

● Nga thënie e mësipërme e Spahiut të cituara më lart, del se slogani i Revolucionit Francez: *Liri-Barazi-Vëllazëri*, paraqet konceptin dhe formulën e vetme të krijimit të kombeve.

● Por, duke qenë Revolucioni Francez një revolucion me bazë politike dhe sociale dhe jo me bazë etniko-kombëtare, slogani

<sup>148</sup> Nga Nexhmedin Spahiu: Koncepti i kombit; Posted on december 15, 2015: <https://atunispoetry.com/2015/12/15/koncepti-i-kombit-nga-nexhmedin-spahiu/>

<sup>149</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“ - Nexhmedin Spahiu dhe Ervis Iljazaj; “ABC News Albania”, 06.11.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

i tij ka paraqitur kryesisht konceptin dhe formulën e krijimit të kombeve multietnike, politike dhe artificiale, siç janë kombi multietnik francez, amerikan, kanadez, zelandez, anglez, brazilian, turk e të tjerë.

● Por slogani *Liri-Barazi-Vëllazëri* i Revolucionit Francez nuk ka paraqitur konceptin e krijimit të kombeve monoetnike. Kjo, sepse kombet monoetnike duke u krijuar nëpërmjet revolucioneve kombëtare, në bazën e krijimit të tyre në radhë të parë kanë pasur konceptin e çlirimit të kombeve nga shtetet okupatore dhe konceptin e bashkimit të pjesëve të ndara të të njëjtit komb brenda një shteti të përbashkët.

● Mbi bazën e konceptit të çlirimit dhe të bashkimit kombëtar që buron nga teoritë gjermane për kombin, është krijuar kombi monoetnik gjerman në vitin 1871, duke themeluar ai Monarkinë Kushtetuese Gjermane. Kështu është krijuar edhe kombi monetnik italian, po ashtu në vitin 1871, duke themeluar ai Monarkinë Kushtetuese Italiane, si dhe janë krijuar edhe shumë kombe të tjera monetnike, përfshi këtu edhe krijimin përgjysmë të kombit shqiptar dhe të shtetit shqiptar në vitet 1912-1913.

● Spahiu duke thënë se kombet janë krijuar vetëm sipas konceptit të sloganit *Liri-Barazi-Vëllazëri* të Revolucionit Francez, ai dëshiron t'i bindë shqiptarët e Kosovës, se ashtu siç koncepti i sloganit *Liri-Barazi-Vëllazëri* i Revolucionit Francez ka çuar në krijimin e kombit francez multietnik politik dhe artificial, edhe revolucioni i tyre (lufta çlirimtare e viteve 1998-1999) ka çuar në krijimin e një "kombi kosovar" politik dhe artificial.

● Por duke qenë shqiptarët e Kosovës pjesë e kombit monoetnik shqiptar dhe duke qenë revolucioni i tyre i luftës çlirimtare një revolucion kombëtar, nga shqiptarët e Kosovës ka qenë e pamundur që të krijohet një komb tjetër joshqiptar, të cilin Spahiu e quan "komb kosovar" politik dhe artificial.

● Spahiu pikërisht për të thënë se pas pavarësimit të Kosovës, nga shqiptarët e Kosovës, sipas tij, është krijuar një komb tjetër "kosovar", ai konceptin e krijimit të kombeve e lidh vazhdimisht dhe vetëm me sloganin *Liri-Barazi-Vëllazëri* të Revolucionit Francez, por nuk e lidh konceptin e krijimit të kombeve monoetnike

me revolucione kombëtare (me luftëra të kombeve për çlirim dhe bashkim kombëtar).

### **Roli i revolucioneve kombëtare në krijimin e kombeve dhe të shteteve**

- Revolucionet Kombëtare të realizuara sipas konceptit të luftërave për çlirim e bashkim kombëtar, gjatë gjithë historisë kanë pasur rolin tyre të pazëvendësueshëm në krijimin e kombeve dhe të shteteve.
- Siç u tha edhe më lart, me revolucione të tilla kombëtare, në vitin 1871 është krijuar dhe bashkuar kombi dhe shteti gjerman, dhe po në vitin 1871 është krijuar dhe bashkuar kombi dhe shteti italian, kurse në vitin 1912 është bashkuar përgjysmë kombi shqiptar dhe është krijuar gjysmë-Shqipëria e Konferencës së Londrës e vitit 1913. Me revolucion të tillë kombëtar është çliruar dhe pavarësuar edhe Kosova. Dhe me revolucione të tilla kombëtare janë krijuar edhe shumica e kombeve monoetnike të botës, bashkë me shtetet e tyre, po ashtu monoetnike.
- Krijimi i kombeve monoetnike me revolucione kombëtare (me lufta çlirimtare), ka rrjedhur gjithnjë në përputhje me teorinë gjermane për kombin, sipas të cilave kombi është një bashkësi njerëzore me prejardhje të përbashkët etnike dhe që ka një histori, një gjuhë dhe një kulturë të përbashkët për të gjithë pjesëtarët e tij.

# 16

---

## **KEQPËRDORIMI I PARIMIT TË TEORIVE FRANCEZE, SIPAS TË CILIT ETNIA DHE KOMBI JANË DY GJËRA TË NDRYSHME, NË FUNKSION TË PROPAGANDIMIT TË GJOJA KRIJIM-EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”**

Në kapitullin 10 të këtij libri lexuesit janë sqaruar se përkufizimi i teorive franceze, sipas të cilit etnia dhe kombi janë dy gjëra të ndryshme, vlen për kombet multietnike, sepse me rastin e krijimit të tyre, etnitë komb-krijuese mbeten të pandryshueshme dhe të njëjta, kurse kombi i krijuar prej tyre është një komb ri multietnik, i cili nuk identifikohet me etnitë komb-krijuese.

Nga ana tjetër, në kapitullin 9 të këtij libri lexuesit janë sqaruar se parimi i teorive franceze, sipas të cilit etnia dhe kombi janë dy gjëra të ndryshme, nuk vlen për kombet monoetnike, sepse te këto kombe etnia dhe kombi janë dy gjëra të njëjta, gjë përputhet me teorinë gjermane për kombin.

Pse Spahiu nëpër debate televizive është shprehur vazhdimisht, se etnia dhe kombi janë dy gjëra të ndryshme, edhe pse te kombet monoetnike etnia dhe kombi paraqesin dy gjëra të njëjta? Spahiu është shprehur vazhdimisht, se etnia dhe kombi janë dy gjëra të ndryshme, sa për të thënë se nga etnia shqiptare, me rastin e pavarësisht të Kosovës, është krijuar një komb tjetër joshqiptar “kosovar”, i cili është i ndryshëm nga etnia shqiptare prej së cilës është krijuar.

## **Te kombet monoetnike nuk ekziston dallimi etni-komb:**

### **Etnia dhe kombi janë dy gjëra të njëjta**

Moderatori i një televizioni nga Shqipëria (z. Adi Krasta) duke intervistuar Spahiun lidhur idenë e “kombit kosovar”, i është drejtuar atij me pyetjen si në vijim:

■ **Të pretendohet që ka një komb kosovar, pra që ka një komb shqiptar, por ka edhe një komb kosovar, a nuk është në vetvete një lloj ideje gjithsesi ndarëse, me një lloj rrezikshmërie të veçantë, për të shkaktuar një lloj prishje të kohezionit, që shqiptarët e kanë pasur gjatë gjithë historisë së tyre të mbijetesës?<sup>150</sup>. (min. 1:15 - 1:37)**

● Spahiu kësaj pyetjeje i është përgjigjur me stereotipet e tij të përsëritura shumë herë si në vijim:

■ **Po, por kjo rrjedhë nga moskuptimi i asaj se çfarë është komb. Në fakt kur përmendet fjala komb shumica absolute e shqiptarëve e nënkuptojnë fjalën etni dhe nuk bëjnë ndonjë dallim, madje edhe në qarqe akademike, njerëz me tituj shkencor, që po t’i pyesish se ku osht dallimi mes etnisë dhe kombit, ata fare nuk din ta bëjnë këtë dallim. (min. 1:49 -2:60) ...shumë media në vend që ta fokusojnë problemin aty ku osht, për ta ndiçuar, për t’i dhënë shikuesit një qasje në njohuritë që do të duhej t’i kishte çdo shoqëri normale, ma tepër merren me denigrimin e atyre personave, të cilët nxisin çështje, të cilat duhet të janë çështje normale debati...<sup>151</sup>. (min. 2:60 - 3:14)**

● Përgjigjja e Spahiut se shqiptarët, përfshirë edhe akademikët, nuk e dinë dallimin mes etnisë dhe kombit nuk qëndron. Akademikët shqiptarë nuk e bëjnë dallimin etni-komb, sepse e dinë se te kombet monoetnike, siç është edhe kombi shqiptar, dallimi etni-komb nuk ekziston, gjë përputhet me teoritë gjermane për kombin, adekuate për përshkrimin e kombeve monoetnike.

● Por Spahiu për thënë se pas çlirimit dhe pavarësismit të Kosovës nga etnia shqiptare është krijuar një komb tjetër “kosovar”, dallimi

---

<sup>150</sup> *Shqiptarët me dy kombe, kombi kosovar*; Adi Krasta në “A Show”, Nexhmedin Spahiu, *Syri TV*, 16.03.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=n02HRe4sAKc>

<sup>151</sup> *Shqiptarët me dy kombe, kombi kosovar*; Adi Krasta në “A Show”, Nexhmedin Spahiu, *Syri TV*, 16.03.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=n02HRe4sAKc>

etni-komb i duhet shumë dhe përpiqet ta gjejë edhe aty ku ai nuk është: te kombi monoetnik shqiptar. Kjo është arsyeja pse Spahiut përkufizimi i teorive franceze, sipas të cilit etnia dhe kombi janë dy gjëra të ndryshme, i pëlqen shumë, kurse përkufizimi i teorive gjermane, sipas të cilave etnia dhe kombi paraqesin dy gjëra të njëjta, nuk i pëlqen aspak.

● Por unë nuk jam fajtor pse duke qenë kombi shqiptar, përfshirë edhe pjesën e tij në Kosovë, një komb monoetnik, me ç'rast etnia dhe kombi shqiptar paraqesin dy gjëra të njëjta, kjo ka bërë që as para dhe as pas pavarësimit të Kosovës, nga pjesa e kombit monoetnik shqiptar në Kosovë, të mos mund të krijohet një komb tjetër i ri “kosovar”.

● Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se, ashtu siç në arën e mbjellë me grurë nuk mund të mbijnë kallinj thekre, por mbijnë kallinj gruri, edhe nga etnia shqiptare në Kosovës, derisa ajo nuk është përzier me martesë reciproke me ndonjë etni/komb tjetër, ka mundur të “mbijë” kombi shqiptar dhe jo një komb tjetër “kosovar”.

### **Te kombet multietnike ekziston dallimi etni-komb:**

#### **Etnia dhe kombi janë dy gjëra të ndryshme**

Spahi, duke u bazuar në teorinë franceze për kombin, ka thënë më tej si në vijim:

■ **Etnitë janë krijesa të Zotit, sepse gjuha, gjaku nuk e përcakton ti. N'momentin kur ti ke lind nga një nanë shqiptare dhe nga një babë shqiptar ti je shqiptar, jetove në Australi, në Kosovë, Shqipri, në hanë, kurse kombi osht një produkt politik<sup>152</sup>. (min. 18:51-19:16)**

● Përkufizimi i teorive franceze, sipas të cilit etnia dhe kombi janë dy gjëra të ndryshme, vlen për kombet multietnike, sepse këto kombe janë krijuar si kombe të reja me marrëveshje politike nga etni të ndryshme dhe, për rrjedhojë, ato si të tilla ndryshojnë nga etnitë-kombkrijuese. Kështu, derisa etnitë komb-krijuese të kombeve multietnike mbeten të pandryshuara (konstante), kombet

---

<sup>152</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?” - Nexhmenin Spahi dhe Ervis Iljazaj, *ABC News Albania*, 06.11.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

multietnike të dala prej tyre janë kombe të reja, që ndryshojnë nga etnitë prej të cilave janë krijuar.

● Por, siç u cek edhe më lart, te kombet monoetnike etnia dhe kombi vërtet janë dy gjëra të njëjta, sinonime. Kjo, sepse ato duke u krijuar nga një etni e vetme, edhe identifikohen me atë etni të vetme komb-krijuese, kuptohet nëse kjo e fundit nuk është përzier etnikisht me martesë të përziera me etni/kombe të tjera.

### **Shqiptarët në Kosovë etnikisht dhe kombëtarisht janë shqiptarë**

Spahiu duke teorizuar për kombin, në një intervistë televizive ka thënë edhe si më poshtë:

■ **Sëpari konfuzioni osht krijue jo vetëm te na në Kosovë por në të gjitha vendet ish socialiste nga koncepti i Stalinit, i cili kombin e ka njësuë me etninë... Do të thotë komb u quajt diçka që osht etni. Definicioni i etnisë oshtë diçka që ka të baj me prejardhjen, me gjuhën, me gjakun. N'qoftëse e ke babën shqiptar, nanën shqiptare, atëherë ti automatikisht je me etni shqiptare, dhe ti pavarësisht se ku jeton je etnikisht shqiptar, atë e ka përcaktue biologjia. Kurse kombi është konstrukt politik, kombi asht bashkësia e hisedarëve që e kanë në pronësi shtetin. Për kombin osht një definicion pak ma ndryshe, natyrisht ka me qindra definicione<sup>153</sup>. (min. 4:05-4: 56)**

● Spahiu në thënien e tij të cituar më lart na thotë se është koncepti i Stalinit për kombin, i cili duke e njësuar etninë me kombin, ka shkaktuar konfuzion jo vetëm në Kosovë, por edhe në të gjitha vendet ish-komuniste. Por në vendet ish-komuniste nuk është mësuar vetëm teoria e Stalinit për kombin, por janë mësuar edhe teoritë e filozofëve gjermanë për kombin, të cilat po ashtu e njësojnë etninë me kombin.

● Por Spahiu nuk thotë se teoritë e filozofëve gjermanë kanë shkaktuar konfuzion lidhur me raportin etni-komb, sepse me emrat e filozofëve gjermanë ai nuk mund të etiketojë askënd, por

---

<sup>153</sup> Nexhmedin Spahiu në "Oksigjen", pjesa e tretë, 23.09.2011:  
<https://www.youtube.com/watch?v=D673tLZUDIE>

thotë se koncepti i Stalinit për kombin ka shkaktuar konfuzion, sepse me emrin e Stalinit ai shpreson t'i etiketojë dhe frikësojë kundërshtarët e idesë së tij, për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

● Por, duke pasuar parasysh se shqiptarët janë një komb monoetnik, që nuk është përzier me martesë me kombe të tjera, ata duke qenë etnikisht shqiptarë, janë njëkohësisht edhe kombëtarisht shqiptarë kudo që jetojnë, gjë që përputhet me parimet e teorive gjermane për kombin, sipas të cilave dallimi etni-komb kur është fjala për kombet etnike nuk ekziston, dhe sipas të cilave kombi paraqet një konstrukt etnik dhe kulturor specifik.

### **Elitat shqiptare e kanë të qartë se nga kombi monoetnik shqiptar nuk mund të krijohet një komb tjetër “kosovar”**

Spahiu për elitën e Prishtinës dhe të Tiranës ka shkruar si më poshtë:

■ **Jo, kombi kosovar osht krijuar, por për teorinë e kombit janë të pakt ata që din në shoqërinë shqiptare dhe në shoqërinë kosovare. Në Shqipëri dhe n’Kosovë ...domethon kombi osht thjeshtëzuar, domethon osht barazue etnia me kombin edhe këto janë krijue si sinonime<sup>154</sup>. (min. 42:56 -43:01)**

■ **N’Shqipri dhe n’Kosovë kombi osht thjeshtëzuar, domethon kombi osht shpjegue në mënyrë të thjeshtëzuar, domethon osht barazue etnia me kombin edhe këto janë krijue si sinonime. Madje edhe n’Akademi t’ Shkencave po t’shkosh e t’pysësh t’Shqiprisë ose t’Kosovës, nuk e din dallimin...<sup>155</sup>. (min. 43:39 - 44:00)**

● Spahiu nëpërmjet thënieve të tij të mësipërme përçmon elitën shqiptare të Prishtinës dhe të Tiranës si elita të paditura, të cilat sipas tij ende nuk e dinë dallimin mes etnisë (në rastin konkret të etnisë shqiptare) dhe të kombit (në rastin konkret të kombit shqiptar), dhe duke e barazuar etninë me kombin dhe anasjelltas kombin me etninë.

---

<sup>154</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“, Nexhmendin Spahiu dhe Ervis Iljazaj, *ABC News Albania*, 06.11.2021 : <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

<sup>155</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“, Nexhmendin Spahiu dhe Ervis Iljazaj, *ABC News Albania*, 06.11.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

● Por elita shqiptare e Prishtinës dhe e Tiranës pikërisht pse kanë njohuri solide mbi teoritë franceze dhe gjermane për kombin, e kanë kuptuar se kur është fjala për kombet monoetnike, siç është edhe kombi shqiptar, etnia dhe kombi nuk janë dy gjëra të ndryshme, por janë dy gjëra të njëjta.

● Dhe meqë etnia dhe kombi janë dy gjëra të njëjta, elitat shqiptare e kanë të qartë se nga kombi monoetnik shqiptar nuk ka mundur të krijohet një komb tjetër joshqiptar “kosovar”. Prandaj Spahiu pret kot që elita shqiptare e Prishtinës dhe e Tiranës të bëjë dallimin mes etnisë shqiptare dhe kombit shqiptar, thjesht sepse një dallim i tillë nuk ekziston.

### **Në shkollat fillore në Perëndim nuk mësohet dallimi etni-komb**

Spahiu duke teorizuar më tej lidhur me dallimin etni-komb është shprehur edhe si më poshtë.

■ **N’skholla fillore nëpër krejt vendet e Perëndimit ata e mësojnë çka oshtë dallimi mes kombit dhe etnisë, fatkeqësisht te na nuk e mësojnë, po ai dallimi shumë i qartë osht, se me etni kuptohet gjuha, gjaku, prejardhja, kurse doket, zakonet, që nuk ndryshon, kudo që jeton n’Amerikë, n’Australi, domethon oshtë e pandryshueshme, biologjike osht etnia, kurse kombi është produkt njerëzor<sup>156</sup>. (min. 21:28 -22:43)**

● Pohimi i Spahiut, sipas të cilit nxënësit në vendet perëndimore e mësuakan dallimin mes etnisë dhe kombit që në shkollat fillore, jo vetëm që nuk qëndron, por edhe paraqet diçka të paimagjinueshme. Ka më shumë se 30 vjet që jetoj në Zvicër, ku tre fëmijët e mi (tanimë të rritur) i kanë kryer shkollat fillore, dhe ku edhe dy nipat dhe mbesa ime po i kryejnë shkollat fillore, por ata si nxënës të shkollave fillore nuk kanë mësuar asnjëherë lidhur me dallimin etni-komb. Kjo, sepse kjo temë konsiderohet temë për të rritur (për nxënës të gjimnazit dhe për studentë të shkencave politike dhe sociale), dhe nuk konsiderohet temë mësimi për fëmijët e shkollave fillore.

---

<sup>156</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri” (Aktualitete - 30.03.2021)  
<https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

● Për mendimin tim, Spahiu, për t'i paraqitur sa më të paditur intelektualët dhe akademikët shqiptarë, për të cilët është shprehur se nuk e dinë dallimin etni-komb dhe për ta paraqitur veten shumë të ditur, i dezinformon lexuesit duke thënë se në shkollat fillore në Perëndim nxënësit mësojnë dallimin etni-komb.

### **“Komibi kosovar” nënkupton identitet joshqiptar**

Spahiu lidhur me “kombin kosovar” ka thënë edhe si në vijim:

■ **Na spo krijojmë indenitet t’ri, na po krijojmë qat identitet që e kemi, vetëm për dallim që pronar t’shtetit t’shqipnis janë shtetats t’Shipnisë me përkatësi etnike shqiptare, pronar t’shtetit t’Kosovës janë shtetasit e Kosovës me përkatësi etnike shqiptare**<sup>157</sup>. (min. 17:30 - 18:07).

● Spahiu, thotë se duke u angazhuar ai, Matoshi e ndonjë tjetër për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, ata kësisoj nuk po krijojnë ndonjë identitet tjetër, por po krijojnë të njëjtin identitet që kanë shqiptarët. Por Spahiu nëpërmjet të këtij pohimi nuk bëjnë tjetër, veçse një përpjekje të ulët për t’i mashtruar shqiptarët e Kosovës, që ata të tjetërsohen nga komb shqiptar në “komb kosovar”, duke menduar se kësisoj nuk po krijojnë ndonjë identitet të ri kombëtar.

● Nëse identiteti kosovar është i njëjtë me atë shqiptar, siç thotë Spahiu për të na mashtruar, atëherë shtrohet pyetja: *Pse u dashka që nga shqiptarët e Kosovës të krijohet një komb tjetër “kosovar”?* Vetë kërkesa për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” flet qartë se Spahiu, Matoshi e ndonjë tjetër po kërkojnë që nga identiteti kombëtar shqiptar të krijojnë një identitet të ri kombëtar “kosovar”.

### **Në Kosovë nuk ka “komb kosovar”,**

Spahiu duke teorizuar mëtej për “kombin kosovar” është shprehur edhe si më poshtë:

■ **Të gjitha këto janë dëshmi se kombi kosovar akoma është një komb një-etnik**<sup>158</sup>.

<sup>157</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun, “Valamala Show” më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

<sup>158</sup> Nexhmedin Spahiu, *Kombi kosovar nuk është multietnik*, (arkiv, 13.01.2012) <https://rtvmitrovica.com/opinion-e-kombi-kosovar-nuk-eshte-multietnik/By>

■ **Mirëpo aktualisht jemi ni komb monoetnik dhe jemi ni komb bi-fetar muslihan dhe katolik<sup>159</sup>. (min. 10:11 - 10:19)**

■ **Kombi kosovar nuk është multietnik, sepse “Martesat mes pjesëtarëve të etnive të ndryshme në Kosovë janë tejet të rralla”<sup>160</sup>**

● Pohimet e Spahiut të cituara më lartë sipas të cilave: **Kombi kosovar akoma është komb një-etnik, kombi kosovar nuk është komb multietnik, sespe në Kosovë martesat mes pjesëtarëve të etnive të ndryshme janë të rralla**”, për vet faktin se në Kosovë realisht dhe objektivist as nuk ka pasur dhe as nuk ka “komb kosovar” as monetnik dhe as multietnik, ato (pohimet e Spahiut) janë të kota.

● Për vetë faktin se shqiptarët e Kosovës i përkasin kombit monoetnik shqiptar, kjo flet qartë se në Kosovë ka komb monoetnik shqiptar, por nuk ka “komb monoetnik kosovar”. Dhe në Kosovë nuk ka “komb monoetnik kosovar”, sepse në Kosovë kombi monoetnik shqiptar nuk është tjetërsuar në “komb monoetnik kosovar”.

● Spahiu duke thënë se në Kosovë ka “komb kosovar monoetnik”, është njësoj si të thotë se në Kosovë ka komb shqiptar monoetnik. Kjo, sepse për të pasur në Kosovë “komb kosovar”, ai patjetër duhet të jetë së paku komb bietnik, në formën e një përzierjeje shqiptar-serbe. Por në mungesë të një përzierjeje të tillë etnike shqiptar-serbe, atë që Spahiu e quan “komb monoetnik kosovar” nuk është tjetër, veçse komb monoetnik shqiptar.

### **Kombi shqiptar në Shqipëri është komb monoetnik**

Spahiu duke folur për pjesën e kombit shqiptar në Shqipëri ka thënë si në vijim:

● Pas rënies së komunizmit kombi shqiptar po tregon se po kalon nga një komb monoetnik në një komb multienik. Dëshmi për këtë është se prej pesë Presidentëve dhe shtatë Kryeminis-trave post-komunistë të Shqipërisë, 4 prej tyre nuk kanë qenë shqiptarë në

---

<sup>159</sup> Debati i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun, *Valamala Show*, më 24.06. 2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

<sup>160</sup> Nexhmedin Spahiu: *Kombi kosovar nuk është multienik* (Arkiv, 13.01.2012) <https://rtvmitrovica.com/opinione-kombi-kosovar-nuk-eshte-multietnik/By>

kuptimin etnik, edhe pse më shumë se 90% apo 95% e banorëve të Shqipërisë janë etnikisht shqiptarë<sup>161</sup>.

● **Shqipnia ka arrit mu bo, toni mo domethon veç mundet mu kujt ni komb multietnik, për vetë faktin se nga disa presidentë edhe disa kryeministra kanë arrit mu bo prej minoriteteve**<sup>162</sup>.  
(min. 18:08 -19:02)

● Nga thëniet e Spahiut të cituara më lart, del se kombi shqiptar në Shqipëri, pas rënies së komunizmit, po bëhet komb multietnik, gjë që nuk qëndron. Pjesa e kombit shqiptar në Shqipëri, si para, ashtu edhe pas rënies së komunizmit ka qenë e ka mbetur komb monoetnik. Duke pasur parasysh se në Shqipëri shumica shqiptare përbën rreth 96% të popullatës së gjithmbarshme, kjo tregon qartë se kombi shqiptar në Shqipëri nuk është komb multietnik, siç na thotë Spahiu, por është komb tipik monoetnik, siç na thotë realiteti objektiv.

● Kombi shqiptar në Shqipëri nuk bëhet komb multietnik, sepse në jug të Shqipërisë jeton një pakicë greke me rreth 30 mijë banorë, e cila edhe sikur të integrohej e tëra me martesë të përziera brenda shumicës shqiptare, ajo është shumë e vogël për ta bërë kombin shqiptar në Shqipëri komb multietnik.

● Edhe sikur të jetë e vërtetë se nga pesë presidentët dhe shtatë kryeministrat e Shqipërisë, katër prej tyre të mos kenë qenë shqiptarë etnikisht, kjo po ashtu nuk e bën kombin shqiptar në Shqipëri komb multietnik, siç mendon Spahiu. Kjo sepse natyra monoetnike e kombit shqiptar nuk ndryshohet aspak pse katër presidentë apo kryeministra të Shqipërisë etnikisht nuk kanë qenë shqiptarë. Nëse vërtet katër nga pesë presidentët dhe shtatë kryeministrat e Shqipërisë të viteve të fundit, etnikisht nuk kanë qenë shqiptarë, kjo nuk tregon se kombi shqiptar në Shqipëri është bërë komb multietnik, por flet për emancipimin politik të shoqërisë shqiptare.

● Edhe pjesa e kombit shqiptar në Kosovë, të cilin Spahiu për qejfin e tij e quan “komb kosovar” politik dhe artificial, duke qenë

<sup>161</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit*, <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

<sup>162</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun, “Valamala Show”, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

pjesë e kombit shqiptar monoetnik dhe duke mos qenë e përzier me martesë me etni të tjera joshqiptare, edhe ajo si para pavarësimit, ashtu edhe pas pavarësimit të Kosovës ka qenë e ka mbetur komb monoetnik shqiptar.

---

**KEQPËRDORIMI I PARIMIT TË TEORIVE FRANCEZE  
PËR KOMBIN-SHTET NË FUNKSION TË GJOJA  
KRIJIM-EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”**

Në kapitullin 10 të këtij libri i kam sqaruar lexuesit, se përkufizimi i teorive franceze, sipas të cilit kombet janë krijesa politike dhe artificiale vlen për kombet multietnike, sepse këto kombe janë krijuar me marrëveshje politike të etnive të ndryshme komb-krijuese.

Nga ana tjetër, në kapitullin 9- të këtij librit i kam sqaruar lexuesit, se përkufizimi i teorive franceze për kombin, sipas të cilit kombet janë krijesa politike dhe artificiale, nuk vlen për kombet monoetnike. Kjo sepse kombet monoetnike për vetë faktin se krijohen mbi bazën e konstruktit të tyre etnik dhe kulturor, ato si të tilla nuk janë produkte politike dhe artificiale, por janë produkte etnike dhe kulturore.

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se si Nexhmedin Spahiu, duke ngulur këmbë se të gjitha kombet janë konstrakte politike dhe artificiale, gjë që nuk qëndron, ai është përpjekur që t'i bindë (sipas meje t'i mashtrojë) shqiptarët e Kosovës, sikur gjoja ata me rastin e pavarësisimit të Kosovës, janë tjetërsuar në një komb tjetër joshqiptar, të emërtuar nga Spahiu si “komb kosovar” politik dhe artificial.

Por duke qenë kombi shqiptar në Kosovë pjesë e kombi

monoetnik shqiptar, prej tij as para e as pas pavarësimit të Kosovës nuk ka mundur të krijohet një komb tjetër “kosovar”, politik dhe artificial.

Edhe vet fakti se pas çlirimit të Kosovës në vitin 1999 dhe pas pavarësimit të Kosovës në vitin 2008, në mesin e shqiptarëve të Kosovës nuk ka pasur ndonjë marrëveshje kolektive politike, që ata nga komb shqiptar etnik të tjetërsohen në një “komb kosovar” politik dhe artificial, kjo flet qartë se në Kosovë ka komb shqiptar dhe nuk ka “komb kosovar” politik dhe artificial.

### **Vetëm kombet multietnike janë krijesa politike dhe artificiale**

Spahiu duke i konsideruar të gjitha kombet krijesa politike dhe artificiale, është shprehur si më poshtë:

■ **Kombet janë krijesa artificiale. Çdo komb osht krijesë artificiale. Ato qi i ka bo Perëndia janë krijesa natyrale. Etninë e ka bo Perëndia. Kombin e bojn njerëzit, e bon politika, idetë. Bohet ni projekt po e bojmë qetu ni komb, pe bojm qetu ni shtet**<sup>163</sup>. (min. 58:29-59:14)

■ **...Çdo komb n’botë osht komb artificial, osht krijuë nga njerëzit të cilët janë marr vesh me krijuë ni shtet edhe që në mes tyre vlen ni formulë e Revolucionit Francez: Liri- Villazri -Barazi: njerëz të lirë, të barabartë dhe qi e qujn vetën vllazën. Ata duhet me iu nënshtre ni ligji, domethon...**<sup>164</sup>. (min. 21:28 -22:43)

■ **.....për dallim prej etnisë me t’cillën zakonisht në shkollat tona, fillore, t’mesme, fakultet, në mediat, që ka të bëj me etnin, domethon me përkatësinë e gjuhës, të gjakut, që oshtë një koncept biologjik,... kombi për dalim oshtë një koncept politik**<sup>165</sup>. (min. 4:13 -4:58)

---

<sup>163</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun, *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

<sup>164</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri” (Aktualitete - 30.03.2021) HYPERLINK : <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8RJd7OQ>

<sup>165</sup> „<https://www.youtube.com/watch?v=kzli8RJd7OQ> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun, *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

### ■ **Kombi osht koncept politik<sup>166</sup>. (min. 58:57- 58:59)**

● Thënia e Spahiut e cituar më lart, sipas të cilës të gjitha kombet janë krijesa artificiale, siç kemi sqaruar edhe më lart, vlen për kombet multietnike të krijuara nga etni të ndryshme me marrëveshje politike, por nuk vlen për kombet monoetnike, sepse ato nuk janë krijuar me marrëveshje politike, por janë krijuar nga etni të vetme si konstrukte të natyrshme etnike, që kanë histori, gjuhë dhe kulturë specifike.

● Sidomos nga kombet monoetnike, të cilat nuk janë përzier me martesë me kombe të tjera, siç është rasti edhe me kombin shqiptar në Ballkan, prej tyre nuk mund të krijohen kombe të tjera politike dhe artificiale. Prandaj kot na thotë Spahiu se nga pjesa e kombit shqiptar në Kosovë na qenka krijuar sipas tij, një komb tjetër politik dhe artificial “kosovar”.

● Duke qenë kombi shqiptar një komb monoetnik në tërë hapësirën e tij etnike në Ballkan, kjo ka bërë që asnjë pjesë e tij të mos tjetërsohet në një komb tjetër politik dhe artificial, ta zëmë në formën e “kombit kosovar”, “iliridas”, “myzeqar”, “dibran”, “shkodran” apo “komb lab” e të tjerë.

### **Shqipërinë e kanë krijuar patriotët shqiptarë por kombi shqiptar ka ekzistuar shumë kohë me parë**

Spahiu duke u marrë edhe mëtej me parimin e teorive franceze, sipas të cilit të gjitha kombet janë krijesa politike dhe artificiale, është shprehur edhe si më poshtë:

### ■ **Edhe Shqipërinë po kështu e krijuan para 100 e kusur vjeteve patriotët shqiptarë se nuk ekzistonte, prandaj çdo komb në botë oshtë krijesë artificiale<sup>167</sup>. (min. 19:50 - 20:06)**

● Është e vërtetë se patriotët shqiptarë para 100 vjetëve (në vitin 1912) kanë krijuar shtetin e Shqipërisë, por nuk është e vërtetë se ata para 100 vjetëve kanë krijuar edhe kombin shqiptar, dhe atë si

<sup>166</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun, “Valamala Show”, më 24.06.2013. <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9m5vA5g>

<sup>167</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“ - Nexhmedin Spahiu dhe Ervis Iljazaj | ABC News Albania 06.11.2021: „<https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>“ <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

komb politik dhe artificial, siç na thotë Spahiu. Kjo, sepse kombi shqiptar nuk është krijuar për herë të parë para 100 vjetëve (më 1912), por ai është krijuar gradualisht si komb shqiptar monoetnik, përgjatë shekujve XVII, XVIII dhe XIX, duke kulmuar si etni dhe komb shqiptar brenda viteve 1878-1881, kur ai, nëpërmjet të kryengritjeve të organizuara nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, është angazhuar për bashkimin e katër vilajeteve shqiptare në një Shqipëri Etnike.

● Kështu, krijimi i shtetit shqiptar në vitin 1912 nga patriotët shqiptar, nuk paraqet krijimin e kombit shqiptar për herë të parë, por paraqet kulmimin e dytë të tij si etni dhe komb shqiptar, me rastin e shtetbërjes së Shqipërisë.

**Keqpërdorimi i konceptit të Ataturkut për kombin, në funksion të propagandimit të ekzistimit të “kombit kosovar”**  
Nexhmedin Spahiu duke folur në një debat televiziv lidhur me definicionin e Kemal Ataturkut për kombin, është shprehur si në vijim:

■ **Shiko kombi osht konstrukt social. Definicioni i Ataturkut për kombin thotë: Kombi oshtë një trup social dhe politik, të cilin e përbashkon gjuha, kultura dhe idetë. (min. 22:50 - 23:30). Ka qindra definicione për kombin por ato e përshkruajnë të njëjtën gjë. Edhe definicioni i Renanit edhe i Ataturkut, edhe pse asnjë fjalë nuk e kanë përbashkët por të njëjtën gjë e përshkruajnë<sup>168</sup>. (min. 45:00 - 45:13)**

● Lidhur me definicionin e Kemal Ataturkut, sipas të cilit kombet janë **trupa sociale dhe politike**, do të thosha se duke qenë kombi turk një komb multietnik, i krijuar artificialisht nga etni të ndryshme si një krijesë sociale dhe politike, ai (Ataturku) as që ka mundur ta definojë ndryshe kombin, përveçse si një **trup social dhe politik**, gjë që përputhet me parimet e teorive franceze për kombin.

● Është e vërtetë se nëpërmjet shkrirjes sociale, martesore

---

<sup>168</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“ - Nexhmedin Spahiu dhe Ervis Iljazaj;  
ABC News Albania 06.11.2021 HYPERLINK „<https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>“  
watch?v=OZtxMHB61UA“<https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

dhe politike të etnive të ndryshme, janë krijuar dhjetëra kombe multietnike në botë, të cilët mund të definoohen si **trupa socialë dhe politikë, në përputhje me definicionin e Kemal Atatürkut për kombin**, ose si **kombe politike artificiale**, në përputhje me teoritë franceze për kombin.

### **Kombet monoetnike nuk janë trupa socialë politikë**

● Por, po ashtu është e vërtetë, se përkufizimi i Atatürkut se kombi është **trup social dhe politik**, kur është fjala për kombet monoetnike, siç është edhe kombi shqiptar, nuk vlen. Kjo, sepse kombet monoetnike nuk janë krijuar nga masa popullore të etnive të ndryshme si pakte sociale dhe politike, në formën e trupave socialë dhe politikë pa asnjë diferencim, por janë krijuar nga masa popullore të diferencuara etnikisht, gjuhësisht dhe kulturorisht dhe, për rrjedhojë, edhe janë krijuar si **trupa etnikë dhe kulturorë**.

● Por pse Spahiu kur flet për krijimin sipas tij të “kombit kosovar”, mbështetet në definicionin e Atatürkut, sipas të cilit kombet janë trupa socialë dhe politikë? Mendoj se ai e bën këtë, thjesht për t’i bindur shqiptarët e Kosovës, se ata me rastin e bërjes shtet të Kosovës në vitin 2008, nga të qenët komb monoetnik shqiptar, brenda natës janë bërë një komb tjetër në formën e një trupi social dhe politik “kosovar”!

● Ose pse Spahiu kur flet për krijimin sipas tij të “kombit kosovar”, nuk iu referohet teorive gjermane për kombin, adekuate për përshkrimin e kombeve monoetnike, siç është edhe kombi shqiptar në Kosovë? Për mendimin tim, ai kur flet për “kombin kosovar” nuk iu referohet teorive gjermane për kombin, sepse sipas këtyre teorive, shqiptarët e Kosovës duke qenë një konstrukt monoetnik, ata si para, ashtu edhe pas pavarësisht të Kosovës, nuk kanë mundur të tjetërsohen nga një **trup etnik dhe kulturor shqiptar, në një trup social dhe politik “kosovar”**.

## **KEQPËRDORIMI I PARIMIT TË TEORIVE FRANCEZE PËR KOMBIN-SHTET NË FUNKSION TË GJOJA KRIJIM-EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”**

Në kapitullin e dhjetë të këtij libri lexuesit janë sqaruar në vija të përgjithshme lidhur me përkufizimin e kombi-shtet të teorive franceze, i cili vlen për kombet multietnike, sepse ato vërtet formohen dhe legjitimohen si kombe multietnike, me rastin e krijimit të shteteve të tyre po ashtu multietnike.

Nga ana tjetër, në kapitullin 9 të këtij libri lexuesit janë sqaruar se, parimi i kombit-shtet dhe shtetit-komb i teorive franceze nuk vlen për kombet monoetnike, sepse ato janë etni dhe kombe edhe kur ende nuk i kanë krijuar shtetet e tyre. Kështu, kurdët duke qenë një komb monoetnik i shpërndarë në katër shtete, janë etni dhe komb kurd, edhe pse ende nuk e kanë shtetin e tyre.

### **Përkufizimi sipas të cilit nuk ka komb pa pasur shtet vlen vetëm për kombet multietnike**

Spahiu duke teorizuar lidhur me parimin e shtetit-komb të teorive franceze, ka shkruar edhe si në vijim:

■ **Nuk mund të jesh komb pa qenë një vend sovran. Kombi shqiptar është njohur si i tillë që në vitin 1913. Nuk mund të**

flasim për një komb në kohën e Skënderbeut<sup>169</sup>.

■ **Kombi ashtë bashkësia e njerëzve që janë pronar i një shteti ose që e ka krijuar një shtetin<sup>170</sup>. (min. 3.35 - 3:44)**

■ **Ose kombi osht një komunitet i kualifikuar sikur inxhinjeri që ashtë një njeri i kualifikuar, ose mjeku që oshtë njeri i kualifikuar për..., ashtu edhe kombi oshtë një komunitet i kualifikuar për ta ndërtuar shtetin, për me krijuar vlera edhe me konsumuar vlera<sup>171</sup>. (min. 3:45 - 4.12)**

● Pohimet e Spahiut të cituara më lart, sipas të cilave: **Nuk mund të jesh komb pa qenë një vend sovran; Kombi osht bashkësia e njerëzve që janë pronar të një shteti, dhe kombi shqiptar është njohur si i tillë që në vitin 1913, janë të kallëpit të teorive franceze për kombin-shtet dhe shtetin-komb, të vlefshme për kombet multietnike, por jo edhe për kombet monoetike.**

Pohimet e lartpërmendura të Spahiut janë të vlefshme për kombet multietnike, sepse siç kemi sqaruar shumë herë më lart, kombet multietnike janë legalizuar dhe legjitimuar si kombe, vetëm me rastin e krijimit të shteteve të tyre po ashtu multietnike. Meqë këto kombe nuk kanë mundur të njihen si kombe të reja pa krijimin e shteteve të tyre, kusht për krijim-ekzistimin e tyre ka qenë krijimi i shteteve vetjake dhe të qenët e tyre pronare të shteteve vetjake.

Kombi multietnik amerikan, kanadez, neozelandez, australian, brazilian e të tjerë, janë legjitimuar si kombe të reja me rastin e krijimit të shteteve të tyre. Në mungesë të zotërimit të shteteve të tyre, ato do të mbeteshin thjesht një larushi etnish të shpërndara në terrene të ndryshme gjeografike në Amerikë, Kanada, Australi dhe Brazil.

### **Përkufizimi “nuk ka komb pa pasur shtet” nuk vlen për kombet monoetnike**

● Por, pohimet e Spahiut, të bazuara në parimin e kombit-shtet të teorive franceze, sipas të cilave: **Nuk mund të jesh komb pa qenë**

<sup>169</sup> Shqipëria dhe Kosova dy kombe të ndryshme me gjuhë të njëjtë 16/03/2021 syri.net: [https://www.syri.net/syri\\_kosova/lajme/228586/](https://www.syri.net/syri_kosova/lajme/228586/)

<sup>170</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun, Valamala Show, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

<sup>171</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun, Valamala Show, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

**një vend sovran**, nuk vlejnë për kombet monoetnike, sepse siç kemi sqaruar edhe në kapitujt pararendës, ato janë etni dhe kombe edhe kur ende nuk i kanë shtetet e tyre, dhe për rrjedhojë edhe kur nuk janë pronare të shteteve vetjake.

● Kështu, edhe kombi monoetnik shqiptar ndonëse zyrtarisht dhe politikisht është njohur si komb në vitin 1913, kur Konferenca e Ambasadorëve në Londër e ka njohur shtetin shqiptar (Shqipërinë), megjithatë, duke qenë popullata e Shqipërisë popullatë monoetnike shqiptare, ajo ka qenë komb monoetnik shqiptar shumë kohë para krijimit të shtetit të Shqipërisë në vitin 1913.

● Kombi shqiptar është krijuar gradualisht si etni dhe komb shqiptar që gjatë shekujve XVI-XVII, kur fiset iliro-arbërore gjithnjë e më shumë kanë filluar të quhen fise shqiptare, dhe ka vazhduar të konsolidohet si komb monoetnik shqiptar edhe gjatë shekujve XVIII-XIX. Gjatë gjithë këtyre kohëve, kombi shqiptar ka ekzistuar edhe si etni, edhe si komb shqiptar njëkohësisht. Kjo është arsyeja pse kur është fjala për kombin monoetnik shqiptar, përkufizimi i teorive franceze i kombit-shtet nuk vlen.

● Edhe thënia tjetër e Spahiut, sipas të cilës: **Nuk mund të flasim për një komb në kohën e Skënderbeut**, nuk qëndron plotësisht. Është e vërtetë se në shekullin XV, kur Skënderbeu për 25 vjet ka mbrojtur Shqipërinë nga pushtimi osman, nocioni “komb” nuk është njohur në kuptimin e sotëm modern, por edhe asokohe nocioni “komb” është njohur në njëfarë mase e mënyre. Kështu, p.sh., Marin Barleti në librin e tij për Skënderbeun ka shkruar se, kur të huajt e kanë pyetur Skënderbeun për origjinën e popullit të tij, ai është përgjigjur: **“Nëse nuk gënjejnë kronikat, ne jemi epirotas”**.

● Po kush kanë qenë epirotasit? Epirotasit kanë qenë banorë të fiseve pellazgo-ilire, të cilat janë quajtur fise epirote, sepse ato kanë jetuar në formacionin shtetëror pellazgo-ilir të Epirit të lashtë (sot në veri të Greqisë) përgjatë bregdetit të detit Jon. Epiri gjatë sundimit osman është njohur si Elajet dhe, së fundi, edhe si Vilajet i Janinës, kurse nga shqiptarët është njohur edhe si Epir i Lashtë dhe si Çamëri.

● Por, në dobi të mendimit se nocioni “komb” në njëfarë mase

dhe mënyre është njohur edhe në shekullin XV, flet edhe fakti se Skënderbeu po të kishte luftuar vetëm për mbrojtjen e krishterimit nga Perandoria Osmane, ai as që do të kthehej në Shqipëri për të luftuar kundër Perandorisë Osmane, por do t'i bashkohej Janosh Huniadit në Hungari dhe, bashkë me të, do të luftonte për mbrojtjen e krishterimit nga Perandoria Osmane.

● Kështu, fakti se Skënderbeu është kthyer në Shqipëri për ta mbrojtur atë (Shqipërinë) dhe popullin e tij shqiptar (asokohe të quajtur popull epirotas) nga pushtimi osman, kjo flet se edhe në shekullin XV kur ka jetuar Skënderbeu, në njëfarë mase dhe mënyre është njohur nocioni “komb” dhe nocioni “atdhe” etj.

● Edhe thënia tjetër e Spahiut, sipas të cilës - **kombi osht një komunitet i kualifikuar...për ta ndërtuar shtetin, për me krijue vlera edhe me konsumue vlera**, nuk qëndron, sepse asnjëherë i tërë kombi nuk është “mjeshtër i kualifikuar” për ndërtimin e shtetit: të kualifikuara për ndërtimin e shtetit janë vetëm elitat shtet-themeluese që i ka secili komb.

● Nga ana tjetër, kombi nuk mund të reduktohet vetëm në aftësinë e tij për të ndërtuar shtetin, sepse ka shumë kombe të afta për ta ndërtuar shtetin, por nuk kanë arritur t'i kenë ndërtuar shtetet e tyre, sepse janë penguar e pengohen nga politika të caktuara gjeorajonale.

● Dhe kombi nuk mund të reduktohet vetëm në aftësinë e tij për të ndërtuar shtetin, sepse kur është fjala për kombet monoetnike, ato janë etni dhe kombe, edhe kur ende nuk kanë arritur t'i kenë shtetet e tyre, gjë që përputhet edhe me teoritë gjermane për kombin.

● *Pse Spahiu duke iu referuar teorive franceze ngul këmbë se etnitë e ndryshme bëhen kombe kur i krijojnë shtetet e tyre?* Ai e bën këtë për të na thënë se edhe etnia shqiptare e Kosovës, sipas tij është bërë komb, por jo komb shqiptar, por çuditësisht është bërë “komb kosovar”, me rastin e shtebërjes së Kosovës.

### **Komuniteti kurd edhe pse ende nuk e ka krijuar shtetin e vet, ai paraqet etni dhe komb shumicë**

\* Spahiu lidhur me komunitetin kurd është shprehur si në vijim:

■ **Ekziston ideja kombëtare kurde sepse ka një ide, ka intelektualë kurdë... Skanë shtet s'jon komb. Janë vetëm etni,**

**janë komunitet etnik që jeton n'Siri, n'Irak, n'Turqi<sup>172</sup>. (min. 49:18 - 49:46)**

● Spahiu duke u bazuar në përkufizimin e kombit-shtet dhe shtetit-komb të teorive franceze, thotë se, meqë komuniteti kurd i shtrirë në Turqi, Irak dhe Siri nuk ka shtet vetjak, ai nuk paraqet komb, por paraqet etni.

● Por duke qenë popullata kurde popullatë monoetnike kurde, ajo edhe pse ende nuk ka arritur të ketë shtetin e saj të Kurdistanit, megjithatë, ajo si në Turqi, ashtu edhe në Irak e Siri, paraqet etni dhe komb kurd njëkohësisht, gjë që përputhet me teoritë gjermane për kombin, adekuate për kombet monoetnike. Kështu, edhe kur është fjala për kombin monoetnik kurd, përkufizimi i teorive franceze i kombit-shtet dhe i shtetit-komb nuk vlen.

● Për mua përkufizimi i teorive franceze, sipas të cilit komunitetet derisa nuk i kanë krijuar shtetet e tyre, nuk janë kombe, por janë komunitete etnike, është një përkufizim shumë regresiv, depresiv dhe madje edhe pengues e racist, ndaj atyre komuniteteve etnike, të cilat ende nuk kanë arritur të kenë shtetet e tyre, por që përpiqen t'i krijojnë ato.

### **Shqiptarët e Kosovës e duan shtetin e Kosovës duke qenë ata që janë: komb monoetnik shqiptar dhe jo “komb kosovar”**

Spahiu për ta përligjur më tej ekzistimin, sipas tij, të “kombit kosovar”, ka thënë edhe si në vijim:

■ **...Nëse shqiptarët e Kosovës nuk duen mu kon komb kosovar, kjo domethon se s'dojnë me kon Kosova shtet (min. 45:37 - 45:45). Çdo shtet e ka pronarin e vetë. Kombi shqiptar osht pronar i Republikës Shqipërisë...kombi polak oshtë pronar i Republikës së Polonisë, kombi serb o pronar i Republikës Serbisë, pronar i Kosovës osht kombi kosovar<sup>173</sup>. (min. 47:07- 47:28)**

● Kushtëzimi i Spahiut i cituar më lart, sipas të cilit: **Nëse**

<sup>172</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun, “Valamala Show”, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>.

<sup>173</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri”. (Aktualitete - 30.03.2021) <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

**shqiptarët e Kosovës nuk duan të jenë “komb kosovar”, kjo do të thotë se ata nuk duan me qenë Kosova shtet, jo vetëm që nuk qëndron, por edhe paraqet një absurditet të llojit të vet. Shtetbërja e Kosovës e realizuar në vitin 2008 nuk është varur dhe nuk varet aspak nga ekzistenca apo mosekzistenca e “kombit kosovar”, realisht joekzistues, por është varur dhe varet edhe sot e kësaj dite nga ekzistenca e kombit shqiptar, realisht dhe objektivisht ekzistues.**

● Edhe pohimi tjetër i Spahiut sipas të cilit: **Pronar i shtetit të Kosovës na qenka “kombi kosovar”** nuk qëndron aspak. Kjo, sepse në Kosovë as para, as pas pavarësimit të saj në vitin 2008, nuk ka pasur dhe nuk ka “komb kosovar”. Dhe në Kosovë nuk ka pasur e nuk ka “komb kosovar”, sepse ka pasur dhe ka komb monoetnik shqiptar.

● Dhe meqë në Kosovë as para dhe as pas pavarësimit të saj nuk ka pasur e nuk ka “kombi kosovar”, atëherë shtrohet pyetja: *Kush është pronar i shtetit të Kosovës?* Pronar legjitim dhe fuqiptotë i shtetit të Kosovës është kombi monoetnik shqiptar, që ka jetuar dhe jeton në Kosovë shekuj radhë, dhe që e ka çliruar dhe e ka bërë shtet Kosovën.

● Spahiu duke u nisur nga parimi i teorive franceze të kombit-shtet, përpiqet që “kombin kosovar” ta identifikojë me shtetin e Kosovës. Por, për vetë faktin se në Kosovë as nuk ka pasur dhe as nuk ka “komb kosovar”, ky komb fiktiv nuk mund të identifikohet me shtetin e Kosovës dhe as nuk mund të jetë pronar i tij. Kjo, sepse një komb për t’u identifikuar me një shtet dhe për të qenë pronar i atij shteti, kusht i domosdoshëm është që ai komb të ekzistojë.

● Shqiptarët e Kosovës e duan shtetin e Kosovës duke qenë ata që kanë qenë dhe që janë: komb monoetnik shqiptar, siç kanë qenë gjithmonë.

**Lindja e shtetit të Kosovës nuk ka çuar në lindjen e “kombit kosovar”, por ka çuar në rikonsolidimin e kombit ekzistues shqiptar**

Spahiu për të na bindur se me lindjen e shtetit të Kosovës ka lindur edhe “kombi kosovar”, ka shkruar si më poshtë;

■ **Ekzistenca e kombit kosovar është evidente për vetë faktin**

se ky komb njihet nga gati gjysma e kombeve të botës; Lindja e shtetit është dëshmia e ekzistencës së një kombi, ashtu siç lindja e fëmijës është dëshmi se një grua është bërë nënë. Lindja e shtetit të Kosovës është dëshmi e ekzistencës së një kombi që ka krijuar këtë shtet<sup>174</sup>.

■ **Momenti që ka lind shteti i Kosovës osht dëshmia që ekziston kombi i Kosovës<sup>175</sup>. (min. 19:11 -19:20)**

■ **Kombi lind dhe e krijon shtetin, shteti oshtë krijesë e kombit, por pa shtetin nuk mundësh me qenë komb, sikurse që nuk mujsh me qenë nonë pa lindë fmi, duhesh me lind fminë për m'u bo nonë<sup>176</sup>. (min. 22:55 -23:07)**

● Të gjitha pohimet e Spahiut të cituara më lart i përkasin përkufizimit të kombit-shtet të teorive franceze për kombin. Por këto pohime, siç kam sqaruar edhe më lart, vlejnjë vetëm për kombet multietnike, të krijuara nga etni të ndryshme me marrëveshje politike dhe, si të tilla, legalizohen dhe legjitimohen si kombe të reja, vetëm me rastin e krijimit të shteteve të tyre, po ashtu multietnike. Kështu, krijimi i çdo shteti multietnik është shoqëruar me krijimin e një kombi të ri po ashtu multietnik, i cili ka krijuar shtetin multietnik, kurse krijimi i shtetit ka qenë dëshmi për ekzistimin e kombit multietnik, që ka krijuar shtetin.

● Por pohimet e Spahiut të cituara më lart nuk vlejnjë për kombet monoetnike, të cilat janë etni dhe kombe si para, ashtu edhe pas krijimit të shteteve të tyre monoetnike. Këto kombe duke qenë kombe monoetnike, me rastin e krijimit të shteteve të tyre nuk tjetërsohen në kombe të tjera të reja, por mbeten ato që kanë qenë edhe para krijimit të shteteve të tyre. Me fjalë të tjera, krijimi i shteteve monoetnike nuk është shoqëruar me krijimin e kombeve të reja, por është shoqëruar me rikonsolidimin e kombeve ekzistuese.

● Spahiut i pëlqen të thotë se, sa herë që krijohet një shtet i ri, bashkë me të krijohet edhe një komb i ri politik dhe artificial që

<sup>174</sup> Kombi kosovar nuk është multietnik, shkruan Nexhmedin Spahiu (Arkiv, 13.01.2012): <https://rtvmitrovica.com/opinione-kombi-kosovar-nuk-eshte-multietnik/By>

<sup>175</sup> Debat i nxehtë "Kombi kosovar" me Nexhmedin Spahiun, "Valamala Show", më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

<sup>176</sup> Nexhmedin Spahiu; *Shteti dhe kombi kosovar*, radio "Sharri" (Aktualitete - 30.03.2021) <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

e ka krijuar atë shtet, sepse kësisoj dëshiron të thotë se edhe me rastin e krijimit të shtetit të Kosovës, nga shqiptarët e Kosovës është krijuar një komb i ri “kosovar” politik dhe artificial.

● Por, duke pasur parasysh se shqiptarët e Kosovës i kanë takuar dhe i takojnë kombit monoetnik shqiptar, ata edhe me rastin e krijimit nga ana e tyre të shtetit të Kosovës, kanë mbetur i njëjti komb shqiptar dhe nuk janë tjetërsuar në një komb të ri “kosovar”. Kjo është arsyeja pse Spahiu nuk mund të përfitojë nga përkufizimi i teorive franceze i njohur si kombi-shtet, për të na bindur se me rastin e krijimit të shtetit të Kosovës është krijuar një komb i ri “kosovar”.

● Pikërisht pse shtetin e Kosovës e ka krijuar kombi monoetnik shqiptar në Kosovë, mund të konkludohet si më poshtë:

- Lindja e shtetit të Kosovës nuk është dëshmi e lindjes së kombit të ri “kosovar”, por është dëshmi e rikonsolidimit të kombit ekzistues shqiptar, i cili realisht e ka çliruar dhe pavarësuar Kosovën.

\* **Meqë shtetin e Kosovës e ka krijuar kombi monoetnik shqiptar në Kosovë, lindja e shtetit të Kosovës nuk flet aspak për lindjen e një kombi të paqenë “kosovar”.**

\* **Gjysma e kombeve të botës nuk e ka njohur “kombin kosovar”, siç na thotë Spahiu, por gjysma e shteteve të botës ka njohur shtetin e Kosovës, dhe atë me atë përbërje etniko-kombëtare që ka pasur e ka: me shumicën kombëtare shqiptare dhe me komunitetet pakicë që kanë jetuar dhe jetojnë në Kosovë.**

\* **Kombi monoetnik shqiptar duke krijuar dy shtetet e tij shqiptare, ai simbolikisht mund të krahasohet me një nënë që ka lindur dy fëmijë, por që edhe njëri, edhe tjetri i përkasin së njëjtës etni dhe të njëjtit komb shqiptar.**

\* **Për vetë faktin se vitin 2008 në Kosovë ka ndodhur lindja e shtetit të Kosovës, por nuk ka ndodhur lindja e “kombit kosovar”, kjo tregon qartë se në Kosovë ka komb shqiptar dhe nuk ka “komb kosovar”, i cili ekziston vetëm në kokën e Spahiut, të Matoshit e të ndonjë tjetri.**

## **Spahiu pa fijen e trupit dhe të ndërgjegjes thotë se Kosovën e ka bërë shtet “kombi kosovar”**

Spahiu lidhur me lindjen e shtetit të Kosovës ka bërë dy pohime kontradiktore:

**Në pohimin e parë thotë:**

■ **Lindja e shtetit të Kosovës është dëshmi e ekzistencës së një kombi të ri që e ka krijuar këtë shtet<sup>177</sup>.**

**Në pohimin e dytë thotë:**

■ **Natyrisht, luftën e bënë si shqiptarë etnikë, sepse në kohën e luftës kombi ...ishte vetëm ide dhe akoma jo një realitet<sup>178</sup>.**

● **Spahiu brenda pohimit të tij të parë thotë se “Lindja e shtetit të Kosovës flet se shtetin e Kosovës e ka bërë kombi i ri “kosovar”. Por ky pohim i tij nuk qendron sepse historia tani më veç e ka fiksuar faktin se shtetin e Kosovës e ka krijuar kombi i saj shumicë shqiptar, dhe këtë e di gjithë bota, përveç Spahiut.**

● **Për Amerikën, Europën, NATO-n është e qartë se gjatë viteve 1998-1999 për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës ka bërë luftë politike dhe luftë të armatosur kombi shqiptar dhe jo “kombi kosovar” joekzistues atëherë e sot. Por Spahiu edhe përkundër fakteve të tilla madhore , pa fijen e trupit dhe pa fijen e ndërgjegjes thotë se, Kosovën e paska bërë shtet një komb i ri duke aluduar në “kombin kosovar”, një komb ky që as nuk ka ekzistuar dhe as nuk ekziston.**

● **Brenda pohimit të dytë, i njëjti Spahiu thotë se luftën për çlirimin e Kosovës e kanë bërë shqiptarët etnikë, sepse sipas tij, gjatë luftës kombi (duke aluduar në “kombin kosovar”; paska qenë vetëm ide dhe jo një realitet. Por nëse “kombi kosovar” gjatë luftës paska qenë vetëm ide dhe jo një realitet, atëherë shtrohet pyetja: *Kush e paska çliruar dhe e paska bërë shtet Kosovën?* “Kombi kosovar” që gjatë luftës paska qenë vetëm ide dhe jo një realitet, apo kombi shqiptar që gjatë luftës nuk ka qenë edhe ide por realitet?**

<sup>177</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi 26 gusht, 2016. *Dritare.Net*: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

<sup>178</sup> “Kombi” kosovar i Nexhmedin Spahiut dhe bashkëvendimtareve të tij, SEPTEMBER 10, 2016 BY DGRECA Nga Sadik Elshani/Filadelfia <https://gazetadielli.com/kombi-kosovar-i-nexhmedin-spahiut-dhe-bashkëvendimtareve-te-tij/>

● Në këtë pyetje s'ka përgjigje tjetër, përveç përgjigjes se Kosovën e ka çliruar nga Serbia pushtuese në vitet 1998-1999 dhe e ka bërë shtet në vitin 2008 pjesa e kombit monoetnik shqiptar në Kosovë, dhe jo “kombi kosovar”, i cili gjatë viteve 1998-1999, siç thotë edhe Spahiu, nuk ka qenë as ide dhe as realitet.

● Shtohet pyetja: *Si ndodhi që, edhe pse Kosovën e ka çliruar dhe pavarësuar kombi shqiptar, pas çlirimit dhe pas pavarësimit të Kosovës, në Kosovë nuk paska më komb shqiptar, sepse ai, sipas Spahiut, na qenka tjetërsuar në “komb kosovar”?! A nuk është ky një absurd i absurdit, një ironi përtej ironisë dhe një cinizëm përtej cinizmit?!*

### **Reduktimi i kombit vetëm në aftësi për krijimin dhe mbajtjen e shtetit**

Spahiu duke teorizuar për kombin, ndër të tjera ka shkruar edhe si më poshtë:

■ **Shiko në botë fliten mbi 7 mijë gjuhë por janë ma pak se 200 kombe. Gjuha nuk të bën komb. Komb të bën aftësia për ta ngritur shtetin, për të mbajtur shtetin<sup>179</sup>. (min. 10:06 - 10:17)**

■ **Në krejt botën domethon ekzistojnë 8 mijë gjuhë, 8 mijë etni, ndërsa janë 193 kombe, i 194-ti po presim me konë<sup>180</sup>. (min. 53:26 -53:35).**

● Edhe ky pohim i Spahiut i cituar edhe më lart, sipas të cilit gjuha nuk të bën komb, por komb të bën aftësia për ta bërë dhe mbajtur shtetin, është bërë në frymën e parimit të kombit-shtet të teorive franceze për kombin, që vlen për kombet multietnike, sepse ato vërtet janë krijuar në saje të aftësisë së etnive të ndryshme komb-krijuese, për ta bërë dhe për ta mbajtur shtetin.

● Por pohimi i Spahiut i cituar më lart, sipas të cilit komb nuk të bën gjuha, por të bën aftësia për ta bërë dhe mbajtur shtetin, nuk vlen për kombet monoetnike, sepse këto kombe, siç thonë edhe teoritë gjermane për kombin, nuk i bën kombe vetëm aftësia e

<sup>179</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shqiptarët me dy kombe, kombi kosovar*, Adi Krasta në “A Show”, *Syri TV*, 16.03.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=n02HRe4sAKc>

<sup>180</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun, “Valamala Show”, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

pjesëtarëve të tyre për t'i bërë dhe mbajtur shtetet e tyre, por në radhë të parë i bëë kombe vetë prejardhja e tyre e veçantë etnike, bashkë me historinë, gjuhën dhe kulturën e veçantë që kanë.

● Shtrohet pyetja: *Pse Spahiu e redukton kombin vetëm në aftësi për bërjen dhe mbajtjen e shtetit?* Për mendimin tim, ai e bën këtë reduktim për t'i bindur (për mendimin tim për t'i mashtruar) shqiptarët e Kosovës, sikur gjoja në Kosovë jo vetëm që ka “komb kosovar”, por ai “komb” edhe paska pasur aftësi për ta bërë Kosovën shtet, ndërkohë që jo vetëm të gjallët, por thenë simbolikisht edhe të vdekurit e dinë, se Kosovë e ka bërë shtet kombi ekistues e shqiptar, dhe jo kombi joekzistues “kosovar”.



# **PJESA E PESTË**

# 19

---

## **MANIPULIM-SPEKULIMI I FAKTEVE HISTORIKE NË FUNKSION TË PROPAGANDIMIT TË GJOJA KRIJIM- EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”**

### **Nuk ekziston asnjë fakt historik dhe politik, që do ta përlligjte krijim-ekzistimin e “kombit kosovar”**

Në këtë kapitull dua t’i sqaroj lexuesit, se si Nexhmedin Spahiu, duke shtrembëruar dhe keqinterpretuar faktet madhore historiko-politike të kombit shqiptar, përpiqet ta përlligjë krijimin nga shqiptarët e Kosovës, sipas tij të “kombit kosovar”. Por nuk ekziston asnjë fakt i vërtetë historik dhe politik, i cili do ta përlligjte krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”. Përkundrazi, të gjitha faktet relevante historiko-politike të kombit shqiptar, flasin se në tërë hapësirën etnike shqiptare në Ballkan ka pasur dhe ka komb shqiptar, por nuk ka pasur e nuk ka “komb kosovar”.

### **Lidhja e Prizrenit nuk ka rezultuar me dy kombe, por me një komb të vetëm shqiptar**

Spahiu idenë e tij të ekzistimit të “kombit kosovar” ndër të tjera e ka lidhur edhe me historinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të vitit 1878, duke u shprehur si në vijim:

■ **Lidhja e Prizrenit është ngjarja vendimtare që ngjizi idenë kombëtare, rezultat i së cilës sot ka dy kombe shqiptare në**

## **Ballkan<sup>181</sup>.**

● Pajtohem me Spahiun, se Lidhja Shqiptare e Prizrenit ka qenë ngjarja më vendimtare e ngjizjes së ideve kombëtare shqiptare, por nuk pajtohem me thënien tjetër të tij, sipas të cilës Lidhja Shqiptare e Prizrenit ka rezultuar me krijimin e dy kombeve shqiptare në Ballkan, sepse në Ballkan ka pasur dhe ka vetëm një komb shqiptar.

● Nuk është e vështirë të kuptohet se Spahiu, duke përmendur dy kombe shqiptare, njëri nga këto dy kombe është kombi shqiptar, kurse tjetri është kombi i tij “kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistent. Por edhe sikur të kishte dy kombe: njëri shqiptar e tjetri kosovar, ato nuk do të ishin dy kombe shqiptare, siç na thotë Spahiu, por do të ishin dy kombe të ndryshme, ashtu siç janë edhe kombi serb e kroat dy kombe të ndryshme, pa marrë parasysh prejardhjen e tyre të njëjtë etnike sllave.

● Spahiu nuk e kupton se nuk mund të ketë dy kombe të të njëjtit komb. Derisa gjermanët kanë jetuar në dy shtetet e tyre, ata nuk kanë qenë pjesëtarë të dy kombeve gjermane, por kanë qenë pjesëtarë të të njëjtit komb gjerman të ndarë në dy shtete. Edhe vietnamezet derisa kanë jetuar në dy shtetet e tyre vietnameze, ata nuk kanë qenë pjesëtarë të dy kombeve vietnameze, por kanë qenë pjesëtarë të të njëjtit komb vietnamez.

● Prandaj edhe shqiptarët, ndonëse jetojnë në dy shtetet e tyre (Shqipëri dhe Kosovë), ata nuk kanë qenë e nuk janë pjesëtarë të dy kombeve shqiptare (njëri shqiptar e tjetri “kosovar”), siç na thotë Spahiu, por janë pjesëtarë të të njëjtit komb shqiptar të ndarë në dy shtete.

● Spahiu duke e konsideruar “kombin e tij kosovar” si një komb të dytë shqiptar, përpiqet t`i bindë (për mendimin tim t`i mashtrojë) shqiptarët, që ata duke menduar se “kombi kosovar” është një “komb i dytë shqiptar”, të pranojnë që të konvertohen nga komb shqiptar në “komb kosovar”. Nëse “kombi kosovar” i Spahiut do të ishte një komb i dytë shqiptar, atëherë shtrohet pyetja: *Pse u dashka të krijohet “kombi kosovar” si komb më vete, kur ai nuk qenka tjetër, veçse një komb i dytë shqiptar?!*

---

<sup>181</sup> *Pse Kosova feston pavarësinë e Shqipërisë?...* shkruan Nexhmedin Spahiu (Arkiv, 16.12.2011): <https://rtvmitrovica.com/pse-kosova-feston-pavaresine-e-shqiperise/>

● Lexuesit duhet ta kuptojnë se, nëse ndodh krijimi i “kombit kosovar”, ai nuk do të jetë një komb i dytë shqiptar, siç thotë Spahiu, por do të jetë një komb tjetër joshqiptar i shkëputur nga kombi shqiptar.

● Por le t'i kthehemi sërish Lidhjes Shqiptare e Prizrenit, e cila sipas Spahiut paska rezultuar me krijimin e dy kombeve shqiptare. Lidhja Shqiptare e Prizrenit nuk ka rezultuar me krijimin e dy kombeve shqiptare, sepse siç sqaruam edhe më lart, dy kombe të të njëjtit komb nuk mund të ketë, por ka rezultuar me konsolidimin e vazhdueshëm të kombit monoetnik shqiptar, në të gjitha viset e tij në Ballkan.

● Lidhja Shqiptare e Prizrenit duke qenë një organizatë politike dhe ushtarake, e cila ka luftuar për bashkimin e katër vilajeteve shqiptare në një Shqipëri të bashkuar, ajo jo vetëm që nuk ka rezultuar me krijimin e dy kombeve shqiptare, por ajo tanimë, për shumë se një shekull, ia ka ruajtur kombit shqiptar kohezionin e brendshëm, duke favorizuar kështu bashkimin e kombit shqiptar, të ndarë padrejtësisht në gjashtë njësi shtetërore të ndryshme në një Shqipëri të vetme.

● Vizioni komb-bashkues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit paraqet një të vërtetë historike globale, të cilën nuk mund ta lëkundë asnjë historian me nam, dhe aq më pak ta lëkundë Spahiu, që s'është historian.

● Fatkeqësisht, Spahiu duke thënë se Lidhja Shqiptare e Prizrenit ka rezultuar me krijimin e dy kombeve shqiptare, përpiqet që idetë e tij komb-ndarëse nëpërmjet propagandimit të krijimit nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, t'ia veshë hiç më pak se Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të vitit 1878.

● Por i tillë është Spahiu: ai për t'i bindur (mashtuar) shqiptarët e Kosovës se nuk i përkasin kombit shqiptar, por i përkasin “kombit kosovar”, ka bërë e bën lojëra deri edhe me historinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, duke thënë se ajo paska rezultuar me krijimin e dy kombeve shqiptare: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”, gjë që nuk qëndron aspak.

## **Shqiptarët kanë synuar pavarësimin e Shqipërisë me Kosovën brenda saj**

- Shqiptarët e Kosovës nëpërmjet kryengritjeve të viteve 1908-1912, kanë synuar pavarësimin e shtetit të Shqipërisë, kuptohet me Kosovën dhe viset e tjera shqiptare brenda tij, por sërish nuk ia kanë arritur. Kjo, sepse Fuqitë e Mëdha pjesëmarrëse në Konferencën e Ambasadorëve të mbajtur në Londër në vitin 1913, nuk qenë për krijimin e një Shqipërie të plotë, me të gjitha viset e saj, por qenë për krijimin e një çerek-Shqipërie, me vetëm 1/3 e viseve të gjithmbarshme të shqiptarëve (rreth 95 mijë kilometra katëror), që shqiptarët kanë zotëruar deri në prag të Kongresit të Berlinit të vitit 1878.
- Kjo është historia e vërtetë dhe e njohur botërisht e kombit shqiptar, dhe nuk është ajo histori, që kombit shqiptar ia vesh Spahiu, sipas së cilës kombi shqiptar me rastin e pavarësimit të Kosovës, na qenka ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

## **Në Kosovë nuk ka pasur asnjëherë lëvizje politike për krijimin e “kombit kosovar”**

Spahiu për ta përligjur ekzistimin, sipas tij, të “kombit kosovar”, është shprehur më tej si në vijim:

■ **Gati një shekull n’Kosovë ka ekzistue lëvizja irredntiste e cila gjithmonë ka nënkuptue, jo Kosova mu bo shtet, por Kosova me ju bashkangjit Shqipnisë.... Kurrë nuk ka pushue lëvizja për mu bashkue. Mirëpo me kohën kjo lëvizje u transformue: Njiherë ka nis me 1968-ën u përmend fjala Kosova Republikë, masandej hop-hop me 1991-ën me Rugovën, veç e ka marr drejtimin Kosova e pavarur, qysh e përmendke ai ... atë formulën: Kosova e pavarur neutrale dhe e hapur ndaj Serbisë dhe ndaj Shqipnisë . ...Me këtë ka fillu lindja e shtetit dhe e kombit njikohësisht<sup>182</sup>. (min. 30:00 - 30:11)**

- Nuk pajtohem me thënien e mësipërme të Spahiut, sipas së cilës

---

<sup>182</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar”, me Nexhmedin Spahiun, *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>.

lëvizja irredentiste e Kosovës për bashkimin Kosovë-Shqipëri, nëpërmjet demonstratave studentore të vitit 1968 në Kosovë, në të cilat është përmendur për herë të parë bërja e Kosovës Republikë, ka marrë një drejtim tjetër, sipas Spahiut, atë të formimit të shtetit të Kosovës jashtë shtetit të Shqipërisë, dhe atë të krijimit të “kombit kosovar” jashtë kombit shqiptar.

● Është e vërtetë se nëpërmjet demonstratave të vitit 1968 dhe sidomos nëpërmjet demonstratave të vitit 1981 dhe të viteve në vazhdim është synuar bërja e Kosovës republikë, por jo vetëm si qëllim në vetvete, por edhe si një hap paraprak që Kosova, duke qenë një Republikë, të mund t’i bashkohej më lehtë Shqipërisë. Këto fakte flasin se lëvizja irredentiste njëshekullore për bashkimin Kosovë-Shqipëri, nëpërmjet të demonstratave të vitit 1968 dhe të vitit 1981, jo vetëm që nuk është ndërprerë dhe nuk ka ndryshuar drejtim, por përkundrazi: është fuqizuar edhe më shumë drejt bashkimit Kosovë-Shqipëri.

### **Në Kosovë as nuk ka pasur dhe as nuk ka iluminim për krijimin e “kombit kosovar”**

Për të na bindur se nga shqiptarët e Kosovës, sipas tij, veç është krijuar “kombi kosovar”, Spahiui ka shkruar edhe si në vijim:

■ **Në Kosovë ka një iluminim për këtë çështje...Ka njerëz të cilltë studiojnë në perëndim, kuptojnë më shumë, e duan më shumë Kosovën si shtet të përhershëm dhe jo si të përkohshëm dhe numri i këtyre personave është gjithmonë e në rritje**<sup>183</sup>.

● Spahiui brenda thënies së tij të cituar më lart pohon pa asnjë fakt, sikur gjoja në Kosovë ka një iluminim për çështjen e “kombit kosovar”. Por në mesin e shqiptarëve të Kosovës as nuk ka pasur e as nuk ka ndonjë iluminim lidhur me çështjen e paqenë të kombit joekzistues “kosovar”.

● Për vetë faktin se idetë e Spahiut për gjoja ekzistimin e “kombit kosovar” nga një pjesë e intelektualëve, por dhe nga shumë

---

<sup>183</sup> Nexhmedin Spahiui: *Shqipëria dhe Kosova dy kombe të ndryshme me gjuhë të njëjtë*, 16.03.2021, *syri.net*:  
[https://www.syri.net/syri\\_kosova/lajme/228586/nexhmedin-spahiui-shqiperia-dhe-kosova-dy-kombe-te-ndryshme-me-gjuhe-te-njejte/](https://www.syri.net/syri_kosova/lajme/228586/nexhmedin-spahiui-shqiperia-dhe-kosova-dy-kombe-te-ndryshme-me-gjuhe-te-njejte/)

njerëz të thjeshtë, këta të fundit nëpërmjet rrjeteve sociale, janë kundërshtuar dhe hedhur poshtë frontalisht, deri edhe me sharje e fyerje ndaj Spahiut, kjo flet se në Kosovë as nuk ka pasur e as nuk ka iluminim për çështjen joekzistuese të “kombit kosovar”, por ka neveri ndaj ideve absurde të Spahiut, sipas të cilave në Kosovë ka “komb kosovar”.

● Spahiu na thotë se iluminim për çështjen e “kombit kosovar” paskan sidomos ata studentë shqiptarë që studiojnë jashtë Kosovës, siç thotë ai në vendet perëndimore, sepse ata, sipas tij, qenkan më të ditur, kuptuakan më shumë dhe e dashkan më shumë Kosovën si shtet të përhershëm.

● Unë nga ana ime, duke jetuar më shumë se 30 vjet jashtë Kosovës, kam takuar shumë studentë shqiptarë që studiojnë në Zvicër, Austri dhe Gjermani, të cilët jo vetëm që nuk iluminonin për çështjen e paqenë të “kombit kosovar”, por edhe i gryojnë të dëmshme idetë komb-ndarëse të Spahiut, të shprehura nga ai nëpërmjet të idesë për krijimin gjoja nga shqiptarët e Kosovës të një kombi tjetër “kosovar”.

### **Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare ka synuar bashkimin Kosovë-Shqipëri**

● Nuk pajtohem as me thënien tjetër të mësipërme të Spahiut, sipas së cilës lëvizja politike e Kosovës e viteve ‘90-të të shekullit XX, në krye të së cilës ka qenë Ibrahim Rugova, ka pasur për qëllim krijimin e shtetit të Kosovës jashtë shtetit të Shqipërisë dhe krijimin e “kombit kosovar” jashtë kombit shqiptar. Në fakt, gjatë viteve ‘90-të është synuar shtetbërja e Kosovës, por sërish jo vetëm si qëllim në vetvete, por edhe si një hap paraprak që Kosova, duke qenë shtet, të mund t’i bashkohej më lehtë Shqipërisë.

● Se edhe lëvizja politike e Kosovës e viteve ‘90-të ka synuar bashkimin Kosovë-Shqipëri, për këtë flasin qartë edhe tri opsionet kryesore për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, të cilat janë dhënë në vitin 1991 nga Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare, në krye të të cilit ka qenë Ibrahim Rugova<sup>184</sup>.

---

<sup>184</sup> Dokumenti i rrallë: Tri opsionet për zgjidhjen e çështjes shqiptare në ish-Jugosllavi në vitin 1991,

● **Sipas opsionit të parë:** Nëse nuk ndryshohen kufijtë e jashtëm dhe kufijtë e brendshëm të Jugosllavisë, duhet të ekzistojë Republika e Kosovës me të drejtë bashkimi në lidhjen e shteteve sovrane në Jugosllavi.

● **Sipas opsionit të dytë:** Nëse nuk ndryshohen kufijtë e jashtëm të Jugosllavisë, por ndryshohen kufijtë e brendshëm ndërmjet republikave, atëherë duhet të krijohet Republika Shqiptare në Jugosllavi mbi bazën e parimit etnik.

● **Sipas opsionit të tretë:** Nëse ndryshohen kufijtë e jashtëm të Jugosllavisë, atëherë populli shqiptar në Jugosllavi, përmes deklarimit të përgjithshëm me plebishit, do të vendosë për bashkimin e territoreve shqiptare, dhe kështu do të krijohet shteti integral shqiptar në Ballkan në kufijtë e tij etnik<sup>185</sup>.

● Kush i lexon me kujdes këto tri opsione të Këshillit Koordinues të Partive Politike Shqiptare, të hartura nga politologu Nikë Gjeloşi, sheh se lëvizja politike e Kosovës e viteve '90-të e udhëhequr nga Ibrahim Rugova, në opsionin e tretë të saj nuk e ka synuar domosdoshmërisht krijimin e shtetit të Kosovës jashtë Shqipërisë, por ka synuar bashkimin e territoreve në të cilat kanë jetuar shqiptarët në Kosovë e vise të tjera, në një shtet shqiptar integral.

● Dhe kush i lexon me kujdes këto tri opsione, sheh se lëvizja politike e Kosovës e viteve '90-të, e udhëhequr nga Ibrahim Rugova, nuk ka synuar krijimin e “kombit kosovar” jashtë kombit shqiptar, por e ka synuar të kundërtën: bashkimin e pjesës së kombit shqiptar të mbetur padrejtsisht në ish-Jugosllavi, me pjesën e kombit shqiptar në Shqipëri, në një shtet integral shqiptar.

● Këto fakte flasin se lëvizja irredentiste për bashkimin Kosovë-Shqipëri, as përgjatë viteve '90-të të lëvizjes politike të shekullit XX jo vetëm që nuk është ndërprerë dhe nuk ka ndryshuar drejtim, por ka vazhduar të mbetet edhe më tej komb-bashkuese, si dhe ka mbetur e tillë (komb-bashkuese) edhe pas shtet-bërjes së Kosovës.

---

19 korrik 2016. <https://www.botasot.info/lajme/556695/dokumenti-i-rralle-tri-opsionet-per-zgjidhjen-e-ceshtjes-shqiptare-ne-ish-jugosllavi-ne-vitin-1991/>

<sup>185</sup> Dokumenti i rralë: Tri opsionet për zgjidhjen e çështjes shqiptare në ish-Jugosllavi në vitin 1991, 19 korrik 2016. <https://www.botasot.info/lajme/556695/dokumenti-i-rralle-tri-opsionet-per-zgjidhjen-e-ceshtjes-shqiptare-ne-ish-jugosllavi-ne-vitin-1991/>

Faktet historike dhe politike nuk ndryshohen sipas dëshirave të individëve, kushdo qofshin ata.

● Duke pasur parasysh sa u tha më lart, del se thënia e Ibrahim Rugovës, sipas së cilës “Kosova duhet të jetë një shtet i pavarur dhe neutral, i hapur ndaj Shqipërisë dhe Serbisë”, nuk ka qenë tjetër, veçse një taktikë politike e tij, që fillimisht të mund të krijohet shteti i Kosovës me sa më pak kundërshtime nga Serbia e Rusia, dhe kur më pas shteti i Kosovës të jetë bërë një akt i kryer, ai t’i bashkohej Shqipërisë.

● Kështu, Spahiu dëshirën e tij për krijimin e shtetit të Kosovës jashtë Shqipërisë dhe dëshirën e tij për krijimin e “kombit kosovar” jashtë kombit shqiptar, nuk mund t’ia veshë as demonstratave studentore të vitit 1968, as demonstratave studentore të vitit 1981 dhe as lëvizjes politike të Kosovës të viteve ‘90-të, në krye të së cilës ka qenë Ibrahim Rugova. Në Kosovë nuk ka ekzistuar asnjëherë ndonjë lëvizje politike për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

● Kur Kosova në vitin 2008 u bë shtet i pavarur, ajo me dëshirë do t’i bashkohej Shqipërisë, por kjo nuk ka ndodhur, sepse Bashkësia Ndërkombëtare nëpërmjet të Dokumentit të Ahtisarit, ia kishte ndaluar Kosovës të drejtën për t’iu bashkuar ndonjë shteti tjetër, gjë që ka nënkuptuar ndalimin për bashkim me Shqipërinë. Por asnjë ndalim nuk është i përhershëm. Kështu, edhe ndalimi i Kosovës për bashkimin e saj me Shqipërinë do të hiqet një ditë.

● Duke pasur parasysh sa u tha më lart, del se pohimi i Spahiut, sipas të cilit në Kosovë ka pasur iluminim për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, nuk paraqet tjetër, veçse një shpikje dhe trillim të tij.

### **UÇK-ja ka synuar bashkimin kombëtar**

● Së fundi, edhe vetë lufta e UÇK-së për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës, e bërë nga UÇK-ja gjatë viteve 1998-1999, ka pasur për synim bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Këtë synim UÇK-ja ndër të tjera e ka shprehur edhe nëpërmjet të betimit të saj ushtarak, në të cilin është thënë tekstualisht, se UÇK-ja po luftonte për bashkimin e të gjitha viseve shqiptare në një shtet të

vetëm shqiptar. Meqë pas çlirimit të Kosovës në qershorin e vitit 1999, Bashkësia Ndërkombëtare nuk ishte e gatshme ta përkrahte projektin e bashkimit Kosovë-Shqipëri, betimi dhe synimi i UÇK-së për bashkimin Kosovë-Shqipëri është heshtur gradualisht. Është heshtur, por as nuk është harruar e as nuk ka vdekur!

● Spahiu kot përpigjet që, nëpërmjet shtrembërimeve dhe keqinterpretimeve të fakteve historiko-politike të kombit shqiptar, t'i bindë shqiptarët e Kosovës që ata, pa as më të voglën arsye e nevojë logjike të tjetërsohen në "komb kosovar". Përpjekje të tilla të Spahiut nuk mund të kenë sukses, sidomos në kohët e sotme, kur faktet historiko-politike të kombit shqiptar janë të dokumentuara dhe të arkivuara jo vetëm në arkivat shqiptarë, por edhe në arkivat e botës, si dhe janë të fiksuara edhe në shumë libra e studime edhe në gjuhë të huaja, dhe çdo shqiptar mund t'i shohë e t'i lexojë.

## 20

---

### **PERANDORIA OSMANE NUK E KA NDIHMUAR AS KRIJIMIN E KOMBIT SHQIPTAR DHE AS KRIJIMIN E ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE**

Edhe në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit lidhur me manipulimet, shtrembërimet dhe shpifjet që Nexhmedin Spahiu i bën historisë së kombit shqiptar, duke shkuar aq larg, sa të na thotë se kombi shqiptar qenka krijuar me ndihmën e Perandorisë Osmane, pohim ky që paraqet absurdin e absurdit.

Nuk ekziston qoftë edhe një fakt i vetëm historik, i cili thotë se për krijimin e kombit shqiptar ka dhënë ndihmesën e vet Perandoria Osmane, por ka me qindra e mijëra fakte historike, të cilat flasin se Perandoria Osmane, sidomos gjatë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, bashkë me Fuqitë të tjera të Mëdha të kohës, desh e ka varrosur të gjallë kombin shqiptar.

Të gjithë historianët shqiptarë të Kosovës dhe të Shqipërisë, të cilët me fakte konkrete hedhin poshtë mendësinë e tij deformuese, sipas së cilës Perandoria Osmane paska ndihmuar krijimin e kombit shqiptar, Spahiu i quan “historianë të shokut Enver”, krejt kjo me qëllim që këta historianë të mirëfilltë, nga frika se mos po konsiderohen komunistë dhe enveristë, të mbyllin gojën duke e lënë Spahiun që të livadhisë!

## Perandoria Osmane nuk e ka ndihmuar krijimin e kombit shqiptar

Spahiu në vazhden e shtrembërimeve të fakteve historike është shprehur si më poshtë:

■ **Kombi shqiptar u krijua me ndihmën e Perandorisë Osmane. Një nga dallimet mes kombit turk e kombit shqiptar është se kombi turk u krijua duke e luftuar Perandorinë Osmane, kurse kombi shqiptar u krijua me ndihmën e Perandorisë Osmane. 3 etapat e komb-ngjizjes dhe komb-formimit shqiptar u përkrahën nga Sulltani. 1. Lidhja e Prizrenit (që më vonë u shtyp nga vetë Osmanët, por që pati efektin e ngjizjes së kombit shqiptar). 2. Krijimi i alfabetit shqip i hartuar nga një prift katolik (i madhi Gjergj Fishta) dhe i financuar nga vetë Sulltani Abdul Hamiti II me kundërvlerë të 400.000 \$ të sotëm. 3. Insistimi pranë Fuqive të Mëdha Europiane të përcaktojë kufijtë e shtetit shqiptar<sup>186</sup>.**

### Perandoria Osmane shqiptarët i ka konsideruar turq, kurse viset e tyre ua ka falur vendeve aleate të Rusisë

● Spahiu brenda thënies së tij të cituar më lart pohon se krijimi i kombit shqiptar qenka ndihmuar nga Perandoria Osmane, duke i ndihmuar ajo tri etapat e komb-formimit shqiptar. Por Perandoria Osmane duke i konsideruar shqiptarët turq, sepse ata nga besimi katolik e ortodoks ishin konvertuar në besimin mysliman, jo vetëm që nuk e ka dashur krijimin e kombit shqiptar, por përkundrazi e ka luftuar krijimin e tij. **Mos kësisoj Perandoria Osmane paska ndihmuar krijimin e kombit shqiptar?!**

● Perandoria Osmane duke i konsideruar viset e shqiptarëve si parcela të saj, ajo bashkë me Fuqitë e tjera të Mëdha 2/3 e viseve të gjithmbarshme të shqiptarëve, brenda viteve 1878-1912, ua ka aneksuar vendeve aleate të Rusisë në Ballkan, me qëllim që Rusia të tërhiqej nga pretendimet territoriale ndaj Perandorisë Osmane. **Mos edhe kështu Perandoria Osmane ka ndihmuar krijimin e kombit shqiptar?!**

---

<sup>186</sup> Nexhmedin Spahiu: *Kombi shqiptar u krijua me ndihmën e Perandorisë Osmane. Kosova ime TV, 1 nëntor 2020*: <https://kosovaime.tv/nexhmedin-spahiu-kombi-shqiptar-u-krijua-me-ndihmen-e-perandorise-osmane/>

● Perandoria Osmane i ka përndjekur deri edhe ata pak mësues e patriotë shqiptarë të kohës, kur ata në fund të shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit të XX deri në vitin 1012, kanë sjellë në viset shqiptare qoftë edhe ndonjë abetare në gjuhën shqipe nga Stambolli, Sofja ose Bukureshti, dhe kur ata kanë hapur ndonjë shkollë shqipe, të quajtura asokohe “mësonjëtorë”. **Mos edhe kështu Perandoria Osmane ka ndihmuar krijimin e kombit shqiptar?!**

### **Perandoria Osmane nuk e ka përkrahur**

#### **Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, por e ka shkatërruar atë**

Sot ka një mal me argumente historike të shkruara në shumë gjuhë, të cilat flasin bindshëm se Perandoria Osmane jo vetëm që nuk e ka përkrahur Lidhjen Shqiptare të Prizrenit të vitit 1878, por edhe e ka shkatërruar atë gjatë viteve 1878-1881. Perandoria Osmane ka angazhuar pashallarët më të egër turq, që me ushtritë e tyre t'i detyronin kryengritësit shqiptarë, që ata krahinën shqiptare të Plavës e Gucisë t'ia dorëzonin Malit të Zi, ashtu siç ishte vendosur në Kongresin e Berlinit të vitit 1878. Perandoria Osmane i ka gjykuar me dënime kapitale dy udhëheqësit kryesorë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit: Abdyl Frashrin dhe Sulejman Vokshin. **Mos kështu Perandoria Osmane e paska përkrahur Lidhjen Shqiptare të Prizrenit?!**

### **Perandoria Osmane nuk ua ka njohur autonominë shtetërore vetëm shqiptarëve**

● Perandoria Osmane në Kongresin e Berlinit të vitit 1878, të gjitha kombeve ballkanike (serbëve, malazezve, grekëve, bullgarëve dhe rumunëve) ua ka njohur autonomitë shtetërore, përveç kombit shqiptar. Dhe jo vetëm kaq, por ajo, siç është cekuar edhe më lart, bashkë me Fuqitë e tjera të Mëdha, brenda viteve 1878-1912, 2/ 3 e viseve të gjithmbarshme të shqiptarëve ua ka aneksuar vendeve aleate të Rusisë: Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Kështu, në vitin 1913 u krijua një Shqipëri që nuk ishte tjetër, veçse një çerek-Shqipërie. **Mos Perandoria Osmane edhe kështu e ka ndihmuar krijimin e kombit shqiptar?!**

## Sulltani nuk e ka përkrahur krijimin e alfabetit të gjuhës shqipe

● Më tej Spahiu, pa ofruar asnjë argument, thotë se krijimin e alfabetit të gjuhës shqipe në Kongresin e Manastirit të vitit 1908 e ka përkrahur dhe sponsorizuar sulltani turk Abdyl Hamiti II me 400 000 dollarë të sotëm. Por është fakt i njohur historik, se Sulltan Hamiti II dhe përfaqësuesit e Perandorisë Osmane në Shkup kanë bërë të pamundurën që, duke manipuluar dhe korruptuar një pjesë të deputetëve shqiptarë proturq të Kongresit të Manastirit, ta dështonin miratimin e alfabetit latin për alfabet të gjuhës shqipe, në mënyrë që shqiptarët të përdornin edhe më tej alfabetin arab. **Mos Abdyl Hamiti II kësisoj paska përkrahur dhe sponsorizuar krijimin e alfabetit të gjuhës shqipe?!**

## Perandoria Osmane nuk e ka kërkuar përcaktimin e kufijve të Shqipërisë

● Edhe pohimi i Spahiut, se Perandoria Osmane e ka kërkuar njohjen e kufijve të Shqipërisë, nuk qëndron aspak. Fakti se Perandoria Osmane në Kongresin e Berlinit të vitit 1878 vetëm shqiptarëve nuk ua ka njohur autonominë shtetërore, flet bindshëm se ajo nuk e ka kërkuar nga Fuqitë Mëdha të Europës as krijimin e shtetit shqiptar dhe as përcaktimin e kufijve të Shqipërisë.

● Perandoria Osmane për të kërkuar nga Fuqitë e Mëdha të kohës përcaktimin e kufijve të Shqipërisë, është dashur që edhe kombit shqiptar t'i njihte të njëjtën autonomi shtetërore, që ua ka njohur kombeve të tjera të Ballkanit në vitin 1878, gjë që nuk e ka bërë, si dhe është dashur që ta kundërshtonte aneksimin e 2/3 të viseve të shqiptarëve gjatë viteve 1878-1912 vendeve fqinje ballkanike: Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë, gjë që nuk e ka bërë. **Mos Perandoria Osmane edhe kësisoj paska kërkuar përcaktimin e kufijve të Shqipërisë?**

Spahiu duke e deformuar mëtej historin e kombit shqiptar është shprehur edhe si më poshtë:

■ **Lindja e kombit shqiptar osht rezultat i pushtimit osman. Sepse ky komb shqiptar, ma spari duhet me ditë çka definohet komb shqiptar? Formula e kohezionit të kombit shqiptar,**

**osht qi osht komb muslimano-kristjan, pa marr parasysh qi shumica janë myslimanë, si muslimani, si katuliku, si ortodoksi si ai që oshtë sunit si ai që oshtë bektashi, nisoj mu ndie shqiptar<sup>187</sup>. (min. 55:25 -56:16).**

● Thënia e Spahiut e cituar më lart nuk tregon aspak se lindja e kombit shqiptar ka qenë rezultat i pushtimit osman, sepse formula e kohezionit të kombit shqiptar nuk ka qenë një formulë që shqiptarëve ua ka dhënë Perandoria Osmane, por ka qenë një formulë e krijuar dhe e zbatuar nga vetë shqiptarët.

● Nga ana tjetër, është paradoksale të thuhet se lindja e një kombi (lindja e kombit shqiptar) ndodhka me rastin e pushtimit të tij nga një perandori (nga Perandoria Osmane). Përkundrazi, pushtimi osman ka mundur të rezultojë jo me lindjen, por me zhdukjen e kombit shqiptar.

### **Spahiu në përkrahje të kërkesës së ministrave turq për ndryshimin e historisë së kombit shqiptar**

Spahiu përkrah dy ministrat turq, të cilët kanë kërkuar korrigjimin e historiografisë shqiptare, duke shkruar si në vijim:

■ **Pas deklaratave të ministrave turq Dinçer e Davutoglu për problemet që ka historiografia e jonë në raport me turqit dhe me Perandorinë Osmane, u ngrit turma e atyre që pretendojnë të jenë historianë, se nuk lejojnë të ndryshohet historia, se të prekësh historinë është si të prekësh shtyllën kurrizore të kombit etj., etj.**<sup>188</sup>

### **Ushtritë osmane duhen quajtur ushtri pushtuese, por nuk duhet quajtur “hordhi turke”**

● Spahiu përmend deklaratat e ministrave turq, Dinçer e Davutoglu, por nuk u tregon lexuesve se çfarë kanë kërkuar ata ministra nga historiografia shqiptare. Këta dy ministra turq pas çlirimit dhe pavarësimit të Kosovës, nga historiografia shqiptare

<sup>187</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun, *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

<sup>188</sup> Nexhmedin Spahiu, *Mos na prekni historinë*, 13 shtator 2011, 22:07, BLOGTEMA: <https://www.dardania.de/vb/upload/showthread.php?t=32227>

kanë kërkuar që ajo sundimin pesëshekullor të viseve shqiptare nga Perandoria Osmane, të mos e quajë pushtim pesëshekullor dhe që ushtritë osmane, të mos i quajë ushtri pushtuese dhe hordhi turke.

● Se Perandoria Osmane dhe ushtritë e saj kanë qenë pushtuese, këtë s'e luan as topi, prandaj historiografia shqiptare Perandorinë Osmane dhe ushtritë e saj nuk mund t'i quajë ndryshe, veçse ashtu siç kanë qenë: **pushtuese**. Cilësimi i ushtrive osmane si ushtri jopushtuese ose si çlirimtare, nuk do të ishte vetëm një falsifikim i rëndë i historisë së kombit shqiptar, por do të ishte njëkohësisht edhe një falsifikim i rëndë i historisë ballkanike dhe europiane.

● Historianët boshnjakë-myslimanë të Bosnjës duke i cilësuar ushtritë pushtuese osmane si ushtri çlirimtare për boshnjakët dhe Bosnjën, ata kanë bërë një falsifikim të trashë të historisë, i cili nuk i bën mirë as historiografisë boshnjake dhe as historiografisë turke të Periudhës Osmane.

● E vetmja gjë që duhet të korrigjohet në historiografinë shqiptare, është që ushtritë osmane të mos quhen "hordhi turke", por thjesht të quhen ushtri pushtuese. Ky korrigjim duhet bërë për hir të marrëdhënieve të mira të Kosovës dhe të Shqipërisë me Republikën e Turqisë në këto tri dekadat e fundit.

### **Historiografia kombëtare shqiptare nuk duhet të ndryshohet për hir të askujt**

● Për vetë faktin se osmanët e kanë pushtuar Ballkanin për zgjerimin e Perandorisë Osmane, historiografitë kombëtare të vendeve të Ballkanit dhe historiografia e Europës dhe e botës, pushtimin e Ballkanit nga ana e Perandorisë Osmane e kanë kualifikuar ashtu siç ka qenë realisht: si pushtim. Këtij cilësimi nuk ka pse t'i ikë edhe historiografia e kombit shqiptar, sepse edhe kombi shqiptar dhe viset e tij kanë qenë të pushtuara nga ushtritë osmane. Në këtë pikë historiografia kombëtare shqiptare nuk mund të ndryshohet për hir të askujt.

### **Cilësim që do të ishte i dëmshëm për shqiptarët dhe për boshnjakët myslimanë**

● Cilësimi i ushtrive osmane si ushtri çlirimtare të shqiptarëve

dhe të boshnjakëve myslimanë jo vetëm që nuk qëndron historikisht, por edhe është i dëmshëm si për shqiptarët, ashtu edhe për boshnjakët. Kjo, sepse ky cilësim ndër të tjera do t'u shërbente shovinistëve serbë si mjet për të propaganduar, sikur gjoja shqiptarët dhe boshnjakët në të kaluarën kanë qenë në anën e Perandorisë Osmane pushtuese, kurse në kohët e sotme janë fundamentalistë islamikë, gjë që do të bënte që këta dy popuj të mos shihen me sy të mirë nga popujt e krishterë të Europës.

● Shqiptarët kanë pësuar shumë padrejtësi historike, pikërisht pse duke qenë shumica e tyre e besimit mysliman, ata në njëfarë mënyre e mase janë parë nga Fuqitë e Mëdha të Europës jo si komb shqiptar, por si mbetje e Perandorisë Osmane në Kontinentin European.

● Tani ka ardhur koha që shqiptarët t'i tregojnë botës, se ata edhe pse kanë tri besime të ndryshme fetare, megjithatë i përkasin të njëjtit komb shqiptar, i cili paraqet kombin më pro-europian e më pro-amerikan në Europë.

● Ndërsa kombet arabe dhe myslimane në Lindjen e Afërt dhe në Lindjen e Mesme, Perandorinë Osmane e kanë konsideruar ashtu siç ka qenë: perandori pushtuese, shqiptarët, përfshi këtu edhe Spahiun, nuk kanë pse përpiqen për ta gënjer botën, sikur gjoja Perandoria Osmane nuk paska qenë perandori pushtuese, por paska qenë një perandori çlirimtare e shqiptarëve.

● Pohimi absurd i Spahiut, sipas të cilit krijimin e kombit shqiptar e paska ndihmuar Perandoria Osmane, nuk i shërben askujt, përveç qarqeve antishqiptare serbe, për të bërë ato propagandë antishqiptare, sikur gjoja shqiptarët në të kaluarën kanë qenë vegël e Perandorisë Osmane, kurse në kohët e sotme janë fundamentalistë islamikë.

● Mjaft e kanë deformuar historinë e kombit shqiptar shovinistët serbë, grekë e të tjerë, dhe tani nuk ka nevojë që historinë e kombit shqiptar ta deformojë edhe Spahi u ndonjë tjetër si ai.

### **Shpëtimi i fiseve iliro-arbërore nga asimilimi sllav ka qenë një fat në fatkeqësi**

● Shpëtimi i një pjese së fiseve iliro-arbërore nga asimilimi në

fise sllave, duke e pranuar ato fise besimin islam gjatë shekujve XV-XVII të sundimit osman, nuk ka qenë tjetër, veçse një fat në fatkeqësi. Kjo, sepse Perandoria Osmane nuk e kishte pushtuar Ballkanin për t'i shpëtuar fiset iliro-arbërore nga asimilimi në fise sllave, por e kishte pushtuar Ballkanin për zgjerimin e kufijve të saj perandorakë. Prandaj shpëtimi i një pjese të fiseve iliro-arbërore nga asimilimi në fise sllave nuk ka qenë meritë e Perandorisë Osmane, siç përpiqen të na bindin disa predikues të islamit në Kosovë e në Shqipëri, por ka qenë meritë e zgjuarsisë politike të fiseve iliro-arbërore, që duke e pranuar besimin islam, të ndërpritej asimilimi i mëtejshëm i tyre në fise sllave.

### **Shqiptarët për hir të fatit në fatkeqësi nuk mund ta ndryshojnë historinë**

● Por shqiptarët, për hir të fatit në fatkeqësi të përmendur më lart, nuk mund ta ndryshojnë historinë duke i quajtur ushtritë pushtuese osmane ushtri jopushtuese ose ushtri çlirimtare. Perandoria Osmane si edhe të gjitha perandoritë e tjera ka qenë pushtuese, dhe kjo gjë paraqet një fakt historik gjithëbotëror. Këtë fakt nuk e ndryshon as qasja miqësore e Turqisë së sotme ndaj Shqipërisë dhe Kosovës. Duhet dalluar marrëdhëniet e mira aktuale mes Turqisë në njërin anë dhe Kosovës e Shqipërisë nga ana tjetër, nga realitetet historike të kohëve kur Turqia ka qenë Perandori Osmane.

### **Fatin në fatkeqësi shqiptarët e kanë paguar shtrenjtë në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit**

Nga ana tjetër, duhet pasur parasysh se edhe e mira që fiseve iliro-arbërorëve iu ka ardhur nga Perandoria Osmane si një fat në fatkeqësi, kur ato gjatë shekujve XV-XVII duke u islamizuar, nuk janë asimiluar më tej në fise sllave, nga shqiptarët është paguar shumëfish nëpërmjet të tri akteve antishqiptare të Perandorisë Osmane, të realizuara në fund të shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit të XX.

**Me aktin e parë antishqiptar**, kur Perandoria Otomane në Kongresin e Berlinit të vitit 1878, të gjitha kombeve të Ballkanit ua

ka njohur autonomit shtetërore përveç kombit shqiptar;

**Me aktin e dytë antishqiptar**, kur Perandoria Otomane në Kongresin e Berlinit të vitit 1878, u pajtua që 1/3 e viseve të shqiptarëve t'u aneksohej Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë;

**Dhe me aktin e tretë antishqiptar**, kur Perandoria Otomane në Konferencën e Ambasadorëve në Londër të vitit 1913, u pajtua që edhe 1/3 tjetër e viseve të shqiptarëve t'i aneksohej sërish Serbisë (Vilajeti i Kosovës), Malit të Zi (një pjesë e Vilajetit të Kosovës dhe një pjesë e Vilajetit të Shkodrës) dhe Greqisë (edhe 1/3 tjetër e Vilajetit të Janinës, alias edhe 1/3 tjetër e Çamërisë).

### **Ndihma që i ka dhënë Turqia Shqipërisë dhe Kosovës është më e vogël se borxhi historik që Turqia i ka kombit shqiptar**

● Duhet pasur parasysh se ndihma që Republika e Turqisë i ka dhënë Shqipërisë në këto dekadat e fundit, duke filluar që nga viti 1991 e këtej, dhe ndihma që Republika e Turqisë i ka dhënë Kosovës në këto dekadat e fundit, duke filluar nga viti 1999 e këtej, është më e vogël se ndihma që i kanë dhënë shqiptarët ndër shekuj Perandorisë Osmane, për të qëndruar ajo në këmbët e saj.

● Kështu, duke pasur parasysh se borxhi historik i Republikës së Turqisë ndaj Shqipërisë dhe Kosovës është më i madh sesa ndihma që Turqia i ka dhënë Shqipërisë dhe Kosovës, kjo e bën të tepërt kërkesën e dy ministrave turq, që shqiptarët tani të falsifikojnë edhe historinë e tyre kombëtare, për hir të ideve neo-perandorake të Turqisë së sotme. Çdo gjë ka një kufi e një karar!

### **Spahiu bashkë me ministrat turq në favor të falsifikimit të historisë kombëtare të shqiptarëve**

Spahiu duke u pozicionuar në krahun e ministrave turq, Dinçer e Davutoglu, ka shkruar si në vijim:

■ **Nuk janë turqit ata që duan të na ndryshojnë historinë, ... Ata që prekën shtyllën kurrizore të kombit janë falsifikatorët e historisë, shërbëtorët e shokut Enver Hoxha (1908-1985) dhe nxënësit e tyre... Këta falsifikatorë të historisë për më së gjysmë shekulli indoktrinuan breza të tërë me histori të**

### **rreme, me gjysmë të vërteta dhe me komente të çoroditura<sup>189</sup>.**

● Spahiu duke thënë se nuk janë turqit, ata që duan të na ndryshojnë historinë, ai del hapur në krahun e ministrave turq Dinçer e Davutoglu të përmendur më lart, të cilët kanë kërkuar që historiografia shqiptare perandorin dhe ushtritë osmane të mos i konsiderojë pushtuese. Por, nëse këto kërkesa të ministrave turq nuk paraqesin dëmtim dhe falsifikim të historisë së kombit shqiptar, siç mendon Spahiu, atëherë shtrohet pyetja: *çka tjetër do të ishte dëmtim dhe falsifikim i historisë së kombit shqiptar?*

● Qëndrime të tilla të Spahiut për mendimin tim flasin se nuk janë vetëm ministrat turq, ata që kanë dashur ta ndryshojnë historiografinë shqiptare, por bashkë me ta është edhe Spahiu, që ka dashur të ndryshojë historiografinë shqiptare. Historia ka treguar se shqiptarëve asnjë e keqe nuk iu ka ardhur nga jashtë, pa u ndihmuar e keqja e ardhur nga jashtë nga disa shqiptarë.

● Edhe unë, ashtu si Spahiu, nuk jam historian për të thënë se sa e ka falsifikuar apo e ka sqaruar historinë e kombit shqiptar Enver Hoxha me “shërbëtorët” e tij, siç shprehet Spahiu. Por, së paku, sa i përket vlerësimit të ushtrive osmane si ushtri pushtuese, në historiografinë shqiptare të botuar në Shqipëri, derisa ka qenë gjallë Enver Hoxha, Spahiut për këtë nuk i ka faj as Enver Hoxha e as historianët “shërbëtorë” të tij. Kjo, sepse ushtritë osmane i kanë vlerësuar si ushtri pushtuese jo vetëm historianët shqiptarë të kohëve kur ka jetuar Enver Hoxha, dhe jo vetëm historianët e vendeve të Ballkanit, por edhe historianët europianë dhe atë shumë kohë para se të vinte në këtë botë Enver Hoxha, Spahiu, ky apo ai tjetri.

---

<sup>189</sup> Nexhmedin Spahiu, *Mos na prekni historinë*, 13 shtator 2011, 22:07, BLOGTEMA: <https://www.dardania.de/vb/upload/showthread.php?t=32227>

## **ANGLIA DHE GJERMANIA KANË PJESËN E TYRE TË MËKATIT TË BËRË NDAJ SHQIPTARËVE DHE SHQIPËRISË**

Nexhmedin Spahiu në vazhdën e fushatës së tij kundër të vërtetave historike, ka shkruar se si në librat e historisë në gjuhën shqipe, me pa të drejtë akuzohen Anglia dhe Gjermania, si vende të cilat kanë kontribuar për ndarjen dhe copëtimin e viseve shqiptare, si në Kongresin e Berlinit të vitit 1878, ashtu edhe në Konferencën e Ambasadorëve të mbajtur në Londër në vitin 1913.

Por faktet madhore historike nuk mund t'i përmbysë as vetë Anglia e Gjermania, e lëre më Spahiu. Ky i fundit, duke mos ia ditur hallin vetë, vetëmendon se është aq i ditur, aq i madh, aq i rëndësishëm dhe aq i fuqishëm, sa të mbrojë edhe Anglinë dhe Gjermaninë, dhe atë nga shqiptarët ende të ndarë në gjashtë njësi shtetërore të ndryshme, pikërisht për shkak të ndarjes dhe të copëtimit të viseve të tyre nga Fuqitë e Mëdha të Europës, ku kanë bërë pjesë edhe Anglia e Gjermania.

### **Po të ishte përkrahur Shqipëria nga Anglia dhe Gjermania, fati i shqiptarëve do të ishte tjetër**

● Spahiu lidhur me qëndrimin e Anglisë dhe të Gjermanisë ndaj fateve të shqiptarëve dhe të Shqipërisë, ka shkruar si më poshtë:

■ **Edhe pse Jusuf Buxhovi me prova të dorës së parë dëshmon se Anglia e Gjermania në Kongresin e Berlinit kishin ndaj Shqipërisë qëndrim identik me atë çfarë patën këto vende**

**ndaj Kosovës më 1999, prap se prap librat tona të historisë, nga ku mësojnë nxënësit dhe studentët tanë, vjellin vrerë kundër Anglisë e Gjermanisë së asaj kohe. A nuk është dëmtim i shtyllës kurrizore të kombit falsifikimi i raporteve të kombit me miqtë më të mirë të tij: Anglinë e Gjermaninë?<sup>190</sup>.**

● Nuk them se në Kongresin famëkeq të Berlinit të vitit 1878, Anglia dhe Gjermania nuk kanë thënë një fjalë të mirë në dobi të kombit shqiptar, por fakti se në Kongresin e Berlinit 1/3 e viseve të të shqiptarëve u është falur vendeve aleate të Rusisë (Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë), kjo tregon qartë se Anglia dhe Gjermania në Kongresin e Berlinit nuk kanë pasur të njëjtin qëndrim pozitiv ndaj Shqipërisë, siç kanë pasur ndaj Kosovës në vitin 1999.

● Sikur Anglia e Gjermania në Kongresin e Berlinit të kishin pasur qëndrim pozitiv të vendosur në dobi të Shqipërisë, ato duke paraqitur dy nga Fuqitë e Mëdha serioze të atyre kohëve, do ta pamundësonin faljen e 1/3 të viseve të shqiptarëve vendeve aleate të Rusisë (Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë). Prandaj pohimi i Jusuf Buxhovit i cituar nga Spahiu, se Anglia dhe Gjermania në Kongresin e Berlinit të vitit 1878 kanë pasur ndaj Shqipërisë qëndrim pozitiv identik me atë që këto vende kanë pasur ndaj Kosovës më 1999, jo vetëm që nuk qëndron, por edhe paraqet një të pavërtetë të madhe sa bjeshka.

● Nëse Austro-Hungaria si fuqi e vetme e pozicionuar në favor të çështjes shqiptare, ka arritur që në Konferencën e Ambasadorëve të mbajtur Londër në vitin 1913, t'i bindë Fuqitë e tjera të Mëdha që Shqipëria të shpallej shtet i pavarur, atëherë mund të merret me mend se sa i madh do të ishte kontributi i Anglisë dhe i Gjermanisë, nëse ato në Kongresin e Berlinit të vitit 1878 dhe Konferencën e Ambasadorëve në Londër të vitit 1913, do të ishin vërtet në favor të shqiptarëve dhe të Shqipërisë.

● Sikur Gjermania dhe Anglia të kishin pasur ndaj Shqipërisë në Kongresin e Berlinit të vitit 1878 dhe në Konferencën e Ambasadorëve të mbajtur në Londër të vitit 1913, të njëjtin qëndrim që kanë pasur ato ndaj Kosovës në vitin 1999, siç na thonë Buxhovi

---

<sup>190</sup> Nexhmedin Spahiu, *Mos na prekni historinë*, 13 shtator 2011, BLOGTEMA: <https://www.dardania.de/vb/upload/showthread.php?t=32227>

dhe Spahiu, sot Shqipëria nuk do të ishte një vend me rreth 29 mijë kilometra katrorë, por do të ishte një vend më 90 mijë kilometra katrorë sa ka pasur deri te Kongresi i Berlinit

● Sikur Anglia dhe Gjermania të kishin qenë me tërë kapacitetet e tyre pro Shqipërisë dhe shqiptarëve, sot nuk do të kishim dy shtete shqiptare (Shqipëri dhe Kosovë) në Ballkan, që marrë së bashku nuk zënë më shumë se 40 mijë kilometra katrorë, por do të kishim një Shqipëri të vetme me rreth 90 mijë kilometra katrorë.

● E gjithë kjo tregon se Anglia dhe Gjermania në Kongresin e Berlinit të vitit 1878 dhe në Konferencën e Ambasadorëve në Londër të vitit 1913, e kanë thënë për Shqipërinë dhe shqiptarët një fjalë të mirë sa për sy e faqe, në stilin *“m’ka çue nana me la gojën!”*, por nuk kanë ngulur këmbë, që viset e shqiptarëve të mos copëtoheshin dhe të mos i faleshin Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë.

● Mosnjohja e autonomisë shtetërore viseve të shqiptarëve në Kongresin e Berlinit të vitit 1878 dhe aneksimi i 1/3-ës së viseve të shqiptarëve tri vendeve të përmendura më lart, nuk mund të ndodhte pa votuar pro vendimmarrjeve të tilla skandaloze edhe Anglia dhe Gjermania.

### **Anglia ka pjesën e të saj të fajit për copëtimin dhe faljen e tokave të shqiptarëve**

Spahiu duke dashur që në njërën anë t’i paraqesë shqiptarët apolitikë, kurse në anën tjetër që të avokojë për Anglinë, ai është shprehur më tej si në vijim:

■ **Ne vazhdojmë me i eduku brezat me histori me gënjeshtër, me fallcifikime. Vazhdojmë me që Konferenca e Londrës që e ka kriju Shqipninin si shtet, na vazhdojmë me thonë që ajo i ka nda tokat shqiptare. Kur ka qenë Ruari O’Connell që e kam pas mysafir, ai mu lajmruie n’telefon - atij pas nji postimi në Facebook qi i bojshin pytje t’shumta, pse Anglia i ka da tokat shqiptare, pse kshtu e pse ashtu. Qysh more thojke ai, po na e kemi krijue Shqiprinë, edhe n’vend qi me thonë faleminderit që e kemi krijue Shqiprinë, po na thoni ... Edhe për Kongresin**

**e Berlinit jonë thonë gjona të cilat janë mësue n'optikën e shokut Enver, qysh i ka vy atj<sup>191</sup>. (ora 1:43:20 -1:44:18)**

● Nuk them se Anglia në Konferencën e Ambasadorëve të mbajtur në Londër në vitin 1913 nuk ka dhënë kontributin e saj për krijimin e çerek-Shqipërisë të vitit 1913 që kemi edhe sot. Por kjo nuk e shfajëson aspak as Anglinë dhe as Fuqitë e tjera të Mëdha, kur ato në Konferencën e Londrës të vitit 1913, edhe 1/3 tjetër të viseve të gjithmbarshme të shqiptarëve ua falin tri vendeve aleate të Rusisë (Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë). Prandaj nuk e di pse zoti O'Connell, që ka qenë ambasador i Anglisë në Kosovë, na qenka **çuditur** aq shumë, kur shqiptarët në "Facebook" e paskan pyetur: *Pse edhe Anglia ka kontribuuar për copëtimin e tokave të shqiptarëve, qoftë në Kongresin e Berlinit të vitit 1878, qoftë në Konferencën e Ambasadorëve të mbajtur në Londër në vitin 1913?*

● E vërteta se Fuqitë e Mëdha, ku ka bërë pjesë edhe Anglia, brenda viteve 1878-1912 rreth 2/3 e viseve të gjithmbarshme të shqiptarëve ua kanë aneksuar Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë, tanimë paraqet një fakt global historik, që nuk mund ta mohojë askush. Prandaj s'ka dyshim që edhe Anglia ka pjesën e saj fajit dhe të mëkatit, për ndarjen dhe copëtimin e tokave të shqiptarëve.

● Se Anglia, Gjermania dhe Fuqitë e tjera të Mëdha i kanë ndarë dhe copëtuar viset e shqiptarëve (viset e Shqipërisë), për këtë nuk është shkruar vetëm në librat e historisë në gjuhën shqipe, të bëra sipas Spahiut nën optikën e shokut Enver, por për këtë është shkruar edhe në shumë punime shkencore, të hartuara nga historianë anglezë, gjermanë dhe të tjerë. Shtrohet pyetja: *Mos vallë edhe këta historianë kanë shkruar nën optikën e shokut Enver?!*

● Mos vallë edhe historiani anglez, Noel Malcolm, i cili në librin e tij "Kosova - një histori e shkurtër", po ashtu ka shkruar për padrejtësitë e bëra ndaj shqiptarëve nga Fuqitë e Mëdha, ku kanë bërë pjesë edhe Anglia e Gjermania. Mos edhe ai këto të vërteta historike të hidhura, i ka shkruar nën optikën e shokut Enver Hoxha?!

Spahiu është kapur pas shokut Enver (Enver Hoxhës) si ai qorri

---

<sup>191</sup> Nexhmedin Spahiu në "Oksigen", pjesa 1, 13.11.21 <https://www.youtube.com/watch?v=gmCJhoFX-Ps>

pas pleshtit, edhe atëherë kur faktet madhore historike nuk e kanë as lidhjen kauzale më të vogël me Enver Hoxhën, të cilin Spahiu e quan me ironi *shoku Enver*. Me sa duket, ai edhe kur flamoset e teshtin, fajin ia lë shokut Enver!

### **Shqiptarët u janë falënderues të gjitha vendeve që kanë ndihmuar për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës**

● Por gabimet e Anglisë dhe të Gjermanisë të bëra ndaj shqiptarëve në të kaluarën, nuk kanë asgjë të përbashkët me Gjermaninë dhe Anglinë e sotme, të cilat bashkë me SHBA-në dhe vendet e tjera aleate, kanë dhënë ndihmën e tyre madhore për çlirimin e Kosovës në vitin 1999 dhe për pavarësimin e Kosovës në vitin 2008. Për këtë shqiptarët u janë shumë mirënjohës Anglisë, Gjermanisë, SHBA-së dhe të gjitha vendeve të tjetra, që brenda harkut kohor 1999-2008 ndihmuan në çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës.

### **E vërteta historike nuk e dëmton dhe nuk e falsifikon historinë**

● Dua t'i them Spahiut, se theksimi i fakteve historike, të cilat flasin se Fuqitë e Mëdha ku ka bërë pjesë edhe Anglia e Gjermania, 2/3 e viseve të shqiptarëve ua kanë falur Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë, nuk paraqet as dëmtim e as falsifikim të historisë, por përkundrazi paraqet ndriçim të të vërtetave të hidhura historike, të cilat nuk mund të eliminohen me suvatime. Historiografia shqiptare nuk është një vend pelegrinazhi, ku falen mëkatet historike të Fuqive të Mëdha, të bëra ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve.

● Mendoj se Spahiu duke qenë i dhënë pas krijimit nga pjesa e kombit shqiptar në Kosovë të “kombit kosovar”, ai kombin shqiptar e urren aq shumë, saqë Fuqive të Mëdha me zemërgjerësinë më të madhe ua fal mëkatet e tyre të bëra ndaj kombit shqiptar. Por nuk janë të gjithë shqiptarët as Nexhmedin Spahiu e as Jusuf Buxhovi! Shumica e tyre i përjetojnë me dhimbje të mëdha padrejtësitë e Fuqive të Mëdha, përfshirë këtu edhe ato të Anglisë e të Gjermanisë, të bëra ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve.

## 22

---

### AS SERBËT, AS GREKËT DHE AS BULLGARËT NUK JANË ISLAMIZUAR NË MASË TË MADHE GJATË SUNDIMIT OSMAN

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se gjatë sundimit pesëshekullor të Perandorisë Osmane në Ballkan, nuk ka ndodhur ndonjë islamizim masiv i serbëve, i bullgarëve dhe i grekëve, siç pohon Nexhmedin Spahiu, duke shpikur gjëra të paqena.

Përkundrazi, serbët, grekët dhe bullgarët duke qenë të besimit të krishterë të rritit ortodoks, ata i ka mbrojtur vazhdimisht Kisha Ortodokse Serbe dh Ruse nga islamizimi masiv. Por edhe duke mos qenë Perandoria Osmane një perandori, e cila ka synuar me çdo kusht islamizimin e popujve të krishterë, edhe kjo ka bërë që serbët, grekët dhe bullgarët, pothuajse të mos islamizohen fare gjatë sundimit pesëshekullor osman.

Spahiu lidhur me krijim-formësimin e kombit serb ka shkruar si në vijim:

■ **Vuk Karaxhiçi (1787-1864) ka insistuar që kombin serb ta përbëjnë serbët e të gjitha religjioneve, mirëpo nuk pati sukses. Doli që serbët ortodoksë veten e konsideruan serbë të rendit të parë, ndërsa serbët katolikë si të rendit të dytë, kurse serbët myslimanë si serbë të rendit të tretë<sup>192</sup>.**

---

<sup>192</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit* <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

● Spahiu duke na treguar se si kombi serb nuk është krijuar sipas ideve të babait shpirtëror të kombit serb, Vuk Karaxhiçit, ai për mendimin tim dëshiron të na thotë se edhe kombi shqiptar nuk është krijuar ashtu siç kanë dashur rilindësit shqiptarë. S'ka dyshim se kombi shqiptar nuk është krijuar ashtu siç kanë dashur rilindësit shqiptarë, sepse Fuqitë e Mëdha 2/3 e viseve të shqiptarëve gjatë viteve 1878-1912 ua kanë aneksuar Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë.

### **Gjatë sundimit osman nuk ka pasur islamizim masiv të serbëve, bullgarëve dhe grekëve**

Më tej Spahiu duke folur për gjoja islamizimin masiv të serbëve, bullgarëve dhe grekeve, është shprehur si në vijim:

■ **Për shembull në shekullin e 19-të edhe në shekullin e 18-të 40% e serbëve ishin t'islamizuar, 45 % të grekëve ishin t'islamizuar, mbi 45% e bullgarëve po ashtu ishin t'islamizuar. Por kur lindi ideja e krijimit të kombit serb, kombit grek, kombit bullgar, ajo nuk ishte definue si te shqiptarët. Por aty bullgar ose grek u quajt vetëm ai i cili e ka fenë ortodokse. Vetëm ai që e flet gjuhën serbe dhe që oshtë ortodokse oshtë qujt serb, ndërsa ata që ishin të islamizuar u qujtën trup i huaj: Ose u dëbuan, ose u vranë, ose u kthyen me dhunë sërish në fenë ortodokse<sup>193</sup>. (min. 24:30 - 25:12)**

■ **Kur ka lind shteti serb 40% të serbëve kanë qenë myslimanë... por si komb serb është definue serb vetëm ai që oshtë ortodoks, kush u kon musliman ja ja kanë pre kryt, ja e kanë përzon në teritore tjera, ose kanë kthye prapë e kanë konvertue n'ortodoks<sup>194</sup>. (56:29 - 56:40).**

Dhe Spahiu vazhdon edhe më tej si më poshtë:

■ **Serbi katolik nuk ekziston se ai me kohën u bo kroat, sepse nuk e kanë pranue në gjinin e vet, ose serbi mysliman...sepse u përzie me boshnjakë dhe i ka hup fara<sup>195</sup>. (min. 34:47 - 35:01).**

<sup>193</sup> Nexhmedin Spahiu, mysafir i Mustafa Nanos në *Ora News*, <https://www.youtube.com/watch?v=Sc9YSOpYfXo>

<sup>194</sup> Debat i nxehtë "Kombi kosovar" me Nexhmedin Spahiu, *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

<sup>195</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio "Sharri". (Aktualitete - 30.03.2021) <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

● Shtrohet pyetja: *Ku e gjeti Spahiu argumentin historik, sipas të cilit, rreth gjysma e kombit serb (40%) gjatë sundimit osman paska qenë e islamizuar, kur fakte relevante historike që do ta vërtetonin këtë pohim të Spahiut, nuk ka as edhe në literaturën më ultrashoviniste serbe?*

● Ose ku e gjeti Spahiu argumentin historik, sipas të cilit, meqë serbët e besimit ortodoks nuk i kanë pranuar në gjirin e tyre serbët besimit katolik, këta të fundit qenkan asimiluar në kroatë, dhe ku e gjeti Spahiu argumentin historik, sipas të cilit, meqë serbët e besimit ortodoks nuk i kanë pranuar në gjirin e vet serbët myslimanë, këta të fundit ose qenkan dëbuar, ose qenkan vrarë, ose qenkan asimiluar në boshnjakë myslimanë.

● S'ka dyshim se nuk ekziston asnjë argument serioz historik, i cili do të vërtetonte se 40% e serbëve gjatë sundimit osman na qenkan islamizuar, dhe meqë ata nuk qenkan pranuar si serbë nga serbët ortodoksë, na qenkan konvertuar në boshnjakë myslimanë, dhe po ashtu nuk ka asnjë argument historik, i cili do të vërtetonte, se një pjesë e madhe e serbëve paskan qenë e besimit katolik, dhe meqë ata nuk qenkan pranuar si serbë nga serbët ortodoksë, qenkan konvertuar në komb kroat.

### **Kisha Ortodokse Serbe dhe Rusia cariste**

#### **kanë pamundësuar islamizimin masiv të serbëve**

● Kisha Ortodokse Serbe duke qenë edhe gjatë sundimit osman një kishë e organizuar mirë, e fantizuar dhe fuqishme, ajo si e tillë ka pamundësuar islamizimin masiv të kombit serb. Edhe Rusia cariste, edhe Kisha Ortodokse Ruse duke mbrojtur qenien serbe ortodokse edhe gjatë sundimit osman, po ashtu kanë pamundësuar islamizimin masiv të kombit serb.

● Kështu, gjatë sundimit osman ka mundur të ketë individë serbë, ose grupe të vogla të individëve serbë të islamizuar, por nuk ka ndodhur që pjesë të mëdha të kombit serb të jenë islamizuar. Prandaj, pohimi i Spahiut, sipas të cilit gjatë sundimit osman rreth 40% e serbëve ka qenë të islamizuar, nuk qëndron aspak.

## **Teza e serbëve të islamizuar i shkon përshtat Akademisë së Shkencave të Serbisë**

Thënia e Spahiut, sipas të cilës gjatë sundimit osman 40% e serbëve kanë qenë të islamizuar, shkon në favor të njëjës nga tezat e shumta shoviniste të Akademisë së Shkencave të Serbisë. Kjo akademi duke u thirrur në tezën false të serbëve të islamizuar gjatë sundimit osman, gjatë viteve '80-të të shekullit XX, teksa shqiptarët kanë demonstruar që Kosovës t'i njihej statusi i Republikës, ka dalë me tezen e saj shoviniste sipas të cilës shqiptarët e Kosovës, nuk ishin shqiptarë, por ishin ish-serbët e islamizuar gjatë sundimit osman.

### **Ku u tretën rreth**

#### **6 milionë serbë të islamizuar?!**

● Nëse sot kemi gjithsej rreth 8 milionë banorë serbë të besimit ortodoks (7 milionë në Serbi dhe 1 milion në Republika Sërpska në Bosnjë), kjo tregon se nga ata 40% të serbëve dikur të islamizuar (siç na pohon Spahiu), sot do të duhej të kishim edhe rreth 6 milionë serbë të tjerë të islamizuar. Shtrohet pyetja: *Ku u tretën këta rreth 6 milionë serbë të islamizuar?*

● Meqë në Turqi ka miliona qytetarë turq me origjinë shqiptare dhe boshnjake, por nuk ka qytetarë turq me origjinë serbe, kjo tregon se ata 6 milionë serbë të islamizuar nuk janë dëbuar në Turqi. Dhe meqë ata nuk janë dëbuar në Turqi, atëherë del se ata janë vrarë e mbytur nga serbët ortodoksë, siç pohon edhe Spahiu?! Por, merreni me mend të jenë vrarë e mbytur 6 milionë serbë të islamizuar nga serbët ortodoksë, dhe të mos ketë fare argumente historike për këtë krim monstruoz, siç nuk ka! Mungesa e argumenteve historike për këtë krim monstruoz, tregon se pohimi i Spahiut, sipas të cilit 40% e serbëve kanë qenë serbë të islamizuar, nuk është tjetër, veçse një shpikje e tij.

● Dihet se nazistët gjermanë gjatë Luftës së Dytë Botërore kanë deportuar dhe vrarë rreth 6 milionë hebrenj, një akt ky gjenocidal që ka ngritur tërë botën në këmbë! Por, çuditërisht, për vrasje-mbytjen e rreth 6 milion serbëve myslimanë nga ana e serbëve ortodoksë, askush nuk di dhe askush nuk ka reaguar! Ky krahasim flet se sa i pavërtetë dhe sa monstruoz është pohimi i Spahiut, sipas

të cilit gjatë sundimit osman rreth 40% e serbëve paskan qenë të islamizuar.

### **Një pjesë e fiseve iliro-arbërore janë asimiluar në fise sllavo-serbe**

● Në fakt ka ndodhur e kundërta! Siç kemi cekur edhe më lart, një pjesë e fiseve ilire-arbërore gjatë mesjetës së mesme (shekujt 9-12) dhe mesjetës së vonshme (shekujt 13-15), duke qenë të nënshtruara nga fiset agresive sllave të ardhura në Ballkan, janë detyruar që ta braktisin besimin e tyre katolik romak, duke kaluar në besimin e krishterë ortodoks të fiseve sllave, gjë që ka çuar edhe në asimilimin e tyre në fise sllave. Por Spahiu nuk flet aspak për asimilimin e fiseve iliro-arbërore në fise serbe ortodokse, por flet për serbë të islamizuar gjatë sundimit osman, edhe pse serbët e islamizuar gjatë sundimit osman kanë mund të numërohen me gishtat e duarve.

### **Gjatë sundimit osman nuk ka pasur islamizim masiv të grekëve**

Spahiu lidhur me islamizimin e grekëve gjatë sundimit osman është shprehur si në vijim:

- **45 % të grekëve ishin t'islamizuar**<sup>196</sup>. (min. 24:35 - 24:37)
- **Edhe grektë njisoj jonë konë, 35% t'grekve jonë konë musliman**<sup>197</sup>. (min. 57:38 - 57: 43)

### **Kisha greke, Rusia dhe Gjermania nuk e kanë lejuar islamizimin masiv të grekëve**

Edhe thënia e Spahiut se rreth 45% ose rreth 35% e grekëve, gjatë sundimit osman kanë qenë të islamizuar nuk qëndron. Grekët në saje të veprimit të tre faktorëve të fuqishëm, nuk janë islamizuar masivisht gjatë sundimit osman. Këta faktorë kanë qenë:

**Faktori i parë** ka pasur të bëjë me Kishën Ortodokse Greke, e cila

<sup>196</sup> Nexhmedin Spahiu, mysafir i Mustafa Nanos në *Ora News*, <https://www.youtube.com/watch?v=Sc9YSOpYfXo>

<sup>197</sup> Debat i nxehtë "Kombi kosovar" me Nexhmedin Spahiun, "Valamala Show", më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

ashtu si Kisha Ortodokse Serbe, duke qenë edhe gjatë sundimit osman shumë e organizuar dhe e fanatizuar, ajo si e tillë nuk e ka lejuar islamizimin e ndonjë pjese të madhe të kombit grek.

**Faktori i dytë** ka qenë Kisha Ortodokse Ruse dhe Rusia cariste, të cilat duke qenë edhe gjatë sundimit osman në mbrojtje të ortodoksisë greke, po ashtu e kanë pamundësuar islamizimin e ndonjë pjese të madhe të kombit grek.

**Faktori i tretë** ka qenë Gjermania. Kjo e fundit duke qenë e dhënë pas kulturës së lashtë greke dhe duke qenë e angazhuar për rimëkëmbjen e kombit grek, që nga gjysma e dytë e shekullit XVIII e deri në fillim të shekullit XX jo vetëm që e ka pamundësuar islamizimin e ndonjë pjese të madhe të kombit grek, por edhe e ka mundësuar tjetërsimin e shqiptarëve dhe të vllahëve ortodoksë në grekë. Kështu, pohimi i Spahiut, sipas të cilit gjatë sundimit osman rreth 40% e grekëve kanë qenë të islamizuar, nuk qëndron aspak.

### **Ku u tretën rreth 8 milionë grekë të islamizuar?!**

● Duke pasur parasysh se sot kemi një Greqi me 10 milionë banorë grekë të besimit ortodoks, kjo tregon se nga 40% të grekëve të islamizuar (siç pohon Spahiu), sot do të duhej të kishim edhe një popullatë tjetër greke të islamizuar prej 8 milionë banorësh. Shtrohet pyetja: *Ku u tretën këta 8 milionë grekë të islamizuar?*

● Në Turqi ka miliona qytetarë turq me origjinë shqiptare dhe boshnjake, por nuk ka as 10 mijë qytetarë turq me origjinë greke, dhe kjo flet se ata 8 milionë grekë të islamizuar nuk janë dëbuar në Turqi. Dhe meqë ata 8 milionë grekë të islamizuar nuk janë dëbuar në Turqi, atëherë del se ata janë vrarë e mbytur nga grekët ortodoksë. Por merreni me mend të jenë vrarë e mbytur 8 milionë grekë të islamizuar nga grekët ortodoksë, dhe të mos ketë fare argumente historike për këtë krim të monstruoz, siç nuk ka! Mungesa e argumenteve historike për këtë krim monstruoz flet se pohimi i Spahiut, sipas të cilit 45% e grekëve gjatë sundimit osman kanë qenë grekë të islamizuar, nuk paraqet tjetër, veç shpikjes së radhës që bën Spahiu.

## **Konvertimi i shqiptarëve dhe i vllahëve ortodoksë në grekë**

- Gjermania, duke qenë e dhënë pas kulturës së lashtë greke, ajo, siç thamë edhe më lart, që nga gjysma e dytë e shekullit XVIII e deri në dy dekadat e para të shekullit XX, duke pasur kompetenca ndërkombëtare për rimëkëmbjen e Greqisë, e ka konsoliduar dhe krijuar kombin grek, ndër të tjera edhe duke iu dhënë dorë të lirë qarqeve shoviniste greke, që ato t'i konvertonin dhunshëm shqiptarët dhe vllahët ortodoksë në grekë.
- Por Spahiu nuk tregon se sa për qind e kombit grek përbëhet nga shqiptarët ortodoksë të asimiluar dhunshëm në grekë, por flet se si gjoja 45% e grekëve qenkan islamizuar gjatë sundimit osman, edhe pse grekë të islamizuar ka pasur fare pak.

## **Greqia shqiptarët e besimit mysliman i ka konsideruar turq dhe i ka përzënë në Turqi**

- Në vitin 1821 ka filluar Kryengritja Greke Antiosmane e njohur edhe si Revolucioni Grek, të cilin e kanë udhëhequr kryesisht shqiptarët vendës (arvanitët), siç kanë qenë Teodor Kolokrotini, Marko Boçari, Laskarina Bubulina e të tjerë. Qëllimi kryesor i kryengritjes së armatosur greke ka qenë çlirimi dhe pavarësimi i Greqisë nga Perandoria Osmane.
- Perandoria Osmane në vitin 1822, nën trysninë e Revolucionit Grek, është detyruar që t'i njohë Greqisë pavarësinë shtetërore. Njohja e pavarësisë së Greqisë është shoqëruar me Marrëveshjen e Lozanës, të arritur mes Greqisë dhe Perandorisë Osmane në janarin e vitit 1923, për shkëmbimin e popullatave turke dhe greke mes këtyre dy shteteve.
- Kështu, në literaturën e kohës thuhet se nga Turqia Europiane, asokohe janë vendosur në Greqi rreth 1,5 milionë grekë ortodoksë dhe turq të krishterë, kurse nga Greqia janë vendosur në pjesë të ndryshme të Turqisë rreth 500 mijë turq dhe grekë të islamizuar gjatë sundimit osman<sup>198</sup>.

---

<sup>198</sup> Renée Hirschon: Crossing the Aegean: The Consequences of the 1923 Greek-Turkish Population Exchange: An Appraisal of the 1923 Compulsory Population Exchange Between Greece and Turkey (Studies in Forced Migration). New York 2004, ISBN 1-57181-562-7, S. 6

### **Turq dhe grekë të islamizuar janë konsideruar shqiptarët**

● Por kohët kanë ndryshuar dhe tanimë edhe shqiptarët po hulumtojnë arkivat dhe historitë e ndodhura kundër tyre, deri vonë të fshehura nën pluhurat e kohëve të kaluara. Kështu, tanimë ka fakte se ata 500 mijë turq dhe grekë islamizuar, që në vitin 1923 në sajë të Konventës së Lozanës janë përzënë nga vatrat e tyre në Greqi, duke u vendosur dhunshëm në Turqi, nuk kanë qenë as turq e as grekë të islamizuar, por kanë qenë shqiptarë të besimit mysliman, që kanë jetuar në viset e tyre në Vilajetin Shqiptar të Janinës (alias në Çamëri) dhe në Vilajetin gjysmë-shqiptar e gjysmë-maqedonas të Selanikut.

● Kjo tregon qartë se Greqia duke përzënë shqiptarët myslimanë në Turqi, sikur gjoja ata kanë qenë turq dhe grekë të islamizuar, në fakt ajo ka bërë spastrimin etnik të shqiptarëve myslimanë nga Vilajeti i Janinës dhe nga Vilajeti i Selanikut. Thënia e Spahiut, sipas të cilës 45% e grekëve kanë qenë grekë të islamizuar gjatë sundimit osman, mendoj se pa dashjen e Spahiut mbulon spastrimin etnik të shqiptarëve myslimanë nga Greqia në Turqi në vitin 1923.

● Besoj se nga ato që u thanë më lart, lexuesi i vëmendshëm do ta ketë kuptuar se pohimet e Spahiut pa asnjë fakt, sikur gjoja gjatë sundimit osman ka ndodhur islamizimi masiv i serbëve dhe i grekëve, tërthorazi dhe pa dashjen e Spahiut mbulon krimet masive serbe e greke, të ushtruara ndaj shqiptarëve sidomos nga gjysma e dytë e shekullit XIX e deri në gjysmën e parë të shekullit XX.

## 23

---

### KEQINTERPRETIMI I STATUSIT POLITIK TË SHQIPTARËVE NË JUGOSLLAVINË FEDERATIVE, NË FUNKSION TË GJOJA KRIJIM-EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit lidhur me spekulimet, që Nexhmedin Spahiu ka bërë me parimin e teorive franceze të kombit-shtet dhe me statusin diskriminues të shqiptarëve të Kosovës, derisa Kosova ka qenë pjesë e Jugosllavisë Federative, krejt kjo me qëllim që ai (Spahiu) t'i bindë (për mendimin tim që t'i mashtrojë) shqiptarët e Kosovës, sikur gjoja ata pas pavarësimit të Kosovës nuk i përkasin më kombit shqiptar, por i përkasin një kombi tjetër joshqiptar, të emërtuar nga Spahiu si “komb kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues.

**Shqiptarët në Jugosllavi nuk kanë qenë minoritet etnik,  
por kanë qenë etni dhe komb shqiptar njëkohësisht**

Spahiu duke teorizuar se si nga shqiptarët e Kosovës, sipas tij, është krijuar “kombi kosovar”, ai është shprehur si më poshtë:

■ **Ne, deri para 10 viteve jemi konë pakicë etnike. Kur vishin t'hujt na thojshin pakicë etnike. Tash kur po vjen Klintonka, kur po vjen Toni Bleri, po na thojnë Nju-Nejshen, kombi i ri e**

**tjerë e tjerë<sup>199</sup>. (min. 40:54 - 41:39)**

**■ Shqiptarët e Kosovës në Jugosllavi nuk ishin komb, ishin minoritet me gjuhën e Kardelit sepse nuk kishin shtet<sup>200</sup>. (min. 39: 48- 40:00)**

● Është e vërtetë se Kushtetuta e Jugosllavisë Federative shqiptarët e Kosovës, edhe pse kanë qenë kombi i tretë më i madh në Jugosllavi, nuk i ka definuar si komb shumicë, por i ka definuar padrejtësisht si kombësi, në kuptimin e pakicës kombëtare pak a shumë të madhe. Po ashtu është vërtetë se figurat politike ndërkombëtare (Hillary Clinton dhe Toni Bler), shqiptarët pas pavarësimit të Kosovës i kanë quajtur “kombi i ri” (New Nation).

● Por duke pasur parasysh se fjala komb në gjuhën angleze “Nation”, e ka edhe kuptimin e kombit edhe kuptimin e shtetit, emërtimi i shqiptarëve si “kombi i ri” (“New-Nation”) nga Hillary Clinton dhe Toni Bler, nuk e ka pasur kuptimin e “kombit të ri kosovar”, si do të donte Spahiu, por e ka pasur kuptimin e “shtetit të ri të Kosovës” për dy arsye:

● •E para, sepse në vitin 2008 ka ndodhur krijimi i shtetit të Kosovës dhe nuk ka ndodhur krijimi i “kombit kosovar”, dhe e dyta sepse nëse figurat politike ndërkombëtare do t`i kenë quajtur shqiptarët e Kosovës “New-Nation” në kuptimin e “kombit kosovar”, ato deri më tani do t`ia kërkonin Kosovës shumë herë krijimin e “kombit kosovar”, gjë nuk ka ndodh.

● Por Spahiu në vend që ta demaskojë Kushtetutën Jugosllave për definimin e padrejtë dhe diskriminues të shqiptarëve të Kosovës si pakicë kombëtare, ai duke u bazuar në përkufizimin e teorieve franceze të kombit-shtet, edhe vetë ka pohuar se meqë shqiptarët në Jugosllavi duke mos pasur shtet, ata nuk kanë qenë komb por kanë qenë thjesht një etni, e cila sipas tij del se me rastin e pavarësimit të Kosovës, brenda natës qenka transformuar në një “komb kosovar” politik, artificial, pa fis e pa farë.

● Por sipas teorisë gjermane për kombin shqiptarët në Jugosllavi,

---

<sup>199</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiu, “Valamala Show”, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

<sup>200</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?” - Nexhmedin Spahiu dhe Ervis Iljazaj; *ABC News Albania*, 06.11.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

duke që ata kombi i tretë me radhë sipas madhësisë, ata nuk kanë paraqitur vetëm etni shqiptare por njëkohësisht kanë paraqitur edhe komb shqiptarë, prej të cilit nuk ka mundur të krijohet një komb tjetër “kosovar”.

- \* **Nga ana tjetër, siç kemi sqaruar edhe në kapitullin e 11 të këtij libri, ekziston edhe kategoria e shteteve pa kombe. Të tilla kombe kombe pa shtete konsiderohen kurdët, palestinezët, tibetanët dhe edhe disa kombe tjera, të cilat ende nuk i kanë krijuar shtetet e tyre.**
- \* **Në Ballkan i vetmi komb pa shtet kanë qenë shqiptarët në Kosovës në kuadër të ish-Jugosllavisë Federative, të cilët me rastin pavarësisht të Kosovës, nga komb pa shtet janë bërë një lpm me shtet**

### **Shqiptarët duhet t`u referohen teorive gjermane për kombin**

● Duke pasur parasysh se teoritë franceze adekuate për përshkrimin e kombeve multi-etnike, shqiptarët ndërsa kanë jetuar brenda Jugosllavisë i nxjerrin pa të drejtë si etni por jo si komb, kurse teoritë gjermane adekuate për përshkrimin e kombeve mono-etnike, shqiptarët ndërsa kanë jetuar brenda Jugosllavisë i nxjerrin me të drejtë etni dhe komb shumicë, shtrohet pyetja: *Nëse ata shqiptarë, të cilët teorizojnë lidhur pjesën e kombit shqiptar, që dikur ka jetuar në viset e veta në kuadër të Jugosllavisë, duhet t`u referohen teorive franceze apo teorive gjermane për kombin?*

● Edhe logjika më elementare flet se ata shqiptarë (përfshi këtu edhe Spahiun) që teorizojnë lidhur me pjesën e kombit shqiptar, që dikur ka jetuar në kuadër të Jugosllavisë Federative, duhet t`u referohen teorive gjermane për kombin jo vetëm pse ato komunitetin shqiptar që ka jetuar dikur në Jugosllavi e nxjerrin si komb shumicë dhe jo si pakicë etnike, por edhe për vetë faktin, sepse parimet e tyre kanë përkuar me realitetin objektiv të të qenit të shqiptarëve kombi i tretë me radhë sipas madhësisë në kuadër të Jugosllavisë.

● Shtrohet pyetja: *Pse i duhet Spahiut që, duke u bazuar në teoritë franceze për kombin, të thotë se, meqë shqiptarët e Kosovës në kuadër*

*të Jugosllavisë nuk kanë pasur shtet të tyre, ata nuk kanë qenë komb, por kanë qenë thjeshtë një etni?*

● Spahiut i duhet të thotë se shqiptarët e Kosovës derisa Kosova ka qenë pjesë e Jugosllavisë, nuk kanë qenë komb shqiptar por kanë qenë vetëm etni shqiptare, sa për të thënë se ajo etni shqiptare e Kosovës dikur në kuadër të Jugosllavisë, me rastin e shtetbërjes së Kosovës është strukturur si një tjetër joshqiptar, i emërtuar prej tij si “komb kosovar”

---

**PIKËPAMJET JO TË DREJTA TË SPAHIUT LIDHUR  
ME STATUSIN POLITIK TË SHQIPTARËVE  
NË MAQEDONI, NË MAL TË ZI DHE NË  
LUGINËN E PRESHEVËS NË SERBI**

Në këtë kapitull shqyrtohen pikëpamjet jo të drejta të Nexhmedin Spahiut lidhur me statusin politik të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës dhe lidhur me raportet e tyre me Kosovën dhe Shqipërinë.

Spahiu duke u bazuar sërish në përkufizimin e teorive franceze të kombit-shtet, sipas të cilit komunitetet bëhen kombe vetëm kur kanë shtetet e tyre, ai shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, edhe pse ata përbëjnë 1/3 të popullatës së gjithmbarshme të vendit, nuk i konsideron komb shumicë, siç janë realisht, por i konsideron pakicë etnike shqiptare, thjesht sepse ata në Maqedoninë e Veriut nuk kanë shtet të tyre.

**Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut nuk janë pakicë etnike,  
por janë komb shqiptar shumicë**

Spahiu duke teorizuar lidhur me statusin politik të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës, është shprehur si në vijim:

■ **U themi shqiptarëve në Maqedoni, Mal të Zi, e Luginë të Preshevës se jeni shqiptarë, në mos më të mirë se prishtinasit**

## **e tiranasit, të paktën jo më të këqij, por nuk jeni komb, jeni pakicë etnike<sup>201</sup>.**

● Nga thënia e Spahiut e cituar më lart, del se ai shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës në Serbi nuk i konsideron pakica kombëtare, siç i kanë definuar ata kushtetutat e vendeve në të cilat jetojnë, por i konsideron diçka më pak se kaq: si pakica etnike.

● Në fakt, derisa shqiptarët në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës, për shkak të numrit të vogël janë pakica kombëtare, shqiptarët në Maqedoninë e Veriut për vetë faktin se paraqesin 30% të popullatës së gjithmbarshme të Maqedonisë, janë një shumicë kombëtare, si edhe shumica kombëtare maqedone.

● Spahiu duke iu thënë shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut se nuk janë komb, por janë pakicë etnike, ai kësisoj miraton definimin diskriminues të shqiptarëve në viset e tyre në Maqedoninë e Veriut si pakicë kombëtare nga ana e kushtetutës së Maqedonisë së Veriut.

● Por unë nuk çuditem me Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut, e cila për vetë faktin se është hartuar nga shovinistët maqedonë, ajo i diskriminon shqiptarët në Maqedoninë e Veriut duke i definuar si pakicë kombëtare, por çuditem me Spahiun, që edhe ky si shovinistët maqedonë, u thotë shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut : **Nuk jeni komb, por jeni pakicë etnike!**

● Shqiptarët në viset e tyre në Maqedoninë e Veriut duke qenë një pjesë e konsiderueshme e kombit monoetnik shqiptar, dhe duke mos pasur përzierje etnike me kombe të tjera, ata paraqesin etni dhe komb shqiptar njëkohësisht, gjë që përputhet me parimin e teorive gjermane, sipas të cilit komunitetet etnike janë etni dhe kombe, edhe kur ato ende nuk i kanë shtetet e tyre.

## **Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe në Luginë të Preshevës janë me fat që ka Kosovë dhe Shqipëri**

Spahiu shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës në Serbi i këshillon edhe më tej si në vijim:

---

<sup>201</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi 26 gusht, 2016. *Dritare.net*: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

■ **...Krijoni raporte miqësore me komunitetet tjera etnike në vendet ku jetoni dhe avancojeni pozitën tuaj. Mos u armiqësoni me kombet me të cilat bashkëjetoni, se qeveritë në Prishtinë e Tiranë ju tradhtojnë. Kërkoni ndihmë nga Prishtina e Tirana, por mos prisni shumë nga ato**<sup>202</sup>.

● Pajtohem me porositë e Spahiut të cituara më lart drejtuar shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës, që ata të mos të armiqësohen pa nevojë me komunitetet e tjera me të cilat bashkëjetojnë, por nuk pajtohem me porosinë tjetër të Spahiut, me formulim tejet negativ drejtuar shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës, se *“qeveritë në Prishtinë e Tiranë ju tradhtojnë”*.

● Është e vërtetë se qeveria e Prishtinës dhe e Tiranës, së paku deri më tani, nuk kanë bërë sa duhet për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës në Serbi, por po ashtu është e vërtetë se po të mos kishte një Shqipëri të pavarur që në vitin 1912 dhe po të mos kishte disa qeveri të Tiranës deri më sot, dhe po të mos kishte në këto 25 vitet e fundit një Kosovë të pavarur që nga viti 2008 dhe, për rrjedhojë, edhe po të mos kishte edhe disa qeveri të Prishtinës, sot do të kishte shumë pak shqiptarë në Maqedoninë e Veriut, kurse në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës pothuajse nuk do të kishte fare shqiptarë.

● Unë shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës do t’ju drejtohesha me një porosi tjetër me formulim pozitiv. Do t’u thosha: Kërkoni të drejtat tuaja legjitime në vendet ku jetoni, përpiquni të mos armiqësoheni me kombet me të cilat bashkëjetoni, por ndihuni me fat, që Tirana dhe Prishtina ju mbështet. Kjo, sepse në mungesë të Tiranës dhe të Prishtinës, ju në viset tuaja në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës në Serbi, do t’i kishit vetëm gjurmët tuaja, por jo edhe veten tuaj.

---

<sup>202</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi 26 gusht, 2016. *Dritare Net*: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

## **Shqiptarët e Luginës së Preshevës janë pakicë kombëtare, sepse numri i tyre është i vogël**

Spahiu duke teorizuar më tej lidhur me shqiptarët në Luginën e Preshevës është shprehur edhe si në vijim:

■ **Shqiptarët në Preshevë janë etni shqiptare por nuk janë komb se nuk e kanë shtetin e tyre**<sup>203</sup>. (min. 6:14-6:16)

■ **Shqiptarët e Preshevës janë minoritet. Kur kam qenë në Bujanoc më kanë thënë - pse ne nuk jemi komb? Iu kam thanë: pse nuk keni stadium kombëtar, bibliotekë kombëtare. Kombi nuk ka të bëjë me atë se çfarë gjuhe flet ti, por me atë që vendos vetë për të drejtat e tua**<sup>204</sup>.

● Lidhur me thëniet e Spahiut të cituara më lart, do të thosha se shqiptarët në Luginën e Preshevës janë pakicë kombëtare shqiptare, sepse numri i tyre është i vogël dhe jo pse ata nuk kanë shtet të tyre në Serbi. Nëse në Luginën e Preshevës do të kishte një milion shqiptarë, atëherë ata edhe pa pasur shtetin e tyre në Serbi, edhe pa pasur stadium kombëtar dhe bibliotekë kombëtare, nuk do të ishin pakicë etnike shqiptare, siç na thotë Spahiu, por do të ishin komb shqiptar, gjë që përputhet edhe me teoritë gjermane për kombin.

● Edhe thënia tjetër e Spahiut e cituar më lart, sipas të cilës **Kombi nuk ka të bëjë me atë se çfarë gjuhe flet ti, por me atë që vendos vetë për të drejtat e tua**, lë shumë për të dëshiruar. Kjo, sepse kur është fjala për gjuhët që fliten nga kombe të caktuara dhe që nuk fliten nga kombe të tjera, ato gjuhë i identifikojnë folësit e tyre me kombet e tyre përkatëse. Kështu, edhe gjuha shqipe për vetë faktin se ajo flitet vetëm nga kombi shqiptar, i identifikon folësit e saj me kombin shqiptar. Kështu, gjuha shqipe edhe shqiptarët në Luginën e Preshevës i identifikon me kombin shqiptar.

● Prandaj thënia e Spahiu, sipas të cilës **Kombi nuk ka të bëjë me atë se çfarë gjuhe flet ti, por me atë që vendos vetë për të drejtat e tua**, kur është fjala për gjuhën shqipe dhe kombin shqiptar nuk

---

<sup>203</sup> Nexhmedin Spahiu në "Oksigjen", pjesa e tretë, 23.09.2011: <https://www.youtube.com/watch?v=D673tLZUdIE>

<sup>204</sup> Nexhmedin Spahiu: Kushtetuta e definon kombin kosovar, të tillë e njohu Kosovën edhe SHBA-ja, *Balkan.Info*, 20 nëntor 2019. <https://klankosova.tv/nexhmedin-spahiu-kushtetuta-e-definon-kombin-kosovar-te-tille-e-njohu-kosoven-edhe-shba/>

vlen. Kjo, sepse gjuha shqipe identifikohet me kombin shqiptar dhe kombi shqiptar identifikohet me gjuhën shqipe.

### **Pajisja e shqiptarëve të Luginës me shtetësi të Kosovës i jep dorë Serbisë për pastrim etnik të tyre**

● Spahiu në një shkrim të tij në “Koha Islame” ndër të tjera ka shkruar:

■ **Kur është fjala për shqiptarët e Preshevës këtu Kosova ka më shumë përgjegjësi dhe obligime... Lugina e Preshevës frymon me Kosovën natyrshëm dhe Kosova ish dashtë që t’u jep shtetësinë gjithë qytetarëve të Luginës që e duan atë...**

**Fakti që shteti i Kosovës nuk përfshinë edhe territorin ku ata banojnë nuk duhet të jetë arsye që t’i lejë ata pa shtetësi të Kosovës. Një shqiptar i Luginës së Preshevës mund të shtroj pyetjen se pse një shqiptar i Kosovës të jetë pjesëtar i kombit, e ai të mos jetë veçse pjesëtar i një pakice etnike<sup>205</sup>.**

● Sado që propozimi i Spahiut i cituar më lart, që Kosova t’u jap shtetësi të Kosovës shqiptarëve të Luginës së Preshevës, në pamje të parë duket sa i arsyeshëm, aq edhe humanist e patriotik, megjithatë, pajisja e shqiptarëve të Luginës së Preshevës me pasaporta të Kosovës mund të ketë pasojat e saj.

● Pajisja e shqiptarëve të Luginës së Preshevës me shtetësi të Kosovës do të mund t’i shërbente Serbisë si një lehtësim teknik, që ajo t’i spastronte përfundimisht shqiptarët e Luginës së Preshevës drejt Kosovës.

● Prandaj mendoj se Kosova dhe Shqipëria nuk do të duhej që çdo shqiptari të Luginës së Preshevës, të Maqedonisë së Veriut dhe të Malit të Zi t’i japin shtetësi me procedurë të përshpejtuar, sidomos në ato raste kur ata nuk janë të përndjekur politikisht nga regjimet e vendeve në të cilat jetojnë, sepse kjo Kosovën dhe Shqipërinë do t’i bënte hisedare në spastrimin etnik të shqiptarëve nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe nga Lugina e Preshevës në Kosovë dhe në Shqipëri.

---

<sup>205</sup> *Shitja e lirë dhe veresia*, Nexhmedin Spahiu, april 21, 2022. *Koha Islame*: <https://kohaislame.com/shitja-lire-dhe-veresi-nexhmedin-spahiu/>

## **Nëse krijohet “kombi kosovar”, Kosova nuk mund të jetë shtet amë i pakicave shqiptare jashtë saj**

● Spahiu duke teorizuar më tej lidhur me shqiptarët në Maqedoni, Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës, ka thënë si në vijim:

■ **Shtet amë, shqiptarët n’Maqedoni, shqiptarët n’Mal të Zi, shqiptarët në Preshevë e kanë Shqipnën dhe Kosovën<sup>206</sup> (min. 51:27 - 51:45).**

■ **Shteti i tyre am osht edhe Kosova edhe Shqipria. (min. 22:51 -23:00)**

● Pajtohem me Spahiun se shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës shtet amë kanë Shqipërinë dhe Kosovën. Por, nëse në Kosovë do të krijohet “kombi kosovar”, për krijimin e të cilit angazhohet Spahiu ditë e natë, atëherë shteti i Kosovës e humb juridikisht dhe ndërkombëtarisht të drejtën për të qenë vend amë i shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës. Kjo, sepse duke qenë “kombi kosovar” një komb joshqiptar, ai nuk e ka të drejtën juridike të amësisë mbi pjesëtarët e kombit shqiptar në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës.

● Nëse në Kosovë do të krijohet “kombit kosovar” shtet amë i shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës, do të jetë vetëm Shqipëria. Dhe nëse në Kosovë do të krijohet “kombi kosovar”, kjo do t’i zbehte shumë lidhjet mes shqiptarëve të Kosovës dhe shqiptarëve jashtë Kosovës, siç janë shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës në Serbi.

● Spahiu nuk dëshiron t’i ketë parasysh të gjitha pasojat që do të kishte krijimi i “kombit kosovar” për tërë kombin shqiptar në viset e tij në Ballkan. Krijimi i “kombit kosovar” në Kosovë, siç kam sqaruar edhe në disa kapituj pararendës të këtij libri, mund t’i ndajë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar” jo vetëm shqiptarët e Kosovës e të Shqipërisë, por mund t’i ndajë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar” edhe shqiptarët brenda

---

<sup>206</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun, *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

Kosovës, brenda në Maqedonisë së Veriut, por edhe edhe në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës, duke u bërë kësisoj tërë kombi shqiptar lesh e li!

# **PJESA E GJASHTË**

---

## **KEQINTERPRETIMI I IDEVE TË RILINDËSVE KOMBËTARË SHQIPTARË NË FUNKSION TË GJOJA KRIJIM-EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit lidhur me keqinterpretimet, që Nexhmedin Spahiut i ka bërë veprimtarisë politike dhe letrare të rilindësve kombëtarë shqiptarë, me qëllim të përligjjes të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar”. Por, me veprimtarinë politike dhe letrare të rilindësve kombëtarë nuk mund të përligjet krijim-ekzistimi i “kombit kosovar”. Përkundrazi, me veprimtarinë e tyre mund të përligjet e kundërta: krijim-ekzistimi ndër shekuj i kombit monoetnik shqiptar, në tërë hapësirën etnike të shqiptarëve në Ballkan.

Të thuash se rilindësit kombëtarë shqiptarë me veprimtarinë e tyre politike dhe letrare kanë përligjur ekzistimin e “kombit kosovar”, siç aludon Spahiu, është njësoj si të thuash se “kumbullat kanë bërë rrush!”, se “gjelat kanë bërë vezë!” dhe se “dashi ka bërë qengj”. Por Spahiu nuk zgjedh mjete për ta përligjur, sipas tij, krijim-ekzistimin e “kombit kosovar”, qoftë edhe duke e keqinterpretuar veprimtarinë politike-patriotike dhe letrare të rilindësve kombëtarë shqiptarë.

Është e turpshme të manipulosh me veprimtarinë politike dhe letrare rilindësve kombëtarë shqiptarë, për të nxjerrë prej tyre atë që ata as nuk e kanë menduar dhe as nuk e kanë synuar: bazën teorike, e cila do ta përligjte ndarjen e kombit shqiptar në dy

apo më shumë kombe. Por Spahiu nuk mërzhitet për trup. Ai e ka “lëkurën e trashë”. Është si “breshka me kapak!”

### **Idetë e rilindësve kombëtarë shqiptarë për kombin janë në përputhje me idetë e filozofëve gjermanë për kombin**

Spahiu në përpjekjet e tij për ta përligjur ekzistimin e “kombit kosovar”, përveç rilindësve kombëtarë ka implikuar edhe fjalorin e Oksfordit dhe akademikët shqiptarë. Kështu, ai ka shkruar si në vijim:

■ **Shqiptarët më të ditur që kanë teorizuar për kombin si Gjergj Fishta, Branko Merxhani, Vangjel Koça, Sami Frashëri, Vaso Pasha, Nebil Çika etj., nuk kanë komunikuar me fjalor të shokut Enver, por me fjalor që e kupton bota. Për ta kombi dhe etnia kanë pas dallim<sup>207</sup>.**

Dhe Spahiu lidhur me këtë temë është shprehur edhe si më poshtë:

■ **Vetëm t’ju përmend emrat të cilët janë marr me teori të kombit, të gjithë këta brenda 70-të viteve të fundit kanë qenë të ndaluar: Branko Merxhani, Vangjel Koça, Nebil Çika, Gjergj Fishta, asnjëri prej tyre nuk njihen që janë marr me teorinë e kombit<sup>208</sup>. (min. 43:02 - 43:38)**

### **Për rilindësit kombëtarë shqiptarë etnia dhe kombi kanë paraqitur të njëjtën gjë**

● Sipas thënieve të Spahiut të cituara më lart, del se, meqë rilindësit paskan komunikuar me fjalorin që e kupton tërë bota (aludim për fjalorin e madh të Oksfordit), ata paskan bërë dallimin mes etnisë dhe kombit, gjë që përkon me teorinë franceze për kombin, të vlefshme për kombet multietnike, por jo edhe për kombet monoetnike, siç është edhe kombi shqiptar.

● Por ky konstatim i Spahiut nuk qëndron, sepse pikërisht në fjalorin, të cilin e kupton tërë bota (fjalorin e Oksfordit), kombi është përkufizuar si konstrukt etnik, historik, gjuhësor dhe kulturor, në përputhje me teorinë gjermane për kombin, sipas të cilave mes

<sup>207</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi 26 gusht, 2016. *Dritare Net*: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

<sup>208</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?” - Nexhmedin Spahiu dhe Ervis Iljazaj; *ABC News Albania*, 06.11.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>.

etnisë dhe kombit nuk ka dallim. Kështu, del se rilindësit kombëtarë shqiptarë pikërisht duke komunikuar me fjalorin e Oksfordit, siç na thotë Spahiu, kanë mësuar se dallim mes etnisë dhe kombit nuk ka.

● Rilindësit shqiptarë nuk e kanë përkufizuar kombin sipas teorive franceze për kombin, të vlefshme për kombet multietnike, sipas të cilave etnia dhe kombi janë dy gjëra të ndryshme, por duke pasur parasysh se kombi shqiptar është komb monoetnik, ata e kanë përkufizuar kombin shqiptar në përputhje me teoritë e filozofëve gjermanë, të vlefshme për kombet monoetnike, sipas të cilave etnia dhe kombi paraqesin të njëjtën gjë.

● *Pse Spahiu i duhet dallimi mes etnisë shqiptare dhe kombit shqiptar?* Ky dallim, siç kemi sqaruar edhe shumë herë më lart, i duhet atij për të thënë se, me rastin e pavarësimit të Kosovës, nga etnia shqiptare (shqiptarët e Kosovës), sipas tij është krijuar një komb i ri “kosovar”, i cili ndryshon nga kombi shqiptar. Por kjo nuk qëndron aspak, sepse siç jemi shprehur edhe në kapituj të tjerë më lart, duke qenë kombi shqiptar në tërë hapësirën e tij etnike komb monoetnik, prej tij nuk mund të krijohet një komb tjetër joshqiptar në formën e “kombit kosovar”.

● Mendoj se Spahiu duke thënë se rilindësit shqiptarë kanë bërë dallimin mes etnisë dhe kombit, dëshiron që të krijojë përshtypjen se po të ishin gjallë rilindësit kombëtarë, ata do të pajtoheshin me idenë e Spahiut, sipas së cilës në Kosovë nga etnia shqiptare na qenka krijuar një komb tjetër “kosovar”. Por rilindësit kombëtarë kanë qenë aq shumë të dhënë pas bashkimit të kombit shqiptar brenda një Shqipërie të vetme, sa që penat e tyre do të nxirrnin edhe zjarr kundër ideve të Spahiut për ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

● Rilindësit kombëtarë shqiptarë njësoj si edhe filozofët gjermanë, që janë përpjekur për bashkimin e kombit gjerman në një Gjermani të vetme, janë përpjekur për bashkimin e kombit shqiptar në një Shqipëri të vetme.

● Spahiu duke thënë se rilindësit kombëtarë shqiptarë kanë bërë dallimin mes etnisë shqiptare dhe kombit shqiptar, ai kështu përpjeket që rilindësit kombëtarë të vdekur para më shumë se një shekulli, tani t'i bëjë argatë të tij për ta propaganduar krijim-ekzistimin e “kombit kosovar” edhe në emër të tyre.

## KEQINTERPRETIMI I VEPRIMTARISË POLITIKO-PATRIOTIKE DHE LETRARE TË GJERGJ FISHTËS, NË FUNKSION TË PËRLIGJES TË GJOJA KRIJIM-EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”

Në këtë kapitull dua t’i sqaroj lexuesit lidhur me keqinterpretimin që Nexhmedin Spahiu i bën veprimtarisë politiko-patriotike dhe letrare të Gjergj Fishtës, për ta përligjur kësisoj krijim-ekzistimin, sipas tij, të “kombit kosovar”.

Gjergj Fishta, autori i “Lahutës së Malësisë”, një vepër kjo monumentale e epikës popullore shqiptare, në kundërshtim me ato që thotë Spahiu për të, ai në asnjë shkronjë apo rresht të shkrimeve të tij nuk ka dhënë asnjëherë ide për kombin, të cilat do ta përligjin ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe: në komb shqiptar dhe në “komb kosovar”.

Përkundrazi, tërë veprimtaria politiko-patriotike dhe letrare e Gjergj Fishtës përshkohet nga filli i kuq i ideve dhe i frymëzimeve të tij të zjarrta patriotike, për konsolidimin dhe bashkimin e kombit shqiptar në një Shqipëri Etnike.

### Sqarim lidhur me shkrimin e Gjergj Fishtës “Udha që duhet ndjekë”

● Spahiu në artikullin e tij me titull “Kombi kosovar dhe Gjergj Fishta”, për të na bindur se Gjergj Fishta ka bërë dallimin mes koncepteve *etni* dhe *komb*, na vë në dispozicion shkrimin e Gjergj

Fishtës me titull: “Udha që duhet ndjekë”, të publikuar nga Fishta në vitin 1916<sup>209</sup>.

● Por kushdo që lexon me kujdes shkrimin e Fishtës “Udha që duhet ndjekë”, sheh se aty nuk është qoftë edhe një rresht i vetëm, i cili flet për dallimin mes etnisë dhe kombit, dhe sheh se ai shkrim i Fishtës nuk përmban asnjë ide apo teori për kombin, që do ta përligjte krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

● Fishta në shkrimin e tij “Udha që duhet ndjekë” në njërën anë ka evidentuar fenomenet negative, që asokohe kishin kapluar kombin shqiptar, kurse në anën tjetër jep këshilla dhe ide, për eliminimin e fenomeneve të tilla negative nga shqiptarët, eliminimi i të cilave do të çonin në përparimin dhe bashkimin e kombit shqiptar.

● Më poshtë është dhënë shkrimi i Fishtës, “Udha që duhet ndjekë”, i publikuar nga Spahiu në shkrimin e tij “Kombi kosovar dhe Gjergj Fishta”.

### ***Udha që duhet ndjekë***

Shùm pûnë t’mdhaja kan ndodhë n’kto kohë të mrame n’shekull e sidomos n’Shqypni! N’vjetë 1908, Konstitucjoni i Tûrkis; n’1909-1910 kryengritja shqyptare e ushtria i Turgut Pashës; n’1912, lufta e Ballkanit e indenpendenca e Shqypnis e lufta europiane në 1914; te vona, n’1915, t’ardhant e malazezeve në Shkoder e t’hinkut e serbve neper Shqypni; në e s’mramit t’himt e ushtris auto-ungare nder ne.

Por nder t’gjitha kto pûnë e ndodhi t’mdha, neper t’cillat u pershkruem n’tetë vjet, shka fituen na e n’shka xuem mend ma teper? Mjerisht do të thomë se kurr ma teper nuk asht diftue fmî shqyptari, si n’kto kohë të mrame, e se jo veçse kemi fitue gja ma teper, por edhe shka na kje dhanë neper tjerë, u xuer prej nesh. Mjaft me ja lshue syt pa pajë e me gjak t’ftoftë, si i thonë, vepres, qi na kemi zhdrivillue n’kto tetë vjetë, pse menjherë kemi me vertetue se na jemi prû, jo ndryshe, veç si fmî e si zeza e vedvedit qi kemi kënë gjithmonë. Po e xam: Mretin tonë nuk e ka nxjerrë prej Shqypniet as inglizi as Franca as Rusia vetun, por e kan xjerrë shqyptarët!

---

<sup>209</sup> *Kombi kosovar dhe Gjergj Fishta*, 21. 02.2011: <https://telegafi.com/kombi-kosovar-dhe-gjergj-fishta><https://telegafi.com/kombi-kosovar-dhe-gjergj-fishta/>

Veç po se megjithkta nuk mund u vëhet shûm faj shqyptarve; pse per me pasë mùjtë me nxjerrë ndoj fare fitimit prej ktyne ndrrimevr e ndodhive t'ndha, ishte lypë qi shqypitari t'kuptonte ma para se shka asht një Shqypni e madhe, një atdhe qi perfshîn kombin marë. Por, per fat t'keq, kto pûnë shumica e madhe e shqyptarve nuk ka pasë si me i diejt, ase mos tjetër nuk ja u ka ndie nevojen; pse gjênda e jetës, n't'cillen e ka pasë perngujue fati i zi i veti e egoizmi e zêmra e keqe e njerzve s'i ka lane me i diejt a me i ndie kto pûnë.

Shteti ase atdheut, t'cillin e lypë aj shpirti e natyre e nierit, nuk asht rrethi i hapët i atij vendit, kû jetojnë t'gjith njerzt, qi kan s'bashkut gjakun, gjuhën, fën etj., por asht njaj rreth vendit e njaj numer gjindsh, me t'cillët nieri ka s'bashkut, jo vetem gjakun e gjûhen, por edhë interesat e veta, e neper t'cillët atij i bahet ma i lét e ma i udobët gjallimi mí shekull.

Tashti, tuj kênë qi prej mungese t'mjeteve t'perpjekunit, fiset e krahinat e Shqypnis s'kan pasë mundet me u thanë, kurrnjifarë marredhanjet njani me tjetrin, kshtû mund t'thohet se, me e peshue pûnen hollë-hollë, shteti ase atdheu i shqyptarit ka kênë, jo Shqypnia e madhe nder kater vilajete; por kater kufijt e bajrakut, ase t'asaj krahînës s'vet; e prandej pûna e Shqypnis marë nuk ka mujtë me e pershkue shpirtin e tij sa duhet e sa e lypë e mira e një atdheut marë.

Ç'interesë ka mujtë me pasë shalnjani, i pa shkollë, me vû kryet e vet n'rrezik per korçarin, me t'cillin s'ka pasë der sod kurrfarë t'perpjekunit? Kshtu, kroati e serbi një fisit janë, por megjithkta sod gjinden n'luftë njani me tjetrin; pse, tuj pasë interesat e jetës, t'dame prej shoqishojt, ata edhë shtetin e atdhen e kan t'dam. Gjaku e gjûha nuk janë atà qi e perbajnë atdhen; janë vetem mjete, neper t'cillat njerzt ma udobisht i perpjekin intereset e jetës njani me tjetrin.

Nuk mund i vëhet, pra, shum faj shqyptarit, pse nder pûnë e ndodhi t'ktyne kohve t'mrame, nuk ka diejt me u sjellë e me u prû, si e ka lypë nevoja e interesja e Shqypnis marë. E prandej, edhë populli shqyptâr nuk ka me mùjtë kurr me u vû në hulli t'gjytetnis, po nuk u perftue n'mênde të tij shllimi ase ideja e jetës s'shoqnueshme; e se rrethi i një bajrakut nuk i mfajton atij, per me e ba t'udobët e t'lët gjallimin mí shekull.

Per ket arsye andej sejcilli shqyptàr a i huej, qi verevertè don me e pa t'gjetetnuem kombin tonë, aj mas'parit do t'mundohet me ba, qi shqiptari ta kuptojë e ta ndiej nevojen e jetës së shoqnueshme, tuj ja sjellë t'gjitha njato njete, neper t'cillat perbahet shoqnija njerzore e gjytetnueme, e tuj u mundue me ja largue elementat, qi i kindershtohen ksaj jete t'shoqnueshme.

Mjetet má t'parat, per me u ndertue shoqnija njerzore e gjtetnueme, janë t'perpjekunat e mëndes e t'vepres s'nieir me mēnde e veper të njerzve tjerë; pse vetem n'ket mnyrë njerzit munden me i nîmue njani-tjetrin, e kshtû me e ba ma t'lèt gjallimin mí shekull, shka asht qellumi i parë i shoqnîs. Kur nieri shef se n'shoqni jeta gzohet má mirë, atherë arsyja vetë i thotë, qi mos me u largue shoqnijet, por me e rregullue sa má mirë, e me e hapë e zhgjanue njaq, sa t'lypet per me u ba gjallimi i lèt e i kandshem.

Pra ndaçim me e pa vendin tonë t'gjetetnuem, ma s'sparit do perkukdesë qi të hapen sa mshumë shkollë fillestare të mira n'Shqypni e qi neper nji shtampë t'ndershme, t'shperndahen libra t'vjefshem e fletore t'arsyshme n'popull; s'dyti duhen çilë rruga e pertrîe mjete letsie n't'perpjekun t'njanit vend me tjetrin. N'ket mnyrë shqyptarët kan me i perpjekun mendimet e shllimet e veta, edhë vepra e forxa e tyne ka me kënë e bashkueme.

Duket se t'verteten e ktyre fjalve e Nalta Komandë Ushtarake Austro-hungareze e ka kuptue ma s'mirit; pse, ç'me ditë qi vûni kamë n'Shqypni, kujdesi ma i parë i saj kjë t'çilunit e rrugave; e porosia ma e forta kjo, t'hapunit e shkollave fillestare n'Shqypni. Prandej çdo shqyptàr i urtë e i mëçem s'do udhët e mara e shkollat e mira janë agimi i parë i gjytetnîs. E ta diejn shqyptarët, qi dersa t'ngurrojn me pûnue rrugat e me la per shkolla, s'kan me kënë kurr popull i dëjë me pasë vetvetsi morale n'shekull; pse edhë ne ja u dhaçin tjerët, kan me e shpartallue kta vetë, sikurse edhë i kemi shpartallue.

### **Interpretimi i drejtë i shkrimit "Udha që duhet ndjekë"**

- \* **Fishta thotë se shqiptarët e krahinave të ndryshme, duke mos pasur komunikim e bashkim interesash mes tyre, për ta atdheu dhe shteti nuk ka qenë tërë Shqipëria me katër**

vilajete, por kanë qenë vetëm hapësirat brenda katër kufijve të bajraqeve (krahinave të vogla) të tyre.

- \* Më tej, ai thotë se Shaljani i pashkollë (shqiptari i viseve veriore që mban mbiemrin Shala), nuk ka pse ta vërë kokën në rrezik për korçarin, me të cilin nuk është takuar (“nuk ka pas t’përpjekun”) dhe nuk e lidh asnjë interes.
- \* Edhe kroati e serbi, thotë Fishta, janë të të njëjtit fis, por megjithatë, sot janë në luftë me njëri-tjetrin, sepse duke pasur interesat e ndarë, ata edhe shtetin dhe atdheun e kanë të ndarë.
- \* Fishta nëpërmjet konstatimit të mësipërm alarmon se, moskomunikimi dhe mosbashkimi i interesave në mesin e shqiptarëve të krahinave të ndryshme, bashkë me nivelin e ulët të arsimimit të tyre, mund të çojë në ndarjen e kombit shqiptar, ashtu siç ka ndodhur ndarja e ish-popullatës sllave në dy kombe: në komb serb dhe në komb kroat.
- \* Kështu, Fishta rrezikun e mosbashkimit të kombit shqiptar brenda një Shqipërie të bashkuar nuk e sheh te dallimi mes etnisë shqiptare dhe kombit shqiptar, siç mund t’i duket Spahiut, por e sheh te mosarsimimi, moskomunikimi dhe mosbashkimi i interesave mes shqiptarëve të krahinave të ndryshme.
- \* Fishta alarmon se vetëm gjaku dhe gjuha nuk mjaftojnë për ta mbajtur bashkë atdheun dhe kombin shqiptar, por duhet edhe komunikimi dhe bashkimi i interesave mes shqiptarëve të krahinave të ndryshme.
- \* Fishta duke pasur parasysh rrethanat shumë negative, brenda të cilave janë gjendur asokohe shqiptarët, ai nuk i fajëson shumë ata (shqiptarët) pse nuk kanë bërë sa duhet për interesat e tyre. Kështu, ai ka shkruar: *“Prandaj nuk mund t’i vihet shumë faj shqiptarit, pse ai në këto ngjarjet e fundit nuk ka ditë me u sjell si e ka lyp interesi i mbarë Shqipërisë”*.
- \* Fishta nëpërmjet të konstatimit të mësipërm ka dashur të thotë, se shqiptarët duke qenë të paditur e të pashkollë (si Shaljani), dhe duke jetuar të izoluar nëpër bajraçet (krahinat) e tyre pa komunikim me njëri-tjetrin, ata nuk

**mund të fajësohen shumë pse nuk kanë ditur të sillen siç e ka kërkuar interesi i mbarë Shqipërisë.**

- \* Fishta duke folur për “mbarë Shqipërinë”, flet për mbarë kombin shqiptar, dhe nuk flet për ndonjë dallim mes etnisë shqiptare dhe kombit shqiptar, dallime këto që do të çonin në ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe.**

### **Konkluzione:**

1. Gjergj Fishta në shkrimin e tij “Udha që duhet ndjekë” nuk ka shkruar aspak për ndonjë dallim mes etnisë shqiptare dhe kombit shqiptar, siç thotë z. Spahiu.
2. Përkundrazi, Fishta nëpërmjet të këtij shkrimi ka bërë thirrje, që kombi shqiptar nëpërmjet arsimimit, komunikimit dhe bashkëpunimit mes pjesëtarëve të tij të krahinave të ndryshme, të bashkohet dhe të mbrojë interesat e mbarë Shqipërisë.
3. Shkrimi i Fishtës, “Udha që duhet ndjekë”, nuk ka as më të vogël lidhje kauzale me idetë e Spahiut, për gjoja ekzistimin e “kombit kosovar”.
4. Këshillat e Fishtës dhënë shqiptarëve në artikullin e tij “Udha që duhet ndjekë”, janë aktuale edhe në kohët e sotme: Edhe sot shqiptarët për t’u bashkuar si komb, duhet të arsimohen gjithnjë e më shumë, duhet të komunikojnë mes tyre gjithnjë e më shumë dhe duhet të lidhen me interesa të përbashkët gjithnjë e më shumë.
5. Mendoj se Spahiu duke thënë se Gjergj Fishta ka bërë dallimin mes etnisë dhe kombit, dhe duke e publikuar shkrimin e tij me titull “Kombi kosovar dhe Gjergj Fishta”, ai dëshiron që kësisoj ta bëjë edhe Gjergj Fishtën hisedar të idesë së tij, për mua të mbrapshtë, të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar”.

Duke pasur parasysh se në mes të “kombit kosovar” të Spahiut dhe Gjergj Fishtës nuk qëndron as lidhja më e vogël kauzale reciproke, titulli i shkrimit të Spahiut “Kombi kosovar dhe Gjergj Fishta”, për mua paraqet titullin më jologjik në mesin e titujve të librave dhe të shkrimve që kam lexuar ndonjëherë.

---

**GJYKIME TË PAQËNDRUESHME TË SPAHIUT PËR  
RILINDËSIN E MADH SAMI FRASHËRI, NË FUNKSION  
TË PËRLIGJES SË GJOJA KRIJIM- EKZISTIMIT TË  
“KOMBIT KOSOVAR”**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit lidhur me gjykimet e paqëndrueshme të Spahiut, të bëra në adresë të krye-ideologut të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Sami Frashërit.

Spahiu na pohon se edhe Sami Frashëri, ashtu si rilindësit e tjerë, ka bërë dallimin etni-komb, me qëllim që të thotë se duke qenë etnia dhe kombi dy gjëra të ndryshme, kjo ka bërë të mundur që nga etnia shqiptare në Kosovë të krijohet një komb tjetër “kosovar”.

Por Sami Frashëri në asnjë rrethanë nuk ka qenë për ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe, por përkundrazi ka qenë promotori kryesor, i bashkimit të kombit shqiptar në një Shqipëri të bashkuar.

Për idetë komb-bashkuese të Sami Frashëri flet vet kryevepra e tij me titull: **“Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”**, brenda të cilës u ka lënë shqiptarëve programin kombëtar më të përparuar deri më tani.

Spahiu duke thënë se Sami Frashëri entinë dhe kombin i paska konceptuar si dy gjëra të ndryshme, përpiqet që edhe Sami Frashërin ta bëjë pjesë të ideve të tij komb-ndarëse: të ndarjes së kombit shqiptar në dy kombe: në komb shqiptar dhe në “komb kosovar”.

**Sami Frashëri etninë dhe kombin nuk i ka konceptuar si dy gjëra të ndryshme, por i ka konceptuar si dy gjëra të njëjta** Spahiu për t'i bindur lexuesi se si gjoja të gjithë rilindësit shqiptarë, përfshi këtu edhe Sami Frashërin, etninë dhe kombin i ka konceptuar si dy gjëra të ndryshme dhe jo si dy gjëra të njëjta, po citojmë më poshtë të njëjtën thënie të Spahiut, të cilën e kam cituar edhe më lart, sipas së cilës:

**■ Shqiptarët më të ditur që kanë teorizuar për kombin si Gjergj Fishta, Branko Merxhani, Vangjel Koça, Sami Frashëri, Vaso Pasha, Nebil Çika etj., nuk kanë komunikuar me fjalor të shokut Enver, por me fjalor që e kupton bota. Për ta kombi dhe etnia kanë pas dallim<sup>210</sup>.**

● Për vetë faktin se Sami Frashëri, si edhe rilindësit e tjerë shqiptarë, ideal jetësor nuk e ka pasur jo ndarjen, por bashkimin e kombit shqiptar, kjo flet se ai etninë dhe kombin nuk i ka konceptuar si dy gjëra të ndryshme, por i kanë konceptuar si dy gjëra të njëjta.

● Edhe duke pasur parasysh se Sami Frashëri, si edhe rilindësit e tjerë bashkimin e kombit shqiptar e kanë mbështetur mbi prejardhjen etnike iliro-arbërore të shqiptarëve, mbi historinë e Skënderbeut, mbi bukurinë e gjuhës shqipe dhe mbi trashëgiminë kulturore të shqiptarëve, kjo po ashtu tregon se Sami Frashëri kombin shqiptar e ka konceptuar si konstrukt etnik, historik, gjuhësor dhe kulturor, në përputhje me idetë e filozofëve idealistë gjermanë, sipas të cilave mes etnisë dhe kombit nuk ka dallim.

● Edhe fakti se Sami Frashëri në asnjë rresht të shkrimeve të tij nuk ka deklaruar se etnia dhe kombi janë dy gjëra të ndryshme, kjo tregon qartë se Spahiu duke thënë se Sami Frashëri etninë dhe kombin i ka perceptuar si dy gjëra të ndryshme, ai kështu Sami Frashërit i ka bërë një shpifje të madhe postmortum!

---

<sup>210</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi 26 gusht, 2016. *Dritare Net*: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

## **Sami Frashëri ka qenë i sigurt, se në viset shqiptare do të funksiononte ideja shqiptare dhe jo ideja turke**

Spahiu duke folur për rrjedhat historike të kombit shqiptar, ka shkruar si në vijim:

■ **Edhe vetë Sami Frashëri nuk ka qenë i sigurt a po funksionon ideja shqiptare a ideja turke**<sup>211</sup>. (min. 42:34 - 42:44)

● Nuk pajtohem aspak me pohimin e Spahiut, sipas të cilit Sami Frashëri nuk paska qenë i sigurt nëse në viset shqiptare do të funksiononte ideja shqiptare apo ideja turke. Edhe pse asokohe në mesin e shqiptarëve ka pasur edhe shqiptarë trukofilë, megjithatë ata kanë qenë shumë pak për ta vënë Sami Frashërin në mëdyshje: nëse në viset shqiptare do të funksiononte ideja shqiptare apo turke. Po të kishte funksionuar në mesin e shqiptarëve ideja turke, shqiptarët do të përpiqeshin që nga viset e tyre të krijonin një Turqi të dytë, dhe nuk do të përpiqeshin që nga viset shqiptare të krijonin shtetin kombëtar shqiptar: Shqipërinë.

● Sami Frashëri duke qenë i sigurt se në viset shqiptare do të triumfonte ideja shqiptare, ai ka shkruar librin “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”. Ky libër, që ka paraqitur dhe paraqet edhe sot **Biblën** dhe **Kuranin** e shqiptarëve, është botuar në vitin 1899 në Bukuresht. Që nga viti 1899 e deri në vitin 1912, kur Turqia u largua nga Ballkani, libri i Sami Frashërit, “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet” ka qarkulluar fshehurazi dorë më dorë nëpër qarqet patriotike shqiptare brenda e jashtë Shqipërisë, duke u bërë kështu një ndër promotorët kryesorë për shpalljen e Shqipërisë shtet i pavarur në vitin 1912.

## **Shqiptarët nuk janë fajtorë për mosbërjen e Shqipërisë së Sami Frashërit**

Spahiu duke shkruar për moskrijimin e Shqipërisë sipas projektit të Sami Frashërit, ka thënë si në vijim:

■ **Ju e dini që Sami Frashëri në librin “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”, i përcakton kufijtë e shtetit shqiptar,**

---

<sup>211</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun, *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

**në të cillat përfshinin Kosovën, Maqedonin Perëndimore, Sanxhakun e sotëm, Ulqinin, Çamërinë, por kjo nuk asht realizue për shkak se shqiptarët nuk kanë qenë të aftë me realizue atë projekt, edhe në fund si rezultat i rrethanave historike u realizue projekti i shtetit të Kosovës, dhe ky projekt duhet mu vlerësue si një arritje<sup>212</sup>. (min. 10:40 - 11:11)**

### **Shqipëria e Sami Frashërit nuk u bë, sepse bërjen e saj e pamundësuan Fuqitë e Mëdha**

● Është e vërtetë se Sami Frashëri brenda projektit të tij kombëtar, të paraqitur në librin e tij **“Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”**, ka parashikuar krijimin e një Shqipërie të vetme me të gjitha viset e banuara me shumicë shqiptare në Ballkan. Por nuk është e vërtetë thënia e Spahiut, sipas të cilës: **“Shqipëria e Sami Frashërit nuk u realizua, sepse shqiptarët nuk kanë qenë të aftë që ta realizonin atë”**. Sot ka argumente të padiskutueshme, të cilat flasin se Shqipëria e Sami Frashërit nuk është realizuar, sepse kundër realizimit së saj kanë qenë Perandoria Osmane dhe shumica e Fuqive të Mëdha të Europës.

● Fuqitë e Mëdha të Kongresit të Berlinit të vitit 1878 i kanë falur Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë 1/3 e viseve të gjithmbarshme të shqiptarëve, kurse Fuqitë e Mëdha të Konferencës së Londrës të vitit 1913 i kanë falur sërish Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë edhe 1/3 tjetër të viseve shqiptare, duke u krijuar kështu në vitin 1913 një Shqipëri me vetëm 1/3 e viseve të saj.

● Spahiu duke thënë se Shqipëria e Sami Frashërit nuk është realizuar, sepse shqiptarët nuk kanë qenë të aftë ta realizonin atë, ai për mendimin tim shfajëson Fuqitë e Mëdha për padrejtësitë makabre që ato kanë ushtuar ndaj kombit shqiptar, dhe në vend të tyre fajëson shqiptarët, që nuk kanë pasur asnjë faj.

● Por Spahiu duke thënë se Shqipëria e Sami Frashërit nuk është realizuar, sepse shqiptarët nuk kanë qenë të aftë ta realizonin atë, ai kështu besoj se pa dashur flet me gjuhën e regjimeve serbe e

---

<sup>212</sup> Nexhmedin Spahiu në “Oksigjen”, pjesa e tretë, 23.09.2011:  
<https://www.youtube.com/watch?v=D673tLZUDIE>

serbe-jugosllave, të cilat kanë kërkuar nga Fuqitë e Mëdha që tokat e shqiptarëve t'ua aneksonin Serbisë dhe Malit të Zi, sepse sipas tyre duke qenë shqiptarët popull pothuajse i egër, ata nuk din të bëjnë shtet.

● Fakti se shqiptarët në të kaluarën për shkak të padrejtësive historike të ushtruara ndaj tyre, nuk kanë arritur ta realizonin Shqipërinë e Sami Frashrit, kjo nuk do të thotë se shqiptarët edhe në kohet që po vijnë, nuk do të arrijn ta realizojnë Shqipërinë e bashkuar të Sami Frashrit.

### **Shqiptarët e vlerësojnë shtetbërjen e Kosovës si arritje e kombit shqiptar dhe jo e “kombit kosovar”**

Spahiu brenda thënies së tij të cituar më lart është shprehur:

■ **... si rezultat i rrethanave historike u realizue projekti i shtetit të Kosovës, dhe ky projekt duhet mu vlerësue si një arritje<sup>213</sup>. (min. 11:05 -11:11)**

● Shqiptarët e Kosovës për vetë faktin se shtetin e Kosovës e kanë krijuar me sakrifica të mëdha, nuk ka dyshim se ata e vlerësojnë atë si jetën e tyre, por jo si pjesëtar të “kombit kosovar” joekzistues, siç do të donte Spahiu, por si pjesëtar të kombit shqiptar objektiv dhe real. Nga analiza që u kam bërë shkrimeve dhe deklarimeve të Spahiut, më rezulton se ai mostjetërsimin shqiptarëve të Kosovës në “komb kosovar” e konsideron si mosvlerësim të shtetbërjes së Kosovës.

● Ajo që Spahiu nuk dëshiron të kuptojë, është fakti se shqiptarët e Kosovës edhe kur i thonë vetes kosovarë, ata i thonë vetes kështu në aspektin vendor-gjeografik, sepse vendi tyre quhet Kosovë, por shqiptarët e Kosovës nuk i thonë vetes kosovarë në aspektin e “kombit kosovar”. Për shqiptarët e Kosovës shtetbërja e Kosovës është arritje e kombit shqiptar dhe jo arritje e ndonjë kombi joekzistues “kosovar”.

● Shqiptarët e Kosovës e kanë çliruar Kosovën nga Serbia gjatë viteve 1998-1999, duke qenë komb shqiptar dhe jo duke qenë “komb

---

<sup>213</sup> Nexhmedin Spahiu në “Oksigjen”, pjesa e tretë 23.09.2011;  
<https://www.youtube.com/watch?v=D673tLZUDIE>

kosovar”. Ata edhe nga Lufta Çlirimtare e Kosovës e viteve 1989-1999 kanë dalë si komb shqiptar, siç kanë qenë shekuj me radhë, dhe jo si “komb kosovar”, siç nuk kanë qenë e nuk janë. Kështu, në Kosovë në vitin 2008 ka ndodhur krijimi i shtetit të Kosovës, por nuk ka ndodhur krijimi i “kombit kosovar”, siç na thotë Spahiu.

---

**KEQINTERPRETIMI I POEZISË SË MITRUSH KUTELIT  
“POEM KOSOVAR”, NË FUNKSION TË GJOJA KRIJIM-  
EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”**

Në këtë kapitull dua t’i sqaroj lexuesit lidhur me keqinterpretimin, që Spahiu i bën poezisë së Mitrush Kutelit me titull “Poem kosovar”, me qëllim të përligjjes së krijim-ekzistimit, sipas tij, të “kombit kosovar”. Mitrush Kuteli ka qenë emri letrar i Dhimitër Paskos, që ka shkruar poezinë me titull “Poem kosovar”.

Meqë Mitrush Kuteli (Dhimitër Pasko) kishte krijuar një simpati e dashuri të veçantë ndaj shqiptarëve të Kosovës, ai në “Poemin kosovar” si rrallëkush i ka përshkruar si vuajtjet, ashtu edhe virtytet e shqiptarëve të Kosovës, të cilët në shenjë respekti dhe adhurimi i quan simbolikisht dhe figurativisht “komb kosovar”.

Spahiu duke u thirrur në emërtimin simbolik të Mitrush Kutelit te shqiptarëve të Kosovës si “komb kosovar”, ai përpiqet që Mitrush Kutelin ta bëjë pjesë të ideve të tij komb-ndarëse: të ndarjes së kombit shqiptar në dy kombe: në komb shqiptar dhe në “komb kosovar”.

“Poemin kosovar” të Mitrush Kutelit e ka recituar me plot përkushtim dhe emocion, artisti i madh shqiptar, Mirush Kabashi, tani më i ndjerë.

## **Shprehja “komb kosovar” paraqet respektin dhe adhurimin e Kutelit ndaj shqiptarëve të Kosovës**

Spahiu lidhur me poezinë “Poem kosovar” të Mitrush Kutelit ka shkruar si më poshtë:

■ **Sintagma “Kombi Kosovar” për herë të parë është përmendur në vitin 1941 nga Mitrush Kuteli në një poezi kushtuar Kosovës<sup>214</sup>.**

● Është e vërtetë se në poezinë e Mitrush Kutelit me titull “Poem kosovar”<sup>215</sup> përmendet shprehja “kombi kosovar”, por kjo shprehje, siç sqaruam edhe më lart, nuk ka të bëjë me “kombin kosovar”, siç mund t’i duket Spahiut e ndonjë tjetri, por ka të bëjë me madhërimin që Mitrush Kutelit u bën shqiptarëve të Kosovës.

● Për të kuptuar se në “Poemin kosovar” shprehja “komb kosovar” nuk ka të bëjë me “kombin kosovar”, po japim më poshtë për lexuesit dy strofa të “Poemit kosovar”.

### **Poem kosovar**

**Jam kosovar  
pra jam shqiptar:**  
Zot e krenar,  
Zot e bujar  
mbi këtë dhe  
q’ e kam si fe.

**Komb i lirë kosovar,  
ti komb shqiptar,**  
ti Zot krenar,  
ti djalëri- ti pleqëri  
bëju gati!  
Bëhu gati  
për vrull të ri;  
ta djegësh botën  
ta bësh hi;  
për Liri!  
Për Shqipëri!

---

<sup>214</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit*; <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

<sup>215</sup> *Poem kosovar* nga Mitrush Kuteli, VOAL:

<https://www.voal.ch/poem-kosovar-nga-mitrush-kuteli/kulture/letersi/>

**Me simbolika dhe metafora bëhet letërsi,  
por nuk mund të krijohet ndonjë komb i ri**

- Siç shihet, në strofën e parë të “Poemit kosovar” të Kutelit thuhet: **“Jam kosovar, pra jam shqiptar...”**, që do të thotë se kosovari është shqiptar si të gjithë shqiptarët e tjerë dhe se ai quhet kosovar, sepse i përket Kosovës dhe jo sepse i përket ndonjë kombi tjetër “kosovar”.
- Në strofën e radhës të “Poemit kosovar” Kuteli ka shkruar: **“Komb i lirë kosovar, ti komb shqiptar”**. Për vetë faktin se Kuteli “kombit kosovar” i drejtohet duke i thënë “ti komb shqiptar”, kjo tregon qartë se ai shprehjen “komb kosovar” nuk e ka shkruar në kuptimin e ekzistimit real të “kombit kosovar”, por e ka shkruar në kuptimin e simbolikës së veçantë të shqiptarëve të Kosovës.
- Dihet se në letërsi përdoren simbolikat, hiperbolat dhe metaforat, sepse këto janë figurat letrare që përbëjnë letërsinë. Por, po ashtu dihet se me simbolika, hiperbola dhe metafora letrare nuk mund të krijohet ndonjë komb i ri “kosovar”. Prandaj, nëpërmjet shprehjes simbolike “komb kosovar” të Kutelit, nuk mund të krijohet asnjë argument, i cili do ta përlligjte ekzistimin e “kombit kosovar”, objektivisht dhe realisht joekzistues.
- Spahiu duke keqinterpretuar simbolikën e “kombit kosovar” të Mitrush Kuteli, përpiqet që edhe Mitrush Kutelin ta bëjë hisedar të idesë së ndarjes së kombit shqiptar në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”

---

## AKUZAT DHE PËRÇMIMET E SPAHIUT BËRË ELITAVE POLITIKE SHQIPTARE DHE AKADEMIKËVE SHQIPTARË, PËR MOSNJOHJEN E TEORIVE PËR KOMBIN

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se si Nexhmedin Spahiu, duke teorizuar për kombin, shumë herë i ka përçmuar dhe akuzuar si elitat politike shqiptare Tiranë-Prishtinë, ashtu edhe akademikët e Akademive të Shkencave Tiranë-Prishtinë, sepse ato, sipas tij, nga mosdija nuk bëjnë dallimin etni-komb, përkatësisht kur flasin për etninë, mendojnë për kombin.

Ofendime dhe përçmime të Spahiut në adresë të elitave shqiptare të Shqipërisë dhe të Kosovës dhe akademikëve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e të Shqipërisë, janë dhënë edhe më lartë në dy kapituj tjerë të këtij libri.

### Spahiu e përçmon shoqërinë shqiptare në Shqipëri dhe në Kosovë

Spahiu lidhur me shoqërinë shqiptare në Shqipëri dhe Kosovë, është shprehur si në vijim:

■ **Jo, kombi kosovar osht krijuar, por dijet për teorinë e kombit janë të pakta në shoqërinë shqiptare dhe në shoqërinë kosovare**<sup>216</sup>. (min. 42:56 - 43:01)

---

<sup>216</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“ - Nexhmedin Spahiu dhe Ervis Iljazaj; *ABC News*

- Me thënien e Spahiut të cituar më lart, sipas së cilës në Kosovë veç qenka krijuar “kombi kosovar”, jo vetëm unë, por edhe të gjithë shqiptarët që kanë dy sy për të parë nuk pajtohen aspak, sepse “kombi kosovare” nuk shihet askund në Kosovë.
- Spahiu në thënien e tij të cituar më lart me shprehjen “shoqëri shqiptare” nënkupton kombin shqiptar në Shqipëri, kurse me shprehjen “shoqëri kosovare” nënkupton “kombin kosovar” në Kosovë. Kështu, ai lexuesve ndarjen, sipas tij, të kombit shqiptar, në komb shqiptar dhe në “komb kosovar”, dëshiron t’ua shesë si një akt të kryer, prej të cilit s’ka kthim.
- Asnjë shoqëri në botë si tërësi nuk i njejnë teoritë për kombin / kombet, por në mesin e çdo shoqërie ka profesionistë që i njohin teoritë për kombin/kombet. Kështu, edhe në mesin e shoqërisë shqiptare në Shqipëri dhe Kosovë ka pasur dhe ka njerëz që i njohin teoritë për kombin/kombet. Por, me sa duket, Spahiu mendon se në mesin e shoqërisë shqiptare dhe “kosovare” është i vetmi njeri që ka njohuri për teoritë për kombin/kombet.

### **Elitat shqiptare etninë dhe kombin i shohin si dy gjëra të njëjta**

- Spahiu duke folur për elitat shqiptare në Tiranë dhe Prishtinë, është shprehur si në vijim:
- **Për elitën shqiptare në Tiranë e Prishtinë etnia dhe kombi ishin sinonime**<sup>217</sup>.
- Elitat shqiptare në Tiranë dhe në Prishtinë pikërisht pse kanë njohuri modeste për teoritë franceze dhe gjermane për kombin, ato duke qenë kombi shqiptar një komb monoetnik i ngritur mbi konstruktin e tij etnik, gjuhësor dhe kulturor, me të drejtë mes etnisë shqiptare dhe kombit shqiptar nuk shohin dallim dhe, për rrjedhojë, etninë dhe kombin i shohin si dy gjëra të njëjta, gjë që përputhet me teoritë gjermane për kombin.
- Spahiu do të dëshironte që elitat shqiptare në Tiranë dhe Prishtinë, etninë dhe kombin t’i kuptonin si dy gjëra të ndryshme,

---

*Albania*, 06.11.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

<sup>217</sup> Nga Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit*; <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

në përputhje me teoritë franceze për kombin, sepse kësisoj ai në mbështetje të ideve të tij për gjoja krijim-ekzistimin e “kombit kosovar”, do të kishte elitën shqiptare të Tiranës dhe të Prishtinës, të cilat ai do t’i lavdëronte duke i ngritur deri në qiell.

● Por fakti se elitat shqiptare Tiranë-Prishtinë etninë dhe kombin shqiptar i kuptojnë si dy gjëra të njëjta në përputhje me teoritë gjermane, duke mos lënë hapësirë të thuhet se nga etnia shqiptare është krijuar një komb tjetër “kosovar”, kjo e nevrikos aq shumë Spahiun, saqë ai pastaj elitat shqiptare Tiranë-Prishtinë i fyen, i përçmon dhe i banalizon.

### **Etiketimet e kundërshtarëve me emrin Stalinit apo të Enverit, ka kohë që janë bërë si “brisku i berberit”!**

Spahi u në një debat televiziv ndër të tjera ka thënë:

■ **Së pari konfuzioni osht krijue jo vetëm te na në Kosovë por në të gjitha vendet ish socialiste nga koncepti i Stalinit, i cili kombin e ka njësue me etninë...**<sup>218</sup>.

■ **N’Shqipri dhe n’Kosovë domethon kombi osht thjeshtue, osht barazue etnia me kombin edhe këto janë kuptue si sinonime. Madje edhe n’Akademi t’ Shkencave po t’shkosh e t’pysish akademikët e Shqiprisë ose t’Kosovës nuk e din dallimin.**<sup>219</sup> (min. 43:39 - 44:00)

● Spahi u nëpërmjet thënieve të mësipërme kundërshtarët e tij, të cilët duke u bazuar në teoritë e filozofëve gjermanë për kombin, nuk pajtohen me të se nga shqiptarët e Kosovës po krijohet apo është krijuar “kombi kosovar”, përpiqet t’i etiketoj jo vetëm si njerëz të prapambetur e të paditur, por edhe si njerëz me ngarkesa ideologjike staliniste.

● Fakti se teoria e Stalinit për kombin ka shumë elemente të përbashkëta me teoritë e filozofëve gjermanë për kombin, kjo nuk do të thotë aspak se akademikët ose joakademikët e Shqipërisë apo të Kosovës, të cilët e kundërshtojnë idenë e Spahiut për ekzistimin

<sup>218</sup> Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam? - Nexhmendin Spahi u dhe Ervis Iljazaj; *ABC News Albania*, 06.11.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

<sup>219</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“ - Nexhmendin Spahi u dhe Ervis Iljazaj; *ABC News Albania*, 06.11.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

e “kombit kosovar”, e bëjnë atë kundërshtim duke u bazuar në teorinë e Stalinit për kombin, por e bëjnë duke u bazuar në teoritë gjermane për kombin.

● Akademikët e Shqipërisë dhe të Kosovës nuk kanë faj pse qoftë sipas teorive gjermane për kombin, qoftë sipas teorisë së Stalinit për kombin, kur është fjala për kombet monoetnike, siç është edhe kombi shqiptar), mes etnisë dhe kombit nuk ka asnjë dallim.

● Teoritë e filozofëve gjermanë për kombin janë publikuar shumë kohë para se të publikohej teoria e Stalinit për kombin, gjë që flet se Stalini teorinë e tij për kombin e ka bazuar në teoritë e filozofëve gjermanë për kombin. Kjo është arsyeja pse mes teorive gjermane për kombin dhe teorisë së Stalinit për kombin vështirë se mund të futet edhe një fije floku.

● Prandaj Spahiu kot përpiqet që akademikët e Shqipërisë dhe të Kosovës, që nuk i shkojnë atij përshtat, t'i etiketojë me emrin e Stalinit apo të “shokut Enver”, siç shprehet ai. Kjo edhe për faktin se përpjekjet e Spahiut për njiolljen e njërit apo të tjetrit me emrin e Stalinit apo të Enverit, ka kohë që janë bërë si “brisku i berberit”!

### **Akademikët shqiptarë etninë dhe kombin shqiptar me të drejtë i kuptojnë si dy gjëra të njëjta**

Spahiu duke i përçmuar akademikët e Akademisë së Shkencave të Kosovës ka shkruar si më poshtë:

■ **Dhe kur anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës e ngatërrojnë konceptin e kombit me konceptin e etnisë, njeriu mund të mendojë se kjo është pasojë e asaj që kemi akademikë, që përveç serbishtes nuk dinë asnjë gjuhë të huaj<sup>220</sup>.**

■ **Për elitën shqiptare në Tiranë e Prishtinë etnia dhe kombi ishin sinonime. Akuzat për tradhti kombëtare, përçarje dhe prishje të unitetit të kombit shqiptar nuk pushuan për vite të tëra<sup>221</sup>.**

● Me pohimet e Spahiut të cituara më lart nuk pajtohem aspak,

<sup>220</sup> Nexhmedin Spahiu. Kombi Kosovar dhe Gjergj Fushta; 21. 02.2011:  
<https://telegrafi.com/kombi-kosovar-dhe-gjergj-fushta/>

<sup>221</sup> Koncepti i kombit, Nexhmedin Spahiu; <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

sepse elitat shqiptare në Tiranë dhe Prishtinë dhe akademikët e Akademisë së Shkencave të Kosovës, pikërisht pse kanë njohuri për teoritë për kombin/kombet, e kanë kuptuar se mes etnisë shqiptare dhe kombit shqiptar nuk ka asnjë dallim.

● Meqë akademikët e Kosovës dhe të Shqipërisë nuk u nënshtrohen mendësive të Spahiut për etninë dhe kombin, kjo e nevrikos Spahiun aq shumë, saqë ai i përçmon duke thënë se ata, përveç serbishtes, nuk njohin asnjë gjuhë të huaj. Por akademikët e Kosovës, për t'i kuptuar drejt teoritë për kombin, nuk kanë nevojë ta njohin as serbishten, sepse teoritë për kombin janë të dhëna në çdo tekst sociologjie, politologjie dhe filozofie, të publikuar në gjuhën shqipe.

### **Akademikët shqiptarë kanë mësuar nga Gjergj Fishta, se mes etnisë dhe kombit nuk ka asnjë dallim**

● Spahiu për t'i përçmuar sa më shumë akademikët e Kosovës, ndër të tjera ka shkruar edhe si në vijim:

■ **... Por, duket se akademikët në fjalë nuk e kanë lexuar mirë as Gjergj Fishtën. Në të kundërtën do ta kishin kuptuar se të paktën për Gjergj Fishtën, por edhe për rilindasit e tjerë, ka një dallim thelbësor mes konceptit të kombit dhe të etnisë<sup>222</sup>.**

● Sipas thënies së mësipërme të Spahiut, del se Gjergj Fishta dhe rilindësit e tjerë e kanë bërë dallimin etni-komb, por akademikët e Kosovës nuk e dinë këtë dallim, sepse ata, sipas Spahiut, nuk e kanë lexuar dhe kuptuar mirë as Fishtën. Por Gjergj Fishta dhe as rilindësit e tjerë shqiptarë, siç kemi sqaruar edhe në kapitujt pararendës, për vetë faktin se kanë punuar ditë e natë jo për ndarjen, por për bashkimin e kombit shqiptar, ata nuk e kanë shkruar as edhe një rresht të vetëm për ndonjë dallim mes etnisë shqiptare dhe kombit shqiptar, sepse kjo thjesht do të vinte në kundërshtim flagrant me vetë synimin e tyre për bashkimin e kombit shqiptar.

● Dhe meqë as Gjergj Fishta dhe as rilindësit e tjerë shqiptarë nuk kanë shkruar për ndonjë dallim mes etnisë dhe kombit, kjo tregon

---

<sup>222</sup> Kombi kosovar dhe Gjergj Fishta, 21. 02.2011: <https://telegrafi.com/kombi-kosovar-dhe-gjergj-fishta/>

se Spahiu kot i akuzon akademikët e Kosovës, sikur ata, sipas tij, nuk e kanë lexuar e kuptuar mirë as Gjergj Fishtën. Përkundrazi, akademikët e Kosovës, pikërisht nga veprimtaria politike dhe letrare e Gjergj Fishtës dhe e rilindësve tjerë shqiptar, kanë kuptuar se kur është fjala për kombet monoetnike, siç është edhe kombi shqiptar, mes etnisë shqiptare dhe kombit shqiptar nuk ka asnjë dallim.



# **PJESA E SHITATË**

## **PËRPIEKJET E SPAHIUT PËR T'I BINDUR PERSONALITETET NDËRKOMBËTARE, PËR GJOJA NEVOJËN E KRIJIMIT NGA SHQIPTARËT E KOSOVËS TË "KOMBIT KOSOVAR"**

Në këtë kapitull dua t'i njoftoj lexuesit, se Nexhmedin Spahiu, nëpërmjet asaj që thotë, sipas të gjitha gjasave, idetë e tij kombndarëse nëpërmjet të propagandimit të krijim-ekzistimit të "kombit kosovar", dhe idetë e tij për mospërdorimin e flamurit kombëtar shqiptar nga shqiptarët e Kosovës, i ka biseduar edhe me figura politike ndërkombëtare.

Spahiu vetë ka pohuar, se idenë e tij për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të "kombit kosovar", e ka biseduar gjerë e gjatë me Marti Ahtisarin, gjë që lë hapësirë të mendohet se ai idetë e tij kombndarëse i ka biseduar edhe me të tjerët: ambasadorin e SHBA-së, Tina Kaidanov, me kryeadministratorin e UNMIK-ut në Kosovë, Hans Hakerupin e të tjerë, kjo me qëllim që ata t'u impononin shqiptarëve të Kosovës, tjetërsimin e tyre në "komb kosovar".

Por, për fat të mirë, asnjëri nga personalitetet ndërkombëtare me të cilat Spahiu thotë se ka biseduar, nuk ua ka imponuar shqiptarëve të Kosovës tjetërsimin e tyre në "komb kosovar", gjë që tregon se ato personalitete nuk i kanë përkrahur idetë kombndarëse dhe komb-tjetërsuese të Spahiut, në raport me kombin shqiptar që jeton në Kosovë.

## **Biseda e Spahiut me Marti Ahtisarin lidhur me “kombin kosovar”**

Spahiu ka shkruar se idenë e krijimit të “kombit kosovar” e ka biseduar fillimisht me Marti Ahtisarin. Kështu, ai në një shkrim të tij është shprehur si në vijim:

**■ Madje jo vetëm Ahtisaari, me të cilin kam biseduar gjerë e gjatë idenë e kombit kosovar, por edhe Kushtetuta e Kosovës përcakton se Kosova është shtet i shqiptarëve dhe komuniteteve të tjera. Pra, i përcakton shqiptarët e Kosovës si komb<sup>223</sup>.**

● Spahiu në pohimet e tij të cituara më lart e pranon se idenë e “kombit kosovar” e ka biseduar gjerë e gjatë me Marti Ahtisarin, duke lënë të vetëkuptohet se ka kërkuar nga Ahtisari, që ai ta përkrahë idenë e tij për tjetërsimin e shqiptarëve të Kosovës nga komb shqiptar në “komb kosovar”. Por, duke pasur parasysh se Ahtisari në asnjë rresht të Planit/Dokumentit të tij nuk e përmend as edhe një herë të vetme “kombin kosovar”, kjo tregon se ai nuk e ka përkrahur idenë e Spahiut për tjetërsimin e shqiptarëve në “komb kosovar”.

● Më tej Spahiu na tregon se Ahtisari, si edhe Kushtetuta e Kosovës, duke e definuar shtetin e Kosovës si shtet të shqiptarëve dhe i komuniteteve pakicë, shqiptarët e Kosovës i kanë definuar si komb. Por ky tregim i Spahiut ka një bisht pas, sepse ai nuk na tregon nëse Ahtisari dhe Kushtetuta e Kosovës i kanë definuar shqiptarët si komb shqiptar apo si “komb kosovar”.

● Por, duke u nisur nga fakti se Spahiu ka kohë që çirret për krijimin e “kombit kosovar”, mendoj se ai brenda thënies së tij të mësipërme ka dashur të thotë, se Ahtisari dhe Kushtetuta e Kosovës shqiptarët i kanë definuar si “komb kosovar” dhe jo si komb shqiptar. Por kjo nuk qëndron aspak, sepse as Plani i Ahtisarit dhe as Kushtetuta e Kosovës nuk e përmendin fare “kombin kosovar”.

● Spahiu duke na treguar se idenë e tij të krijimit të “kombit kosovar” e ka biseduar gjerë e gjatë edhe me Ahtisarin, tregon se sa

---

<sup>223</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi 26 gusht, 2016. Dritare net: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

shumë ka qenë dhe është i ethshëm për ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe (në komb shqiptar dhe në “komb kosovar”), saqë për këtë ndarje ka kërkuar ndihmë edhe nga Marti Ahtisari, por ai një ndihmë të tillë nuk ia ka dhënë.

● Merrni me mend se si në mesin e shqiptarëve të shekullit XXI ka edhe shqiptarë si Nexhmedin Spahiu, të cilët në vend që nga personalitetet politike ndërkombëtare të kërkojnë ndihmë për konsolidimin e shtetit të Kosovës, kërkojnë prej tyre ndihmë për tjetërsimin e shqiptarëve të Kosovës nga përkatësia kombëtare shqiptare, në një përkatësi tjetër kombëtare “kosovare”. A nuk është ky një rast për t’u shenjuar në librin e Gjinitist?!

### **Biseda konfidenciale me ambasadorët e vendeve që e kanë njohur shtetin e Kosovës**

Lidhur me bisedat e tij me ambasadorët e vendeve që e kanë njohur shtetin e Kosovës, Spahiu është shprehur si në vijim:

■ **Po ata ...flasin në mënyrë konfidenciale me mu, por asniherë si kom bo publike. ...Ata vijn edhe mysafir n’shpi, por une... Por kur e shohin ndërtesën e AKI-së përballë ngat shpisë teme, thojnë a mujn me na përgju prej ktuhit<sup>224</sup>. (ora 1:49:05-1:49:48)**

● Spahiu nëpërmjet të thënies së tij të cituar më lart, na tregon se ka bërë dhe bën biseda konfidenciale (të fshehta dhe të besueshmërisë së lartë) me ambasadorët e vendeve që e kanë njohur shtetin e Kosovës, por ato biseda ai nuk i bën publike. Shtohet pyetja: *Cilat na qenkan ato tema aq të fshehta, për të cilat Spahiu paska biseduar me ambasadorët e vendeve të ndryshme, por që ai nuk po i bëka publike për opinionin e gjerë?*

● Duke u nisur nga fakti se Spahiu tanimë ka më shumë se dy dekada që shqyhet e çirret për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” dhe për mospërdorimin nga shqiptarët e Kosovës të flamurit kombëtar shqiptar, mendoj se temat e fshehta që ai (Spahiu) ka biseduar me ambasadorët e vendeve të ndryshme,

---

<sup>224</sup> Nexhmedin Spahiu në “Oksigjen”, pjesa 1, 13.11.21:  
<https://www.youtube.com/watch?v=gmCJhoFX-Ps>

kanë të bëjnë pikërisht me krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” dhe me mospërdorimin e flamurit kombëtar shqiptar nga shqiptarët e Kosovës.

### **Ambasadorët e vendeve të huaja e kanë të qartë se në Kosovë ka komb shqiptar**

● Fakti se asnjëri nga ambasadorët e vendeve që e kanë njohur shtetin e Kosovës, nuk u ka imponuar shqiptarëve as tjetërsimin e tyre në “komb kosovar” dhe as mospërdorimin e flamurit kombëtar shqiptar, kjo tregon se ata e kanë të qartë që në Kosovë nuk ka “komb kosovar”, por ka pasur e ka “komb shqiptar”, pjesëtarët e të cilit e kanë të patjetërsueshme si të drejtën për t’i takuar kombit shqiptar, ashtu edhe të drejtën për përdorimin e flamurit të tyre kombëtar shqiptar.

● Kjo sjellje e tillë mosimponuese e ambasadorëve të vendeve të huaja, flet qartë se ata nuk i përkrahin aspak idetë Spahiut, qoftë për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, qoftë për mospërdorimin e flamurit kombëtar shqiptar nga shqiptarët e Kosovës.

### **Raportet e Spahiut me ambasadoren e SHBA-së, Tina Kaidanov**

Lidhur me bisedat e tij me ambasadoren e SHBA-së në Kosovë, Tina Kaidanov<sup>225</sup>, Spahiu ka shkruar si në vijim:

■ **Në prill të vitit 2007 ambasadorja amerikane, Tina Kaidanov, erdhi në zyrën time, ku diskutuam edhe çështjen e simboleve kombëtare kosovare. Unë i sugjerova që këto të jenë simbolet që ka propozuar Presidenti Rugova, të cilat kishin fituar një legjitimitet tashmë 4-vjeçar, por ajo nuk ishte e interesuar ta hidhëronte Hashim Thaçin e gjallë, lider të ardhshëm të Kosovës, për Ibrahim Rugovën e vdekur<sup>226</sup>.**

<sup>225</sup> Tina Kaidanov ka qenë ambasadore e SHBA-së në Kosovë në vitet 2007-2009.

<sup>226</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi, 26 gusht, 2016. *Dritare Net*: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

## **Ambasadorja amerikane Kaidanov është marrë me simbolet shtetërore të Kosovës dhe jo me simbolet e “kombit kosovar”**

● Nga pohimet e Spahiut të cituara më lart, del se ambasadorja e SHBA-së në Prishtinë, Tina Kaidanov, në vitin 2007 paska qenë në zyrën e Spahiut për të biseduar me të çështjen e simboleve shtetërore të Kosovës, të cilat Spahiu jorastësisht i quan “simbole të kombëtare të Kosovës”, për të aluduar kësisoj sikur Kaidanov ka folur me të për simbolet e “kombit kosovar”. Por për mua është e qartë, se ambasadorja amerikane në zyrën e Spahiut nuk është marrë aspak me simbolet e “kombit joekzistues kosovar”, por është marrë me simbolet shtetërore të Kosovës. Kaidanov duke qenë një anglishtfolëse, ka mundur që simbolet shtetërore të Kosovës t'i ketë quajtur *simbole kombëtare*, por duke pasur parasysh se fjala “komb” (në gjuhën angleze “nation”) ka edhe kuptimin e *kombit*, edhe kuptimin e *shtetit*, ajo ka folur për simbolet e shtetit të Kosovës dhe jo për simbolet e “kombit kosovar”, joekzistues atëherë e sot.

## **Ambasadorja amerikane Kaidanov nuk është marrë me idenë e Spahiut për krijimin e “kombit kosovar”**

● Shtrohet pyetja nëse Spahiu është përpjekur që ta bindë edhe ambasadoren amerikane, Tina Kaidanov, që ajo ta përkrahte idenë e tij për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”? Meqë Spahiu idenë e tij për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” e ka biseduar me Marti Ahtisarin, kjo lë të mendosh se ai këtë ide do ta ketë biseduar edhe me ambasadoren amerikane Tina Kaidanov. Por fakti se ambasadorja amerikane Kaidanov, shqiptarëve të Kosovës nuk u ka imponuar asnjëherë tjetërsimin nga komb shqiptar në “komb kosovar”, tregon se, edhe nëse Spahiu i ka folur asaj për idenë e “kombit kosovar”, ajo këtë ide të Spahiut nuk e ka përfillur aspak.

## **Bisedat e Spahiut me kryeadministratorin e UNMIK-ut, Hans Hakerupin**

Spahiu lidhur me bisedat e tij me Përfaqësuesin Special të OKB-së për Kosovën, danezin z. Hans Hakerup, ka shkruar si në vijim:

■ Në takimin me kryeadministratorin e UNMIK-ut, Hans Hakerup<sup>227</sup>, arrita ta bind atë, që logoja e institucioneve të përkohshme të Kosovës të jetë harta e Kosovës ngjyrë ari në sfond të kaltër. Ai u pajtua, por tha se për këtë duhet të shpallet një konkurs, ku do të konturohej kjo ide<sup>228</sup>.

### Vendimmarrje e ardhur si akt i kryer nga lart

● Sipas pohimit të Spahiut, cituar më lart, del se ai (Spahiu), paska qenë një njeri aq i fuqishëm në Kosovë, saqë e paska bindur edhe Hakerupin, që logoja e institucioneve të Përkohshme të Kosovës, të ishte harta e Kosovës me ngjyrë ari në sfondin e kaltër. Nuk them se Hakerupi nuk ka biseduar me Spahiun lidhur me logon e institucioneve të Kosovës, por nuk besoj se vendimmarrja e Hakerupit për logon e institucioneve të Kosovës ka ndodhur për shkak të ndikimit të Spahiut. Kjo, sepse modeli i simboleve të shtetit të Kosovës është marrë i gatshëm nga modeli i simboleve shtetërore të Bosnjë-Hercegovinës.

● Por, ndërsa Spahiu thotë se në vitin 2001 e ka bindur Hakerupin, që logoja e institucioneve të Kosovës të ishte harta e Kosovës ngjyrë ari në sfondin e kaltër, i njëjti Spahi thotë se në vitin 2007 ambasadores amerikane në Prishtinë, Tina Kaidanov, ia ka sugjeruar simbolet e Kosovës të propozuara nga Ibrahim Rugova. Por duke qenë këto dy pohime janë diametralisht të kundërta me njëri-tjetrin, nuk merret vesh nëse Spahiu ua ka sugjeruar Hakerupit dhe Tina Kaidanovit simbolet shtetërore të Kosovës pa asnjë përmbajtje kombëtare shqiptare (si këto që janë në fuqi), apo ua ka sugjeruar simbolet shtetërore të Kosovës me përmbajtje të reduktuar kombëtare shqiptare, siç kanë qenë ato të Ibrahim Rugovës.

● Por, duke pasur parasysh se Spahiu, që asokohe është shqyer duke e propaganduar krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” dhe duke propaganduar mospërdorimin e

---

<sup>227</sup> Hans Hakerup ka qenë kryeadministratori i UNMIK-ut në Kosovë gjatë vitit 2001, si dhe ka qenë Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Kosovën.

<sup>228</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi, 26 gusht, 2016. *Dritare Net*: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

flamurit kombëtar shqiptar nga ana e shqiptarëve të Kosovës, këto dy fakte lënë hapësirë të besohet se ai Hakerupit dhe Tina Kaidanovit më parë u ka sugjeruar simbolet shtetërore të Kosovës pa asnjë përmbajtje kombëtare shqiptare (si këto që janë në fuqi), sesa simbolet shtetërore të Kosovës me përmbajtje të reduktuar kombëtare shqiptare, të propozuara nga Ibrahim Rugova.

### **Hakerupi nuk është marrë me idenë e krijimit të “kombit kosovar”**

● Shtrohet pyetja: *A ka kërkuar apo jo Spahiu nga Hakerupi përkrahjen e idesë së tij për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”?* Duke pasur parasysh se Spahiu edhe asokohe e ka propaganduar krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” dhe duke pasur parasysh se ai idenë e “kombit kosovar” e ka biseduar me Marti Ahtisarin, gjasat flasin se ai idenë e “kombit kosovar” do ta ketë biseduar edhe me Hakerupin. Por fakti se Hakerupi shqiptarëve të Kosovës nuk ua ka imponuar tjetërsimin në “komb kosovar”, kjo tregon se, edhe nëse Spahiu i ka folur atij për idenë e krijimit të “kombit kosovar”, ai këtë ide të Spahiut nuk e ka përfillur aspak.

### **As kushtetuta dhe as miqtë e Kosovës nuk kanë bërë sugjerime për krijimin e një “kombi multietnik”**

Spahiu në vazhden e manipulim-spekulimeve të tij lidhur me krijimin dhe ekzistimin sipas tij të “kombit kosovar”, ka thënë edhe si në vijim:

■ **Kushtetuta dhe të gjitha sugjerimet e miqeve t’Kosovës janë që ne t’bojm një komb multietnik<sup>229</sup>. (min. 9:40-10:10)**

● Pohimi i Spahiut i cituar më lart, sipas të cilit Kushtetuta dhe të gjithë miqtë e Kosovës janë për bërjen e një kombi multietnik në Kosovë, gjë që nënkupton bërjen nga shqiptarët e Kosovës të “kombit multietnik kosovar”, brenda të cilit do të integroheshin pakica serbe dhe pakicat e tjera, nuk qëndron aspak.

---

<sup>229</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun: Valamala Show, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

● Pohimi i mësipërm i Spahiut nuk qëndron, sepse Kushtetuta e Kosovës në nenin 3 pika 1 të saj, Kosovën e definon si shoqëri multietnike të përbërë nga shumica shqiptare dhe nga komunitetet pakicë, dhe nuk e definon si shtet i përbërë nga një komb i vetëm multietnik “kosovar”, siç mundohet të na bindë Spahiu pa asnjë fakt.

**Në nenin 3, pika 1 e Kushtetutës thuhet si më poshtë:**

■ **Republika e Kosovës është shoqëri shumëetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore<sup>230</sup>.**

● Mëtej pohimi i Spahiut se Kushtetuta dhe miqtë e Kosovës janë për bërjen e një kombi multietnik në Kosovë nuk qëndron, sepse asnjë vend mik i Kosovës dhe asnjë figurë politike madhore e botës nuk kanë bërë asnjë sugjerim, që në Kosovë të krijohet një komb multietnik (“kosovar”), brenda të cilit do të integroheshin (*de facto* do të shkriheshin) komunitetet pakicë.

● Dhe pohimi i Spahiut se Kushtetuta dhe miqtë e Kosovës janë për bërjen e një kombi multietnik në Kosovë nuk qëndron, sepse në **pikën 1.1 të Planit/Dokumentit të Ahtisarit** thuhet si më poshtë:

■ **Kosova do të jetë një shoqëri shumëetnike, që do të ushtrojë autoritetin e saj demokratik përmes institucioneve të saj legislative, ekzekutive dhe gjyqësore, dhe me respekt të plotë për sundimin e ligjit<sup>231</sup>.**

● Siç shihet nga pika 1.1 e Planit/Dokumentit të Ahtisarit, Kosova definohet si një **shoqëri shumëetnike**, në kuptimin e një shteti me shumë etni të ndryshme me të drejta të barabarta, dhe nuk definohet si një shtet me një **komb të përbashkët multietnik “kosovar”**, brenda të cilit do të integroheshin (asimiloheshin) komunitetet e ndryshme pakicë që jetojnë në Kosovë.

---

<sup>230</sup> Kushtetuta e Kosovës: [https://biblioteka.sejm.gov.pl/wp-content/uploads/2017/05/Kosowo\\_alb\\_010117.pdf](https://biblioteka.sejm.gov.pl/wp-content/uploads/2017/05/Kosowo_alb_010117.pdf)

<sup>231</sup> Kushtetuta e Kosovës: [https://biblioteka.sejm.gov.pl/wp-content/uploads/2017/05/Kosowo\\_alb\\_010117.pdf](https://biblioteka.sejm.gov.pl/wp-content/uploads/2017/05/Kosowo_alb_010117.pdf)

● Spahiu nuk e kupton ose nuk dëshiron të kuptojë se dy dokumentet kryesore të shtetbërjes së Kosovës, siç janë Plani i Ahtisarit dhe Kushtetuta e Kosovës, duke e definuar Kosovën si shoqëri shumetnike, janë për një Kosovë me etni të shumta të barabarta mes tyre, dhe nuk janë për një Kosovë me një komb të vetëm multietnik “kosovar”, brenda të cilit në emër të integritimit do të asimiloheshin komunitete të ndryshme joshqiptare pakicë.

● Nga ana tjetër, në Kosovë nuk mund të krijohet një “komb kosovar” multietnik edhe për tri arsye të tjera: **së pari**, sepse shumica kombëtare shqiptare nuk dëshiron që të tjetërsohet në “komb kosovar”, **së dyti**, sepse pakica serbe e indoktrinuara për shumë kohë me urrejtje ndaj shqiptarëve jo vetëm që nuk pranon të integrohet brenda shumicës shqiptare, por edhe ndihet e fyer nëse dikush dëshiron integritimin e saj brenda shumicës shqiptare, dhe **së treti**, sepse pakica serbe duke qenë aq shumë e diskriminuar pozitivisht nga Plani i Ahtisarit dhe nga Kushtetuta e Kosovës në aspektin etnik dhe kombëtar, ajo as që ia ka fare nevojën integritimit të saj brenda shumicës shqiptare, për t’u krijuar kështu “kombi kosovar” multietnik.

### **Në vende me konflikte ndëretnike nuk mund të krijohen kombe multietnike**

● Në vendet e dala nga konfliktet ndëretnike, siç janë vendet e Ballkanit, nga etnitë e armiqësuarat nuk mund të krijohen “kombe multietnike”, por mund të krijohen shtete multietnike, brenda së cilave jetojnë etni të veçanta me të drejta të barabarta.

● Kështu në Kroaci nuk ka komb multietnik kroat, sepse pakica serbe për shkak të konfliktit me shtetin kroat, ajo si e tillë nuk e pranon integritimin e saj brenda shumicës kroate.

● Edhe në Bosnjë-Hercegovinë nuk ka komb multietnik boshnjak, sepse as kroatët e krishterë dhe as serbët ortodoksë, nuk pranojnë që të integrohen brenda shumicës boshnjako-myslimane.

● Edhe në Kosovë nuk mund të krijohet një “komb multietnik kosovar”, sepse shqiptarët nuk pranojnë të tjetërsohen në “komb kosovar”, kurse serbët nuk pranojnë që të integrohen brenda shumicës shqiptare.

## **Spahiu idetë e tij deshqiptarizuese i ka hedhur në pazar**

● Nëse Spahiu vërtet është përpjekur që ta bindë Marti Ahtisarin, i cili ka udhëhequr bisedimet për statusin përfundimtar të Kosovës, kryeadministratorin e UNMIK-ut në Kosovë, Hans Hakerupin, dhe ambasadorin amerikane në Kosovë, Tina Kaidanov, që ata të pozicionohen në favor të tjetërsimit të shqiptarëve të Kosovës nga komb shqiptar në “komb kosovar”, kjo do të thotë se Spahiu idetë e tij deshqiptarizuese në raport me kombin shqiptar në Kosovë i ka hedhur herët në Pazarin Ndërkombëtar.

● Dhe kjo do të thotë se, ndërsa UÇK-ja gjatë viteve 1998-1999 ka luftuar kundër forcave serbe për çlirimin e Kosovës nga Serbia dhe për konsolidimin e mëtejshëm të kombit shqiptar në Kosovë, pas çlirimit të Kosovës në vitin 1999 dhe në vitet në vazhdim, në prapaskenë është gjendur dikush si Nexhmedin Spahiu, i cili duke bërë biseda jopublike dhe konfidenciale me figura të politikës ndërkombëtare, ka punuar për përhapjen dhe zbatimin e ideve të tij komb-ndarëse dhe komb-deshqiptarizuese, në raport me shqiptarët e Kosovës. Dhe kjo ngjan me atë legjendën shqiptare ku thuhet: *“Tre vllazën gjithë ditën murojnë, por gjithë natën dikush muranat ua rrënon...!”*

## **Përpjekjet e Spahiut për t'i bindur ndërkombëtarët, sikur gjoja në Kosovë ka lindur “kombi kosovar”**

Spahiu në një debat televiziv të bërë më 13.11.2021 në “TV Klan”, tregon se si ai kishte bërë përpjekje që t'i bindë ndërkombëtarët se, meqë “kombi kosovar” veç kishte lindur, tani ata duhet ta ndihmonin atë për t'u ngritur në këmbët e tij. Kështu ai është shprehur si më poshtë:

■ **Kur u diskutojke mbas luftës çka duhet me bo me Kosovën, unë përpiqesha me i bind këta ndërkombëtarët me kando që bisedojsha, që tash na veç kemi lind si komb... Neve ose doni me na myt, ose doni me na ndihmue mu ngrit n'kom.... se s'mundesh foshnja që ka lind, me e shiti prapë n'bark t'nonës vet ...Ju keni intervenue sikur kur ni nonë që do me myt foshnjën e vet n'bark, e ajo ka qenë Serbia, edhe keni intervenue, e keni marr me zor e keni nxjerr fëmin. Tash a po**

**doni me shti përsëri aty n'atë bark? Nuk mundesh sepse e myt edhe foshnjën edhe nonën. Kështu duhet me ndihmue me e rrit...Mendoj që na kemi kalue në këto faza prej inkubatorit, në një foshnjëri dhe tash osht një fmi i vogël që ecën, por që sigurisht mbas një kohe ka me qenë një komb normal<sup>232</sup>. (min. 17:27:21 -1:28:20)**

● Spahiu me pohimet e tij të cituara më lart tregon për përpjekjet që ka bërë ai për t'i bindur ndërkombëtarët, se si gjoja nga shqiptarët e Kosovës veç kishte lindur “kombi kosovar”, dhe se tani ata (ndërkombëtarët) duhej ta ndihmonin rritjen e foshnjës e porsalindur (“kombin kosovar”), që tani kishte filluar të ecte me këmbët e veta si një fëmijë i vogël.

● Spahiu me pohimet e tij të cituara më lart tregon vetë se ai, nga të gjitha personalitetet politike ndërkombëtare me të cilët ka biseduar (nga Marti Ahtisari, Hans Hakerupi, Tina Kaidanovi dhe të tjerë), ka kërkuar prej tyre që ata ta përkrahnin krijimin nga shqiptarët e Kosovës të një kombi tjetër joshqiptar në formën e “kombit kosovar” dhe, për rrjedhojë, edhe ka kërkuar prej tyre që ata t'ua imponojnë shqiptarëve të Kosovës tjetërsimin e tyre në “komb kosovar”.

● Por, për vetë faktin se asnjë personalitet politik ndërkombëtar jo vetëm që nuk ka bërë ndonjë imponim ndaj shqiptarëve të Kosovës, që ata të tjetërsohen nga komb shqiptar në “komb kosovar”, por as që e ka zënë në gojë qoftë edhe një herë të vetme termin “komb kosovar”, kjo tregon se ata (ndërkombëtarët) nuk i kanë përkrahur aspak idetë komb-ndarëse dhe komb-tjetërsuese të Spahiut, në raport me kombin shqiptar në Kosovë.

● Duke pasur parasysh pohimet e Spahiut të cituara më lart, shtrimi i disa pyetjeve drejtuar atij bëhet i domosdoshëm: *Kush ia ka dhënë Spahiut të drejtën, që ai prapa shpinës së shqiptarëve të bisedojë dhe të kërkojë ndihmë nga ndërkombëtarët, që ata ta përkrahnin dhe ta ndihmonin tjetërsimin e shqiptarëve të Kosovës nga komb shqiptar në “komb kosovar”?! A paraqet vepër penale të dënueshme veprimtaria e*

---

<sup>232</sup> Nexhmedin Spahiu në “Oksigjen”, pjesa 1, 13.11.21: <https://www.youtube.com/watch?v=gmCJhoFX-Ps>

*Spahiut: e kërkim-ndihmës nga ndërkombëtarët për deshqiptarizimin e shqiptarëve të Kosovës? Cila është vlera morale, qytetare dhe njerëzore e një njeriu si Spahiu, që prapa shpinës së shqiptarëve të Kosovës, punon për deshqiptarizimin e tyre? Dhënien e përgjigjeve në këto pyetjeve po ua lë lexuesve!*

## IMPLIKIMI I PRESIDENTËVE AMERIKANË NË FUNKSION TË PROPAGANDIMIT TË GJOJA KRIJIM-EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”

Në këtë kapitull dua t’i sqaroj lexuesit, se si Nexhmedin Spahiu duke e keqinterpretuar emërtimin e Kosovës nga ana e presidentëve amerikanë dhe nga ana e figurave të tjera politike anglisht-folëse si “Komb i Kosovës” (“Kosovo-Nation”), ose si “Komb i ri” (“New Nation”), përpiqet që t’i bindë (për mendimin tim t’i mashtrojë) shqiptarët e Kosovës, që ata nga komb shqiptar të tjetërsohen në “komb kosovar”.

Por, siç kemi sqaruar edhe në kapituj të tjerë paraprakë, fjala komb (në gjuhën angleze “nation”) ka dy kuptime: edhe kuptimin e ngushtë të kombit, edhe kuptimin e shtetit. Shtrohet pyetja: *në cilin kuptim presidentët amerikanë e kanë quajtur dhe quajnë Kosovën “komb i Kosovës” ose “Komb i ri”?*

Për vetë faktin se presidentët amerikanë nuk kanë kërkuar asnjëherë që nga shqiptarët e Kosovës të krijohet një komb tjetër “kosovar”, kjo flet qartë se ata Kosovën e kanë quajtur dhe e quajnë “Komb i Kosovës” dhe “Komb i ri” në kuptimin e “Shtetit të Kosovës” dhe në kuptimin e “Shtetit të ri” të Kosovës, dhe jo në kuptimin e “kombit kosovar”, siç mundohet të na bindë Spahiu.

Sikur presidentët amerikanë ta quanin Kosovën “Komb i Kosovës” (“Nation of Kosovo”) dhe “Komb i ri” (“New Nation”) në

kuptimin e ngushtë të “kombit kosovar”, atëherë edhe presidentët e vendeve joanglishtfolëse të Europës, Kosovën po ashtu do ta quanin “Komb i Kosovës” dhe “Komb i ri”, në kuptimin e ngushtë të “kombit kosovar”.

Por për vetë faktin se presidentët dhe kryeministrat e vendeve joanglisht-folëse të Europës, Kosovën e kanë quajtur dhe e quajnë “Shtet të Kosovës”, kjo flet qartë se edhe presidentët amerikanë, duke e quajtur Kosovën “Komb i Kosovës” dhe “Kombi i ri”, ata në fakt e kanë quajtur Kosovën “Shtet i Kosovës” dhe “Shtet i ri” i Kosovës, dhe nuk e kanë quajtur Kosovën “Komb kosovar”, ose “Komb i ri” kosovar.

### **Presidenti amerikan Xhorxh Bush e ka njohur Kosovën si shtet i ri dhe jo si “komb i ri kosovar”**

Spahiu lidhur me emërtimin e Kosovës si “komb” nga presidenti amerikan Bush ka shkruar si në vijim:

■ **Prandaj George W. Bush kur e ka njohur Kosovën e ka njohur si komb... e jo vetëm si një shtet si Colorado apo shtetet tjera që kanë simbolet por s’është komb**<sup>233</sup>.

Spahiu lidhur me emërtimin e Kosovës si “komb” nga presidenti Bush është shprehur edhe si në vijim:

■ **A e keni pa Gjorgj Bushin kur thotë unë kam vendos me njoftë Kosovën si komb sovran dhe t’pavarun, domethon nuk thotë si shtet por si komb**<sup>234</sup>. (min. 27:36 -27:44)

Dhe Spahiu lidhur me emërtimin e Kosovës si “komb” nga presidenti Bush është shprehur edhe si më poshtë:

■ **Ish dashur të dënohej një media e cila e vë në pikëpyetje ekzistencën e kombit. Kjo vë në pikëpyetje ekzistencën e një kombi që George W. Bush e ka pranuar, sepse e thotë se: “Kosovën, SHBA ka vendosur ta pranojë si komb të pavarur dhe sovran**<sup>235</sup>.

<sup>233</sup> Nexhmedin Spahiu: Kushtetuta e definon kombin kosovar - të tillë e njohu Kosovën edhe SHBA-ja, *Balkan. Info*; 20 nëntor 2019; <https://klankosova.tv/nexhmedin-spahiu-kushtetuta-e-definon-kombin-kosovar-te-tille-e-njohu-kosoven-edhe-shba/>

<sup>234</sup> Nexhmedin Spahiu: *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri” (Aktualitete - 30.03.2021); <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd70Q>

<sup>235</sup> Nexhmedin Spahiu: Kushtetuta e definon kombin kosovar - të tillë e njohu Kosovën

● Me pohimet e Spahiut të cituara më lart, sipas të cilave presidenti amerikan Xhorxh Bush i Riu, duke e quajtur Kosovën komb sovran, ai e ka njohur Kosovën si “komb” në kuptimin e “kombit kosovar”, nuk pajtohem aspak. Kjo, sepse siç kam sqaruar edhe në hyrje të këtij kapitulli, fjala *komb* (në gjuhën angleze “nation”) ka edhe kuptimin e kombit, edhe kuptimin e shtetit, kurse duke pasur parasysh se në vitin 2008 ka ndodhur shtetbërja e Kosovës, por nuk ka ndodhur bërja e ndonjë “kombi të ri kosovar”, kjo flet qartë se presidenti Bush e ka quajtur Kosovën “komb sovran” në kuptimin e shtetit sovran të Kosovës.

### **Shqiptarët edhe në kuadër të Jugosllavisë**

#### **kanë qenë edhe etni, edhe komb shqiptar njëkohësisht**

Spahiu duke teorizuar më tej për “kombin kosovar” dhe duke e keqinterpretuar më tej emërtimin e Kosovës nga figurat politike anglishtfolëse si “komb i ri”, është shprehur edhe si më poshtë:

■ **Ne, deri para 10 viteve jemi konë pakicë etnike. Kur vishin t’hujt na thojshin pakicë etnike. Tash kur po vjen Klintonka (bashkëshortja e presidentit Klinton, shën aut.), kur po vjen Toni Bleri, po na thojnë Nju-Nejshen, kombi i ri e tjerë e tjerë<sup>236</sup>. (min. 40:54 - 41:39)**

● Me këtë pohim të Spahiut, të trajtuar edhe në njërin nga kapitujt pararendës, sipas të cilit shqiptarët deri para dhjetë vitesh (derisa kanë jetuar në kuadër të Jugosllavisë Federative) kanë qenë pakicë etnike, nuk pajtohet asnjë shqiptar që ka dy sy për të parë, dy vesh për të dëgjuar e dy fije mend për të menduar.

● Shqiptarët e Kosovës, siç kemi sqaruar edhe në ndonjërin nga kapitujt pararendës, si pakicë kombëtare (alias si *kombësi* në kuptimin e pakicës kombëtare), i ka definuar padrejtësisht kushtetuta shoviniste jugosllave, për t’i paraqitur shqiptarët e Kosovës para opinionit jugosllav dhe botëror jo si shumicë kombëtare, siç kanë qenë, por si pakicë kombëtare, siç nuk kanë qenë.

---

edhe SHBA-ja, *Balkan.Info*; 20 nëntor 2019 ora 22:35: <https://klankosova.tv/nexhmedin-spahiu-kushtetuta-e-definon-kombin-kosovar-te-tille-e-njohu-kosoven-edhe-shba/>

<sup>236</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun; *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

● Duke qenë se shqiptarët ishin populli i tretë sipas madhësisë në kuadër të Jugosllavisë , dhe duke pasur ata vetëdije të lartë kombëtare shqiptare, ata në kuadër të Jugosllavisë nuk kanë qenë pakicë etnike shqiptare, siç i ka definuar kushtetuta jugosllave dhe siç thotë edhe Spahiu, por kanë qenë njëkohësisht shumicë etnike shqiptare edhe shumicë kombëtare shqiptare, gjë që përputhet edhe me teoritë gjermane për kombin, sipas të cilave etnia dhe kombi paraqesin të njëjtën gjë.

● Edhe pohimi i Spahiut se, pas pavarësimit të Kosovës, “Klintonka”<sup>237</sup> dhe Toni Bleri<sup>238</sup> e kanë quajtur Kosovën “Komb i ri” (anglisht “New Nation”) në kuptimin e kombit të ri “kosovar”, për arsyet që kemi paraqitur më lart nuk qëndron aspak. Kjo, sepse si ish-Sekretarja e Shtetit Amerikan, Hillari Klinton, ashtu edhe ish-kryeministri i Britanisë së Madhe, Toni Bler, Kosovën e kanë quajtur “komb i ri” në kuptimin e shtetit të ri të Kosovës dhe jo në kuptimin e “kombit të ri kosovar”.

### **Toni Bler dhe Hilari Klinton nuk i kanë uruar jetë të gjatë “kombit kosovar”**

Spahiu duke teorizuar mëtej për “kombin kosovar” dhe duke e keqinterpretuar më tej emërtimin e Kosovës nga figurat politike anglisht-folëse si “Komb i Kosovës”, ka shkruar si më poshtë:

■ **Kjo situatë ndryshoi pasi Kosova shpalli Pavarësinë e saj, kur Toni Blair e Hilary Clinton, gjatë vizitave të tyre në Kosovë, i dëshiruan “jetë të gjatë kombit të ri kosovar. Pas këtij urimi përkrahësit e kombit kosovar u shumuan aq shumë sa edhe Presidenti i Serbisë, Boris Tadiq, në paraqitjen e tij para Këshillit të Sigurimit të KB, e pa të arsyeshme të argumentojë se kombi kosovar nuk ekziston**<sup>239</sup>.

<sup>237</sup> *Klintonka*: Spahiu sekretaren e Shtetit Amerikan, Hilari Klinton, e quan në frymën e gjuhës serbe “Klintonka”, që do të thotë bashkëshortja e Bill Klintonit. Spahiu si në të shkruar, ashtu edhe në të folur është aq shumë i ndikuar nga gjuha serbe, sa që të duket sikur ai mendimet i formulon në gjuhën serbe, ndërsa kur shkruan dhe flet i përkthen në gjuhën shqipe.

<sup>238</sup> Toni Bler gjatë viteve 1998-1999 të Luftës Çlirimtare të Kosovës së bashku me presidentin amerikan, Bill Klinton, ka dhënë ndihmën e tij madhore për çlirimin e Kosovës në vitin 1999 dhe për pavarësimin e Kosovës në vitin 2008.

<sup>239</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit* <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

● Toni Bler dhe Hilari Klinton, siç sqaruam edhe më lart, duke qenë figura politike anglishtfolëse, gjuhë kjo në të cilën fjala **komb** (anglisht “nation”) ka edhe kuptimin e kombit, edhe kuptimin e shtetit, duke i uruar jetë të gjatë “kombit kosovar”, faktikisht i kanë uruar jetë të gjatë shtetit të Kosovës.

**Pse ndërsa Spahiu ka folur për “kombin kosovar”,  
njerëzit kanë reaguar duke ia bërë vuuu!**

Spahiu në një intervistë televizive është shprehur si në vijim:

■ **Kur flas unë për kombin kosovar njerëzit bojn vuuu! Kur vjen Klintoni edhe thotë ky asht kombi ma i ri në Europë, ose kur Toni Bleri flet për kombin kosovar, na i rrehim shuplakat<sup>240</sup>.**

● Është e vërtetë se kur Bill Klintoni ose Toni Bleri Kosovën e kanë quajtur “Komb i Kosovës” (“Kosovo Nation”) ose “Komb i ri” (“New Nation”), njerëzit në Kosovë iu kanë duartrokitur, sepse ata (Klintoni dhe Toni Bleri) me emërtime të tilla, nuk kanë nënkuptuar “kombin kosovar”, siç na thotë Spahiu, por kanë nënkuptuar shtetin e Kosovës.

● Po ashtu është e vërtetë se kur Spahiu ka folur për “kombin kosovar”, njerëzit nuk i kanë duartrokitur, por kanë reaguar duke ia bërë vuuu! Kjo ka ndodhur, sepse Spahiu duke folur për “kombin kosovar” në kuptimin e ngushtë të fjalës **komb**, ai ua ka mohuar tërthorazi të pranishmeve përkatësinë kombëtare shqiptare dhe ata i janë kundërvënë atij duke ia bërë vuuu!

---

<sup>240</sup> Nexhmedin Spahiu në “Oksigjen”, pjesa e tretë; 23.09.2011.  
<https://www.youtube.com/watch?v=D673tLZUdIE>

## **KEQINTERPRETIMI I DEKLARATAVE TË PRESIDENTËVE TË SERBISË PËR MOSEKZISTIMIN E “KOMBIT TË KOSOVËS”, NË FUNKSION TË NXITJES SË KRIJIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se Nexhmedin Spahiu, duke u marr me deklaratat e presidentëve të Serbisë se “nuk ekziston kombi i Kosovës”, përpiqet që t'i bindë shqiptarët e Kosovës, që ata, në kundërshtim me deklaratat e tilla të presidentëve të Serbisë, të bëjnë të kundërtën: të tjetërsohen nga komb shqiptar në “komb kosovar”.

### **Politikanët kryesorë të Serbisë mohojnë ekzistimin e shtetit të Kosovës dhe nuk mohojnë ekzistimin e “kombit kosovar“**

Spahiu lidhur me deklarimin e udhëheqësve kryesorë të Serbisë, si Boris Tadiqi e të tjerë, të cilët edhe në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, sipas tij, kanë deklaruar se nuk ka komb të Kosovës, ka shkruar si në vijim:

■ ... edhe Presidenti i Serbisë, Boris Tadiq, në paraqitjen e tij para Këshillit të Sigurimit të KB, e pa të arsyeshme të argumentojë se kombi kosovar nuk ekziston<sup>241</sup>.

● Por Spahiu thirret edhe në deklaratën e Ivica Daçiçit, duke u shprehur si më poshtë:

---

<sup>241</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit*: <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

■ A e ke pa Ivica Daçiçin për shembull kur me Vlora Qitakun, Hashim Thaçin e Skënder Hysenin, e me këta tjerë gjithmonë thojke: nuk ka n’Kosovë komb kosovar, ka veç pakicë etnike shqiptare n’Kosovë, e cila domethonë pakicë që bon pjesë në një shtet tjetër. Për me konë komb duhet me pas shtetin tand. Ai s’ta njuh shtetin domethon s’tjeh si komb. N’mometin që t’njuh si komb, ai t’njuh edhe si shtet dhe anasjelltas<sup>242</sup>. (min. 27:08 - 27:35)

● Lidhur me thëniet e mësipërme të Spahiut, dua të shtoj se jo vetëm presidenti i Serbisë, Tadiq, por edhe presidenti aktual i Serbisë, Vuçiç dhe ministri i Brendshëm aktual i Serbisë, Ivica Daçiç, para Këshillit të Sigurimi të OKB-së janë shprehur se “**nuk ekziston kombi i Kosovës**” dhe nuk janë shprehur se “**nuk ekziston kombi kosovar**”, siç na thotë Spahiu.

● Duke pasur parasysh se këto figura kryesore politike të Serbisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së kanë folur në gjuhën angleze, gjuhë kjo në të cilën fjala **komb** (anglisht “nation”) ka edhe kuptimin e kombit, edhe kuptimin e shtetit, ata duke thënë se “**nuk ekziston kombi i Kosovës**”, në fakt kanë thënë se “**nuk ekziston shteti i Kosovës**”, dhe nuk kanë thënë se “**nuk ekziston kombi kosovar**”, në kuptimin e ngushtë të fjalës **komb**.

● Por Spahiu duke interpretuar thënien e presidentëve të Serbisë se “**nuk ekziston kombi i Kosovës**” në kuptimin e ngushtë të fjalës **komb**, sikur gjoja ata kanë deklaruar se “**nuk ekziston “kombi kosovar**”, për mendimin tim përpiqet që t’i nxitë shqiptarët e Kosovës, që ata, për inat të presidentëve të Serbisë, të cilët sipas tij kanë thënë se “**nuk ekziston kombi kosovar**”, pikërisht të tjetërsohen nga komb shqiptar në “**komb kosovar**”.

### Liderët politikë dhe elita e Kosovës nuk janë pajtuar me presidentin Tadiq

Spahiu duke sulmuar liderët politikë dhe elitën e Kosovës, për mosnjohjen nga ana e tyre të “kombit kosovar”, ka shkruar më tej si në vijim:

---

<sup>242</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri” (Aktualitete - 30.03.2021): <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

■ **Paradoksi qëndron në atë se gati të gjithë liderët politikë të Kosovës dhe e ashtuquajtura elita kosovare pajtohen me Presidentin Tadiq, që kombi kosovar nuk ekziston. Ky qëndrim i liderëve kosovarë i bënë të duken qesharakë e budallenj në sytë e kolegëve të tyre nga Perëndimi. Edhe kërkojnë anëtarësim në OKB, edhe deklarojnë se nuk janë komb!**<sup>243</sup>

● Me pohimin e Spahiut të cituar më lart, sipas të cilit liderët politikë të Kosovës dhe elita e Kosovës, duke mos e pranuar ekzistimin e “kombit kosovar”, pajtohen me presidentin e Serbisë, Tadiq, unë nuk pajtohem aspak. Kjo, sepse siç sqaruam edhe më lart, presidenti i Serbisë, Tadiq, duke folur para Këshillit të Sigurimit të OKB-së në gjuhën angleze, ku fjala “komb” ka edhe kuptimin e kombit, edhe kuptimin e shtetit, ai duke thënë se “**kombi i Kosovës nuk ekziston**”, ka thënë se “**nuk ekziston shteti i Kosovës**” dhe nuk ka thënë se “**nuk ekziston kombi kosovar**”.

● Duke u nisur sa u tha më lart, liderët politikë dhe elita e Kosovës nuk pajtohen aspak me ish-presidentin e Serbisë, Tadiq, sepse ai duke thënë se “**nuk ekziston kombi i Kosovës**”, në fakt ka thënë se “**nuk ekziston shteti i Kosovës**”.

● As thënia tjetër e Spahiut, sipas së cilës liderët e Kosovës edhe e kërkojnë anëtarësimin e Kosovës në OKB, edhe deklarojnë se nuk janë komb, nuk qëndron aspak. Liderët e Kosovës nuk kanë deklaruar asnjëherë se Kosova është shtet pa komb. Ata kanë deklaruar se Kosova e ka kombin e saj shumicë shqiptar, si dhe ka edhe komunitetet pakicë, siç janë komuniteti **serb, turk, boshnjak, romë, ashkali, mysliman** etj.

**Shteti i Kosovës nuk identifikohet me “kombin joekzistues kosovar”, por identifikohet me kombin ekzistues shqiptar**

● Spahiu duke teorizuar më tej me deklaratën e presidentit të Serbisë, se “**nuk ekziston kombi i Kosovës**”, ka shkruar si në vijim:

■ **...pasi që për Presidentin e Serbisë nuk ekziston shteti i Kosovës, rrjedhimisht nuk ekziston as edhe kombi kosovar. Po**

<sup>243</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit*: <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

**të ekzistonte për Presidentin e Serbisë kombi kosovar, atëherë ai do ta pranonte shtetin e Kosovës<sup>244</sup>.**

● Edhe pohimi i Spahiut i cituar më lart, sipas të cilit presidenti i Serbisë duke thënë se nuk ekziston shteti i Kosovës, kësisoj ka thënë se “nuk ekziston kombi kosovar”, nuk qëndron aspak. Kjo, sepse shteti i Kosovës nuk identifikohet me “kombin kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues, por identifikohet me kombin shqiptar realisht dhe objektivisht ekzistues, si dhe identifikohet edhe me komunitetet pakicë ekzistuese në Kosovë.

### **Serbia ka dy synime: mosnjohjen e shtetit të Kosovës dhe ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe**

Duke pasur parasysh sa u tha më lartë duka të konkludoj es Serbia në një rën anë nuk e njuh shtetin e Kosovës, kurse në anën tjetër e do ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe: në komb shqiptar në Shqipëri dhe në “komb kosovar“ në Kosovë. Serbia, siç jemi shprehur edhe më lart, e do ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe, në mënyrë që gjatë përpjekjeve të saj për rikthimin e Kosovës brenda Serbisë, të mos ketë punë me pesë milionë shqiptarë, por të ketë punë me vetëm dy milionë “kosovarë”. Serbia edhe për një kohë, derisa të defashistizohet tërsisht, nuk ka për ta njohur shtetin e Kosovës, pa marrë parasysh nëse shqiptarët e Kosovës do t'i thonë vetes komb shqiptar apo “komb kosovar”.

---

<sup>244</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit*: <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

## SPEKULIMI I SPAHIUT ME IBRAHIM RUGOVËN E VDEKUR NË FUNKSION TË PROPAGANDIMIT TË GJOJA KRIJIM- EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”

Nexhmedin Spahiu për t'i bindur shqiptarët e Kosovës që ata të tjetërsohen nga komb shqiptar në “komb kosovar”, nuk ka lënë gjë pa keqinterpretuar, keqpërdoruar, shtrembëruar, manipuluar e spekuluar. Kështu ai i ka përdorur pa vend dhe keqinterpretuar teoritë franceze për kombin, i ka keqpërdorur dhe deformuar ngjarjet historike kombëtare shqiptare që kanë pasur të bënin me shqiptarët e Kosovës, ka keqinterpretuar veprimtarinë atdhetare të rilindësve kombëtarë shqiptarë, ka mohuar veprimet antishqiptare të Perandorisë Osmane dhe Fuqive të Mëdha të Europës dhe, së fundmi, ka bërë përpjekje që të spekulojë edhe me figurën e ish-Presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugovës, duke pohuar pa pasur asnjë fakt, sikur gjoja ai (Ibrahim Rugova), paska përkrahur idenë e tij (të Spahiut) për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

### **Sipas Spahiut, Ibrahim Rugova ka qenë përkrahës i krijimit të “kombit kosovar”**

Spahiu duke spekuluar me figurën e Ibrahim Rugovës lidhur me “kombin kosovar”, ka shkruar si në vijim:

■ **E vërteta është se kombi kosovar ishte ide e imja e para 25 viteve... që u fuqizua politikisht vite më vonë, kur këtë ide**

## **timen e përkrahën Halil Matoshi e Fatos Lubonja dhe më pas edhe vetë Presidenti Ibrahim Rugova<sup>245</sup>.**

● Spahiu nëpërmjet thënies së tij të cituar më lart, na thotë se ideja e “kombit kosova” paska qenë ide e tij e para 25 vjetësh, që do të thotë se ajo (ideja e “kombit kosovar”) në kokën tij qenka kurdisur gjatë viteve 1988-1989 e këndeje. Kjo tregon se, ndërsa populli i Kosovës si komb shqiptar gjatë viteve 1988-1998 ka rezistuar stoikisht duke demonstruar kundër heqjes së autonomisë së Kosovës nga ana e Serbisë, Nexhmedin Spahiu pjesës së kombit shqiptar në Kosovë ia paska gjetur “ilaçin”: tjetërsimin e tij nga komb shqiptar në “komb kosovar”. “Hosona barraba!” - do të thoshte Fan Noli,

● Po sipas thënies së mësipërme të Spahiut të cituar më lart, del se idenë e tij për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” e paska përkrahur edhe ish-Presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova. Por kjo nuk qëndron, sepse Ibrahim Rugova nuk është shprehur asnjëherë, as me gojë e as me shkrim, për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”. Prandaj, pohimi i Spahiut, sipas të cilit Ibrahim Rugova paska qenë për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” nuk paraqet gjë tjetër, përveçse një shpifje të tij ndaj Ibrahim Rugovës postmortum.

● Kur Spahiu në artikullin e tij të vitit 2016 me titull: “**Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi**” ka shkruar se edhe Ibrahim Rugova e paska përkrahur idenë e tij për krijimin e “kombin kosovar”, Ibrahim Rugova kishte 10 vjet që kishte vdekur, që në vitin 2006. Dhe natyrisht që Spahiu e ka ditur se Rugova i vdekur nuk do të ngrihej nga varri për të thënë të kundërtën: se nuk e ka përkrahur idenë e Spahiut për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

### **Sipas Halil Matoshit, Ibrahim Rugova ka synuar bashkimin Kosovë-Shqipëri**

Se Ibrahim Rugova nuk e ka synuar as ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe, dhe as mosbashkimin e Kosovës me Shqipërinë, flet

---

<sup>245</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi 26 gusht, 2016. dritare.net: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

një shkrim i publikuar në një faqe të internetit me titull “**Matoshi: Ibrahim Rugova ka synuar bashkimin kombëtar**”. Në atë shkrim është thënë si më poshtë:

■ **Ish-gazetari dhe analisti i rregullt i zhvillimeve politike, Halil Matoshi, ka folur për qëndrimet e presidentit të ndjerë të Kosovës, Ibrahim Rugova, para luftës. Matoshi ka thënë në emisionin “Pressing”, në televizionin T7, se Rugova gjithnjë ka dashur bashkim kombëtar mes Shqipërisë dhe Kosovës. Sipas Matosit, Rugova ka vlerësuar se “Republika e Kosovës është kompromis”. Ai ka thënë se, sipas Rugovës, pavarësimi nuk ka qenë kërkesa maksimale e shqiptarëve të Kosovës**<sup>246</sup>.

● Siç shihet nga shkrimi i mësipërm, del se Ibrahim Rugova, në kundërshtim me ato që thotë Spahiu për të, jo vetëm që nuk e ka synuar ndarjen e kombit shqiptar dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”, por përkundrazi ka synuar bashkimin Kosovë-Shqipëri. Duke synuar bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, Ibrahim Rugova është deklaruar madje, se “Republika e Kosovës është kompromis”.

### **As Ibrahim Rugova, as Adem Demaçi dhe as Skënderbeu nuk kanë pasur mandat për ta ndarë kombin shqiptar në dy kombe**

Spahiu në një rast tjetër është shprehur si në vijim:

**... me vet faktin se Rugova edhe të gjithë ata që janë konë rreth tij, kanë vendos me pas shtetin e Kosovës dhe këtë pjesë jo me ja bashkue Shiprisë, qatëherë u marr vendimi mu bo dy kombe dhe jo ni komb**<sup>247</sup>. (min. 29:16 -29: 25)

● Lidhur me pohimet e Spahiut të cituara më lart, dua t’u sqaroj lexuesve dy gjëra:

***E para***, nuk ka qenë Ibrahim Rugova, ai që ka vendosur që Kosova të mos i bashkohej Shqipërisë, por ka qenë Dokumenti i Ahtisarit, që ia ka ndaluar Kosovës bashkimin me një shtet tjetër, gjë që ka

<sup>246</sup> Matoshi: Ibrahim Rugova ka synuar bashkimin kombëtar; February 11, 2020: <https://www.voal.ch/matoshi-ibrahim-rugova-ka-synuar-bashkimin-kombetar/politike/kosove/>

<sup>247</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun; *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

nënkuptuar mosbashkimin me Shqipërinë, dhe **E dyta**, as Ibrahim Rugova dhe as ata rreth tij nuk kanë vendosur që shqiptarët të jenë me dy kombe e jo një komb, siç na thotë Spahiu, sepse për diçka të tillë nuk ka asnjë fakt.

● Mëtej, lidhur me pohimin e Spahiut sipas të cilit: Rugova dhe ata që kanë qenë rreth tij paskan vendos që shqiptarët të janë dy kombe dhe jo një komb, dua t'i sqaroj lexuesit se, as Ibrahim Rugova, as Adem Demaçi dhe madje as edhe vetë Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, nuk kanë pasur mandat të marrin vendim për t'i ndarë shqiptarët në dy kombe: në komb shqiptar në Shqipëri dhe në "komb kosovar" në Kosovë, dhe as nuk kanë pasur mandate për të marrë vendime që Kosova mos të bashkohet me Shqipërinë.

● Shqiptarët e Kosovës janë aq shumë të lidhur me identitetin e tyre kombëtar shqiptar, saqë ata nuk tjetërsohen në një komb tjetër "kosovar" për hir të asnjë autoriteti të vdekur apo të gjallë. Po të ishte aq e lehtë ndarja e kombit shqiptar në dy kombe, këtë do ta realizonte Serbia shumë kohë para Spahiut, e cila në vitet '60 dhe të 70 të shekullit XX është përpjekur që ta ndajë kombin shqiptar në dy kombe: njëri komb "albanci" në Shqipëri e tjetri komb "shiftari" në Kosovë, por nuk ia ka arritur.

● Ata që janë përpjekur dhe përpiqen pa sukses që të marrin mandatin nga vetja për ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri "kosovar", janë katër publicistë e gazetarë: Nexhemedin Spahiu, Halil Matoshi, Migjen Kelmendi dhe Bardhyl Meta, që siç thuhet në popull: "Zoti hair ua bëftë...!"

● Por kombi shqiptar këtyre katër musketarëve në vend të mandatit për ta ndarë kombin shqiptar në dy kombe, ka për t'u dhënë mandatin e të humburve në shkretëtirën, të cilën ata e kanë krijuar vetë!

## **IMPLIKIMI I FJALORËVE NË FUNKSION TË PROPAGANDIMIT TË GJOJA KRIJIM-EKZISTIMIT TË “KOMBIT KOSOVAR”**

Në këtë kapitull dua t`i sqaroj lexuesit se si Nexhmedin Spahiu për ta përligjuar sipas tij krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, përpiket të spekuloj e manipuloj edhe me fjalorin e famshëm të Oksfordit. Por fjalori i Oksfordit nuk e shpeton Spahiun as nga realiteti i ekzistimit në Kosovë të kombit shqiptar dhe, as nga realiteti i mosekzistimit në Kosovë të “kombit kosovar”. Këto dy realitete të hidhura për Spahiun nuk i ndryshon aspak fjalori i Oksfordit. Kështu, kapja e Spahiut për fjalorin e Oksfordit është si kapja për kashta e atij që po mbytet!

### **Ndarja e shqiptarëve në përdorues dhe mospërdorues të fjalorit të Oksfordit**

- Spahiu duke pasur për kriter përdorimin ose mospërdorimin e fjalorit të Oksfordit, ka kohë që shqiptarët i ka ndarë në dy kategori: në shqiptarë bashkëkohorë, që sipas tij komunikojnë me fjalor të Oksfordit, në ballë të të cilëve sipas të të gjitha gjasave e sheh veten e tij), dhe në shqiptarë të prapambetur, që sipas tij nuk komunikojnë me fjalorin e Oksfordit. Këta të fundit janë kryesisht ata shqiptarë, që në njërën anë nuk pajtohen me idetë e Spahiut për ekzistimin, sipas tij, të “kombit kosovar”, kurse në anën tjetër synojnë bashkimin Kosovë-Shqipëri në planin afatgjatë.
- Nexhmedin Spahiu për të na bindur se nga shqiptarët e Kosovës

veç është krijuar një komb tjetër joshqiptar, të cilin ai e quan “komb kosovar”, ndër të tjera ka implikuar edhe fjalorët, si p.sh: fjalorin e famshëm të Oksfordit, fjalorët anglisht-gjuhë të tjera, dhe natyrisht edhe fjalorët e shërbëtorëve të shokut Enver! Krejt kjo për t’i bindur shqiptarët, se fjala “komb” në gjuhën angleze “nation” ka vetëm kuptimin e “kombit” dhe jo edhe të “shtetit”, edhe të “vendit”.

● Spahiu ka nevojë që fjala “nation” e gjuhës angleze të ketë vetëm kuptimin e “kombit”, sepse duke pasur ajo vetëm kuptimin e “kombit”, kjo do të thotë se presidentët amerikanë duke e quajtur Kosovën “Komb i Kosovës”, (“Kosovo Nation”), ata e kanë pasur fjalën për ekzistimin në Kosovë të “kombit kosovar”, të cilin Spahiu e propagandon për 25 vite me radhë.

● Por, për fatin e keq të Spahiut, fjala “nation” në shumicën e fjalorëve të gjuhës angleze - gjuhë tjera ka tri kuptime: 1) të kombit, 2) të shtetit dhe 3) të vendit, por siç do të shohim më poshtë, Spahiu përkthimin e fjalës “nation” jo vetëm si “komb”, por edhe si “shtet”, edhe si “vend” e quan huti, moskuptim dhe gabim!

### **Në shumë fjalorë fjala angleze “nation” përkthehet edhe si komb, edhe si shtet, edhe si vend**

Spahiu, lidhur me domethënien e fjalës “komb”, që në gjuhën angleze shkruhet “nation”, ka shkruar si në vijim:

■ **Me çdo fjalor anglisht-shqip apo shqip-anglisht, fjala “nation” përkthehet “komb” dhe anasjelltas<sup>248</sup>. Kur përkthimi nga gjuha angleze, ose nga cilado gjuhë tjetër perëndimore shkakton huti apo moskuptim, ndodh shpesh që fjala “komb” të përkthehet si “shtet”. Ky është një gabim i madh<sup>249</sup>.**

● Lidhur me thënien e Spahiut të cituar më lart, dua t’i sqaroj lexuesit, se ashtu siç i kam sqaruar edhe në disa kapituj të tjerë të këtij libri, se fjala “nation” e gjuhës angleze në shumë fjalorë anglisht-gjuhë të tjera, është përkthyer si *komb*, *shtet* dhe *vend*.

● Siç u shpreha edhe më lart, Spahiu dëshiron që fjala “nation” të ketë vetëm kuptimin e kombit, për të thënë se kur ish-presidentët

<sup>248</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi, 26 gusht, 2016. *Dritare.net*: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

<sup>249</sup> Nexhmedin spahiu: *Koncepti i kombit*, <https://www.kosova-sot.info/opinione/63593/>

amerikanë, Bill Klinton dhe Xhorxh Bush i Riu, dhe kur edhe ish-sekretarja e SHBA-së, Hilari Klinton, si dhe kur ish-ministri i Jashtëm i Britanisë, Toni Bler, e kanë quajtur Kosovën “komb kosovar” (“Kosovo Nation”), ose “Komb i ri” (“New Nation”), ata gjoja duke u shprehur kësisoj kanë vërtetuar krijimin në Kosovë të “kombit kosovar”, gjë që nuk qëndron aspak.

● Për vetë faktin se fjala angleze “nation” nuk ka vetëm kuptimin e kombit, por ka edhe kuptimin e shtetit, edhe të vendit, dhe duke pasur parasysh se në Kosovë ka ndodhur shtetbërja e Kosovës, por nuk ka ndodhur krijimi i “kombit kosovar” e, së fundmi, edhe duke pasur parasysh se figurat madhore politike të përmendura më lart, as edhe një herë të vetme nuk i kanë bërë vërejtje Kosovës pse ajo nuk po krijon ende “kombin kosovar”, të gjitha këto flasin se figurat madhore politike të përmendura më lart, Kosovën e kanë quajtur “komb i Kosovës” (“Kosovo-Nation”) në kuptimin e shtetit të Kosovës dhe jo në kuptimin e “kombit kosovar”, siç na thotë Spahiu.

● Për t’i sqaruar lexuesit, se fjala e gjuhës angleze “nation” nuk ka vetëm kuptimin e “kombit”, siç na thotë Spahiu, por ka edhe kuptimin e “shtetit” dhe të “vendit”, po japim më poshtë përkthimin e fjalës angleze “nation” në disa gjuhë: në gjuhën gjermane, shqipe, italiane, spanjolle, portugeze dhe serbokroate.

1. Në fjalorin: **Englisch-Deutsch Wörterbuch**, PONS Langenscheidte GmbH, Stöckachstrasse 11, 70190 Stuttgart, 2022 p. 625. ISBN: 978 -3-12-514058-4 - Fjala *nation* e gjuhës angleze është përkthyer si: **shtet, vend dhe komb.**
2. Në fjalorin: **Kompaktwörterbuch Englisch-Deutsch**, PONS Langenscheidte GmbH, Stöckachstrasse 11, 70190 Stuttgart, 2024, p. 543 ISBN: 978 -3 -12 -516250-1 - Fjala *nation* e gjuhës angleze është përkthyer si: **shtet, vend dhe komb.**
3. Në fjalorin: **Grosse Schulwörterbuch Englisch-Deutsch**, PONS Langenscheidte GmbH, Stöckachstrasse 11, 70190 Stuttgart, 2023, p.463 ISBN: 978 -3-12-516179-5 - Fjala *nation* e gjuhës angleze është përkthyer si: **shtet, vend dhe komb.**
4. Në fjalorin: **Power Wörterbuch Deutsch als Fremedsprache**, PONS Langenscheidte GmbH, Stöckachstrasse 11, 70190

- Suttgart, 2023, p 625. ISBN: 978- 3-514117-9 - Fjala *nation* e gjuhës angleze është përkthyer si: **shtet, vend dhe komb.**
5. Në fjalorin **Langenscheidt Handwörterbuch English-Deutsch**, botim 2001; faqe 392 - Fjala *nation* e gjuhës angleze është përkthyer si: **a) nation (komb), b) volk (popull) c) staat (shtet).**
  6. Në fjalorin e **Ilo Stefanllarit: Fjalor anglisht-shqip, Rilindja**, Prishtinë, 1988, faqe 254, fjala *nation* e gjuhës angleze është përkthyer si: **1) komb; 2) shtet; 3) vend.**
  7. Në fjalorin e **Ilo Stefanllari -Albanian-English, English - Albanian Dictionary**, Hippocrene Books, New York, 2002, faqe 298, fjala *nation* e gjuhës angleze është përkthyer si: 1) komb; 2) shtet; 3) vend.
  8. Në fjalorin e **Ramazan Hysës: Fjalor anglisht-shqip**, botim 1998: faqe 460 - Fjala *nation* e gjuhës angleze është përkthyer si: **1) komb, 2) vend dhe 3) popull, fis.**
  9. Në fjalorin e **Abedin Prezës, Ervin Preza: Fjalor italisht-shqip**, botim 2010: faqe 921, fjala “nazione” e gjuhës italiane është përkthyer si: **a) komb, b) shtet dhe c) lindje, prejardhje; vendlindje.**
  10. Në fjalorin e **Kristofor Ndreut: Fjalor spanjisht-shqip**, botim 2011, faqe 696, fjala *nacion* e gjuhës spanjolle është përkthyer si: **komb, vend dhe popull.**
  11. Në fjalorin **portugalisht-anglisht (portugues ingles)**, (Sao Paulo, 1985, faqe 225, fjala “nation” e gjuhës portugeze është përkthyer si: **1) nacao (komb), pais (vend, shtet), 2) raca (racë)** dhe disa kuptime të tjera.
  12. Në fjalorin e **Morton Benson: Englesko-Srpsko-hrvatski rečnik**, botim 1986, faqe 424, fjala “nation” e gjuhës angleze është përkthye si: **narod (popull); nacija (komb); zemlja (vend).**
  13. Në fjalorin **Engleski-srpskohrvatski rečnik** (fjalor anglisht-serbokroatisht), Obod Cetinje, Medicinska knjiga Beograd Zagreb, 1988, faqe 212, fjala “nation” e gjuhës angleze është përkthyer si: **1) narod (popull), nacija (komb), 2) narodnost (pakicë kombëtare), nacionalnost (kombësi), 3) drzava (shtet), zemlja (vend).**

● Por edhe përkundër faktit, se pothuajse në të gjithë fjalorët e botës, fjala e gjuhës angleze “nation”, përveç kuptimit të kombit, ka edhe kuptimin e shtetit dhe të vendit, Spahiu ngul këmbë se fjala angleze “nation” në të gjithë fjalorët anglisht-gjuhë të tjera, ka vetëm kuptimin e kombit.

● Shtrohet pyetja: a është e mundur që gjithë ata hartues, profesionistë të fjalorëve të gjuhës angleze-gjuhë të tjera, duke përkthyer fjalën “nation” të gjuhës angleze edhe si komb, edhe si shtet të kenë gabuar rëndë, kurse Spahiu ynë duke thënë se fjala angleze “nation” e ka vetëm kuptimin e “kombit”, të ketë të drejtë?!

● Është e pamundur që të gjithë ata hartues profesionistë të fjalorëve gjuhë angleze -gjuhë tjera, duke përkthyer fjalën angleze “nation” edhe si komb, edhe si shtet të kenë gabuar rëndë, kurse vetëm Spahiu (që nuk është hartues fjalorësh), duke thënë pa asnjë fakt se fjala angleze “nation” e ka vetëm kuptimin e kombit, të ketë të drejtë!

### **Teorizimet e Spahiu lidhur me fjalorin e Oksfordit**

Spahiu duke teorizuar lidhur me fjalorin e Oksfordit, është shprehur edhe si në vijim:

■ **Bota komunikon me fjalor të Oxfordit e jo me fjalor të Kostallarit**<sup>250</sup>.

● Është e vërtetë se bota komunikon me fjalorin Oksfordit sepse gjuha angleze ka qenë dhe është gjuhë e komunikimit ndërkombëtar. Dhe është e vërtetë se bota nuk komunikon me fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980 botuar në Tiranë (të cilin Spahiu e quan fjalor i Kostallarit), sepse gjuha shqipe nuk është gjuhë e komunikimit ndërkombëtar.

● Por, po ashtu është e vërtetë se shqiptaret nuk përdorin vetëm fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980 me 40 mijë fjalë, por e përdorin edhe fjalorin gjuhës shqipe të botuar në vitin 2023 në Tiranë me 70 mijë fjalë, si dhe e përdorin edhe fjalorin e Oksfordit dhe edhe fjalorë të gjuheve tjera, sipas fushave të dijeve që ndjekin.

---

<sup>250</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi 26 gusht, 2016. *Dritare Net*: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

● Por, cilindo fjalor që të përdorë bota, një gjë nuk ndryshon aspak: fjala e gjuhës angleze “nation” përveç kuptimit të kombit, ka edhe kuptimin e shtetit dhe të vendit. Kështu, kur politikanët anglishtfolës Kosovën e kanë quajtur *Komb i Kosovës* (“Kosovo-Nation”) ose *Komb i ri* (“New Nation”), ata kështu Kosovën e kanë quajtur *Shteti i Kosovës* dhe *Shtet i ri*, dhe nuk e kanë quajtur Kosovën “komb kosovar”, siç do të donte Spahiu ynë.

### **Definicioni i kombit në fjalorin e Oksfordit dhe në fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980**

Spahiu duke teorizuar mëtej lidhur me fjalorin e Oksfordit, është shprehur si më poshtë:

■ Nëse lexoni kuptimin e kësaj fjale në fjalorin e Oxfordit dhe atë të Kostallarit, dallimi është thelbësor. Në fjalorin e Oxfordit thuhet se: komb konsiderohet një komunitet i madh njerëzish që i bashkon origjina, historia, kultura, gjuha e përbashkët që qeveriset nga një qeveri. Kjo do të thotë jo domosdoshmërisht të gjithë qytetarët që qeverisen nga ajo qeveri, por vetëm ata që i bashkon origjina, historia, kultura, gjuha e përbashkët. Kjo i bie që, komb shqiptar mund të konsiderohet vetëm komuniteti i shqiptarëve etnikë të Shqipërisë dhe jo edhe pakicat e tjera etnike të paintegrara që jetojnë në Shqipëri, e as edhe shqiptarët etnikë që nuk e kanë shtetësinë e Shqipërisë<sup>251</sup>.

\* Por Spahiu duke folur për fjalorin e Oksfordit shprehet edhe për fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980 si më poshtë:

■ Por në fjalorin e Kostallarit (shokut Enver Hoxha)<sup>252</sup> i mungojnë fjalët “nën një qeveri”. Kjo i bën disa apo shumicën, e sidomos ata jashtë Shqipërisë, të mendojnë se i gjithë etnikumi shqiptar në Ballkan e përbën kombin shqiptar!<sup>253</sup>.

● Për t`i sqaruar lexuesit lidhur me definicionin për kombin të

---

<sup>251</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi; 26 gusht, 2016. *Dritare net*: Blushi:

<https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

<sup>252</sup> Fjalori Kostallarit (shokut Enver Hoxha) nënkupton fjalorin e gjuhës shqipe të botuar në vitin 1980.

<sup>253</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi 26 gusht, 2016. *Dritare Net*: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

dhënë në fjalorin e Oksfordit dhe, lidhur me definicionin për kombin të dhënë në fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980, duhet që këto dy definicione të krahason për t`ua gjetur të përbashkëtat dhe dallimet.

### **Definicioni për kombin në fjalorin e Oksfordit**

Spahu thotë se kombi në fjalorin e Oxfordit definohet si:

■ **Komunitet i madh njerëzish që i bashkon origjina, historia, kultura, gjuha e përbashkët që qeveriset nga një qeveri.**

### **Definicioni për kombin në fjalorin e gjuhës shqipe**

Në fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980, të cilin Spahiu me ironi e herë e quan fjalor i Kostallarit e herë fjalor i shokut Enver, kombi definohet si më poshtë:

■ **Bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit, të jetës ekonomike dhe të formimit psikik, që shfaqet në bashkësinë e kulturës.**

### **E përbashkëta mes dy definicioneve**

● E përbashkëta e të dy definicioneve ka të bëjë me faktin se ato e definojnë kombin në përputhje me parimet e teorive gjermane për kombin sipas të cilave: **Kombi është një konstrukt etnik që ka prejardhje etnike, histori, gjuhë dhe kulturë të përbashkët për të gjithë pjesëmarrëve të tij.**

### **E dallshmja në mes dy definicioneve**

● Ajo që i dallon dy definicionet e cituara më lart për kombin ka të bëjë me faktin se, ndryshe në fjalorin Oksfordit thuhet se kombi është: **komunitet i madh njerëzish.....që qeveriset nga një qeveri**, në fjalorin gjuhës shqipe të vitit 1980 nuk thuhet se kombi është: **një bashkësi njerëzish.... që qveriset nga një qeveri.**

Pikërisht ndaj këtij dallimit në mes të dy definicioneve ka reagur Spahiu si më poshtë:

■ **Por në fjalorin e Kostallarit (shokut Enver Hoxha) i mungojnë fjalët “nën një qeveri”. Kjo i bën disa apo shumicën,**

**e sidomos ata jashtë Shqipërisë, të mendojnë se i gjithë etnikumi shqiptar në Ballkan e përbën kombin shqiptar!<sup>254</sup>.**

### **Pse Spahiut i pëlqen definicioni i kombit i dhënë në fjalorin e Oksfordit**

● Spahiu i pëlqen definicioni i kombit i dhënë në fjalorin e Oksfordit, ngase sipas tij pjesëtar të kombit shqiptar janë vetëm shqiptarët e Shqipërisë, kjo sepse vetëm ata qeverisen nga qeveria e Shqipërisë, kurse shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Luginës së Preshevës, nuk i përkasin kombit shqiptar sepse nuk qeverisen nga qeveria e Shqipërisë, por qeverisen nga tri qeveri tjera. Ky përkufizim i pëlqen Spahiut për të thënë se meqë shqiptarët e Kosovës nuk qeverisën nga qeveria e Shqipërisë, ata nuk janë pjesëtar të kombit shqiptar, por janë pjesëtar të një kombi tjetër “kosovar”.

● Por kjo mendësi e Spahut nuk qëndron sepse historia ka treguar se gjermanët, edhe kur kanë jetuar në dy shtete gjermane dhe, për rrjedhojë edhe kur nuk janë qeverisur nga një qeveri e vetme, por janë qeverisur nga dy qeveri të ndryshme, megjithatë i kanë takuar të njëjtit komb gjerman. Dhe historia ka treguar se edhe vietna-mezët, kur kanë jetuar në dy shtete vietnameze dhe nuk janë qeverisur nga një qeveri e vetme, por janë qeverisur nga dy qeveri të ndryshme, megjithatë i kanë takuar të njëjtit komb vietnamez. Dhe historia tregon se edhe arabët, edhe pse jetojnë në shumë shtete arabe, dhe nuk qeverisen nga një qeveri e vetme, por qeverisen nga dhjetë e më shumë qeveri të ndryshme, megjithatë i takojnë të njëjtit komb arab.

### **Pse Spahiut nuk i pëlqen definicioni i kombit sipas fjalorit të gjuhës shqipe**

● Spahiut nuk i pëlqen definicioni i kombit i dhënë në fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980, sepse ai duke mos e kushtëzuar të qenit e shqiptarëve pjesëtar të kombit shqiptar me qeverisjen e tyre nga

---

<sup>254</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi 26 gusht, 2016. *Dritare Net*; <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

qeveria e shtetit shqiptar, flet qartë se pjesëtar të kombit shqiptar nuk janë vetëm shqiptarët e Shqipërisë që qeverisen nga qeveria shqiptare, por janë edhe shqiptarët Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Luginës së Preshevës, edhe pse nuk qeverisen nga qeveria e Shqipërisë, por qeverisen nga tri qeveri tjera.

● Me fjalë të tjera, Spahiut nuk i pëlqen definicioni i kombit i dhënë në fjalorin e gjuhës shqipe, sepse sipas këtij definicioni të gjithë shqiptarët brenda e jashtë Shqipërisë i përkasin kombit shqiptar, dhe nuk i përkasin edhe ndonjë kombi tjetër “kosovar”, ekzistim-krijmin e të cilit Spahiu e propagandon ditë e natë pa asnjë fakt.

### **Gjithë etnikumi shqiptar përbën kombin shqiptar**

● Se tërë etnikumi shqiptar në Ballkan (brenda e jashtë Shqipërisë) i përket kombit shqiptar, këtë të vërtetë nuk e lëviz jo vetëm fjalori i Oksfordit, por nuk e lëviz dot as topi dhe aq më pak ta lëvizë fjala e Spahiut. Kjo ndër të tjera, edhe për vetë faktin se në botë ka pasur e ka kombe të ndara në dy a më shumë shtete, të cilat edhe pse janë qeverisur dhe qeverisen nga qeveri të ndryshme, megjithatë, u kanë takuar e u takojnë kombeve të tyre përkatëse.

### **Shumë shqiptarë e kanë përdorur dhe e përdorin fjalorin e Oksfordit**

● Spahiu duke mos mundur të shkëputet nga fjalori i Oksfordit, shprehet edhe si në vijim:

■ **Atë çfarë po bëjmë unë, Halil Matoshi, Fatos Lubonja, Blerim Gashani, Bardhyl Meta, Vesat Ademi, Hazbi Gashi, Ertan Munoglli, e shumë e shumë të tjerë, është që po u themi shqiptarëve në Kosovë e Shqipëri që duhet të komunikojmë me fjalorin e Oksfordit që të na kuptojë bota**<sup>255</sup>.

● Sipas thënies së Spahiut të cituar më lart, del se ai dhe ata shtatë veta që i përmend me emra, u kanë thënë shqiptarëve në Kosovë e në Shqipëri, që të komunikojnë me fjalorin e Oksfordit, që t'i kuptojë bota. Unë e siguroj Spahiun dhe ata të tjerët që përmend

---

<sup>255</sup> Nexhmedin Spahiu, e premte 26 gusht 2016, *Dritare.Net*: Blushi: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

ai, se shumë shqiptarë e kanë përdorur fjalorin e Oksfordit, shumë kohë para Spahiut dhe atyre shtatë vetave që përmend ai.

● Nuk e di nëse Spahiu dhe ata shtatë të tjerët që përmend, komunikojnë ose jo me fjalorin e Oksfordit, por e di se Spahiu bashkë me ata shtatë të tjerët, duke u shërbyer me fjalorin e Oksfordit, do të mësojnë se ai fjalor kombin e përkufizon si konstrukt etnik, gjuhësor e kulturor specifik, në përputhje me teoritë gjermane për kombin, të cilat flasin shkurt e qartë, se të gjithë shqiptarët në Ballkan, përfshi edhe shqiptarët e Kosovës, i takojnë të njëjtit komb shqiptar.

# **PJESA E TETË**

---

## **NË KOSOVË MUND TË KETË LUFTË CIVILE - VËLLAVRASËSE VETËM NËSE NGA NJË PJESË E SHQIPTARËVE TË KOSOVËS DO TË KRIJOHEJ “KOMBI KOSOVAR”**

Në këtë kapitull dua që, bashkë me lexuesit, të analizojmë përmbajtjen shumë destruktive dhe toksike të një shkrimi të Nexhmedin Spahiut, të publikuar në “facebook”-un e tij. Spahiut në shkrim-statusin e tij ka shkruar lidhur me mundësinë e ndezjes së një lufte civile në Kosovë, të cilën sipas tij do ta pengonte SHBA-ja. Por nëse roli i SHBA-së në Ballkan do të dobësohej, atëherë sipas Spahiut, në Kosovë do të fuqizoheshin forcat, të cilat Kosovën do të donin t’ia bashkonin Shqipërisë, dhe kjo do të bënte që patriotët e vërtetë të Kosovës ta mbronin pavarësinë e Kosovës me luftë!

Edhe pse Spahiut nuk e thotë qartë, se cilat do të ishin palët ndërluftuese në luftën civile që, sipas tij, do të mund të ndodhte në Kosovë, duke e lexuar me kujdes këtë artikull të Spahiut për mendimin tim ai aludon, që palët ndërluftuese të një lufte civile në Kosovë, në njërin anë do të ishin pjesëtarët e kombit shqiptar, që do të donin që Kosovën t’ia bashkonin Shqipërisë, kurse në anën tjetër do të ishin pjesëtarët e “kombit kosovar”, të cilët si patriotët të vërtetë do të mbronin pavarësinë e Kosovës me luftë.

Kështu, ndërsa unë kam shkruar se duhet të parandalohet krijimi i “kombit kosovar”, pikërisht për të mos ndodhur luftëra të tilla civile mes shqiptarëve të ndar edhe brenda Kosovës në komb

shqiptar dhe në “komb kosovar”, Spahiu jo vetëm që synon krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, por edhe kërcënon se si pjesëtarët e “kombit kosovar”, si patriotë të vërtetë, do ta mbronin pavarësinë e Kosovës duke luftuar kundër pjesëtarëve të kombit shqiptar.

### **Artikulli i Spahiut i publikuar në “facebook”-un e tij**

Spahiu në artikull-statusin e tij të publikuar në “Facebook” ka shkruar si më poshtë:

**“Kosova fatkeqësisht është e ndarë mes atyre që Kosovën e duan shtet të pavarur e sovran e subjekt ndërkombëtar dhe atyre që pavarësinë e shohin të përkohshme vetëm si trampolinë drejt bashkangjijtes së saj Shqipërisë.**

**Në luftën çlirimtare (1998/99) ishim të gjithë bashkë, sepse të dy palët kishim interes ta heqim qafe Serbinë. Tani sa më shumë po e harrojmë Serbinë po ndezet konflikti i brendshëm. Shumë nga kombet në fillimet e veta janë përballur me luftën civile. Kombi Shqiptar është përballur me luftë civile 3 dekada pas lindjes së tij (1943/44).**

**Tani Kosova është futur në dekadën e dytë pas pavarësisë de jure dhe dekadën e tretë de facto. Shenjat e rrezikut janë të qarta. Por ka një dallim mes Shqipërisë 1944 dhe Kosovës 2030.**

**Krijuesja e Shqipërisë, Austro-Hungaria kishte vdekur dhe zëvendësuesja e saj Gjermania po humbiste luftën.**

**Kosova ka babë Amerikën dhe kjo është garancë që nuk do të ketë luftë civile në Kosovë. Nëse roli amerikan në Ballkan në ndërkohë dobësohet, atëherë do të fuqizohen forcat që janë kundër pavarësisë së Kosovës, kurse patriotët e vërtetë të Kosovës do të detyrohen ta mbrojnë pavarësinë e Kosovës me luftë<sup>256</sup>“**

Lidhur me këtë shkrim të Spahiut të cituar më lart, dua të sqaroj lexuesit si më poshtë:

---

<sup>256</sup> Spahiu thotë se SHBA-ja e mbron Kosovën nga lufta Civile 2.12.24. Periskopi <https://www.periskopi.com/spahiu-thote-se-shba-te-mbrojne-kosoven-nga-lufta-civile/>

● Kosova nuk është aspak e ndarë mes atyre që Kosovën e shohin shtet të pavarur sovran dhe subjekt ndërkombëtar, dhe atyre që pavarësinë e Kosovës e shohin si një trampolinë drejt bashkëngjitjes saj me Shqipërinë, siç na thotë Spahiu në shkrimin e tij tejet destruktiv të paraqitur më lart. Ky pohim i Spahiut nuk qëndron aspak, sepse shumica dërmuese e shqiptarëve Kosovën e do shtet të pavarur, sovran dhe subjekt ndërkombëtar, por duke lënë të hapur edhe mundësinë e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë.

● Në Kosovë nuk ekziston frika nga ata shqiptarë që mendojnë se Kosova duhet t'i bashkohet Shqipërisë, por në Kosovë ekziston frika nga disa shqiptarë, që Kosovën duan t'ia bashkojnë Serbisë.

● Në Kosovë vetëm Spahiu me nja tre publicistë të tjerë kanë frikë se mos Kosova po i bashkohet Shqipërisë. Kjo katërshe ka më shumë se 25 vjet që po deklarohet kundër bashkimit të mundshëm Kosovë-Shqipëri, edhe pse as Kosova dhe as Shqipëria bashkimin e tyre ende nuk e kanë prioritet për arsye të caktuara.

● Edhe pse Serbia në këto 25 vitet e fundit e ka kërcënuar Kosovën shumë herë me luftë e pushtim, Spahiu nuk është shprehur se patriotët e vërtetë do ta mbrojnë Kosovën me luftë. Me sa duket Spahiu më shumë e ka frikë bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, sesa okupimin e serishëm të Kosovës nga Serbia.

### **Shqiptarët gjatë luftës çlirimtare nuk kanë qenë dy palë por një palë**

● Edhe thënia e Spahiut, sipas të cilës **“në luftën çlirimtare (1998-‘99) ishim të gjithë bashkë, sepse të dyja palët kishim interes ta hiqnim qafe Serbinë”**, nuk qëndron aspak. Kjo, sepse shqiptarët e Kosovës gjatë luftës çlirimtare kanë qenë bashkë si një palë e vetme dhe nuk kanë qenë dy palë të ndara, siç na thotë Spahiu. Thënia e paqëndrueshme e Spahiut, sikur gjoja shqiptarët gjatë luftës çlirimtare paskan qenë të ndarë në dy palë, për mua flet qartë se sa thellë Spahiu i ka të rrënjosura idetë e tij komb-ndarëse dhe destruktive ndaj kombit shqiptar në tërësi.

● Njerëz që me shkrimet e tyre destruktive kanë bërë nxitje, që shqiptarët e Kosovës gjatë luftës çlirimtare të ndaheshin në dy palë kundërshtarë ka pasur, por ata duke qenë të paktë dhe duke

qenë të komprometuar, nuk kanë arritur që shqiptarët gjatë luftës çlirimtare t'i ndajnë në dy palë kundërshtare.

● Prandaj duhet t'i them Spahiut, se shqiptarët e Kosovës gjatë luftës çlirimtare të viteve 1998-1999 kanë qenë një palë e vetme, e cila ka luftuar kundër palës serbe për çlirimin e Kosovës dhe, nuk kanë qenë dy palë, siç thua ti, për qëllime destruktive kombndarëse dhe komb-vrasëse në raport me kombin shqiptar .

### **Në Kosovë nuk ka ndezje konflikti në mes të shqiptarëve**

● Edhe thënia tjetër, për mua monstruoze e Spahiut, sipas së cilës **“tani sa më shumë që po e harrojmë Serbinë, aq më shumë po ndizet konflikti i brendshëm”** nuk qëndron. Shqiptarët e Kosovës as nuk janë duke i harruar krimet gjenocidale të Serbisë dhe as nuk janë duke ndezur ndonjë konflikt mes tyre. Shqiptarët e Kosovës kanë papunësi dhe, për rrjedhojë, edhe varfëri ekonomike, por nuk kanë konflikt të brendshëm mes tyre, siç na thotë Spahiu, për shkak të frymës destruktive që ka brenda vetes.

● Spahiu duke thënë në shkrimin e tij të cituar më lart, **se shumë kombe në fillimet e tyre janë përballuar me luftëra civile**, dëshiron të na thotë se edhe kombi i tij “kosovar” realisht joekzistues, në fillimet e tij do të përballet me luftë civile. Dhe meqë kombi shqiptar në Shqipëri sipas Spahiut, qenka përballur me luftë civile në dekadën e tretë pas krijimit të tij; në vitet 1943-1944 të Luftës Antifashiste, tani po sipas Spahiut, edhe “kombi kosovar”, duke qenë, sipas tij, në dekadën e tretë pas krijimit të tij, do të përballet po ashtu me luftë civile. Çuditërisht kombet u përballkan me luftë civile, në dekadën e tretë pas krijimit të tyre. Parashikim se, jo mahi!

### **Në Shqipëri ka pasur luftë antifashiet dhe jo luftë civile**

● Duhet sqaruar lexuesit, se pjesa e kombit shqiptar në Shqipëri, gjatë viteve 1943-1944 të Luftës së Dytë Botërore, nuk është përballuar me luftë të brendshme civile, siç na thotë Spahiu, por është përballur me Luftë Antifashiste të bërë kundër ushtrive fashiste italiane dhe kundër ushtrive naziste gjermane, duke e renditur kështu Shqipërinë në anën e drejt të historisë: në krahun

e Koalicionit Antifashist Botëror, të përbërë nga Amerika, Britania e Madhe dhe Rusia.

● Por Spahiu duke i pasur idol krerët fashistë të Partisë Fashiste Shqiptare dhe duke e pasur idol kryenazistin shqiptar, Xhafer Devën, nga Mitrovica, Luftën Antifashiste të Shqipërisë e quan luftë civile mes partizanëve antifashistë në njëren anë, dhe pjesëtarëve të Partisë Fashiste Shqiptare, pjesëtarëve profashistë të Partisë së Legalitetit të mbretit Zog dhe pjesëtarëve poronazistë të Partisë së Ballit Kombëtar, të cilët bashkë me fashistët italianë dhe nazistët gjermanë kanë luftuar kundër forcave partizane nacional-çlirimtare.

● Duke pasur parasysh se shqiptarët e Kosovës i kanë takuar dhe i takojnë kombit monoetnik shqiptar, prej tij nuk do të mund të krijohet një komb tjetër “kosovar”, gjë që tregon se ky komb joekzistues nuk ka si të përballet me luftë civile me këdo qoftë.

### **Nëse shqiptarët ndahen në dy kombe ata mund të kenë luftë vëllavrasëse**

● Por, nëse historia do të gabojë sërish ndaj kombit shqiptar, duke çuar në ndarjen e shqiptarëve brenda Kosovës në komb shqiptar dhe në “komb kosovar”, atëherë këto dy kombe në përpjekje e sipër për dominancë dhe pushtet, edhe do të mund të futeshin në qarkun e luftës civile vëllavrasëse, që Zoti mos e thëntë!

● Unë pikërisht duke pasur parasysh rrezikun e luftës vëllavrasëse mes shqiptarëve të Kosovës, ose mes shqiptarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë, jam kundër krijimit nga ndonjë pjesë e shqiptarëve të Kosovës të “kombit kosovar”.

● Por Spahiu duke propaganduar ditë e natë ekzistimin sipas tij të “kombit kosovar”, tregon se krijimin e “kombit kosovar” jo vetëm që e dëshiron, por edhe kërcënon në emër të tij me luftë civile vëllavrasëse mes shqiptarëve.

● Më duhet t’u them lexuesve, se patriotët e vërtetë të Kosovës nuk do ta mbrojnë Kosovën me luftë të armatosur nga ata shqiptarë, që sipas Spahiut Kosovën do të donin t’ia bashkojnë Shqipërisë, por do ta mbrojnë Kosovën me luftë të armatosur nga ata shqiptarë, që Kosovën do të përpiqen t’ia bashkojnë Serbisë.

## Spahiu i gatshëm të luftojë kundër Shqipërisë

- Për të treguar përkushtimin e tij ndaj shtetit të Kosovës dhe ndaj “kombit kosovar”, Spahiu në një debat televiziv të datës 7 prill të vitit 2025 në televizionin “Kanal 10” ka deklaruar se do të luftonte kundër Shqipërisë, nëse ajo do ta sulmonte Kosovën<sup>257</sup>.
- Duke pasur parasysh se Serbia tanimë shumë herë me radhë ka kërcënuar haptas Kosovën me pushtim ushtarak; duke pasur parasysh se ajo ka ndërtuar shumë baza ushtarake në kufijtë e saj me Kosovën, si dhe duke pasur parasysh se ajo i ka afruar forcat e saj ushtarake shumë herë pranë kufijve me Kosovën, Spahiu më parë do të duhej të deklaronte se do të luftonte me armë kundër Serbisë, nëse ajo do ta sulmonte Kosovën, gjë që edhe mund të ndodhë, sesa të deklaronte se do të luftonte me armë kundër Shqipërisë, nëse ajo do të sulmonte Kosovën, gjë as nuk ka ndodhur dhe as nuk mund të ndodhë.
- Kështu, ndërsa Spahiu gjatë viteve 1998-1999 të Luftës Çlirimtare të Kosovës të bërë nga UÇK-ja nuk ka qenë i gatshëm që ta mbrojtë Kosovën me armë nga Serbia, e cila po gjenocidonte Kosovën, tani tregohet i gatshëm që të luftojë me armë kundër Shqipërisë, nëse ajo do ta sulmonte Kosovën!
- Ky është Spahiu: jo i gatshëm të luftojë kundër Serbisë, por shumë i gatshëm të luftojë kundër Shqipërisë! Në popull nuk thuhet kot: “Mos e vet (pyet), se kallëzon vetë...!”

## Kërcënimi i Spahiut bërë medieve që vënë në pikëpyetje ekzistimin e “kombit kosovar”

Spahiu siç jam shprehur edhe në një kapitull tjetër të librit, kërcnon me dënime ato media të cilat e vënë në pikëpyetje ekzistimin e “kombit kosovar”. Kështu ka shkruar si në vijim:

■ **Ish dashur të dënohej një media, e cila e vë në pikëpyetje ekzistencën e kombit. Kjo vë në pikëpyetje ekzistencën e një kombi që George W. Bush e ka pranuar, sepse e thotë se: “Kosovën, SHBA ka vendosur ta pranojë si komb të pavarur dhe sovran”<sup>258</sup>.**

<sup>257</sup> Nexhmedin Spahiu: *Do të luftoja kundër Shqipërisë nëse do të sulmonte Kosovën.*  
<https://www.youtube.com/watch?v=zf2kGldHJCs>

<sup>258</sup> Nexhmedin Spahiu: Kushtetuta e definon kombin kosovar - të tillë e njohu Kosovën edhe

● Spahiu kërcënon ato medie të Kosovës të cilat vënë në pikëpyetje ekzistencën, sipas tij, të “kombit kosovar”. Por Spahiu nuk dëshiron të kuptojë, se për t’u dënuar një medie, pse ajo vë në pikëpyetje ekzistencën e “kombin kosovar”, kusht i domosdoshëm do të ishte ekzistimi real i “kombit kosovar”.

● Por, meqë në Kosovë “kombi kosovar” realisht dhe objektivisht nuk ekziston, kjo tregon se asnjë medie nuk mund të dënohet për shkak të vënies në pikëpyetje të ekzistimit të “kombit kosovar”. Të kërcënosh mediet se po vënë në pikëpyetje ekzistencën e një kombi joekzistues “kosovar”, kësaj i thonë: “Peshku në det e fulterja mbi zjarr”!

● Për ta rritur dozën kërcënimit të tij ndaj atyre medieve, që vënë në pikëpyetje ekzistencën e “kombit kosovar” joekzistues, Spahiu kërcënimin e tij e lidh me emrin e Presidentit amerikan Xhorxh Bush, duke thënë se ata që vënë në pikëpyetje ekzistencën e “kombit kosovar”, vënë në pikëpyetje ekzistencën e një kombi që Presidenti Bush e ka quajtur **komb të pavarur dhe sovran**.

● Por presidentët amerikanë, siç kemi sqaruar edhe në kapitujt pararendës të këtij libri, duke e quajtur Kosovën “Komb i Kosovës” ose “Komb i ri”, ata për vetë faktin se fjala e gjuhës angleze “nation”, ka edhe kuptimin e “kombit”, edhe kuptimin e “shtetit”, nuk e kanë quajtur Kosovën “Komb i Kosovës” në kuptimin e “kombit kosovar”, por e kanë quajtur Kosovën “Komb i Kosovës” në kuptimin “shtet i Kosovës”, gjë që përputhet edhe me realitetin objektiv, sepse në vitin 2008 ka ndodhur bërja e Kosovës shtet, por nuk ka ndodhur krijimi i “kombit kosovar”.

● Spahiu krijim-ekzistimin e “kombit kosovar” e lidh aq shumë me presidentët amerikanë, saqë njeriut i duket se presidentët amerikanë, Bill Klinton dhe Xhorxh Bush, që Kosovën e kanë quajtur “Komb i Kosovës” ose “Komb i ri dhe sovran”, tani nuk po i zë gjumi duke menduar pse në Kosovë nuk po krijohet ende “kombi kosovar”!

● Spahiu nuk dëshiron të kuptojë, se për vetë faktin që shteti i

---

SHBA-ja, *Balkan.Info* 20 nëntor 2019, ora 22:35.

<https://klankosova.tv/nexhmedin-spahiu-kushtetuta-e-definon-kombin-kosovar-te-tille-e-njohu-kosoven-edhe-shba/>

Kosovës nuk identifikohet me “kombin kosovar” joekzistues, por identifikohet me kombin shqiptar ekzistues, kjo flet qartë se vënia në pikëpyetje e ekzistencës së kombit joekzistues “kosovar” nga ana e medieve, nuk mund të paraqesë vepër penale të dënueshme.

- Përkundrazi, vepër penale të dënueshme ka bërë Spahiu sa herë që ka pohuar se në Kosovë është krijuar “kombi kosovar”, sepse ai kështu shqiptarëve të Kosovës ua ka mohuar përkatësinë kombëtare shqiptare, veprim ky i dënueshëm me nene të caktuara të Kushtetutës së Kosovës.

## **IDETË E SPAHIUT PËR KRIJIMIN NGA SHQIPTARËT E KOSOVËS TË “KOMBIT KOSOVAR” NUK KANË GJETUR PËRKRAHJE, POR KANË GJETUR BUMERANG**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se idetë Spahiut për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, edhe përkundër përpjekjeve të ethshme propagandistike të tij, në Kosovë nuk kanë gjetur përkrahje, por përkundrazi kanë gjetur bumerang!<sup>259</sup>.

Kështu, siç kam sqaruar edhe kapitullin e tretë të këtij libri, idetë komb-ndarëse të Spahiut në Kosovë janë përkrahur e përkrahen edhe aktualisht vetëm nga H. Matoshi, B. Meta e ndonjë tjetër, që marrë së bashku janë një grusht njerëzisht, që mund të numërohen me gishtat e dorës.

### **Pjesa dërmuese e shqiptarëve nuk i ka përkrahur idetë komb-ndarëse**

● Dhe siç kam sqaruar edhe në kapitullin e dytë të këtij libri, pjesa dërmuese e shqiptarëve të Kosovës jo vetëm që nuk i ka përkrahur idetë komb-ndarëse të Spahiut, të Matoshit, të Kelmendit e të Metës, por edhe u është kundërvënë atyre në mënyra të ndryshme:

---

<sup>259</sup> *Bumerang* do të thotë një copë e përkulur druri, e cila me rastin e goditjes me të të një objekti, kthehet prapa duke e goditur hedhësin. Një shembull konkret i bumerangut janë edhe gënjeshttrat e një individi ndaj individit tjetër, të cilat për shkak të rrethanave të krijuara i kthehen prapa gënjeshtarit me pasoja për të.

kryesisht duke u shprehur kundër ideve të tilla komb-ndarëse në mjedise publike dhe private dhe, pjesërisht, edhe duke u shprehur kundër ideve të tilla nëpër portale dhe rrjete sociale, me indinjatë, mllef, zemërim, fyerje, akuza dhe sharje, të cilat për shkaqe etike nuk po i përmend.

● Por më lart në kapitullin e dytë të këtij libri kam sqaruar se edhe një pjesë e akademikëve, e profesorëve, e politikanëve, e historianëve, e sociologëve, e publicistëve dhe e gazetarëve, po ashtu u janë kundërvënë ideve komb-ndërse të Spahiut dhe të tre publicistëve të tjerë, si nëpërmjet shkrimeve të tyre analitike, ashtu edhe nëpërmjet të debateve televizive.

● Nga ana tjetër edhe pse shumë intelektualë, akademikë, profesorë, politikanë dhe ish-luftëtar e vetranë të Luftës Çlirimtare të Kosovës, nuk u janë kundërvënë fenomenit të ideve komb-ndarëse të Spahiut, kjo moskundërvënie e tyre ka të bëjë kryekëput me nglizhencë e tyre ndaj ideve të tilla të Spahit dhe, nuk ka aspak të bëjë më pajtimin e tyre për ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”

● Nga të gjitha sa u tha më lart, del e qartë se idetë komb-ndarëse të Spahiut dhe të tre publicistëve e gazetarëve të tjerë të përmendur më lart, për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, në Kosovë jo vetëm që nuk kanë gjetur as përkrahjen më të vogël, por edhe kanë gjetur kundërshti e bumerang.

### **Djegia e librit “Drejt kombit kosovar”**

● Për të ilustruar faktin se idetë e Spahiut për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombin kosovar”, në mesin e shqiptarëve të Kosovës nuk kanë gjetur përkrahje, por kanë gjetur bumerang, flet edhe djegia e librit të Spahiut me titull “Drejt kombit kosovar”, nga pjesëmarrësit në promovimin e atij libri në vitin 2004. Kjo ka ndodhur, sepse pjesëmarrësit në promovimin e atij libri nuk kanë mundur ta gëlltisnin idenë absurde të Spahiut, për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

● Shqiptarët në kodin e tyre kulturor nuk e kanë djegien e librave. Kështu, që nga viti 1945 e deri në vitin 2025, kur po shkruhet ky libër, nuk ka ndodhur që nga shqiptarët Kosovës të digjet ndonjë

libër, përveç librit të Spahiut me titull **“Drejt kombit kosovar”**.

● Shqiptarët e Kosovës për vetë faktin se janë djegur e pjekur shumë herë nga armiq të ndryshëm për të mbetur komb shqiptar, ata janë të gatshëm që të vriten e të digjen me këdo që përpiqet t'i tjetërsojë nga komb shqiptar në një komb tjetër joshqiptar, të quajtur “komb kosovar”.

● Edhe kundërshtimi dhe heshtja prej varri e pjesëmarrëseve në promovimin e tre librave të tjerë të Spahiut me tituj: “Kombi në inkubator”; “Foshnjëria e kombit kosovar” dhe “Ngritja e kombit kosovar”, po ashtu tregon qartë se idetë komb-ndarëse të Spahiut, nëpërmjet të propagandimit të krijimit nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, në mesin e shqiptarëve të Kosovës jo vetëm që nuk kanë gjetur as përkrahjen më të vogël, por kanë gjetur kundërshti, heshtje, injorim dhe bumerang.

**Pse kur Spahiu ka folur për “kombin kosovar” të papranishmit kanë reaguar ndaj tij duke bërë “Vuuu! Vuuu!”**

Ashtu siç kam shkruar edhe në kapitullin 31 të këtij libri, Spahiu i pakënaqur me faktin se idetë e tij komb-ndarëse në mesin e shqiptarëve nuk po gjenin as përkrahjen më të vogël, është shprehur si më poshtë:

■ **Unë nuk e di pse njerëzit kur flas unë për kombin kosovar, njerëzit bojn vuuu! Kur vjen për shembull Klintoni thotë ky asht kombi ma i ri në Europë, kombi kosovar, ose kur thotë Toni Bleri flet për kombin kosovar, atëherë na i rrehim shuplakat<sup>260</sup>. (min. 8:11 -8:35)**

● Spahiu në vend që të pyesë veten pse kur ai flet për “kombin kosovar” të pranishmit e kundërshtojnë duke bërë **“Vuuu! Vuuu!”**, ai kapet tek ish-presidenti amerikan, Bill Klinton dhe ish-kryeministri i Anglisë, Toni Bler.

● Kur Spahiu ka thënë pa asnjë fakt, se nga shqiptarët e Kosovës është krijuar “kombi kosovar”, shqiptarët duke e ditur se i përkasin kombit shqiptar dhe nuk i përkasin një kombi tjetër “kosovar”,

---

<sup>260</sup> Nexhmedin Spahiu në “Oksigjen”, pjesa e tretë 23.09.2011:  
<https://www.youtube.com/watch?v=D673tLZUDIE>

realisht dhe objektivisht joekzistues, ata natyrisht që kanë reaguar kundër Spahiut duke ia bërë **“Vuuu! vuuu!”**.

● Por, duke pasur parasysh se ish-presidenti amerikan, Bill Klinton dhe ish-kryeministri i Anglisë, Toni Bleri, Kosovën e kanë quajtur “Kombi më i ri i Europës”, në kuptimin e shtetit më të ri të Europës, shqiptarët natyrisht që i kanë duartrokitur.

● T’u mohosh shqiptarëve të Kosovës përkatësinë kombëtare shqiptare, duke thënë se ata janë tjetërsuar në një komb tjetër “kosovar”, dhe të çuditësh se ata këtë e kundërshtojnë duke të ta vënë ty kujën me “vuuu! vuuu!”, kjo është shumë herë më e çuditshme se vetë kuja me “vuuu! vuuu!”

### **Përdorimi masiv i flamurit kombëtar shqiptar nga shqiptarët e Kosovës**

● Një indikator tjetër, i cili tregon se idetë e Spahiut për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” në mesin e shqiptarëve të Kosovës nuk kanë gjetur përkrahje, por kanë gjetur bumerang, është edhe fakti se shqiptarët e Kosovës sa më shumë që Spahiu ka kërkuar që ata të mos e përdorin flamurin e tyre kombëtar shqiptar, ata aq më shumë e kanë përdorur dhe e përdorin pikërisht flamurin kombëtar shqiptar, jo vetëm me rastin e festës së 28 Nëntorit, që paraqet festën e flamurit kombëtar shqiptar, por edhe në festat e tyre familjare dhe në raste të tjera.

● Kështu, sidomos gjatë stinës së verës, kur në Kosovë bëhen dasmat, nëpër rrugët e Kosovës valojnë flamujt kombëtarë shqiptarë, të cilët valëviten nga dasmorët. Personalisht e marr me mend sa keq ndihet Spahiu, kur gjatë stinës së verës gjithandej Kosovës sheh flamuj kombëtarë shqiptarë kuqezi.

● Kështu, Spahiu duke mbjellë erë “komb-ndarëse” në mesin e shqiptarëve, ka korrur furtunë komb-konsoliduese e komb-bashkuese! Është bërë për të të ardhur keq për të!



# **PJESA E NËNTË**

---

**GJUHA NUK PARAQET FAKTOR KOMB-PËRCAKTUES  
PËR KOMBET MULTIETNIKE, POR PARAQET FAKTOR  
KOMB-PËRCAKTUES PËR KOMBET MONOETNIKE,  
SIÇ ËSHTË EDHE KOMBI SHQIPTAR NË VISET E TIJ  
NË BALLKAN**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se pikëpamjet e Spahiut, lidhur me raportet mes gjuhëve dhe të kombeve, lënë shumë për të dëshiruar.

Spahiu duke i trajtuar njëanshëm raportet gjuhë-kombe, u thotë lexuesve në mënyrë të përgjithësuar, se gjuha nuk të bën komb, se gjuha nuk është faktor dhe element komb-përcaktues, dhe se vetëm aftësia për ta bërë dhe mbajtur shtetin të bën komb.

Por pikëpamje të tilla të Spahiut lidhur me raportet gjuhë-kombe, siç do të shohim më poshtë, vlejnë vetëm për gjuhët, të cilat fliten nga kombet multietnike (të përbëra nga etni të ndryshme), por nuk vlejnë për gjuhët, të cilat fliten nga kombet monoetnike (të përbëra nga një etni e vetme).

**Gjuhët e kombeve multietnike  
nuk janë gjuhë komb-përcaktuese**

Spahiu duke teorizuar lidhur me raportet gjuhë-kombe, ai ka shkruar si më poshtë:

■ **Gjuha nuk të bën komb. Komb të bën aftësia për të mbajtur shtetin**<sup>261</sup>.

■ **Gjuha nuk ka të bëjë me kombin, gjuha nuk osht faktor i kombit fare. Një komb, çdo komb ka një gjuhë por edhe disa gjuhë. Ose disa kombe kanë një gjuhë por gjuha nuk ka të baj fare me kombin, kjo ka t'boj me etninë. Çdo etni e ka gjuhën e vetë, edhe ni komb mund me pas gjuhën e vet. Por disa kombe munden me pas një gjuhë, por mundet edhe një komb me i pas tri gjuhë, si p.sh: kombi zviceran që ka tri gjuhë. Me secilën prej ktyne gjuhëve bon punë në gjithë Zvicrën. Gjuha nuk asht element, ky asht përkufizim i Stalinit**<sup>262</sup>. (min. 6:20 - 7:17)

● Pohimet e Spahiut të cituara më lart, sipas të cilave **gjuha nuk të bën komb, gjuha nuk është faktor i kombit**, janë bërë në frymën e teorive franceze për kombin dhe janë të vlefshme për gjuhët e kombeve multi-etnike. Kjo, sepse këto gjuhë duke qenë të ndryshme nga gjuhët amtare të etnive të ndryshme komb-krijuese, ato si të tilla nuk identifikohen me etnitë komb-krijuese dhe, për rrjedhojë, edhe nuk janë gjuhë komb-përcaktuese.

### **Gjuha angleze nuk është gjuhë komb-përcaktuese**

Spahiu duke teorizuar mëtej lidhur me raportet gjuhë-kombe është shprehur edhe si më poshtë:

■ **Jo domosdo kombet e ndryshme flasin gjuhë të ndryshme. Çfarë flasin ta zam anglezët, amerikanët, australianët, irlandezët, zelandezët, kanadezët...gjuha e tyre osht po e njëjta**<sup>263</sup>. (min. 10:23 - 10:35)

● Është e vërtetë se anglezët, amerikanët, australianët, irlandezët, zelandezët dhe kanadezët që përmend Spahiu, janë kombe të ndryshme të shteteve të ndryshme, të cilat përdorin të njëjtën gjuhë angleze. Por, gjuha angleze për vetë faktin se flitet nga

<sup>261</sup> Studiuesi Nexhmedin Spahiu: *Shqipëria dhe Kosova dy kombe të ndryshme me gjuhë të njëjtë*, 16/03/2021. Në *syri.net*: <https://www.syri.net/politike/409977/studiuesi-nexhmedin-spahiu-shqipëria-dhe-kosova-dy-kombe-te-ndryshme-me-gjuhe-te-njejte/>

<sup>262</sup> Nexhmedin Spahiu në "Oksigjen", pjesa e tretë 23.09.2011: <https://www.youtube.com/watch?v=D673tLZUdIE>

<sup>263</sup> *Shqiptarët me dy kombe - kombi kosovar*, Adi Krasta në "A Show"; Nexhmedin Spahiu, *Syri TV*, 16.03.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=n02HRe4sAKc>

kombe të ndryshme, ajo nuk paraqet gjuhë komb-përcaktuese për asnjërin nga kombet që e flasin atë.

- Kështu, një njeri anglishtfolës jo domosdoshmërisht është anglez, sepse ai mund të jetë edhe kanadez, australian etj. Kjo është arsyeja pse gjuha angleze nuk është gjuhë komb-përcaktuese.

- Edhe gjuha spanjolle për vetë faktin se flitet nga disa kombe të ndryshme, siç janë: kombi spanjoll, argjentinasi, bolivian, kolumbian dhe disa kombe të tjera, ajo si e tillë nuk identifikohet me kombet e lartpërmendura prej të cilave flitet dhe, për rrjedhojë, edhe nuk është gjuhë komb-përcaktuese. Kjo tregon se një spanjishtfolës jo domosdoshmërisht është një spanjoll, sepse ai mund të jetë edhe një argjentinasi, bolivian apo kolumbian.

### **Gjuhët e kombeve monoetnike janë gjuhë komb-përcaktuese**

- Por pohimet e Spahiut të cituara më lart, sipas të cilave **gjuha nuk të bën komb, gjuha nuk është faktor i kombit**, nuk vlejné për gjuhët e kombeve monoetnike. Kjo, sepse këto gjuhë për vetë faktin se fliten vetëm nga pjesëtarët e kombeve përkatëse monoetnike dhe nuk fliten nga pjesëtarët e kombeve të tjera, ato si të tilla edhe identifikohen me kombet përkatëse monoetnike prej të cilave fliten dhe, për rrjedhojë, edhe paraqesin element komb-përcaktues.

### **Gjuha shqipe identifikohet me kombin shqiptar**

- Gjuha shqipe duke qenë gjuhë e kombit monoetnik shqiptar, përkatësisht duke pasur parasysh se ajo flitet vetëm nga kombi monoetnik shqiptar dhe nuk flitet nga asnjë komb tjetër, ajo si e tillë folësit e saj i identifikon me kombin shqiptar dhe ky i fundit identifikohet me gjuhën shqipe. Për vetë faktin se gjuha shqipe folësit e saj i identifikon me kombin shqiptar, ajo si e tillë paraqet një gjuhë komb-përcaktuese.

- Edhe gjuha hungareze duke qenë se flitet vetëm nga kombi monoetnik hungarez dhe nuk flitet nga ndonjë komb tjetër, ajo si e tillë identifikohet me kombin hungarez dhe ky i fundit identifikohet me gjuhën hungareze. Për vetë faktin se gjuha hungareze folësit

e saj i identifikon me kombin hungarez, ajo si e tillë paraqet një gjuhë komb-përcaktuese.

● Edhe gjuha italiane për vetë faktin se flitet vetëm nga kombi italian dhe nuk flitet edhe nga ndonjë komb tjetër, edhe ajo si e tillë identifikohet me kombin italian dhe ky i fundit identifikohet me gjuhën italiane. Për vetë faktin se gjuha italiane folësit e saj i identifikon me kombin italian, kështu ajo paraqet një gjuhë komb-përcaktuese.

● Gjuha hebraike për vetë faktin se flitet vetëm nga kombi hebraik dhe nuk flitet edhe nga ndonjë komb tjetër, ajo si e tillë identifikohet me kombin hebraik dhe ky i fundit identifikohet me gjuhën hebraike. Për vetë faktin se gjuha hebraike folësit e saj i identifikon me kombin hebraik, ajo si e tillë paraqet një gjuhë komb-përcaktuese.

● Spahiu duke thënë në mënyrë të përgjithësuar, se gjuha nuk ka të bëjë me kombin, ose gjuha nuk është fare faktor i kombit, ai për mendimin tim edhe me këtë rast dëshiron të thotë, se edhe gjuha shqipe **nuk ka të bëjë me kombin shqiptar dhe nuk është fare faktor përcaktues i kombit shqiptar**, sepse atë përveç kombit shqiptar, sipas tij, e flet edhe një komb tjetër, të cilin ai e ka emërtuar si “kombi kosovar”.

● Por, duke pasur parasysh se shqiptarët e Kosovës nuk janë tjetërsuar në “komb kosovar”, ata si edhe shqiptarët e Shqipërisë i përkasin të njëjtit komb shqiptar dhe kjo tregon se gjuha shqipe, të cilën e flasin shqiptarët e Kosovës, këta të fundit i identifikon me kombin ekzistues shqiptar dhe nuk i identifikon me kombin joekzistues “kosovar”.

### **Gjuha shqipe shqiptarët e Luginës së Preshevës**

#### **i identifikon me etninë dhe kombin shqiptar në Ballkan**

Spahiu duke e vlerësuar gjuhën si një faktor që s'ka të bëjë me kombin, ka shkruar edhe si në vijim:

■ **Shqiptarët e Preshevës janë minoritet. Kur kam qenë në Bujanoc më kanë thënë: - Pse ne nuk jemi komb? Iu kam thanë: pse nuk keni Stadium Kombëtar, Bibliotekë kombëtare. Kombi nuk ka të bëjë me atë se çfarë gjuhe flet ti, por me atë**

**që vendos vetë për të drejtat e tua. E shqiptarët e Luginës së Preshevës gëzojnë të drejtat që ua jep Beogradi. A shqiptarët e Kosovës i bëjnë vetë të drejtat e tyre<sup>264</sup>.**

● Është e vërtetë se shqiptarët e Luginës së Preshevës janë një minoritet shqiptar në jugun e Serbisë, por gjuha shqipe edhe pse shqiptarët e Luginës së Preshevës nuk kanë stadium kombëtar të futbollit dhe nuk kanë bibliotekë kombëtare, dhe edhe pse të drejtat e tyre i përcakton Beogradi, megjithatë, ajo i bën ata pjesë e kombit unik shqiptar, që jeton në gjashtë njësi shtetërore të ndryshme në Ballkan.

● Gjuha shqipe për shkak të arsyeve të përmendura më lart, edhe minoritetin shqiptar në Mal të Zi e bën pjesë të etnisë dhe të kombit unik shqiptar në viset e tij në Ballkan.

● Gjuha shqipe edhe shqiptarët që jetojnë në gjysmën perëndimore të Maqedonisë i bën pjesë e etnisë dhe e kombit shqiptar që jeton në viset e tij në Ballkan. Duke pasur parasysh se shqiptarët në Maqedoni përbëjnë 30% të popullatës së gjithmbarshme të vendit, kjo flet qartë se ata paraqesin shumicë kombëtare shtet-formuese, bashkë me shumicën kombëtare maqedonase.

### **Raportet mes identiteteve gjuhësore dhe identiteteve kombëtare**

Lidhur me raportet mes identiteteve gjuhësore dhe identiteteve kombëtare, Spahiu është shprehur edhe si në vijim:

■ **Shiko në botë fliten mbi 7 mijë gjuhë por janë ma pak se 200 kombe. Gjuha nuk të bën komb. Komb të bën aftësia për ta ngritur shtetin, për të mbajtur shtetin<sup>265</sup>. (min. 10:06 – 10:17)**

■ **Sipas teorisë së Stalinit e trashiguar nga teoria e filozofit gjerman Gotlib Fihte që çdo popull që flet një gjuhë t'veçantë duhet ta ket shtetin e vetë. Kshtu që në planetin tonë ekzistojnë 8-të mijë popuj, 8-të mijë etni që flasin gjuhë të ndryshme, kurse janë veç 193 kombe, kombi kosovar ashtë i 194-ti që po**

<sup>264</sup> Nexhmedin Spahiu në "Oksigjen", pjesa e tretë 23.09.2011: <https://www.youtube.com/watch?v=D673tLZUdIE>

<sup>265</sup> *Shqiptarët me dy kombe, kombi kosovar*; Adi Krasta në "A Show", Nexhmedin Spahiu, *Syri TV*, 16.03.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=n02HRe4sAKc>

## **pret n'rend mu antarsue. Asht i njohur si komb prej 80-të e kusur kombeve të tjera<sup>266</sup>. (min. 7:30 -8:17)**

● Pohimi i Spahiut i cituar më lart, sipas të cilit në botë fliten 7 mijë gjuhë, por ka vetëm 200 kombe, dhe pohimi tjetër, sipas të cilit në botë ekzistojnë 8 mijë etni të ndryshme, por ka vetëm 193 kombe, nuk falsin aspak se gjuha s'të bën komb, ose se gjuha nuk është fare faktor i kombit, siç na thotë Spahiu.

● Në fakt duke ekzistuar në botë 7 mijë gjuhë, kjo tregon se në botë ekzistojnë 7 mijë etni të ndryshme, të cilat i flasin ato gjuhë, dhe të cilat edhe në përputhje me parimet teorive gjermane për kombin, duke qenë etni janë edhe kombe njëkohësisht.

● Tjetër gjë është pyetja pse nga këto 8 mijë etni dhe kombe të ndryshme, vetëm rreth 200 prej tyre kanë arritur të kenë shtetet e tyre? Përgjigjja ime për këtë pyetje është se shumica dërmuese e 7 mijë etnive dhe kombeve të ndryshme, për shkak të rrethanave historiko-politike jo të favorshme për to, nuk kanë arritur të kenë shtetet e tyre, dhe jo domosdoshmërisht pse ato kanë qenë më pak të afta për të bërë shtetet e tyre, në krahasim me ato 200 kombe që kanë arritur t'i bëjnë shtetet e tyre.

● Në fakt, ato 7 mijë gjuhë ekzistuese në botë paraqesin faktorin kryesor pse në botë ekzistojnë 7 mijë etni/kombe pa shtete. Nëse ato 7 mijë etni dhe kombe gjatë rrugëtimit të tyre historik do t'i humbin gjuhët e tyre specifike, duke përdorur gjuhë të përziera, ato nuk do të ishin tjetër, veçse masa njerëzore pa identitet etnik dhe kombëtar njëkohësisht, gjë që tregon se gjuha të bën me komb, sepse është element përcaktues i kombit.

### **Në botë janë shuar rreth 3 mijë etni/kombe**

● Në botë deri më tani janë zhdukur (janë shuar) rreth 3 mijë etni/kombe të ndryshme, pikërisht pse brenda rrethanave të pafavorshme historiko-politike, ato i kanë humbur dhe braktisur paraprakisht gjuhët e tyre të veçanta, nëpërmjet të cilave ato janë shquar si etni/komb të veçanta. Edhe ky fakt, në kundërshtim me

---

<sup>266</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“ - Nexhmendin Spahiu dhe Ervis Iljazaj; *ABC News Albania*, 06.11.2021  
<https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

ato që thotë Spahiu, tregon se gjuha ka të bëjë me etninë/kombin, sepse humbja e saj shoqërohet me humbjen-shuarjen e etnisë/kombit.

● Prandaj nuk thuhet kot se, nëse do ta shuash një komb, atij kombi fillimisht duhet t'ia shuash gjuhën e veçantë që flet, e pastaj zhdukja e tij vjen vetë.

\*\*\*

### **Ka një komb të vetëm arab të ndarë në disa shtete që e flet të njëjtën gjuhë arabe**

Spahiu duke teorizuar lidhur me raportet gjuhë-kombe, ndër të tjera është shprehur edhe si më poshtë:

■ **Me dhjetëra kombe arabe flasin po të njëjtën gjuhë<sup>267</sup>. (min. 10:39 - 10:44)**

● Me pohimin e Spahiut të cituar më lart, sipas të cilit shumë kombe arabe flasin të njëjtën gjuhë arabe, nuk pajtohemi aspak. Kjo, sepse nuk ka shumë kombe e arabe që flasin të njëjtën gjuhë arabe, por ka një komb të vetëm arab që jeton në disa shtete arab, në të cilat e flet të njëjtën gjuhë arabe, gjë flet se se gjuha arabe paraqet element komb-përcaktues për tërë kombin arab, që jeton në shumë shtete të Ligës Arabe.

● Pse Spahiu thotë se disa kombe arabe flasin të njëjtën gjuhë arabe, kur dihet se në këtë botë ka vetëm një komb arab? Për mendimin tim Spahiu thotë se disa kombe arabe flasin të njëjtën gjuhë arabe, për të thënë se edhe gjuhën shqipe e flasin dy kombe: njëri shqiptar në Shqipëri dhe tjetri “kosovar” në Kosovë.

● Por, për ta folur gjuhën shqipe dy kombe, kusht i domosdoshëm do të ishte që kombi shqiptar të jetë vërtetë i ndarë në dy kombe. Por meqë në botë ekziston vetëm një komb shqiptar unik dhe i pandarë, gjuha shqipe nuk ka si të flitet nga dy kombe të ndryshme. Dhe meqë gjuha shqipe flitet vetëm nga kombi unik shqiptar, ajo paraqet element komb-përcaktues vetëm për kombin shqiptar.

---

<sup>267</sup> *Shqiptarët me dy kombe, kombi kosovar*; Adi Krasta në “A Show”, Nexhmedin Spahiu, *Syri TV*, 16.03.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=n02HRe4sAKc>

## **PIKËPAMJET E SPAHIUT LIDHUR ME GJUHËT STANDARDE NË PËRGJITHËSI DHE LIDHUR ME GJUHËN STANDARDE SHQIPE NË VEÇANTI, LËNË SHUMË PËR TË DËSHIRUAR**

Në këtë kapitull dua të sqaroj lexuesit me pikëpamjet e Spahiut ndaj gjuhëve standarde në përgjithësi dhe ndaj gjuhës standarde shqipe në veçanti, të cilat lënë shumë për të dëshiruar.

Siç kemi sqaruar edhe më lart Spahiu të gjitha gjuhët të standardizuara ose jo, nuk i konsideron faktorë përcaktues të kombeve të cilat i flasin ato, edhe pse kur është fjala për kombet monoetnike, gjuhët e tyre standarde paraqesin faktorë përcaktues të këtyre kombeve.

Spahiu kur është fjala për gjuhen standarde shqipe në njërin anë e ngre deri në qiell gjuhën standarde shqipe të vitit 1916, të bazuar kryesisht në dialektin gegë të shqipes, kurse në anën tjetër qorton ekstremisht gjuhen standarde shqipe të vitit 1972, të bazuar kryesisht në dialektin toskë të shqipes.

### **Gjuhët standarde të kombeve multietnike nuk janë gjuhë komb-përcaktuese**

Spahiu duke teorizuar lidhur me raportet mes gjuhëve standarde dhe kombeve, ka shkruar edhe si në vijim:

■ Natyrisht çdo komb e flet në gjuhë standarde, ka një gjuhë

**standarde, por kjo nuk osht ajo përcaktuesja për kombin<sup>268</sup>. (min. 10:50 - 10:55)**

● Pajtohem me pohimin e Spahiut të cituar më lart, se secili komb ka një gjuhë standarde, si dhe pajtohem se gjuhët standarde të kombeve multietnike, për vet faktin se ato fliten nga kombe të ndryshme, si të tilla nuk janë gjuhë standarde komb-përcaktuese, sepse nuk identifikohen me asnjërin nga kombet që i flasin ato.

● Kështu, gjuha standarde angleze nuk është komb-përcaktuese, sepse ajo nuk flitet vetëm nga kombi anglez, por flitet edhe nga kombi australian, kanadez, neozelandez etj. Edhe gjuha standarde spanjolle nuk është gjuhë komb-përcaktuese, sepse ajo nuk flitet vetëm nga kombi spanjoll, por flitet edhe nga kombi argjentinaz, kombi bolivian e kombe të tjera. Edhe shumë gjuhë të tjera standarde nuk janë gjuhë komb-përcaktuese, sepse ato nuk fliten nga një komb i vetëm, por fliten nga dy a më shumë kombe të ndryshme.

### **Gjuhët standarde të kombeve monoetnike janë gjuhë komb-përcaktuese**

● Por gjuhët standarde të kombeve monoetnike për vetë faktin se fliten vetëm nga kombe të caktuara monoetnike dhe nuk fliten nga kombe të tjera, ato si të tilla identifikohen plotësisht me kombet përkatëse që i flasin ato dhe, për rrjedhojë, edhe janë gjuhë standarde komb-përcaktuese.

● Kështu, për vetë faktin se gjuha standarde shqipe flitet vetëm nga kombi shqiptar dhe nuk flitet nga asnjë komb tjetër, kjo tregon se ajo për kombin shqiptar është gjuhë komb-përcaktuese. E njëjta gjë vlen edhe për gjuhët standarde të kombeve të tjera monoetnike, siç janë, p.sh., gjuha standarde hungareze që flitet vetëm nga kombi hungarez, gjuha standarde sllovene, që flitet vetëm nga kombi slloven, gjuha standarde italiane që flitet vetëm nga kombi italian e kështu me radhë. Të gjitha këto gjuhë standarde janë komb-përcaktuese për kombet përkatëse monoetnike prej së cilave fliten.

---

<sup>268</sup> *Shqiptarët me dy kombe - kombi kosovar*, Adi Krasta në "A Show"; Nexhmedin Spahiu, *Syri TV*, 16.03.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=n02HRre4sAKc>

● Shtohet pyetja: *Pse Spahiu duke u bazuar njëanshmërisht në parimet teorive franceze kozmopolite për kombin, gjuhët standarde në mënyrë të përgjithësuar i paraqet gjuhë që nuk janë komb-përcaktuese, edhe pse gjuhët standarde të kombeve monoetnike janë gjuhë standarde komb-përcaktuese?*

● Për mendimin tim, Spahiu thotë në mënyrë të përgjithësuar, se gjuhët standarde nuk janë komb-përcaktuese, për të aluduar se edhe gjuha shqipe nuk është gjuhë komb-përcaktuese. Kjo, sepse po u tha se gjuha standarde shqipe është gjuhë komb-përcaktuese, kjo do të thotë se edhe shqiptarët e Kosovës, për vetë faktin se përdorin gjuhën standarde shqipe, identifikohen me kombin shqiptar dhe jo me “kombin kosovar”, gjë që Spahiut nuk i pëlqen aspak.

### **Dy standarde dialektore të së njëjtës gjuhë shqipe**

Spahiu duke teorizuar lidhur me standardet e gjuhës shqipe të vitit 1916 dhe të vitit 1972, ka shkruar si në vijim:

■ **...Publiku ynë nuk e di që gjuha shqipe nuk osht standardizue vetëm në vitin 1972. Ajo ka qenë e standardizume që nga viti 1916, nga Komisija Letrare e Shkodrës dhe të gjitha qeveritë pasardhëse deri në vitin 1944 e kanë respektuar këtë standard... e kjo ishte e folmja e Elbasanit<sup>269</sup>. (min. 13:25 - 13:59)**

● Është e vërtetë se “Komisia Letrare e Shkodrës”, me në krye Gjergj Fishtën dhe anëtarët e tjerë të saj, si Aleksandër Xhuvani, Sotir Peci, Ndre Mjeda, Gjergj Pekmezi, Hil Mosi dhe të tjerë, në vitin 1916 për herë të parë kanë hartuar gjuhën standarde shqipe, të bazuar kryesisht në dialektin gegë të shqipes, që është folur në qytetin e Elbasanit.

● Por gjuha shqipe është standardizuar edhe nga gjuhëtarë të shumtë të të gjitha trevave shqiptare në Kongresin e Drejtshkrimit të Shqipes, të mbajtur në Tiranë në vitin 1972, duke u bazuar kryesisht në dialektin toskë të shqipes, që thuhet se paraqet të folmen e qytetit të Përmetit.

---

<sup>269</sup> *Shqiptarët me dy kombe - kombi kosovar*, Adi Krasta në “A Show”; Nexhmedin Spahiu, Syri TV, 16.03.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=n02HRr4sAKc>

- Por, të dy këto standarde të gjuhës shqipe kanë njëanshmëritë e tyre dialektore, sepse ka qenë e pamundur të hartohet një gjuhë standarde shqipe, që do të përfshinte në masë të barabartë të dy dialektet kryesore të shqipes.

- Por edhe pse njëanshmëria dialektore e standardeve gjuhësore të viteve 1916 dhe 1972 i bën të dallueshme këto dy standarde në rrafshin dialektor, ato për vetë faktin se kanë leksik dhe shumëçka tjetër të përbashkët, nuk paraqesin dy standarde të dy gjuhëve të ndryshme, por paraqesin dy standarde dialektore të së njëjtës gjuhë shqipe. Dhe kjo është arsyeja pse shqiptarët duhet të respektojnë të dy standardet e gjuhës shqipe, pa marrë parasysh njëanshmëritë e tyre dialektore.

### **Njëanshmëria dialektore e gjuhëve standarde nuk do të duhej të ishte e qortueshme**

- Duke pasur parasysh se edhe gjuhët standarde të popujve të tjerë, nuk kanë mundur të hartohen duke i përfshirë të gjitha dialektet e tyre në masë të barabartë, por janë hartuar duke u bazuar kryesisht në njërin nga dialektet e tyre kryesore, kjo tregon se në parim njëanshmëria dialektore e gjuhëve standarde nuk duhet qortuar.

- Por, duke filluar që nga viti 1990 e këtej në mesin e shqiptarëve në Shqipëri dhe në Kosovë ka pasur zëra të caktuar, të cilët në njërin anë kanë dalë me qortime deri edhe ekstreme ndaj njëanshmërisë dialektore të standardit gjuhësor të vitit 1972, të bazuar në dialektin toskë të shqipes, kurse në anën tjetër kanë dalë me lavdërime ekstreme ndaj standardit gjuhësor të vitit 1916, të bazuar kryesisht në dialektin gegë të shqipes.

### **Qortueshmëria e njëanshme ndaj njërit apo tjetrit standard gjuhësor është e dëmshme**

- Nëse në Shqipëri dhe në Kosovë ka njerëz që duan patjetër ta qortojnë njëanshmërinë dialektore të standardeve gjuhësore, ata do të duhej të qortonin jo vetëm njëanshmërinë dialektore të standardit gjuhësor të vitit 1972, por do të duhej të qortonin edhe njëanshmërinë dialektore të standardit gjuhësor të vitit 1916.

- Qortueshmëria e njëanshme e njërit nga dy standardet gjuhësore

të gjuhës shqipe nuk ishte dashur të ndodhte, sepse ajo si e tillë mund të krijojë deri edhe paragjykime negative mes shqiptarëve, që në përditshmëri flasin kryesisht në dialektin toskë të shqipes, dhe të shqiptarëve që në përditshmëri flasin kryesisht dialektin gegë të shqipes.

● Në Kosovë ata që e kanë qortuar njëanshmërisht standardin e gjuhës shqipe të vitit 1972, të bazuar kryesisht në dialektin toskë të shqipes, kanë qenë N. Spahiu, H. Matoshi, M. Kelmendi, B. Meta, duke kërkuar që asaj t'i bëhen korrigjime, përmirësime dhe ndryshime të thella, të cilat do të rezultonin me krijimin e një gjuhë standarde shqipe të bazuar kryesisht në dialektin gegë të shqipes, siç ka qenë rasti me standardin e gjuhës shqipe të vitit 1916.

● Por, duke pasur parasysh se standardit të gjuhës shqipe të vitit 1916 i mungojnë elemente të caktuara të dialektit toskë të shqipes, kurse standardit të gjuhës shqipe të vitit 1972 i mungojnë elemente të caktuara të dialektit gegë të shqipes, del e qartë se këto dy standarde të gjuhës shqipe janë njësoj të mira dhe njësoj jo të mira, dhe nuk mbetet vend për anësim ndaj njërit apo ndaj tjetrit standard.

● Dhe duke pasur parasysh se këto dy standarde të gjuhës shqipe janë njësoj të mira dhe njësoj jo të mira, për mua heqja nga përdorimi i standardit gjuhësor të vitit 1972 që kemi në përdorim, dhe zëvendësimi i tij me standardin gjuhësor të vitit 1916, nuk paraqet zgjidhje racionale, sepse sërish kemi të bëjmë me një gjuhë standarde me njëanshmëri dialektore, siç është edhe gjuha standarde aktuale.

● Për mendimin tim, zgjidhja më e mirë dhe më racionale do të ishte përdorimi i mëtejshëm i gjuhës standarde aktuale shqipe, të bazuar kryesisht në dialektin toskë, duke i shtuar asaj sa më shumë elemente të dialektit gegë të shqipes, të cilat nuk ia prishin strukturën bazë.

### **Gjuha standarde e vitit 1972 nuk u është imponuar arteve në masë të madhe**

Spahiu duke e qortuar ekstremisht standardin gjuhësor të vitit 1972, është shprehur si në vijim:

■ Për dallim prej standardit të vitit 1972, standardi i gjuhës shqipe që përdorej nga e 16-ta deri në 45-ën, ishte një standard që përdorej në administratë, në gjykata, në prokurori, në ushtri, në polici, .... që nuk u imponue në romane, në poezi, në këngë, në muzikë, në dramë, në ndërkohë që në vitin 1972 u bo ni krim ndaj gjuhës shqipe përgjithësisht, për shkak se gjuha shqipe në vend që të avanconte ma parë, përpara, ajo u varfërua. ... Por, imagjinoni për shembull kur drama bahet me subjekt në Tetovë, ku ka ni dialekt shumë interesant, shumë të bukur të t ‘folmes shqipe, dhe kur inskenohet ajo në të folmen, ta zam në të folmen në dialektin e Përmetit. Kjo absolutisht e damton atë dramë, nuk oshtë ajo nuk fare një dramë<sup>270</sup>. (min. 13.59 -15:23)

● Sa i përket thënies së Spahiut të cituar më lart, sipas të cilës standardi i gjuhës shqipe i vitit 1972 u është imponuar arteve: letërsisë, muzikës, dramës, këngëve e të tjera, është e vërtetë se ky standard në njëfarë mase u është imponuar artëve, por jo në masë të madhe, siç thonë disa nga kritikuesit ekstremë të standardit gjuhësor të vitit 1972. Unë dhe shumë moshatar të mi jemi dëshmitarë se, derisa Shqipëria ka qenë një vend socialist/komunist, në televizionin shtetëror të Tiranës, në Radio-Tirana dhe në Radio-Kukësi janë dhënë filma, drama, këngë dhe recitale, sipas rastit, në dialektin toskë dhe, sipas rastit, në dialektin gegë të shqipes.

● Nga ana tjetër, jo vetëm gjuha standarde shqipe, por edhe gjuhët standarde të popujve të tjerë u janë imponuar dhe u imponohen artëve në masë të caktuar. Duke jetuar për tri dekada me radhë në një vend gjermano-folës, siç është Zvicra, e di se as në Zvicër, as në Gjermani e as në Austri nuk botohen as romane e as drama të shkruara në ndonjë dialekt të gjermanishtes, por shkruhen e botohen romane dhe drama në gjuhën standarde gjermane. Dhe e njëjta gjë vlen edhe për librat shkollorë, për gjuhën e gazetave, për gjuhën e televizioneve dhe të radiove, dhe për gjuhën e filmave e

---

<sup>270</sup> *Shqiptarët me dy kombe - kombi kosovar*, Adi Krasta në "A Show"; Nexhmedin Spahiu, *Syri TV*, 16.03.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=n02HRe4sAKc>

të dramave, që në këto vende transmetohen në gjuhën standarde gjermane.

● E vetmja gjë që në arte thuhet jashtë gjuhës standarde gjermane, janë vetëm disa thënie dialektore tipike për vendet dhe krahinat e ndryshme gjermano-folëse, në të cilat zhvillohen ngjarjet e paraqitura. Kështu, gjuha standarde gjermane u është imponuar arteve diçka më shumë se gjuha standarde shqipe.

● Se standardi i vitit 1972 në Shqipëri nuk u është imponuar arteve në masë të madhe, siç na thotë Spahiut, për këtë flet edhe përgjigjja që z. Spahiu i ka dhënë moderatorit i një televizionit nga Shqipëria, z. Adi Krasta, ndërsa ai po e intervistonte Spahhiun. Moderatorit Krasta është shprehur si më poshtë:

■ **... Për hir të vërtetës... ne kemi pasur trupa teatrore brenda Shqipërisë. Shqipëria ka një diversitet, ka një ndryshueshmëri shumë të jashtëzakonshme dhe shumë të gjallë brenda vetes, nuk ka nevojë ta kërkojë këtë në zonat jashtë saj... Këtu trupat teatrore kanë folur shkodranisht, në dialektin e Korçës, kanë folur si në Gjirokastrë, si në Vlorë etj.**<sup>271</sup> (min. 15:29 - 15:52)

● Pohimi i mësipërm i moderatorit Krasta flet qartë se Spahiu ndaj gjuhës standarde shqipe të vitit 1972, të bazuar kryesisht në dialektin toskë të shqipes ka paragjykime të theksuara negative, kurse ndaj gjuhës standarde shqipe të vitit 1916, të bazuar kryesisht në dialektin gegë të shqipes, ka paragjykime të theksuara pozitive, të cilat nuk i bëjnë mirë gjuhës shqipe.

**Standardi i vitit 1916 dhe ai vitit 1972 kanë qenë përpjekje fisnike të gjuhëtarëve shqiptarë të dy kohëve të ndryshme** Spahiu duke qenë i pakënaqur me gjuhën standarde shqipe të vitit 1972, në thënien e tij të cituar më lart është shprehur si në vijim:

■ **“...në vitin 1972 u bo një krim ndaj gjuhës shqipe përgjithësisht, për shkakun që gjuha shqipe në vend që të avanconte përpara ajo u varfërua”**<sup>272</sup>.

<sup>271</sup> Shqiptarët me dy kombe - kombi kosovar, Adi Krasta në “A Show”; Nexhmedin Spahiu, Syri TV, 16.03.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=n02HRe4sAKc>

<sup>272</sup> Shqiptarët me dy kombe - kombi kosovar, Adi Krasta në “A Show”; Nexhmedin Spahiu, Syri TV, 16.03.2021: <https://m.facebook.com/syrimedia/videos/>

● Lidhur me pohimin e Spahiut të cituar edhe më lart, do të thosha se, nëse me rastin e standardizimit të gjuhës shqipe në vitin 1972, ndaj gjuhës shqipe qenka bërë krim sepse ajo në vend të avancimit qenka varfëruar (ngase është hartuar kryesisht mbi bazën e dialektit toskë), kjo flet se ndaj gjuhës shqipe edhe me rastin e standardizimit të saj në vitin 1916, na qenka bërë krim sepse ajo edhe këtë rast në vend të avancimit qenka varfëruar (ngase është hartuar kryesisht mbi bazën e dialektit gegë të shqipes).

● Por as standardizimi i gjuhës shqipe i vitit 1916 dhe as standardizimi i gjuhës shqipe i vitit 1972 nuk kanë qenë një krim ndaj gjuhës shqipe, siç thotë Spahiu për standardin e vitit 1972. Përkundrazi, ato edhe përkundër njëanshmërive dialektore, kanë qenë dy përpjekje fisnike të gjuhëtarëve shqiptarë të dy kohëve të ndryshme, për standardizimin e gjuhës shqipe sipas shembujve të standardizimit të gjuhëve të tjera në Ballkan dhe Europë.

● Spahiu pasi e lavdëron standardin e gjuhës shqipe të vitit 1916, dhe e pasi e qorton standardin gjuhësor të vitit 1972, ai shprehet për krijimin e një standardi gjuhësor të vetëm, për të gjithë shqiptarët në Ballkan. Lidhur me këtë ai është shprehur si vijon:

■ **Por një standard duhet t’krijohet, n’mos gjuha e Elbasnit e Shkodrës, në mos e Shkodrës e Përmetit. Osh bërë tani çfarë është bërë. Për mendimin tem osh shumë e keqe që standardi ka ndryshuar nga ai vitit 1916, se ka qenë shumë e natyrshme e logjikshme që e folmja e Elbasnit si mei i Shqiprisë t’jetë më i kapshëm për të gjithë shqiptarët**<sup>273</sup>. (54:38: 55:03)

**Pse duhet përdorur edhe më tej gjuha standarde e vitit 1972, duke i shtuar asaj elemente të dialektit gegë të shqipes**

● Duke pasur parasysh se gjuha standarde shqipe aktuale e bazuar kryesisht në dialektin toskë të shqipes, tani ka më shumë se gjysmë shekulli që është në përdorim dhe, për rrjedhojë, përdorimi i saj në masë të madhe është rutinizuar nga të gjithë shqiptarët, mendoj

---

nexhmedin-spahiu-shqiptarët-me-dy-kombe-kombi-kosovar-dhe-kombi-shqiptar/3949363651787984/?depth=2

<sup>273</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“ - Nexhmedin Spahiu dhe Ervis Iljazaj; *ABC News Albania*, 06.11.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

se varianti më i mirë do të ishte përdorimi i mëtejshëm i gjuhës standarde shqipe aktuale, duke i shtuar asaj elemente të caktuara të dialektit gegë, të cilat nuk e prishin strukturën bazë të saj. Krejt kjo me qëllim që gjuha standarde aktuale të bëhet sa më e kapshme për shumicën e shqiptarëve, dhe jo të të hartohet e të përdoret një gjuhë e dytë standarde e bazuar kryesisht në dialektin gegë, e cila po ashtu do të vuante nga njëanshmëria dialektore, si edhe gjuha standarde që kemi.

● Nga ana tjetër, edhe për vetë faktin se tanimë në gjuhën standarde shqipe që kemi në përdorim janë arsimuar miliona shqiptarë, janë botuar me qindra mijëra libra shkencorë e artistikë, janë hartuar fjalorë të fushave të ndryshme, si dhe për vetë faktin se ajo ka gjetur përdorim të gjerë edhe në institucione shtetërore dhe në administratë, të gjitha këto po ashtu flasin se varianti më i mirë do të ishte përdorimi i mëtejshëm i gjuhës standarde shqipe aktuale, duke i shtuar asaj elemente të caktuara të dialektit gegë, se sa të krijohet nga e para një gjuhë e dytë standarde e bazuar kryesisht në dialektin gegë, që sërish do të ishte një gjuhë standarde me njëanshmëri dialektore.

● Varianti më i keq do të ishte nëse shqiptarët si komb do të bëhen me dy gjuhë standarde: njëra e bazuar kryesisht në dialektin toskë, siç është rasti me gjuhën standarde shqipe aktuale, dhe tjetra e bazuar i bazuar kryesisht në dialektin gegë të shqipes, me ç'rast përdorimi i dy standardeve gjuhësore me kalimin e kohëve, do të mund të çonte në ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe: jo në planin shqiptar-kosovar, por në planin gegë-toskë.



# **PJESA E DHJETË**

## **PËRDORIMI I FLAMURIT SHETËROR TË KOSOVËS DHE PËRDORIMI I FLAMUJVE KOMBËTARË NË RAPORT ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit lidhur me legjislacionin e Kosovës, që përcakton rregullat e përdorimit të simboleve shtetërore të Kosovës dhe të simboleve kombëtare të komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Në legjislacionin e Kosovës është sanksionuar si ligji për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës, ashtu edhe ligji për përdorimin e flamujve kombëtarë.

### **Ligji për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës**

Më poshtë jepen nenet e ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore:

#### **Neni 2.1**

Në **nenin 2.1** të ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës thuhet:

■ **Simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës janë: flamuri, stema dhe himni**<sup>274</sup>.

---

<sup>274</sup> Ligji për përdorimin e simboleve shtetërore:  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2517>

● Ky nen vërteton se flamuri, stema dhe himni i Kosovës janë simbole të shtetit të Kosovës, dhe nuk janë simbole kombëtare të Kosovës apo të “kombit kosovar”, siç përpiqet t’i paraqes ato Spahiu, Matoshi e ndonjë tjetër.

## Neni 2.2

● Në nenin 2.2 të ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës thuhet:

■ **Me flamurin, stemën dhe himnin përfaqësohet Republika e Kosovës dhe identiteti shtetëror i saj**<sup>275</sup>.

● Ky nen tregon qartë se me flamurin, stemën dhe himnin e Kosovës përfaqësohet Republika e Kosovës dhe identiteti shtetëror i saj, dhe nuk përfaqësohet identiteti i “kombit kosovar” edhe ashtu joekzistues, siç përpiqet të na bind Spahiu, Matoshi dhe ndonjë tjetër

## Neni 4.1

Në nenin 4.1 të ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës thuhet:

■ **Flamuri shtetëror vendoset në mjediset e brendshme dhe të jashtme të institucioneve shtetërore dhe publike. Për përdorimin e flamurit shtetëror në mjediset e brendshme dhe të jashtme të institucioneve publike, Qeveria e Republikës së Kosovës mund të nxjerrë akte nënligjore**<sup>276</sup>.

● Ky nen tregon qartë se flamuri shtetëror i Kosovës vendoset në mjediset e brendshme dhe të jashtme të institucioneve shtetërore dhe publike të Kosovës, gjë që në Kosovë është zbatuar e zbatohet në plotni. Por në këtë nen nuk thuhet se në institucionet shtetërore dhe publike të Kosovës, nuk mund të vendoset krahas flamurit shtetëror të Kosovës edhe ndonjë flamur tjetër, ta zëmë flamuri kombëtar shqiptar, ngase komuniteti kombëtar shqiptar paraqet komunitetin shumicë në Kosovë.

<sup>275</sup> Ligji për përdorimin e simboleve shtetërore <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2517>

<sup>276</sup> Ligji për përdorimin e simboleve shtetërore <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2517>

● Për mendimin tim, **neni 4.1** për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës, do të duhej plotësuar si në vijim:

■ **Flamuri shtetëror vendoset në mjediset e brendshme dhe të jashtme të institucioneve shtetërore dhe publike të Kosovës, por duke pasur parasysh se shqiptarët paraqesin komunitetin shumicë në Kosovë, në mjediset e brendshme dhe të jashtme të institucioneve shtetërore dhe publike të Kosovës, krahas flamurit shtetëror mund të vendoset edhe flamuri kombëtar shqiptar**

### Neni 4.3

*Në nenin 4.3 të ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës thuhet:*

■ **Flamuri shtetëror i Republikës së Kosovë përdoret në rastet e takimeve ceremoniale të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore me përfaqësues të shteteve të huaja<sup>277</sup>.**

● Ky nen tregon qartë se duke qene flamuri i Kosovës flamur shtetëror i Kosovës, ai përdoret në rastet e takimeve ceremoniale të përfaqësuesve të Kosovës, me përfaqësues të shteteve të huaja. Ky nen i ligjit për përdorimin e flamurit shtetëror në Kosovë është zbatuar dhe zbatohet në plotni.

### Neni 5

*Në nenin 5 të ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës thuhet:*

■ **Çdo qytetar i Republikës së Kosovës ka të drejtë ta përdorë flamurin shtetëror të Republikës së Kosovës (më tej në tekst: flamurin shtetëror) në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi<sup>278</sup>.**

● Ky nen tregon se çdo qytetar i Republikës së Kosovës ka të drejtë ta përdorë flamurin shtetëror të Republikës së Kosovës në pajtim me ligjin. Në Kosovë askush nuk e konteston përdorimin e flamurit shtetëror të Kosovës nga qytetarët e Kosovës në pajtim me këtë ligj.

---

<sup>277</sup> Ligji për përdorimin e simboleve shtetërore  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2517>

<sup>278</sup> Ligji për përdorimin e simboleve shtetërore  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2517>

● Edhe pse në të gjitha nenet e cituara më lart të ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës thuhet tekstualisht se flamuri, stema dhe himni i Kosovës janë simbole shtetërore të Republikës së Kosovës, megjithatë Spahiu, Matoshi dhe B. Meta, duke u sjellë si ata që godasin murin me kokë, nuk ndalen duke na thënë se flamuri, stema dhe himni i Kosovës, janë simbole kombëtare të Kosovës, përkatësisht se janë simbole të “kombit kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues.

### **Ligji për përdorimin e flamujve kombëtarë në Kosovë**

Më poshtë jepen nenet e ligjit për përdorimin e simboleve kombëtare të komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

#### **Neni 6.1**

Në **nenin 6.1** të ligjit për përdorimin e flamujve kombëtarë në Kosovë thuhet:

■ **Çdo qytetar i Republikës së Kosovës ka të drejtë të përdorë flamujt kombëtarë në pajtim me këtë ligj dhe me legjislacionin tjetër në fuqi<sup>279</sup>.**

● Ky nen thotë qartë se në Kosovë çdo qytetar ka të drejtë që ta përdorë flamurin e tij kombëtar, gjë që tregon se kushdo që bën thirrje për mospërdorimin e flamujve kombëtarë në Kosovë, (siç bën thirrje Spahiu për mospërdorimin e flamurit kombëtar shqiptar nga shqiptarët), ai vjen në kundërshtim flagrant me nenin 6.1 të ligjit për përdorimin e flamujve kombëtarë në Kosovë.

#### **Neni 6.2**

Në **nenin 6.2** të ligjit për përdorimin e flamujve kombëtarë në Kosovë thuhet:

■ **Qytetarët e të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës kanë të drejtën, në mënyrë individuale apo si komunitet, të përdorin flamujt kombëtarë në pajtim me këtë ligj dhe me standardet ndërkombëtare<sup>280</sup>.**

---

<sup>279</sup> Ligji për përdorimin e simboleve shtetërore  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2517>

<sup>280</sup> Ligji për përdorimin e simboleve shtetërore

● Ky nen tregon qartë se në Kosovë qytetarët e kanë të drejtën e përdorimit të flamujve kombëtarë qoftë si individ, qoftë si komunitet, gjë që tregon sërish se kushdo që bën thirrje për mospërdorimin e flamujve kombëtarë në Kosovë, vjen në kundërshtim flagrant edhe me nenin 6.2 të ligjit për përdorimin e flamujve kombëtarë në Kosovë.

### Neni 6.3

Në nenin 6.3 të ligjit për përdorimin e flamujve kombëtarë në Kosovë thuhet:

■ **Për mënyrën e përdorimit të flamujve kombëtarë në mjedise të brendshme dhe të jashtme në institucionet publike, Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr akte përkatëse nënligjore<sup>281</sup>.**

● Ky nen tregon se Qeveria e Republikës së Kosovës e ka të drejtën e nxjerrjes së akteve përkatëse nënligjore, për përdorimin e flamujve kombëtarë në mjedise të brendshme dhe të jashtme të institucioneve.

● Duke pasur parasysh se në nenet 6.1, 6.2 dhe nenin 6.3 të ligjit për përdorimin e flamujve kombëtarë, flitet për përdorimin e flamujve kombëtarë të të gjitha komuniteteve kombëtare në Kosovë, kjo tregon qartë se flamuri i Kosovës nuk është flamur kombëtar i Kosovës, në kuptimin e flamurit të “kombit kosovar”, siç na thotë Spahiu, por është flamur shtetëror i Kosovës.

● Por Spahiu duke u sjellë si ai që i bie murit me kokë, assesi nuk bindet se flamuri i Kosovës paraqet flamurin shtetëror të Kosovës, dhe nuk paraqet flamurin kombëtar të “kombit kosovar”, edhe ashtu joekzistues.

**Në Kosovë festohet “Dita e shqiptarëve”, “Dita e serbëve”,  
“Dita e turqve”; “Dita e myslimanëve”,  
“Dita e boshnjakëve”, “Dita e romëve” etj.**

● Qeveria e Republikës së Kosovës nëpërmjet akteve përkatëse nënligjore ka caktuar ditët (datat) kur komunitetet kombëtare të

---

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2517>

<sup>281</sup> Ligji për përdorimin e simboleve shtetërore:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2517>

Kosovës i festojnë ditët e tyre kombëtare, duke vendosur flamujt e tyre kombëtarë në vende publike. Kështu në “Ditën e shqiptarëve”, që është dita e 28 Nëntorit, kur në vitin 1912 është ngritur flamuri kombëtar shqiptar në Vlorë, në vendet publike ngrihet flamuri kombëtar shqiptar. Në “Ditën e serbëve” në vendet publike ku jetojnë serbët ngrihet flamuri kombëtar serb, e kështu me radhë në ditë të caktuara në vende publike ngrihen edhe flamujt kombëtarë të komuniteteve tjera. Prandaj kushdo që bën thirrje për mospërdorimin e flamujve kombëtarë në Kosovë (siç bën thirrje Spahiu për mospërdorimin e flamurit kombëtar shqiptar nga shqiptarët), ai vjen në kundërshtim flagrant me të drejtën e komuniteteve të Kosovës, për t’i ngritur ata flamujt kombëtarë në vende publike.

● Për mendimin tim, shprehjet “Dita e shqiptarëve”, “Dita e serbëve”, “Dita e turqve”, “Dita e boshnjakëve”, “Dita e romëve” etj., duhet të zëvendësohen me shprehjet: “Dita ose Festa kombëtare e shqiptarëve”, “Dita ose Festa kombëtare e serbëve”, “Dita ose Festa kombëtare e turqve”, “Dita ose Festa kombëtare e boshnjakëve”, “Dita ose Festa kombëtare e romëve” etj.

● Vetë fakti i ngritjes së flamujve kombëtarë të komuniteteve që jetojnë në Kosovë në ditët e caktuara të tyre, flet qartë se flamujt kombëtarë në Kosovë janë flamujt kombëtarë të komuniteteve të ndryshme, kurse flamuri i Kosovës me hartën e Kosovës me ngjyrë të verdhë në sfondin e kaltër, paraqet flamurin shtetëror i Kosovës dhe jo flamurin kombëtar të “kombit kosovar”, siç na thotë Spahiu,

### **Legjislacioni i Kosovës e lejon si përdorimin e simboleve shtetërore, ashtu edhe përdorimin e simboleve kombëtare**

● Ajo që ka rëndësi është se ligji për përdorimin e simboleve shtetërore dhe ligji për përdorimin e flamujve kombëtarë, qytetarëve të Kosovës ua mundëson si përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës, ashtu edhe përdorimin e simboleve kombëtare ( flamujve kombëtarë) të tyre.

● Dhe kjo tregon se kushdo që i kundërvihet përdorimit të simboleve shtetërore apo përdorimit të flamujve kombëtarë në Kosovë, vjen në kundërshtim me ligjin për përdorimin e simboleve

shtetërore dhe me ligjin për përdorimin e simboleve kombëtare në Kosovë. Dhe kushdo që vjen në kundërshtim me këto ligje të dalë nga Kushtetuta e Kosovës, bën vepër të dënueshme antikushtetuese.

● Kështu, nenet e ligjeve të shqyrtuara më lart flasin se Spahiu, Matoshi apo ndonjë tjetër, duhet ta ndalin propagandën e tyre destruktive për mospërdorimin e flamurit kombëtar shqiptar nga shqiptarët e Kosovës, sepse vijnë në konflikt me ligjet e lartpërmendura.

---

## KEQINTERPRETIMET E SPAHIUT BËRË SIMBOLEVE SHTETËRORE TË KOSOVËS, PËR T'I PARAQITUR ATO SI SIMBOLE KOMBËTARE TË KOSOVËS

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit lidhur me keqinterpretimet që Nexhmedin Spahiu u bën simboleve shtetërore të Kosovës, duke i propaganduar ato si simbole kombëtare të Kosovës, në kuptimin e simboleve të “kombit kosovar”, realisht joekzistues.

■ **Flamuri i Kosovës me hartën e Kosovës në sfondin e kaltër, himni i Kosovës si muzikë dhe pa fjalë dhe stema e Kosovës me hartën e Kosovës në mes, siç thuhet edhe në nenin 2.1 të ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës, të cituar në kapitullin pararendës, paraqesin tri simbolet shtetërore të Kosovës, që do të thotë se ato nuk paraqesin simbolet kombëtare të asnjë komuniteti në Kosovë.**

Por Spahiu, për na bindur se simbolet shtetërore të Kosovës të përmendura më lart, janë simbole kombëtare të Kosovës (në kuptimin e simboleve të “kombit kosovar”), e keqinterpreteton si Planin/Dokumentin e Ahtisarit, ashtu edhe Kushtetutën e Kosovës, manipulime dhe spekulime këto që i kemi shqyrtuar edhe në kapitujt 4, 5, 6 dhe 7 të këtij libri.

Më poshtë bëhen sqarime të caktuara shtesë, të cilat flasin qartë se simbolet e Kosovës (flamuri, stema dhe himni), janë simbole të shtetit të Kosovës dhe nuk janë simbole kombëtare të Kosovës,

përkatësisht nuk janë simbole kombëtare të “kombit kosovar”, siç dëshiron t’i paraqes Spahiu.

### **Plani/Dokumenti i Ahtisarit simbolet e Kosovës i nënkupton si simbole të shtetit të Kosovës**

\*Spahiu në disa debate televizive është shprehur kundër përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar nga ana e shqiptarëve të Kosovës, ndër të tjera edhe duke u thirrur në pikën 1.7 të Dokumentit të Ahtisarit, në sajë të të cilit Kosova ka shpallur pavarësinë e saj në vitin 2008.

**Në pikën 1.7 të Dokumentit të Ahtisarit thuhet si në vijim:  
Kosova do të ketë simbolet e veta të veçanta kombëtare, përfshirë flamurin, stemën dhe himnin, të cilët pasqyrojnë karakterin e saj multi-etnik<sup>282</sup>.**

● Është e vërtetë se në Dokumentin e Ahtisarit simbolet që Bashkësia Ndërkombëtare ia ka dhënë Kosovës me rastin e pavarësisht të saj, janë cilësuar si simbole kombëtare të Kosovës, por po ashtu është e vërtetë se ato simbole po në pikën 1.7 të dokumentit të Ahtisarit janë simbole që pasqyrojnë karakterin multi-etnik të Kosovës, gjë që tregon se ato simbole nuk i përkasin asnjë etnie/kombi të veçantë, por u përkasin pjesëtarëve të të gjitha etnive të ndryshme të Kosovës, duke e pasqyruar kështu ato karakterin multi-etnik të shtetit të Kosovës, dhe kjo tregon se ato simbole janë thjesht simbole të shtetit të Kosovës.

● Shtrohet pyetja: *Nëse simbolet e Kosovës janë simbole të shtetit të Kosovës, atëherë pse ato në pikën 1.7 të Dokumentit të Ahtisarit quhen simbole kombëtare të Kosovës?* Simbolet e shtetit të Kosovës në Dokumentin e Ahtisarit quhen simbole kombëtare të Kosovës, sepse Dokumenti i Ahtisarit është shkruar në gjuhën angleze, ku fjala “komb” (“nation”), siç kemi sqaruar edhe në shumë kapituj të tjerë të këtij libri, nuk ka vetëm kuptimin e kombit, por e ka edhe kuptimin e shtetit. Se cilin kuptim merr fjala “nation”, atë të kombit apo atë të shtetit, kjo varet nga natyra e çështjes që trajtohet.

---

<sup>282</sup> Nexhmedin Spahiu: *Kushtetuta e definon kombin kosovar - të tillë e njohu Kosovën edhe SHBA-ja, Balkan.Info*; 20 nëntor 2019: <https://klankosova.tv/nexhmedin-spahiu-kushtetuta-e-definon-kombin-kosovar-te-tille-e-njohu-kosoven-edhe-shba/>

● Duke pasur parasysh se në Kosovë në vitin 2008 ka ndodhur pavarësimi i Kosovës, por nuk ka ndodhur krijimi i “kombit kosovar”, kjo flet qartë se shprehja “simbolet kombëtare të Kosovës” në Dokumentin e Ahtisarit, nuk ka pasur dhe nuk ka të bëjë aspak me simbolet kombëtare të ndonjë kombi, ta zëmë “kosovar”, siç do të donte Spahiu, por ka pasur dhe ka të bëjë me simbolet shtetërore të Kosovës, të vlefshme për të gjitha etnitë që jetojnë në Kosovë, duke pasqyruar ato kësisoj karakterin multietnik të shtetit të Kosovës.

### **Ligjet për përdorimin e simboleve shtetërore dhe kombëtare**

● Se flamuri, stema dhe himni i Kosovës nuk paraqesin simbole kombëtare të Kosovës, siç na thotë Spahiu, por paraqesin simbole të shtetit të Kosovës, flasin qartë nenet e ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore dhe nenet e ligjit për përdorimin e flamujve kombëtarë në Kosovë. Por, meqë nenet e ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore dhe nenet e ligjit për përdorimin e flamujve kombëtarë i kemi cituar më lart në kapitullin pararendës të librit, nuk e shoh të arsyeshme që ato t'i citoj edhe në këtë kapitull. Lexuesit e interesuar mund t'i lexojnë ato në kapitullin pararendës.

● Është e rëndësishme se nenet e këtyre ligjeve bëjnë dallimin e qartë mes simboleve shtetërore të Kosovës (flamurit, himnit dhe stemës së Kosovës), dhe flamujve kombëtarë të komuniteteve që jetojnë në Kosovë, siç është edhe flamuri kombëtar shqiptar dhe flamujt e komuniteteve pakicë.

### **Përdorimi i flamurit kombëtar shqiptar dhe përdorimi i flamujve kombëtarë të komuniteteve pakicë dëshmon karakterin multietnik të shtetit të Kosovës**

Spahiu duke qenë kundër përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar nga shqiptarët e Kosovës, është shprehur edhe më tej si në vijim:

■ **Dikush më pyet çka ka t'keqe nëse ai flamur shqiptar është në hapësirat publike, institucionet tona? Nuk ka t'keqe, nuk osht ai flamur që na poshtëron neve, por tregon që na akoma nuk po ia dim randsinë shtetit të Kosovës, nuk po e vlerësojmë**

**atë sa duhet, po i bojm rivalitet, dhe kjo tregon një joseriozitet tonin pra gjithë atyre miqve ton, të cilët na kanë ndihmue mu bo shtet<sup>283</sup>. (29:07 - 29:35)**

● Në kundërshtim me thënien e Spahiut të cituar më lart, vendosja e flamurit kombëtar shqiptar në hapësira publike dhe në institucione të Kosovës nuk paraqet aspak ndonjë rivalitet ndaj shtetit të Kosovës, por paraqet një realitet faktik sa bjeshka, i cili tregon se brenda shtetit të Kosovës jeton kombi shumicë shqiptar, që bashkë me komunitetet e tjera pakicë i japin Kosovës karakterin e shtetit multietnik, të cekur si në Dokumentin e Ahtisarit, ashtu si edhe në Kushtetutën e Kosovës.

● Edhe vendosja në ditë të caktuara të flamujve kombëtarë të komuniteteve pakicë në hapësira publike të përmendura në kapitullin pararendës, po ashtu nuk paraqet aspak ndonjë rivalitet ndaj shtetit të Kosovës, por tregon se në shtetin e Kosovës bashkë me komunitetin (kombin) shumicë shqiptar, jetojnë edhe disa komunitete pakicë, që së bashku i japin Kosovës karakterin e shtetit multietnik, të cekur si në Dokumentin e Ahtisarit, ashtu edhe Kushtetutën e Kosovës.

● Nuk pajtohem aspak me Spahiun, se përdorimi në Kosovë i flamurit kombëtar shqiptar tregon se shqiptarët nuk ia dinë rëndësinë shtetit të Kosovës, dhe se kësisoj ata tregojnë një joseriozitet ndaj miqve perëndimorë, të cilët Kosovën e kanë bërë shtet. Përkundrazi përdorimi i flamurit kombëtar shqiptar dhe përdorimi i flamujve kombëtarë të komuniteteve pakicë në Kosovë, tregon se në shtetin e Kosovës jetojnë të barabartë mes tyre, komuniteti shumicë shqiptar dhe komunitetet e tjera pakicë, të cilat së bashku shtetit të Kosovës i japin karakter multietnik.

● Miqtë tanë që kanë dhënë ndihmën madhore për çlirimin dhe shtetbërjen e Kosovës nuk kanë pse të indinjohen apo zhgënjehen, pse shqiptarët e Kosovës duke qenë shqiptarë, e duan dhe e përdorin flamurin e tyre kombëtar. Miqtë tanë e kanë ditur me kohë se po e ndihmonin çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës, si

---

<sup>283</sup> Nexhmedin Spahiu në "Oksigjen", pjesa e parë, 13.11.21: <https://www.youtube.com/watch?v=gmCJhoFX-Ps>

një vend i banuar me shumicë kombëtare shqiptare dhe me disa komunitete pakicë.

● Por Spahiu jo rastësisht i zë në gojë miqtë tanë ndërkombëtarë. Ai e bën këtë për t'i trembur shqiptarët e Kosovës, se po përdorën flamurin kombëtar shqiptar, miqtë tanë ndërkombëtarë do të inatosen me ta, gjë që nuk qëndron aspak.

● Përdorimi i flamurit kombëtar shqiptar nga shqiptarët e Kosovës jo vetëm që nuk e pengon aspak të ardhmen e Kosovës, por edhe e fuqizon atë. Ai tregon se edhe shteti i Kosovës, si edhe shumica e shteteve të botës ka brenda vetes si kombin shumicë shqiptar, ashtu edhe komunitetet pakicë, një realitet faktik ky, i cili nuk ka asnjë arsye që të fshihet para askujt.

● Flamuri shtetëror i Kosovës ka në mes hartën e Kosovës, domethënë ka integritetin territorial të Kosovës. Flamuri kombëtar shqiptar është flamuri kombëtar i të gjithë shqiptarëve në botë, përfshi edhe shqiptarët e Kosovës. Shtrohet pyetja: *Çfarë të keqe dhe çfarë rivaliteti ka mes këtyre dy flamujve?* Nuk ka asnjë të keqe dhe asnjë rivalitet në mesin e këtyre famujve. Rivalitet mes këtyre dy flamujve ka vetëm në kokën e Spahiut.

● Për vetë faktin se SHBA-ja, vendet e fuqishme të Europës dhe NATO-ja, në vitin 1999 i kanë shpëtuar shqiptarët e Kosovës nga gjenocidi serb, duke e ditur mirë se ata kanë qenë me përkatësi kombëtare shqiptare, kjo tregon qartë se SHBA-ja vendet e Fuqishme të Europës dhe NATO-ja nuk zhgënjehen aspak nëse në vende publike në Kosovë shohin flamurin kombëtar shqiptar. Vërtet, ku e ka bazën kjo shqiptarofobi kaq e shprehur te Spahiu, Matoshi e ndonjë tjetër?!

### **Ndalimi i përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar në një Kosovë të lirë as që mund të imagjinohet**

● Përdorimi i flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë ka qenë i ndaluar nga ish-Jugosllavia Federative e Titos brenda viteve 1945-1968, por ndalimi i përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar në një Kosovë të lirë as që mund të imagjinohet. Shtrohet pyetja: *A do ta ndalonte Spahiu me ligj përdorimin e flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë, ashtu siç e ka ndaluar me ligj përdorimin e tij ish-Jugosllavia?*

● Mund të gabohej, por duke u bazuar në ato që Spahiu ka thënë e shkruar, për mospërdorimin e flamurit kombëtar nga shqiptarët në Kosovë, lë të mendohet se ai, po të kishte mundësi ligjore, shqiptarëve të Kosovës do t'ua ndalonte me ligj përdorimin e flamurit kombëtar shqiptar.

### **Sipas Spahiut, shqiptarët e Kosovës nuk duhet ta duan dhe ta valëvitin flamurin kuqezi**

Spahiu duke u marrë me përdorimin e flamujve, i porositi shqiptarët duke u shprehur si në vijim:

■ **...Tash pas shpalljes se pavarësisë së Kosovës s'osht i randsisem me dasht flamurin kuq e zi, jo duhet vetëm me respektue, por edhe me dashtë flamurin verdhë e kaltër<sup>284</sup>. (min. 28:15 -28:28:29)**

■ **Nuk oshtë dashni p.sh. tue value flamurin kuq e zi. Ajo ka qenë dashni para 30-40 vjeteve, por jo tani jo. Tani oshtë dashni me value flamurin verdhë e kaltër<sup>285</sup>. (min. 50:12 -50:28)**

● Me thëniet e Spahiut të cituara më lart nuk pajtohem aspak. Shqiptarët e Kosovës duke i takuar kombit shqiptar si para, ashtu edhe pas pavarësimit të Kosovës, flamurin kombëtar shqiptar e kanë dashur dhe e duan si para, ashtu edhe pas pavarësimit të Kosovës. E vetmja gjë që ka ndryshuar është se, pas pavarësimit të Kosovës në vitin 2008, shqiptarët e Kosovës e duan edhe flamurin e shtetit të tyre të Kosovës. Historia ka dashur që shqiptarët e Kosovës të kenë dy flamuj: njërin shtetëror dhe tjetrin kombëtar dhe këtu s'ka asgjë të keqe.

● Mendoj se Spahiu nuk e do përdorimin e flamurit kombëtar shqiptar, sepse e ka hallin tek ai kombi i tij "kosovar", krijimi i të cilit mendon se pengohet nëse shqiptarët e Kosovës do ta përdorin masovikisht flamurin kombëtar shqiptar, siç e kanë përdorur dhe siç e përdorin. Ai e ka të qartë se nga shqiptarët që e përdorin dhe e duan flamurin e tyre kombëtar shqiptar

---

<sup>284</sup> Nexhmedin Spahiu në "Oksigjen", pjesa I, 13.11.21:  
<https://www.youtube.com/watch?v=gmCJhoFX-Ps>

<sup>285</sup> Nexhmedin Spahiu në "Oksigjen", pjesa I, 13.11.21:  
<https://www.youtube.com/watch?v=gmCJhoFX-Ps>

nuk mund të krijohet një komb tjetër joshqiptar, të cilin e quan “komb kosovar“.

### **Patriotë janë ata që e duan edhe flamurin shtetëror të Kosovës, edhe flamurin kombëtar shqiptar**

● Ndërsa në debatin televiziv me emrin “Kojshia Show” të 30 qershorit të vitit 2024, moderatori i emisionit Sadri Imeri po bisedonte me Fadil Kajtazin lidhur me ata shqiptarë të Kosovës që po punojnë për shërbimet sekrete të Serbisë, aty nga gjysma e atij emisioni pjesë e debatit u bë edhe Nexhmedin Spahiu, duke shpalosur një flamur shtetëror të Kosovës. Kur moderatori e pyet pse nuk e ke marrë flamurin kuq e zi? - Spahiu tha:

■ **Ti vlla shko në Shqipni edhe e ki flamurin kuq e zi edhe.... (36:14 - 36:17).... Mu më intereson nëse Sadri Imeri, domethon e qet flamurin e Kosovës, ai domethon osht patriot i Kosovës, nëse e qet flamurin e Shqipnisë, ai ose pe pagun Shërbimi Inteligent i Shipnisë, SHISH-i për me bo kit punë, ose pe bon pi budallakisë vetë sepse mendon se shitet ma patriot, kryesore veprimi i tij osht anti-Kosovë<sup>286</sup> (5:00 - 50:32)**

● T'i thuash shqiptarit të Kosovës “shko në Shqipëri se atje e ke flamurin kuqezi”, siç i tha Spahiu moderatorit të emisionit “Kojshia Show”, Sadri Imerit, për mendimin tim është si t`i thuash atij, se në Kosovën e banuar me shumicë kombëtare shqiptare, nuk ka vend për flamurin kombëtar shqiptar kuqezi, prandaj shko (kalo) në Shqipëri se atje ka flamur kuqezi.

● T'i thuash shqiptarit të Kosovës: “Shko në Shqipëri, se atje e ke flamurin kuqezi”, siç u shpreh Spahiu në atë debat televiziv, kjo nuk ka si të mos na kujtojë atë thënien e shovinistëve serbë, maqedonë dhe malazezë, kur gjatë viteve '80-të shekullit XX thërrisnin: “Ata shqiptarë që e duan Shqipërinë dhe flamurin e Shqipërisë, lirisht le t`i kalojnë Bjeshkët e Nemuna dhe le të vendosen në Shqipëri!

● Nuk pajtohem aspak me Spahiun, se ai shqiptar i Kosovës që e përdor flamurin kombëtar shqiptar, ai ose paguhet prej SHISH-it<sup>287</sup>

<sup>286</sup> Kojshia Show - Fadil Kajtazi & Nexhmedin Spahiu, „700 agjent të UDB-së sillen në Kosovë. <https://www.youtube.com/watch?v=orGj8liM7Wk>

<sup>287</sup> SHISH paraqet shkurtesën e Shërbimit Informativ Shqiptar

të Shqipërisë, ose është budalla, por gjithësi bën veprim anti-Kosovë. Ky konstatim i tij është një absurditet dhe makabritet i radhës që bën ai. Shqiptari i Kosovës duke qenë pjesëtar i kombit shqiptar, ai e do Shqipërinë dhe e përdor flamurin kombëtar shqiptar pa u paguar nga askush.

● Shqiptarin e Kosovës kanë dashur ta paguajnë shërbimet sekrete serbe e jugosllave, që ai flamurin kombëtar shqiptar jo vetëm të mos e përdorë, por edhe ta përdhosë, por nuk ia kanë arritur. Flamuri kombëtar shqiptar nga shqiptarët e Kosovës përdoret aq shumë, saqë SHISH-it nuk do t'i mjaftonte as tërë buxheti shtetëror i Shqipërisë, për t'i paguar gjithë ata shqiptarë të Kosovës që e duan dhe e përdorin flamurin kombëtar shqiptar, dhe që janë në gjendje edhe të vdesin me të në dorë.

● Spahiu thotë se ata shqiptarë të Kosovës që e përdorin flamurin kombëtar, nëse nuk janë të paguar nga SHISH-i i Shqipërisë, atëherë ata këtë e bëjnë nga budallallëku! Unë mendoj ndryshe. Për mua ata shqiptarë që nuk e përdorin flamurin kombëtar shqiptar, edhe pse shqiptarë të tillë ka fare pak, ata këtë e bëjnë ose pse paguhen nga Sherbimi Sekret i Serbisë, ose këtë e bëjnë nga budallallëku.

● Kurrë nuk është budalla ai shqiptar që përdor flamurin e vet kombëtar. Dhe kurrë nuk është budalla ai shqiptar, i cili nuk u bindet predikuese, të cilët atij i thonë: mos e përdor flamurin tënd kombëtar, sepse po e përdore, je budalla!

● Nëse të gjithë ata shqiptarë që e përdorin flamurin kombëtar shqiptar janë budallenj, siç na thotë Spahiu, atëherë nuk mbetet tjetër, veçse Republika e Kosovës të quhet Republika e Budallenjve!

● Spahiu thotë se ata shqiptarë të Kosovës që e përdorin flamurin kombëtar shqiptar bëjnë veprim anti-Kosovë. Por duke pasur parasysh se sa shumë shqiptarë të Kosovës e përdorin flamurin kombëtar shqiptar, jo vetëm në Festën e 28 Nëntorit, por edhe në festa e tyre familjare, kjo sipas Spahiut tregon se pothuajse të gjithë shqiptarët e Kosovë bëjnë veprim anti-Kosovë! Unë mendoj ndryshe: shqiptarët që përdorin flamurin e tyre kombëtar shqiptar nuk bëjnë veprim anti-Kosovë. Veprime anti-Kosovë bën Serbia me lakenjtë e saj në Kosovë.

● Spahiu duhet ta dijë se në Kosovën e banuar me shumicë

kombëtare shqiptare mund të valëviten flamuj kuqezi më shumë se në Shqipëri, dhe nuk ka për të shkuar askush nga Kosova në Shqipëri, sa për t'u çmallur me flamuj kuqezi. Spahiu duhet ta fiksojë në kokë njëherë e mirë, se flamuri kombëtar shqiptar kuqezi në Kosovën e banuar me rreth 94% shqiptarë, nuk është në shtëpi të huaj, por është i ulur këmbëkryq në shtëpinë e tij.

● Dhe tjera që Spahiu duhet ta dijë, është se flamuri kombëtar shqiptar kuqezi, aq sa është i shqiptarëve të Shqipërisë, po aq është i shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë së Veriut, të Malit të Zi dhe të Luginës së Preshevës në Jug të Serbisë. Dhe kjo tregon se flamuri kombëtar shqiptar nuk është vetëm pjesë e identitetit kombëtar të shqiptarëve të Shqipërisë, por është edhe pjesë e identitetit kombëtar të shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë së Veriut, të Malit të Zi, të Luginës së Preshevës në Jug të Serbisë dhe e shqiptarëve të Çamërisë.

● Të përpiqesh që t'i bindësh shqiptarët e Kosovës që të heqin dorë nga përdorimi i flamurit kombëtar shqiptar, në një Kosovë të lirë dhe të pavarur, është njësoj si t'i thuash ujit: ec përpjetë!

### **Shqiptarët e Kosovës i duan dhe i respektojnë të dy flamujt: flamurin shtetëror dhe atë kombëtar**

● Sipas thënies së Spahiut të cituar më lart, del se shqiptarët pas pavarësimit të Kosovës duhet ta duan dhe ta valëvitin flamurin e Kosovës, të cilin ai e quan “verdhë e kaltër”, kurse flamurin kombëtar shqiptar, të cilin ai shpesh e quan “kuqezi”, duhet ta respektojnë, por nuk duhet ta përdorin (valëvitin) nëpër Kosovë.

● Të thuash se në Kosovën e lirë nuk duhet të përdoret (valëvitet) flamuri kombëtar shqiptar, duke qenë shqiptarët e Kosovës pjesë legjitime e kombit shqiptar, kjo nuk paraqet vetëm absurdin, por edhe diçka që nuk bënë vaki. Merreni me mend, shqiptarët e Kosovës flamurin kombëtar shqiptar e kanë valëvitur edhe kur Kosova duke qenë pjesë e Jugosllavisë, përdorimi i tij ka qenë i ndaluar me ligj, kurse tani në një Kosovë të lirë u dashka që shqiptarët e Kosovës të mos e valëvitin flamurin kombëtar shqiptar, sepse kështu dashkan N. Spahiu, H. Matoshi e ndonjë tjetër?! Një fjalë e urt e vendit tim thotë: O Zotë jep mend ku ska!

● Spahiu thotë se flamuri kombëtar shqiptar të mos valëvitet në Kosovën e lirë, sepse nuk do që ta ketë parasysh historinë e flamurit kombëtar shqiptar pikërisht në Kosovë. Flamuri kombëtar shqiptar në Kosovë është larë me lot e gjak! Shumë shqiptarë të Kosovës kanë bërë shumë vite burg, ngaqë kanë ngritur flamurin kombëtar shqiptar në kulmet e shtëpive të tyre, në kundërshtim me regjimet shoviniste serbe e jugosllave. Mijëra shqiptarë të Kosovës me flamurin e tyre kombëtar shqiptarë në duar, kanë luftuar për mbrojtjen e tërësisë tokësore të shqiptarisë. Dhjetëra mijëra shqiptarë të Kosovës me flamurin kombëtar shqiptar në duar, kanë luftuar kundër forcave serbe edhe gjatë viteve 1998-1999 të Luftës Çlirimtare të Kosovës për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës. Në Kosovë mijëra dëshmorë janë varrosur me arkivole të mbështjellë me atë flamur. Kështu, të kërkoj që në Kosovën e lirë të mos valëvitet flamuri kombëtar shqiptar, kjo nuk paraqet vetëm absurditet, por paraqet edhe një ironi përtej ironisë dhe një cinizëm përtej cinizmit!

● Shqiptarët e Kosovës kanë arsye t'i duan, t'i respektojnë, t'i valëvisin dhe t'i ekspozojnë të dy flamujt e tyre: njëri shtetëror dhe tjetri kombëtar. Dhe shqiptarët e Kosovës kështu kanë bërë e po bëjnë. Ata që nga viti 2008 e këndeje kur Kosova u pavarësua, i duan dhe i respektojnë të dy flamujt: flamurin verdhë e kaltër të shtetit të Kosovës dhe flamurin kombëtar shqiptar kuqezi, të cilët i vendosin si në ambiente private, ashtu edhe hapësirat publike.

## **FLAMURI KOMBËTAR SHQIPTAR TE VARREZAT E DËSHMORËVE KA PARAJSËN E VET!**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se si Nexhmedin Spahiu, duke qenë kundër përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë, ka shkuar aq larg, saqë në disa paraqitje të tij publike është shprehur se, po të hiqej flamuri kombëtar shqiptar nga varrezat e dëshmorëve të rënë gjatë viteve 1998-1999 të Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe, po të vendosej në vend të tij flamuri i Kosovës, Kosova do të bëhej menjëherë shtet i përvetshëm!

Duke u nisur nga fakti se dëshmorët e Luftës Çlirimtare të Kosovës, kanë luftuar pikërisht me flamurin kombëtar shqiptar në duar, kjo flet qartë se te varrezat e dëshmorëve vendin e flamurit kombëtar shqiptar, nuk mund ta zë asnjë flamur tjetër. Flamuri shtetëror i Kosovës mund të vendoset te varrezat e dëshmorëve, por jo duke e hequr nga varrezat e dëshmorëve flamurin kombëtar shqiptar, i cili te varrezat e dëshmorëve ka parajsën e vetë!

### **Edhe të vdekurve do t'ua ndërrojë identitetin kombëtar**

● Spahiu duke dëshiruar që nga varrezat e dëshmorëve të hiqet flamuri kombëtar shqiptar dhe në vend të tij të vendoset flamuri i ishtetit të Kosovës, të cilin ai e konsideron flamur kombëtar të Kosovës (në kuptimin e flamurit të “kombit kosovar”), kjo tregon se ai jo vetëm shqiptarëve të gjallë, por edhe dëshmorëve

të vdekur, të rënë gjatë viteve 1998-1999 të Luftës Çlirimtare të Kosovës, përpiket t'ua ndërrojë identitetin kombëtar: nga identitet kombëtar shqiptar në identitet kombëtar "kosovar".

● Historia njih raste të shumta, kur të gjallët e fuqishëm të gjallëve më pak të fuqishëm ua kanë ndryshuar me dhunë identitetin kombëtar. Por historia nuk e njih as edhe një rast të vetëm, që të gjallët e fuqishëm të janë përpjekur për t'ua ndërruar identitetin kombëtar edhe të vdekurve, siç mundohet Spahiu t'ua ndërrojë identitetin kombëtar dëshmorëve të vdekur, të rënë në Luftën Çlirimtare të Kosovës gjatë viteve 1998-1999.

### **Spahiu i qorton familjarët e dëshmorëve për vendosjen e flamurit kombëtar shqiptar në varrezat e dëshmorëve**

Spahiu duke folur kundër përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë, ai i qorton deri edhe familjarët e dëshmorëve si në vijim:

■ **Fatkeqësisht një numër i madh, një numër i familjeve të dëshmorëve, familjeve heroike të Kosovës, që kanë dhan shumë për çlirimin e Kosovës, kanë dështuar që me që projektin e shtetit të Kosovës deri në fund. Në varrezat e dëshmorëve gjithandej kemi flamurin kuq e zi dhe jo flamurin verdhë kaltër, ashtu siç e parasheh ligji i Kosovës. Dhe në momentin kur flamuri verdhë e kaltër do ta zavendojë flamurin kuq e zi në varrezat e dëshmorëve në Prekaz, në Gllogjan, gjithandej ku janë varrezat e dëshmorëve, shteti i Kosovës do të bëhet i përjetshëm, siç janë të pavdekshëm dëshmorët që e dhanë jetën për lirin e Kosovës<sup>288</sup>. (min. 29:37 -30:30)**

● Për mendimin tim, qortimi i mësipërm i Spahiut bërë familjarëve të dëshmorëve paraqet absurdin e absurdit. Kjo sepse shtrohet pyetja: *Cilin flamur duhej të vendosnin familjarët e dëshmorëve te varrezat e dëshmorëve, kur dihet se djemtë dhe vajzat e tyre kanë luftuar si shqiptarë dhe shqiptare, me flamurin e tyre kombëtar shqiptar në duar për çlirimin e Kosovës nga Serbia?!*

● Duke e pasur parasysh faktin se dëshmorët e të gjitha kohëve,

---

<sup>288</sup> Nexhmedin Spahiu në "Oksigjen", pjesa e parë, 13.11.21:  
<https://www.youtube.com/watch?v=gmCJhoFX-Ps>

flamurin kombëtar shqiptar e kanë pasur në ballë të të gjitha luftërave të tyre për çlirim dhe bashkim kombëtar, mund të merret me mend se sa lëndues, fyes dhe indinjues është për familjarët e dëshmorëve qortimi i Spahiut, pse ata te varrezat e të rënëve të tyre e kanë vendosur flamurin kombëtar shqiptar!

● Spahiu i qorton familjarët e dëshmorëve, sepse ata sipas tij, duke e vendosur flamurin kombëtar shqiptar te varrezat e dëshmorëve, paskan dështuar ta çojnë deri në fund projektin e shtetit të Kosovës! Merreni me mend sipas Spahiut, çuarja deri në fund e projektit të Kosovës u lidhka me mosvendosjen e flamurit kombëtar shqiptar te varrezat e dëshmorëve! Vërtet, çfarë nuk bën vaki në këtë botë!

● Familjarët e dëshmorëve pikërisht duke vendosur flamurin kombëtar shqiptar te varrezat e të rënëve të tyre, nuk e kanë dështuar, por e kanë fuqizuar projektin e shtetit të Kosovës, sepse kanë treguar se shtetin e Kosovës e ka çliruar kombi shqiptar, duke i vendosur ai në altarin e lirisë djemtë më të mirë dhe vajzat më të mira që ka pasur.

● Projekti i shtetit të Kosovës çohet përpara me të vërteta dhe jo me të pavërteta. Shteti i Kosovës nuk fuqizohet duke gënjyer veten dhe botën, sikur gjoja pas pavarësimit të Kosovës nga shqiptarët e Kosovës na qenka krijuar një komb tjetër “kosovar”, siç na thotë Spahiu, tanimë për më shumë se dy dekada me radhë.

● Vërtet, cila shqiponjë dykrenore e stampuar mbi varret e dëshmorëve po e pengon kaq shumë Spahiun tonë? Atë po e pengon shqiponja dykrenore e flamurit kombëtar shqiptar, me të cilin mijëra ushtarë të UÇK-së, duke e pasur atë në duar dhe në gji, kanë rënë dëshmorë për liri! Dhe Spahiun po e pengon ai flamur kombëtar shqiptar, me idealin e të cilit kanë vdekur mbi 10 mijë civilë shqiptarë, të vrarë e të gjenocidizuar nga forcat nazifashiste serbe. E po një flamur i tillë as nuk mund të “burgoset” e as nuk mund të “varroset” në muze...!

● Përfundimisht do të thosha se t'i qortosh familjarët e dëshmorëve, pse ata te varrezat e të rënëve të tyre kanë vendosur flamurin kombëtar shqiptar, është njësoj si t'i qortosh shqiptarët pse janë shqiptarë, si ta qortosh diellin pse bën dritë, si t'i qortosh arat pse bëjnë grurë, si t'i qortosh livadhet pse bëjnë bar, si t'i qortosh malet pse rritin drunjt dhe si ta qortosh erën pse fryn!

## **Nuk ekziston asnjë ligj detyrues për vendosjen e flamurit të Kosovës në varrezat e dëshmorëve**

- Spahiu duke thënë se - **në varrezat e dëshmorëve gjithandej kemi flamurin kuq e zi dhe jo flamurin verdhë e kaltër, ashtu siç e parasheh ligji i Kosovës**, përpiqet të na bindë sikur në Kosovë është në fuqi një ligj, sipas të cilit në varrezat e dëshmorëve duhet të vendoset patjetër flamuri i shtetit të Kosovës dhe jo flamuri kombëtar shqiptar, gjë që nuk qëndron aspak.
- Mendoj se përmendja këtij ligji joekzistues nga Spahiu flet qartë se ai po ta kishte ligjin në duart e tij, shqiptarëve të Kosovës përdorimin e flamurit kombëtar shqiptar do t'ua ndalonte me ligj. Mendoj se më shumë se kaq kundër përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë, nuk kanë qenë as shovinistët serbë, malazezë dhe maqedonas bashkë.
- Do të pajtohesh me Spahiun, sikur ai familjarëve të dëshmorëve t'u sugjeronte që ata në varrezat e dëshmorëve, krahas flamurit kombëtar shqiptar, ta vendosin edhe flamurin shtetëror të Kosovës. Por nuk pajtohem me Spahiun, që në varrezat e dëshmorëve të hiqet flamuri kombëtar shqiptar, për t'u zëvendësuar me flamurin shtetëror të Kosovës.

### **“Zëri i popullit zëri i Zotit!”**

- Për vetë faktin se familjarëve të dëshmorëve përveç Spahiut, asnjë shqiptar tjetër nuk iu ka bërë ndonjë qortim të tillë, kjo tregon se Spahiu duke dalë kundër vendosjes së flamurit kombëtar shqiptar në varrezat e dëshmorëve, ai është në konflikt flagrant jo vetëm me familjarët e dëshmorëve, por edhe me shumicën absolute të shqiptarëve të Kosovës. Spahiu ka harruar se “Zëri i Popullit është zëri i Zotit” (“Vox Populi vox Dei”).

### **Te varrezat e dëshmorëve vendoset ai flamur, me të cilin kanë luftuar dëshmorët**

- Në tërë botën dihet se te varrezat e dëshmorëve vendoset ai flamur, me të cilin dëshmorët kanë luftuar për çlirimin e vendeve të tyre. Duke pasur parasysh se dëshmorët e Luftës Çlirimtare të Kosovës, të zhvilluar nga UÇK-ja brenda viteve 1998-1999, kanë

luftuar për çlirimin e Kosovës me flamurin kombëtar shqiptar, kjo flet qartë se flamuri kombëtar shqiptar te varrezat e dëshmorëve e ka dhe do të ketë vendin e vet!

● Të gjithë atyre shqiptarëve që kanë rënë dëshmorë duke u ndier me përkatësi kombëtare shqiptare, duhet t'u vendoset te varret flamuri kombëtar shqiptar, me ose pa flamurin shtetëror të Kosovës.

### **Lojë me varreza, me dëshmorë dhe me flamuj!**

● Mendoj se Spahiu nuk është aq i paditur, sa të mos e kuptojë drejtësinë e vendosjes në varrezat e dëshmorëve të flamurit kombëtar shqiptar, të rënë për çlirimin e Kosovës. Mendoj se ai këtë gjë e kupton mirë, por duke qenë thellësisht kundër përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë, ai shkon aq larg, sa që u hakërrehet deri edhe familjarëve të dëshmorëve, pse ata kanë vendosur flamurin kombëtar shqiptar në varrezat e të rënëve të tyre.

● Për mendimin tim, Spahiu tërë këtë lojë fjalësh me varreza, me dëshmorë e me flamuj e ka bërë dhe e bën për të na bindur, sikur gjoja pas pavarësimit të Kosovës nga shqiptarët e Kosovës, veç është krijuar, sipas tij, “kombi kosovar”. Dhe kjo për mua është njësoj sikur të thotë dikush: **“Dilni e shihni se si kumbullat paskan bërë rrush...!”**

### **Shteti i Kosovës nuk bëhet i përjetshëm duke hequr flamurin kombëtar shqiptar nga varrezat e dëshmorëve**

Le t'i kthehemi edhe një herë thënies së Spahiut të cituar më lart, sipas së cilës: **N'momentin kur flamuri verdhë e kaltër do ta zëvendësoj flamurin kuq e zi në varrezat e dëshmorëve në Prekaz, në Glllogjan dhe gjithandej ku janë varrezat e dëshmorëve, shteti i Kosovës bohet i përjetshëm, siç janë të pavdekshëm dëshmorët e Kosovës, që e dhanë jetën për lirin e Kosovës<sup>289</sup>. (min. 29:37 -30:30)**

---

<sup>289</sup> Nexhmedin Spahiu në “Oksigjen”, pjesa e parë, 13.11.21:  
<https://www.youtube.com/watch?v=gmCJhoFX-Ps>

● Jo, shteti i Kosovës nuk bëhet i përjetshëm duke hequr flamurin kombëtar shqiptar nga varrezat e dëshmorëve, siç mendon Spahiu. Përkundrazi, shteti i Kosovës kësisoj bëhet i përkohshëm, sepse ai kësisoj do ta eliminonte bazën e tij kombëtare shqiptare, mbi të cilën është ngritur si shtet. T’ia heqësh shtetit të Kosovës bazën kombëtare shqiptare mbi të cilën ai është ngritur, është njësoj si t’ia presësh atij degët e lisit ku ka vendosur këmbët!

● Shteti, i cili mohon bazën kombëtare, mbi shpatullat e së cilës është ngjitur e ngritur, është si një shtëpi pa themele, që sapo të fryjë era e parë rrëzohet, si të ishte prej kartoni apo prej letre. Shtetin e Kosovës ashtu siç e ka krijuar pjesa e kombit shqiptar në Kosovë, atë edhe e mba në këmbë po pjesa e kombit shqiptar që jeton në Kosovë, dhe jo një komb joekzistues “kosovar”, siç përpriqet të na bindë Spahiu, Matoshi e ndonjë tjetër si këta.

### **Pa flamurin kombëtar shqiptar Kosova nuk do të ishte shtet i pavarur**

● Të kërkosh që nga varrezat e dëshmorëve të hiqet flamuri kombëtar shqiptar për t’u zëvendësuar me flamurin e shtetit të Kosovës, kjo për mendimin tim paraqet absurdin e radhës. Kjo, sepse flamuri shtetëror i Kosovës as që do të ekzistonte, nëse për bërjen e shtetit të Kosovës nuk do të luftonin ushtarët e UÇK-së, pikërisht me flamurin kombëtar shqiptar në duar.

● Në Kosovë flamuri kombëtar shqiptar e ka sjellë në jetë flamurin e shtetit të Kosovës dhe jo e kundërta. Prandaj të kërkosh që në Kosovë të hiqet nga përdorimi flamuri kombëtar shqiptar, është njësoj si të kërkosh që flamurit shtetëror të Kosovës t’i hiqet dyshemeja mbi të cilën i ka vënë këmbët!

● T’u kërkosh prindërve të një dëshmori që ata ta heqin nga varri i djalit të tyre flamurin kombëtar shqiptar, flamur ky me të cilin djali i tyre ka luftuar për çlirimin e Kosovës dhe ka rënë dëshmor, mendoj se diçka e tillë për ne qeniet e vdekshme, është shumë e trishtueshme dhe e rëndë.

---

**EKSPOZIMI I FLAMURIT KOMBËTAR SHQIPTAR  
NË PRESIDENCËN E KOSOVËS KRAHAS FLAMURIT  
SHTETËROR TË KOSOVËS NUK PARAQET  
TRADHTI KOMBËTARE**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se ekspozimi i flamurit kombëtar shqiptar në presidencën e Kosovës, krahas ekspozimit të flamurit shtetëror të Kosovës, për vetë faktin se rreth 94% e popullatës së Kosovës përbëhet nga pjesëtarët e kombit shqiptar, jo vetëm që nuk paraqet tradhti ndaj shtetit të Kosovës, siç na thotë Spahiu, por përkundrazi paraqet të vërtetën e madhe, se kombi shumicë në Kosovë është kombi shqiptar, i cili Kosovën e ka çliruar dhe pavarësuar bashkë me miqtë ndërkombëtarë.

Dhe në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se shqiptarët e Kosovës, duke qenë pjesëtarë të kombit shqiptar, ata duhet ta përdorin flamurin kombëtar shqiptar thjesht edhe për nevojat e tyre të mirëfillta, pa u bazuar në ***bajgat*** që kundër përdorimit të tij, kanë nxjerrë e nxjerrin nga goja ultrashovinizistët serbë si Ivica Daçiçi, Aleksandër Vuçiçi, Aleksandër Vulini e të tjetër.

**Ekspozimi i flamurit kombëtar shqiptar në Presidencën e Kosovës nuk paraqet tradhti, por paraqet atëdhetarizëm dhe normalitet**

Spahiu në vazhden e propagandës kundër përdorimit të flamurit

kombëtar shqiptar nga shqiptarët e Kosovës ka shkruar edhe si në vijim.

■ **Flamuri i Shqipërisë guxon të jetë në Presidencën e Kosovës vetëm kur aty e pret Presidentin e Shqipërisë. Çdo përdorim joprotokollar i flamujve në institucionin më të lartë të shtetit, është joseriozitet kulmor, përbuzje dhe abuzim kulmor me shtetin e Kosovës, shkelje e betimit si President dhe tradhti kombëtare, ka shkruar Spahiu<sup>290</sup>.**

● Spahiu në thënien e tij të cituar më lart fjalën e ka për ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçin, të cilin e akuzon deri edhe për tradhti kombëtare, pse ai në zyrën e Presidencës së Kosovës, krahas flamurit shtetëror të Kosovës ka ekspozuar edhe flamurin kombëtar shqiptar, të cilin Spahiu njësoj si edhe ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Daçiçi, nuk e quan flamur kombëtar të shqiptarëve, por e quan qëllimisht flamur i Shqipërisë.

● Në parim pajtohem me Spahiun se në Presidencën e Kosovës, përveç flamurit shtetëror të Kosovës, nuk do të duhej të kishte flamuj të tjerë. Por secila rregull ka edhe përjashtimet e saj. Kështu, duke pasur parasysh se në Kosovë kombi shumicë është kombi shqiptar, që përbën rreth 94% të popullatës së gjithmbarshme të Kosovës, në Presidencën e Kosovës duhet që si një përjashtim nga rregulli, krahas flamurit shtetëror të Kosovës dhe krahas flamurit të BE-së, të vendoset edhe flamuri kombëtar shqiptar, gjë që në të ardhmen do të duhej të rregullohej me ligj.

● Ekspozimi në Presidencën e Kosovës i flamurit kombëtar shqiptar, krahas flamurit shtetëror të Kosovës, tregon të vërtetën e madhe se në shtetin e Kosovës jeton kombi shumicë shqiptar. Pikërisht duke iu referuar këtij realiteti madhor, askush nga ndërkombëtarët nuk është shprehur asnjëherë kundër ekspozimit në Presidencën e Kosovës të flamurit kombëtar shqiptar, krahas ekspozimit të flamurit shtetëror të Kosovës.

● Spahiu ekspozimin e flamurit kombëtar shqiptar në Presidencën e Kosovës e konsideron tradhti kombëtare ndaj shtetit të Kosovës.

---

<sup>290</sup> Nervozohet analisti kosovar: Tradhti kombëtare vendosja e flamurit të Shqipërisë nga Thaçi. *Gazetametro.net*, 01.01.2020. <https://www.gazetametro.net/nervozohet-analisti-kosovar-tradhti-kombetare-vendosjen-e-flamurit-te-shqiperise-nga-thaci/>

Por, duke pasur parasysh se Kosovën e ka çliruar dhe e ka pavarësuar kombi shumicë shqiptar, kjo bën që ekspozimi i flamurit kombëtar shqiptar në Presidencën e Kosovës të jetë një atdhetarizem dhe normalitet dhe jo një tradhti kombëtare ndaj Kosovës.

● Duke pasur parasysh se Spahiu tanimë për 25 vite me radhë krijim-ekzistimin e “kombit kosovar” e propagandon me lodër në krahë, kjo për mendimin tim tregon se ai ekspozimin e flamurit kombëtar shqiptar në Presidencën e Kosovës, nuk e konsideron tradhti ndaj shtetit të Kosovës, por edhe pse nuk e thotë, e konsideron tradhti ndaj kombit të tij fiktiv “kosovar”. Kjo, sepse ai mendon se sa më shumë që të përdoret flamuri kombëtar shqiptar nga shqiptarët e Kosovës, aq më i vogël është shansi i krijimit nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

● Spahiu flamurin kombëtar të shqiptarëve për disa qëllime tejet destruktivë e quan flamur të Shqipërisë: për t’i bindur shqiptarët e Kosovës se ata duke përdorur flamurin kombëtar shqiptar, po përdorin flamurin e një shteti tjetër; për ta arsyetuar kësisoj kërkesën e tij ndaj shqiptarëve të Kosovës, që ata të heqin dorë nga përdorimi i flamurit të tyre kombëtar shqiptar; për t’i dhënë shans krijimit nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, për ta larguar Kosovën sa më shumë nga Shqipëria dhe për ta parandaluar kësisoj bashkimin Kosovë-Shqipëri.

● Por në Kosovë flamuri kombëtar shqiptar përdoret në cilësinë e flamurit kombëtar të të gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë dhe nuk përdoret domosdoshmërisht në cilësinë e flamurit shtetëror të Shqipërisë. Flamuri kombëtar shqiptar është i të gjithë shqiptarëve, përfshi këtu edhe shqiptarët e Kosovës. Në Kosovë flamuri kombëtar shqiptar do të përdorej nga shqiptarët, edhe sikur të mos ekzistonte fare Shqipëria. Kështu, edhe sikur në një moment të ndodhë fundosja e pakthim e Shqipërisë, shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera sërish do ta përdornin flamurin e tyre kombëtar kuqezi. Unë e garantoj Spahiu se, për sa kohë që do të jetë gjallë, sytë e tij flamuj kuq e zi kanë për të parë!

## **Me deklaratën e Daçiqit nuk mund të arsyetohet mospërdorimi i flamurit kombëtar shqiptar**

Spahiu në një shkrim të tij përpiket që, nëpërmjet të një deklaratë të ish-ministrit të Jashtëm të Serbisë, Ivca Daçiqit, ta arsyetojë mospërdorimin e flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë. Daçiqi në atë deklaratë, sipas Spahiut, ka thënë si në vijim:

■ **“Në Prishtinë me qindra herë ka më shumë flamuj të Shqipërisë se sa të Kosovës. Edhe vetë liderëve të Kosovës nuk iu pëlqen flamuri [i Kosovës]. Mos të bëhemi naivë e të mendojmë se Kosova e Shqipëria do të jenë dy shtete”<sup>291</sup>**

● Por më intriguese se deklarata e Ivca Daçiqit e cituar më lart, është komenti që Spahiu i bën asaj deklaratë të Daçiqit. Lexoni me kujdes:

■ **Shikone se kujt ia bëjnë qefin ata që në Prishtinë e ngrënë flamurin kombëtar shqiptar e jo flamurin kombëtar kosovar. Edhe Ivca Daçiqi është për “Shqipërinë e Madhe” dhe e dëshiron flamurin kuq e zi<sup>292</sup>.**

● Derisa Daçiqi (ish-ministri i Jashtëm i Serbisë) tregon pakënaqësi pse në Prishtinë ka qindra herë më shumë flamuj të Shqipërisë sesa të Kosovës, Spahiu na thotë të kundërtën: **Shihni se kujt po ia bëjnë qefin (në kuptimin se po ia bëjnë qefin Daçiqit) ata që në Prishtinë po e ngrënë flamurin kombëtar shqiptar e jo flamurin kombëtar kosovar.** Por edhe logjika më elementare thotë se, meqë Daçiqi tregon pakënaqësi pse në Prishtinë ka qindra herë më shumë flamuj të Shqipërisë sesa flamuj të Kosovës, atëherë ata që po e ngrënë flamurin kombëtar shqiptar në Prishtinë nuk po ia bëjnë qefin Daçiqit, siç i duket Spahiut, por po ia prishin qefin Daçiqit.

● Ose derisa Daçiqi i alarmon politikanët serbë duke u thënë atyre: **“Të mos bëhemi naivë e të mendojmë se Kosova e Shqipëria do të jenë dy shtete”**, duke aluduar kësajsoj se Kosova dhe Shqipëria

<sup>291</sup> Nexhmedin Spahiu: Edhe Ivca Daçiqi është për “Shqipërinë e Madhe” dhe e dëshiron flamurin kuqezi, 3 march 2019: <https://www.periskopi.com/nexhmedin-spahiu-edhe-ivca-daciqi-eshte-per-shqiperine-e-madhe-dhe-e-deshiron-flamurin-kuq-e-zi/>

<sup>292</sup> Nexhmedin Spahiu: Edhe Ivca Daçiqi është për “Shqipërinë e Madhe” dhe e dëshiron flamurin kuqezi, 3 march 2019: <https://www.periskopi.com/nexhmedin-spahiu-edhe-ivca-daciqi-eshte-per-shqiperine-e-madhe-dhe-e-deshiron-flamurin-kuq-e-zi/>

do të bashkohen një ditë, Spahiu thotë absurdin tjetër: **“Edhe Ivica Daçiqi është për “Shqipërinë e Madhe” dhe e dëshiron flamurin kuqezi!”**. Por, duke pasur parasysh se Daçiqi alarmon klasën politike serbe, që ajo ta pengojë bashkimin Kosovë-Shqipëri, ai nuk është aspak për krijimin e “Shqipërisë së Madhe”, siç mund t’i duket Spahiut, por përkundrazi është kundër bashkimit Kosovë-Serbi, ashtu siç është edhe kundër ngritjes së flamurit kombëtar shqiptar në Prishtinë.

● Spahiu nuk duhet që dëshirën e tij destruktive për mospërdorimin e flamurit kombëtar shqiptar nga shqiptarët e Kosovës, ta vendosë në lidhje kauzale me ankesat e Daçiqit, pse në Prishtinë më shumë paska flamuj të Shqipërisë sesa të Kosovës. Për mendimin tim Spahiu ishte dashur që në debatet e tij televizive, që ka herë pas here me Daçiqin në Beograd, t’i thoshte atij se flamuri kombëtar shqiptar paraqet flamurin kombëtar të shqiptarëve të Kosovës dhe nuk e paraqet flamurin e Shqipërisë.

● Spahiu kot përpiqet që vendimmarrjet politike të shqiptarëve të Kosovës t’i lidhë me ato që thonë për ta Daçiqët, Vuçiqët dhe Vulinët! Shqiptarët e Kosovës vendimmarrjet e tyre i lidhin vetëm me ato që thonë për ta dhe Kosovën vetë shqiptarët dhe aleatët e Kosovës: SHBA-ja dhe vendet e fuqishme të Europës.

# 43

---

## PËR SHQIPTARËT E KOSOVËS FLAMURI KOMBËTAR SHQIPTAR ËSHTË VETVETJA DHE INDI I TYRE QË NUK VDES!

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se për shqiptarët e Kosovës, si kur ata kanë jetuar në kuadër të Jugosllavisë Federative deri më 12 qershor të vitit 1991, ashtu edhe tani në këto 25 vitet e fundit që jetojnë në Kosovën e lirë, flamuri kombëtar shqiptar ka qenë dhe ka mbet simbol që ata i ka mbushur me frymëzime, krenari kombëtre dhe me shpresa lirie.

Spahiu në vazhden e fushatës së tij kundër përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë, është shprehur më tej si në vijim:

■ **Na derisa nuk e kishim flamurin ton kombëtar, na e simpatizojshim flamurin kuq e zi, sepse ai përfaqësonte vllaznit tonë, përfaqësonte kombin shqiptar. Por n 'momentin kur na e kemi krijue shtetin tonë, e kemi flamurin tonë...<sup>293</sup>. (min. 25:09 -25:25)**

● Spahiu nëpërmjet të pohimit të tij të cituar më lartë na thotë se, derisa ne shqiptarët e Kosovës e nuk e kemi pasur flamurin tonë kombëtar, që nënkupton flamurin shtetëror të Kosovës, e paskemi

---

<sup>293</sup> Nexhmedin Spahiu, Shteti dhe kombi kosovar, radio "Sharri" (Aktualitete - 30.03.2021)  
<https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

simpatizuar flamurin kuq e zi të kombit shqiptar, por tani që jemi tjetërsuar në “komb kosovar” e kemi flamurin ton kombëtar verdhë kaltër, dhe nuk kemi pse ta simpatizojmë dhe ta përdorim flamurin e një kombi tjetër (shqiptar) dhe të një shteti tjetër (Shqipërisë).

● Por për fatin e keq të Spahiut “komb kosovar” dhe flamur kombëtar të “kombit kosovar”, në sipërfaqen e tokës së Kosovës nuk ka. Për mendimin tim një komb i tillë dhe një flamur të tillë ka kohë që vajtojnë si dy kukuvajka në kokën e Spahiut, të Matoshit e të ndonjë tjetri. Kujuvajkat vajtojnë e Spahiu propogandon krijim-ekzistimin e kombit kosovar dhe të flamurit kombëtar “kosovar”, siç e quan ai flamurin shtetëror të Kosovës.

● Shqiptarët e Kosovës si kur Kosova ka qenë pjesë e Jugosllavisë Federative, ashtu edhe pas çlirimit dhe pavarësisht të saj kanë përdorur dhe përdorin natyrshëm dhe me të drejtë flamurin e tyre kombëtar shqiptar, flamur ky të cilin atyre nuk ua zëvendëson asnjë flamur tjetër në botë.

● Shqiptarët e Kosovës flamurin kombëtar shqiptar e kanë pasur flamur në luftëra, flamur në dasma dhe flamur në vdekje. Shqiptarët me arkivole të mbështjella me flamurin kombëtar shqiptar, kanë varrosur dëshmorët e kombit të rënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

● Duke pasur parasysh sa u tha më lart, mund të thuhet se shqiptarët e Kosovës nuk shkëputen nga flamuri kombëtar shqiptar, sepse ai për ta ka qenë e ka mbetur vetvetja dhe indi i tyre që nuk vdes kurrë!

## **Flamuri shtetëror i Kosovës me hartën e Kosovës në mes, nuk e paraqet flamurin kombëtar të asnjë kombi në Kosovë**

- Flamuri i Kosovës me hartën me ngjyrë të verdhë në sfondin e kaltër, duke qenë flamur shtetëror i Kosovës, si i tillë nuk është dhe nuk mund të jetë flamur kombëtar i asnjë kombi apo etnie të veçantë në Kosovë. Spahiu vazhdimisht është përpjekur dhe përpiqet që t'i bindë shqiptarët e Kosovës, se flamuri i tyre kombëtar pas pavarësismit të Kosovës, nuk është më flamuri kombëtar shqiptar kuqezi, por është flamuri shtetëror i Kosovës verdhë-kaltër, të cilin qëllimisht e quan flamur kombëtar i Kosovës, në kuptimin e flamurit të “kombit kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues.
- Bërja e Kosovës shtet nuk e kushtëzon aspak mospërdorimin e flamurit kombëtar shqiptar nga shqiptarët e Kosovës. Kjo sepse shqiptarët e Kosovës edhe pas pavarësismit të Kosovës janë shqiptarë dhe i përkasin kombit shqiptar. Kështu, kushdo që u thotë shqiptarëve të Kosovës mos e përdorni flamurin tuaj kombëtar shqiptar, siç u thotë atyre Spahiu, është njësoj si t'u thotë atyre: *Mos e doni vetveten!*

## **Spahiu simbolet shtetërore të Kosovës nuk mund t'i shesë si simbole kombëtare të Kosovës**

Spahiu lidhur me idenë e tij për mospërdorimin e flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë, ka thënë edhe si në vijim:

■ **“Nuk duhet në Kosovë të krijojmë karshillëk simboleve kombëtare, me ato të Shqipërisë apo me asnjë të ndonjë shteti”<sup>294</sup>.**

Dhe Spahiu duke teorizuar mëtej në këtë drejtim është shprehur edhe si më poshtë:

■ **Absolutisht ne nuk duhet, nuk ka asnji arsye që një gja që lidhet me emocionet dhe me kujtesën tonë historike, ajo nuk duhet mu përbuzë, por nuk ka nevojë ai flamur me i krijue rivalitet flamurit të Kosovës<sup>295</sup>. (min. 52:05 -52:16)**

<sup>294</sup> Nexhmedin Spahiu: Kushtetuta e definon kombin kosovar – të tillë e njohu Kosovën edhe SHBA-ja. *Balkan. Info*, 20 nëntor 2019  
<https://klankosova.tv/nexhmedin-spahiu-kushtetuta-e-definon-kombin-kosovar-te-tille-e-njohu-kosoven-edhe-shba/>

<sup>295</sup> Nexhmedin Spahiu në “Oksigjen”, pjesa e parë, 13.11.21  
<https://www.youtube.com/watch?v=gmCJhoFX-Ps>

● Spahiu nëpërmjet thënies së tij të parë të cituar më lartë kërkon që në Kosovë të mos përdoren simbolet kombëtare shqiptare (të cilat qëllimisht i quan të Shqipërisë, në kuptimin e simboleve të një sahteti tjetër), sepse ato sipas tij i bëjnë rivlitet e karshillëk simboleve kombëtare të Kosovës, të cilat edhe pse realisht janë simbole shtetërore të Kosovës, Spahiu i quan me vetëdije gabimisht si simbole kombëtare të Kosovës, në kuptimin e simboleve kombëtare të “kombit kosovar”, realisht joekzistues.

● Por meqë shqiptarët e Kosovës i përkasin kombit shqiptar, përdorimi nga ana e tyre e simboleve kombëtare shqiptare paraqet një normalitet, i cili nuk i bënë asnjë rivalitet e karshillëk simboleve shtetërore të Kosovës. Në Kosovë nuk ka as rivalitet e as karshillëk reciprok në mes të simboleve shtetërore të Kosovës dhe simboleve kombëtare të kombit shumicë shiptar.

● Shqiptarët i përdorin edhe simbolet shtetërore të Kosovës edhe simbolet kombëtare shqiptare pa asnjë prapaskenë e qëllim të keq.

● Flamurit shtetëror të Kosovës i vjen era shtet por nuk i vjen era komb! Shqiptarët e Kosovës në Kosovën e lirë duan ta ndiejnë jo vetëm erën e shtetit të Kosovës, por edhe erën kombit të tyre shqiptar, duke përdorur krahas flamurit të shtetit të Kosovës edhe flamurin kombëtar shqiptar.

● Spahiu në thënien e tij të dytë të cituar më lartë thotë se emocionet dhe kujtesa historike që kanë shqiptarët për flamurin kombëtar shqiptar, nuk e arsyeton përdorimin e flamurit kombëtar shqiptar sepse ai bën rivalitetet flamurit të Kosovës.

● Me këtë mendësi përçmuese të Spahiut ndaj emocioneve dhe ndaj kujtesës historike të shqiptarëve të Kosovës ndaj flamurit kombëtar shqiptar, jo vetëm se nuk pajtohem aspak por edhe përjetoj atë si një mendësi raciste ndaj shqiptarëve të Kosovës.

● Për qeniet inteligjente siç janë njerëzit përçmimi dhe mohimi i emocioneve dhe i kujtesave historike nga kushdo qoftë, nuk paraqet vetëm një fyerje të rëndë por edhe një padrejtësi të madhe, sepse janë emocionet dhe kujtesat historike ato që jetën e njëjzve e bëjnë jetë inteligjente.

● Hulumtimet e koheve të fundit kanë treguar se emocionet dhe kujtesat për gjerat e ndyshme, nuk janë të rëndësishme vetëm për

qeniet inteligjente siç janë njerëzit, por janë të rënësishte edhe për kafshët.

● Kështu. P.sh: një lopë kullotë tërë ditën në fushë a në mal por kur në mbrëmje kthet në fshat, ajo duke pasur njëfarë kujtese emocionale instinktive futet në shtëpinë e të zotit të vet dhe nuk futet në shtëpi të tjera as edhe me dhunë. Edhe në tufën e deleve me qengja secili qengj thith gjirin e nënës së vet, sepse secili qengj e ka njëfarë kujtese emocionale instinktive ndaj nënës së vet.

● Nga ana tjetër, për vetë faktin se flamuri kombëtar shqiptar dhe flamuri shtetëror i Kosovës, edhe pse nuk e zëvendësojnë njëri-tjetrin, megjithatë e plotësojnë dhe e fuqizojnë njëri-tjetrin, kjo flet qartë se këta dy flamuj nuk e rivalizojnë njëri-tjetrin, siç na thotë Spahiu për qëllimet e tij destruktive.

● Me fjalë të tjera, flamuri kombëtar shqiptar dhe flamuri shtetëror i Kosovës janë si “binjakët siamezë”, që kur teshtin njëri, kollitet tjetri...!

### **Flamujt kombëtarë shqiptarë i kanë treguar të vërtetën televizionit CNN**

Spahiu në vazhden e fushatës së tij kundër përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë, është shprehur më tej si në vijim:

■ **Ka qenë fushata e kalume Vjosa Osmanit... Vjen ajo me e bo fushatën n’shkollën ku e ka krye, n’Zhabar. Me vra Zoti se gjojshe ni flamur t’Kosovës n’shkollë, se krejt ishin me flamuj kuq e zi. Tash ish aty CNN e përcillke, jepke një përshtypje t’keqe për Kosovën<sup>296</sup>. (ora 1:20:31 -1:21:05)**

● Mendoj se njerëzit që e kanë pritur Vjosa Osmanin në fushatën zgjedhore me flamuj kombëtarë shqiptarë, televizionit amerikan CNN nuk i kanë dhënë asnjë përshtypje të keqe për Kosovën, siç thotë Spahiu, por i kanë treguar atij të vërtetën e madhe, se popullata shumicë e Kosovës i përket kombit shqiptar, që natyrshëm respekton flamurin e vet kombëtar shqiptar, pa pasur asgjë kundër flamurit shtetëror të Kosovës.

---

<sup>296</sup> Nexhmedin Spahiu në “Oksigjen”, pjesa e parë, 13.11.21:  
<https://www.youtube.com/watch?v=gmCJhoFX-Ps>

● E vërteta nuk i sjell asnjë të keqe Kosovës: Kosovës i kanë ardhur të gjitha të këqijat nga të pavërtetat, që armiqtë e kombit shqiptar kanë shpërndarë kundër saj nëpër botë. Ne i bëjmë keq Kosovës, nëse të huajve u themi të pavërteta, p.sh., nëse u themi atyre se, pas pavarësimit të Kosovës, nga shqiptarët e Kosovës veç është krijuar “kombi kosovar”, edhe pse diçka e tillë nuk ka ndodhur.

● Televizioni amerikan CNN nuk e ka pasur dhe nuk ka asnjë paragjykim të keq ndaj shqiptarëve të Kosovës, pse ata kanë qenë e janë shqiptarë, ose pse ata duke qenë shqiptarë, e përdorin flamurin e tyre kombëtar shqiptar. Paragjykime negative ndaj shqiptarëve të Kosovës dhe ndaj flamurit të tyre kombëtar shqiptar kanë pasur dhe e kanë shovinistët serbë, malazezë e maqedonë, të cilët shqiptarët e Kosovës i kanë gjenocidizuar e spastruar etnikisht, vetëm pse kanë qenë shqiptarë.

● Natyrisht nuk them se ata që e kanë pritur Vjosa Osmanin në fshatin e saj të lindjes për të bërë fushatë zgjedhore, nuk duhej të kishin në duar edhe flamuj të shtetit të Kosovës. Ata krahas flamujve kombëtarë shqiptarë, mund të kishin edhe flamujt e shtetit të Kosovës dhe kjo do të ishte mirë.

### **Spahiu ka qenë dhe është për një Kosovë-shtet me sa më pak elemente kombëtare shqiptare**

● Spahiu nga ato që ka shkruar dhe ka thënë, del se ai është për një shtet të Kosovës me sa më pak elemente të kombit shqiptar. Ai do një shtet të Kosovës me shqiptarë të tjetërsuar në “komb kosovar”, që nuk e përdorin flamurin kombëtar shqiptar dhe që nuk e duan bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.

● Por, ku t'i gjejmë ata shqiptarë të Kosovës që pranojnë të tjetërsohen më “komb kosovar”, që nuk e përdorin flamurin kombëtar shqiptar, dhe që nuk e duan bashkimin e Kosovës me Shqipërinë! Shqiptarë të tillë nuk ka.

### **Para se të jetë shuar edhe shqiptari i fundit...!**

● Ekzistimin e kombit shqiptar dhe përdorimin e flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë bashkë me idenë e bashkimit Kosovë-Shqipëri, nuk mund ta ndalë askush pa u shuar edhe

shqiptari i fundit në Kosovë, në Shqipëri e kudo tjetër përmbi dhe. E marr me mend se ky konstatim imi Spahiut as nuk i pëlqen e as nuk i besohet. Prandaj uroj që ai të rrojë gjatë dhe vërtetësinë e një konstatimi të tillë ta shohë me sy, ta dëgjojë me vesh dhe ta prekë me dorë!

\*\*\*

### **O Zot, ruaji shqiptarët nga ish-shqiptarët!**

● Derisa Kushtetuta e Kosovës e njeh ekzistimin e kombit shumicë shqiptar në Kosovë, dhe derisa ajo ua njeh shqiptarëve të Kosovës edhe të drejtën e përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar, Spahiu duke thënë se në Kosovë është krijuar “kombi kosovar”, ai në njërën anë shqiptarëve të Kosovës ua mohon përkatësinë kombëtare shqiptare, kurse në anën tjetër kërkon prej tyre që ata të mos e përdorin flamurin kombëtar shqiptar.

● Mbretëria e Serbisë gjatë viteve 1912-1918 dhe më pas Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene gjatë viteve 1918-1929 dhe, së fundi, edhe Mbretëria e Jugosllavisë gjatë viteve 1929-1941, shqiptarëve të Kosovës me vise përveçse ua kanë mohuar përkatësinë kombëtare shqiptare, ua kanë ndaluar edhe përdorimin e flamurit kombëtar shqiptar. Por duke qenë këto tri formacione shtetërore fund e krye shoviniste dhe antishqiptare, mohimi i përkatësisë kombëtare shqiptare dhe ndalesa e përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar nga ana e tyre kanë qenë të pritshme.

● Por, të dalë një ish-shqiptar si Spahiu, i cili së paku në planin teorik ua mohon shqiptarëve të Kosovës përkatësinë kombëtare shqiptare, duke i konsideruar ata pa asnjë fakt relevant pjesëtarë të një kombi tjetër “kosovar”, si dhe të kërkojë nga shqiptarët e Kosovës që ata të mos e përdorin flamurin e tyre kombëtar shqiptar, kjo jo vetëm nuk është e pritshme, por është edhe e çuditshme!

● Duke pasur parasysh ide të tilla destruktive të Spahiut ndaj pjesës së kombit shqiptar në Kosovë, njeriut nuk i mbetet tjetër, veçse t'i lutet Zotit: **O Zot, ruaji shqiptarët e Kosovës dhe flamurin e tyre kombëtar nga disa ish-shqiptarë!**

## FLAMURI KOMBËTAR SHQIPTAR NUK I TAKON VETËM TË KALUARËS, POR I TAKON EDHE TË ARDHMES

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se flamuri kombëtar shqiptar nuk i takon vetëm të kaluarës (historisë dhe muzeve të harresës), siç i duket Nexhmedin Spahiut, por i takon edhe të tashmes dhe të ardhmes, sepse shqiptarët me flamurin e tyre kombëtar kanë për të shënuar edhe kryefitoren e kombit shqiptar: *bashkimin Kosovë-Shqipëri*.

Ata që si Spahiu, Matoshi dhe ndonjë tjetër mendojnë se flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë i ka perënduar ylli dhe i ka ikur epoka e përdorimit, dhe se tanimë ai duhet t'i takojë të kaluarës, historisë dhe muzeve, për mendimin tim ata aq sa vuajnë nga shkurtpamësia, po aq vuajnë edhe nga perceptimi i gabuar i realitetit brenda kohës dhe hapësirës.

Ata nuk mund të kuptojnë se flamuri kombëtar shqiptar për shqiptarët e Kosovës është flamur mbiepokal dhe mbimuzeal. Nuk ka epokë e nuk ka muze që shqiptarëve të Kosovës do të mund t'ua "varrosin" flamurin kombëtar shqiptar.

### Flamuj kombëtar shqiptar ka më shumë në Kosovë se sa në Shqipëri

● Besoj se numri i flamujve kombëtarë shqiptarë në Kosovë është më i madh sesa në Shqipëri. Në Kosovë përveç flamujve kombëtarë shqiptarë, që ruhen për përdorim me rastin e festimit

të 28 Nëntorit, është edhe një numër i madh i flamujve kombëtarë shqiptarë në shtëpitë e shqiptarëve, sepse shqiptarët e Kosovës flamurin kombëtar e përdorin edhe në festa familjare dhe, madje, edhe në raste vdekjesh.

● Në Shqipëri flamujt kombëtarë gjenden në institucionet shtetërore dhe kulturore, për t'u përdorur në raste festash kombëtare e shtetërore, por ka më pak flamuj kombëtarë në shtëpitë e shqiptarëve, sepse shqiptarët e Shqipërisë në krahasim me shqiptarët e Kosovës, flamurin kombëtar e përdorin më pak në festat familjare.

● Me këtë dua të them se Spahiu, Matoshi dhe ndonjë tjetër si këta, për heqjen nga përdorimi të flamurit kombëtar shqiptar, më parë mund t'i bindin shqiptarët e Shqipërisë sesa shqiptarët e Kosovës.

● Shqiptarët e Kosovës janë shumë të lidhur me flamurin kombëtar shqiptar, jo sepse janë më patriotë se shqiptarët e Shqipërisë, por sepse atyre për kohë të gjatë (brenda periudhës kohore 1912-1968), nga regjimet serbe dhe jugosllave u është ndaluar pasja dhe përdorimi i flamurit kombëtar shqiptar, dhe sepse ata kanë bërë shumë vite burgime, ngaqë e kanë përdorur flamurin kombëtar shqiptar në kundërshtim me ligjin serbo-jugosllav për ndalimin e përdorimit të tij.

● Ndryshe ka qenë puna në Shqipëri: atje flamuri kombëtar shqiptar që nga viti 1912, kur atë e ngriti Ismail Qemali në Vlorë e deri më sot, asnjëherë nuk është ndaluar me ligj përdorimi i tij.

### **Me flamurin kombëtar shqiptar do të shënjohet edhe bashkimi Kosovë-Shqipëri**

Spahiu duke qenë kundër përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë, ai është shprehur edhe më tej si në vijim:

■ **...Flamuri kuq e zi i pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës vendin e ka në muze, njisoj si flamuri me të cilin ka luftue Gjorgj Vashingtoni për çlirimin e Amerikës që asht në muze. Tani Amerika ka një flamur tjetër kombëtar dhe në zyrën e presidentit Baiden ndodhet ky flamuri që të gjithë e njihni me 50 vje, por ai flamur me të cilin ka luftuar Vashingtoni nuk osht mo, osht vetëm në muze<sup>297</sup>. (min. 28:31 -26:56)**

---

<sup>297</sup> Nexhmedin Spahiu në "Oksigjen", pjesa e parë, 13.11.21

● Nga thënia e Spahiut e cituar më lart shihet se ai dëshiron që shqiptarët e Kosovës, pas pavarësimit të Kosovës, flamurin kombëtar shqiptar t'ia lënë të kaluarës (historisë), duke e vendosur atë në muze. Por, a futet zjarri në muze?! Mendoj e besoj se një dëshirë e tillë Spahiut nuk do t'i plotësohet kurrë. Jo se unë jam kundër kësaj dëshire të tij (për mua të çoroditur), por sepse shqiptarët e Kosovës janë kundër kësaj dëshire të tij.

● Spahiut mund të mos i besohet, por shqiptarët e Kosovës me flamurin kuqezi në duar, ashtu siç kanë bërë histori në kohët e kaluara, po me atë flamur kanë për të bërë histori edhe në kohët që po vijnë. Ata me të në duar kanë për të shënjuar edhe ngjarjen e të gjitha ngjarjeve: *bashkimin Kosovë-Shqipëri*. Flamuri kombëtar shqiptar s'ka për t'i takuar kurrë vetëm të kaluarës, por ka për t'i takuar gjithnjë edhe të tashmes, edhe të ardhmes dhe, për rrjedhojë, s'ka për t'u vendosur kurrë në muze derisa do të ketë shqiptarë mbi dhe.

● Flamuri kombëtar shqiptar është një flamur që jo vetëm nuk plakët, por edhe sa më shumë që ikin kohët, ai rinohet e rinohet. Mjerë kush turpërohet!

### **Ka pasur arsye objektive pse flamuri i Uashingtonit është vendosur në muze**

● Është e vërtetë se flamuri me të cilin dikur ka luftuar Xhorxh Uashingtoni për pavarësimin e SHBA-së ka shumë kohë që ndodhet i vendosur në muze. Por kjo ka pasur arsyen e vet, sepse me luftërat e bëra me atë flamur në korrikun e vitit 1776 është arritur që brenda shtetit të përbashkët të Amerikës të bashkohen vetëm 13 koloni. Por, meqë ndërkohë Amerikës fillestare me 13 koloni i janë bashkuar edhe shumë koloni të tjera të banuara me etni të ndryshme, duke arritur kështu numri i gjithmbarshëm i tyre në 50, kjo ka bërë që flamuri i SHBA-së të ketë 50-të yje, kurse flamuri me të cilin ka luftuar Xhorxh Uashingtoni të vendoset në muze.

● Krejt ndryshe qëndron puna me flamurin kombëtar shqiptar. Për vetë faktin se kombi shqiptar si në Shqipëri, ashtu edhe në

Kosovë e vise të tjera ka qenë dhe ka mbetur një komb monoetnik shqiptar, kjo tregon se shqiptarët kudo që janë nuk kanë asnjë arsye as historike e as politike, që flamurin e tyre kombëtar shqiptar ta heqin nga përdorimi, duke “e burgosur” atë në muze, siç mendon Spahiu.

● Flamuri i Xhorxh Uashingtonit dhe flamuri kombëtar shqiptar nuk u janë nënshtruar rrjedhave të njëjta historike, për të pasur të njëjtin fat të vendosjes në muze. Rrjedhat historike, të cilave u është nënshtruar flamuri i Amerikës i kohës së Uashingtonit, kanë bërë që ai flamur të vendoset në muze, kurse rrjedhat historike që u është nënshtruar flamuri kombëtar shqiptar, kanë bërë që ai, që nga kohët e Skënderbeut e këtej, të jetë flamur kombëtar shqiptar në përdorim.

### **Cilin flamur dëshiron ta vendosë në muze Spahiu?!**

● Shtrohet pyetja: Vërtet, cilin flamur dëshiron ta vendosë në muze Spahiu? Spahiu dëshiron ta “burgosë” e ta “varrosë” në muze flamurin kombëtar shqiptar; flamurin me të cilin shqiptarët e Kosovës kanë luftuar për mbrojtjen e tërësisë tokësore të kombit shqiptar; flamurin me të cilin shqiptarët e Kosovës kanë luftuar për pavarësimin e Shqipërisë bashkë me Kosovën dhe viset e tjera shqiptare brenda saj; flamurin me të cilin ka luftuar UÇK-ja kundër Serbisë për çlirimin e Kosovës; flamurin të cilin e kanë marrë me vete në varre 2400 Dëshmorët e Kombit, të rënë në Luftën Çlirimtare të Kosovës të bërë nga UÇK-ja gjatë viteve 1998-1999; flamurin me të cilin ka luftuar heroikisht kundër forcave serbe për tri ditë e tri net me radhë komandanti legjendar Adem Jashari në Prekaz, derisa u vra bashkë me të gjithë familjarët e tij.

● Thuhet se një astronaut amerikan me origjinë shqiptare pranë flamurit amerikan ka vendosur në Hënë edhe flamurin kombëtar shqiptar. Thuhet! Nuk e di saktë! Por, nëse po, atëherë shtrohet pyetja: *a është e mundur që përdorimi i flamurit kombëtar shqiptar të lejohet në Hënë, por jo në Kosovë?!*

● Pse Spahiu tani më për më shumë se dy dekada, shprehet kundër përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar nga ana e shqiptarëve të Kosovës? Mendoj se ai këtë e bën nga frika, sepse mendon se,

derisa shqiptarët e Kosovës e duan dhe e përdorin flamurin e tyre kombëtar shqiptar, në Kosovë nuk do të mund të krijohet ai kombi i tij “kosovar”.

### **Kosova në OKB do të përfaqësohet me flamurin e shtetit të Kosovës**

Spahiu në vazhden e propagandës kundër përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar nga shqiptarët e Kosovës, ka thënë edhe si në vijim:

■ **Flamuri kombëtar shqiptar osht në kombe t’bashkume, e ka nxon vendin, tash ti nuk mundesh me marr ato...<sup>298</sup>. (min. 25:03 -25:07**

● Spahiu duke thënë se në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB) flamuri kombëtar shqiptar e ka zënë vendin e tij si flamur përfaqësues i Shqipërisë, ai dëshiron të na thotë se në OKB, me të njëjtin flamur kombëtar shqiptar, nuk mund të përfaqësohen dy shtete: edhe Shqipëria, edhe Kosova.

● Por Spahiu s’ka arsye pse të brengoset për këtë punë, sepse për vetë faktin se në OKB nuk anëtarësohen kombet, por anëtarësohen shtetet, Kosova me rastin e anëtarësimit të saj në OKB do të përfaqësohet me flamurin e saj shtetëror “verdhë e kaltër”, dhe jo me flamurin kombëtar shqiptar “kuqezi”.

---

<sup>298</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri” (Aktualitete - 30.03.2021)  
<https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>



# **PJESA E NJËMBËDHJETË**

---

**KUNDËRVËNIA E SPAHIUT NDAJ BASHKIMIT  
KOSOVË-SHQIPËRI ME SHEMBUJ JO TË DUHUR,  
PRIMITIVË DHE BANALË**

Në këtë kapitull dhe në shtatë kapitujt të tjerë vijues të këtij libri do të trajtohen arsyet e paarsyeshme, shkaqet e paqëndrueshme dhe të pavërtetat e shumta, që ka përdoruar Nexhmedin Spahiu për t'i bindur (për mendimin tim, për t'i mashtruar) shqiptarët e Kosovës, që ata të pozicionohen kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri.

Spahiu përpiqet që dëshirën e tij për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri ta përlij me shembuj jo të duhur, primitivë dhe banalë, siç është p.sh., shembulli i vëllezërve, të cilët pasi ndahen njëherë, të shumtën e rasteve nuk bashkohen më asnjëherë etj. Por lexuesit duhet të kuptojnë se dy vëllezër që janë ndarë njëherë e nuk bashkohen më, nuk mund të krahasohen me dy shtete të të njëjtit komb, siç janë Shqipëria dhe Kosova, që janë të ndara, por që duan të bashkohen në një shtet të vetëm, ashtu siç dikur që janë bashkuar dy Gjermanitë në një Gjermani dhe dy Vietnamet në një Vietnam.

Spahiu e ndonjë tjetër si ky duke u deklaruar kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri me tam-tame e duhi, të lënë përshtypjen sikur Kosova e Shqipëria i kanë bërë të gjitha parapërgatitjet për t'u bashkuar me njëra-tjetrën në një Shqipëri të vetme, bashkim ky që, sipas Spahiut, do të ishte i dëmshëm, sidomos për Kosovën dhe “kombin kosovar”, komb ky i cili, sipas Spahiut, tanimë i ka

kaluar tri fazat e krijimit të tij, duke marrë aktualisht formën e djalit të ri!

### **Ç`është kjo zhurmë për asgjë?!**

Shtrohet pyetja: *Pse Spahiu, Matoshi e ndonjë tjetër bëjnë propagandë me tam-tame e me buri kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, kur dihet mirëfilli se Kosova dhe Shqipëria nuk janë duke bërë asgjë konkretisht për bashkimin e tyre. Vërtet, ç`është gjithë kjo zhurmë për asgjë?*

● Spahiu dhe Matoshi bëjnë zhurmë kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, sikur ai veç është duke ndodhur dhe ata po përpiqen ta ndalojnë bashkimin e tyre. Por, duke pasur parasysh se bashkimi Kosovë-shqipëri, as nuk është duke ndodhur dhe as që mund të ndodh edhe për një kohë, ata i kundërvihen bashkimit Kosovë-Shqipëri pa asnjë shkas, thjeshtë për ta parandaluar ndodhjen e tij edhe në të ardhmën.

### **Kandili i bashkimit Kosovë-Shqipëri e do nga një pikë vaj që të mos shuhet derisa ky bashkim të ndodh realisht**

● Për mendimin tim, shqiptarët nuk duhet t`i fryejnë shumë zjarrit të bashkimit Kosovë-Shqipëri, sepse për momentin dhe edhe për një kohë Fuqitë e Mëdha vendimmarrëse për hir të paqes rajonale, të nuk janë për bashkimin Kosovë-Shqipëri.

● Por nga ana tjetër, shqiptarët për çdo ditë duhet t`ia hedhin nga një pikë vaj kandilit të bashkimit Kosovë-Shqipëri, që ai të mos shuhet deri sa bashkimi Kosovë-Shqipëri të ndodh realisht. Puna hap pas hapi dhe në doza të vogla është rruga më e mirë për ndodhjen e bashkimit Kosovë-Shqipëri.

● Porosia ime lidhur me bashkimin Kosovë-Shqipëri përkon me fjalën e urtë: “Piq e mos digj”! Kjo në njërin anë do të thotë se shqiptarët nuk duhet t`i fryjnë shumë zjarrit për bashkim sa të digjen vetë në të, kurse në anën tjetër kjo do të thotë shqiptarët duhet t`i frejnë zjarrit për bashkim çdo ditë e ngapak në mënyrë që ai të mos shuhet, derisa të krijohen rrethanat ndërkombëtare për bashkim.

● Për mendimin tim, edhe nëse Kosova e Shqipëria kurrë nuk do të bashkohen (gjë nuk ka për të ndodhur), shqiptarët nuk duhet

të ndahen në dy kombe: njëri shqiptar dhe tjetri “kosovar”, sepse siç kam theksuar edhe në njërin nga kapitujt pararendës, ndarja e kombit shqiptar në dy kombe është shumë herë më tragjike sesa mosbashkimi Kosovë-Shqipëri.

● Tani le t’u referohemi shembujve jo të duhur që jep Spahiu, për të arsyetuar nëpërmjet tyre, propagandën e tij për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri.

### **Reduktimi i bashkimit Kosovë-Shqipëri me shembullin e vëllezërve, që kur ndahen njëherë, nuk bashkohen më asnjëherë**

Spahiu në pyetjen e moderatorit A. D. të një televizioni nga Tirana: **Pse Kosova e Shqipëria nuk duhet të bashkohen, kur dihet se shumica e shqiptarëve e duan këtë bashkim**, Spahiu kësaj pyetjeje i është përgjigjur si më poshtë:

■ **Ka plotë që janë vllazën e jonë nda me vlla, pse s’po shkojn mu bashkue me vllaun qi ja ka bo baba a e nona?**<sup>299</sup>. (min. 19:21 - 19:24)

■ **(Vëllezërit, shën. aut.) masi që i kanë maure shpitë veç e veç, unë se kom pa ni vëlla që shkon e prishë shpinë e vet, që ja shti flakën...**<sup>300</sup>. (min. 19:27 - 19:32)

● Spahiu thotë se vëllezërit pasi ndahen dhe bëjnë shtëpitë e tyre, ata nuk bashkohen sërish brenda së njëjtës shtëpi ose familje, duke aluduar kështu se edhe Kosova e Shqipëria, duke qenë dy shtete të veçanta dhe të ndara, ato s’kanë pse të bashkohen në një shtet të përbashkët.

● Përgjigjja ime lidhur me një mendësi të tillë të Spahiut është si vijon:

**E para**, është e vërtetë se dy vëllezër të ndarë në shumicën e rasteve nuk bashkohen më për t’u bërë sërish një familje e vetme, por kjo nuk vlen për dy shtete të të njëjtit komb, të cilat në të shumtën e rasteve bashkohen në një shtet. Kështu janë bashkuar

<sup>299</sup> Nexhmedin Spahiu, *youtube, televizioni T7*, 30.11.2022 [https://www.youtube.com/watch?v=7FJ\\_XYeAm6c](https://www.youtube.com/watch?v=7FJ_XYeAm6c)

<sup>300</sup> Nexhmedin Spahiu, *youtube, televizioni T7*, 30.11.2022 [https://www.youtube.com/watch?v=7FJ\\_XYeAm6c](https://www.youtube.com/watch?v=7FJ_XYeAm6c)

dy shtetet e të njëjtit komb gjerman në një Gjermani të vetme, dhe janë bashkuar edhe dy shtetet e të njëjtit komb vietnamez në një Vietnam të vetëm.

**E dyta**, nëse dy vëllezër që janë ndarë njëherë, do të bashkohen ose jo, kjo varet nga vullneti i dy individëve, kurse nëse dy shtetet shqiptare (Kosova dhe Shqipëria) do të bashkohen ose jo, kjo varet nga vullneti i rreth pesë milionë shqiptarëve në Shqipëri dhe në Kosovë, dhe i rreth pesë milionë shqiptarëve që jetojnë kryesisht në Europë, por edhe në Amerikë, Kanada, Australi e vende të tjera nëpër botë.

**E treta**, meqë shumica dërmuese e shqiptarëve në Kosovë dhe në Shqipëri, siç tregojnë edhe sondazhet e bëra janë për bashkimin Kosovë-Shqipëri, kjo flet qartë se Bashkimi Kosovë-Shqipëri nuk ka të bëjë aspak me shembullin e dy vëllezërve, që janë ndarë njëherë dhe që nuk bashkohen asnjëherë.

● Duke u nisur nga sa u tha më lart, del qartë se shembulli i dy vëllezërve, që pasi ndahen njëherë nuk bashkohen më asnjëherë, është një shembull jo i duhur, primitiv dhe banal, për t'u ilustruar me të bashkimi ose mosbashkimi i dy shteteve të të njëjtit komb shqiptar, siç janë Kosova dhe Shqipëria.

### **Reduktimi i bashkimit Kosovë-Shqipëri, me shembullin e atij vëllait që, pasi e kall shtëpinë e vet, shkon në shtëpinë e vëllait duke iu bërë barrë atij**

Spahiu duke teorizuar më tej lidhur me temën e bashkimit Kosovë-Shqipëri, është shprehur edhe si në vijim:

■ **Kur njeriu e ka krijue shpinë e vet, e ka krijue adresën e vet, ai nuk shkon mi shkatrrue ato. Nëse e shkatrron shtetin e Kosovës, ajo bohote barrë për Shqipërinë, sikur ni vëlla që e kall shpinë e vet e shkon n'shpinë e vëllaut<sup>301</sup>. (min. 19:34 -19:58)**

● Edhe shembulli i Spahiut, sipas të cilit kur njëri vëlla ia fut flakën shtëpisë vet, shkon në shtëpinë e vëllait duke iu bërë atij barrë, paraqet po ashtu një shembull sa joadekuate, aq edhe primitiv e

---

<sup>301</sup> Nexhmedin Spahiu, *youtube, televizioni T7*, 30.11.2022  
[https://www.youtube.com/watch?v=7FJ\\_XYeAm6c](https://www.youtube.com/watch?v=7FJ_XYeAm6c)

banal, nëpërmjet të cilit Spahiu nuk mund ta përlijë aspak dëshirën e tij (për mua e çoroditur) për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri. Kjo, sepse shqiptarët e Kosovës duke ia bashkuar Kosovën Shqipërisë, ata Kosovën as nuk e kallin e as nuk e djegin, dhe as nuk ia bëjnë atë barrë Shqipërisë, siç na thotë Spahiu. Përkundrazi, shqiptarët e Kosovës duke ia bashkuar Kosovën Shqipërisë, Kosovën e fuqizojnë duke i shtuar asaj krahun e munguar të Shqipërisë, kurse Shqipërinë e fuqizojnë duke i shtuar asaj krahun e munguar të Kosovës.

● Nëse Kosova i bashkohet Shqipërisë, ajo bëhet shumë më e mbrojtur nga synimet gllabëruese të Serbisë. Dhe nëse Kosova i bashkohet Shqipërisë, kjo e fundit bëhet shumë më e mbrojtur nga synimet gllabëruese të Greqisë.

● Nëse Kosova i bashkohet Shqipërisë me vullnet të lirë, ajo as nuk shkatërrohet, as nuk kallet, as nuk zhduket, sepse Kosova ka qenë dhe është një copë Shqipëri.

● Merre me mend: Spahiu nuk e dëshiron bashkimin Kosovë-Shqipëri, sepse ka frikë se mos Kosova do t'i bëhej barrë Shqipërisë! Cinizëm se jo mahi!

\*\*\*

### **Gjuha e Enver Hoxhës nuk ka qenë e mbarsur me pompa bashkimi**

Spahiu duke qenë kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, ai si edhe shumë herë të tjera, sërish kapet me figurën e Enver Hoxhës, duke u shprehur si më poshtë:

■ **Gjuha e shokut Enver Hoxha me pompa bashkimi na çon në perspektivë të konfliktit të ardhshëm mes Prishtinës e Tiranës. Gjuha e Fishtës e Merxhanit sjell harmoni e bashkërendim mes vete**<sup>302</sup>.

● Thënia e Spahiut e cituar më lart, sipas së cilës gjuha e Enver Hoxhës paska qenë plot me pompa bashkimi nuk qëndron aspak.

---

<sup>302</sup> Nexhmedin Spahiu: Enver Robelli vs. Halil Matoshi & Ben Blushi; 26 gusht, 2016. *Dritare Net*: <https://dritare.net/enver-robelli-vs-halil-matoshi-ben-blushi>

Kjo, sepse Enver Hoxha për shkaqe strategjike, asnjëherë nuk e ka kërkuar shkëputjen e Kosovës nga Jugosllavia, për t'ia bashkuar atë Shqipërisë. Ai ka kërkuar nga Jugosllavia, që ajo t'ua njohë shqiptarëve në viset e tyre në Jugosllavi, të njëjtat të drejta që ua ka njohur popujve të tjerë të vendit.

● Por Enver Hoxha, për vetë faktin se Jugosllavia ka qenë tetë herë më e madhe dhe më e fuqishme se Shqipëria, nuk ka kërkuar nga Jugosllavia që kjo e fundit t'ia kthejë Kosovën Shqipërisë, sepse një kërkesë e tillë do të ishte për kohën një donkishotizëm.

● Nga ana tjetër, edhe sikur gjuha e Enver Hoxhës të ketë qenë plot me pompa bashkimi, ajo nuk do të çonte aspak në ndonjë konflikt mes Prishtinës dhe Tiranës, siç na thotë Spahiu. Kjo, sepse bashkimi Kosovës-Shqipëri nuk do të realizohej as asokohe e as në kohët e sotme me konflikt, por do të realizohej me marrëveshje dhe mirëkuptim, mes shqiptarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë.

● Nga ana tjetër, pajtohem me Spahiun se gjuha e Fishtës dhe e Merxhanit në mesin e shqiptarëve kanë sjellë harmoni e bashkërendim, por nuk pajtohem me Spahiun, se gjuha e Fishtës dhe e Merxhanit, u kanë shërbyer ideve të tij për ndarjen e shqiptarëve në dy kombe: në komb shqiptar dhe në “komb kosovar”. Se Gjergj Fishta edhe Branko Merxhani nuk kanë pasur të bëjnë me idetë e Spahiut për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, për këtë kam shkruar në kapitujt 25 dhe 26 të këtij libri.

---

## **BASHKIMI KOSOVË-SHQIPËRI KA QENË, ËSHTË DHE DO TË JETË NDËRMARRJE PROGRESIVE**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se thënia e Spahiut, sipas të cilës - bashkimi Kosovë-Shqipëri ka qenë ide progresive vetëm derisa Kosova duke qenë pjesë e Jugosllavisë nuk ka qenë shtet, kurse bashkimi Kosovë-Shqipëri, tani pas bërjes së Kosovës shtet është ide regresive, jo vetëm që nuk qëndron, por edhe paraqet një ide antihistorike.

Idetë e bashkimit të dy shteteve të të njëjtit komb, ose idetë e bashkimit të kombeve të ndara në disa shtete të huaja, historia nuk i ka vlerësuar si ide regresive, por i ka vlerësuar si ide progresive. Por Spahiu nuk identifikohet me historinë, ai identifikohet me antihistorinë.

Kështu, bashkimi i dy Gjermanive në një Gjermani të vetme në vitin 1990 nuk ka paraqitur ide regresive, por ka paraqitur ide progresive. Edhe bashkimi i dy Vietnameve në vitin 1975 nuk ka paraqitur ide regresive, por ka paraqitur ide progresive. Prandaj edhe bashkimi Kosovë-Shqipëri nuk paraqet ide regresive, por paraqet ide progresive.

**Bashkimi Kosovë-Shqipëri ka qenë dhe është ide progresive**  
Spahiu në një intervistë që i ka dhënë IBNA-së lidhur me bashkimin Kosovë-Shqipëri është shprehur si në vijim:

■ **“Bashkimi Kosovë-Shqipëri ka qenë një ide progresive kur**

**Kosova nuk ka qenë ende shtet. Tani që Kosova është shtet, kjo oshtë një ide regresive. Bashkimi Kosovë-Shqipëri do të thotë që të shuhet shteti i Kosovës, që është arritur me aq shumë sakrifica, jo vetëm nga shqiptarët në vendet ku flitet shqipja, por edhe nga komuniteti internacional, që ka investuar miliarda euro për ta ndërtuar këtë shtet”<sup>303</sup>.**

● Pohimi i Spahiut i cituar më lart, sipas të cilit bashkimi Kosovë-Shqipëri, pas bërjes së Kosovës shtet është ide regresive, nuk qëndron aspak. Përkundrazi, ideja e bashkimit Kosovë-Shqipëri, për vetë faktin se pajtohet me tendencën e natyrshme të kombeve të ndara për bashkimin dhe jo për ndarjen e tyre, ka qenë dhe është ide progresive, si kur Kosova ka qenë pjesë e ish-Jugosllavisë, ashtu edhe tani kur Kosova është bërë shtet i pavarur.

● Spahiu, për mendimin tim, idenë e bashkimit Kosovë-Shqipëri e konsideron ide regresive, sepse ai ka frikë se po ndodhi bashkimi Kosovë-Shqipëri, krijimi nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” nuk do të ndodhë. Spahiu mendon kësisoj, sepse nuk është i aftë të parashikojë se “kombi kosovar” nuk do të krijohet, pa marrë parasysh nëse Kosova e Shqipëria do të bashkohen ose jo.

### **Bashkimi Kosovë-Shqipëri i shpaguean shumëfish sakrificat për bërjen e Kosovës shtet të pavarur**

● Edhe pohimi tjetër i Spahiut i cituar më lart, sipas të cilit bashkimi Kosovë-Shqipëri nuk do të duhej të ndodhë, sepse për bërjen e Kosovës shtet janë bërë sakrifica të mëdha si nga shqiptarët, ashtu dhe nga Bashkësia Ndërkombëtare, nuk qëndron. Kjo sepse duke pasur parasysh përfitimet e mëdha që do të ketë tërë kombi shqiptar me rastin e bashkimit Kosovë-Shqipëri, kjo flet qartë se bashkimi Kosovë-Shqipëri kurdo që do të bëhej i mundur, nuk i bën aspak të kota as sakrificat e shqiptarëve dhe as ato të Bashkësisë Ndërkombëtare për bërjen e Kosovës shtet. Përkundrazi, bashkimi

---

<sup>303</sup> Nexhmedin Spahiu: *Intervista në gjuhën shqipe dhënë IBNA-së:*  
<https://balkaneu.com/ibna-interviewspahiu-isnt-kosovos-army-urgent-matter/>  
Nexhmedin Spahiu: *Intervista në gjuhën angleze dhënë IBNA-së:*  
<https://web.archive.org/web/20211019021351/>  
<https://balkaneu.com/ibna-interviewspahiu-isnt-kosovos-army-urgent-matter/>

Kosovë-Shqipëri do t'i shpaguante shumëfish sakrificat e bërjes së Kosovës shtet i pavarur.

### **Bashkimi Kosovë-Shqipëri paraqet faktor stabilizues për paqen rajonale në Ballkan**

● Duke pasuar parasysh se Serbia ka pretendime territoriale ndaj Kosovës, kurse Greqia ka pretendime territoriale ndaj jugut të Shqipërisë, bashkimi Kosovë-Shqipëri do t'i kontribuonte shumë ruajtjes së paqes rajonale ballkanike. Kjo, sepse po u bashkuan Kosova e Shqipëria në një shtet të vetëm shqiptar, Greqia do të hiqte dorë nga gllabërimi i viseve jugore të Shqipërisë, kurse Serbia do të hiqte dorë nga ripushtimi i Kosovës. Kjo është arsyeja pse bashkimi Kosovë-Shqipëri, për vetë faktin se i shërben ruajtjes së paqes rajonale, paraqet një ide sa progresive aq dhe racionale.

● Për mendimin tim për t`u parandaluar konfliktet në Ballkanin jugor, të katër shtetet e Ballkanit jugor (Serbia, Bullgaria, Greqia dhe Shqipëria), duket të kenë pak a shumë të njëjtën madhësi dhe duhet të kenë pak a shumë edhe të njëjtin numër të banorëve, sepse ky ballancim i bën ato pak a shumë njësoj të fuqishme dhe për rrjedhojë bën që ato të mos ia mësyjnë njëra-tjetrës me pushtime dhe aneksime.

● Sa i përket Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë ato veç janë tri shtete pak a shumë me madhësi të njëjta dhe me numër pak a shumë të njëjtë të banorëve, dhe si të tilla edhe pse kanë qasje agresive nuk e kanë të lehtë ta sulmojnë njëra-tjetrën.

● Por duke pasur parasysh se shteti i katërt i Ballkanit jugor Shqipëria, duke qenë e ndarë si territor dhe si komb në gjashtë njësi shtetërore ndryshme, ajo ka qenë dhe ka mbet hallka e dobët e Ballkanit, mbi të cilën i kanë derdhur gjyket e topave të tyre Serbia, Bullgaria dhe Greqia, duke e ndarë dhe prerë atë në gjashtë copa.

● Prandaj kush dëshiron që ta ruaj paqen rajonale ballkanike, këtë mund ta bëjë duke e fuqizur shtetin e katërt të Ballkanit jugor -Shqipërinë: duke ia bashkuar asaj Kosovën dhe pjesën e kombit shqiptar në Kosovë, me ç`rast edhe Shqipëria e bashkuar do të bëhej pak a shumë njësoj e madhe dhe fuqishme sa Serbia, Bullgaria dhe Greqia dhe, për rrjedhojë këto tri shtete nuk do t`ia mësyenin

më Shqipërisë së bashkuar me sulme ushtarake aneksuese, si deri në të kaluarën e afërt.

● Për mendimin tim balancimi Serbi-Bullgari-Greqi -Shqipëri si madhësi dhe si fuqi, do ta ruannte paqen rajonale ballkanike më mirë se Europa dhe Amerika bashkë.

### **Ideja e Bashkimit Kombëtar nuk i përkeqëson, por i përmirëson marrëdhëniet Kosovë-Shqipëri**

Spahiu duke u pozicionuar kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, ka thënë mëtej si në vijim:

■ Unë nuk pres përmirësim t'marrdhanjeve me Shqipërinë, t'paktën jo derisa nga diskursi publik në Kosovë të hiqet fjala "bashkim", sepse fjala bashkim e trembë Shqipërinë edhe krijon distancë me ta... Shqipëria osht e kënaqun me ato që ka, me ndërtimin e vet, me shpinë e vetë, edhe na do t'mirën, por don që ne t'jemi n'shpi tonë dhe mos t'përzihemi<sup>304</sup>. (ora 1:09:22 - 1:11:55)

### **Fjala "bashkim" nuk e ka trembur asnjëherë Shqipërinë!**

● Nuk pajtohem aspak me pohimin e Spahiut të cituar më lart, sipas të cilit marrëdhëniet Kosovë-Shqipëri nuk do të jenë të mira, derisa në Kosovë të dëgjohet fjala "bashkim", sepse fjala "bashkim" e trembka Shqipërinë! Por ky pohim i Spahiut nuk qëndron, sepse pikërisht fjala "bashkim" që dëgjohet në Kosovë, marrëdhëniet Kosovë-Shqipëri nuk i përkeqëson, por përkundrazi i përmirëson drejt qëllimit të përbashkët të shqiptarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë.

Kush e njeh sadopak historinë e kombit shqiptar, e di mirë se fjala "bashkim" nuk e ka trembur dhe nuk e tremb aspak Shqipërinë, siç na thotë Spahiu. Tjetër gjë është fakti se Shqipëria duke qenë një shtet shumë më i vogël se ish-Jugosllavia, ajo nuk ka mundur që ta çlirojë Kosovën me luftë të armatosur, duke ia bashkuar atë vetes së saj. Por kësaj nuk i thuhet trembje nga fjala "bashkim", siç mund t'i duket Spahiut, por i thuhet pamundësi për bashkim.

---

<sup>304</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio "Sharri" (Aktualitete - 30.03.2021) <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

● Për mendimin tim, Spahiu duke qenë vetë kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, ai përpiqet që dëshirën e tij për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri t'ia hedhë Shqipërisë. Fjalës “bashkim”, kur është fjala për bashkimin Kosovë-Shqipëri, i janë trembur dhe i tremben Serbia dhe Greqia. Serbia, sepse synon ripushtimin e Kosovës së lirë, kurse Greqia, sepse ka më shumë se shtatë dekada që synon aneksimin e disa viseve jugore të Shqipërisë.

● Spahiu duke thënë pa asnjë fakt, se Shqipëria i trembet bashkimit me Kosovën, ai për mendimin tim thotë një marrëzi të padëgjuar, nëpërmjet së cilës dëshiron t'i bindë (mashtrojë) shqiptarët e Kosovës, që të heqin dorë nga bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, sepse Shqipëria nuk e do këtë bashkim.

### **Rilindësit e kanë ëndërruar bashkimin e të gjithë shqiptarëve në një Shqipëri të vetme**

Spahiu duke e kundërshtuar bashkimin Kosovë-Shqipëri, ka thënë edhe si në vijim:

■ **... krejt çka kish mu arrit me bashkim, kish mu arrit përmes marrëdhajeve ma t'mira me njeni-tjetrin. Fakti se Kosovën e kanë njoft 117 kombe të botës, kjo osht diçka përtej asaj çka kanë andrrue rilindasit tonë<sup>305</sup>.**

● Pohimi i Spahiut i cituar më lart, sipas të cilit krejt çka do të arrihej me bashkimin Kosovë-Shqipëri, do të arrihej përmes marrëdhënieve më të mira Kosovë-Shqipëri, së paku nuk qëndron plotësisht. Kjo, sepse me marrëdhënie të mira arrihet shumëçka, por me bashkim mund të arrihet më shumë se shumëçka. Prandaj kombi shqiptar në njërin anë është për marrëdhënie të mira Kosovë-Shqipëri, kurse në anën tjetër synon edhe bashkimin Kosovë-Shqipëri.

● Edhe pohimi tjetër i Spahiut i cituar më lart, sipas të cilit njohja e shtetit Kosovës nga 117 kombe të botës paraqet diçka që i tejkalon ëndrrat e rilindësve kombëtarë, po ashtu lë shumë për të dëshiruar. **E para**, shtetin e Kosovës nuk e kanë njohur 117 kombe të botës,

---

<sup>305</sup> Nexhmedin Spahiu në “Oksigjen”, pjesa e parë, 13.11.21:  
<https://www.youtube.com/watch?v=gmCJhoFX-Ps>

por e kanë njohur 117 shtete të botës, sepse kombet nuk njohin shtete, por shtetet njohin shtete. E **dyta**, rilindësit kombëtarë shqiptarë sado që do t'i gëzoheshin njohjes së shtetit të Kosovës nga 117 shtete të botës, ata sërish do ta synonin bashkimin e kombit shqiptar në një Shqipëri të vetme, për të gjithë shqiptarët në viset e tyre në Ballkan. Dhe kjo gjë tregon se shtetbërja e Kosovës nuk është diçka përtej asaj që kanë ëndërruar rilindësit, por është diçka më pak asaj që kanë ëndërruar rilindësit tonë.

### **Bashkimi Kosovë-Shqipëri nuk është shkuarje prapa, por është shkuarje kilometrike përpara**

Spahiu duke qenë i pozicionuar kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, ai ka shkruar edhe si në vijim:

■ **Kjo ....nuk do t'ishte mirë. Nuk dot ishte mirë që nga pasja e Prishtinës kryeqytet me shëndrrue atë në provincë, që mbetet prej kryeqytetit, ma larg se Kukësi. Kjo osht shkuarje mbrapa... Nuk osht ajo rrugë, e kanë provue njerëz ma t'mençem e ma t'zot se sa këta brezat, se Albin Kurti, Ramush Hajradini, Enver Hoxhaj. E ka provue Xhafer Deva dhe e ka pa që ajo nuk funksionon<sup>306</sup>. (ora 1:01:56 - 1:04:33)**

● Pohimi i Spahiut i cituar më lart, sipas të cilit bashkimi Kosovë-Shqipëri nuk është diçka e mirë dhe se ai bashkim do të ishte një shkuarje prapa, për mendimin tim nuk paraqet vetëm diçka të paqëndrueshme, por paraqet edhe diçka që është në kundërshtim me vetë synimet e të gjitha kombeve të ndara për bashkim.

● Deri më sot nuk njihet ndonjë politikan, sociolog ose filozof, që të ketë thënë se bashkimi i dy pjesëve të ndara të një kombi është diçka jo e mirë dhe shkuarje prapa, kurse mbetja e një kombi i ndarë në dy pjesë, qoftë edhe kur ato dy pjesë të atij kombi janë dy shtete të pavarura, është shkuarje përpara. Vetëm mendja e Spahiut mund të thotë se bashkimi i dy shteteve të të njëjtit komb jo vetëm se nuk qenka diçka e mirë, por edhe qenka shkuarje prapa.

● Pohimi i Spahiut, sipas të cilit bashkimi Kosovë-Shqipëri nuk

---

<sup>306</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio "Sharri" (Aktualitete - 30.03.2021): <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

është diçka e mirë dhe do të ishte një shkuarje prapa, të detyron të mendosh: Sa budallenj paskan qenë vietnamezët, kur ata në vitin 1975 kanë bashkuar dy Vietnamet në një Vietnam! Ose sa budallenj paskan gjermanët, kur në vitin 1990 kanë bashkuar dy Gjermanitë në një Gjermani të bashkuar! Ose sa budallenj qenkan koreanët, që synojnë bashkimin e dy Koreve në një Kore të bashkuar!

● Dhe çfarë të themi për kombin e madh kurd, i cili duke qenë i ndarë në katër shtete të ndryshme, po ashtu synon dhe gjakon bashkimin e tij në një Kurdistan të bashkuar! Bashkimi i kurdve në një shtet të bashkuar, nuk paraqet prapa- kthim por një para-kalim historik.

● Me fjalë të tjera, sikur bashkimi kombëtar (bashkimi Kosovë-Shqipëri) të ishte i panevojshëm, i dëmshëm dhe regresiv, siç na thotë Spahiu, atëherë këtë bashkim nuk do ta bënte kombi i ndarë gjerman dhe kombi i ndarë vietnamez, si dhe nuk do ta aspironte edhe kombi ndarë korean.

● Për mua dhe besoj edhe për shumicën dërmuese të shqiptarëve, bashkimi Kosovë-Shqipëri nuk është shkuarje prapa, siç thotë Spahiu, por është shkuarje kilometrike përpara.

● Siguria, vetëbesimi, vetëvlerësimi dhe mirëqenia ekonomike, që do të prodhonte bashkimi Kosovë-Shqipëri për të gjithë shqiptarët, do të ishin shumë herë më të mëdha se siguria, vetëbesimi, vetëvlerësimi dhe mirëqenia ekonomike, që prodhojnë Kosova dhe Shqipëria si dy shtete të ndara.

● Për mendimin tim, Spahiu bashkimin Kosovë-Shqipëri e sheh si shkuarje prapa, sepse ka frikë se po ndodhi ky bashkim, atëherë nuk do krijohet ai kombi i tij “kosovar”. Dhe Spahiu, sipas mendimit tim, e do krijimin e “kombit kosovar”, sepse mendon se po ndodhi krijimi i “kombit kosovar”, nuk do të ndodhë bashkimi Kosovë-Shqipëri.

● Për filozofët gjermanë, që gjatë shekujve XVIII-XIX kanë teorizuar për kombin/kombet, toka e Gjermanisë nuk ka qenë as perëndimore e as lindore, por ka qenë tokë e të gjithë gjermanëve, dhe kombi gjerman nuk ka qenë as perëndimor e as lindor, por ka qenë një komb gjerman i të gjithë gjermanëve. Filozofët gjermanë duke u nisur nga këto parime objektive dhe racionale për kombin,

e kanë ndihmuar shumë bashkimin e principatave gjermane në një Gjermani Monarkike Kushtetuese në vitin 1871 dhe, rrjedhimisht, e kanë ndihmuar shumë edhe bashkimin e dy Gjermanive në vitin 1990.

● Edhe intelektualët shqiptarë në Shqipëri dhe në Kosovë për ta ndihmuar bashkimin Kosovë-Shqipëri, duhet të bazohen në teoritë e filozofëve gjermanë për kombin, dhe nuk duhet të bazohen në teoritë franceze për kombin, të cilat duke qenë të përshtatshme për përshkrimin e krijimit të kombeve multietnike, nuk janë të përshtatshme për përshkrimin e krijimit të kombeve monoetnike, siç është edhe kombi shqiptar dhe shumë kombe të tjera në botë.

---

## KOSOVA DHE SHQIPËRIA DUKE QENË DY SHTETE SOVRANE KANË TË DREJTËN E BASHKIMIT NË NJË SHTET TË PËRBASHKËT SHQIPTAR

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se dy a më shumë shtete të veçanta dhe sovrane, që do të thotë se dy a më shumë shtete që nuk janë të përfshira brenda ndonjë shteti federal ose konfederal, janë shtete me sovranitet të plotë dhe, si të tilla, kanë të drejtën e bashkimit të tyre në një shtet të vetëm qoftë unitar, qoftë federal apo konfederal.

Por në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se kur shtetet e ndryshme të të njëjtit komb, shpesh multietnik, ndërsa janë të përfshira brenda shteteve të përbashkëta federale ose konfederale, ato nuk kanë sovranitet të plotë, por kanë sovranitet të kufizuar dhe, si të tilla, e kanë të kufizuar edhe të drejtën e bashkimit të tyre me shtete të tjera, jashtë federatave ose konfederatave brenda të cilave gjenden.

**Shtetet e të njëjtit komb nuk janë plotësisht sovrane, ndërsa janë pjesë e ndonjë shteti federal apo konfederal**  
Spahiu duke teorizuar për kombet dhe shtetet, ndër të tjera është shprehur edhe si më poshtë:

■ **Mund t'ket një komb që asht pronar i 50 shteteve, siç osht kombi amerikan, ose kombi gjerman, por ato nuk janë shtete**

### **sovrane<sup>307</sup>. (min. 30:27 -30:35)**

● Kombi amerikan është pronar i 50 shteteve, por ato 50 shtete nuk janë plotësisht sovrane, sepse një pjesë e sovranitetit të tyre individual e kanë të deleguar brenda sovranitetit të përbashkët Federal të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo është arsyeja pse asnjëri nga 50 shtetet e SHBA-së nuk ka të drejtë të bashkohet me ndonjë shtet tjetër jashtë SHBA-ve pa pajtimin e SHBA-ve.

● Gjermania e sotme përbëhet prej 16 landeve, të cilat edhe pse kanë elemente shtetërore, megjithatë nuk janë plotësisht sovrane, sepse një pjesë të sovranitetit të tyre individual e kanë të deleguar brenda sovranitetit federal Gjermanisë Federale. Kështu, asnjëra nga 16 landet e Gjermanisë nuk ka të drejtë të bashkohet me ndonjë shtet tjetër jashtë Gjermanisë Federale, pa pajtimin e Gjermanisë Federale.

### **Shtetet të njëjtit komb janë sovrane nëse**

#### **nuk janë pjesë e ndonjë shteti federal apo konfederal**

● Por dy a më shumë shtete të të njëjtit komb janë plotësisht sovrane, nëse ato nuk janë pjesë e ndonjë shteti federal ose konfederal, por janë dy a më shumë shtete të pavarura dhe të veçanta. Këto shtete të të njëjtit komb, duke qenë plotësisht sovrane, e kanë të drejtën e bashkimit të tyre në një shtet.

● Kështu, duke qenë se Gjermania Perëndimore dhe Gjermania Lindore dy shtete sovrane, ato kanë realizuar të drejtën e bashkimit të tyre në një Gjermani Federale, siç është Gjermania e sotme. Edhe Vietnami Verior dhe Vietnami Jugor, duke qenë dy shtete me sovranitet të plotë, po ashtu kanë realizuar të drejtën e bashkimit të tyre në një Vietnam të vetëm që e kemi sot. Dhe natyrisht edhe Koreja Veriore dhe Koreja Jugore, duke qenë dy shtete me sovranitet të plotë, e kanë të drejtën e bashkimit të tyre në një Kore të vetme.

### **Shqipëria dhe Kosova duke qenë dy shtete sovrane, kanë të drejtën e bashkimit të tyre në një Shqipëri të vetme**

● Edhe Shqipëria dhe Kosova duke qenë dy shtete sovrane e

<sup>307</sup> „Tirane-Prishtine: Ku gabuam?“ - Nexhmendin Spahiu dhe Ervis Iljazaj; “ABC News Albania”, 06.11.2021:

<https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

kanë të drejtën e bashkimit të tyre në një Shqipëri të vetme. Por, të drejtën e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë aktualisht e pamundëson Plani/Dokumenti i Ahtisarit, në saje të të cilit Kosova është shpallur shtet i pavarur. Sipas Planit/Dokumentit të Ahtisarit, shteti i Kosovës nuk mund t'i bashkohet një shteti tjetër, që do të thotë se nuk mund t'i bashkohet Shqipërisë. Por, si çdo gjë tjetër, edhe Dokumenti i Ahtisarit nuk është i përjetshëm. Kështu, nuk do të jenë të largëta kohët, kur e drejta e Kosovës dhe e Shqipërisë për bashkim nuk do të kontestohet prej askujt.

● Spahiu duke propaganduar krijim-ekzistimin e “kombit kosovar” në Kosovë, përpiqet që bashkimit Kosovë-Shqipëri t'i vërë sa më shumë pengesa teorike dhe hipotetike. Ai bën këtë, sepse mendon se, nëse shqiptarët do të mbeten të ndarë në dy shtete, mundësitë për t'u krijuar nga shqiptarët e Kosovës “kombi kosovar” ekziston, kurse nëse do të ndodhë bashkimi Kosovë- Shqipëri, mundësitë për krijimin nga shqiptarët e Kosovës “kombit kosovar” do të ishin zero.

### **Kosova do të jetë shtet i përjetshëm vetëm nëse nuk do të mund të bashkohet me Shqipërinë**

Spahiu duke qenë kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, ai është shprehur edhe si në vijim.

■ **Për çdo qytetar, për çdo patriot, shteti i Kosovës duhet me ekzistue për jetë. Shteti i Kosovës duhet me ekzistue për jetë edhe atëherë kur ska me eksizitue shteti i Serbisë, edhe atëherë kur shteti i Shqipnisë ska me ekzistue<sup>308</sup> (min. 18:48 -19:04)**

● Pajtohem me Spahiun që shteti i Kosovës duhet të ekzistojë për jetë, por me një kusht: shteti i Kosovës duhet të ekzistojë përjetësisht, vetëm nëse ai nuk do të mund të bashkohet asnjëherë me Shqipërinë. Shqiptarët e Kosovës dhe të Shqipërisë, për vetë faktin se i përkasin të njëjtit komb shqiptar, ata si edhe popujt e tjerë të ndarë në dy a më shumë njësi territoriale-shtetërore, kanë synuar dhe synojnë bashkimin e tyre kombëtar në një shtet të vetëm shqiptar.

---

<sup>308</sup> Nexhmedin Spahiu; *youtube, televizioni T7*, 30.11.2022:  
[https://www.youtube.com/watch?v=7FJ\\_XYeAm6c](https://www.youtube.com/watch?v=7FJ_XYeAm6c)

● Spahiu duke pohuar se **“Për çdo qytetar, për çdo patriot, shteti i Kosovës duhet me ekzistue për jetë”**, ai shqiptarëve të Kosovës u thotë se, për ta pasur ata Kosovën shtet të përhershëm, duhet ta kundërshtojnë patjetër bashkimin Kosovë-Shqipëri, si dhe tregon se ai ata shqiptarë, që krahas dëshirës që shteti i Kosovës të ekzistojë për jetë duan edhe bashkimin e saj me Shqipërinë, nuk i konsideron qytetarë patriotë. Por të kundërtën ka thënë historia: ajo ata shqiptarë që kanë luftuar për bashkimin Kosovë-Shqipëri, siç kanë qenë, p.sh., rilindësit kombëtarë shqiptarë, në kundërshtim me Spahiun, i ka fiksuar si pishtarë e patriotë të mëdhenj.

**Kosova në OKB do të jetë shteti i dytë i kombit shqiptar**  
Spahiu duke qenë kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri dhe pro krijimit të “kombit kosovar”, ka shkruar mëtej si në vijim:

■ **“Nëse ne nuk duam të jemi në Kombet e Bashkuara... atëherë ne s’oshtë dashtë ta shpallim pavarësinë fare, por është dashtë t’i bashkohemi Shqipërisë...<sup>309</sup>.”**

Sa i përket thënies së Spahiut të cituar më lart, dua të sqaroj lexuesit si më poshtë:

● Sikur Kosovës të mos i ishte ndaluar bashkimi me Shqipërinë nga ana e Planit/Dokumentit të Ahtisarit, ajo sigurisht që menjëherë pas pavarësimit të saj në vitin 2008, me dëshirë të flaktë do t’i bashkohej Shqipërisë. Edhe Shqipëria sikur Kosovës të mos i ishte ndaluar bashkimi me të nga ana e Planit/Dokumentit të Ahtisarit, edhe ajo menjëherë pas pavarësimit të Kosovës në vitin 2008, me dëshirë të flaktë do të bashkohej me Kosovën.

● Por, meqë Kosovës nuk iu lejua nga Bashkësia Nërcombëtare bashkimi me Shqipërinë, kjo ka bërë që jo vetëm shqiptarët e Kosovës, por edhe të gjithë shqiptarët tjerë në viset e tyre në Ballkan, të duan që Kosova të bëhet sa më shpejt vend anëtar i OKB-së. Kjo, sepse duke qenë Kosova shtet anëtar i OKB-së, ajo ndër të tjera e ka edhe të drejtën që të kërkojë bashkimin e saj me Shqipërinë.

---

<sup>309</sup> Nexhmedin Spahiu: *Kushtetuta e definon kombin kosovar* - të tillë e njohu Kosovën edhe SHBA-ja. *Balkan.Info*; 20 nëntor 2019 ora 22:35; <https://klankosova.tv/nexhmedin-spahiu-kushtetuta-e-definon-kombin-kosovar-te-tille-e-njohu-kosoven-edhe-shba/>

- Por, ndërsa shqiptarët duan që Kosova të bëhet shtet anëtar i OKB-së si shtet i dytë i kombit shqiptar, Spahiu dëshiron që Kosova të bëhet shtet anëtar i OKB-së si shtet i një kombi tjetër “kosovar”. Por, si mund të bëhet Kosova shtet i “kombit kosovar”, kur ky komb realisht dhe objektivisht nuk ekziston?!
- Duke pasur parasysh se OKB-ja është neutrale kundruall përbërjes etnike dhe kombëtare të shteteve që e aspirojnë anëtarësimin e tyre në OKB, kjo flet qartë se anëtarësimi i Kosovës në OKB nuk do të kushtëzohet me krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, përkatësisht kjo flet qartë se Kosova do të anëtarësohet në OKB si shtet i banuar me shumicën kombëtare shqiptare dhe me komunitetet e saj pakicë.
- Edhe përcaktimet e artikullit 4, kapitullit II të Kartës së kombeve të Bashkuara të dhëna në kapitujt 11, 12 dhe 13 të këtij libri, tregojnë qartë se OKB-ja e bënë anëtarësimin e shteteve pa i kushtëzuar ato me krijimin prej tyre të ndonjë komb të caktuar dhe të paqenë.

---

## **BASHKIMI KOSOVË-SHQIPËRI DO TË BËHET ME VULLNET TË LIRË DHE ME MARRËVESHJE MES SHQIPTARËVE TË KOSOVËS DHE TË SHQIPËRISË**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit lidhur me pohimin e Nexhmedin Spahiut, sipas të cilit bashkimi Kosovë-Shqipëri nuk mund të ndodhë, sepse sipas tij as Shqipëria nuk ka fuqi ta pushtojë dhe aneksojë Kosovën dhe as Kosova nuk ka fuqi ta pushtojë dhe aneksojë Shqipërinë. Por ky pohim i Spahiut nuk qëndron aspak, sepse sidomos në kohët e sotme (në shekullin XXI), asnjë shteti nuk i lejohet që ta pushtojë dhe aneksojë një shtet tjetër për t'u bashkuar me të. Por, Spahiu sipas të gjitha gjasave, ende nuk e ka kuptuar, se martesat me dhunë ka kohë që kanë marrë fund!

**Bashkimi Kosovë-Shqipëri nuk do të ndodhë  
me aneksime territoriale, por me vullnet e me  
marrëveshje mes shqiptarëve**

Spahiu duke qenë kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, ai është shprehur edhe si në vijim:

■ **Nëse ndodh bashkimi i shqiptarëve ja Shqipria do ta aneksoj Kosovën, ja Kosova do ta aneksoj Shqipërinë, njëra prej ktyne**

**do të ndodh. Por, nuk osht mirë të ndodh asnjëra prej tyre<sup>310</sup>.  
(ora 1:04:09 -1:04:19)**

● Pohimi i Spahiut i cituar më lart, sipas të cilit bashkimi Kosovë-Shqipëri do të mund të realizohej nëpërmjet pushtim-aneksimit të Kosovës nga Shqipëria, ose nëpërmjet pushtim-aneksimit të Shqipërisë nga Kosova, paraqet një pohim absurd. Kjo, sepse bashkimi Kosovë-Shqipëri do të bëhet me vullnet të lirë dhe me marrëveshje mes shqiptarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë, dhe nuk do të bëhet me aneksimin e Kosovës nga Shqipëria, apo me aneksimin e Shqipërisë nga Kosova, siç thotë mendësia kobsjellëse e Spahiut.

● Një bashkim Kosovë-Shqipëri duke pushtuar Shqipëria Kosovën, ose duke pushtuar Kosova Shqipërinë, edhe nëse ndodh, nuk do të ishte një bashkim i mirëfilltë, por do të ishte një bashkim i shoqëruar me tragjedi, i tillë siç ka qenë bashkimi tragjik i dy Vietnameve, ku Vietnami Verior pas një lufte shumëvjeçare pushtoi Vietnamin Jugor.

● Mendoj se Spahiu duke thënë se bashkimi Kosovë-Shqipëri do të bëhet ose duke aneksuar/pushtuar Shqipëria Kosovën, ose duke aneksuar/pushtuar Kosova Shqipërinë, ai kësisoj shqiptarët e Kosovës dhe shqiptarët e Shqipërisë i vendos para opsionit të vëllavrasjes dhe të gjakderdhjes, për t'i trembur dhe për t'i armiqësuar ata paraprakisht, me qëllim që ata vetë t'i kundërvihen bashkimit Kosovë-Shqipëri.

● Shqiptarët e Kosovës dhe të Shqipërisë duke i takuar të njëjtit komb shqiptar, bashkimi Kosovë-Shqipëri ka për të ndodhur me vullnet e dëshirë të shqiptarëve, ashtu siç ka ndodhur edhe bashkimi i dy Gjermanive, me vullnet e dëshirë të gjermanëve.

### **Bashkimi i vullnetshëm i dy shteteve të të njëjtit komb nuk paraqet pushtim të njërit shtet ndaj tjetrit**

Spahiu duke qenë kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, ai është shprehur edhe si në vijim:

---

<sup>310</sup> Tirane-Prishtine: Ku gabuam?" - Nexhmendin Spahiu dhe Ervis Iljazaj; *ABC News Albania*, 06.11.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

**Jo nuk bohet....sepse as nuk oshtë fuqi Shqipnija me pushtue Kosovën... as nuk ka fuqi Kosova me pushtue Shqiprinë. Kështuqë kjo asht ni gjo që nuk ndodh. Ajo çfarë mundet me ndodh osht që mi pas marrdhanjet e mira ose t'kqija<sup>311</sup>. (oramin.1:04:55 - 1:05:22)**

● Spahiu edhe brenda këtij pohimi thotë pothuajse të njëjtën gjë, që ka thënë edhe me thënien paraprake të cituar dhe të shqyrtuar më lart. Ai sërish e lidh pamundësinë e bashkimit Kosovë-Shqipërinë, me pafuqinë e Shqipërisë për ta pushtuar Kosovën dhe me pafuqinë e Kosovës për ta pushtuar Shqipërinë. Por kjo nuk qëndron aspak, sepse edhe sikur Shqipëria të kishte fuqi për ta pushtuar Kosovën, edhe sikur Kosova të kishte fuqi për ta pushtuar Shqipërinë, ato nuk do të bashkohen me fuqi pushtuese reciproke e me gjakderdhje ndërvëllazërore, por Shqipëria dhe Kosova do të bashkohen me fuqinë e dëshirës dhe të vullnet të lirë të shqiptarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë.

● Për mendimin tim, bashkimi Kosovë-Shqipëri ose ndodh me dëshirë e vullnet të lirë të shqiptarëve të të dyja anëve të kufirit shqiptaro-shqiptar, ose në të kundërtën s'ka për të ndodhur fare.

### **Bashkimi Kosovë-Shqipëri nuk do të ndodhë vetëm për përfitime ekonomike**

Më tej Spahiu bashkimin Kosovë-Shqipëri e lidh edhe me zhvillimin jo të barabartë ekonomik të tyre, duke thënë si në vijim:

■ **A mundet me ndodh bashkimi i Kosovës me Shqipninë? Bashkimi i Kosovës me Shqipninë mundet me ndodh vetëm nëse njani prej ktyne dy shtetve kollapson. Qysh mundet me ndodh? N'qoftëse për shembull Shqipnija përparon shumë, bohet shtet i fuqishëm, Kosova mbetet shtet katastrofë, edhe këta thojnë na s'po dim me bo shtet, thojnë hajde t'i bashkohemi Shqipërisë, ose ansjelltas, nëse Kosova përparon shumë e Shqipnija mbetet mbrapa, thotë a di çka? Hë! T'i bashkohemi Kosovës<sup>312</sup>. (min. 41:24 - 42:04)**

<sup>311</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio "Sharri" (Aktualitete - 30.03.2021): <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd70Q>

<sup>312</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio "Sharri" (Aktualitete - 30.03.2021);

● Është e vërtetë se, nëse Shqipëria do të ketë zhvillim të madh ekonomik, kjo do ta joshte Kosovë për t'iu bashkuar Shqipërisë. Por edhe nëse Kosova do të ketë zhvillim të madh ekonomik, kjo do ta joshte Shqipërinë për t'iu bashkuar me Kosovën. Por një joshje e tillë ekonomike reciproke paraqet vetëm njërin nga faktorët e shumtë, që do të çonte në bashkimin Kosovë-Shqipëri, por nuk paraqet faktorin kryesor të bashkimit Kosovë-Shqipëri.

### **Faktor kryesor për bashkimin Kosovë-Shqipëri**

#### **ka qenë dhe është përkatësia e njëjtë kombëtare shqiptare**

● Faktor kryesor për bashkimin Kosovë-Shqipëri ka qenë dhe do të jetë përkatësia e njëjtë kombëtare shqiptare e shqiptarëve të Kosovës dhe e shqiptarëve të Shqipërisë. Kjo përkatësi e përbashkët kombëtare në mënyrë të natyrshme e ka nxituar dhe do ta nxisë vazhdimisht dëshirën dhe vullnetin e shqiptarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë për bashkim.

● Përkatësia e përbashkët kombëtare shqiptare është ajo, e cila nxit bashkimin Kosovë-Shqipëri edhe nëse Kosova e Shqipëria do të ishin dy vende njësoj të varfra ose njësoj të pasura, ose edhe kur njëra do të ishte më e pasur se tjetra.

● Kosova (shqiptarët e Kosovës) në mungesë të përkatësisë kombëtare të përbashkët me serbët, bullgarët e të tjerët, nuk do t'i bashkohej as Serbisë e as Bullgarisë, edhe nëse këto dy vende do të kishin zhvillim ekonomik dhjetë herë më të madh se Shqipëria.

● Spahiu pikërisht për ta shkatërruar përkatësinë e përbashkët kombëtare shqiptare të shqiptarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë, tanimë për 25 vjet propagandon ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe: në komb shqiptar në Shqipëri dhe në “komb kosovar në Kosovë”, ndarje kjo e cila do ta pamundësonte bashkimin Kosovë-Shqipëri.

### **Roli i Bashkësisë Ndërkombëtare në bashkimin Kosovë-Shqipëri**

● Por faktori i dytë kryesor për bashkimin Kosovë-Shqipëri do

të jetë Bashkësia Ndërkombëtare. Pa lejen e të cilës nuk do të mund të bëhej bashkimi Kosovë-Shqipëri. Aktualisht Bashkësia Ndërkombëtare, për të ruajtur paqen në rajonin e Ballkanit, nuk është për bashkimin Kosovë-Shqipëri.

● Por kjo nuk duhet t'i dëshpërojë shqiptarët, sepse nuk janë të largëta kohët kur Bashkësia Ndërkombëtare jo vetëm që do ta lejojë bashkimin Kosovë-Shqipëri, por për shkaqe objektive, racionale dhe pragmatike edhe do ta ndihmojë këtë bashkim.

\*\*\*

### **Spahiu i kërcënon me burg ata që thonë se Kosova dhe Shqipëria duhet të bashkohen**

● Spahiu është aq shumë kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, sa që kërcënon me burg ata që thonë se Kosova e Shqipëria duhet të bashkohen.

● Kështu, Spahiu në emisionin "Politiko" në televizionin TV-10, të datës 25. 11. 2024, i është kundërvënë deputetit të *Vetëvendosjes*, Haki Abazit, duke i thënë se ai do të duhej të dënohej me burgim, sepse ka thënë që Kosova duhet t'i bashkohet Shqipërisë, si dhe ka thënë se ai do t'i luftojë edhe me armë ata që Kosovën duan t'ia bashkojnë Shqipërisë.

---

## AMZA E PËRBASHKËT E KOMBIT SHQIPTAR E LEGJITIMON TË DREJTËN E BASHKIMIT KOSOVË-SHQIPËRI

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se Shqipëria dhe Kosova, duke qenë dy shtete të të njëjtit komb shqiptar, amësia e shqiptarëve të Kosovës shtrihet nga Kosova drejt Shqipërisë, dhe amësia e shqiptarëve të Shqipërisë shtrihet nga Shqipëria drejt Kosovës, dhe se është një amësi e tillë e përbashkët e shqiptarëve, është ajo që u jep atyre të drejtën e patjetërsueshme të bashkimit Kosovë-Shqipëri.

### **Amësia e përbashkët e kombit shqiptar shtrihet nga Kosova në Shqipëri dhe nga Shqipëria në Kosovë**

Spahiu duke teorizuar lidhur me amësinë e shqiptarëve të Kosovës është shprehur edhe si në vijim:

■ **Por tash me krijimin e shtetit të Kosovës mo shtet amë e kemi Kosovën, nuk e kem mo shtet amë Shqipërinë**<sup>313</sup>. (min. 30:59 - 31:10)

● Edhe pse thënia e Spahiut e cituar më lart, sipas së cilës pas pavarësimit të Kosovës në vitin 2008, shqiptarët e Kosovës vend

---

<sup>313</sup> Nexhmedin Spahiu, *youtube, televizioni T7*, 30.11.2022:  
[https://www.youtube.com/watch?v=7FJ\\_XYeAm6c](https://www.youtube.com/watch?v=7FJ_XYeAm6c)

amë kanë Kosovën dhe jo Shqipërinë *de jure* dhe në parim qëndron, megjithatë, gjërat nuk qëndrojnë plotësisht, siç thotë Spahiu.

● Për vetë faktin se shqiptarët e Kosovës dhe të Shqipërisë paraqesin të njëjtin komb shqiptar, kjo *de fakto* tregon se amësia kombëtare e shqiptarëve të Kosovës shtrihet nga Kosova drejt Shqipërisë, kurse amësia kombëtare e shqiptarëve të Shqipërisë shtrihet nga Shqipëria drejt Kosovës.

● Është amësia e përbashkët e shqiptarëve të Shqipërisë dhe të Kosovës, ajo që u jep atyre të drejtën e patjetërsueshme për bashkimin Kosovë-Shqipëri, kuptohet kur të krijohen rrethanat që do ta mundësonin këtë bashkim.

### **Kosova edhe sikur të mos e kishte Shqipërinë, do të duhej t'i lutej Zotit që ta kishte!**

● Duke pasur parasysh se pavarësia e Kosovës kundërshtohet ashpër nga Serbia deri edhe me kërcënime pushtuese, duke pasur parasysh se Kosova ende nuk njihet edhe nga pesë vende të Bashkimit Europian, dhe duke pasuar parasysh se kundër shtetbërjes së saj janë edhe dy superfuqi botërore, siç janë Kina e Rusia, Kosova edhe sikur të mos kishte një shtet vëlla si Shqipëria, do të duhej t'i lutej Zotit që ta kishte!

● Duke pasur parasysh rrethanat e rrezikshme, brenda së cilave gjendet Kosova, ajo *de fakato* ende ka nevojë për Shqipërinë qoftë si vend amë, qoftë si vend vëlla. Pa Shqipërinë nuk do të mund të kishte Luftë Çlirimtare të Kosovës dhe, për rrjedhojë, nuk do të kishte as Kosovë të lirë dhe të pavarur.

● Nëse mua do të pyeste dikush se cili është shqiptari më i çmendur e më budalla i Kosovës, përgjigjja ime do të ishte se shqiptari më i çmendur dhe më budalla i Kosovës, do të ishte ai shqiptar që shan, mohon dhe e urren Shqipërinë!

● Edhe shqiptari më i keq i Shqipërisë gjatë luftës së Kosovës me Serbinë, shqiptarit të Kosovës ia ka hapur derën e shtëpisë!

**Nëse krijohet “kombi kosovar”, pakicat shqiptare në shtetet fqinje shtet amë do të kenë Shqipërinë dhe jo Kosovën**

Spahiu duke teorizuar lidhur me pakicat shqiptare në vendet fqinje, ai është shprehur edhe si më poshtë:

■ **Kosovën dhe Shqipërinë i kanë shtete amë shqiptarët ku janë minoritete si n’ Luginë t’ Preshevës, në Mal të Zi, n’ Maqedoni. Ata duhet me i respektu njisoj si flamurin e Kosovës si flamurin e Shqipërisë...<sup>314</sup>. (min. 31:10 - 31:22)**

● Lidhur me thënien e Spahiut të cituar më lart, dua të sqaroj lexuesit se, nëse nga shqiptarët e Kosovës vërtet do të krijohet “kombi kosovar”, atëherë siç kam cekur edhe në një kapitull tjetër, del se meqë Kosova do t’i takonte “kombit kosovar”, ajo si e tillë nuk mund të jetë më vend amë i pakicave kombëtare shqiptare në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës në jug të Serbisë, sepse ato i përkasin kombit shqiptar dhe jo “kombit kosovar”.

● Thënë me fjalë të tjera, po u krijua në Kosovë “kombi kosovar”, pakicat kombëtare shqiptare në vendet fqinje vend amë do të kenë vetëm Shqipërinë, sepse ajo i përket kombit shqiptar, dhe jo Kosovën, që i përket një kombi tjetër “kosovar”.

---

<sup>314</sup> Nexhmedin Spahiu, *youtube televizioni T7*, 30.11.2022 [https://www.youtube.com/watch?v=7FJ\\_XYeAm6c](https://www.youtube.com/watch?v=7FJ_XYeAm6c)

---

## SHQIPËRIA KURRË NUK ËSHTË DEKLARUAR KUNDËR BASHKIMIT KOSOVË-SHQIPËRI: KOSOVA EDHE PAS PAVARËSIMIT TË SAJ E DO BASHKIMIN ME SHQIPËRINË

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se Shqipëria, në kundërshtim me ato që thotë Spahiu, kurrë nuk është deklaruar kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, kurse Kosova edhe pas pavarësimit të saj e do bashkimin me Shqipërinë.

Shqipëria prej vitit 1913 kur është njohur shtet i pavarur e këtëj, edhe përkundër rrethanave të pafavorshme e ka dëshiruar përherë bashkimin e saj me Kosovën dhe viset tjera shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës në Jug të Serbisë.

### **Spahiu dëshirën e tij për mosbashkim përpiqet t'ia veshë Shqipërisë**

Spahiu duke qenë kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri është shprehur si në vijim:

■ ...kur ke thonë po du mu bashku me Shqipnin, ata n'Shqipni ka thon jo valla si kemi punët mu bashku.... Shqipria nuk don edhe sot e kësaj dite mu bashkue. Nuk don se thjeshtë kjo Shqipni, ky komb që u ndërtue që 100 vjet... u krijue në mënyrë të mundimshme me baraspesha shumë të brishta, shumë të ndjeshme n 'mes të jugut e veriut, n 'mes të myslimanve, katolikve, ortodoksëve e bektashinjve, n 'mes

**anës kontinentale, anës bregdetare... Të gjithë këta ekuilibra ju ka dasht 100 vjet me i komponu. Për ni moment po don me ia shtu ni territor, po do me ia shtue një popullsi... Ai po ndihet i rrezikum. Qata ekuilibra a di po ndihen t'rrezikum. Prandaj ata thojnë mirë janë, janë shumë t'kanqun qi Kosova me konë shtet, nuk duen që me ju përzie, t'i me shuke me votue atje për Salih Berishën<sup>315</sup>. (min. 30:50 - 32:11)**

● Thënia e Spahiut cituar më lart, sipas së cilës Shqipëria e paska refuzuar bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, nuk është tjetër, veçse një thënie e trilluar prej tij për qëllime fund e krye destruktive. Shqipëria nuk është deklaruar asnjëherë se nuk e do bashkimin me Kosovën, ngase asaj (Shqipërisë) do t'i prisheshin ekuilibrat e brendshëm, siç mundohet të na bindë Spahi.

● *Pse Spahi u ia vesh Shqipërisë mosdëshirën e tij për bashkimin Kosovë-Shqipëri?* Për mendimin tim, ai e bën këtë, për t'i dëshpëruar sa më shumë shqiptarët e Kosovës, sikur gjoja Shqipëria nuk e paska dashur dhe nuk e dashka bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.

● Shqipëria derisa Kosova ka qenë pjesë e Jugosllavisë, nuk e ka kërkuar publikisht bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, sepse kjo kërkesë asokohe nuk ka mundur të realizohej, dhe vetëm sa do t'i përkeqësonte edhe më shumë të drejtat e shqiptarëve brenda Jugosllavisë.

● Shqipëria edhe tani nuk e kërkon publikisht bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, sepse me këtë kërkesë ende nuk pajtohet Bashkësia Ndërkombëtare. Por Shqipëria bashkimin me Kosovën e ka kërkuar shumë herë tërthorazi, si në të kaluarën, kur ajo ka qenë një vend socialist, ashtu edhe në këto tri dekadat e fundit, kur ajo është një vend demokratik.

● Se Shqipëria nuk ka hequr dorë nga bashkimi i mundshëm Kosovë-Shqipëri, flet edhe fakti, se bashkimin Kosovë-Shqipëri në këto tri dekadat e fundit e kanë përmendur publikisht si mundësdy kryeministra të Shqipërisë, Sali Berisha dhe Edi Rama, si dhe e kanë perënduar publikisht edhe dy presidentë të Shqipërisë, Alfred Moisiu dhe Bujar Nishani.

---

<sup>315</sup> Debat i nxehtë "Kombi kosovar" me Nexhmedin Spahiun, *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

## **Kosova edhe pas pavarësimit të saj e do bashkimin me Shqipërinë**

● Ka plot indikatorë, të cilët flasin se shqiptarët e Kosovës edhe pas çlirimit dhe pavarësimit Kosovës në vitin 2008, e duan bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Ëndrra e shqiptarëve të Kosovës për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë nuk ka vdekur me t'u shpallur Kosova shtet i pavarur në vitin 2008. Kjo ëndërr do të jetojë për aq kohë sa do të ketë shqiptarë mbi tokë.

● Përdorimi masiv i flamurit dhe i himnit kombëtar shqiptar, si dhe festimi i ditës së flamurit kombëtar shqiptar nga ana e shqiptarëve të Kosovës çdo 28 Nëntor, këngët popullore të Kosovës, në të cilat kërkohet bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, bashkë me deklaratimet e shqiptarëve të Kosovës në përditshmëri në favor të bashkimit Kosovë-Shqipëri, paraqesin vetëm një pjesë të vogël të indikatorëve që flasin se Kosova, edhe pas pavarësimit të saj, e do bashkimin me Shqipërinë.

● Spahiu duke qenë i vetëdijshëm për dëshirën e shqiptarëve të Kosovës për bashkimin Kosovë-Shqipëri, përpiket që ta parandalojë këtë bashkim, duke propaganduar tanimë për më shumë se dy dekada krijimin nga shqiptarët e Kosovës, sipas tij, të “kombit kosovar”, si dhe duke u thënë shqiptarëve të Kosovës, se Shqipëria nuk e ka dashur dhe nuk e do bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.

## **Shqipëria dhe Kosova janë një vend me dy shtete**

● Shqipëria dhe Kosova si në planin etnik, ashtu edhe në planin historik, politik dhe demografik, deshi apo nuk deshi Spahiu paraqesin një vend të vetëm të ndarë në dy shtete: në Shqipëri dhe në Kosovë. Kështu, kur shqiptarët flasin për Shqipërinë dhe Kosovën, duhet të shprehen me “dy shtetet tona”, por nuk duhet shprehen me “dy vendet tona”, sepse Kosova dhe Shqipëria janë i njëjti vend i ndarë dy shtete: në shtetin e Shqipërisë dhe në shtetin e Kosovës.

## **Spahiu e deformon domethënien e tubimit me lajtmotivin: “Një komb, një qëndrim!”**

● Ndërsa forcat serbe në pranverën e vitit 1999 po i përzinin shqiptarët në shifra kolosale nga Kosova, duke i deportuar ata në

masë të madhe në Shqipëri, në Tiranë më 5 shkurt të vitit 1999 në sheshin “Skënderbe”, është mbajtur një tubim i madh popullor në mbështetje të Kosovës me moton “Një komb - një qëndrim”. Në atë tubim, në të cilin përveç presidentit Rexhep Mejdani, fjalën e ka marrë edhe Sali Berisha, asokohe në opozitë, u kërkuar që tërë kombi shqiptar të mbante të njëjtin qëndrim mbështetës ndaj Kosovës. Por ndryshe e komenton domethënien e atij tubimi Spahiu, duke thënë si në vijim:

■ **Nji komb, nji gjak, nji qëndrim, n’Shqipëri unë jom kon atëherë, kur u mbajt ai tubim. Ajo e ka pas konotacionin se n’Shqipëri socialistë e demokratë jemi ni komb dhe duhet me pas të njëjtin qëndrim ndaj vëllazërve tonë n’Kosovë, ndaj vllazërve ton t’gjakut, dhe nuk e ka pas kuptimin se na jemi nji komb si shqiptarët n’Kosovë, si shqiptarët n’Shqipni**<sup>316</sup>. (min. 47:46 - 48:23)

### **Thënia “një komb - një qëndrim” ka pasur të bëjë me të gjithë shqiptarët në Ballkan**

● Lidhur me tubimin me moto “Një komb - një qëndrim”, i mbajtur në sheshin qendror të Tiranës në shkurtin e vitit 1999, dua t’i sqaroj lexuesit, se ai tubim nuk ka pasur vetëm kuptimin se në Shqipëri socialistë e demokratë janë një komb dhe duhet të kenë të njëjtin qëndrim mbrojtës ndaj vëllazërve të tyre të Kosovës, siç na thotë Spahiu, por ka pasur edhe kuptimin se të gjithë shqiptarët në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në Çamëri, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës në Serbi, janë i njëjti komb, i cili duhet të ketë një qëndrim të vetëm në mbrojtje të vëllazërve të tyre të Kosovës, të cilët po gjenocidizoheshin nga Serbia nazifashiste e Millosheviqit.

● *Por, pse Spahiu ia mohon atij tubimi pikërisht kuptimin gjithëpërfshirës, duke thënë se ai tubim ka pasur vetëm kuptimin se në Shqipëri socialistë e demokratë janë i njëjti komb shqiptar, dhe nuk e ka pasur kuptimin se shqiptarët janë i njëjti komb si në Shqipëri,*

<sup>316</sup> Debat i nxehtë „Kombi kosovar“ me Nexhmedin Spahiun. *Valamala Show* me moderator Valon Malokun. Më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

*ashtu edhe në Kosovë?* Për mendimin tim, ai i mohon atij tubimi karakterin gjithëpërfshirës e gjithëshqiptar, për të aluduar se shqiptarët e Kosovës nuk i përkasin të njëjtit komb shqiptar, si edhe shqiptarët e Shqipërisë, por i përkasin një kombi tjetër joshqiptar të emërtuar prej tij si “komb kosovar”.

● Por në atë tubim shqiptarët e Kosovës jo vetëm që janë konsideruar komb shqiptar, por janë konsideruar edhe si **epiqendra e kombit shqiptar**. Udhëheqësit kryesorë politikë të Shqipërisë dhe qytetarët e Tiranës ishin tubuar për të shfaqur mbështetjen e tyre unike ndaj pjesës së kombit shqiptar në Kosovë, dhe jo për të shfaqur mbështetjen e tyre unike ndaj ndonjë “kombi kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues. Qëllimet e tilla të shenjta të atij tubimi nuk do të duhej t’i deformonte kaq paturpësisht Spahiu.

● Por Spahiu duke qenë ekstremisht kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, nuk ka lënë e nuk lë mjet pa përdorur kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri. Shpresoj që bashkimi Kosovë-Shqipëri të mos ndodhë sa është gjallë Spahiu, sepse po të ndodhë sa është gjallë, ai do të pëlcasë si kokrra e kripës në zjarr!

● Duke u nisur nga ato që Spahiu ka shkruar e thënë, del se ai ka dy misione jetësore: misionin e tjetërsimit të shqiptarëve të Kosovës në “komb kosovar”, dhe misionin e pengimit të bashkimit Kosovë-Shqipëri.

## **BASHKIMI KOSOVË-SHQIPËRI DO TË JETË KRYEFITORJA HISTORIKE E TËRË KOMBIT SHQIPTAR NË VISET E TIJ NË BALLKAN**

Në këtë kapitull dua t'i njoftoj lexuesit lidhur me pohimet, për mua destruktive të Spahiut, sipas të cilave me rastin e bashkimit Kosovë-Shqipëri, Kosova dhe shqiptarët e Kosovës do të humbnin gjithçka. Por, me rastin e bashkimit Kosovë-Shqipëri jo vetëm që nuk humb askush asgjë, por do të fitonin të gjithë shqiptarët në viset e tyre në Ballkan. Kjo, sepse bashkimi Kosovë-Shqipëri e fuqizon shumëfish kombin shqiptar në të gjitha aspektet e mundshme.

### **Bashkimi Kosovë-Shqipëri do të jetë kryefitorja historike e kombit shqiptar në Ballkan**

Spahiu duke qenë kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, ai është shprehur si në vijim:

■ **Nëse Shqipëria e Kosova bashkohen shuhet një komb, m'varet kush bohet kryeqytet shuhet ai komb. Nëse Prishtina bëhet kryeqytet shuhet ky kombi këndej...nëse Tirana bohet kryeqytet atëherë shuhet ai kombi... Kjo nuk do me thonë se ata njerëz vdesin, sepse ata janë të njëjtit njerzë, kanë t'njëjtën etni, por ai si komb fillon mos me ekzistue: nuk ke me e pas mo kombëtaren e Kosovës në Ligën e Kombeve, nuk ka me pas**

**mo Kosova për shembull Ministri të Jashtme ...<sup>317</sup>. (min. 31:30 - 32:08)**

● Spahiu duke e interpretuar bashkimin Kosovë-Shqipëri si një humbje të madhe të Kosovës në shumë drejtime, ai për mendimin tim dëshiron që t'i trembë shqiptarët e Kosovës nga bashkimi i Kosovës me Shqipërinë. Spahiu duke thënë se me rastin e bashkimit Kosovë-Shqipëri, Kosova humb gjithçka, ai me fjalë të tjera u thotë shqiptarëve të Kosovës: “Ikni nga shqiptarët e Shqipërisë dhe nga vetë Shqipëria, siç ikën djalli nga temjani”!

● Duke pasur parasysh se shqiptarët e Kosovës dhe të Shqipërisë i përkasin të njëjtit komb shqiptar, ata pas bashkimit Kosovë-Shqipëri nuk kanë nevojë që të kenë anëtarësim të dyfishtë si dy shtete të ndara në OKB; nuk kanë nevojë të kenë dy kombëtare të futbollit në Ligën e Kombeve; nuk kanë nevojë që të kenë dy Teatro Kombëtare e dy Biblioteka Kombëtare, si dhe nuk kanë nevojë që të kenë edhe dy Ministri të Jashtme.

● Përkundrazi, pas bashkimit Kosovë-Shqipëri shqiptarët e Kosovës dhe të Shqipërisë kanë nevojë që të kenë anëtarësim të Shqipërisë së Bashkuar në OKB; kanë nevojë të kenë një kombëtare të përbashkët të futbollit në Ligën e Kombeve; kanë nevojë të kenë një Teatër Kombëtar dhe një Bibliotekë Kombëtare të përbashkët, si dhe kanë nevojë të kenë edhe një Ministri të Jashtme të përbashkët.

● Duke qenë institucionet e lartpërmendura edhe të shqiptarëve të Kosovës, edhe të shqiptarëve të Shqipërisë, kjo tregon se me rastin e bashkimit Kosovë-Shqipëri jo vetëm që nuk humb askush asgjë, por edhe fitojnë të gjithë shqiptarët, kudo që jetojnë në viset e tyre në Ballkan.

● Kështu, pas bashkimit Kosovë-Shqipëri shqiptarët e bashkuar do të jenë një komb më i fuqishëm seç janë: do të kenë një Atdhe të përbashkët më të gjerë, më të madh, më të pasur e më të larmishëm; shqiptarët e Kosovës do të bëhen me det të vet; resurset e bashkuara natyrore të Kosovës e të Shqipërisë, kombit të bashkuar shqiptar, do t'i japin një ngritje më të madhe ekonomike

---

<sup>317</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“, Nexhmendin Spahiu dhe Ervis Iljazaj; *ABC News Albania*, 06.11.2021; <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

seç i japin aktualisht; fushat e Kosovës dhe ato të Myzeqesë në Shqipëri do ta furnizonin kombin e bashkuar shqiptar më të gjitha të mirat: me drithëra, pemë e perime; Bjeshkët e Kosovës dhe të Shqipërisë do të ofronin kullota për miliona kokë bagëti.

● Me rastin e bashkimit Kosovë-Shqipëri, mendësia e përbashkët e kombit shqiptar do të triumfonte mbi mendësitë lokale-krahinore, duke shpërthyer me arritje të ndryshme: Kombi i Bashkuar Shqiptar do të bëhej një komb më sovran e më i fuqishëm, për t'u bërë ballë edhe më suksesshëm, ta zëmë ndërhyrjeve armiqësore të Rusisë apo të aleatëve të saj në Ballkan, siç janë Serbia e Greqia; rëndësia gjeostrategjike dhe gjeopolitike e kombit të bashkuar shqiptar do të ishte shumë më e madhe si në raport me vendet fqinje antishqiptare, ashtu edhe në raport me Fuqitë e Mëdha.

● Duke pasur parasysh të gjitha këto, s'ka dyshim se bashkimi Kosovë-Shqipëri do të jetë kryefitorja historike e kombit shqiptar në viset e tij në Ballkan.

### **Shtetet e ndryshme e kanë njohur Kosovën si shtet me shumicë kombëtare shqiptare dhe jo si shtet me shumicë “kombëtare kosovare”**

Spahiu në vazhden e kundërshtive të tij ndaj bashkimit Kosovë-Shqipëri është shprehur edhe si në vijim:

■ **Nëse thon se s'jemi komb, atëherë automatikisht kjo bon që Kosovës t'ja hjekun krejt ambasadat prej ktushit. Sepse nëse ti e shpallë vetën se s'je komb, ti s'je as shtet. Nëse s'je komb s'mujsh me pas ambasada. ...Pa qenë komb nuk mundish me pas ambasada**<sup>318</sup>. (min. 56:10 -56:36)

● Spahiu në pohimin e tij të cituar më lart jo vetëm në këtë kapitull, por edhe në njërin nga kapitujt pararendës, na thotë se: “Nëse shqiptarët e Kosovës thonë se nuk janë komb, atëherë shtetet e ndryshme që e kanë njohur shtetin e Kosovës ia heqin Kosovës ambasadat nga Prishtina”!

● Shtrohet pyetja: *Kush nga shqiptarët e Kosovës po thotë se s'jemi*

---

<sup>318</sup> Nexhmedin Spahiu, Shteti dhe kombi kosovar, radio “Sharri” (Aktualitete - 30.03.2021); <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>.

*komb, që Spahiu ynë alarmohet kaq shumë?* Askush nga shqiptarët e Kosovës nuk ka thënë e nuk thotë se s'jemi komb. Përkundrazi, të gjithë shqiptarët e Kosovës kanë thënë e thonë se janë komb shqiptar, siç kanë qenë shekuj me radhë. Dhe meqë shqiptarët e Kosovës thonë se janë komb, atëherë shtetet e huaja s'kanë pse t'ia heqin Kosovës ambasadat nga Prishtina.

● Por thënia e Spahiut: **“Nëse thon se s'jemi komb, atëherë Kosovës ia hjekun krejt ambasadat prej ktushit”** e ka një bisht prapa. Kjo, sepse Spahiu me fjalën “komb” nënkupton “kombin kosovar”, realisht joekzistues, dhe nuk e nënkupton kombin shqiptar, realisht ekzistues.

● Spahiu duke thënë se: “Nëse shqiptarët e Kosovës thonë se s'janë komb, atëherë shtetet që e kanë njohur shtetin e Kosovës ia heqin Kosovës ambasadat”, ai na thotë se, nëse shqiptarët e Kosovës thonë se nuk janë “komb kosovar”, atëherë shtetet që e kanë njohur shtetin e Kosovës, ia heqin Kosovës ambasadat. Por kjo nuk qëndron aspak, sepse shtetet e ndryshme Kosovën me kohë e kanë njohur si shtet me shumicë kombëtare shqiptare dhe nuk e kanë njohur si shtet me shumicë “kombëtare kosovare”, realisht joekzistuese.

● Shtetet që e kanë njohur shtetin e Kosovës nuk i heqin ambasadat e tyre nga Prishtina, pa marrë parasysh nëse shqiptarët e Kosovës deklarohen si komb shqiptar apo si “komb kosovar”, ose edhe si ndonjë komb tjetër, që nesër mund t'i bie ndër mend dikujt tjetër.

● Kështu, edhe pse dihet publikisht dhe zyrtarisht se shqiptarët e Kosovës i përkasin kombit shqiptar dhe nuk i përkasin “kombit kosovar”, asnjë shtet që e ka njohur shtetin e Kosovës nuk e ka hequr ambasadën e tij nga Prishtina.

### **Pas bashkimit Kosovë-Shqipëri, ambasadat të vendosen në kryeqytetin e Shqipërisë së Bashkuar**

Në pyetjen e moderatorit A. K. nga një televizion i Tiranës drejtuar Spahiut: *Pse ju e shihni si problem bashkimin e Kosovë-Shqipëri?* - Spahiu është përgjigjur si në vijim:

■ **Bashkimi nuk osht interes as i Kosovës as i Shqipnisë. Kosova e Shqipnija kanë interes me bashkpunu, me pas mardhanje**

t'mira njona me tjetrën, mos me pas probleme me njona-tjetrën, me pas ekonomi, tregti, kulturë ...Por nuk ka nevojë për shembull me ju thon ambasadave në Prishtinë, mbyllni ktu ambasadat se i kemi ambasadat në Tiranë... Me t'njoftë 117 kombe t'botës dhe ti ju thotë: Jo, faliminderit se spo na duheni mo...Ose nëse ndodh që Prishtina mbetet kryeqyteti i qati shteti t'bashkum, edhe n'Tiranë me ju thonë ambasadave ikni se s'so mo Tirana kryeqytet... Këto nji popull normal nuk e bon sepse me arrit njohjen osht punë e madhe...<sup>319</sup>. (min. 21:41 - 22:51)

● Nga pohimet e mësipërme të Spahiut, del se ai nuk është për bashkimin Kosovë-Shqipëri, sepse nëse Tirana do të bëhej kryeqytet, ambasadat e vendeve të ndryshme do të mbylleshin në Prishtinë për t'u vendosur në Tiranë, kurse nëse Prishtina do të bëhej kryeqytet, ambasadat e vendeve të ndryshme do të duhej të mbylleshin në Tiranë për t'u vendosur në Prishtinë.

● Por bashkimi Kosovë-Shqipëri, më së paku, do të ishte problem ambasdash. Nëse Kosova dhe Shqipëria duan të bashkohen në një shtet të vetëm, dhe nëse bashkimi i tyre lejohet nga Bashkësia Ndërkombëtare, vendet e ndryshme të botës ambasadat e tyre pa asnjë problem do t'i vendosnin qoftë në Prishtinë, qoftë në Tiranë. Po të ishte bashkimi Kosovë-Shqipëri problem ambasdash, ky bashkim do të realizohej menjëherë pas pavarësisimit të Kosovës në vitin 2008.

### **Në Tiranë ambasadat, në Prishtinë konsullatat**

● Pas bashkimit Kosovë-Shqipëri, shtetet që do ta njohin shtetin e bashkuar shqiptar, nëse Tirana do të ishte kryeqyteti i Shqipërisë së Bashkuar, vendet e ndryshme ambasadat e tyre do t'i vendosnin në Tiranë, kurse konsullatat e vendeve të tyre do t'i vendosnin në Prishtinë. Kështu, askush nga Kosova nuk do të ishte i detyruar që, për të marr një vizë udhëtimi, të shkojë në Tiranë, sepse vizat do të jepen edhe nga konsullatat e vendeve të ndryshme të vendosura

---

<sup>319</sup> Nexhmedin Spahiu, *youtube, televizioni T7*, 30.11.2022;  
[https://www.youtube.com/watch?v=7FJ\\_XYeAm6c](https://www.youtube.com/watch?v=7FJ_XYeAm6c)

në Prishtinë. Edhe lidhjet ekonomike dhe tregtare të Kosovës me vendet e ndryshme do të rregulloheshin nëpërmjet të konsullatave të vendeve të ndryshme të vendosura në Prishtinë.

### **Bashkimi Kosovë-Shqipëri paraqet normalitet dhe jo anormalitet**

- Spahiu gabon rëndë kur thotë, se një popull normal nuk u thotë ambasadave të huaja që të mbyllen në Prishtinë, për t'u vendosur në Tiranë, ose që të mbyllen në Tiranë, për t'u vendosur në Prishtinë. Sipas këtij pohimi të Spahiut, del se populli gjerman nuk paska qenë normal, kur me rastin e bashkimit të dy Gjermanive në vitin 1990, ka bërë që vendet e ndryshme të botës t'i zhvendosin ambasadat tyre nga Berlina Lindor i Gjermanisë Lindore, në Berlinin Perëndimor të Gjermanisë Perëndimore.
- Dhe po sipas pohimit të mësipërm të Spahiut, del se edhe populli vietnamez nuk paska qenë normal, kur ai me rastin e bashkimit të dy Vietnameve në vitin 1975, ka bërë që vendet e ndryshme ambasadat e tyre t'i heqin nga kryeqyteti Sajgon i Vietnamit Jugor, për t'i vendosur ato në kryeqytetin Hanoi të Vietnamit Verior.
- Dhe po sipas pohimit të mësipërm të Spahiut, del se edhe populli shqiptar do të jetë një popull jonormal, kur ai me rastin e bashkimit Kosovë-Shqipëri, do të bëjë që vendet e ndryshme ambasadat e tyre t'i heqin nga Prishtina, për t'i vendosur në kryeqytetin e Shqipërisë së Bashkuar në Tiranë.
- Njerëzimi në kundërshtim me mendësitë e Spahiut ka kohë që bashkimin e dy shteteve të të njëjtit komb e ka konsideruar dhe e konsideron normalitet, kurse mosbashkimin e dy shteteve të të njëjtit komb e ka konsideruar dhe e konsideron anormalitet. Por i tillë është Spahiu: ato që për botën janë normalitet, për Spahiun janë anormalitet!

## POROSIA MAKABRE E NAZISTIT XHAFER DEVA PËR MOSBASHKIMIN E KOSOVËS ME SHQIPËRINË

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se si Nexhmedin Spahiu e lavdëron duke e ngritur deri në qiell nazistin shqiptar të LBD-së, Xhafer Deva, sepse ai mërgatës shqiptare të Kosovës në kuvendin e Lidhjes III të Prizrenit, të mbajtur më 27 nëntor të vitit 1966 në Amerikë, i ka lënë këtë porosi: Kosova duhet të pavarësohet nga Jugosllavia, por nuk duhet të bashkohet me Shqipërinë.

Pajtohem me pjesën e parë të porosisë së Xhafer Devës, që Kosova të pavarësohej (shkëputej) nga Jugosllavia, por nuk pajtohem me pjesën e dytë të porosisë së tij, që Kosova e pavarësuar (shkëputur) nga Jugosllavia të mos i bashkohet Shqipërisë.

Ndërsa gjermanët një figure politike gjermane, e cila do të linte porosinë që Gjermania Lindore të pavarësohej (shkëputej) nga Bashkimi Sovjetik, por të mos i bashkohej Gjermanisë Perëndimore, do t'i këndonin këngë marrëzie, Spahiu ynë duke qenë vetë kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, Xhafer Devës pikërisht pse ka lënë porosi për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri, i këndon këngë lavdie!

Spahiu duke lavdëruar figurën e nazistit të thekur Xhafer Deva, ai ndër të tjera është shprehur si më poshtë.

■ ... (Amerikanët, shën. aut.) deri në vitin 1949 provojnë me prue Mihtat Frashërin, kryetar i Ballit Kombëtar, kryeministër të Shqipërisë. ...Por, ai gjindet i helmuar në një hotel në Nju-Jork, vdesë, dhe pas tij Xhafer Deva bohët i përkdheluni i

amerikanëve, bohet ai përmes të cilit tentojnë ta rrëzojnë pushtetin n'Shqipri. Por ai vazhdimisht tradhtohet... sepse grupet rivale, po mendoj që e tentonin pushtetin e spiunonin te regjimi komunist, i cili i kishte ndjekur. ....Dhe n'fund, përfundimisht Xhafer Deva gjatë viteve të 60-ta heqë dorë nga bashkimi me Shqiprinë. E pranon këtë si realitet dhe thotë se Kosova duhet të çlirohet nga Jugosllavia, por të jetë domethon e pavaruar edhe nga Shqipria. Dhe në Lidhjen e III të Prizrenit të mbajtur 27 nandor të vitit 1966, ai këtë ua paraqet si koncept dhe këtu në një mënyrë Xhafer Deva mund të konsiderohet si babai i idesë për pavarësinë e Kosovës. Prandaj ai edhe amerikanët ai i ka bind, sepse ka bashkpunue me amerikanët...<sup>320</sup>. (min. 32:41:- 33:03).

### **Lidhja III e Prizrenit ka qenë Lidhje Komb-Ndarëse dhe Shqipëri-Ndarëse**

Lidhur me pohimet e Spahiut të cituara më lart, dua t'i sqaroj lexuesit si më poshtë:

● Ndërsa Lidhja Shqiptare e Prizrenit e mbajtur në Prizren më 10 qershor të vitit 1878, e njohur si Lidhja I e Prizrenit, synim kryesor ka pasur bashkimin e katër vilajeteve shqiptare në një Shqipëri Etnike, dhe ndërsa Lidhja Shqiptare e Prizrenit e mbajtur në Prizren në shtatorin e vitit 1943, e njohur si Lidhja II e Prizrenit, synim kryesor ka pasur bashkimin e Kosovës, të viseve shqiptare në Maqedoni dhe të viseve të Sanxhakut të Pazarit të Ri me Shqipërinë, Lidhja Shqiptare e Prizrenit e mbajtur më 27 nëntor të vitit 1966 në Amerikë, e njohur si Lidhja III e Prizrenit<sup>321</sup>, në njërin anë e ka synuar çlirimin e Kosovës nga Jugosllavia, kurse në anën tjetër e ka synuar ndarjen e Kosovës nga Shqipëria, duke u pozicionuar kundër bashkimit të Kosovës me Shqipërinë.

---

<sup>320</sup> Nexhmedin Spahiu në "Oksigjen", pjesa e parë, 13.11.21:  
<https://www.youtube.com/watch?v=gmCJhoFX-Ps>

<sup>321</sup> Lidhja e Tretë e Prizrenit ka qenë një organizatë e themeluar nga një grup i shqiptarëve nacionalistë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 1946. Kjo organizatë është rinovuar me iniciativën e CIA-s në vitin 1962, për të organizuar dhe koordinuar aktivitete për rrëzimin e Qeverisë Komuniste të Shqipërisë.  
[https://www.wikiwand.com/sq/Lidhja\\_e\\_Tretë\\_e\\_Prizrenit](https://www.wikiwand.com/sq/Lidhja_e_Tretë_e_Prizrenit)

● Kështu, ndërsa Lidhja Shqiptare Prizrenit e vitit 1878 ka qenë dhe ka mbetur në histori si Lidhje Shqiptare Komb-Bashkuese dhe Shqipëri-Bashkuese, Lidhja III e Prizrenit, për shkak të porosisë së Xhafer Devës për mosbashkimin e Kosovës me Shqipërinë, ka qenë e ka mbetur në histori një Lidhje Shqiptare Komb-Ndarëse dhe Shqipëri-Ndarëse.

● Meqë Lidhja e III e Prizrenit ka qenë shqiptar-ndarëse ajo në thelb nuk ka qenë Lidhje Shqiptare, por ka qenë një Lidhje Antishqiptare.

### **Porosia e Xh. Devës për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri e ka bërë atë një antikombëtar dhe antishqiptar me damkë**

● Për mendimin tim, historia e kombit shqiptar porosinë e nazistit Xhafer Deva, për mosbashkimin e Kosovës me Shqipërinë, veç e ka fiksuar si një akt të zi antikombëtar dhe antishqiptar *par excellence*. Ky akt i zi Xhafer Devën nuk e bën patriotin dhe politikanin më të madh shqiptar, siç na thotë Spahiu, por e bën atë një antipolitikan, një antikombëtar dhe një antishqiptar me damkë.

### **Baballarët e Kosovës së pavarur janë Adem Demaçi, Ibrahim Rugova, Adem Jashari e Hashim Thaçi dhe jo Xhafer Deva**

Spahiu thotë se porosia e Xhafer Devës për mosbashkimin e Kosovës me Shqipërinë, e paska bërë atë babanë e idesë për pavarësimin e Kosovës, gjë që nuk qëndron aspak.

● Por ne jemi dëshmitarë se, deri te pavarësia e Kosovës nuk na ka çuar porosia makabre Xhafer Devës për mosbashkimin e Kosovës me Shqipërinë, por na ka çuar rezistenca politike 30-vjeçare e Adem Demaçit dhe e mijëra shqiptarëve të tjerë që kanë bërë së bashku më shumë se 200 shekuj burgje nëpër burgjet Serbisë e të Jugosllavisë, për bashkim të Kosovës me Shqipërinë; na ka çuar veprimtaria politike e ish-Presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova dhe e mijëra aktivistëve të tjerë politikë të të gjitha partive; na ka çuar lufta titanike e Adem Jasharit për çlirimin e Kosovës nga Serbia dhe për bashkimin e të gjitha viseve të shqiptarëve brenda një Shqipërie të vetme, dhe deri te pavarësia e Kosovës na ka çuar

edhe lufta politike e Hashim Thaçit, e Xhavit Halitit, e Bardhyl Mahmutit, e Jashar Salihut, e Jakup Krasniqit dhe lufta me armë e Ramush Hajredinajt, e Kadri Veselit, e Rexhep Selimit, dhe lufta e 2400 ushtarëve të UÇK-së të cilët kanë ranë Dëshmorë të Atdheut, duke luftuar kundër forcave serbe gjatë viteve 1998-1999.

● Adem Demaçi, Ibrahim Rugova, Adem Jashari dhe të tjerët të përmendur më lart, edhe pse nuk arritën bashkimin e të gjitha viseve shqiptare në një Shqipëri të vetme, megjithatë ka qenë lufta e tyre politike dhe me armë, ajo që ka rezultuar me pavarësimin e Kosovës në shkurtin e vitit 2008. Kështu, baballarët e mirëfilltë të pavarësisë së Kosovës janë Adem Demaçi, Ibrahim Rugova dhe Adem Jashari dhe jo Xhafer Deva.

### **Tiri-makatiri, si baba, si biri!**

● Duke qenë një adhurues i flaktë i nazistit Xhafer Deva, pikërisht pse Xhafer Deva ka lënë porosinë e tij makabre për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri, Spahiu për ta realizuar këtë porosi makabre të Xhafer Devës, përreth 26 vite me radhë (që nga viti 1999 kur Kosova është çliruar e këtej) e propagandon ditë e natë ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe dhe mosbashkimin Kosovë-Shqipëri.

● Kësaj i thonë se, ndërsa ati shpirtëror i Spahiut, Xhafer Deva, është angazhuar për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri, i biri metaforik i Xhafer Devës (Spahiu), është angazhuar dhe angazhohet për ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe. Një fjalë e urtë e vendit tim thotë: **Tiri-makatiri, si baba, si biri!**

● Ta ketë dikush idol Sami Frashrin, ideologun e komb-formimit dhe të komb-bashkimit të kombit shqiptar, kjo është diçka e zakonshme dhe e akseptueshme për të gjithë shqiptarët. Por të ketë dikush idol Xhafer Devën, ideatorin kundër-bashkimit Kosovë-Shqipëri, siç është rasti me Spahiun, kjo as nuk është e zakonshme dhe as e akseptueshme. Përkundrazi, kjo për mendimin tim është diçka sa e neveritshme, aq edhe e marrëzishme!

## **Bashkimi Kosovë-Shqipëri do të varet nga verdikti i kombit shqiptar, dhe jo nga porosia makabre e Xhafer Devës për mosbashkim**

● Por, nëse Kosova dhe Shqipëria në të ardhmen do të bashkohen ose jo, kjo nuk do të varet aspak as nga Xhafer Deva i vdekur e as nga Spahiu i gjallë, por do të varet nga verdikti i kombit shqiptar në Kosovë dhe në Shqipëri për bashkim, si dhe do të varet edhe nga Bashkësia Ndërkombëtare: nëse ajo do ta lejojë ose jo bashkimin Kosovë-Shqipëri.

● Sa u përket shqiptarëve të Kosovës e të Shqipërisë, ata verdiktin për bashkimin Kosovë-Shqipëri, që sot e kanë në zemër dhe në gji, sa i përket Bashkësisë Ndërkombëtare do të vijë një kohë jo e largët, kur edhe ajo do ta akseptojë bashkimin Kosovë-Shqipëri.

### **Amerika vepron sipas interesave të saj nacionalë dhe jo sipas porosive të Xhafer Devës**

Spahiu duke e madhëruar figurën e Xhafer Devës ka shkruar edhe si në vijim:

■ **Edhe Rugova kur fillon në fillim të viteve të 90-ta jo bashkim me Shqipërinë, ata i thojnë: Le, le se o kon ni njeri i mençem qi e ka provu këtë *de fakto*, dhe e ka pa që nuk ka funksionue edhe tash duhet mi grah po mendoj kësaj ideje<sup>322</sup>. (min. 34:34 -34:49)**

● Për ta zbërthyer thënien e Spahiut të cituar më lartë duhet sqaruar se, ata që sipas Spahiut i kanë thënë Ibrahim Rugovës në fillim të viteve të 90-ta të shekullit të XX të heq dorë nga bashkimi Kosovë- Shqipëri kanë qenë amerikanët, kurse njeriu i mençur që i ka bindur amerikanët se bashkimi Kosovë-Shqiperi nuk funksion ka qenë nazisti Xhafer Deva, sepse ai e paska provuar këtë bashkim dhe paska ardhur në përfundim se ai nuk ka funksionuar!

● Merreni me mend amerikanët, sipas Spahiut, porosinë e Xhafer Devës të vitit 1966, për mosbashkimin e Kosovës me Shqipërinë, e paskan mbajtur vath në vesh rreth 30 vjet me radhë, derisa i

---

<sup>322</sup> Nexhmedin Spahiu në "Oksigjen", pjesa e parë, 13.11.21. <https://www.youtube.com/watch?v=gmcJhoFX-Ps>

paskan thënë Ibrahim Rugovës në fillim të viteve '90-të të shekullit XX: *Lëre bashkimin Kosovë-Shqipëri, se ka qenë njeri shumë i mençur (Xhafer Deva), që atë bashkim e ka provur de fakto, dhe e ka ardhur në përfundim që ai nuk ka funksionuar, thënie kjo, që edhe zogjtë e malit i bën për të qeshur!*

● Siç dihet, të gjitha administratat amerikane vendimmarrjet e tyre politike i kanë marrë dhe i marrin gjithnjë duke iu referuar interesit nacional amerikan, dhe jo duke iu referuar porosive të ndonjë individi si puna e Xhafer Devës, që dikur para shumë dekadave paska lënë porosi për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri! Amerika aktualisht për shkak të konflikteve të ngrira në rajonin ballkanik, nuk është për bashkimin Kosovë-Shqipëri, por kjo nuk ka të bëjë aspak me porosinë e vitit 1966 të Xhafer Devës, për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri.

● Kështu, të thuash se administratat amerikane sa u përket raporteve Amerikës me Kosovën dhe Shqipërisë, na qenkan udhëhequr nga një porosi e Xhafer Devës e bërë në vitin 1966, kjo në rastin më të mirë paraqet një donkishotizëm të pashoq, që i bën të qeshin jo vetëm të gjallët, por edhe të vdekurit. Bota ka nevojë për Don Kishot, sepse ka nevojë të qeshë!

### **Këngë të tjera u këndohen atyre që lënë amanet**

#### **mosbashkimin e dy pjesëve të kombit dhe të atdheut të vet**

● Për Spahiun, Xhafer Deva pikërisht pse ka lënë porosi që Kosova të mos bashkohet me Shqipërinë, ai e paraqet atë si politikanin dhe atdhetarin më të madh e më të mençur në mesin e të gjithë politikanëve dhe atdhetarëve shqiptarë të kohës së LDB-së.

● Me rastin e bashkimit të dy Gjermanive në një Gjermani të vetme, politikanë dhe atdhetarë të mëdhenj gjermanë janë konsideruar ata politikanë gjermanë që kanë realizuar bashkimin e dy Gjermanive, kurse Spahiun ynë politikan dhe atdhetar të madh e konsideron Xhafer Devën, që ka lënë porosi mosbashkimin Kosovë-Shqipëri. *Hosona Barraba...!* - do të thoshte Noli ynë i madh.

● Nëse porosia e Xhafer Devës për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri, sipas Spahiut, na qenka patriotizëm dhe mençuri, kjo do të thotë se të gjithë ata politikanë e atdhetarë shqiptarë, të cilët

që nga kohët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878) e këndej, kanë dhënë edhe jetën e tyre për bashkimin e viseve të shqiptare në një Shqipëri Etnike, na paskan qenë budallenj dhe tradhtarë!? Jo, o *tempora o mores!*, por o *tempora o mortes!*

### **Xhafer Deva - urdhërues i masakrës së 4 shkurtit të vitit 1944 në Tiranë**

● Tanimë ka fakte të padiskutueshme historike, se idoli i Spahiut, Xhafer Deva, duke pasur postin e ministrit të Brendshëm në kuadër të Qeverisë Kuislinge të Tiranës, në shkurtin e vitit 1944 ka urdhëruar masakrimin e dhjetëra civilëve shqiptarë në Tiranë, nga ana e forcave shqiptare të Ministrisë së Brendshme në krye me Xhafer Devën. Kjo, sepse një pjesë e tyre kanë pasur ide antifashiste dhe antinaziste, kurse një pjesë tjetër pse kanë qenë familjarë të partizanëve, bijtë e të cilëve po luftonin maleve kundër forcave gjermane.

● Por, kur është fjala për këtë masakër, Spahi u pa pasur asnjë fakt, thotë se atë masakër nuk e kishte bërë Xhafer Deva me shokë, por e kishin bërë vetë partizanët. Kështu, sipas Spahiut del se më 4 shkurt të vitit 1944 partizanët kishin zbritur nga malet në Tiranë, dhe i kishin pushkatuar përkrahësit e tyre antifashistë dhe antinazistë, si dhe kishin pushkatuar edhe familjarët e tyre. Por, edhe logjika më e çoroditur tregon se diçka e tillë nuk ka mundur të ndodhë. Por Spahiut, siç jemi shprehur edhe në ndonjë kapitull pararendës të këtij libri, “mushka i bën mëz”, “dashi i bën qengj” dhe “gjeli i bën vezë!” Lum ai për veten e tij!

● Dua të sqaroj lexuesit, se në Shqipëri gjatë viteve 1945-1990, masakra e Xhafer Devës e 4 shkurtit të vitit 1944 është përmendur fare rrallë. Edhe kur është përmendur nuk është thënë se autori i saj ka qenë Xhafer Deva nga Mitrovica e Kosovës. Kjo, sepse është menduar se kjo e vërtetë e hidhur do të mund të keqkuptohej nga shqiptarët e Kosovës, si një mosdashje e Shqipërisë ndaj Kosovës.

### **Spahi u zbatim të amanetit të Xhafer Devës**

● Nga ato që u thanë më lart del se Spahi u pozicionimin e tij për mosbashkimin e Kosovës me Shqipërinë, e ka mision dhe amanet

nga Xhafer Deva, të cilin ai e ka idol. Por ëndrrën dyshekullore të kombit shqiptar për bashkim, nuk mund ta presin si me gërshtë as Xhafer Deva, as Nexhemedin Spahiu dhe askush tjetër në botë.

● Pas çlirimit të Kosovës në vitin 1999 dhe pas pavarësimit të Kosovës në vitin 2008, për ata që kanë sy për të parë, veshë për të dëgjuar dhe dy fije mend për të menduar, Shqipëria e Kosova po bashkohen çdo ditë, herë me rrugë të padukshme e herë me rrugë të dukshme. Spahiu shtiret sikur nuk e sheh këtë bashkim spontan Kosovë-Shqipëri, por kjo shtirje nuk i ndihmon aspak.

● Idetë e Spahiut për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri dhe për ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe: në komb shqiptar në Shqipëri dhe në komb “kosovar” në Kosovë, kanë qenë të vdekura ende pa i nxjerrë ai nga goja!



# **PJESA E DYMBËDHJETË**

---

**ME HISTORIKUN E KOMBIT GJERMAN, KOREAN DHE  
VIETNAMEZ NUK MUND TË PËRLIGJET KRIJIM-EKZISTIMI  
I “KOMBIT KOSOVAR”: KA PASUR DHE KA NJË KOMB TË  
VETËM GJERMAN, NJË KOMB TË VETËM KOREAN, NJË KOMB  
TË VETËM VIETNAMEZ DHE NJË KOMB TË VETËM  
SHQIPTAR**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit lidhur me të pavërtetat e Nexhmedin Spahiut, sipas të cilave ndërsa gjermanët gjatë periudhës kohore 1945-1990 kanë jetuar të ndarë në dy shtete gjermane: në Gjermaninë Perëndimore dhe në Gjermaninë Lindore, ata nuk kanë qenë një komb i vetëm gjerman, por kanë qenë dy kombe të ndryshme: njëri “gjermano-perëndimor” e tjetri “gjermano-lindor”.

Kështu, sipas Spahiut, Gjermania Perëndimore dhe Gjermania Lindore në OKB kanë qenë të anëtarësuara si dy shtete të ndryshme të dy kombeve të ndryshme: Gjermania Perëndimore si shtet i “kombit gjermano-perëndimor”, kurse Gjermania Lindore si shtet i “kombit gjermano-lindor”, gjë që nuk qëndron aspak.

Më tej dua t'i sqaroj lexuesit edhe me një tjetër të pavërtetë të Spahiut, sipas të cilës Koreja Veriore dhe Koreja Jugore janë të anëtarësuara në OKB si dy shtete të ndryshme të dy kombeve të ndryshme koreane: Koreja Veriore si shtet i “kombit koreano-verior”, kurse Koreja Jugore si shtet i “kombit koreano-jugor”, gjë nuk qëndron.

Spahiu thotë se, ndërsa Gjermania ka qenë e ndarë në dy shtete, gjermanët kanë qenë të ndarë në dy kombe, dhe thotë se edhe Koreja ndërsa është ndarë në dy shtete, koreanët janë të ndarë në dy kombe, për t'i bindur shqiptarët se dhe ata duke jetuar në dy shtete (Shqipëri dhe Kosovë), po ashtu janë të ndarë në dy kombe: në komb shqiptar në Shqipëri dhe në “komb kosovar” në Kosovë, gjë që nuk e pranon as logjika më elementare..

### **Ka pasur dhe ka një komb të vetëm gjerman**

Spahiu për të përligjur idetë e tij për ekzistimin e “kombit kosovar” dhe idetë e tij për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri, është shprehur si në vijim lidhur me kombin gjerman:

■ **Gjermania para bashkimit të fundit ka qenë dy kombe, sepse te dyja kanë qenë anëtare të Kombeve të Bashkume edhe kombi gjermano-lindor u zhduk...**<sup>323</sup> (min. 37:18:25)

■ **Gjermania Lindore ka qenë i vetmi komb në botën bashkohore që osht shue, domethon nuk osht mo, nuk janë vdek ata gjermanë, por u shue ai komb, nuk ekziston.**<sup>324</sup>(min. 30: 57 - 31:08)

■ **Në historinë moderne i vetmi komb që u shue osht kombi gjermano-lindor, domethon nuk janë vdek ata gjermanë, por si komb janë shue edhe qytetarët thjeshtë i janë bashkangjitë kombit gjermano-perëndimor**<sup>325</sup>. (min. 38:55 -39:15)

■ **Gjermania osht një shembull i vetëm ku ni komb oshtë zhdukur. Ka ekzistue kombi gjermano-lindor. Ai komb domethon oshtë zhduk**<sup>326</sup>. (min. 8:38- 9:05)

● Thëniet e mësipërme e Spahiut, sipas të cilave kombi gjerman para bashkimit të dy Gjermanive në vitin 1990 ka qenë i ndarë në dy kombe të ndryshme, nuk qëndron aspak. Është e vërtetë se

---

<sup>323</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri”. (Aktualitete - 30.03.2021) <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

<sup>324</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“, Nexhmendin Spahiu dhe Ervis Iljazaj, *ABC News Albania*, 06.11.2021: <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

<sup>325</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri”. (Aktualitete - 30.03.2021) <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

<sup>326</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun, *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

Gjermania para bashkimit të saj të fundit në vitin 1990 ka qenë e ndarë në dy shtete, por kombi gjerman nuk ka qenë i ndarë në dy kombe: në **“komb gjermano-perëndimor”** dhe në **“komb gjermano-lindor”**, siç na thotë Spahiut.

● Fuqitë e Mëdha (Amerika dhe Rusia), Gjermaninë në vitin 1945 e kanë ndarë në dy shtete, por nuk kanë ndarë kombin gjerman në dy kombe të ndryshme, siç mund t'i duket Spahiut. Kështu, ndarja e kombit gjerman në **“komb gjermano-perëndimor”** dhe në **“komb gjermano-lindor”**, është një shpikje *sui generis* e Spahiut.

● Duke qenë kombi gjerman një komb monoetnik dhe i papërzier me kombe të tjera, ai edhe kur ka jetuar i ndarë në Gjermani Perëndimore dhe në Gjermani Lindore, ka paraqitur të njëjtin komb unik gjerman. Kjo, sepse kombet monoetnike dhe të papërziera etnikisht me kombe të tjera, edhe nëse jetojnë në njëqind shtete të ndryshme, ato mbesin gjithnjë i njëjti komb.

● E njëjta gjë vlen edhe për kombin shqiptar, sepse edhe ai duke qenë një komb monoetnik, si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, paraqet të njëjtin komb shqiptar unik dhe të pandarë.

### **Me rastin e bashkimit të Gjermanive është bashkuar kombi gjerman dhe nuk është zhdukur asnjë komb**

● Edhe pohimi tjetër i Spahiut i cituar më lart, sipas të cilit me rastin e Bashkimit të dy Gjermanive në vitin 1990 ka ndodhur zhdukja e kombit gjermano-lindor nuk qëndron. Kjo thjesht sepse para bashkimit të dy Gjermanive në vitin 1990, nuk ka pasur as **“komb gjermano-perëndimor”** e as **“komb gjermano-lindor”**, por ka pasur vetëm komb unik gjerman. Dhe ky fakt tregon se me rastin e bashkimit të dy Gjermanive ka ndodhur bashkimi i kombit unik gjerman, por nuk ka ndodhur as zhdukja e **“kombit gjermano-perëndimor”** dhe as zhdukja e **“kombit gjermano-lindor”**, thjesht sepse këto kombe si të tilla nuk kanë ekzistuar, dhe meqë nuk kanë ekzistuar, nuk kanë pasur as si të zhduken.

● Të thuash se me rastin e bashkimit të dy Gjermanive në vitin 1990, Gjermania Lindore qenka shuar si komb, kjo jo vetëm se nuk qëndron por edhe e paraqet një absurd të llojit të vet. Kjo sepse në Gjermaninë Lindore nuk ka jetuar një komb tjetër i ndryshëm

nga kombi gjerman që ka jetuar në Gjermaninë Perëndimore, por ka jetuar i njëjti komb gjerman që ka jetuar edhe në Gjermaninë Perëndimore, i cili me rastin e Bashkimit të dy Gjermanive nuk është zhdukur, por i është bashkuar pjesës tjetër të kombit gjerman në Gjermaninë Perëndimore.

● Pse Spahiu thotë se me rastin e bashkimit të dy Gjermanive është zhdukur kombi gjermano-lindor? Për mendimin timm ai e thotë këtë të pavërtetë, për të thënë se edhe rastin e bashkimit të dy Shqipërive (Shqipërisë dhe Kosovës), do të zhdukët “kombi kosovar”.

● Por duke pasuar parasysh se “kombi kosovar” realisht dhe objektivisht as nuk ka ekzistuar dhe as nuk ekziston, ai edhe nuk ka si të zhduket me rastin e bashkimit Kosovë-Shqipëri, me ç’rast do të ndodh thjesht bashkimi i dy shteteve shqiptare (Shqipëri-Kosovë) dhe i dy pjesëve të kombit shqiptar, në një shtet të vetëm shqiptar.

● Për vetë faktin se shqiptarët e Shqipërisë dhe të Kosovës i përkasin të njëjtit komb shqiptar, kjo flet qartë se me rastin e bashkimit Kosovë-Shqipëri nuk shuhet/zhdukët asnjë komb, por konsolidohet më tej kombi i vetëm shqiptar i bashkuar në një Shqipëri të vetme.

### **Në OKB dy Gjermanitë kanë qenë të anëtarësuar si dy shtete të të njëjtit komb gjerman**

● Spahiu në debatet e tij televizive duke teorizuar për pronësinë e kombeve mbi shtetet e tyre, disa herë është shprehur se OKB-ja Gjermaninë Perëndimore e ka anëtarësuar si shtet i “kombit gjermano-perëndimor”, kurse Gjermania Lindore e ka anëtarësuar si shtet i “kombit gjermano-lindor”.

● Pajtohem plotësisht me Spahium se pronare të shteteve janë kombet, por nuk pajtohem me pohimin e tij se në OKB Gjermania Perëndimore është anëtarësuar si shtet i “kombit gjermano-perëndimor”, kurse Gjermania Lindore është anëtarësuar si shtet i “kombit gjermano-lindor”.

● OKB-ja te dy Gjermanitë i ka anëtarësuar si dy shtete të ndryshme, por jo si dy shtete të dy kombeve të ndryshme: njëri

gjermano-perëndimor dhe tjetri gjermano-lindor, siç na thotë Spahiu. Kjo është kështu sepse OKB-ja nuk e ka asnjë një ligj, i cili e ndalon anëtarësimin e dy e më shumë shteteve të të njëjtit komb. Kështu, në OKB janë të anëtarësuara me shumë se dhjetë shtete të ndryshme të të njëjtit komb arab.

● Spahiu thotë se dy Gjermanitë kanë qenë anëtare të Kombeve të Bashkuara (OKB-së) si dy shtete të ndryshme të dy kombeve të ndryshme, për të na bindur se edhe Shqipëria dhe Kosova, do të anëtarësohen në OKB si dy shtete të ndryshme të dy kombeve të ndryshme: Shqipëria si shtet i kombit shqiptar, kurse Kosova si shtet i “kombit kosovar”, gjë që nuk qëndron aspak.

● Më fjalë të tjera, sipas mendësisë së tillë të Spahiut del se për t’u bërë i mundur anëtarësimi i shtetit të Kosovës në OKB, shqiptarët e Kosovës duhet patjetër të tjetërsohen nga komb shqiptar në “komb kosovar”, gjë që paraqet një absurditet.

● Por OKB-ja ashtu siç i ka anëtarësuar dy Gjermanitë si dy shtete të të njëjtit komb gjerman, ajo edhe dy shtetet shqiptare (Shqipërinë dhe Kosovën) do t’i anëtarësoj si dy shtete të ndryshme të të njëjtit komb shqiptar, dhe jo si dy shtete të dy kombeve të ndryshme: Shqipërinë si shtet i kombit shqiptar, kurse Kosovën si shtet të “kombit kosovar”, siç mendon Spahiu e ndonjë tjetër.

● Janë përcaktimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara të citura në kapitujt 11,12 dhe 13 të këtij libri, ato të cilat flasin qartë se OKB-ja anëtarësimin e shteteve në radhet e saj e kushtëzoi me pasjen e popullit të tyre, pa ndërhy në përbërjen etnike/ kombëtare të popullit të shteteve që anëtarëson.

● Përcaktimi i mësipërm i Kartës së Kombeve të Bashkuara flet se, OKB-ja edhe anëtarësimin e dy Gjermanive e ka bërë me atë popullatë gjermane që ato kanë pasur, pa e kushtëzuar ndarjen e asaj popullate në dy kombe të ndryshme: njëri gjermano-perëndimor për shtetin e Gjermanisë Perëndimore dhe tjetri gjermano-lindor për shtetin e Gjermanisë Lindore, siç na thotë Spahiu.

● Dhe përcaktimi i mësipërm i Kartës së Kombeve të Bashkuara flet se OKB-ja edhe anëtarësimin e dy Shqipërive (të Shqipërisë dhe të Kosovës), ka për ta bërë me atë popullatë shqiptare që ato kanë, pa e kushtëzuar ndarjen e asaj popullate në dy kombe të ndryshme:

njëri shqiptar për shtetin e Shqipërisë dhe tjetrin “kosovar” për shtetin e Kosovës.

### **Bashkimi i Gjermanive nuk ka ndodhur vetëm për përfitime ekonomike të njëjës palë**

Spahiu bashkimin e dy Gjermanive e lidh kryesisht me kolapsin e ekonomisë së Gjermanisë Lindore, duke shkruar si në vijim:

**■ Thjeshtë, Gjermania Lindore, thjeshtë ka kollapsu. Dhe në kohën kur Gjermania Perëndimore ka qenë në lulëzim, Gjermania Lindore ka qenë në mjerim. Ata thjeshtë e kanë dorëzue shtetin e tyre, kanë pranue me ju bashkangjitë vllaznëve t’vetë edhe shtetit...<sup>327</sup> (min. 37:45 - 38:12)**

● S’ka dyshim se Gjermania Perëndimore duke pasur ekonomi shumë më të zhvilluar Gjermania Lindor, ajo si e tillë i ka joshur gjermanët e Gjermaninë Lindore për bashkim me të, por ky faktor i ekonomik nuk ka qenë vendimtar për bashkimin e dy Gjermanive në vitin 1990.

● Faktori vendimtar për bashkimin e Gjermanive ka qenë faktori kombëtar gjerman: kombi gjerman që e ka dashur domosdoshmërisht bashkimin e dy Gjermanive në një Gjermani të vetme.

● Faktori tjetër po ashtu vendimtar për bashkimin e dy Gjermanive ka pasur të bëjë me Bashkimin Sovjetik, i cili në fund të viteve ‘90 të shekullit XX nuk ka pasur as resurse ekonomike dhe as resurse ushtarake, për t’i mbajtur nën tutelën e tij ish-shtetet socialiste të Europës Lindore, përfshi këtu edhe Gjermaninë Lindore.

● Dhe faktori tjetër vendimtar, që ka mundësuar bashkimin e Gjermanive, ka qenë pajtueshmëria e Fuqive të Mëdha të Europës dhe e SHBA-së për bashkimin e dy Gjermanive në një Gjermani të vetme.

### **Roli i instinktit për bashkim në mesin e pjesëve të ndara të të njëjtit komb**

● Dhe natyrisht që në bazë të të gjithë faktorëve që kanë çuar në bashkimin e dy Gjermanive, ka qëndruar instinkti i natyrshëm i

---

<sup>327</sup> Nexhmedin Spahiu; *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri”. (Aktualitete - 30.03.2021); <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd70Q>

kombit gjerman, për bashkimin e tij në një Gjermani të vetme për të gjithë gjermanët. Instinktin, dëshirën dhe vullnetin e natyrshëm dhe të ligjshëm për bashkim, e kanë pasur dhe e kanë të gjitha kombet botës, përfshi këtu edhe kombin shqiptar. Instinkti, dëshira dhe vullneti i tillë i kombit gjerman do të bënte që dy Gjermanitë të bashkoheshin, edhe sikur ato të kishin zhvillim ekonomik të barabartë.

- Nëse gjermanët e Gjermanisë Perëndimore dhe ata të Gjermanisë Lindore nuk do ta kishin ndjesinë e përkatësisë së njëjtë kombëtare gjermane, ata nuk do ta kishin as instinktin, as dëshirën dhe as vullnetin e natyrshëm për bashkim dhe, për rrjedhojë, Gjermanitë nuk do të bashkoheshin.

- Kështu, Gjermania Lindore nuk është bashkuar me Gjermaninë Perëndimore vetëm për shkaqe të përfitimit ekonomik, siç thotë Spahiu, por në radhë të parë i është bashkuar Gjermanisë Perëndimore, për shkak të përkatësisë së njëjtë kombëtare të gjermanëve në të dy shtetet gjermane.

- Të njëjtin instinkt dhe të njëjtën dëshirë të natyrshme dhe të ligjshme për bashkim e ka pasur dhe e ka edhe kombi shqiptar i ndarë në disa shtete: në Shqipëri, në Kosovë, por edhe në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi, në Luginën e Preshevës në jug të Serbisë, dhe në Çamëri në veri të Greqisë.

- Të gjitha kombet e ndara në disa shtete të ndryshme e kanë ëndërruar dhe e ëndërrojnë bashkimin e tyre në një shtet të vetëm kombëtar. Të njëjtën ëndërr për bashkim tanimë për dy shekuj me radhë e ushqen edhe kombi shqiptar, të cilit ëndërrën e bashkimit kombëtar nuk mund t'ia presë askush si me gërshërë!

### **Ka pasur dhe ka vetëm një komb vietnamez**

- Shembullit të të dy Gjermanive dhe të dy Koreve dua t'ia shtoj edhe shembullin e dy Vietnameve. Vietnam brenda viteve 1955-1975 ka qenë i ndarë nga Fuqitë e Mëdha në dy shtete vietnameze: në Vietnam Verior dhe Vietnam Jugor, por kombi vietnamez nuk ka qenë i ndarë në dy kombe: njëri si “komb vietnamezo-verior” dhe tjetri si “komb vietnamezo-jugor”.

- Te dy Vietnamet kanë qenë të anëtarësuar në OKB si dy shtete

të ndryshme të të njëjtit komb vietnamez, dhe jo si dy shtete të dy kombeve të ndryshme: njëri i “komb vietnamezo-verior” dhe tjetri i “komb vietnamezo-jugor”. Dhe kjo tregon se edhe dy Shqipëritë (Shqipëria dhe Kosova), do të janë të anëtarësuara në OKB si dy shtete të të njëjtit komb shqiptar, dhe jo si dy shtete të dy kombeve të ndryshme: njëri shqiptar në Shqipëri dhe tjetri “kosovar” në Kosovë.

● Spahiu duke manipuluar me rrethanat politiko-historike të kombit gjerman dhe të kombit korean, jo vetëm që nuk i bind shqiptarët që ata të ndahen në dy kombe, por përkundrazi u kujton atyre që edhe ata në shembullin e bashkimit të kombit gjerman në një Gjermani të vetme dhe në shembullin e bashkimit të kombit vietnamez në Vietnam të vetëm, të përpiqen të bashkohen si komb në një Shqipëri të vetme, kuptohet me mjete të lejueshme dhe në marrëveshje me Fuqitë e Mëdha.

● Nëse Kosova dhe Shqipëria bashkohen në një shtet të vetëm shqiptar, shqiptarët jo vetëm që nuk humbin asgjë, por edhe do të fitojnë shumëfish. Dy duar punojnë edhe veç e veç, por kur punojnë së bashku, ato kryejnë punë shumë më të mëdha se kur punojnë veç e veç. Nëse me njërën dorë mund ta ngrinin në lartësinë e një metri një peshë prej 20 kilogramësh, me të dyja duart mund të ngrinin në lartësinë e një metri një peshë prej 50 kilogramësh. Prandaj nëse Kosova e Shqipëria bashkohen, potenciali i kombit të bashkuar shqiptar nuk dyfishohet, por shumëfishohet.

● Duke pasur parasysh sa u tha më lart, del e qartë se Spahiu me historikun e kombit gjerman dhe korean jo vetëm që nuk mund ta përlligjë krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, por përkundrazi u kujton shqiptarëve që ta forcojnë unitetin kombëtar shqiptar drejt bashkimit Kosovë-Shqipëri.

### **Ka pasur dhe ka një komb të vetëm korean**

Spahiu për t’i përlligjur idetë e tij për ekzistimin e “kombit kosovar” dhe idetë e tij për mosbashkimin Kosovë-Shqipëri, është shprehur edhe lidhur me kombin korean si në vijim:

■ **Koreja e Veriut dhe Koreja e Jugut janë dy kombe që janë**

**anëtare të Kombeve të Bashkuara, janë dy kombe të ndryshme, por janë e njëjta etni<sup>328</sup>. (min. 30:49 - 30:59)**

Spahiu duke u marr mëtej me kombin korean është shprehur edhe si më poshtë:

■ ■... thjeshtë sikur dy Koretë që janë sot dy kombe të ndryshme qi i takojnë ni etnie, ni feje, ni gjuhe, por që janë dy kombe të ndryshme, sepse i kanë dy shtete të ndryshme, sepse të tjerave ligje iu përgjigjet koreani verior, e tjerave ligje iu përgjigjet koreani jugor<sup>329</sup>. (min. 37:30 - 37:46)

■ Por edhe koreanët veriorë dhe jugorë janë dy kombe të ndryshme<sup>330</sup>.

● Edhe thëniet e mësipërme e Spahiut, sipas të cilave dy Koretë janë dy shtete të ndryshme të dy kombeve të ndryshme nuk qëndron. Kjo, sepse ndarja e Koresë në dy shtete në vitin 1953 nuk është shoqëruar me ndarjen e kombit korean në dy kombe: në “komb koreano-verior” dhe në “komb koreano-jugor”. Prandaj edhe “kombi koreano-verior” dhe kombi “koreano-jugor”, janë po ashtu një shpikje tjetër *sui generis* e Spahiut.

● Koreanët e Koresë së Veriut dhe koreanët e Koresë Jugore duke i takuar të njëjtit komb korean, nuk i përkasin vetëm të njëjtës etni koreane, siç na thotë Spahiu, por i përkasin edhe të njëjtit komb korean.

● Kur në të ardhmen Koreja Veriore dhe Koreja Jugore do të bashkohen në një Kore të vetme, kjo nuk do të çoj në zhdukjen e “kombit koreano-verior”, apo të “kombit koreano-jugor”, sepse dy kombe të tilla koreane as nuk kanë ekzistuar dhe as nuk ekzistojnë. Prandaj bashkimi i dy Koreve do të shoqërohet me bashkimin e dy pjesëve të ndara të të njëjtit komb korean, brenda një Koreje të bashkuar.

---

<sup>328</sup> „Tiranë-Prishtinë: Ku gabuam?“, Nexhmedin Spahiu dhe Ervis Iljazaj; *ABC News Albania*, 06.11.2021; <https://www.youtube.com/watch?v=OZtxMHB61UA>

<sup>329</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri”. (Aktualitete - 30.03.2021) <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd7OQ>

<sup>330</sup> Nexhmedin Spahiu: *Shqipëria dhe Kosova dy kombe të ndryshme me gjuhë të njëjtë*; 16/03/2021 syri.net. [https://www.syri.net/syri\\_kosova/lajme/228586/nexhmedin-spahiu-shqipëria-dhe-kosova-dy-kombe-te-ndryshme-me-gjuhe-te-njejte/](https://www.syri.net/syri_kosova/lajme/228586/nexhmedin-spahiu-shqipëria-dhe-kosova-dy-kombe-te-ndryshme-me-gjuhe-te-njejte/)

- Dy Koretë janë dy shtete të ndryshme anëtare të OKB-së, por ato nuk janë dy shtete të ndryshme të dy kombeve të ndryshme, siç na thotë Spahiu, por janë dy shtete të të njëjtit komb shumicë korean.
- Spahiu duke deklaruar se, derisa Koreja është e ndarë në dy shtete koreane, edhe kombi korean është i ndarë në dy kombe, ai edhe me këtë rast dëshiron të na thotë se edhe kombi shqiptar, duke qenë i ndarë në dy shtete (Shqipëri dhe Kosovë), po ashtu është i ndarë në dy kombe: njëri komb shqiptar në Shqipëri dhe tjetri “kosovar“ në Kosovë.
- Por për vetë faktin se OKB-ja e bën anëtarësimin e dy e më shteteve të të njëjtit komb, kur ai komb paraqet kombin shumicë në dy a më shumë shtete, kjo tregon se edhe dy Koretë në OKB janë të anëtarësuara si dy shtete të të njëjtit komb korean, dhe kjo tregon se edhe Shqipëria dhe Kosova do të janë anëtare të OKB-së si dy shtete të njëjtit komb shqiptar.

---

## **ME SHEMBULLIN E KRIJIMIT TË KOMBIT AUSTRIAK NUK MUND TË PËRLIGJET GJOJA KRIJIMI NGA SHQIPTARËT E KOSOVËS TË “KOMBIT KOSOVAR”**

Në këtë kapitull dua që t'i sqaroj lexuesit, se si Nexhmedin Spahiu, edhe nëpërmjet të shembullit të krijimit të kombit austriak nga ish-popullata gjermane e Austrisë, është përpjekur dhe përpiqet që ta përlijë propagandën e tij për gjoja krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

Por po në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit pse Spahiu me shembullin e krijimit të kombit austriak nga ish-gjermanët e Austrisë, nuk mund ta përlijë propagandën e tij të shfrenuar, për gjoja krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

Kombi austriak është krijuar nga ish-gjermanët e Austrisë për shkak të përzierjes së tyre etnike (me martesë të përziera) me pakicat relativisht të mëdha çeke, sllovake, polake, sllovene dhe kroate, që kanë jetuar dhe jetojnë në Austri.

Por kombi “kosovar” nuk është krijuar nga shqiptarët e Kosovës, sepse shqiptarët e Kosovës kanë bërë përzjerje etnike (me martesë të përziera) me pakicën serbe ose me pakicat e tjera, që kanë jetuar dhe jetojnë në Kosovë.

Nga ana tjetër, kombi austriak është krijuar nga ish-gjermanët e Austrisë, sepse në favor të krijimit të tij kanë vepruar një sërë faktorësh historiko-politikë për afro dy shekuj me radhë.

Por kombi “kosovar” nuk është krijuar nga shqiptarët e Kosovës,

sepse nuk ka pasur faktorë historiko-politikë që kanë vepruar në favor të krijimit të tij.

### **Faktorët historiko-politikë që kanë favorizuar krijimin e kombit austriak dhe faktorët historiko-politikë, që nuk e kanë favorizuar krijimin e “kombit kosovar”**

● Më poshtë jepen faktorët kryesorë historiko-politikë specifikë, të cilët kanë çuar në krijimin e kombit austriak nga një pjesë e kombit gjerman që ka jetuar në Austri<sup>331</sup>, si dhe jepen faktorët kryesorë historiko-politikë specifikë, të cilët nuk kanë çuar në krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

1. Kur janë krijuar kushtet e para për krijimin e kombit dhe të shtetit austriak nga ish-gjermanët e Austrisë, gjermanët e Gjermanisë së sotme kanë qenë ende të ndarë në shumë principata. Kjo tregon se po të kishte pasur me kohë një shtet gjerman, kombi dhe shteti austriak nuk do të ishin krijuar. Kështu, mungesa një shteti gjerman i ka dhënë dorë krijimit të kombit austriak jashtë kombit gjerman, dhe krijimit të shtetit të Austrisë jashtë Gjermanisë.

● Por krejt ndryshe qëndron puna me historikun e kombit shqiptar. Kur Kosova është bërë shtet në vitin 2008, shteti shqiptar (Shqipëria) ka ekzistuar që nga viti 1913 e këtej, gati një shekull më parë. Ekzistimi i shtetit të Shqipërisë rreth një shekull para ekzistimit të shtetit të Kosovës, ka bërë që shqiptarët e Kosovës të synojnë bashkimin me shtetin amë, Shqipërinë, dhe jo të krijojnë nga vetja e tyre një komb tjetër joshqiptar, të emërtuar si “komb kosovar”.

2. Kombi austriak është krijuar nga ish-gjermanët e Austrisë në epokën e kapërcimit të sistemit shoqëror feudal në sistemin shoqëror kapitalist, përkatësisht gjatë shekujve XVIII-XIX dhe në dekadat e para të shekullit XX, periudhë kohore kjo, brenda së cilës ka ndodhur krijimi i kombeve dhe i shteteve të reja. Kjo periudhë kohore në masë të caktuar ka favorizuar krijimin kombit austriak jashtë kombit gjerman dhe krijimin e Austrisë jashtë Gjermanisë.

● Por ndryshe ka qëndruar puna me shqiptarët e Kosovës. Ata që

---

<sup>331</sup> Österreich <https://de.wikipedia.org/wiki/Österreich>

nga dekadat e para të shekullit XX dhe deri në këto dy dekadat e para të shekullit XXI, për afro një shekull kanë jetuar në një epokë krejtësisht tjetër: në epokën e kapitalizmit të zhvilluar dhe në epokën e globalizmit, kur si rregull krijimi i kombeve të reja ka përfunduar. Natyrisht që kjo epokë si e tillë nuk e ka favorizuar krijimin nga shqiptarët e Kosovës të ndonjë kombi tjetër joshqiptar të emërtuar si “komb kosovar”, por përkundrazi ka motivuar bashkimin e dy pjesëve të kombit shqiptar në një Shqipëri të vetme.

**3.** Ish-popullata gjermane në Austri, prej së cilës është krijuar kombi austriak, nuk ka qenë një popullatë gjermane plotësisht monoetnike dhe homogjene, por ka qenë një popullatë gjermane relativisht multietnike dhe heterogjene, për shkak të martesave të saj me pjesëtarët e pakicave relativisht të mëdha që kanë jetuar në Austri. Të tilla kanë qenë: pakica çeke, sllovaqe, hungareze, polake, kroate dhe italiane. Edhe të qenët e popullatës ish-gjermane të Austrisë një popullatë në masë të caktuar multietnike dhe heterogjene, po ashtu ka favorizuar krijimin e kombit austriak nga ish-gjermanët e Austrisë.

● Por ndryshe ka ndodhur me shqiptarët e Kosovës. Ata duke mos pasur martesa të përziera me pakicën serbe, ndër të tjera edhe për shkak të dallimeve fetare mes tyre, kanë qenë e kanë mbetur një popullatë tipike monoetnike dhe homogjene shqiptare. Edhe ky monoetnicitet dhe homogjenitet i theksuar i shqiptarëve të Kosovës, nuk e ka favorizuar dhe nuk e favorizon krijimin nga shqiptarët e Kosovës të ndonjë kombi tjetër joshqiptar, të emërtuar si “komb kosovar”.

**4.** Edhe vetë themelimi në vitin 1804 i Monarkisë Austriake, si një Monarki e veçantë të Habsburgëve, jashtë principatave të shumta gjermane, ende të pabashkuara në një Gjermani të vetme, po ashtu në masë të konsiderueshme e ka favorizuar krijimin kombit austriak nga ish-gjermanët e Austrisë.

● Por në fillim të shekullit XIX (në vitin 1804) nuk kemi krijim të ndonjë “Monarkie të Kosovës” jashtë viseve të tjera shqiptare, themelimi i së cilës do ta favorizonte krijimin nga shqiptarët e Kosovës të ndonjë kombi tjetër joshqiptar, të emërtuar si “komb kosovar”.

5. Sidomos lufta e vitit 1866 mes Austrisë dhe Prusisë (Prusia ka paraqitur bërthamën e shtetit të ardhshëm gjerman), ka vendosur hendekun e thellë mes gjermanëve të Gjermanisë dhe të ish-gjermanëve të Austrisë. Edhe ky hendek në masë të caktuar i ka paraprirë ndarjes së gjermanëve në dy kombe: në komb gjerman dhe në komb austriak.

● Fatmirësisht mes shqiptarëve të Shqipërisë dhe shqiptarëve të Kosovës nuk ka ndodhur asnjëherë ndonjë luftë ndërvëllazërore, që do të vendoste një hendek të thellë mes shqiptarëve të Shqipërisë dhe të shqiptarëve të Kosovës, hendek ky që do të mund ta favorizonte ndarjen e shqiptarëve në dy kombe: në komb shqiptar në Shqipëri dhe në “komb kosovar” në Kosovë.

6. Edhe të qenët e austriakëve themelues dhe drejtues kryesorë të Perandorisë Austro-Hungareze, ekzistuese brenda viteve 1867-1818, po ashtu e ka favorizuar krijimin e kombit austriak jashtë kombit gjerman.

● Por diçka e tillë nuk ka ndodhur me shqiptarët e Kosovës. Ata pikërisht gjatë viteve 1867-1918, kur është krijuar Perandoria Austro-Hungareze, jo vetëm që nuk kanë krijuar ndonjë bashkim perandorak të Kosovës me ndonjë vend tjetër, për t’u favorizuar kësosoj krijimi i “kombi kosovar” jashtë kombit shqiptar, por edhe u janë nënshtuar krimeve gjenocidale dhe spastrimeve etnike të tmerrshme, të ushtruara ndaj tyre nga Mbretëria e Serbisë dhe më pas edhe nga Mbretëria e Jugosllavisë.

### **E djeshmja ka krijuar kombin austriak, por as e djeshmja dhe e as e sotmja nuk e kanë krijuar “kombin kosovar”**

● Të gjitha faktet e përmendura më lart tregojnë pse as me shembullin e krijimit të kombit austriak nga pjesa e kombit gjerman që ka jetuar në Austri, nuk mund ta arsyetohet dhe të përligjet krijimi i “kombit kosovar” nga pjesa e kombit shqiptar që ka jetuar dhe jeton në Kosovë. Kjo, sepse rrjedhat historiko-politike, nëpër të cilat ka kaluar pjesa e kombit gjerman në Austri, nuk kanë qenë ekuivalente me rrjedhat historiko-politike, nëpër të cilat ka kaluar pjesa e kombit shqiptar në Kosovë.

● Kështu, e djeshmja nga një pjesë e kombit gjerman ka krijuar

kombin austriak, por as e djeshmja dhe as e sotmja nga një pjesë e kombit shqiptar nuk e ka krijuar “kombin kosovar”.

### **Raporti Kosovë-Shqipëri nuk është i njëjtë me raportin Austri-Gjermani**

Spahiu në përpjekje e sipër, që nëpërmjet krijimit të kombit austriak të përligjë propagandën e tij destruktive të gjoja krijimit “kombit kosovar”, është shprehur si më poshtë:

■ **Raporti Kosovë-Shqipëri osht i njillojtë me atë Austri-Gjeramani, kështu që këtu ska ndonji dallim<sup>332</sup>. (min. 10:10 - 10: 15)**

● Por raporti Kosovë-Shqipëri nuk është aspak i njëjtë me raportin Austri-Gjermani. Kjo, sepse raporti Austri-Gjermani në kohët e sotme paraqet një raport mes dy shteteve me dy kombe të ndryshme, njëri gjerman në Gjermani e tjetri austriak në Austri, ky i fundit siç kemi sqaruar më lart, i krijuar nëpërmjet përzierjes etnike të pjesës së kombit gjerman në Austri me pakicat kombëtare: çeke, sllovaqe, polake, sllovene e kroate që kanë jetuar dhe jetojnë në Austri.

● Krejtësisht tjetër është raporti Kosovë-Shqipëri, sepse ai paraqet dy shtete të të njëjtit komb shqiptar, sepse siç kemi theksuar edhe më lart, shqiptarët e Kosovës duke mos u përzier etnikisht me serbët apo kombet e tjera, ata kanë mbetur i njëjti komb shqiptar si në Shqipëri.

### **Bashkimin e Austrisë me Gjermaninë e kanë pamundësuar Fuqitë e Mëdha të LDB-së**

Krijimin e kombit austriak nga ish-gjermanët që kanë jetuar në territorin e Austrisë, Spahiu duke dashur që ta arsyetojë e përligj me të krijimin, sipas tij, nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, është shprehur edhe si në vijim:

■ **E njëjta gjo ka ndodh me Austrinë në vitin 1938, kur Republika e Austrisë e lindur në vitin 1918 deri në vitin 1938**

---

<sup>332</sup> Nexhmedin Spahiu në “Oksigjen”, pjesa e tretë, 23.09.2011:  
<https://www.youtube.com/watch?v=D673tLZUDIE>.

**kishte 20 vjet taman. Mirëpo meqenëse ish mësue me konë Perandori, mi pas gjithë ato, dhe mbet e vogël, ajo mbet e varfër, nuk arriti me rimarr vetën, ndërkohë që Gjermania me Hitlerin prej vitit 1933 deri me 1938-ën, për pesë vjet boni bum, u bo superfuqi botnore. Atëherë austriakët bon referendum: A dojmë me ndejt shtet i pavaruar, apo dojmë me ju bashkangjit Gjermanisë, meqenëse i bashkonte gjuha, gjaku. A e dini cili ka qenë rezultati i referendumit: 99,7% kanë votu për bashkim me Gjermanin, vetëm 0,3% për me mbet shtet i pavarur. Mirëpo siç e dim, siç përfundon Lufta e Dytë Botnore edhe munden gjermanët, dhe atëherë këta që e okupojnë: Anglia, Amerika, Franca, Rusia, e ndajnë, i bojnë pikë e pesë, domethon, jo vetëm qi e ndajnë Austrinë, e ndajnë edhe Gjermanin, edhe Austrinë e ndajnë prej Gjermanisë<sup>333</sup>. (min. 39:20 - 41:02)**

● Thëniet e Spahiut të cituara më lart flasin se një pjesë e një kombi (në rastin konkret pjesa e kombit gjerman në Austri), nuk ndahet aq lehtë nga pjesa tjetër e madhe e të njëjtit komb (në rastin konkret nga pjesa e madhe e kombit gjerman në Gjermani). Këtë e vërteton vetë fakti, se austriakët edhe pse Austria brenda viteve 1867-1818 bashkë me Hungarinë kanë qenë Perandori, megjithatë, siç na thotë edhe Spahiu, 99% e austriakëve në vitin 1938 kanë votuar në favor të bashkimit të Austrisë me Gjermaninë. Por ai bashkim nuk ka ndodhur, sepse Fuqitë e Mëdha të Koalicionit Antifashist Botëror, Amerika, Anglia dhe Bashkimi Sovjetik, duke e ndarë Gjermaninë pas LDB-së në dy shtete dhe duke e ndarë Austrinë pesë zona të influencës, e kanë pamundësuar bashkimin e Austrisë me Gjermaninë.

● Mendoj se Spahiu merret me shembullin e pamundësimit të bashkimit të Austrisë me Gjermaninë në vitin 1938 nga ana e Fuqive të Mëdha të kohës, për të na thënë se edhe bashkimin Kosovë-Shqipëri e pengojnë Fuqitë e Mëdha të kohëve të sotme, prandaj le ta bëjmë sa më shpejt nga shqiptarët e Kosovës një komb tjetër “kosovar”.

---

<sup>333</sup> Nexhmedin Spahiu, *Shteti dhe kombi kosovar*, radio “Sharri” (Aktualitete - 30.03.2021) <https://www.youtube.com/watch?v=kzli8Rjd70Q>

● Por, siç kam cekuar edhe në një kapitull pararendës, Shqipëria dhe Kosova edhe nëse nuk do të bashkohen kurrë, kombi shqiptar për arsye etnike, kombëtare, historike, gjeorajonale, gjuhësore dhe etnokulturore nuk duhet të ndahet në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”. Kjo, sepse shqiptarët mund të jetojnë si komb shqiptar pa asnjë pengesë në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut e gjithandej, dhe sepse ndarja e shqiptarëve në dy kombe, siç kam shkruar edhe në një kapitull tjetër, është shumë më tragjike se mosbashkimi Kosovë-Shqipëri.

● Për mendimin tim, Spahiu e dëshiron shumë mosbashkimin e pjesës së kombit shqiptar në Kosovë me pjesën e kombit shqiptar në Shqipëri, me qëllim që në ndëkohë nga shqiptarët e Kosovës me kalimin e kohëve të mund të krijohet “kombi kosovar”.

### **Më mirë qesh ai që qesh i fundit!**

● Duke pasur parasysh se Spahiu tanimë ka më shumë se dy dekada, që në njërën anë propagandon ethshëm krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, kurse nga ana tjetër është pozicionuar kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri, kjo tregon se ai do ta ketë pritur me gëzim të madh faktin që Plani/Dokumenti i Ahtisarit, ia pamundëson Kosovës bashkimin me një vend tjetër, në rastin konkret me Shqipërinë.

● Por Spahiu nuk duhet të ngutet e të gëzohet para kohe, sepse sidomos në kohët e sotme ngjarjet dhe vendimmarrjet ndryshojnë shumë shpejt. Kështu, një ngjarje e vendimmarrje e djeshme që të ka dhënë gëzim, nesër mund të ndryshohet duke të dhënë hidhërim. Prandaj nuk thuhet kot se - qesh më mirë ai që qesh i fundit. Me këtë dua të them, se Dokumenti i Ahtisarit aktualisht e për një kohë ia ndalon Kosovës bashkimin më Shqipërinë, por nesër ndalesa e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë mund të hiqet, dhe Spahiu mund të na hidhërohet shumë.

### **Bashkimi European do ta realizojë bashkimin Kosovë-Shqipëri**

● Besoj se vetë Bashkimi European në të ardhmen nuk do të pajtohet, që duke qenë pesë milionë shqiptarë të ndarë në dy shtete

(Shqipëri dhe Kosovë), me rastin e vendimmarrjeve madhore europiane të kenë në dispozicion dy vota, kurse kombi gjerman me rreth 85 milionë banorë, kombi francez me rreth 68 milionë banorë, kombi italian me rreth 61 milionë banorë dhe kombi spanjoll me rreth 48 milionë banorë, me rastin e vendimmarrjeve madhore europiane, të kenë në dispozicion vetëm nga një votë.

● Kjo është arsyeja pse unë besoj se në të ardhmen vetë Bashkimi European do ta iniciojë dhe realizojë bashkimin Kosovë-Shqipëri në një shtet të vetëm shqiptar. Kështu, nëse z. Spahi do të rrojë edhe nja 10 ose 15 vjet, gjasat që ai ta përjetojë me hidhërim të madh bashkimin Kosovë-Shqipëri nga ana e Bashkimit European janë të mëdha.

● Por Bashkimi European nuk mund ta iniciojë bashkimin e Maqedonisë së Veriut me Bullgarinë në një shtet të vetëm, sepse ndërsa bullgarët kanë origjinë sllavo-mongole-hune, maqedonasit sipas të gjitha gjasave kanë origjinë të hershme pellazgo-ilire, si edhe shqiptarët.

● Bashkimi European nuk mund ta iniciojë as bashkimin e Malit të Zi me Serbinë në një shtet të vetëm, sepse ndërsa serbët kanë origjinë tipike sllave, malazezët kanë origjinë iliro-arbërore, si edhe shqiptarët.

● Bashkimi European nuk mund ta iniciojë bashkimin e Moldavisë me Rumanin në një shtet të vetëm, sepse ish-rumunët e Moldavisë duke pasur përzierje etnike me pakicat ruse dhe ukrainase brenda Moldavisë, ata tanimë janë krijuar si një komb tjetër moldav, i ndryshëm nga kombi rumun në Rumani.

## ME SHEMBULLIN E KRIJIMIT TË KOMBIT MOLDAV NUK MUND TË PËRLIGJËT GJOJA KRIJIMI NGA SHQIPTARËT E KOSOVËS TË “KOMBIT KOSOVAR”

Në këtë kapitull dua që t’i sqaroj lexuesit, se si Nexhmedin Spahiu, edhe nëpërmjet të shembullit të krijimit të kombit moldav nga ish-popullata rumune e Moldavisë, është përpjekur dhe përpiqet që ta përlijë propagandën e tij të false, për gjoja krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

Por po në këtë kapitull dua t’i sqaroj lexuesit se përse Spahiu as me shembullin e krijimit të kombit moldav nga ish-rumunët e Moldavisë, nuk mund ta përlijë propagandën e tij destruktive, për gjoja krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

**Pse me shembullin e kombit moldav  
nuk mund të përlijet gjoja krijimi i “kombit kosovar”**  
Spahiu lidhur me kombin moldav në Moldavi ka shkruar si në vijim:  
■ Rumunët ortodoksë kanë tentuar të zhvillojnë një komb të vetëm, por fati historik (invadimi i BRSS-së në Moldavi në vitin 1944), ka bërë që nga rumunët ortodoks të bëhen dy kombe (rumunët dhe moldavët). Moldavët gjuhën e tyre e quajnë rumune dhe nuk e mohojnë etninë rumune<sup>334</sup>.

<sup>334</sup> *Koncepti i kombit*, Nexhmedin Spahiu; <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

■ **Shikoni Rumunin dhe Moldavin, asht një popull që ka një gjuhë, që ka të njëjtën fe, por që ka dy shtete, dy kombe të ndryshme**<sup>335</sup>. (min. 22:15 -22:25)

### **Kombi moldav është produkt i përzierjes etnike**

● Është e vërtetë se nga ish-rumunët e Moldavisë është krijuar kombi moldav, por Spahiu me shembullin e krijimit kombit moldav nuk mund ta përligjë aspak propagandën e tij për gjoja krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”. Kjo, sepse kombi moldav në Moldavi është krijuar nëpërmjet përzierjes etnike (martesave të përziera) të ish-rumunëve të Moldavisë, me pakicat etnike relativisht të mëdha ruse dhe ukrainase, që kanë jetuar dhe jetojnë në Moldavi. Kurse në Kosovë nuk është krijuar nga shqiptarët një komb tjetër “kosovar”, sepse ata nuk janë përzier etnikisht (me martesë të përziera) me ndonjë etni/komunitet tjetër joshqiptar, duke mbetur kështu një komb shqiptar, si edhe shqiptarët e Shqipërisë.

● Nga ana tjetër dua t’i sqaroj lexuesit, se kombi moldav nuk është krijuar pas pavarësimit të Moldavisë nga ish-Bashkimi Sovjetik në vitin 1991, por është krijuar gradualisht që nga viti 1940, kur Moldavia është bërë pjesë e ish-Bashkimit Sovjetik<sup>336</sup> e këtej deri në vitin 1991, kur Moldavia është bërë shtet i pavarur.

● Pjesëtarët e kombit shumicë rumunë në Moldavi duke pasur besim të njëjtë fetar ortodoks, si edhe pjesëtarët e pakicave kombëtare ruse dhe ukrainase<sup>337</sup>, duke pasur edhe mentalitet të ngjashëm me pjesëtarët e pakicës ruse dhe ukrainase, ata gjatë gjithë periudhës kohore 1940-1991 kanë pasur martesë të përziera me këto pakica, duke u krijuar kështu nga ish-popullata rumune e Moldavisë, një komb tjetër i ri multi-etnik i emërtuar si *komb moldav*.

● Por, duke pasur parasysh se në Kosovë mes kombit shumicë

<sup>335</sup> Nexhmedin Spahiu, mysafir i Mustafa Nanos në *Ora News*, <https://www.youtube.com/watch?v=Sc9YSOpYfXo>

<sup>336</sup> Republik Moldau [https://de.wikipedia.org/wiki/Republik\\_Moldau#Geschichte](https://de.wikipedia.org/wiki/Republik_Moldau#Geschichte)

<sup>337</sup> Moladavia ka 2,4 milionë banorë: rreth 1 milion e 900 mijë janë moldavë, 420 mijë janë ukrainas, rreth 300 mijë janë rusë, rreth 200 mijë të tjerë janë gagaus, polakë, romë, gjermanë tatarë etj.: [https://de.wikipedia.org/wiki/Republik\\_Moldau#Bevölkerung](https://de.wikipedia.org/wiki/Republik_Moldau#Bevölkerung)

shqiptar dhe pakicës kombëtare serbe nuk ka pasur martesë të përziera, kjo ka bërë që nga pjesëtarët e kombit shqiptar në Kosovë, të mos krijohet një komb tjetër bietnik (shqiptaro-serb) i emërtuar si “komb kosovar”.

● Kanë qenë dy faktorë, të cilët duke pamundësuar martesat e përziera mes shumicës shqiptare dhe pakicës serbe, kanë pamundësuar edhe krijimin e “kombit kosovar” nga shqiptarët e Kosovës.

**Faktori i parë** ka pasur të bëjë me shtypjen etnike deri në gjenocid, që ka ushtruar Serbia ndaj shqiptarëve të Kosovës, fatkeqësisht edhe me pjesëmarrjen e pjesëtarëve të pakicës serbe në Kosovë.

**Faktori i dytë** ka pasur të bëjë me religjionin. Shqiptarët duke qenë të besimit mysliman, kurse serbët të besimit të krishterë ortodoks, ata për shkak të dallimeve fetare nuk kanë pasur martesë të përziera mes tyre, përveçse në raste të rralla.

### **Raporti Kosovë-Shqipëri nuk është i njëjtë me raportin Moldavi-Rumuni**

Spahiu duke e krahasuar raportin Kosovë-Shqipëri me raportin Moldavi-Rumuni, është shprehur si në vijim:

■ **Raporti Kosovë-Shqipëri është i njëjtit me raportin Moldavi-Rumani...**<sup>338</sup>. (min. 10:05 -10:10)

● Por duke pasur parasysh faktet e përmendura më lart, del e qartë se pohimi i Spahiut, që raporti Kosovë-Shqipëri është i njëjtit me raportin Moldavi-Rumani nuk qëndron. Kjo, sepse ndërsa raporti Moldavi-Rumani paraqet një raport mes dy shteteve me dy kombe të ndryshme: njëri rumun në Rumani dhe tjetri moldav në Moldavi, raporti Kosovë-Shqipëri paraqet një raport mes dy shteteve të njëjtit komb shqiptar.

● Spahiu nuk merret me krijimin e kombit moldav për ta sqaruar thjesht krijimin e tij, por merret me krijimin e tij për të na bindur (sipas meje, për të na mashtruar), se ashtu siç nga ish-rumunët e Moldavisë që është krijuar kombi moldav, edhe nga shqiptarët

---

<sup>338</sup> Nexhmedin Spahiu në “Oksigjen”, pjesa e tretë, 23.09.2011:  
<https://www.youtube.com/watch?v=D673tLZUDIE>

e Kosovës është krijuar “kombi kosovar”. Por ky krahasim nuk shkon, sepse ndërsa historia ka punuar në favor të krijimit nga ish-rumunët e Moldavisë të kombit moldav multientik, ajo (historia) nuk ka punuar në favor të krijimit nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar bietnik”.

● Këto janë arsyt kryesore, pse Spahiu as nëpërmjet të shembullit të krijimit nga ish-rumunët e Moldavisë të kombit moldav, nuk mund ta përlijë propagandën e tij të çoroditur për gjoja krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues.

---

**ME SHEMBULLIN E KRIJIMIT TË KOMBIT MAQEDON  
NUK MUND TË PËRLIGJET GJOJA KRIJIMI NGA  
SHQIPTARËT E KOSOVËS TË “KOMBIT KOSOVAR”**

Në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se si Nexhmedin Spahiu edhe nëpërmjet të shembullit të krijimit të kombit maqedon, sipas tij nga ish-popullata sllavo-bullgare e Maqedonisë, është përpjekur e përpiket ta përlijë propagandën e tij për gjoja krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues.

Por, po në këtë kapitull dua t'i sqaroj lexuesit, se Spahiu as me shembullin e krijimit të kombit maqedon nuk mund ta përlijë propagandën e tij për gjoja krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”. Kjo, sepse gjasat që kombi maqedon të mos ketë prejardhje etnike sllavo-bullgare, por të ketë prejardhje pellazgo-ilire, ashtu si kombi shqiptar, janë të mëdha.

Dhe nëse kombi i sotëm maqedon nuk ka prejardhje sllavo-bullgare, kjo tregon se ai nuk është krijuar si shkëputje nga kombi bullgar, siç na thotë Spahiu, por është krijuar si një komb tjetër i veçantë maqedon, me prejardhje pellzgo-ilire, si shqiptarët.

Dhe nëse kombi maqedon nuk është krijuar si shkëputje nga kombi bullgar, por është krijuar që në fillimet e tij si një komb tjetër i veçantë, kjo tregon se Spahiu nuk mund ta krahasojë krijimin e kombit maqedon me krijimin, sipas tij, nga shqiptarët e Kosovës të kombit “kosovar”.

Por, edhe nëse kombi maqedon është krijuar si shkëputje nga ish-popullata bullgare që ka jetuar në pjesën lindore të Maqedonisë së Veriut, kjo nuk do të thotë aspak se edhe popullata shqiptare e Kosovës duhet të ndjekë shembullin e ish-popullatës bullgare të Maqedonisë, duke u tjetërsuar nga komb shqiptar në “komb kosovar”.

Më tej dua t'i sqaroj lexuesit se, ndërsa Maqedonia e sotme e Veriut, brenda periudhës kohore 1945-1991 ka qenë një Republikë e Jugosllavisë Federative, historianët e asaj periudhe kohore të ndikuar nga politikat pansllaviste jugosllave-ruse, kombin maqedon e kanë nxjerrë vazhdimisht me prejardhje etnike sllave.

Por, pas pavarësimit të Maqedonisë në shtatorin e vitit 1991 e këtej, gjithnjë e më shumë kanë gjetur vend ata zëra, që kombin e sotëm maqedon nuk e nxjerrin me origjinë sllave si dikur e një kohë, por e nxjerrin me origjinë pellazgo-ilire, si edhe shqiptarët.

### **Historia e Maqedonisë antike dhe e Aleksandrit të Madh janë përvetësuar nga historiografia e Greqisë**

● Historianët grekë dhe jogrekë të shekujve XVIII, XIX dhe të shekullit XX, nëpërmjet shtrembërimit të fakteve historike kanë arritur që ta bindin botën, sikur gjoja historia e Maqedonisë antike, ekzistuese gjatë periudhës kohore nga shekulli VII para erës së re e deri në vitin 146 pas erës së re, kur Maqedonia antike është pushtuar nga Perandoria Romake, ka qenë pjesë përbërëse e historisë së Greqisë.

● Por edhe përvetësimi i historisë së një kombi nga një komb tjetër ka një kufi e një fund. Kështu, faktet historike të njohura që herët dhe faktet historike të njohura së voni (sidomos ato të tri dekadave të fundit), kanë treguar dhe tregojnë se historia e Maqedonisë antike dhe e Aleksandrit të Madh nuk kanë të bëjnë aspak me historinë e Greqisë, por kanë të bëjnë historinë e dy kombeve të tjera të së njëjtës origjinë pellazgo-ilire, siç janë kombi shqiptar dhe kombi maqedon.

## Të dhëna historike që flasin se në territorin e Maqedonisë antike kanë jetuar fiset pellazgo-ilire

● **Straboni**, historian dhe gjeograf i kohëve antike, ka shkruar shumë herë se rajonet rreth Lynkusit, Pelagonias, Orestias dhe Elimais, që dikur janë quajtur Maqedoni e Epërme, kurse më vonë janë quajtur Maqedonia e Lirë, kanë qenë të banuara me maqedonë që nuk kanë qenë grekë<sup>339</sup>.

● Sipas **Didorit**, përshkruesit të historisë së Greqisë antike, del se në shekullin IV para erës së re ushtarët maqedonë nuk kanë lejuar të udhëhiqen nga komandantët grekë<sup>340</sup>, gjë që tregon se maqedonët e vjetër nuk kanë qenë grekë.

● **Markus Justinusi**, përshkruesi romak i historisë antike ka shkruar se Maqedonia antike kishte një popullsi pellazge dhe ilire, njësoj si Epiri dhe Iliria. Maqedonia më parë ishte quajtur *Emathia*, nga emri i mbretit Emathion. Banorët e saj ishin quajtur pellazgë, kurse vendi ishte quajtur Paonia<sup>341</sup>.

● **Malte Bruni** ka shkruar se “shqiptarët janë pasardhës të fiseve ilire, që flasin një gjuhë që ishte e lidhur me atë të pellazgëve, dardanëve, grekeve dhe **maqedonëve**. Sidoqoftë, ne i identifikojmë shqiptarët si ilirë dhe gjuhën e tyre si pellazge”<sup>342</sup>

● **Johan von Han**, albanolog gjerman, në kuadër të studimeve shqiptare, ilirët, epirotët dhe **maqedonët** i ka klasifikuar në një grup të përbashkët linguistik dhe i ka shtuar teorisë së Malte Brunit identifikimin e shqiptarëve si pellazgë<sup>343</sup>.

● **Marin Barleti**, historian dhe prift nga Shkodra, Skënderbeun e quan “prijës të epirotëve”, që do të thotë të fiseve ilire epirotase,

---

<sup>339</sup> Straboni, libri VII, 7.8. Cituar nga Elena Kocaqi në librin me titull: *Pellazgët - origjina e shqiptarëve*, Tiranë 2021, f. 17.

<sup>340</sup> Didor <https://de.wikipedia.org/wiki/Diodor>

<sup>341</sup> Marcus Junianus Justinus, *Epitome of the Phillippik Hystory of Pompeius Trogus*. Përkthyer John Selby Watson. London 1853. Lib. VII. 1. Cituar në librin e Elena Kocaqit me titull: *Pellazgët - origjina e shqiptarëve*, Tiranë 2021, f. 18.

<sup>342</sup> Stephanie Schwandner-Sieveres, Brend Jürgen Fischer, *Albanian Identities: Myth und History*, USA 2002, f. 75; cituar në librin e Eelena Kocaqit me titull: *Pellazgët - origjina e shqiptarëve*, Tiranë 2021, f. 40.

<sup>343</sup> Stephanie Schwandner-Sieveres, Brend Jürgen Fischer, *Albanian Identities: Myth und History*, USA 2002, f. 76; Cituar në librin e Elena Kocaqit me titull: *Pellazgët - origjina e shqiptarëve*, Tiranë 2021, f. 41.

kurse kur shkruan për vendbanimet e epirotasve (shqiptarëve), thotë se një pjesë e tyre “jeton në Peloponez”, një pjesë në **Maqedoni** dhe një në Epir<sup>344</sup>.

● **Jakob Fallmerayer**, studiues gjerman i shekullit XIX, ka shkruar se “shqiptarët përbënin një komb të pavarur në Greqi. I gjithë rajoni midis lumit Drin dhe maleve Chimaera (Himarës) quhej Shqipëri. Më vonë, Epiri, Etolia dhe një pjesë e Thesalisë dhe e **Maqedonisë**, do të quheshin gjithashtu Shqipëri, ose Arnautland<sup>345</sup>.

● **Engjell Sedaj**, filolog nga Kosova, ka shkruar: “Për të kuptuar situatën më qartë, nga një përshkrim anonim i shekullit XVI, thuhet se nga Gryka e Kotorrit e poshtë, fillon ai vend që sot quhet Arbëri dhe që dikur quhej **Maqedoni** dhe Epir<sup>346</sup>.

● Edhe fakti se në lojërat Olimpikë të Greqisë së lashtë nuk janë ftuar të marrin pjesë maqedonët, ngase ata duke mos qenë greqisht-folës janë konsideruar “barbarë<sup>347</sup>, po ashtu tregon se maqedonët e vjetër nuk kanë qenë grekë, por sipas të gjitha gjasave kanë qenë pjesëtarë të fise pellazgo-ilire-trakase ilirisht-folëse.

● Edhe fakti se **Filipi II i Maqedonisë** për arsimimin e djalit të tij, Aleksandrit të Madh të Maqedonisë, ka angazhuar Aristotelin, që ai t’i jepte mësim në gjuhën amtare ilire, tregon se fiset e vjetra maqedone duke qenë fise pellazgo-ilire-trakase, kanë qenë edhe fise ilirisht-folëse.

### **Gjasat që maqedonët e sotëm të kenë origjinë pellazgo-ilire-thrrakase janë të mëdha**

● Dhe nëse maqedonët e kohëve antike nuk kanë qenë grekë, ata aq më pak kanë mundur të jenë sllavë, sepse në kohët antike nuk ka pasur sllavë në Ballkan. Dhe nëse ata nuk kanë qenë as grekë

---

<sup>344</sup> Engjell Sedaj, *Etnonimet epirotike*: epirot, makedon, ilir (II) 2018; cituar në librin e Elena Kocaqit me titull: Pellazgët-origjina e shqiptarëve, Tiranë 2021, f. 48.

<sup>345</sup> Jacob Phillip Fallmerayer, *Geschichte der Halbinsel Morea während des Mittelalters*, Volume 2, f. 240 -263. Përkthyer nga Robert Else; cituar në librin e Elena Kocaqit me titull: Pellazgët-origjina e shqiptarëve, Tiranë 2021, f. 51.

<sup>346</sup> Engjell Sedaj, *Etnonimet epirotike*: epirot, makedon, ilir (II) 2018; cituar në librin e Elena Kocaqit me titull: Pellazgët - origjina e shqiptarëve, Tiranë 2021, f. 49.

<sup>347</sup> Makedonien: [https://de.wikipedia.org/wiki/Makedonien#Altertum\\_\(ca.\\_1400\\_v.\\_Chr.\\_bis\\_600\\_n.\\_Chr.\)](https://de.wikipedia.org/wiki/Makedonien#Altertum_(ca._1400_v._Chr._bis_600_n._Chr.))

dhe as sllavë, shtrohet pyetja: *çfarë ka kanë qenë?* Logjika thotë se nuk kanë mundur të jenë tjetër, përveçse fise pellazgo-ilire-trakase, që kanë jetuar në territorin e Maqedonisë Antike.

● Duke u nisur nga të dhënat historike të cituara më lart, del se kombi i sotëm maqedon me gjasa të mëdha nuk ka prejardhje sllavo-bullgare dhe, për rrjedhojë, edhe nuk është krijuar si shkëputje nga kombi bullgar, por është krijuar si komb më vete: si komb maqedon me prejardhje pellazgo-ilire, si edhe shqiptarët.

● Natyrisht, fjalën e fundit lidhur me prejardhjen etnike të kombit maqedon nuk e kam unë, por e kanë studimet dhe hulumtimet e mëtejshme historike, arkeologjike, antropologjike dhe të tjera, por unë me këtë rast paraqita vetëm hipotezën time të bazuar pak a shumë edhe në disa argumente historike të citura më lart.

### **Popullata sllavisht-folëse e Maqedonisë intuitivisht nuk është ndier me origjinë sllavo-bullgare**

● Se popullata e sotme maqedone mund të ketë origjinë pellazgo-ilire, flet edhe fakti se popullata ortodokse maqedone që ka jetuar në gjysmën lindore të Maqedonisë së sotme, në të gjitha momentet vendimtare historike, as nuk ka dashur të bëhej pjesë e kombit bullgar, dhe as nuk ka dashur që Maqedonia të bëhej pjesë e Bullgarisë.

● Kjo tregon se popullata maqedone deri vonë e paarsimuar, intuitivisht nuk e ka ndier veten pjesë të kombit bullgar, por e ka ndier veten si një komb tjetër i veçantë maqedon. Kështu, edhe pse gjatë **Luftërave Ballkanike 1912-1913**, gjatë **Luftës së Parë Botërore 1914-1918** dhe gjatë **Luftës së Dytë Botërore 1941-1945**, Maqedonia e sotme ka qenë e pushtuar nga Bullgaria, popullata maqedone nuk e ka preferuar bashkimin e Maqedonisë me Bullgarinë.

### **Pranimi i përkatësisë kombëtare shqiptare nga disa figura politike maqedone**

● Se popullata sllavisht-folëse e gjysmës lindore të Maqedonisë së Veriut mund të ketë prejardhje etnike pellazgo-ilire, për këtë nuk flasin vetëm të dhënat e historianëve antikë dhe të mesjetës, por

këto vitet e fundit ka folur edhe pranimi i përkatësisë kombëtare shqiptare, nga ana e disa politikanëve dhe intelektualëve maqedonë.

- Kështu, në vitin 2017, vetë Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, nga radhët e Partisë *Lidhja Social-Demokrate e Maqedonisë* (LSDM), ka deklaruar se gjyshi i tij ka qenë shqiptar ortodoks, si dhe ka thënë se në Ballkan janë disa rreth 20 milionë banorë me prejardhje etnike Ilire.

- Edhe një ish-ministri i Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut, Vllado Buçkovski, në biseda private me politikanët shqiptarë ka pranuar origjinën e tij shqiptare.

- Edhe ish-akademiku i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë së Veriut dhe poeti i njohur Matea Matevski<sup>348</sup> (1929-2018), që një kohë ka qenë edhe drejtor i Radio-Televizionit të Shkupit, ka qenë nga një familje shqiptare ortodokse, që ka jetuar në fëmijërinë e tij në Stamboll të Turqisë<sup>349</sup>.

- Dhe së fundmi, edhe shumë maqedonë të tjerë intelektualë dhe jointelektualë, në këto tri dekadat e fundit në mënyrë konfidenciale kanë pranuar origjinën e tyre shqiptare, para shqiptarëve me të cilët kanë pasur kontakte pune apo shoqërore.

- Pranimi i përkatësisë kombëtare shqiptare nga ana e disa intelektualëve, politikanëve dhe intelektualëve maqedonë dhe, pranimi i përkatësisë kombëtare shqiptare edhe nga shumë maqedonë të tjerë, sipas të gjitha gjasave paraqet vetëm fillimin e shpalesjes së një vërtete të fshehtë për më shumë se 2000 vjet: të fshehtë e prejardhjes etnike pellazgo-ilire të popullatës së sotme maqedone, që jeton në gjysmën lindore të Maqedonisë së Veriut.

---

<sup>348</sup> Matevski lindi më 13 mars 1929 në Stamboll, Turqi, në një familje shqiptare të rritit ortodoks lindor.[3] Familja e tij banonte përkohësisht në Turqi për punë. Matevski është diplomuar në Fakultetin Filologjik në Shkup. Punoj si gazetar në Radio-Televizionin Maqedonas, redaktor i programit kulturor dhe letrar, kryeredaktor dhe drejtor i televizionit, si dhe drejtor i përgjithshëm i Radio-Televizionit të Shkupit. Ai ka mbajtur edhe funksionin e kryetarit të Komisionit për Marrëdhënie Kulturore jashtë Vendlit dhe ka qenë anëtar i kryesisë së RS-së së Maqedonisë. Ka qenë redaktor në shtëpinë botuese "Çoço Racin". Ka shërbyer si profesor i historisë së dramës botërore dhe profesor në Fakultetin e Arteve Dramatike në Shkup.

<sup>349</sup> Mateja MATEVSKI<. [https://en.wikipedia.org/wiki/Mateja\\_Matevski](https://en.wikipedia.org/wiki/Mateja_Matevski)

## **Ngjizja fillestare e kombit maqedon ka filluar që para Kongresit të Berlinit në vitin 1878**

Spahiu duke dashur që, nëpërmjet krijimit të kombit maqedon të përligjë propagandën e tij për gjoja krijimin e “kombit kosovar”, ka shkruar për kombin maqedon si në vijim:

■ **Pasi Serbia përmes Luftërave Ballkanike pushtoi Maqedoninë dhe procesi i serbizimit të bullgarëve të Maqedonisë dështoi, ngjarjet historike rezultuan me formimin e kombit maqedonas<sup>350</sup>**

■ **Ideologët e tyre ....për të forcuar sa më shumë identitetin kombëtar, shkuan aq larg sa edhe mohuan etninë e tyre bullgare. Gjuhën e tyre e quajnë maqedone edhe pse gjatë bisedave mes zyrtarëve maqedonë dhe bullgarë nuk ka nevojë për përkthyes<sup>351</sup>**

■ **Sidoqoftë, është e drejtë e tyre politike që etninë e tyre ta konsiderojnë ashtu siç duan vetë edhe përkundër faktit se krye-heroi i tyre, Goce Delçevi, veten e ka konsideruar bullgar, dhe VMRO-ja ka synuar që territori i Maqedonisë t'i bashkëngjitet Bullgarisë<sup>352</sup>.**

● Sipas thënieve të Spahiut të cituara më lart, del se kombi maqedon është strukturuar si komb gjatë dhe pas Luftërave Ballkanike të viteve 1912-1913, kur Fuqitë e Mëdha Maqedoninë e sotme ia kanë aneksuar Serbisë, por sot ka të dhëna të mjaftueshme, të cilat flasin se kombi maqedon ngjizjen e tij si komb e ka filluar në çerekun e fundit të shekullit XIX.

● Është e vërtetë se Serbia pas aneksimit të Maqedonisë në vitet 1912-1913 ka synuar serbizimin e popullatës sllavisht-folëse të Maqedonisë, por për vetë faktin se pjesa dërmuese e popullatës sllavisht-folëse ortodokse e Maqedonisë së sotme, nuk është ndier as si popullatë serbe dhe as si popullatë bullgare, por është ndier popullatë e mëvetësishme maqedone që para Kongresit të Berlinit të vitit 1878, kjo tregon se Spahiu nuk ka të drejtë që popullatën e

<sup>350</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit* <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

<sup>351</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit* <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

<sup>352</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit* <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

dikurshme dhe të sotme maqedone ta konsiderojë si ish-popullatë sllavo-bullgare të Maqedonisë, vetëm pse ajo flet një variant të gjuhës bullgare.

### **Ideologët e kombit maqedon e kanë konsideruar veten maqedonë dhe jo bullgarë**

Spahiu lidhur me krijimin e kombit maqedon, sipas tij, si një shkëputje nga kombi bullgar, ka dhënë dy pohime të kundërta me njëra-tjetrën, që janë si në vijim:

■ **Goce Delçevi që konsiderohet heroi i Maqedonisë vetes i ka thonë bullgar, dhe atë jo i territorit ku oshtë sot Maqedonia, por i territorit të Greqisë veriore. Goce Delçevi ka dashtë me bashkue Maqedonin me Bullgarinë<sup>353</sup>. (min. 45:30 - 46:24)**

■ **Ideologët e tyre për të forcuar sa më shume identitetin kombëtar, shkuan aq larg sa edhe mohuan etninë e tyre bullgare. Gjuhën e tyre e quajnë maqedone edhe pse gjatë bisedave mes zyrtarëve maqedonë dhe bullgarë nuk ka nevojë për përkthyes<sup>354</sup>.**

● Spahiu në pohimin e tij të parë thotë se heroi i kombit maqedon, Goce Delçevi, veten e ka konsideruar bullgar dhe Maqedoninë ka dashur t'ia bashkojë Bullgarisë, kurse në pohimin e tij të dytë thotë se ideologët e kombit maqedon (ku ka bërë pjesë edhe Goce Delçevi), për ta fuqizuar krijimin e kombit maqedon kanë mohuar prejardhjen e tyre etnike bullgare, kurse gjuhën e tyre e kanë quajtur gjuhë maqedone, edhe pse maqedonët dhe bullgarët flasin pa përkthyes.

● Këto dy pohime kontradiktore të Spahiut të cituara më lartë tregojnë se Spahiu duke mos e njohur historikun e krijimit të kombit maqedon, flet për kombin maqedon kuturu çka i bie në mend, duke e ekonsideruar atë *a priori* me origjinë sllavo-mongolo-bullgare dhe si një shkëutje nga kombi bullgar.

● Për vetë faktin se Goce Delçevi ka qëndruar në krye të Lëvizjes Kombëtare Maqedone që në vitin 1894, ai nuk e ka ndier veten bullgar, por e ka ndier veten maqedon. Edhe shokët e tij të ngushtë,

<sup>353</sup> Debat i nxehtë "Kombi kosovar" me Nexhmedin Spahiun, *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

<sup>354</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit*: <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

si Dame Gruevi, Nikolla Karevi, Pitu Guli (Pjetër Guri, shqiptar), Sugarevi, Uzinovi e të tjerë, duke qenë bashkë me Delçevin në krye të Lëvizjes Kombëtare Maqedone, nuk e kanë ndier veten bullgarë, por e kanë ndier maqedonë.

● Goce Delçevi së bashku me shokët e tij të përmendur më lart, pikërisht pse janë ndier maqedonë, kanë organizuar **Kryengritjen Antiosmane Maqedone të Ilindenit me 3 gusht të vitit 1903, e cila ka rezultuar me krijimin e Republikës së Krushevës**, që ka paraqitur strukturën e parë shtetërore të shtetit të Maqedonisë së Veriut që kemi sot.

### **Gjuha të shumtën e herëve identifikohet me kombin, por jo në të gjitha rastet**

Spahiu për të na bindur se kombi maqedon ka prejardhje etnike bullgare, ka shkruar edhe si në vijim:

■ **Bullgaria dhe Maqedonia, kur flasin kryeministrat flasin pa përkthyes, sepse flasin t'njëjtën gjuhë...<sup>355</sup>. (min. 22: 25 -22:35)**

● Është e vërtetë se gjuha maqedone është pothuajse e njëjtë me gjuhën bullgare, por kjo nuk flet domosdoshmërisht se maqedonët dhe bullgarët janë i njëjti popull e komb. Po ashtu, është e vërtetë se gjuha të shumtën e herëve identifikohet me kombin, por jo në të gjitha rastet. Kur është fjala për një gjuhë, e cila flitet vetëm nga një komb i caktuar dhe nuk flitet nga asnjë komb tjetër, ajo gjuhë identifikohet me kombin, i cili e flet atë gjuhë. Kështu, meqë gjuha shqipe flitet vetëm nga kombi shqiptar dhe nuk flitet nga asnjë komb tjetër, ajo si e tillë identifikohet me kombin shqiptar.

● Por, kur një gjuhë flitet nga dy e më shumë kombe të ndryshme, siç është rasti me gjuhën angleze, që flitet nga shumë kombe, ajo si e tillë nuk identifikohet me ndonjë komb të caktuar. Kështu, edhe gjuha bullgare për vetë faktin se flitet, thënë kushtimisht nga dy kombe të ndryshme (nga kombi bullgar dhe kombi maqedon), ajo si e tillë nuk identifikohet automatikisht me kombin bullgar, sepse atë e flet edhe kombi maqedon.

---

<sup>355</sup> Nexhmedin Spahiu, mysafir i Mustafa Nanos në *Ora News*; <https://www.youtube.com/watch?v=sc9ysopyfxo>

## **Gjasat flasin se maqedonët fillimisht kanë folur gjuhën pellazgo-ilire, kurse më pas gjuhën sllavo-bullgare**

● Duke pasur parasysh se në territorin e Maqedonisë së sotme Veriore, në kohët antike, por edhe gjatë mesjetës kanë jetuar fiset pellazgo-ilire-trakase, kjo flet në favor të hipotezës se maqedonët e sotëm gjatë kohëve antike e deri në shekujt VIII-X të mesjetës, kur Maqedonia ka qenë nën sundimin e dy perandorive bullgare, do të kanë folur gjuhën pellazgo-ilire, të cilën pastaj gjatë sundimit të dy Perandorive Bullgare do ta kenë braktisur, duke e zëvendësuar me një variant të gjuhës sllavo-bullgare, të cilën popullata maqedone e flet edhe sot.

### **Rilindësit maqedonë nuk e kanë dashur bashkimin e Maqedonisë me Bullgarinë**

Spahi u duke thënë se rilindësit maqedonë e kanë synuar bashkimin e Maqedonisë me Bullgarinë është shprehur edhe si më poshtë:

■ **Goce Delçevi nuk ka dasht me e krijue Maqedonin. Ata kanë desht me bashkue Maqedonin me Bullgarin**<sup>356</sup>. (min. 45:30 - 46:24)

■ **Edhe rilindasit tonë kanë dasht me bashkue (Kosovën me Shqipërinë, shën. aut.)**<sup>357</sup>. (min. 46:15 - 46:17)

● Pajtohem me thënien e Spahiut, se rilindësit shqiptarë kanë dashur ta bashkojnë Kosovën me Shqipërinë, por rilindësit maqedonë (Goce Delçevi, Dame Gruevi, Nikolla Karevi, Dinu Vangjeli, Sugarevi, Uzinovi dhe Pjetër Guri, ky i fundit shqiptar), duke u ndier maqedonë dhe jo bullgarë, nuk kanë dashur që Maqedoninë t'ia bashkonin Bullgarisë, siç mund t'i duket Spahiut.

● Kjo mosdashje e rilindësve të kombit maqedon për bashkimin e Maqedonisë shtetit të Bullgarisë, ka folur e flet në dobi të mendimit se kombi maqedon dhe kombi bullgar, sipas të gjitha gjasave, nuk kanë qenë e nuk janë i njëjti komb, por kanë qenë e janë dy kombe të ndryshme. Por rilindësit maqedonë këtë mosdashje për

<sup>356</sup> Debat i nxehtë "Kombi kosovar" me Nexhmedin Spahiun: *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

<sup>357</sup> Po aty: Debat i nxehtë "Kombi kosovar" me Nexhmedin Spahiun: *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

bashkimin e Maqedonisë shtetit të Bullgarisë, siç kam shkruar më poshtë, e kanë paguar shtrenjtë me kokë.

### **Mes maqedonëve në gjysmën lindore të Maqedonisë dhe shtetit bullgar ka pasur luftëra klandestine**

Spahiu duke teorizuar lidhur me raportet e shteteve dyshe në Ballkan, ndër të tjera është shprehur edhe si në vijim:

■ **Mali i Zi dhe Serbia skan luftue mes veti, as Moldavia e Rumania skan luftue ndër veti, as Maqedonia e Bullgaria skan luftu ndër veti, as Kosova e Shqipnia skan me luftue ndër veti, mos u tut<sup>358</sup>. (min. 46:30 - 46:42)**

● Pajtohem me Spahiun, se as Mali i Zi dhe Serbia, as Moldavia e Rumunia dhe as Kosova e Shqipëria nuk kanë luftuar mes tyre, por kur është fjala për Maqedoninë dhe Bullgarinë, puna qëndron ndryshe.

● Mes Maqedonisë dhe Bullgarisë nuk ka pasur luftëra frontale, por mes çetave klandestine pro-maqedone që kanë synuar konsolidimin e kombit maqedon dhe të shtetit të pavarur të Maqedonisë, dhe çetave klandestine pro-bullgare me klandestinë vendas dhe klandestinë të ardhur nga Bullgaria, që kanë synuar bashkimin e kombit maqedon me kombin bullgar dhe bashkimin e Maqedonisë me Bullgarinë, kanë ndodhur konflikte të herëpashershme të armatosura, duke filluar që nga kohët e Kongresit të Berlinit të vitit 1878 e deri në prag të Luftës së Dytë Botërore në vitet 1940-1941.

● Këto konflikte të armatosura mes çetave klandestine promaqedone dhe probullgare, po ashtu paraqesin indikacione, të cilat flasin në dobi të mendimit, se maqedonët dhe bullgarët nuk u kanë takuar të njëjtit komb bullgar, por u kanë takuar dy kombeve të ndryshme: njëri bullgar e tjetri maqedon.

### **Vrasjet me atentate të fshehta**

● Krahu pro-bullgar i **OFMRO-se** (Organizatës së Fshehtë Revolucionare Maqedono-Odrinase), që në gjuhën maqedone është

---

<sup>358</sup> Debat i nxehtë "Kombi kosovar" me Nexhmedin Spahiun: *Valamala Show*, më 24.06.2013: <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>.

quajtur **TMORO** (Tajana Maked-nosko-Odrinska Revolucionerna Organizacija -**TMORO**)<sup>359</sup>, duke u angazhuar për identifikimin e popullatës maqedone me kombin bullgar dhe për bashkimin e Maqedonisë me Bullgarinë, gjatë viteve 1878-1912 ka vrarë me atentate të fshehta krerët kryesorë të krahut pro-maqedon të **OFRMO-së**, pse ata janë angazhuar për konsolidimin e kombit maqedon jashtë kombit bullgar dhe për krijimin e shtetit të pavarur të Maqedonisë jashtë shtetit të Bullgarisë.

● Kështu, nga krahu pro-bullgar i OFMRO-së janë vrarë me atentate të fshehta: Nikolla Karevi në vitin 1905 në moshën 28-vjeçare<sup>360</sup>, Dame Gruevi në vitin 1906 në moshën 35-vjeçare<sup>361</sup>, Sugrevi dhe Uzinovi po ashtu janë vrarë me atentate të fshehta<sup>362</sup>, kurse Goce Delçevi është vrarë nga xhandarmëria turke në majin e vitit 1903 në moshën 31-vjeçare<sup>363</sup>, duke e nxjerrë atë në pritën e xhandarmërisë turke krahu pro-bullgar i OFRMO-së, në fshatin Banicë të krahinës së Serrit në veri të Greqisë<sup>364</sup>.

● Por edhe krahu pro-maqedon i OFRMO-së, përkatësisht i TMORO-së në gjuhën maqedone, brenda viteve 1878-1912, në shenjë hakmarrjeje ka vrarë me atentate të fshehta krerët kryesorë të krahut pro-bullgar të OFMRO-së, siç kanë qenë Serafimoski, Gavranovi, Matovi dhe të tjerë<sup>365</sup>.

### Krijimi i VMRO-së në vitin 1919

● VMRO-ja (maqedonisht “Vnatreshna Makedonska Revolucionerna Organizacija”) (shqip “Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedone-OBRM”), është themeluar pas Luftës së Parë Botërore në vitin 1919 nga Todor Aleksandrovi, që ka qenë një nga pasardhësit e “Organizatës së Fshehtë Revolucionare Maqedono-Odrinase-OFRMO, maqedonisht “Tajana Maked-nos-

---

<sup>359</sup> [https://de.wikipedia.org/wiki/Innere\\_Mazedonische\\_Revolutionäre\\_Organisation](https://de.wikipedia.org/wiki/Innere_Mazedonische_Revolutionäre_Organisation)

<sup>360</sup> Historia e Popullit Maqedonas, Shkup 1983.

<sup>361</sup> Goce\_Delçe: [https://sh.wikipedia.org/wiki/Goce\\_Delçe](https://sh.wikipedia.org/wiki/Goce_Delçe)

<sup>362</sup> Historia e Popullit Maqedonas, Shkup 1983

<sup>363</sup> Historia e Popullit Maqedonas, Shkup 1983

<sup>364</sup> Historia e Popullit Maqedonas, Shkup 1983

<sup>365</sup> Historia e Popullit Maqedonas, Shkup 1983.

ko-Odrinska **Revolucionerna Organizacija -TMORO**<sup>366</sup>.

● Por edhe VMRO-ja, si edhe pararendësja e saj, OFMRO-ja, po ashtu ka qenë e ndarë në dy krahe politike: në krahun djathtë politik, që është angazhuar për bashkimin e kombit maqedon me kombin bullgar dhe për bashkimin e Maqedonisë me Bullgarin, dhe në krahun e majtë politik, që është angazhuar për konsolidimin e kombit maqedon jashtë kombit bullgar dhe për krijimin e shtetit të Maqedonisë jashtë Bullgarisë.

● Ndarja e VMRO-së në dy krahe politike ka bërë që krahu i majtë i VMRO-së në vitin 1925 të krijojë “VMRO-në e Bashkuar”, e cila duke iu kthyer traditës së Republikës së Krushevës, është distancuar nga kursi pro-bullgar i krahut të djathtë politik të VMRO-së<sup>367</sup>.

● Por me krahun e majtë të VMRO-së nuk është pajtuar krahu i djathtë i VMRO-së, i angazhuar për bashkimin e kombit maqedon me kombin bullgar dhe për bashkimin e Maqedonisë me shtetin e Bullgarisë. Mospajtimet mes dy krahëve të VMRO-së sërish janë shoqëruar me konflikte të herëpashershme me armë në mes të çetave klandestine pro maqedone dhe të çetave klandestine probullgare.

### **Biografia e Goce Delçevit**

Goce Delçevi ka lindur në vitin 1872 në fshatin Kukush (sot në Greqinë Veriore me emrin Klikis) dhe ka vdekur duke u vrarë në pritë nga xhandarmëria osmane më 4 maj të vitit 1903, në vendin e quajtur Banica në rrethin e Serrit (sot po ashtu në Greqinë Veriore).

Fshati Kakush dhe Banica historikisht i kanë takuar **Maqedonisë së Egjeut**<sup>368</sup>, që gjatë sundimit osman është njohur si Vilajet i

---

<sup>366</sup> [https://de.wikipedia.org/wiki/Innere\\_Mazedonische\\_Revolutionäre\\_Organisation](https://de.wikipedia.org/wiki/Innere_Mazedonische_Revolutionäre_Organisation)

<sup>367</sup> Innere Mazedonische Revolutionäre Organisation

[https://de.wikipedia.org/wiki/Innere\\_Mazedonische\\_Revolutionäre\\_Organisation](https://de.wikipedia.org/wiki/Innere_Mazedonische_Revolutionäre_Organisation)

<sup>368</sup> Statistikat e dhëna në librin “Historia e Popullit Maqedonas të botuar në vitin 1983, flasin a se në Vilajetin e Selanikut, të njohur si Maqedonia e Egjeut, deri në vitin 1923 kanë jetuar rreth 450 000 turq, 280 000 grekë, 230 000 bullgarë (alias maqedonë), 105 000 shqiptarë, 41 000 hebrej dhe disa pakica të tjera. Por, po ashtu ka të dhëna se shumica e atyre 450 000 turqve që kanë jetuar në Vilajetin e Selanikut, në fakt kanë qenë shqiptarë të besimit mysliman të turqizuar nga Perandoria Osmane, të cilët Greqia nëpërmjet Marrëveshjes së Lozanës të vitit 1923 me Turqinë për shkëmbimin reciprok të popullatave, i ka pastruar etnikisht, duke i vendosur dhunshëm në Turqi.

Selanikut, dhe që deri në vitin 1912 ka qenë pjesë e Perandorisë Osmane.

Delçevi, pasi ka kryer gjimnazin për meshkuj në Selanik, ka filluar Akademinë Ushtarake në Sofje të Bullgarisë, prej së cilës për shkak të ideve socialiste dhe ideve pro-maqedone që ka pasur është përjashtuar.

Delçevi në vitin 1894, i gjendur në qytetin e Shtipit në Maqedoninë e sotme, ka rënë në kontakt me revolucionarin Dame Gruevin, i cili Delçevin e ka vënë në kontakt me **“Organizatën e Fshehtë Revolucionare Maqedone-Odrinase -OFRMO”**, që në gjuhën maqedone është quajtur **“Tajana Mekednosko-Odrinska Revolucionerna Organizacija -TMORO”**<sup>369</sup>, duke u bërë ai kryetar i saj

Në vitin 1900 Delçevi ka themeluar degët e OFRMO-së në Trakinë Perëndimore në veri të Greqisë dhe në Trakinë Lindore që paraqet Turqinë Europiane, të quajtur në gjuhën maqedone si “Odrinska Trakia”, ose në gjuhën turke si “Trakia e Edrenës”<sup>370</sup>.

Delçevi bashkë me krahun promaqedon të OFMRO-së dhe bashkë me grupimin socialist në krye me Nikolla Karevin ka organizuar kryengritjen maqedone antiosmane të Ilindenit në gushtin e vitit 1903, të cilën nuk e ka përjetuar sepse me 4 maj të vitit 1903 është vrarë nga xhandarmëria osmane në Banica të rrethit të Serrit në veri të Greqisë së sotme, ndërkohë që Kryengritja e Ilindenit ka filluar më 3 gusht të vitit 1903.

Kryengritja e Ilindenit pas luftimeve të shkurtra mes forcave kryengritëse maqedone dhe forcave turke ka rezultuar me çlirimin e Krushevës dhe shpalljen e Republikës së Krushevës.

---

<sup>369</sup> “Organizata e Fshehtë Revolucionare Maqedone-Odrinase -OFRMO”, që në gjuhën maqedone do të thotë “Tajana Mekednosko-Odrinska Revolucionerna Organizacija-TMRO”, ka ekzistuar si organizatë politiko-ushtarake brenda viteve 1892-1919. Ajo ka pasur brenda vetes si krahun promaqedon, ashtu edhe krahun probullgar, të armiqësuar ekstremisht mes tyre për shkaqe politike. Në mesin e çetave klandestine promaqedone dhe çetave klandestine probullgare të TMORO-së ka pasur konflikte me armë, kurse krerët promaqedonë dhe probullgarë të TMORO-së janë vrarë mes tyre me atentate të fshehta.

<sup>370</sup> Iwan Karajotow, Stojan Rajtschewski, Mitko Iwanow: История на Бургас. От древността до средата на XX век (zu dt. “Geschichte der Stadt Burgas. Von der Antike bis zur Mitte des 20. Jahrhunderts”). Verlag Tafprint OOD, Plowdiw, 2011, ISBN 978-954-92689-1-1; S. 192.

Këshilli i Përgjithshëm i Republikës së Krushevës është përbërë nga 60 këshilltarë: 20 maqedonë, 20 shqiptarë dhe 20 vllahë. Nga Këshilli i Republikës së Krushevës është emëruar Qeveria e Përkohshme prej gjashtë vetash, me në krye Dinu Vangjelin.

Republika e Krushevës ka qenë jetëshkurtër. Ajo ka ekzistuar nga 3 gushti deri më 13 tetor të vitit 1903, sepse për zhbërjen e saj nuk u angazhuan vetëm ushtritë turke, por edhe figurat politike të krahut pro-bullgar të OFMRO-së (Organizatës së Fshehtë Revolucionare Maqedone-Odrinase), të cilat nuk ishin për krijimin e kombit maqedon dhe për krijimin e shtetit të pavarur të Maqedonisë, por ishin për bashkimin e popullatës maqedone me kombin bullgar dhe për bashkimin e Maqedonisë me Bullgarinë. Meqë Delçevi është shpallur Hero Kombëtar i Maqedonisë në vitin 1946, mbetjet e tij mortore janë marrë nga Greqia dhe janë varrosur në qytetin e Shkupit në Maqedoni. Por Goce Delçevin edhe Bullgaria, për shkak të qëllimeve aneksuese ndaj Maqedonisë, e ka shpallur Hero Kombëtar të Bullgarisë.

### **Raporti Kosovë-Shqipëri nuk ka qenë dhe nuk është i njëjtë me raportin Bullgari-Maqedoni**

Spahiu duke dashur ta përligjë propagandën tij për gjoja krijimin nga pjesa e kombit shqiptar në Kosovë të “kombit kosovar”, është shprehur edhe si në vijim:

■ **Jo, raporti Kosovë - Shqipri asht i njëllajt me raportin Maqedoni-Bullgari**<sup>371</sup> (min 9:58 -10:02)

● Lidhur me pohimin e tillë të Spahiut dua t'i sqaroj lexuesit, se as raporti Kosovë-Shqipëri dhe as raporti Maqedoni-Bullgari nuk qëndrojnë ashtu siç mendon Spahiu. Ndërsa raporti Maqedoni-Bullgari ka gjasa të jetë një raport mes dy kombeve të ndryshme (njëri maqedon e tjetri bullgar), raporti Kosovë-Shqipëri është raport i të njëjtit komb shqiptar që jeton në Kosovë dhe në Shqipëri. Kjo është arsyeja pse raporti Kosovë-Shqipëri dhe Maqedoni-Bullgari nuk janë të njëjtë siç na thotë Spahiu.

---

<sup>371</sup> Nexhmedin Spahiu, mysafir i Mustafa Nanos në *Ora News*:  
<https://www.youtube.com/watch?v=Sc9YSOpYfXo>.

● Spahu dëshiron që kombi maqedon të jetë krijuar si një shkëputje nga kombi bullgar, për të thënë se ashtu siç kombi maqedon që është krijuar nga kombi bullgar, edhe nga kombi shqiptar në Kosovë është krijuar sipas tij, “kombi kosovar”.

### **Raportet e përgjakshme Maqedoni-Bullgari**

● Ajo që raportin Kosovë-Shqipëri nuk e bën të njëjtë me raportin Maqedoni-Bullgari, ka të bëjë me faktin se, ndërsa raporti Kosovë-Shqipëri ka qenë paqësor dhe ndërvëllazëror, raporti Maqedoni-Bullgari në masë të caktuar ka qenë i përgjakshëm. Kjo, sepse siç u tha edhe më lart, mes çetave klandestine pro-maqedone dhe pro-bullgare, si dhe në mesin e krerëve politikë pro-maqedonë dhe pro-bullgarë të së njëjtës organizatë të njohur si “**Organizata e Fshehtë Revolucionare Maqedone-Odrinase -OFRMO**”, që në gjuhën maqedone është quajtur “**Tajana Mekednosko-Odrinska Revolucionerna Organizacija -TMORO**”, gjatë periudhës kohore 1878-1912 ka pasur jo vetëm konflikte të ashpra politike, por edhe konflikte të herëpashershme të përgjakshme.

● Këto janë arsyet pse Spahiu me krijimin e kombit maqedon gjoja si një shkëputje nga kombi bullgar, nuk mund ta përllig krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues.

---

**ME SHEMBULLIN E KRIJIMIT TË KOMBIT MALAZEZ NUK  
MUND TË PËRLIGJËT GJOJA KRIJIMI NGA SHQIPTARËT  
E KOSOVËS TË “KOMBIT KOSOVAR”**

Në këtë kapitull dua që t'i sqaroj lexuesit, se si Nexhmedin Spahiu edhe nëpërmjet të shembullit të krijimit të kombit malazez, sipas tij, si një shkëputje nga kombi serb, përpiqet ta përlijë krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues.

Por po në këtë kapitull dua që t'i sqaroj lexuesit, se Spahiu as nëpërmjet shembullit të krijimit të kombit malazez, nuk mund ta përlijë propagandën e tij për gjoja krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, sepse ekzistojnë të dhëna historike të besueshme të cilat falsin se, kombi malazez sipas të gjitha gjasave nuk ka prejardhje etnike sllavo-serbe, por ka prejardhje etnike pellazgo-ilire, si edhe kombi shqiptar.

Por, edhe nëse kombi malazez është krijuar si shkëputje nga ish- popullata serbe që ka jetuar në territorin e Malit të Zi të sotëm, kjo nuk do të thotë aspak se edhe popullata shqiptare e Kosovës duhet të ndjekë shembullin e ish-popullatës sebe në Mal të Zi, duke u tjetërsuar nga komb shqiptar në “komb kosovar”.

## **Politikat hegjemoniste serbe kombin malazez e kan e kanë nxjerr me origjinë serbo-sllave**

● Ndërsa Mali i Zi gjatë periudhës kohore 1945-1991 ka qenë pjesë e Jugosllavisë Federative dhe ndërsa gjatë viteve 2002-2006 i ka takuar Unionit Serbi-Mali i Zi, shumë historianë serbë e malazezë, të ndikuar nga politikat hegjemoniste serbe, kombin malazez e kanë nxjerrë me origjinë sllavo-serbe.

● Që nga viti 2006, kur Mali i Zi u nda nga Unioni Serbi-Mali i Zi, duke u bërë shtet i pavarur, kanë dalë vazhdimisht në shesh të dhëna historike, etnologjike dhe arkeologjike, të cilat flasin se popullata ortodokse sllavisht-folëse malazeze nuk ka prejardhje etnike sllavo-serbe, por ka prejardhje etnike iliro-arbërore, gjë që tregon se kombi malazez nuk është krijuar si shkëputje nga kombi serb, siç i duket Spahiut, por është krijuar si komb i mëvetësishëm malazez me prejardhje iliro-arbërore.

### **Baballarët e kombit malazez edhe pse janë ndier serbë, janë angazhuar për shtetbërjen e Malit të Zi**

Spahiu duke dashur që nëpërmjet krijimit të kombit malazez të përlligj propagandën e tij për gjoja krijimin e “kombit kosovar”, është shprehur si në vijim:

■ **Baba i kombit malazez Njegoshi vedit i ka thon serb. Njegoshi ka dasht me bashkue Malin e Zi me Serbinë<sup>372</sup>. (min. 45:38 - 46.10)**

■ **■Ai që tani quhet babai i kombit malazez Njegoshi e madje edhe Mbreti Nikolla vetën e kanë e quajt serbë dhe jo malazez. Por tani malazeztë e konsiderojnë veten komb në vete, dhe e kemi po të njëjtin rast edhe këtu te Kosova dhe Shqipëria<sup>373</sup>. (min. 22:50 -23:12)**

■ **Rast i kundërt janë malazezët, të cilët me të dalë në jetë si komb, pretendojnë që etnia e tyre është e ndryshme nga ajo serbe, dhe gjuhën e tyre kanë filluar ta quajnë gjuhë malazeze,**

<sup>372</sup> Debat i nxehtë “Kombi kosovar” me Nexhmedin Spahiun: *Valamala Show*, më 24.06.2013 <https://www.youtube.com/watch?v=ky5d9msvA5g>

<sup>373</sup> Nexhmedin Spahiu, mysafir i Mustafâ Nanos në *Ora News*; <https://www.youtube.com/watch?v=Sc9YSOpYfXo>

## **përkundër faktit që kryeheroi i tyre kombëtar, Njegoshi, e ka konsideruar veten e tij serb<sup>374</sup>.**

● Lidhur me pohimet e Spahiut të citura më lart, do t'i sqaroj lexuesit si në vijim:

● Është e vërtetë se baballarët e kombit malazez (Petar Petroviq Njegoshi I, Petar Petroviq Njegoshi II dhe Nikolla I Petrović Njogoš, ky i fundit i njohur nga viti 1860 deri më 1910 si Princ i Malit të Zi, dhe që nga viti 1910 deri më 1918 si Mbret (Krajli) i Malit të Zi) janë ndier serbë, sepse të parët e tyre me orgjinë serbe janë vendosur nga Hercegovina në Mal të Zi.

● Por, po ashtu është e vërtetë, se baballarët e kombit malazez, edhe pse i kanë thënë vetes serbë, megjithatë, duke parë dallime të dukshme mes malazezve dhe serbëve, janë angazhuar gjatë gjithë jetës së tyre për konsolidimin e kombit malazez jashtë kombit serb, dhe për konsolidimin e Principatës së Malit të Zi jashtë Principatës së Serbisë, dhe së fundi janë angazhuar edhe për konsolidimin e Mbretërisë së Malit të Zi jashtë Mbretërisë së Serbisë.

● Kështu, të dhënat historike flasin se kur Petar Petroviq Njegoshi I në vitin 1785 ka qenë në Rusi<sup>375</sup> dhe kur Petar Petroviq Njegoshi II në vitin 1834 po ashtu ka qenë në Rusi<sup>376</sup>, nuk kanë kërkuar nga Carët e Rusisë ndihmë për t'ia bashkuar Malin e Zi Serbisë, por kanë kërkuar ndihmë për konsolidimin dhe mbrojtjen e Principatës së Malit të Zi<sup>377</sup> nga forcat e Perandorisë Osmane dhe nga forcat e Napolon Bonapartit.

### **Disa argumente, të cilat flasin se kombi malazez ka orgjinë pellazgo-ilire, përkatësisht iliro-arbërore**

● Pa hyrë në ato që kanë shkruar historianët dhe gjeografët antikë, sipas të cilëve territori i Malit të Zi duke qenë pjesë e formacionit shtetëror të Ilirisë, ka qenë i banuar me fise pellazgo-ilire, prej të cilave besohet se është krijuar kombi malazez, po përmend më poshtë vetëm disa argumente të kohëve të vona, të kapshme për secilin.

<sup>374</sup> Nexhmedin Spahiu: *Koncepti i kombit*: <https://gazetamapo.al/koncepti-i-kombit/>

<sup>375</sup> Petar I Petrović Njogoš: [https://sh.wikipedia.org/wiki/Petar\\_I\\_Petrović\\_Njogoš](https://sh.wikipedia.org/wiki/Petar_I_Petrović_Njogoš)

<sup>376</sup> Petar I Petrović Njogoš: [https://sh.wikipedia.org/wiki/Petar\\_I\\_Petrović\\_Njogoš](https://sh.wikipedia.org/wiki/Petar_I_Petrović_Njogoš)

<sup>377</sup> Petar II: [https://de.wikipedia.org/wiki/Petar\\_II](https://de.wikipedia.org/wiki/Petar_II).

**Savo Bërković (1906-1991)** historian, poet dhe politikan malazet, në librin e tij me titull “Etnogenezifobia” (në gjuhën shqipe “Etnogjenezofobia”) të botuar në Cetinje në vitin 1988, ndër të tjera ka dhënë mjaft argumente historike, të cilat flasin se kombi malazet nuk ka prejardhje sllavo-serbe, por ka prejardhje etnike iliro-arbërore, si edhe shqiptarët. Autori Bërković në librin e tij “Etnogjenezofobia”, që do të thotë *frika nga gjeneza etnike*, u është kundërvënë me fakte historike ideve serbomëdha, të orientuara kundër kombit malazet. Ai i ka gjetur (identifikuar) argumentet e falsifikuara serbe, të cilat u janë imponuar malazetve si argumente të vërteta shkencore, për t’i bindur ata sikur gjoja kanë identitetet sllavo-serb<sup>378</sup>. Kundër autorit të librit “Etnogjenezofobia”, Savo Bërkovićit, ka pasuar kritika të ashpra si nga ana e qarqeve intelektuale serbomëdha, ashtu edhe nga ana e udhëheqësve politikë malazetë, që kanë qenë vegla të shovinizmit serb, gjë që ka çuar në përjashtimin e tij nga radhët e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë (LKJ-së)<sup>379</sup>.

**Jevrem Bërković (1933 - 2021)** ka qenë romancier, poet, politikan dhe disident malazet, i cili ngaqë ka qenë i përndjekur politikisht gjatë viteve ‘90 të shekullit XX, nga ana e regjimit të Slobodan Millosheviqit, në vitin 1994 është detyruar që të mërgojë në Kroaci dhe për një kohë të shkurtër edhe në Shqipëri, po ashtu ka dhënë argumente, të cilat flasin se kombi malazet nuk ka prejardhje serbo-sllave, siç na thotë Spahiu, por ka pasur prejardhje iliro-arbërore. Këto argumente Jevrem Bërkovićin e kanë konfrontuar me qarqet serbomëdha në Mal të Zi dhe sidomos në Serbi, të cilat e kanë akuzuar atë për përçaje kombëtare<sup>380</sup>. Në vitin 2006 ndaj Jevrem Bërkovićit është ushtruar një atentat nga qarqet shoviniste serbe, me ç’rast është vrarë truproja e tij, Sergjan Vujiqiqi, që ka qenë edhe shoferi i tij, kurse ai vetë është plagosur lehtë<sup>381</sup>.

---

<sup>378</sup> Etnogenezofobia: [https://hr.wikipedia.org/wiki/Etnogenezofobija\\_-\\_prilog\\_kritici\\_velikosrpstva](https://hr.wikipedia.org/wiki/Etnogenezofobija_-_prilog_kritici_velikosrpstva)

<sup>379</sup> Etnogenezofobia [https://hr.wikipedia.org/wiki/Etnogenezofobija\\_-\\_prilog\\_kritici\\_velikosrpstva](https://hr.wikipedia.org/wiki/Etnogenezofobija_-_prilog_kritici_velikosrpstva)

<sup>380</sup> Jevrem\_Brković: [https://en.wikipedia.org/wiki/Jevrem\\_Brković](https://en.wikipedia.org/wiki/Jevrem_Brković)

<sup>381</sup> Jevrem\_Brković: [https://en.wikipedia.org/wiki/Jevrem\\_Brković](https://en.wikipedia.org/wiki/Jevrem_Brković)

**Mirash Martinoviqi** i lindur me 1952 në Andrijevicë të Malit të Zi, është shkrimtar i njohur malazez, që ka botuar romanin e tij historiko-politik me titull “Teuta”, që është përkthyer nga gjuha malazeze edhe në gjuhën shqipe dhe që është botuar në Prishtinë në vitin 2003<sup>382</sup>. Mirash Martinoviqi në romanin “Teuta” përshkruan formacionin shtetëror të Ilirisë gjatë kohës kur në krye të tij ka qenë Mbretëresha Teutë, duke dhënë argumente të shumta historiko-politike në formë të letrarizuar, të cilat flasin se malazetët nuk kanë prejardhje sllavo-serbe, por kanë prejardhje nga fiset iliro-arbërore, që kanë jetuar në territorin e Malit të Zi.

● Dhe se malazetët kanë prejardhje iliro-arbërore-shqiptare, për këtë flasin qartë edhe vetë mbiemrat e shumicës së malazetëve të sotëm, që janë mbiemra të njohur të dymbëdhjetë fiseve kryesore shqiptare dhe të shumë nënfiseve shqiptare, të cilëve u janë shtuar prapashtesat “viç” apo “iç” të gjuhës serbe. Kështu, mbiemri shqiptar Gashi është bërë Gashiq, mbiemri Shala është bërë Shaliq, mbiemri Berisha është bërë Berishiq, mbiemri Krasniqi është bërë Kërstiq, mbiemri Kryeziu është bërë Cërnogllaviq, mbiemri Hoti është bërë Hotiq, mbiemri Nikaj është bërë Nikiq, mbiemri Palabardhi është bërë Bjellopavliç e kështu me radhë.

● Por, se malazetët kanë prejardhje iliro-arbërore-shqiptare, për këtë flasin edhe mentaliteti, traditat dhe doket e njëjta dhe të përafërta të malazetëve me ato të shqiptarëve. Kështu, edhe akademiku serb Vasa Qubrilloviqi (1897-1990), në elaboratin e tij antishqiptar të vitit 1937 me titull “Shpërngulja e arnautëve”<sup>383</sup>, dhe me elaboratin e tij antishqiptar të vitit 1944 me titull “Zgjidhja e problemit të pakicave kombëtare në Jugosllavinë e Re”<sup>384</sup>, ka shkruar se në viset shqiptare të rrafshit të Dukagjinit duhet të vendosen kolonët malazetë, sepse malazetët kanë mentalitet dhe tradita të ngjashme me ato të shqiptarëve.

● Të gjitha këto fakte flasin se kombi malazez nuk është krijuar si shkoputje nga kombi serb, siç na thotë Spahiu, por është krijuar

---

<sup>382</sup> E kaluara jeton brenda nesh: <https://www.koha.net/de/kulture/e-kaluara-jeton-brenda-nesh>

<sup>383</sup> Vaso Čubrilović: [https://de.wikipedia.org/wiki/Vaso\\_%C4%8Cubrilovi%C4%87](https://de.wikipedia.org/wiki/Vaso_%C4%8Cubrilovi%C4%87)

<sup>384</sup> Vaso Čubrilović: [https://de.wikipedia.org/wiki/Vaso\\_%C4%8Cubrilovi%C4%87\\_](https://de.wikipedia.org/wiki/Vaso_%C4%8Cubrilovi%C4%87_)

si një popullatë e shkëputur nga amza iliro-arbërore, e cila duke u tjetërsuar fetarisht nga fise shqiptare të besimit katolik të rritit perëndimor në fise të besimit ortodoks lindor si fiset serbe, është tjetërsuar në fise malaziase ortodokse sllavisht-folëse.

● Spahiu dëshiron që kombi malazez të jetë krijuar si një shkëputje nga kombi serb, për të thënë se ashtu siç kombi malazez është krijuar nga kombi serb, nuk prish punë pse edhe nga kombi shqiptar është krijuar, sipas tij, “kombi kosovar”. Ai me këtë krahasim dëshiron që ta relativizojë të keqen e madhe, që krijimi i “kombit kosovar” sjell pas për të gjithë kombin shqiptar në viset e tij në Ballkan.

### **Me shembullin e krijimit të kombit malazez nuk mund të përlijet krijimi i “kombit kosovar”**

Faktet e përmendura më lart flasin se Spahiu as nëpërmjet shembullit të krijimit të kombit malazez nuk mund ta përlijë propagandën e tij për gjoja krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”. Kjo, sepse ndërsa kombi malazez dhe kombi serb, sipas të gjitha gjasave, janë dy kombe të ndryshme, popullata shqiptare e Kosovës dhe popullata shqiptare e Shqipërisë i perkasin të njëjtit komb shqiptar.



# **PJESA E TREMBËDHJETË**

---

**PSE NË KOSOVË S'KA  
DHE S'MUND TË KETË  
KOMB KOSOVAR**

Në këtë kapitull bashkë-përmbledhes të këtij libri me titull “Pse s`ka dhe s`mundë të ketë komb kosovar”, janë dhënë faktorët e shumtë të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët e kanë pamundësuar dhe e pamundësojnë, krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

Për nevoja didaktike ky kapitull është ndarë në dhjetë nënkapituj, me ç`rast në secilin nënkapitull janë përfshi faktorë të veçantë, që kanë kontribuar për mbetjen e kombit shqiptar (përfshi këtu edhe pjesën e tij në Kosovë) në një komb i pandarë dhe, jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar dhe tjetri “kosovar”.

**1**

**Roli i krakteristikave të përbashkëta etnike**

- **Karakteristikat kryesore etnike, kombëtare dhe kulturore shqiptare**, të përbashkëta për të gjithë shqiptarët në viset e tyre në Ballkan, kanë paraqitur faktorin kryesor që ka pamundësuar dhe pamundëson ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe, nëpërmjet të tjetërsimit të një pjese të tij në një komb tjetër joshqiptar “kosovar”.
- Të tilla karakteristika të përbashkëta kanë qenë e janë: **prejardhja etnike pellazgo-iliro-arbërore, gjuha shqipe, flamuri, himni**

**dhe heroi kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu**, që u përkasin të gjithë shqiptarëve, përfshi këtu edhe shqiptarët që kanë jetuar dhe jetojnë në Kosovë. Këto karakteristika të përbashkëta kanë bërë që kombi shqiptar të jetë një komb unik dhe jo një komb i ndarë në dy kombe.

● Por edhe **traditat, zakonet, doket, fenomenet e besës, fenomenet e mikpritjes, kanuni i Lek Dukagjinit** dhe shumëçka tjetër, të cilat duke qenë karakteristika të përbashkëta kulturore të të gjithë shqiptarëve, po ashtu kanë ndikuar që shqiptarët e Kosovës të mos tjetërsohen në një komb tjetër joshqiptar, ta zëmë “kosovar”.

● Dhe së fundmi, edhe **mentaliteti kombëtar shqiptar**, i cili ndonjëse ndryshon në njëfarë mase nga krahina në krahinë, megjithatë paraqet mentalitetin e përbashkët kombëtar shqiptar (përfshi këtu edhe mentalitetin e shqiptarëve të Kosovës), po ashtu e ka pamundësuar dhe pamundëson krijimin nga shqiptarët e Kosovës të një kombi tjetër joshqiptar “kosovar”.

● Shqiptarët e Kosovës duke qenë të mësuar që të **ekzistojnë shekuj me radhë si komb shqiptar**, me të gjitha dhe brenda të gjitha karakteristikave kombëtare shqiptare të përmendura më lart, ata përkatësinë e tyre kombëtare shqiptare nuk e kanë ndërruar dhe nuk e ndërrojnë me ndonjë përkatësi tjetër kombëtare joshqiptare, politike dhe artificiale, siç do të ishte “kombi kosovar”.

● **Roli i prejardhjes etnike pellazgo-iliro-arbërore:** Sidomos prejardhja etnike pellazgo-iliro-arbërore që kanë shqiptarët e Kosovës, si edhe të gjithë shqiptarët e tjerë që jetojnë në viset e tyre në Ballkan, ka bërë dhe bën që ata të mos tjetërsohen në ndonjë komb tjetër, ta zëmë “kosovar”, por të mbeten gjithnjë pjesë integrale e kombit shqiptar,

● **Roli i gjuhës shqipe:** Gjuha shqipe duke qenë një gjuhë që përveç kombit shqiptar nuk e flet asnjë komb tjetër në botë, ajo si e tillë i identifikon shqiptarët (përfshi edhe shqiptarët e Kosovës) me kombin shqiptar, dhe kombin shqiptar me gjuhën shqipe.

● **Gjuha shqipe duke i identifikuar të gjithë shqiptarët me kombin shqiptar**, ajo nuk i identifikon ata me ndonjë komb tjetër joshqiptar, ta zëmë “kosovar”, realisht joekzistues. Dhe kjo tregon se gjuha shqipe ka paraqitur dhe paraqet një faktor madhor, që

e ka pamundësuar dhe e pamundëson krijimin nga shqiptarët e Kosovës të ndonjë kombi tjetër joshqiptar, të emërtuar si “komb kosovar”.

## 2

### **Roli i vetëdijes kombëtare në mosndarjen e kombit shqiptar në dy kombe**

● Shqiptarët e Kosovës duke pasur, ashtu si edhe shqiptarët e viseve të tjera, një vetëdije kombëtare shqiptare të rrënjosur ndër shekuj dhe të konsoliduar në vazhdim, duke filluar që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e vitit 1878 e këtej, ata nuk janë tjetërsuar dhe nuk tjetërsohen në ndonjë komb tjetër joshqiptar, të emëruar si “komb kosovar”.

● Shqiptarët e Kosovës edhe kur më shumë se 90% tyre kanë qenë analfabetë, siç ka qenë gjendja e tyre deri në vitin 1945, ata megjithatë kanë pasur një vetëdije kombëtare shqiptare, në saje të së cilës nuk kanë pranuar të asimilohen në turq gjatë sundimit pesëshekullor osman, dhe nuk kanë pranuar të asimilohen në serbë gjatë sundimit pothuajse njëshekullor serb (brenda viteve 1912-1999), duke mbetur kësisoj komb shqiptar si të gjithë shqiptarët e tjerë në Ballkan.

● Vetëdija kombëtare në mesin e shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera me shumicë shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës në jug të Serbisë, është ngritur sidomos pas hapjes së Universitetit të Kosovës në gjuhën shqipe në vitin 1971 në Prishtinë.

● Që nga viti 1971 e deri më tani ka kaluar më shumë se gjysmë shekulli, që vetëdija kombëtare shqiptare në mesin e shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve tjera shqiptare ka ardhur duke e ngritur, gjë që ka pamundësuar dhe pamundëson krijimin nga shqiptarët e Kosovës të një kombi tjetër joshqiptar, të emërtuar si “komb kosovar”.

● Demonstratat e rinisë studentore dhe të masave popullore, të ndodhura gjatë viteve ‘80 të shekullit XX për bërjen e Kosovës Republikë, bashkë me arsimimin masiv të rinisë shqiptare në Universitetin e Kosovës dhe, bashkë me mbështetjen që Shqipëria

i ka dhënë kërkesës gjithëpopullore për bërjen e Kosovës një Republikë (asokohe brenda Jugosllavisë), kanë qenë tri shtyllat kryesore, mbi të cilat vetëdija kombëtare e shqiptarëve në Kosovë dhe vise tjera me shumicë shqiptare në Jugosllavi, është ngritur deri në shkallën më të lartë: **Atë të flijimit për interesat e kombit shqiptar.**

### 3

#### **Roli i rrugëtimit historik i Kosovës në mosndarjen e kombit shqiptar në dy kombe**

- Sidomos rrugëtimi historik i shqiptarëve të Kosovës dhe i viseve tjera me shumicë shqiptare në Jugosllavi, si komb shqiptar dhe jo si “komb kosovar”, ka paraqitur dhe paraqet faktorin kryesor, i cili ka pamundësuar dhe pamundëson krijimin nga shqiptarët e Kosovës të në kombi tjetër joshqiptar “kosovar”.
- Kur flasim për rrugëtimin historik të shqiptarëve të Kosovës, fjala është për luftërat politike dhe me armë që ata kanë bërë përreth dy shekuj me radhë, si komb shqiptar dhe jo si “komb kosovar”, për konsolidimin dhe bashkimin e kombit shqiptar në një Shqipëri Etnike.
- Shqiptarët e Kosovës në kuadër të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, gjatë viteve 1878-1881 kanë luftuar për bashkimin e katër vilajeteve shqiptare (Vilajetit të Kosovës, të Manastirit, të Shkodrës dhe të Janinës) në një Shqipëri Etnike, dhe nuk kanë luftuar për krijimin e “kombit kosovar” jashtë kombit shqiptar, dhe as për krijimin e shtetit të Kosovës jashtë Shqipërisë.
- Shqiptarët e Kosovës edhe gjatë viteve 1903-1912 kanë luftuar për pavarësimin e Shqipërisë, me të gjitha viset e banuara me shumicë shqiptare brenda saj, përfshi këtu edhe viset e Kosovës, dhe nuk kanë luftuar për krijimin e “kombit kosovar” jashtë kombit shqiptar, dhe as për bërjen e Kosovës shtet jashtë shtetit të Shqipërisë.
- Shqiptarët e Kosovës edhe gjatë viteve 1941-1945 të Luftës së Dytë Botërore (LDB-së), kanë luftuar kundër forcave italiane fashiste dhe gjermane naziste në kuadër të Luftës Antifashiste të Kosovës, me qëllim që Kosova dhe viset e tjera me shumicë

shqiptare të mbetura në Jugosllavi, pas LDB-së t'i bashkoheshin vendit amë, Shqipërisë<sup>385</sup>, dhe nuk kanë luftuar as për krijimin e “kombit kosovar” jashtë kombit shqiptar, dhe as për bërjen e Kosovës shtet jashtë shtetit të Shqipërisë.

● Edhe demonstratat studentore dhe të masave popullore shqiptare, të ndodhura në vjeshtën e vitit 1968, përgjatë vitit 1981 dhe përgjatë viteve në vazhdim, kanë synuar bërjen e Kosovës Republikë, jo vetëm me qëllim që shqiptarët e Kosovës të kishin të drejta të njëjta me kombet e tjera në Jugosllavi, por edhe me qëllim që Kosova duke u bërë Republikë, të mund t'i bashkohej më lehtë Shqipërisë.

● Dhe së fundi, shqiptarët e Kosovës edhe Luftën Çlirimtare të Kosovës të viteve 1998-1999, të bërë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK-ja), nuk e kanë bërë vetëm për çlirimin e Kosovës nga Serbia okupatore, por e kanë bërë edhe për bashkimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare të mbetura në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës në Serbi, me shtetin amë, Shqipërinë. Për këtë flet qartë edhe vetë betimi i ushtarëve të UÇK-së, i dhënë më poshtë.

### **Betimi i ushtarëve të UÇK-së**

**“Si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, betohem se do të luftoj për çlirimin e tokave të pushtuara të Shqipërisë dhe bashkimin e tyre, do të jem përherë ushtar besnik, luftëtar i denjë i lirisë, vigjilent, guximtar dhe i disiplinuar, i gatshëm që në çdo kohë, pa kursyer as jetën time, të luftoj për të mbrojtur interesat e shenjtë të ATDHEUT. Nëse shkel këtë betim, le të ndëshkohem me ligjet më të ashpra të luftës, dhe nëse tradhtoj, qoftë i humbur gjaku im. BETOHEM!”**

---

<sup>385</sup> Fjala është “Mbledhjen e Këshillit Antifashist të Kosovës” të mbajtur në fshatin Bujan të Shqipërisë nga 31 dhjetori i vitit 1943 deri më 1 e 2 janar të vitit 1944, në të cilën është vendosur që Kosova dhe viset e tjera të banuara me shumicë shqiptare në Jugosllavi, në saje të parimit të vetëvendosjes pas LDB-së, t'i bashkohen Shqipërisë. Por këtë të drjtë shqiptarëve ua ka pamundësuar Partia Komuniste e Jugosllavisë (PKJ-ja), e cila në korrikun e vitit 1945 Kosovën dhe viset tjera me shumicë shqiptare ia ka aneksuar dhunshëm Jugosllavisë.

● Ky rrugëtim historik i shqiptarëve të Kosovës, i shoqëruar me luftëra politike dhe me kryengritje të shumta të armatosura, i bërë gjithnjë në emër të kombit shqiptar dhe jo në emër të ndonjë kombi tjetër “kosovar”, dhe i bërë gjithnjë në emër të bashkimit të të gjitha viseve shqiptare (përfshirë edhe Kosovën) në një Shqipëri të vetme, tregon qartë se ai jo vetëm që e ka pamundësuar në të kaluarën krijimin nga shqiptarët e Kosovës të një kombi tjetër joshqiptar, por e pamundëson edhe në të ardhmen krijimin nga shqiptarët e Kosovës të një kombi tjetër joshqiptar të emërtuar p. sh: si “komb kosovar”, realisht dhe objektivisht joekzistues.

#### 4

### **Roli i shtypjes etnike, i religjioneve dhe i përbërjes etnike në mosndarjen e kombit shqiptar në dy kombe**

● **Roli i shtypjes etnike:** Vet shtypja etnike serbo-jugosllave e ushtruar ndaj shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve tejsra shqiptare të mbetura në Jugosllavinë Federtative, ka shërbyer si një mësim historik për të gjithë shqiptarët (përfshirë edhe ata të Kosovës), që ata të kultivojnë vazhdimisht unitetin kombëtar shqiptar, gjë që e ka pamundësuar ndarjen e kombit shqiptar në dy apo më shumë kombe.

● Vet valët gjenocidale dhe të spastrimeve etnike të ushtruara ndaj shqiptarëve të Kosovës, nga ana e Serbisë fashiste të Millosheviqit gjatë viteve 1998-1999, po ashtu kanë shërbyer si mësim historik që kombi shqiptar të jetë unik dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

● **Roli i religjioneve:** Duke qenë shqiptarët të besimit islamik, kurse serbët të besimit të krishterë ortodoks, kjo ka bërë në mes të shqiptarëve dhe serbëve të mos kishte martesë të përziera, përveç ndonjë rasti të veçantë. Mospërziera e tillë etnike shqiptaro-serbe, po ashtu e ka pamundësuar krijimin nga shqiptarët e Kosovës të një kombi tjetër të përzier shqiptaro-serb, i cili do të mund të quhej “komb kosovar”.

● **Roli i përbërjes etnike të popullatës:** Në Kosovë nuk ka pasur dhe nuk “komb kosovar” edhe për shkak të përbërjes etnike të komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Kjo, sepse duke qenë përqindja

e komunitetit serb në Kosovë shumë e vogël (3% e popullatës së gjithmbarshme), kjo tregon se edhe nëse tërë komuniteti pakicë serb do të integrohej brenda shumicës shqiptare që përbën 94% të popullatës së gjithmbarshme, sërish natyra bazë e kombit shqiptar në Kosovë nuk do të ndryshohej mjaftueshëm, saqë prej tij të krijohet një komb tjetër joshqiptar, që do të mund quhej “komb kosovar”.

● Në Kosovë do të mund të kishte “komb kosovar” vetëm nëse Kosova do të kishte një përbërje tjetër etnike, për shembull, nëse kombi shumicë shqiptar do të përbënte 50% ose 60% të popullatës së gjithmbarshme, nëse komuniteti serb do të përbënte rreth 30% të popullatës së gjithmbarshme, dhe nëse komunitetet e tjera pakicë (boshnjakët, turqit, myslimanët, romët, ashkalinjt e të tjerë) do të përbënin rreth 10% të popullatës së përgjithshme.

● Nëse brenda kësaj përbërjeje etnike të Kosovës të supozuar më lart, shumica shqiptare me rreth 1 milion banorë do të bënte përzjerje etnike (me martesë të përziera), me komunitetin serb prej rreth 400 mijë banorësh dhe me komunitetet e tjera pakicë prej rreth 100 mijë banorësh, atëherë në Kosovë vërtet do mund të krijohet një komb tjetër joshqiptar, i cili do të ishte një komb multietnik “kosovar”.

● Meqë Kosova, sipas të gjitha gjasave, edhe në ardhmen do të ketë përbërje etnike që ka, kjo tregon se nga shqiptarët e Kosovës “kombi kosovar” nuk mund të krijohet as në të ardhmën.

## 5

### **Roli i bashkëpunimit kulturor Kosovë-Shqipëri në mosndarjen e komnit shqiptar në dy kombe**

● Në fillim të viteve ‘70-të të shekullit XX derisa Kosova ka qenë pjesë e Jugosllavisë Federative, mes Kosovës dhe Shqipërisë ka funksionuar “Marrëveshja Kosovë-Shqipëri për Bashkëpunim Kulturor”. Kjo marrëveshje ka qenë në fuqi që nga fillimi i viteve ‘70-të e deri në marsin e vitit 1981, kur funksionimi i saj është ndërprerë njëanshëm nga Jugosllavia, për shkak të ndodhjes së demonstratave studentore të marsit e të prillit të vitit 1981 në Prishtinë, me kërkesën politike për bërjen e Kosovës Republikë.

● Entuziazmit romantiko-patriotik të viteve '70 të shekullit XX të në Kosovë, i ka paraprirë simpoziumi shkencor i mbajtur në Prishtinë vitin 1968, me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Shqiptar, Gjergj Kastriot- Skënderbeut, simpoziium ky në të cilin për herë të parë kanë marrë pjesë edhe studiues nga Shqipëria. Në mesin e rinisë shqiptare të asaj kohe, figura e Skënderbeut për herë të parë u kthye në një simbol krenarie, lavdie dhe frymëzimi i të qenit shqiptar.

● Ngjarja tjetër madhore, e cila ua shtoi shpresën për dije e dituri të gjithë shqiptarëve të mbetur padrejtësisht edhe pas LDB-së në kuadër të Jugosllavisë, siç kemi cekuar edhe më lart, ka qenë themelimi dhe hapja e Universitetit të Kosovës në gjuhën shqipe në Prishtinë në vitin 1971.

● Në Universitetin e Kosovës gjatë gjithë viteve '70 dhe '80 të shekullit XX, pothuajse për 20 vite me radhë, kanë marrë edukim dhe arsimim të lartë jo vetëm të rinjtë shqiptarë të Kosovës, por edhe ata të viseve të tjera me shumicë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës në jug të Serbisë.

● Ai arsimim masiv i të rinjve shqiptarë nga të gjitha viset shqiptare të mbetura në kuadër të Jugosllavisë, në mesin e rinisë shqiptare ka kulmuar me ngritjen e vetëdijes kombëtare, deri në shkallën e vetëflijimit për interesat e kombit shqiptar.

● Ngjarja e tretë madhore, e cila të gjithë shqiptarët i ka bërë të ndihën si të ishin një komb i bashkuar, ka qenë standardizimi i gjuhës shqipe në Kongresin e Drejtshkrimit të Shqipes, i mbajtur në Tiranë në vitin 1972. Njësimi i gjuhës shqipe për të gjithë shqiptarët në viset e tyre në Ballkan ka paraqitur bashkimin gjuhësor, kulturor dhe shpirtëror të kombit shqiptar.

● Ndjenja e bashkimit kombëtar nëpërmjet bashkimit gjuhësor, asokohe kishte përfshirë tërë rininë shqiptare studentore dhe atë shkollave të mesme, bashkë me masat e gjera popullore, duke krijuar një atmosferë të bashkimit kombëtar, pa ndodhur realisht bashkimi kombëtar.

● Por atmosferën plot shpresë për fitore e kanë ndezur sidomos ansamblet artistike të këngëve e të valleve, grupet teatrore dhe ekspozitat e arteve pamore të Shqipërisë, që në vitete e 70-ta të

shekullit të XX, në saje të Marrëveshjes Kosovë-Shqipëri për Bashkëpunim Kulturor, po jepnin shfaqjet e tyre kryesisht në Prishtinë, por edhe në disa qytete të tjera të Kosovës, duke nderur flakë zemrat e të rinjve shqiptarë me dashuri të pashoqe për vendin amë, Shqipërinë.

- Ka qenë vetëdija kombëtare e arritur gjatë viteve '70-të të shekullit XX, ajo që ka çuar në ndodhjen e demonstratave studentore dhe gjithëpopullore të pranverës së viteve 1981 dhe të viteve në vazhdim, për bërjen e Kosovës Republikë, me qëllim të fundit bashkimin e saj me Shqipërinë.

- Dhe kanë qenë ngjarjet e viteve '80-të të shekullit XX, të shoqëruara me demonstrata masive të të gjithë shqiptarëve në Jugosllavi, për bërjen e Kosovës Republikë, ato që e kanë përgatitur rininë shqiptare, që ajo në fillim të viteve '90-të të shekullit XX, të themelojë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për çlirimin e Kosovës nga Serbia me luftë të armatosur.

## 6

### **Roli mbrojtës i Kosovës ndaj Shqipërisë në mosndarjen e kombit shqiptar në dy kombe**

- Gatishmëria e shqiptarëve të Kosovës për ta mbrojtur me të gjitha mjetet e mundshme Shqipërinë, nëse ajo do të sulmohej nga Jugosllavia për shkak të nxitjes nga Serbia, po ashtu e ka vulosur mbetjen e kombit shqiptar një komb i pandarë, dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e "tjetri kosovar".

- Shqiptarët e Kosovës duke filluar që nga viti 1945, kur është themeluar Jugosllavia Federative, e deri në vitin 1991, kur Jugosllavia Federatave u shpërbë, kanë qenë të gatshëm që për mbrojtjen e Shqipërisë, të derdhnin edhe pikën e fundit të gjakut, nëse Shqipëria do të sulmohej nga Jugosllavia.

- Shqiptarët e Kosovës nëse Jugosllavia, e nxitur nga tri republikat e saj jugore antishqiptare, do ta sulmonte Shqipërinë, ata do ta çlironin Kosovën nga Serbia dhe Jugosllavia dhe do t'ia bashkonin atë Shqipërisë.

- Jugosllavia edhe duke e ditur se nëse ajo do ta sulmonte Shqipërinë, nuk do të konfrontohej vetëm me tre milionë e gjysmë

shqiptarë të Shqipërisë, por do të konfrontohej edhe me 2,5 milionë shqiptarë brenda Jugosllavisë, ajo shumë herë i ka rdektuar planet e saj për sulmimin ushtarak të Shqipërisë.

● Shqiptarët e Kosovës si nëpërmjet rezistencës politike të fshehtë, të ushtruar nga organizatat politike të fshehta, ashtu edhe nëpërmjet të rezistencës politike legale (të ushtruar me demonstrata masive gjatë viteve '80 të shekullit XX), kanë bërë që Jugosllavia duke u marrë me “Shqipërinë e Brendshme” (me shuarjen e rezistencës së shqiptarëve brenda Jugosllavisë), të mos mund të merrej aq shumë me “Shqipërinë e Jashtme” (me Republikën e Shqipërisë).

● Për të gjitha këto shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, të mbetura edhe pas LDB-së brenda Jugosllavisë, kanë paraqitur një **gardh të gjallë mbrojtës për Shqipërinë**, gjë që e ka farkëtuar edhe më shumë të qenët e kombit shqiptar një komb i pandarë, dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

## 7

### **Roli i ndihmës së Shqipërisë dhënë Kosovës në mosndarjën e kombit shqiptar në dy kombe**

● Shqipëria prej se është njohur ndërkombëtarisht si shtet në vitin 1913 e deri në vitin 1999, kur Kosova është çliruar nga Serbia, dhe më pas edhe deri në vitin 2008, kur Kosova është pavarësuar, ajo brenda rrethanave dhe mundësive të saj kryesisht të pafavorshme, në njërën anë i ka përkrahur politikisht të drejtat e shqiptarëve në Kosovë e vise tjera në Jugosllavi, kurse në anën tjetër e ka akuzuar Jugosllavinë dhe Serbinë, për ushtrim të gjenocidit dhe të spastrimeve etnike, ndaj shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve tjera të banuara me shumicë shqiptare si në Maqedoni, Mal të Zi dhe në Serbi.

● Kjo përkrahje afatgjatë që Shqipëria ka bërë për shqiptarët e Kosovës dhe të viseve tjera me shumicë shqiptare në Jugosllavi, e ka vulosur shumë herë të qenit e kombit shqiptar një komb i pandarë, dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

● **Ndihma e Shqipërisë në arsim:** Sidomos ndihma afatgjatë e Shqipërisë për arsimin shqip në Kosovë dhe në vise tjera të shqiptarëve në Jugosllavi, e ka vulosur mbetjen e kombit shqiptar një komb i pandarë, dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

● Qeveria Proitaliane e Shqipërisë gjatë viteve 1941-1943 të Luftës së Dytë Botërore, ka dërguar në Kosovë mësues dhe libra në gjuhën shqipe, për të mundësuar arsimimin e shqiptarëve të Kosovës në gjuhën amtare shqipe.

● Edhe Qeveria Komuniste e Shqipërisë menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore (DB-së) në vitin 1945 e deri në vitin 1948, kur Shqipëria ka prishur njëanshëm marrëdhëniet e saj me Jugosllavinë, po ashtu ka dërguar në Kosovë mësues dhe libra shqip, për të mundësuar arsimimin e shqiptarëve të Kosovës në gjuhën shqipe.

● Dhe Qeveria Komuniste e Shqipërisë edhe brenda viteve 1970-1980, ndërsa ka qenë në fuqi “Marrëveshja Kosovë-Shqipëri për Bashkëpunim Kulturor”, ka dërguar në Kosovë shumë profesorë (pedagogë) për të ligjëruar lëndë të ndryshme në Universitetin e Kosovës, si dhe ka dërguar edhe literaturë me karakter historik, shkencor, kulturor, letrar dhe artistik, për përdorim nga nxënësit e shkollave të mesme dhe nga studentët shqiptarë në Kosovë.

● Kështu, s’ka dyshim se kjo ndihmë e madhe e Shqipërisë për arsimin shqip në Kosovë, duke çuar në rritjen e vetëdijes kombëtare në mesin e shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve tjera shqiptare në Jugosllavi, ka bërë që kombi shqiptar në tërë hapësirën e tij etnike në Ballkan, të mbetej një komb i pandarë dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

● **Propaganda me karakter kombëtar e Shqipërisë:** Shqipëria që nga vitet ‘50-të dhe ‘60-të të shekullit XX, kur ajo për herë të parë ka pasur mjete informative audiovizuale, e deri në fund të viteve ‘80-të të shekullit XX, nëpërmjet Radio-Tiranës, Radio-Kukësit dhe Televizionit Shtetëror të Shqipërisë, ka bartur në Kosovë dhe Vise propagandë historiko-politike kombëtare shqiptare.

● S’ka dyshim se propaganda e tillë afatgjate kombëtare, e bartur

nga Shqipëria në Kosovë dhe vise tjera shqiptare në Jugosllavi, duke i kontribuar ngritjes së vetëdijes kombëtare në mesin e shqiptarëve, i ka kontribuar njëkohësisht edhe mbetjes së kombit shqiptar një komb i pandarë, dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

● **Propagandë kombëtare në dyzet gjuhë të huaja:** Shqipëria padrejtësitë e ushtruara ndaj shqiptarëve nga ana e Jugosllavisë (alias nga tri republikat e saj jugore: Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi) dhe kërkesat politike të shqiptarve të Kosovës, gjatë viteve ‘70-të e ‘80-të të shekullit XX (për 20 vite me radhë), opinionit ndërkombëtar publik dhe politik ndërkombëtar, ia ka bartur në dyzet gjuhë të ndryshme, nëpërmjet të valëve radiofonike.

● Edhe kjo propagandë ndërkombëtare e Shqipërisë lidhur me Kosovën në dyzet gjuhë të botës, s’ka dyshim që ka ndikuar, që kombi shqiptar të mbetet një dhe i pandarë, dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

● **Shqipëria - zëri i vetëm për Kosovën:** Shqipëria që nga viti 1948, kur i ka prishur njëanshmërisht marrëdhëniet e saj me Jugosllavinë, e deri në vitin 1990, kur ka filluar shkatërrimi i Jugosllavisë Federatave, ka paraqitur vendin e vetëm në botë që e ka ngritur zërin e saj kundër padrejtësive serbe e jugosllave, të ushtruara ndaj shqiptarëve në Kosovë e vise tjera të banuara me shumicë shiptare në Jugosllavinë Federative. Ska dyshim që ky zë i vetëm, por i fuqishëm i Shqipërisë për Kosovën, ka ndikuar që kombi shqiptar të mbetet një komb i pandarë dhe, jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

### **Përkrahja politike e Shqipërisë gjatë viteve ‘80-ta.**

● Përkrahja politike që Shqipëria, sidomos gjatë viteve ‘80-të të shekullit XX, i ka dhënë kërkesë politike të studentëve dhe të masave popullore shqiptare, për bërjen e Kosovës Republikë, asokohe brenda Jugosllavisë, po ashtu i ka kontribuar shumë mbetjes së kombit shqiptar një komb i pandarë, dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

## **Mundësia e mbrojtjes së Kosovës edhe me luftë armatosur:**

- Sidomos gjatë viteve '80-të të shekullit XX, kur shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera me shumicë shqiptare në Jugosllavi, po demonstironin duke kërkuar nga Jugosllavia që ajo t'ia njihte Kosovës statusin e Republikës, Shqipëria disa herë me radhë në momente kritike ka vendosur forca të konsiderueshme ushtarake dhe armatime pranë kufijve të saj me Kosovën.
- Ai dislokim forcash e armatimesh pranë kufijve me Kosovën nuk ka ndodhur vetëm për ta mbrojtur Shqipërinë nga ndonjë sulm ushtarak serbo-jugosllav, por ka ndodhur edhe për t'i mbrojtur shqiptarët e Kosovës me luftë të armatosur, nëse Jugosllavia do të ushtronte ndaj tyre gjenocid masiv apo spastrim etnik masiv.
- Ska dyshim se edhe gatishmëria e Shqipërisë për mbrojtjen e shqiptarëve të Kosovës deri edhe me luftë të armatosur, ka bërë që kombi shqiptar të jetë një komb i pandarë dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri "kosovar".

## **8**

### **Roli i ndihmës së Shqipërisë dhënë Kosovës gjatë Luftës Çlirimtare të viteve 1998-1999**

- Sidomos ndihma madhore e Shqipërisë dhënë Kosovës gjatë viteve 1998-1999 të Luftës Çlirimtare të Kosovës të bërë nga UÇK-ja, e ka çelikusur unitetin kombëtar të shqiptarëve në të gjitha viset e tij në Ballkan, duke i kontribuar kështu mbetjes së kombit shqiptar një komb i pandarë, dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri "kosovar".
- **Ndihma politike:** Qeveria e Shqipërisë dhe diplomatët shqiptarë në ambasadat e Shqipërisë nëpër botë, gjatë viteve 1998-1999 të Luftës Çlirimtare të Kosovës, kanë qenë shumë të angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe për mbrojtjen e UÇK-së nga etiketimet e Serbisë dhe të Rusisë si organizatë terroriste.
- Në shkurtin e vitit 1998 ambasadori amerikan, z. Gellbart, ka deklaruar në qytetin e Shkupit, se UÇK-ja është organizatë terroriste, duke e dëmtuar kështu si UÇK-në, ashtu edhe vetë perspektivën e Kosovës.

● Por pas dy takimeve të dy përfaqësuesve politikë të UÇK-së (z. Bardhyl Mahmutit dhe z. Ramadan Avdiu) në Zvicër në qershorin e vitit 1998 me ambasadorët amerikanë, Robert Gellbard dhe Riçard Hollbruk, takime këto të ndërmjetësuar nga Kryeministri i Shqipërisë, Fatos Nano, Departamenti i Shtetit Amerikan UÇK-në nuk e ka cilësuar më si organizatë terroriste, por e ka cilësuar si Ushtri Çlirimtare<sup>386</sup>.

● Nga ana tjetër, ndërsa në kështjellën e Rambujesë afër Parisit, në shkurtin dhe marsin e vitit 1999 po mbahej Konferenca Ndërkombëtare e Rambujesë, për ndaljen e krizës humanitare në Kosovë dhe për gjetjen e një statusi politik për Kosovën, në afërsi të Kështjellës së Rambujesë ka qëndruar vazhdimisht ministri i Jashtëm i Shqipërisë, z. Paskal Milo, me disa diplomatë të tjerë, për ta këshilluar delegacionin e Kosovës që ai të merrte vendime drejta politike.

● Ndhima e tillë politike e Shqipërisë dhënë Kosovës dhe UÇK-së, gjatë viteve 1998-1999 të Luftës Çlirimtare të Kosovës, ka qenë një akt shtesë që e ka forcuar unitetin e kombit shqiptar në aksin Kosovë-Shqipëri.

● **Ndhima me logjistikë dhe armatime:** Ndhima logjistike dhe me armatime e Shqipërisë dhënë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) gjatë viteve 1998-1999 të luftës, ka qenë një faktor tjetër madhor që ka konsoliduar kombin shqiptar si komb unik i pandarë.

● Sot dihet që 95% e armëve të përdorura për çlirimin e Kosovës nga Serbia, kanë qenë armë të marra nga Shqipëria dhe vetëm rreth 5% e armëve të përdorura për çlirimin e Kosovës, kanë qenë armë të ardhura nga vendet e Europës.

● Dhe sot dihet se pa një vend si Shqipëria ku UÇK-ja ka lëvizur lirshëm, ku ka grumbulluar armë dhe ku ka pasur edhe bazat e saj rreth kufijve të Shqipërisë me Kosovën, Luftë Çlirimtare në Kosovës nuk do të mund kishte, kurse pa Luftën Çlirimtare të Kosovës, nuk do të kishte as çlirim dhe as pavarësim të Kosovës.

● **Ndhima madhore në strehim:** Edhe strehimi në Shqipëri në

---

<sup>386</sup> Bardhyl Mahmuti, "Ushtria çlirimtare e Kosovës në shënjestër të vazhdueshme", *Epoka e re*, 2024, faqe 119-124.

pranverën e vitit 1999 i rreth 700 mijë shqiptarëve të Kosovës, të dëbuar nga regjimi fashist i Millosheviqit, po ashtu ka vulosur përjetësisht mbetjen e kombit shqiptar një komb i pandarë dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

## 9

### **Roli i të qenit të kombit shqiptar kombi më i rrezikuar i Europës në mosndarjen e tij në dy kombe**

● Edhe të qenët e kombit shqiptar kombi më i rrezikuar në Ballkan dhe Europë, në këta dy shekujt e fundit e deri më sot, po ashtu ka ndikuar që kombi shqiptar të jetë një komb i pandarë, dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

● **Synimet gllabëruese të Serbisë ndaj Kosovës:** Fakti se Serbia që nga viti 1999, kur Kosova u çlirua nga kthetrat e saj e deri tani, në afërsi të kufijve të saj me Kosovën ka vendosur 40 pika ushtarake dhe një kazermë të madhe; fakti se Serbia në kushtetutën e saj e konsideron Kosovën pjesë të Serbisë, si dhe fakti që ajo nga viti 1999 e këtej, dhjetëra herë e ka kërcënuar Kosovën me agresion ushtarak, të gjitha këto fakte marrë së bashku flasin se kombi shqiptar është vërtet kombi më i rrezikuar në Ballkan dhe Europë.

● **Serbia dëshiron të përballët vetëm me rreth 2 milionë “kosovarë”:** Serbia dëshiron që kombi shqiptar të ndahet në dy kombe, me qëllim që në përpjekjet e saj për ta ripushtuar Kosovën, të mos konfrontohet me 5 milionë shqiptarë sa janë gjithsej në Ballkan, por të konfrontohet vetëm me rreth dy milionë “kosovarë”.

● S’ka dyshim se edhe ky rrezik afatgjatë serb për Kosovën i ka kontribuar dhe i kontribuon mbetjes së kombit shqiptar një komb i pandarë, dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

● **Synimet gllabëruese të Greqisë ndaj Shqipërisë:** Fakti se Greqia që nga viti 1945 e këtej, tani më për më shumë se shtatë dekada me radhë, në kushtetutën e saj e ka të sanksionuar “Ligjin e Luftës me Shqipërinë”, dhe fakti se Greqia ka synime gllabëruese ndaj viseve jugore të Shqipërisë, edhe këto dy fakte marrë së bashku, flasin se kombi shqiptar është vërtet kombi më i rrezikuar në Ballkan dhe në Europë.

● **Greqia dëshiron të përballet me vetëm 3 milionë shqiptarë:**

Greqia dëshiron që kombi shqiptar të ndahet në dy kombe, me qëllim që në përpjekjet e saj për aneksimin e viseve jugore të Shqipërisë, të mos konfrontohet me rreth 5 milionë shqiptarë sa janë ata gjithsej në Ballkan, por të konfrontohet vetëm me rreth 3 milionë shqiptarë të Shqipërisë.

● Dhe s'ka dyshim se edhe ky rrezik afatgjatë grek për Shqipërinë, i ka kontribuar dhe i kontribuon mbetjes së kombit shqiptar një komb i pandarë, dhe jo një komb i ndarë në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

● **Kombi i rrezikuar shqiptar ka nevojë për unitet e jo për ndarje:** Qenia e kombit shqiptar kombi më i rrezikuar i Ballkanit dhe i Europës, kërkon që ai ta ruajë unitetin e tij kombëtar dhe jo të ndahet në dy kombe: njëri shqiptar në Shqipëri dhe tjetri “kosovar” në Kosovë.

● Aq shumë i rrezikuar është kombi shqiptar saqë kërkesat për ndarjen e tij në dy kombe, janë të barabarta me kërkesat për shkatërrimin e tij përfundimtar në të gjitha viset e tij në Ballkan.

## 10

### DISA PËRFUNDIME

● Të gjithë këta faktorë kohezivë brendashqiptarë dhe faktorë të tjerë të jashtëm, të përmendur më lart, kanë bërë që në Kosovë të ketë komb unik shqiptar për shekuj me radhë, dhe të mos ketë “komb kosovar” politik dhe artificial, krijimin e të cilit e duan dhe e presin me padurim dy vendet fqinje antishqiptare: Serbia dhe Greqia.

● **As 20 veta nuk i përkrahin idetë komb-ndarëse të Spahiut:** Kanë qenë e janë faktorë të tillë kohezivë brendashqiptarë, ata që kanë bërë që, edhe përkundër propagandës së katër publicistëve dhe gazetarëve shqiptarë për më shumë se 25 vite me radhë, për gjoja krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombi kosovar”, megjithatë, në tërë Kosovën të mos ketë më shumë se rreth 20 përkrahës të ideve të tilla komb-ndarëse, të katër publicistëve dhe gazetarëve.

● **Është fantazma e “kombit kosovar”** ajo që i nxit katër publicistët dhe gazetarët shqiptarë që të propagandojnë pa asnjë

fakt, sikur gjoja nga shqiptarët e Kosovës veç është krijuar “kombit kosovar”, gjë që nuk qëndron aspak.

● **Kush fiton nga ndarja e kombit shqiptar?** Edhe të miturit mund të vijnë në përfundimin, se nga ndarja e kombit shqiptar në dy kombe përfitojnë dy vendet ballkanike fund e krye antishqiptare: fiton Serbia, që ka synime gllabëruese ndaj Kosovës, dhe fiton Greqia, që ka synime gllabëruese ndaj viseve jugore të Shqipërisë.

● **Kush humb nga ndarja e kombit shqiptar?** Edhe të miturit mund të vijnë në përfundimin, se nga ndarja e kombit shqiptar në dy kombe, humb vetëm kombi shqiptar që paraqet kombin më të rrezikuar në Ballkan dhe Europë.

● **Favorizimi i synimeve antishqiptare Serbi-Greqi:** Secili shqiptar që kërkon ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe, ai me vetëdije ose pavetëdije favorizon synimet antishqiptare të dy vendeve ballkanike: të Serbisë ndaj Kosovës dhe të Greqisë ndaj Shqipërisë.

● **Defavorizimi i kombit shqiptar:** Dhe kushdo që e kërkon ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe, ai me vetëdije ose pavetëdije e defavorizon kombin shqiptar, që edhe ashtu paraqet kombin më të copëtuar dhe më të rrezikuar në Europë.

● **Çelësi i shturjes së tërë kombit shqiptar!** Nëse në të ardhmen nga shqiptarët e Kosovës do të krijohet vërtet një komb tjetër joshqiptar i emërtuar si “komb kosovar”, atëherë ai “kombi kosovar” për shkak të domino-efektit negativ që do të kishte, do të çonte në ndarjen e shqiptarëve në dy kombe (shqiptar dhe “kosovar”) jo vetëm brenda Kosovës, por edhe në viset shqiptare në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi, në Luginën e Preshevës dhe mbase edhe në verilindje të Shqipërisë.

● Kështu, krijimi i “kombit kosovar” nga shqiptarët e Kosovës, për mendimin tim do të paraqiste çelësin e shturjes totale të kombit shqiptar. Prandaj përpjekjet me apo pa vetëdije të kujtdo qoftë, për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”, janë përpjekje për shturjen totale të kombit shqiptar.

● Kjo është arsyeja pse mendoj se ata që luajnë me kartën e “kombit kosovar”, me ose pa vetëdije luajnë me ekzistencën e tërë kombit shqiptar në viset e tij në Ballkan.

● Është pikërisht rreziku i shturjes totale të kombit shqiptar ai që e arsyeton plotësisht kundërvënien preventive të akademikëve, profesorëve dhe të intelektualëve tjerë shqiptarë, ndaj ideve kombndarëse të katër publicistëve dhe gazetarëve shqiptarë dhe të disa përkrahësve të tyre.

● Dhe është rreziku i shturjes totale të kombit shqiptar ai që e arsyeton plotësisht kërkesën, që mediet e shkruara dhe audiovizuale të Kosovës të mos “kosovarizojnë” gjithçka në Kosovë, duke e quajtur gjithçka “kosovarë”, sepse kështu në njërin anë e bëjnë deshqiptarizimin e gjithçkaje në Kosovë, kurse në anën tjetër i kontribuojnë padukshëm krijimit nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

● Dhe është rreziku i shturjes totale të kombit shqiptar ai që më detyron t’u drejtohem shqiptarëve të Kosovës, që ata në përditshmëri të mos thonë vazhdimisht “ne kosovarët”, por të thonë edhe “ne shqiptarët”, siç kanë thënë shekuj me radhë. Kjo sepse edhe shprehja “ne kosovarët” e përdorur për një kohë të gjatë, çon padukshëm në krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar”.

● Secili shqiptar e ka të drejtën e patjetërsueshme të ruajtjes dhe të kultivimit të unitetit kombëtar, duke iu kundërvënë institucioneve, individëve apo grupeve të individëve, që synojnë ndarjen e kombit shqiptar në dy a më shumë kombe, me qëllim shkatërrimin e tij total si komb.

● Unë për vetën time nuk do të tjetërsohem kurrë në “komb kosovar”. Kjo, thjesht sepse asnjëri prej të parëve të mi nuk i ka takuar “kombit kosovar”, por të gjithë i kanë takuar kombit shqiptar shekuj me radhë.

● Ose po të shkojmë prapa në histori, të parët e mi i kanë takuar fisit ilir të njohur si fis dardan i Dardanisë, ndërkohë që termat “Kosovë” dhe “kosovar” janë terma sllavë të fiseve sllave, të cilat në mesjetën e vonshme formacionin shtetëror të Dardanisë e kanë emërtuar si “Kosovë”, kurse banorët e saj shqiptarë i kanë emërtuar si “kosovarë”.

● **Ideve kombndarëse duhet t’u kundërvihen edhe të vdekurit!**: Aq të rrezikshme janë idetë e ndarjes së kombit shqiptar

në dy kombe, saqë ideve të tilla do të ishte dashur t'u kundërvihen jo vetëm shqiptarët e gjallë, por thënë simbolikisht, edhe shqiptarët e vdekur!

● Por nëse shqiptarët (sidomos ata të Kosovës) nuk duan t'u kundërvihen ideve komb-ndarëse të kujtdo qoftë, atëherë nuk më mbetet gjë tjetër veçse t'u thëm atyre: **Duke e shkruar dhe publikuar këtë libër unë e kreu paunën time, pra ju e paqi vetën në qafë!, si dhe t'u them se: Kush vretë vetën shkon gjak-humbur! Amin!**

---

**KAPITULLI PËRMBYLLËS:  
“TOKA SILLET RRETH DIELLIT  
DHE JO DIELLI RRETH TOKËS”**

**Idetë lineare njëdimensionale të Spahiut  
dhe të bashkëmendimtarëve të tij**

Idetë e Spahiut dhe të bashkëmendimtarëve të tij të pakët, sipas të cilave, meqë Kosova është bërë shtet i pavarur, shqiptarët e Kosovës veç janë tjetërsuar ose duhet të tjetërsohen nga komb shqiptar në “komb kosovar”, janë ide lineare njëdimensionale, që në pamje të parë duken të qëndrueshme, por që po të analizohen ca më thellë, shihet se ato nuk përkojnë me realitetin objektiv të ekzistimit në Kosovë të kombit shqiptar dhe jo të “kombit kosovar”.

Idetë lineare njëdimensionale sa herë nuk përputhen me realitetin objektiv, ato janë ide të gabuara, joracionale dhe, sipas rastit, edhe destruktive. Ato janë ide nga më të thjeshtat, që truri i njeriut i prodhon qysh në moshën e fëmijërisë. Por shumë fenomene nuk janë aq të thjeshta sa të përshkruhen, sqarohen e të prognozohen drejt me ide e mendësi lineare.

Për mendimin tim, Spahiu pikërisht duke u shërbyer me ide të tilla lineare njëdimensionale, ka dalë me ide joracionale, joobjektive dhe destruktive, sipas të cilave pas pavarësimit të Kosovës, nga shqiptarët e Kosovës veç na qenka krijuar një komb

tjetër joshqiptar, të cilin ai e quan “komb kosovar”, gjë që nuk qëndron aspak.

### **Kompleksiteti i fenomeneve kërkon ide komplekse shumëdimensionale**

Duke qenë shumica e fenomeneve të kësaj bote komplekse dhe të ndërlikuara, për sqarimin dhe kuptimin e tyre shpesh nuk janë të mjaftueshme idetë lineare njëdimensionale të moshës së fëmijërisë, por kërkohen ide komplekse shumëdimensionale të moshës së pjekurisë. Nuk është aq lineare dhe aq e thjeshtë, që një populli, i cili jo vetëm deri dje, por edhe sot është e ndihet komb shqiptar, t'i thuhet papritmas se je bërë “komb kosovar”, thjesht sepse Kosova është bërë shtet.

Shtetin e Kosovës nuk ka pse ta pengojë realiteti objektiv i të qenit të banorëve të tij me përkatësi kombëtare shqiptare. Përkundrazi, shtetin e Kosovës do ta pengonin krijesat joobjektive dhe fiktive, siç është joobjektive dhe fiktive krijesa e “kombit kosovar”.

Se idetë e Spahiut për gjoja krijimin në Kosovë të “kombit kosovar”, janë ide joobjektive, joracionale, fiktive dhe destruktive, flet qartë rasti i kombit gjerman dhe rasti i kombit vietnamez.

Fakti se në asnjërën nga dy Gjermanitë (as në Gjermaninë Perëndimore dhe as në Gjermaninë Lindore) nuk është krijuar një komb tjetër jogjerman, kjo tregon se edhe në asnjërën nga dy Shqipëritë (as në Shqipëri dhe as në Kosovë), nuk është krijuar një komb tjetër joshqiptar, i emërtuar si “komb kosovar”, ekzistimin e të cilit e propagandon Spahiu pa asnjë fakt ditë e natë.

Edhe fakti se në asnjërin nga dy Vietnamet (as në Vietnamin Verior dhe as në Vietnamin Jugor) nuk është krijuar një komb tjetër jovietnamez, kjo tregon se edhe në asnjërën nga dy Shqipëritë (as Shqipëri dhe as Kosovë), nuk është krijuar një komb tjetër joshqiptar, i emërtuar si “komb kosovar”, ekzistimin e të cilit e Spahiu propagandon ditë e natë.

### **“Toka sillet rreth Diellit dhe jo Dielli rreth Tokës!”**

Kisha katolike gjatë gjithë mesjetës e deri vonë, në saje të ideve të saj lineare njëdimensionale që ka kultivuar gjatë shekujve, është

deklaruar se Toka është e rrafshët dhe se Dielli bashkë me planetët e tjerë sillen rreth saj. Dhe vërtet, edhe sot po ta shikosh Tokën dhe Diellin duke qenë në tokë, do të krijosh ide lineare njëdimensionale, sipas të cilave Toka është e rrafshët dhe qëndron në vend, kurse Dielli është i rumbullakët dhe sillet rreth Tokës!

Por, po t'u referohesh ideve komplekse shumëdimensionale të shkencëtarit me famë, Nikolla Koperniku (1473-1543), dhe të shkencëtarit tjetër me famë, Galileo Galilei (1564-1641), del se Toka është e rumbullakët dhe se ajo bashkë me planetët e tjerë sillet rreth Diellit dhe jo e kundërta.

Kështu, mendësia se në Kosovë pas pavarësimit të saj nga shqiptarët e Kosovës është krijuar një komb tjetër “kosovar”, është si ajo mendësia lineare njëdimensionale e Kishës Katolike, sipas të cilës Toka ishte e rrafshët dhe Dielli sillej rreth saj, kurse mendësia sipas të cilës në Kosovë as pas pavarësimit të saj nuk ka “komb kosovar”, por ka komb shqiptar, është si mendësia shumëdimensionale dhe e sprovuar e Kopernikut dhe e Galileit, sipas të cilave Toka është e rumbullakët dhe se ajo bashkë me planetët e tjerë sillen rreth Diellit.

### **Unë mbjell grurë, kurse Spahiu mbjell egjër!**

Unë dhe Spahiu kemi diçka të përbashkët: **të dy jemi farëmbjellës!** Por unë dhe Spahiu kemi edhe diçka që na dallon shumë nga njëri-tjetri: **unë mbjell grurë, kurse ai mbjell egjër!** Kombi shqiptar nëse do grurë, grurë do të gjej, por nëse do egjër, egjër do të gjej! Kësaj i thonë: zgjidh e merr!

## PASTHËNIE

---

Të nderuar lexues,

Këtë libër, ashtu siç e kam filluar me një parathënie, dua edhe ta përfundoj me një pasthënie, sepse si çdo gjë tjetër, edhe ky libër e ka një fillim dhe një mbarim. Duke prekur fundin e këtij libri, dua të theksoj me sa vijon:

Do të isha i lumtur dhe i përmbushur, nëse nëpërmjet këtij libri, të bërë sipas lajtmotivit ***“Në Kosovë nuk ka pasur dhe nuk ka komb kosovar, por ka pasur dhe ka komb shqiptar”***, të kem arritur që t’i sqaroj mjaftueshëm lexuesit, se duke qenë kombi shqiptar (përfshirë këtu edhe pjesën e tij në Kosovë) një komb monoetnik, prej tij nuk ka mundur të krijohet një komb tjetër “kosovar”; se teoritë franceze për kombin janë adekuate për përshkrimin e krijimit të kombeve multietnike, por nuk janë adekuate për përshkrimin e krijimit të kombeve monoetnike, siç është kombi shqiptar; se teoritë gjermane për kombin janë adekuate për përshkrimin e krijimit të kombeve monoetnike, siç është kombi shqiptar dhe shumë kombe të tjera, por nuk janë adekuate për përshkrimin e krijimit të kombeve multietnike, siç është, p.sh., kombi amerikan dhe shumë kombe të tjera.

Por, duke e përfunduar këtë libër, do të ndihesha i lumtur dhe i plotësuar, edhe nëse kam arritur që, nëpërmjet tij, t’i kam sqaruar mjaftueshëm lexuesit, se kombi shqiptar duke paraqitur kombin më të ndarë e më të copëtuar territorialisht dhe më të rrezikuar të Europës, ai ka 1001 arsye për bashkimin e tij shpirtëror, politik, ekonomik dhe kulturor dhe, nëse do të krijohen rrethana

ndërkombëtare të favorshme, edhe për bashkimin e tij territorial në një shtet të vetëm shqiptar.

Dhe duke e përfunduar këtë libër, do të ndihesha i lumtur, sidomos nëse kam arritur që, nëpërmjet tij, t'i kem sqaruar mjaftueshëm lexuesit lidhur me rrezikun e madh që paraqet krijimi i “kombit kosovar”, për shthurjen totale të kombit shqiptar, dhe nëse në përputhje me këtë rrezik të madh, edhe t'i kem sensibilizuar mjaftueshëm intelektualët, politikanët, analistët politikë, publicistët, gazetarët dhe lexuesit e tjerë, që ata t'i kundërvihen me argumente të mirëfillta tezës së çoroditur të ndarjes së kombit shqiptar në dy kombe: njëri shqiptar e tjetri “kosovar”.

Por, duke përfunduar këtë libër nuk ndihem aspak i lumtur, që duke shkruar atë më është dashur, që si shqiptar t'u kundërvihem disa shqiptarëve, siç janë Spahiu dhe disa të tjerë si ai, të cilët pa asnjë fakt, arsye e nevojë, me apo pa vetëdije, punojnë për ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe: njëri shqiptar në Shqipëri e tjetri “kosovar” në Kosovë.

Nëse duke shkruar këtë libër kam arritur ose jo t'i përmbush qëllimet e shkrimi të tij, të përmendura në kapitullin e parë, këtë pres që ta thonë lexuesit.

Me respekt autori:

Xhevat Hasani

Cyrih, nëntor 2025

## DISA FJALË RRETH LIBRIT “PSE S‘KA DHE S‘MUND TË KETË KOMB KOSOVAR”

---

Kam fatin të jam, në mos i pari, së paku ndër të parët, që kam pasur në duar këtë libër në dorëshkrim, me ide thellësisht atdhetare, thellësisht paraprijëse për mbrojtjen nga ndonjë e keqe që mund t’u ndodhë shqiptarëve si komb, një dorëshkrim ky thellësisht i kuptueshëm nga çdo shqiptar, i intelektualit, veprimtarit dhe atdhetarit të shquar, dr. Xhevat Hasanit.

Ky libër duhet të jetë në bibliotekën e çdo familjeje shqiptare, mbi tryezat e Akademive të Shkencave në Tiranë e Prishtinë, të politik-anëve, politologëve, analistëve, gazetarëve dhe të gjitha subjekteve mediatike; në duart e korifenjve tanë kombëtarë; në katedrat e universiteteve; në shtëpitë botuese dhe kudo ku i thuhet bukës-bukë dhe nënës-nënë, për të marrë masa parandaluese ndaj qëndrimeve “legale” vëlla-ndarëse, vëlla-përçarëse të disa “intelektualëve” në Tiranë e Prishtinë. Kjo, sepse këta disa “intelektualë” ka vite që janë deklaruar pikërisht për ndarjen e kombit shqiptar në dy kombe (në komb shqiptar dhe “komb kosovar”) dhe për ndarjen e gjuhës letrare shqipe në dy gjuhë letrare: në gjuhën letrare shqipe të bazuar në dialektin toskë me përdorim në Shqipëri, dhe në gjuhën letrare shqipe të bazuar në dialektin gegë të shqipes me përdorim në Kosovë.

Shumë dekada më parë, Beogradi zyrtar, mediatik e publik, i paraprirë nga qarqet shoviniste serbe, hodhën në efir postulatet kombëndarëse të shqiptarëve në Shqipëri dhe të shqiptarëve në Kosovë e viset e tjera etnike të tyre. Postulate të tilla serbo-jugosllave antishqiptare ishin si në vijim: një komb - dy ideologji (ideologji komuniste në

Jugosllavi dhe nacionaliste e shqiptaromadhe në Shqipëri); një komb - dy kombe (kombi shiptari-shiftari në Jugosllavi dhe kombi albanci në Shqipëri); një gjuhë - dy gjuhë (toskërishte në Shqipëri dhe gegërishte në viset shqiptare në Jugosllavi,); një komb - dy histori; një komb - dy kultura; një komb - dy tradita; një komb - dy mentalitete; një komb - dy nivele (komb në Shqipëri - kombësi në Jugosllavi); një komb dy pre-jardhje (shqiptarët në Shqipëri-pasardhës të ilirëve, kurse ata në Kosovë e vise të saj - sllavë të islamizuar) e të ngjashme si këto.

Pas çlirimit të Kosovës, këto postulate u “kristalizuan” në Shqipëri e në Kosovë nga një grusht “intelektualësh”, të cilët dolën me idetë e ndarjes së shqiptarëve në Shqipëri e në Kosovë në dy kombe, dhe me idetë e ndarjes së gjuhës standarde shqipe në dy gjuhë. Këto kërpuha të mbira pas shiut (pas çlirimit dhe pavarësisht të Kosovës), nga “intelektualë” të caktuar u hodhën në efir si “tullumbace” kundërkombëtare e kundërshtqiptare.

Nuk e di nëse këto “tullumbace” të atij grushti “intelektualësh” vijnë nga snobizmi, smira dhe egoizmi, nga “qeji” apo nga “zori” (këto i dinë ata që kanë dalë me ide të tilla, por i dinë edhe arkivat), ose vijnë nga se ata (“intelektualët”) kanë gjetur grazhde ku kullosin dhe nxitin ide të tilla komb-ndarëse dhe gjuhë-ndarëse, të cilat përkojnë “natyrs-hëm” me interesat e Beogradit.

Është detyrë urgjente që, të gjithë faktorët politiko-shoqërorë dhe opinionin publik në Shqipëri e Kosovë, t’u japin fund moskokëçarjeve dhe indiferencave ndaj tentativave të tilla komb-ndarëse dhe gjuhë-ndarëse sa janë ato në fillësë, sepse në të kundër, ideve të tilla do t’u shtohen edhe pasues të tjerë, nga joshjet dhe përfitimet materiale e financiare të ofruara prej qarqeve kundër-shqiptare të shteteve shovene ballkanike, sidomos të Serbisë dhe të Greqisë.

Tanimë është bërë e njohur se Serbia e Greqia kanë vënë në dispozicion dhjetëra milionë dollarë dhe euro, për financimin e agjentëve të tyre në Shqipëri e Kosovë, për veprimtaritë e tyre kundërshtqiptare.

Veproni sa nuk është vonë! Mbytni me pështymë dhe izolojini këto qenie kundërkombëtare e kundërshtqiptare!

Tiranë, më 07.02. 2022

Dr. Bardhi Vërria



# **REZYME NË GJUHËN ANGLEZE**

## **WHY THERE IS NOT AND CANNOT BE A KOSOVAR NATION IN KOSOVA**

This summary chapter of the book entitled 'Why There is Not and Cannot Be a Kosovar Nation' sets out the many internal and external factors that have prevented and do prevent the creation, by the Albanians of Kosova, of the 'Kosovar Nation'.

For didactic reasons this chapter is divided into ten sub-chapters, and each sub-chapter includes distinct factors that have served to sustain the Albanian nation (including that part of it in Kosova) as one undivided nation, and not one nation split into two nations: one Albanian and the other 'Kosovar'.

### **1**

#### **The role of common ethnic characteristics**

- **The principal Albanian ethnic, national and cultural characteristics**, common to all Albanians in their territories in the Balkans, have represented the leading factor preventing, and continuing to prevent, the separation of the Albanian nation into two nations, by means of the alienation of one portion of it into another, non-Albanian, 'Kosovar' nation.

- Such common characteristics have been and remain: **Pelasgo-Illyro-Arbëror ethnic antecedents, the Albanian language,**

**the flag, the anthem and the national hero Gjergj Kastrioti Skanderbeg**, which belong to all Albanians, including those who have lived and who live in Kosova. These common characteristics have rendered the Albanian nation a unitary nation, and not a nation divided into two nations.

- At the same time there are **the traditions, the customs, the mores, the phenomenon of besa [word of honour], the phenomenon of hospitality, the kanun [folk law code] of Lek Dukagjini** and much else which, as common cultural characteristics of all Albanians, have likewise mitigated against the alienation of the Albanians of Kosova into another, non-Albanian nation which might be called 'Kosovar'.

- Finally, the **Albanian national mentality** which, though it differs to some extent from region to region, nonetheless stands as common Albanian national mentality (thus including the mentality of the Albanians of Kosova), likewise has prevented and prevents the creation, from the Albanians of Kosova, of another, non-Albanian, 'Kosovar' nation.

- Accustomed to **their existence over unbroken centuries as an Albanian nation**, with all and within all the Albanian national characteristics mentioned above, the Albanians of Kosova have not exchanged and do not exchange their Albanian national affiliation with some other, political and artificial, non-Albanian national affiliation – as the 'Kosovar nation' would be.

- **The role of Pelasgo-Illyro-Arbëror ethnic ancestry:** the Pelasgo-Illyro-Arbëror ethnic ancestry of the Albanians of Kosova, shared by all the other Albanians inhabiting their own territories in the Balkans, has worked and works against their alienation into some other nationality, which one might call 'Kosovar', and on the contrary renders them forever an integral part of the Albanian nation.

- **The role of the Albanian language:** as a language spoken by no other people in the world besides the Albanian nation, the Albanian language identifies Albanians (including the Albanians of Kosova) with the Albanian nation, and the Albanian nation with the Albanian language.

- Since **the Albanian language identifies all Albanians with the Albanian nation**, it does not identify them with any other, non-Albanian nation – for instance a ‘Kosovar’ – which does not in fact exist. And this demonstrates that the Albanian language has represented and represents a major factor which has prevented and prevents the creation, out of the Albanians of Kosova, of another, non-Albanian nation, labelled the ‘Kosovar nation’.

## 2

### **The role of national consciousness in the non-division of the Albanian nation into two nations**

- The Albanians of Kosova, just like the Albanians of other territories, having an Albanian national consciousness laid down over centuries and continuously consolidated, beginning with the 1878 Albanian League of Prizren, have not been alienated and are not alienated into some other, non-Albanian nation, labelled the ‘Kosovar nation’.

- Even when more than ninety percent of them were illiterate, as was the case until 1945, the Albanians of Kosova nevertheless had an Albanian national consciousness, thanks to which they did not allow themselves to be assimilated with the Turks during the five-century Ottoman occupation, nor to be assimilated with the Serbs (between 1912 and 1999), thereby remaining the Albanian nation just like all the other Albanians in the Balkans.

- National consciousness among the Albanians of Kosova – and of other regions with Albania majorities, in Macedonia, Montenegro and the Preshevo Valley in southern Serbia – increased particularly following the opening of the Albanian-language University of Kosova in Prishtina in 1971.

- Between 1971 and the present day more than half a century has passed, during which Albanian national consciousness among the Albanians of Kosova and of other territories has only increased, a phenomenon that has prevented and prevents the creation out of the Albanians of Kosova of another, non-Albanian nation, labelled the ‘Kosovar nation’.

- The demonstrations by students and significant portions of the

population during the 1980s, the wholesale education of Albanian youth in the University of Kosova, and the support given by Albania to the universal popular demand for a Republic of Kosova (at that time within Yugoslavia) have been the three principal pillars on which national consciousness among the Albanians of Kosova and of other regions of Yugoslavia with Albanian majorities has ascended to the highest level: that of **self-sacrifice for the interests of the Albanian nation**.

### 3

#### **The role of Kosova's historical path in the non-division of the Albanian nation into two nations**

- The historical path of the Albanians of Kosova – as the Albanian nation and not the ‘Kosovar’ – and of the other territories in Yugoslavia with Albanian majorities has represented in particular, and represents, the chief factor that has prevented and prevents the creation from the Albanians of Kosova of another, non-Albanian ‘Kosovar’ nation.

- When we speak of the historical path of the Albanians of Kosova, we refer to their political and armed struggles over two centuries in succession, as the Albanian nation and not the ‘Kosovar’, for the consolidation and unification of the Albanian nation in one Ethnic Albania.

- Under the auspices of the Albanian League of Prizren, from 1871 to 1881 the Albanians of Kosova fought for the unification of the four Albanian Vilayets (those of Kosova, Manastir, Shkodra and Janina) in one Ethnic Albania; they did not fight for the creation of the ‘Kosovar nation’ outside the Albanian nation, nor for the creation of a state outside the state of Albania.

- In the years 1903-1912, the Albanians of Kosova likewise fought for the independence of Albania, to incorporate all the territories with an Albanian majority, including the lands of Kosova; and they did not fight for the creation of the ‘Kosovar nation’ outwith the Albanian nation, nor for the establishment of a Kosova state outwith the state of Albania.

- In the years 1941-45 of the Second World War, the Albanians

of Kosova likewise fought against the fascist forces of Italy and the Nazi forces of Germany, under the auspices of Kosova's anti-fascist war, with the intention that Kosova and the other territories with Albanian majorities left in Yugoslavia would, after the war, unite with the mother-country, Albania;<sup>387</sup> they did not fight for the creation of the 'Kosovar nation' outwith the Albanian nation, nor for the establishment of a Kosova state outwith the state of Albania.

- The demonstrations by students and the broader mass of the Albanian population that took place in the Autumn of 1968, during 1981 and through the years that followed, likewise aimed at the establishment of a Kosova Republic, not merely with the aim that the Albanians of Kosova should have the same rights as other nations within Yugoslavia but with the further aim that, by becoming a republic, Kosova might more easily unite with Albania.

- Finally, the Albanians of Kosova did not wage the Kosova Liberation War of 1998-99, spearheaded by the Kosova Liberation Army (Ushtria Çlirimtare e Kosovës – UÇK), merely for the liberation of Kosova from Serbian occupation, but for the unification of Kosova and the other remaining Albanian territories in Macedonia, Montenegro and the Preshevo Valley in Serbia with the mother-country, Albania. The military oath of the UÇK makes this clear:

### **Military Oath of the UÇK**

**As a member of the Kosova Liberation Army, I swear that I shall fight for the liberation of the occupied territories of Albania and their unification, I shall be always a faithful soldier, a worthy fighter for freedom, vigilant, courageous and disciplined, ready at all times, unstinting even of my life, I shall fight to defend the sacred interests of the FATHERLAND. If I**

---

<sup>387</sup> The allusion here is to the 'Assembly of the Anti-Fascist Council of Kosova', held in the village of Bujan in Albania between 31 December 1943 and 1 or 2 January 1944, in which it was resolved that Kosova and the other territories with Albanian majorities within Yugoslavia should, consistent with the principle of self-determination, join Albania after the war. But this rightful goal of the Albanians was prevented by the Communist Party of Yugoslavia which, in July 1945, violently annexed Kosova and the other territories with Albanian majorities to Yugoslavia.

**break this oath, let me be punished according to the severest laws of war, and if I betray, may I lose my blood. I SWEAR!**

This historical path of the Albanians of Kosova, accompanied with much political struggle and many armed risings, always conducted in the name of the Albanian nation and not in the name of some other, 'Kosovar' nation, and always conducted in the name of the union of all Albanian territories (including Kosova itself) in one single Albania, demonstrates clearly that it not only prevented the creation in the past of some other, non-Albanian nation from the Albanians of Kosova, but also prevents in the future the creation of some other, non-Albanian nation from the Albanians of Kosova – such as a 'Kosovar nation', really and objectively non-existent.

#### **4**

#### **The role of ethnic oppression, of religion and of ethnic composition in the non-division of the Albanian nation into two nations**

- **The role of ethnic oppression:** The Serbo-Yugoslav ethnic oppression inflicted on the Albanians of Kosova and of other Albanian territories left within Yugoslavia itself served as an historical lesson for all Albanians (including those of Kosova), that they should continuously cultivate Albanian national unity, something that prevented the division of the Albanian nation into two or more nations.

- The waves of genocide and ethnic cleansing committed against the Albanians of Kosova by the fascist Serbia of Milosević in the years 1998-99 likewise served as an historical lesson that the Albanian nation should be unitary and not a nation divided into two nations: one Albanian and the other 'Kosovar'.

- **The role of religion:** The fact that the Albanians are of the Islamic faith, while the Serbs are of the Christian Orthodox faith, has mitigated against mixed marriages between Albanians and Serbs except in special cases. This non-mixing between Albanian and Serb has likewise prevented the creation of another, mixed

Albano-Serb nation out of the Albanians of Kosova, which might be labelled a 'Kosovar nation'.

- **The role of ethnic composition of population:** Furthermore, there has not been and there is not a 'Kosovar nation' in Kosova because of the ethnic composition of the communities living in Kosova. Given that the Serb community in Kosova is very small (3% of the overall population), even if the entire Serb minority were integrated with the Albanian majority – which forms 94% of the overall population – the basic nature of the Albanian nation in Kosova would not change sufficiently for the creation from it of another, non-Albanian nation, which might be labelled a 'Kosovar nation'.

- There could only be a 'Kosovar nation' in Kosova if Kosova had a different ethnic composition – if, for example, the majority from the Albanian nation represented some 50 or 60% of the overall population, if the Serbian community represented some 30% of the overall total, and if the other minority communities (Bošniaks, Turks, Muslims, Roma, Ashkali and others) represented some 10% of the overall population.

- If, within this hypothetical ethnic composition of Kosova, an Albanian majority of some one million inhabitants were to blend (by means of mixed marriage) with a Serbian community of some 400,000 inhabitants and with other minority communities of some 100,000 inhabitants, then another, non-Albanian nation might indeed be created in Kosova, a multi-ethnic 'Kosovar' nation.

- The fact that Kosova, in all likelihood, will in the future have the same ethnic composition that it has now goes to show that a 'Kosovar nation' may not be created from the Albanians of Kosova in the future either.

## 5

### **The role of Kosova-Albania cultural co-operation in the non-division of the Albanian nation into two nations**

- Although at the time Kosova was part of the Yugoslav Federation, at the beginning of the 1970s the 'Kosova-Albania Agreement for Cultural Co-operation' was in operation. The

agreement was in force until March 1981, when its operation was unilaterally interrupted by Yugoslavia because of the student demonstrations in Prishtina in March and April of that year with their political bid for a Kosova Republic.

- The romantic-patriotic enthusiasm of the 1970s in Kosova was heralded by the scholarly symposium held in Prishtina in 1968 to mark the five hundredth anniversary of the death of the Albanian national hero, Gjergj Kastrioti Skanderbeg, a symposium in which for the first time scholars from Albania participated. Among the Albanian young people of the time, the character of Skanderbeg became for the first time a symbol of pride, glory and inspiration for Albanian identity.

- As was mentioned above, another major event which increased the potential for wisdom and knowledge among all Albanians left unjustly under Yugoslavia after the Second World War was the founding and opening of the Albanian-language University of Kosova in Prishtina in 1971.

- In the University of Prishtina during the 1970s and 1980s, for some twenty years in succession, young Albanians from not only Kosova but also other territories with Albanian majorities in Macedonia, Montenegro and the Preshevo Valley in the south of Serbia received higher education and development.

- This widespread education of young Albanians from all the Albanian territories left in Yugoslavia culminated in the raising of national consciousness among young Albanians, to the point of their willingness to sacrifice themselves in the interests of the Albanian nation.

- The third major event which stirred all Albanians to feel as one united nation was the standardization of the Albanian language at the Albanian Orthographical Congress held in Tirana in 1972. Unity of the Albanian language for all Albanians in their territories across the Balkans represented the linguistic, cultural and spiritual unification of the Albanian nation.

- At that time, the sense of national unification through linguistic unification caught up all young Albanians in university and high school, together with the broader mass of the population,

fostering an atmosphere of national unification even without its achievement in reality.

- This atmosphere full of hope for victory was kindled in particular by those artistic ensembles of folk singers, theatre troupes and exhibitions of visual art from Albania in the 1970s that, thanks to the Kosova-Albania Agreement for Cultural Co-operation, put on their shows chiefly in Prishtina but also in other Kosovan towns, lighting in the hearts of young Albanians the flame of unequalled passion for the mother-country, Albania.

- It was the national consciousness attained during the 1970s that led to the organization of student and cross-society demonstrations in spring 1981 and the years that followed, calling for the establishment of the Kosova Republic, with the final aim of its union with Albania.

- And it was the events of the 1980s, accompanied by mass demonstrations by all of Yugoslavia's Albanians calling for the Kosova Republic, that prepared Albanian youth, so that at the beginning of the 1990s they founded the Kosova Liberation Army for the liberation of Kosova from Serbia by armed struggle.

## 6

### **Kosova's defensive role for Albania in the non-division of the Albanian nation into two nations**

- The readiness of the Albanians of Kosova to defend Albania with all possible means, were it to be attacked by Yugoslavia at the incitement of Serbia, has likewise stamped the Albanian nation as one undivided, rather than a nation divided into two nations: one Albanian and the other 'Kosovar'.

- From 1945, when the Federal Yugoslavia was founded, to 1991, when the Yugoslav Federation disintegrated, the Albanians of Kosova have been ready to shed their last drop of blood in the defence of Albania, were it to be attacked by Yugoslavia.

- Were Yugoslavia, incited by its three anti-Albanian southern republics, to have attacked Albania, the Albanians of Kosova would have liberated Kosova from Serbia and from Yugoslavia and united it with Albania.

- Knowing that, were it to attack Albania, it would be confronted not only by three and a half million Albanians of Albania, but also by two and half million Albanians inside Yugoslavia, Yugoslavia diminished its plans for military action against Albania.

- As by means of secret political resistance conducted by secret political organizations, so by means of legal political resistance (in the form of mass demonstrations during the 1980s) did the Albanians of Kosova oblige Yugoslavia to deal with 'the Internal Albania' (stifling the resistance of Albanians within Yugoslavia) rather than dealing so much with 'the External Albania' (the Republic of Albania).

- In all this the Albanians of Kosova and of other Albanian territories left within Yugoslavia after the Second World War served as a **living defensive barrier for Albania**, something which forged the Albanian nation even more strongly as one undivided, rather than a nation divided into two nations: one Albanian and the other 'Kosovar'.

## 7

### **The role of the aid given by Albania to Kosova in the non-division of the Albanian nation into two nations**

- From the time that Albania was internationally recognised as a country in 1913, and until 1999, when Kosova was liberated from Serbia, and then even until 2008, when Kosova became independent, in a mainly unfavourable context, and as far as it was able, Albania gave political support to the rights of Albanians in Kosova and other parts of Yugoslavia, but also accused Yugoslavia and Serbia of genocide and ethnic cleansing of the Albanians of Kosova and other areas inhabited by Albanian majorities, such as Macedonia, Montenegro and Serbia.

- This long-term support that Albania offered the Albanians of Kosova – and the other areas with Albanian majorities in Yugoslavia – repeatedly confirmed the Albanian nation as an undivided nation, and not a nation split into two nations: one of them Albanian and the other 'Kosovar'.

- **Help from Albania for education:** The long-term aid from

Albania for Albanian language education in Kosova and other Albanian areas in Yugoslavia confirmed the continuation of the Albanian nation as an undivided nation, and not a nation split into two nations: one of them Albanian and the other 'Kosovar'.

- Between 1941 and 1943, during the Second World War, the pro-Italian government of Albania sent teachers and books in Albanian to Kosova, to enable the education of Kosova's Albanians in their native Albanian language.

- Immediately after the end of the Second World War in 1945, and until 1948, when Albania unilaterally broke off relations with Yugoslavia, the Communist government of Albania also sent teachers and books in Albanian to Kosova, to enable the education of Kosova's Albanians in Albanian.

- Even in the period from 1970 to 1980, when the 'Kosova-Albania Agreement for Cultural Co-operation' was in force, the Communist Government of Albania sent a large number of pedagogical experts to Kosova to lecture in a variety of subjects in the University of Kosova, and also sent historical, scientific, cultural, literary and artistic literature, for the use of Albanian high school and university students in Kosova.

- Thus, there is no doubt that this significant help from Albania for Albanian-language education in Kosova, increasing a national consciousness among Kosova's Albanians and those in other Albanian areas of Yugoslavia, resulted in the Albanian nation surviving as an undivided nation across the areas where Albanians lived in the Balkans, and not as a nation split into two nations: one of them Albanian and the other 'Kosovar'.

- **Albania's propaganda of a national character:** From the 1950s and 1960s, when Albania had informative audio-visual tools for the first time, until the end of the 1980s, Albania transmitted to Kosova – and other areas – Albanian national historical-political propaganda via Radio Tirana, Radio Kukës and Albanian State Television.

- There is no doubt that such long-term national propaganda, transmitted from Albania to Kosova – and other Albanian areas of Yugoslavia – contributing to increasing a national consciousness

among the Albanians, also contributed to the Albanian nation's survival as an undivided nation, and not a nation split into two nations: one of them Albanian and the other 'Kosovar'.

- **National propaganda in forty foreign languages:** Albania transmitted information over the radio waves in forty languages to inform international public opinion and international politics on the injustice against the Albanians by Yugoslavia (in other words, by her three southern republics: Serbia, Macedonia and Montenegro) and the political demands of Kosova's Albanians during the 1970s and 1980s (over a period of twenty years).

- There is no doubt that this international propaganda in regard to Kosova, transmitted by Albania in forty world languages, had an impact in ensuring the Albanian nation's survival as one undivided nation, and not a nation split into two nations: one of them Albanian and the other 'Kosovar.'

- **Albania – the only voice for Kosova:** From 1948, when it unilaterally broke off relations with Yugoslavia, and until 1990 when the destruction of Federal Yugoslavia began, Albania showed itself as the only country in the world to raise its voice against the Serbian and Yugoslav injustices against the Albanians of Kosova and other regions with an Albanian majority in Federal Yugoslavia. There is no doubt that Albania's lone, but powerful, voice for Kosova had an impact in ensuring the Albanian nation's survival as one undivided nation, and not a nation split into two nations: one of them Albanian and the other 'Kosovar.'

- **Albania's political support during the 1980s.** The political support that Albania gave, especially during the 1980s, to the political demand from students and the Albanian masses, for Kosova to become a Republic of the then Yugoslavia also contributed significantly to the Albanian nation's survival as one undivided nation, and not a nation split into two nations: one of them Albanian and the other 'Kosovar'.

- The possibility of defending Kosova even in an armed conflict: Particularly during the 1980s when the Albanians of Kosova – and of other areas with an Albanian majority within Yugoslavia – were demonstrating, demanding that Yugoslavia should recognise Kosova

with the status of a Republic, Albania at various critical moments placed considerable armed forces along its borders with Kosova.

- This movement of forces and weapons along its borders with Kosova was not only to defend Albania against any Serbo-Yugoslav military attack. It was also done with the aim of defending Kosova's Albanians in an armed conflict if Yugoslavia committed any mass genocide or ethnic cleansing.

- There is no doubt that Albania's readiness to defend Kosova's Albanians, even in an armed conflict, contributed to the Albanian nation being one undivided nation, and not a nation split into two nations: one of them Albanian and the other 'Kosovar'.

## **8**

### **The role of the support Albania gave Kosova during the Liberation War of 1998-1999**

- In particular, the great help that Albania gave Kosova during 1998-1999 in the Kosova Liberation War waged by the KLA cemented national unity for Albanians in all territories in the Balkans where they dwelt, thus contributing to the survival of the Albanian nation as one undivided nation, and not a nation split into two nations: one of them Albanian and the other 'Kosovar'.

- Political help: In the years of the Kosova Liberation War of 1998-1999, the Albanian government and Albanian diplomats in Albania's embassies around the world were very engaged in defending Kosova's rights in the international arena and defending the KLA from Serbia and Russia's labelling of it as a terrorist organisation.

- In February 1998, the American Ambassador, Mr Gelbard, stated in Skopje that the KLA was a terrorist organisation, thus damaging both the KLA and the future of Kosova.

- But after two meetings of the KLA's two political representatives (Mr Bardhyl Mahmuti and Mr Ramadan Avdiu) in Switzerland in June 1998 with Robert Gelbard and Richard Holbrooke – meetings mediated by the Prime Minister of Albania, Fatos Nano – the American State Department no longer described the KLA as a

terrorist organisation, but as a Liberation Army.<sup>388</sup>

- On the other hand, while in the Château of Rambouillet, near Paris, the International Rambouillet Conference was held in February and March 1999 in order to stop the humanitarian crisis in Kosova and to find a political status for Kosova, the Foreign Minister of Albania, Mr Paskal Milo, stayed throughout near the Château of Rambouillet with some other diplomats in order to advise the Kosova delegation on making good political decisions.

- Such political support from Albania to Kosova and the KLA during the 1998-1999 Kosova Liberation War was an additional act which strengthened the unity of the Albanian nation along the Kosova-Albania axis.

- **Help with logistics and weapons:** The support with logistics and weapons which Albania gave to the Kosova Liberation Army (KLA) during the war in 1998-1999 was another great factor that consolidated the Albanian nation as a unique and indivisible nation.

- Today we know that 95% of the weapons used for Kosova's liberation from Serbia were weapons brought from Albania, and only around 5% of weapons used for Kosova's liberation were arms that came from the countries of Europe.

- It is also recognised today that without a country like Albania where the KLA could move freely, where weapons were gathered, and where there were also bases along the border with Kosova, the Kosova Liberation War would not have been possible. And without the Kosova Liberation War, there would not have been either the liberation or the independence of Kosova.

- **Significant aid in offering shelter:** In the spring of 1999, around 700.000 Kosova Albanians who had been displaced by Milošević's fascist regime were sheltered in Albania and this also confirmed forever the survival of the Albanian nation as an undivided nation, and not a nation divided into two nations: one Albanian and the other 'Kosovar'.

---

<sup>388</sup> Bardhyl Mahmuti, "The Kosova Liberation Army as a constant target" Epoka e Re, 2024, pp 119-124

**The role of the Albanian nation's status as the most endangered nation in Europe in the non-division of the Albanian nation into two nations**

- Even the fact of the Albanian nation being the most endangered nation in the Balkans and in Europe over the last two centuries has contributed to the Albanian nation being an undivided nation, and not a nation divided into two nations: one Albanian and the other 'Kosovar'.

- **Serbia's goal of devouring Kosova:** The fact that since 1999, when Kosova escaped its claws, Serbia has set up forty military bases and a large barracks along its border with Kosova; the fact that Serbia's constitution considers Kosova a part of Serbia; and the fact that since 1999 she has threatened Kosova with military aggression dozens of times – all these facts taken together make clear how the Albanian nation is really the most endangered nation in the Balkans and in Europe.

- **Serbia wants to deal with only around two million 'Kosovars':** Serbia wants the Albanian nation to be divided into two nations, with the goal that in its attempts to reconquer Kosova, she will not be confronted with five million Albanians, as there are altogether in the Balkans, but with just two million 'Kosovars'.

- There is no doubt that this long-term Serbian threat to Kosova has contributed and continues to contribute to the survival of the Albanian nation as an undivided nation and not a nation divided into two nations: one Albanian and the other 'Kosovar'.

- **Greece's intention to absorb Albania:** The fact that since 1945, meaning now for seven consecutive decades, the Greek constitution has sanctioned the 'Law on War with Albania,' and the fact that Greece would like to absorb the southern areas of Albania, taken together make clear how the Albanian nation is really the most endangered nation in the Balkans and in Europe.

- **Greece wants to deal with only three million Albanians:** Greece wants the Albanian nation to be divided into two, with the aim that in her attempts to annex the southern areas of Albania, she will not be confronted with around five million Albanians as

there are altogether in the Balkans, but only with around three million Albanians from Albania.

- And there is no doubt that this long-term Greek threat to Albania has contributed and continues to contribute to the survival of the Albanian nation as an undivided nation and not a nation divided into two nations: one Albanian and the other 'Kosovar'.

- **The endangered Albanian nation needs unity, not division:** The status of the Albanian nation as the most endangered nation in the Balkans and in Europe requires it to maintain its national unity, and not to be divided into two nations: Albanian in Albania and 'Kosovar' in Kosova.

The Albanian nation is so endangered that demands for its division into two nations are the same as demands for its final destruction in all areas of the Balkans.

## 10

### SOME CONCLUSIONS

- All these intra-Albanian factors for cohesion, and the other external factors mentioned above, mean that in Kosova there has been for centuries this unique Albanian nation, and not a political and artificial 'Kosovar nation' which our two anti-Albanian neighbours, Serbia and Greece, would love to see.

- **There are not twenty people who support Spahiu's nation-dividing idea:** there have been, and there continue to be, such cohesive intra-Albanian factors that, despite the propaganda of four Albanian public intellectuals and journalists over more than 25 years on the creation from Kosova's Albanians of a so-called 'Kosovar nation', in all Kosova there are nevertheless no more than around twenty supporters of such nation-dividing ideas from just four public intellectuals and journalists.

- **The 'Kosovar nation' is a fantasm** which encourages four Albanian public intellectuals and journalists to disseminate propaganda without a single fact, as if Kosova's Albanians have created a 'Kosovar nation' – an idea which simply does not stand up.

- **Who gains by the division of the Albanian nation?** Even a child could see that the two Balkan countries who benefit from the

division of the Albanian nation into two are those that are entirely anti-Albanian: Serbia, which would like to devour Kosova, and Greece, which would like to devour the southern areas of Albania.

- **Who loses by the division of the Albanian nation?** Even a child could see that from the division of the Albanian nation into two, the only loser is the Albanian nation which stands as the most endangered nation in the Balkans and in Europe.

- **Support for the anti-Albanian aims of Serbia and Greece:** Every Albanian who calls for the division of the Albanian nation into two nations is, whether consciously or not, supporting the anti-Albanian aims of two Balkan countries: of Serbia against Kosova and of Greece against Albania.

- **Undermining the Albanian nation:** And whoever calls for the division of the Albanian nation into two nations is, whether consciously or not, undermining the Albanian nation, which is the most dismembered and endangered nation in Europe.

- **The trigger for unravelling the entire Albanian nation!** If in the future there really were a non-Albanian nation called the 'Kosovar nation' created from Kosova's Albanians, then that 'Kosovar nation' would, through the negative domino effect it would have, lead to the division of the Albanians into two nations (Albanian and 'Kosovar') not only within Kosova but also in the Albanian regions of North Macedonia, Montenegro, the Presheva valley and maybe also in the north east of Albania.

- Thus, the creation of a 'Kosovar nation' from Kosova's Albanians would, in my opinion, represent the trigger for a total unravelling of the Albanian nation. For this reason, the attempts – whether consciously or not, and by whomsoever – by the Albanians of Kosova to create a 'Kosovar nation' are attempts to completely unravel the Albanian nation.

- This is the reason why I think that those who play the 'Kosovar nation' card are, whether consciously or not, playing with the existence of the entire Albanian nation in its Balkan lands.

It is precisely the risk of a total unravelling of the Albanian nation that completely justifies the preventative action that academics, teachers and other Albanian intellectuals should take against the

nation-dividing ideas of the four Albanian public intellectuals and journalists and others who support them.

- It is also the risk of a total unravelling of the Albanian nation that completely justifies the call for the written and audio-visual media in Kosova not to 'Kosovarise' everything in Kosova, by calling everything 'Kosovan', because in this way on the one hand they de-Albanianize everything in Kosova, and on the other hand they contribute stealthily to the creation from Kosova's Albanians of a 'Kosovan nation'.

- And it is the risk of the total unravelling of the Albanian nation which forces me to address Kosova's Albanians, requesting them not to use the term 'we Kosovars' all the time in daily life, but also to say 'we Albanians', as they have said for centuries. This is because the expression 'we Kosovars' if used for a long time will also lead stealthily to the creation from Kosova's Albanians of a 'Kosovar nation'.

- Every Albanian has the inalienable right to preserve and cultivate national unity, opposing institutions, individuals or groups of individuals who are attempting to divide the Albanian nation into two or more nations with the goal of destroying it completely as a nation.

- Personally, I will never be separated into a 'Kosovar nation'. This is simply because none of my ancestors belonged to the 'Kosovar nation' – while over centuries, all of them belonged to the Albanian nation.

- Or if we go back in history, my ancestors belonged to the Illyrian tribe known as the Dardanian tribe of Dardania, while the terms 'Kosova' and 'Kosovar' were Slavic terms for Slavic tribes, who – in late mediaeval times – named the state formation of Dardania as 'Kosova', and the Albanians living there 'Kosovars'.

- **Even the dead must oppose nation-dividing ideas!** The idea of dividing the Albanian nation into two nations is so dangerous that it would be good if it could be opposed not only by living Albanians but also – speaking symbolically – those Albanians who have died!

# PËRMBAJTJA

---

Parathënie ..... 9

## **PJESA E PARË..... 15**

- 1 Pse në Kosovë nuk duhet të krijohet “kombi kosovar”? Pse Spahiu, Matoshi dhe ndonjë tjetër kanë dalë me ide komb-ndarëse? Cilat janë temat bosht të këtij libri?..... 16
- 2 Ideve komb-ndarëse të Spahiut u është kundërvënë një pjesë e intelektualëve dhe shumë qytetarë të thjeshtë ..... 28

## **PJESA E DYTË..... 37**

- 3 Propagandimi i “kombit kosovar” në katër libra metaforikë dhe qesharakë ..... 38
- 4 Keqinterpretimi i planit/dokumentit të Ahtisarit në funksion të propagandimit të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar“ ..... 49
- 5 Dokumenti i Ahtisarit nëpërmjet të diskriminimit pozitiv të pakicës serbe e pamundëson krijimin e kombit kosovar, si dhe e bën Kosovën shtet sui generis ..... 60
- 6 Keqinterpretimi i Kushtetutës së Kosovës në funksion të propagandimit të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” ..... 70
- 7 Keqinterpretimi i anëtarësimit të shteteve në OKB, në funksion të propagandimit të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” ..... 76
- 8 Çfarë thotë Karta e Kombeve të Bashkuara për anëtarësimin e shteteve në OKB? Cilat janë kushtet dhe procedurat për anëtarësimin e shteteve në OKB ..... 84

**PJESA E TRETË .....91**

- 9 Teoritë gjermane për kombin (përfaqësuesi tipik: Johann Gottlieb Fichte)..... 92
- 10 Teoritë franceze për kombin (përfaqësuesi tipik: Ernest Renan).102
- 11 Kombet dhe llojet e kombeve.....111
- 12 Dallimet mes kombit dhe shtetit dhe llojet e shteteve..... 119
- 13 Një komb mund të jetë pronar i dy a më shumë shteteve të banuara prej tij: kombi shqiptar është pronar legjitim i dy shteteve shqiptare ..... 126
- 14 Shqiptarët e Kosovës janë pjesëtarë të kombit shqiptar, pa marrë parasysh nëse kanë apo nuk kanë pasaportë të Shqipërisë.....133

**PJESA E KATËRT .....139**

- 15 Keqpërdorimi i parimeve të Revolucionit Francez për kombin, në funksion të propagandimit të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” ..... 140
- 16 Keqpërdorimi i parimit të teorive franceze, sipas të cilit etnia dhe kombi janë dy gjëra të ndryshme, në funksion të propagandimit të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” ..... 146
- 17 Keqpërdorimi i parimit të teorive franceze për kombin-shtet në funksion të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” ..... 156
- 18 Keqpërdorimi i parimit të teorive franceze për kombin-shtet në funksion të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” ..... 161

**PJESA E PESTË .....173**

- 19 Manipulim-spekulimi i fakteve historike në funksion të propagandimit të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” .....174
- 20 Perandoria Osmane nuk e ka ndihmuar as krijimin e kombit shqiptar dhe as krijimin e alfabetit të gjuhës shqipe.....183
- 21 Anglia dhe Gjermania kanë pjesën e tyre të mëkatit të bërë ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë ..... 193
- 22 As serbët, as grekët dhe as bullgarët nuk janë islamizuar në masë të madhe gjatë sundimit osman ..... 198

23	Keqinterpretimi i statusit politik të shqiptarëve në Jugosllavinë Federative, në funksion të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” .....	206
24	Pikëpamjet jo të drejta të Spahiut lidhur me statusin politik të shqiptarëve në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës në Serbi .....	210

**PJESA E GJASHTË.....217**

25	Keqinterpretimi i ideve të rilindësve kombëtarë shqiptarë në funksion të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” .....	218
26	Keqinterpretimi i veprimtarisë politiko-patriotike dhe letrare të Gjergj Fishtës, në funksion të përligjjes së gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” .....	221
27	Gjykime të paqëndrueshme të Spahiut për rilindësin e madh Sami Frashëri, në funksion të përligjjes së gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” .....	227
28	Keqinterpretimi i poezisë së Mitrush Kutelit “Poem kosovar”, në funksion të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” .....	233
29	Akuzat dhe përcënimet e Spahiut bërë elitave politike shqiptare dhe akademikëve shqiptarë, për mosnjohjen e teorive për kombin....	236

**PJESA E SHTATË..... 243**

30	Përpyjekjet e Spahiut për t'i bindur personalitetet ndërkombëtare për gjoja nevojën e krijimit nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” .....	244
31	Implikimi i presidentëve amerikanë në funksion të propagandimit të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” .....	256
32	Keqinterpretimi i deklaratave të presidentëve të Serbisë për mosekzistimin e “kombit të Kosovës”, në funksion të nxitjes së krijimit të “kombit kosovar” .....	261
33	Spekulimi i Spahiut me Ibrahim Rugovën e vdekur në funksion të propagandimit të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” ...	265
34	Implikimi i fjalorëve në funksion të propagandimit të gjoja krijim-ekzistimit të “kombit kosovar” .....	269

<b>PJESA E TETË .....</b>	<b>279</b>
35 Në Kosovë mund të ketë luftë civile – vëllavrasëse vetëm nëse nga një pjesë e shqiptarëve të Kosovës do të krijohet “kombi kosovar”	280
36 Idetë e Spahiut për krijimin nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” nuk kanë gjetur përkrahje, por kanë gjetur bumerang..	288
 <b>PJESA E NËNTË .....</b>	 <b>293</b>
37 Gjuha nuk paraqet faktor komb-përcaktues për kombet multietnike, por paraqet faktor komb-përcaktues për kombet monoetnike, siç është edhe kombi shqiptar në viset e tij në Ballkan.....	294
38 Pikëpamjet e Spahiut lidhur me gjuhët standarde në përgjithësi dhe lidhur me gjuhën standarde shqipe në veçanti lënë shumë për të dëshiruar .....	301
 <b>PJESA E DHJETË .....</b>	 <b>311</b>
39 Përdorimi i flamurit shtetëror të Kosovës dhe përdorimi i flamujve kombëtarë në raport me legjislacionin në fuqi .....	312
40 Keqinterpretimet e Spahiut bërë simboleve shtetërore të Kosovës për t'i paraqitur ato si simbole kombëtare të Kosovës.....	319
41 Flamuri kombëtar shqiptar te varrezat e dëshmorëve ka parajsën e vet!.....	329
42 Ekspozimi i flamurit kombëtar shqiptar në Presidencën e Kosovës krahas flamurit shtetëror të Kosovës nuk paraqet tradhti kombëtare.....	335
43 Për shqiptarët e Kosovës flamuri kombëtar shqiptar është vetvetja dhe indi i tyre që nuk vdes!.....	340
44 Flamuri kombëtar shqiptar nuk i takon vetëm të kaluarës, por i takon edhe të ardhmes .....	347
 <b>PJESA E NJËMBËDHJETË .....</b>	 <b>353</b>
45 Kundërvënja e Spahiut ndaj bashkimit Kosovë-Shqipëri me shembuj jo të duhur, primitivë dhe banalë.....	354

46	Bashkimi Kosovë-Shqipëri ka qenë, është dhe do të jetë ndërmarrje progresive .....	360
47	Kosova dhe Shqipëria, duke qenë dy shtete sovrane, kanë të drejtën e bashkimit në një shtet të përbashkët shqiptar.....	368
48	Bashkimi Kosovë-Shqipëri do të bëhet me vullnet të lirë dhe me marrëveshje mes shqiptarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë ..	373
49	Amza e përbashkët e kombit shqiptar e legjitimon të drejtën e bashkimit Kosovë-Shqipëri .....	378
50	Shqipëria kurrë nuk është deklaruar kundër bashkimit Kosovë-Shqipëri: Kosova edhe pas pavarësisë së saj e do bashkimin me Shqipërinë.....	381
51	Bashkimi Kosovë-Shqipëri do të jetë kryefitorja historike e tërë kombit shqiptar në viset e tij në Ballkan .....	386
52	Porosia makabre e nazistit Xhafer Deva për mosbashkimin e Kosovës me Shqipërinë .....	392

## **PJESA E DYMBËDHJETË..... 401**

53	Me historikun e kombit gjerman, korean dhe vietnamez nuk mund të përliqjet krijim-ekzistimi i “kombit kosovar”: ka pasur dhe ka një komb të vetëm gjerman, një komb të vetëm korean, një komb të vetëm vietnamez dhe një komb të vetëm shqiptar .....	402
54	Me shembullin e krijimit të kombit austriak nuk mund të përliqjet gjoja krijimi nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” .....	412
55	Me shembullin e krijimit të kombit moldav nuk mund të përliqjet gjoja krijimi nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” .....	420
56	Me shembullin e krijimit të kombit maqedon nuk mund të përliqjet gjoja krijimi nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” .....	424
57	Me shembullin e krijimit të kombit malazez nuk mund të përliqjet gjoja krijimi nga shqiptarët e Kosovës të “kombit kosovar” .....	440

## **PJESA E TREMBËDHJETË..... 447**

58	Pse në Kosovë s’ka dhe s’mund të ketë komb kosovar .....	448
----	----------------------------------------------------------	-----

59 Kapitulli përmbyllës: “Toka sillet rreth diellit dhe jo dielli rreth tokës” .....	467
<b>PASTHËNIE .....</b>	<b>470</b>
Disa fjalë rreth librit “Pse s’ka dhe s’mund të ketë komb kosovar”..	472
<b>REZYME NË GJUHËN ANGLEZE.....</b>	<b>475</b>
Why there is not and cannot be a Kosovar nation in Kosova.....	476







**Xhevat Hasani**

Xhevat Hasani ka lindur më 14 shkurt të vitit 1953 në fshatin Buzëz të krahinës së Opojës në Kosovë. Gjatë 1979-1991 ka punuar si asistent dhe docent në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Në fund të vitit 1992, për shkak të përndjekjeve politike nga regjimi serb, është larguar nga Kosova. Prej 30 vjetësh jeton në Zvicër.

Ka qenë përkrahës i rinisë studentore të viteve '80-të dhe përkrahës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Letërsia, historia, politika dhe çështja e Kosovës në veçanti, kanë qenë e janë profesioni i tij i dytë pas profesionit të mjekut.

#### **Libra të botuar:**

**1. "Shkolla dhe arsimiti shqip ndër viset shqiptare në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi përballë shovinizmit serb, maqedon e malazez",** Vjenë 1995. I njëjti libër është botuar edhe në gjuhën gjermane: **"Die Albanische Schulen und das Schulwesen in den Albanischen Gebieten in Kosovo, Makedonien und Montenegro angesichts des Serbischen, Makedonischen und Montenegrinischen Chauvinismus",** Wien 1995.

**2. "Sistemi shëndetësor i Kosovës: Mjekësia popullore dhe ritualet",** Zyrih 2000. I njëjti libër është botuar edhe në gjuhën gjermane: **"Das Gesundheitssystem Kosovas: Volks heilkunde und Rituale",** Zürich 2003.

**3. "Një jetë në shërbim të lirisë",** libër monografik kushtuar dëshmorit Naser Hani nga Struga, Prishtinë 2013.

**4. "Me Selman Lajçin nëpër Sanxhak",** libër monografik kushtuar dëshmorit Selman Lajçi, Prishtinë 2015.

**5. "Dymbëdhjetë legjenda shqiptare",** Prishtinë 2025.  
Ky libër është botuar edhe në gjuhën gjermane me titull:

**"Zwölf Albanische Legenden",** Prishtinë 2025.

Ky libër është dhe libri i tij i gjashtë me karakter politiko- publicistik.

ISBN 978-3-9525622-6-0



9 783952 562260 >